

V E N D I M

I K Q T E P P S H, I P R E S I D I U M I T T E K U V E N D I T P O P U L L O R D H E I K E S H I L L I T T E M I N I S T R A V E T E R P S H M B I 50-VJ E T O R I N E S H P A L L J E S S E P A V A R E S I S E

19 nëntor 1962

Më 28 Nëntor të këtij viti populli ynë, i lirë e sovran, i bashkuar si një trup i vetëm rreth Partisë së Punës të Shqipërisë, feston 50-vjetorin e shpalljes së pavarësisë së tij kombëtare.

Më 28 Nëntor 1912 Kuvendi Kombëtar i mbledhur në Vlorë, nën kryesinë e patriotit të shquar Ismail Qemali, mori vendimin historik që Shqipëria të shpallej shtet më vete, i lirë e i pavarur. Pas pesë shekujsh robërie, në këtë ditë të shënuar për historinë tonë kombëtare, u përmbys zgjedha e egër mesjetare turke dhe në qiellin e atdheut tonë filloi të valvitet i lirë flamuri i Skënderbeut.

Shpallja e pavarësisë së Shqipërisë dhe krijimi i shtetit kombëtar shqiptar ishin kurorëzimi i luftërave shekullore të popullit shqiptar kundër pushtuesve turq dhe synimeve grabitqare të fuqive imperialiste e të shovinistëve fqinj, fillimi i një etape të re të historisë mijërvjeçare të popullit tonë. Shteti i ri shqiptar lindi me vullnetin e shqiptarëve, në luftë kundër pushtuesve të huaj dhe kundër intrigave të fuqive imperialiste që kërkonin të copëtonin atdheun tonë.

E gjatë dhe e vështirë, por e lavdishme, ka qenë rruga historike për të arritur në shpalljen e pavarësisë. Ajo ka qenë një rrugë heroike e mbuluar me lavdinë e betejave të panumërta çlirimtare kundër perandorisë së fuqishme të osmanllinjve, një rrugë gjatë së cilës populli shqiptar shfaqti me një forcë të madhe dashurinë e tij të pakufishme për atdheun, urrejtjen e thellë për skllavërinë dhe shtypjen, aspiratat e flakta dhe vullnetin e tij të përpur për përparim, besimin e patundur për të fituar lirinë dhe trimërinë e pashoqe në luftën e pabarabartë me armiqtë. Këto virtyte të rralla të popullit shqiptar shkëlqyen me madhështi sidomos në luftën e madhe shqiptaro-turke të shekullit XV, të udhëhequr nga burri i madh i shtetit dhe strategu i shquar, Heroi Kombëtar Gjergj Kastrioti — Skënderbeu dhe në periudhën e Rilindjes shqiptare. Ja sepse populli shqiptar mundi t'u bënte ballë rre-

besheve të shekuive, t'i qëndronte politikës së egër asimiluese e përçarëse të sultanëve turq dhe të ruante gjuhën, traditat, kulturën, ekzistencën e tij si popull.

Sundimi i huaj solli shkatërrimin e forcave prodhuese dhe të vlerave materiale të krijuara nga populli, ai u shoqërua me obkurantizmin më të errët në fushën e kulturës, me shtypjen e ndjekjet më barbare, shkaktoi prapambetjen e thellë të atdheut tonë. Por, ndonëse të rrënuar e të grabitur sistematikisht nga pushtuesit e huaj, të zhveshur e pa bukë, të ndjekur e të gjakosur, bijtë e këtij vendi nuk u përlulën asnjëherë. Sulltanët e Turqisë lidhën pas vetes feudalët shqiptarë dhe i bënë ata vegla të politikës së tyre, por nuk mundën asnjëherë të shtronin popullin heroik shqiptar.

Periudha e sundimit turk në Shqipëri është e mbushur plot me kryengritje heroike popullore — çlirimtare nga ana e shqiptarëve. Nga gjiri i tij dhe në zjarrin e kryengritjeve të pareshtura populli nxori patriotë të mëdhenj e luftëtarë të shquar të çështjes sonë kombëtare. Nga gjiri i popullit shqiptar dhe në zjarrin e luftës dolën patriotët tanë të mëdhenj të Rilindjes si Naum Veqilharxhi e Zef Jubani, Kostandin Kristoforidhi e vëllezërit Frashëri, Ismail Qemali e patriotë të tjerë, të cilët përpunuan një program të qartë revolucionar të luftës së popullit tonë për liri e pavarësi. Veprimtaria e tyre patriotike është e lidhur me periudhën e shkëlqyer të Rilindjes shqiptare, me periudhën e luftës së gjerë çlirimtare dhe demokratike revolucionare, me pendë e me armë, për të fituar lirinë dhe pavarësinë e Shqipërisë.

Një nga faqet më të shkëlqyera të kësaj periudhe e përbën Lidhja e Prizrenit, e cila për tre vjet me radhë ngriti peshë malësorët e masat e tjera punonjëse dhe luftoi kundër politikës së fuqive të mëdha e të shteteve fqinjë, që synonin copëtimin e Shqipërisë si dhe kundër shtypësve shekullorë turq. Duke luftuar kundër të gjithë pushtuesve të huaj në emër të çështjes së shenjtë të çlirimit, Lidhja e Prizrenit shpalli autonominë e Shqipërisë dhe formoi qeverinë e parë kombëtare shqiptare. Megjithëse forcat e errëta të reaksionit turk e evropian e shtypën me zjarr dhe hekur Lidhjen e Prizrenit dhe kryengritjen e popullit, ajo shënoi një etapë të rëndësishme në rrugën drejt 28 Nëntorit 1912. Por lufta për çlirimin kombëtar nuk u ndërpre, ajo vazhdoi më me forcë në të gjitha drejtimet, brenda vendit dhe jashtë tij në kolonitë shqiptare të mërgimit. Forca të reja të ardhura nga radhët e vegjëlisë i dhanë lëvizjes patriotike një karakter më të theksuar antiimperialist, antifeudal, demokratik.

Kryengritja shqiptare u ndez edhe me shumë sidomos në vjetët 1910-1912 që e tronditën nga themelet Perandorinë turke. Dhe megjithëse përsëri Shqipëria kryengritëse u ndesh në politikën armiqësore të fuqive të mëdha imperialiste e të fqinjëve shovinistë, populli shqiptar çau përpara i vendosur për të fituar pava-

rësinë e tij. Kryengritja e madhe shqiptare, që shpërtheu si zjarr anembanë Shqipërisë dhe përfshiu gjithë popullin shqiptar, arriti kulmin më 1912. Marshimi triumfues i kryengritësve në të gjitha anët e vendit i trembi qeveritë shoviniste fqinje, të cilat kishin bërë marrëveshje të fshehta për ta copëtuar truallin e shqiptarëve dhe për ta fshirë emrin e Shqipërisë nga harta politike e Ballkanit. Ato nuk lanë gjë pa bërë për t'ua hequr nga dora shqiptarëve fitoret e arritura dhe, kur filloi Lufta e parë ballkanike, në tetor 1912, zunë të vinin në jetë me nxitim planet e tyre antishqiptare. Por edhe në këtë periudhë, e cila ishte një nga më të rëndat e historisë së tij, populli shqiptar nuk u çorientua, nuk u tremb e nuk u përul, por rrëmbeu armët për të mbrojtur atdheun nga pushtuesit e rinj.

Oshëtima e pushkëve dhe buçitja e kushtrimit të shqiptarëve «Ja vdekje, ja liri» i treguan botës se populli shqiptar është i vendosur deri në fund për të hequr qafe çdo zgjedhë të huaj dhe për të krijuar shtetin e vet të pavarur e sovran. Nga të gjitha krahinat e vendit buçiste zëri i masave për shpalljen sa më parë të pavarësisë kombëtare. Një valë e fuqishme entuziazmi e hareje u përhap anembanë atdheut, kur u muar vesh se Ismail Qemali, ky patriot dhe diplomat i madh i Shqipërisë, bashkë me një grup patriotësh të tjerë kishin marrë iniciativën për të mbajtur në Vlorë një kuvend kombëtar, që do ta shpallte Shqipërinë të pavarur. Mbarë populli ynë u bë mbështetja e fuqishme e Kuvendit Kombëtar, që u mblodh në Vlorë dhe i dha gjithë përkrahjen Ismail Qemalit, i cili më 28 Nëntor 1912 shpalli pavarësinë e Shqipërisë.

Shpallja e pavarësisë kombëtare më 28 Nëntor 1912 është një fitore e madhe historike, realizimi i ëndrrës shekullore të popullit tonë për të cilën ai kishte derdhur lumenj gjaku dhe kishte bërë sakrifica të panumërta në luftën e pabarabartë me armiq të fuqishëm, dinakë e barbarë, që kurorëzimi i përpjekjeve të tija vigane për liri qysh nga kohët më të lashta. Prandaj, populli shqiptar brez pas brezi do t'ua jetë mirënjohës e do t'i kujtojë me nderim të thellë gjithë patriotët e shquar, që tërë jetën e tyre punuan pa u lodhur dhe u shkrinë në luftë për të realizuar aspiratën e zjarrtë të popullit shqiptar, pavarësinë kombëtare, siç do ta ruajë ai thellë në zemër si një gjë të shtrenjtë edhe kujtimin e mijëra e mijëra njerëzve të thjeshtë, luftëtarë të njohur e të panjohur që nuk kursyen asgjë, as edhe gjakun e tyre në luftën për çështjen e shenjtë të çlirimit të atdheut.

Me shpalljen e pavarësisë dhe me lindjen e shtetit shqiptar populli ynë filloi luftën për konsolidimin e fitoreve të arritura dhe për përparimin ekonomik e shoqëror të vendit. Por shtetit tonë të porsalindur, të rrethuar në të gjitha anët nga armiqtë imperialistë e shovinistë të vendeve fqinje, ju desh të kalonte përsëri prova të rënda. Si rezultat i pazarllëqeve të fuqive imperialiste me kli-

kat shoviniste të vendeve fqinje, nga trunghi i Shqipërisë u shkëputën krahina të tëra. Kosova, Rrafshi i Dukagjinit dhe toka të tjera shqiptare në Maqedoni e në Mal të Zi kaluan nën zgjedhën e shteteve fqinje më 1913, kur u caktuan kufitë e Shqipërisë.

Më vonë, me Traktatin e fshehtë të Londrës të prillit 1915, fuqitë imperialiste vendosën ta zhduknin Shqipërinë nga harta e Evropës duke e copëtuar të gjithë midis tyre. Por populli shqiptar nuk e lejoi një gjë të tillë. Ai u ngrit përsëri në luftën e shenjtë për tërësinë tokësore të atdheut me parullën e luftëtarëve të lirisë «Ja vdekje, ja liri», të shkruar në flamurin e tyre të ngjyer me gjak. Në këtë kohë, midis reve të zeza që kishin pllakosur sërish atdheun tonë, lindi një rreze drite, ndodhi kthesa e madhe historike që luajti një rol vendimtar për fatet e popullit, triumfoi Revolucioni i madh socialist i Tetorit, i cili çau frontin e imperializmit botëror, themeloi shtetin e parë të punëtorëve dhe të fshatarëve, shënoi fillimin e epokës së revolucionit proletar, të shembjes së kapitalizmit dhe të kalimit të njerëzimit në socializëm në shkallë botërore. Botimi, me iniciativën e Leninit të madh, nga ana e qeverisë sovjetike i traktateve të fshehta imperialiste, midis të cilave edhe i Traktatit të fshehtë të Londrës, i tregoi popullit shqiptar gjithë prapaskenën që ishte kurdisur nga imperialistët në kurriz të tij. Në të gjitha anët e vendit shpërtheu një lëvizje e fuqishme popullore antiimperialiste. U mblodh Kongresi i Lushnjës i cili hodhi poshtë të gjitha intrigat e pazarllëqet e imperialistëve. Bijtë e shqipes, ndonëse të paarmatosur mirë, me në krye trimat e vegjëlisë si Selam Musai me shokë, u ngritën në epopë legjendare të Vlorës të 1920-s dhe u vërsulën me guxim mbi pushtuesit italianë, kapërcyen telat me gjemba, rrëmbyen topat nga gryka, i shkulën nga pozicionet e tyre dhe i flakën në det imperialistët. Kudo, në Jug dhe në Veri, luftohej kundër armiqve të pavarësisë shqiptare. Me luftën e tij, me gjakun e derdhur pa kursim në fushat e betejave të ashpra me armiqtë e tradhëtarët, me patriotizmin, me guximin dhe me besimin në fitore, populli shqiptar e ruajti pavarësinë e shpallur më 1912, rimëkëmbi shtetin e vet të pavarur dhe i detyroi imperialistët ta njohin atë. Qëllimet e imperialistëve dhe të shovinistëve të shteteve fqinje dështuan me turp. Luftërat e përpjekjet e popullit tonë për pavarësinë dhe tërësinë tokësore të atdheut u udhëhoqën me zotësi nga patriotët të shquar si Ismail Qemali e Luigj Gurakuqi, Ded Gjo Luli e Hasan Prishtina, Themistokli Gërmenji e Bajram Curri, Mihal Grameno e Çerçiz Topulli, Isa Buletini e shumë të tjerë, kujtimin e të cilëve do ta ruajë në shekuj me nderim e respekt gjithë populli ynë.

Pas sigurimit të pavarësisë kombëtare tehu i luftës së popullit të shumëvujtur shqiptar u drejtua kundër feudalëve vendës, që kishin qenë mbështetja kryesore e pushtuesve të huaj dhe i

pinin gjakun vegjëlisë. Lufta antifeudale për vendosjen e rendit demokratik në Shqipëri, u acarua, u rrit si një ortek dëbore dhe arriti shkallën më të lartë me revolucionin demokratiko-borgjez, që përmbysi në qershorin e 1924-s forcat e reaksionit dhe solli në fuqi qeverinë demokratike antiimperialiste. Shqipëria e vogël, e shtypur, e marrur nëpër këmbë u bë një vend demokratik dhe një bazë e rëndësishme edhe për lëvizjen revolucionare në Ballkan. Por reaksioni imperialist e ballkanik i trembur nga zhvillimi i ngjarjeve në Shqipëri, në bashkëpunim të ngushtë me reaksionin e brendshëm, të cilin qeveria e re nuk e zhduku plotësisht, e mbytën pa u mëkëmbur akoma demokracinë në Shqipëri. Me një sulm të kombinuar, ata vendosën në dhjetor të vitit 1924 pushtetin reaksionar të veglës së tyre, Ahmet Zogut.

Fitorja e kundërrevolucionit dhe vendosja e diktaturës zogiste në Shqipëri hapën një nga periudhat më të errëta në historinë e vendit tonë, periudhën gjatë së cilës për 15 vjet me radhë populli shqiptar u bë objekt i shfrytëzimit të egër çifligaro-borgjez dhe i kapitalit të huaj. Si rezultat i politikës zogiste të dyerve të hapura Shqipëria u kthye në fakt në një gjysmëkoloni të fashizmit italian.

Politika antipopullore e antikombëtare e Zogut shpuri në pushtimin fashist të vendit më 7 prill 1939. Shqipëria e humbi edhe një herë pavarësinë. Populli përsëri u ngrit më këmbë. Kërkoj armë për të luftuar agresorët. Por qeveria tradhëtare e Zogut nuk e armatosi popullin, e pengoi të luftonte dhe e braktisi atë duke u hapur rrugën armatave fashiste italiane, të cilat e pushtuan vendin me gjithë qëndresën e ashpër popullore.

Pushtimi fashist ishte një fatkeqësi e madhe, një zgjedhje e padurueshme për popullin shqiptar. Çdo shqiptar i ndershëm e shihte qartë se Shqipëria kishte rënë në një robëri po aq të rëndë e jo më pak të rrezikshme se ajo e kohës së sundimit turk. Pushtimi i Shqipërisë nga Italia fashiste vuri seriozisht në rrezik vetë ekzistencën e popullit tonë. Para popullit shqiptar u vu edhe një herë detyra e shenjtë të çohet më këmbë e me armë në dorë të luftonte kundër skllavëruesve të huaj, të çlironte vendin dhe të fitonte pavarësinë kombëtare. Populli shqiptar kurrë nuk u qe nënshtruar të huajve. Këtë ai s'mund ta lejonte dhe nuk e lejoi. Si gjithnjë, ai zgjodhi rrugën e luftës për liri, rrugën më të vështirë, por të vetmen rrugë të denjë për të.

Më kot u munduan shtypësit e huaj dhe veglat e tyre në vend, t'i nënshtronin shqiptarët. As premtimet as fjalët e bukura as kërcënimet nuk e penguan shpërthimin e fuqishëm të urrejtjes së popullit për skllavëruesit fashistë. Vala e urrejtjes popullore vinte çdo ditë duke u shtuar; ajo shprehej në forma konkrete, në demonstrata dhe në protesta antifashiste, në greva të punëtorëve dhe në luftë me armë kundër armiqve. Në këtë luftë për jetë a për

vdekje, populli e ndjente nevojën e një udhëheqje që ta printe drejt fitores së lirisë e të pavarësisë.

Pa një udhëheqje të shëndoshë revolucionare, të dalë nga gjiri i popullit, nuk mund t'i bëhej ballë armikut të egër e të fuqishëm dhe nuk mund të arrihej në fitore. Një udhëheqje të tillë populli shqiptar e gjeti te Partia Komuniste e Shqipërisë, që u formua në çastet më të vështira nëpër të cilat kalonte atdheu ynë. Krijimi i Partisë Komuniste (sot Partia e Punës) më 8 Nëntor 1941 qe një kthesë e madhe historike, në fatet e popullit tonë heroik, që do të luante një rol vendimtar për të ardhshmen e Shqipërisë.

Populli shqiptar pa te Partia Komuniste luftëtaren e vendosur deri në fund për mbrojtjen e interesave të larta të atdheut dhe të masave të shtypura e të shfrytëzuara, për plotësimin e kërkesave urgjente politike dhe të aspiratave shekullore të shqiptarëve, ai pa te ajo të vetmen udhëheqëse të zonjën, që do ta çonte atë në fitoren e plotë mbi armiqtë e jashtëm e të brendshëm.

Nën udhëheqjen e Partisë së Punës të Shqipërisë, me shokun Enver Hoxha në krye, populli shqiptar u ngrit peshë në Luftën Nacional-Çlirimtare, përsëriti epopenë e lavdishme të kohës së Skënderbeut dhe të Rilindjes shqiptare, por këtë radhë në një shkallë më të lartë, me një forcë edhe më të madhe. Lufta e tij tani synonte jo vetëm çlirimin e atdheut nga pushtuesit fashistë dhe sigurimin e pavarësisë së plotë kombëtare, por shkonte edhe më larg: në shkatërrimin e rendit çifligaro-borgjez dhe në ndërtimin e një Shqipërie të lirë demokratike popullore, ku pushteti të ishte në duart e popullit punonjës.

Në zjarrin e luftës antifashiste lindi dhe u forcua Fronti Nacional-Çlirimtar (sot Fronti Demokratik i Shqipërisë), që përbënte një bashkim të fuqishëm vullnetar të klasës punëtore, të fshatarësisë së varfër dhe të mesme, të borgjezisë së vogël dhe të mesme të qytetit, të intelektualëve patriotë, të të gjitha forcave revolucionare antifashiste të popullit shqiptar nën udhëheqjen e Partisë Komuniste të Shqipërisë. Ky bashkim mbështetej në luftën pa rezervë e pa kompromis kundër pushtuesve të huaj dhe tradhëtarëve. Një bashkim luftarak dhe organizim të tillë kurrë nuk e kishte njohur më parë historia e vendit tonë.

Lufta heroike e popullit të vogël shqiptar kundër fashistëve italianë dhe gjermanë ngjalli admirim në të gjithë botën dhe gjeti përkrahjen e popujve që luftonin kundër të njëjtit armik të njerëzimit kundër agresorëve fashistë. Mbështetjen pa rezervë dhe të sigurtë lufta çlirimtare e popullit tonë e gjeti në Luftën e madhe patriotike të Bashkimit Sovjetik, që luajti rolin vendimtar në shkatërrimin e Gjermanisë hitleriane dhe në shpëtimin e botës nga rreziku i robërimit fashist. Duke shkatërruar fashizmin, Bashkimi Sovjetik i dha mundësi edhe popullit tonë, që me luftën e

vet të çlironte vendin dhe të ndërtonte shtetin e demokracisë popullore.

Më 29 Nëntor 1944 agoi përgjithmonë dielli i lirisë, Shqipëria u çlirua krejt nga skllavëruesit fashistë dhe për të parën herë në historinë e atdheut tonë u vendos pushteti popullor. Për herë të parë populli shqiptar u bë zot i plotfuqishëm në tokën e tij, sepse jo vetëm likuidoi çdo zgjedhë të huaj, por së bashku me sundimin e imperialistëve zhdukoi edhe sundimin politik të çifligarëve e të borgjezisë së vendit. Klasat shfrytëzuese dhe organizatat reaksionare që i përfaqësonin ato, «Balli Kombëtar» e «Legaliteti», me qëndrimin e tyre antikombëtar, si vegla të pushtuesve fashistë, ngjallën urrejtjen e thellë të popullit, i cili i damkosi me vullën e tradhëtisë së lartë ndaj atdheut dhe i luftoi ato deri në fund.

Në saje të qëndrimit të drejtë dhe të taktikës së vendosur të Partisë sonë gjatë Luftës nacional-çlirimtare, me çlirimin e vendit, qysh në fillim të pushteti kaloi plotësisht në duart e klasës punëtore, në aleancë me të gjitha masat punonjëse e patriotë të vendit, në duart e një Partie të vetme, të Partisë Komuniste Shqiptare. Ky ishte kushti themelor që i krijoi mundësi vendit tonë t'i shmangej rrugës plot vuajtje e dhëmbje të zhvillimit kapitalist, e cila do ta shpinte atë patjetër përsëri nën sundimin imperialist dhe të futej pa vonesë në rrugën e zhvillimit socialist, që ishte në të njëjtën kohë rruga e sigurimit të vërtetë të lirisë dhe të sovranitetit të atdheut tonë.

Me fitoren e madhe të 29 Nëntorit 1944 u realizuan plotësisht dëshirat e zjarra dhe ëndrrat më të guximshme të patriotëve, të mendimtarëve dhe të revolucionarëve të mëdhenj shqiptarë, të mbarë popullit tonë. U realizuan qëllimet e larta për të cilat kanë luftuar dhe kanë derdhur lumenj gjaku shqiptarët në periudhën e Skënderbeut e të Rilindjes, më 1912 dhe më 1920, më 1924 dhe në Luftën nacional-çlirimtare.

Lufta shekullore që ka bërë populli shqiptar kundër zgjedhës së huaj dhe kurorëzimi i saj me fitoren e plotë më 29 Nëntor 1944 dëshmojnë në mënyrë bindëse se lirinë dhe pavarësinë kombëtare nuk ta falin kurrë pushtuesit imperialistë, as sundimtarët e brenshëm, por ajo fitohet me përpjekje, me gjak e me sakrificë.

Pas çlirimit, imperialistët, me ata amerikanë në krye, dhe veglat e tyre monarko-fashistët grekë e revizionistët jugosllavë u orvatën shumë herë, t'ja rrëmbenin popullit tonë frutet e fitores, ata organizuan komplete e thurën gjithfarë intrigash kundër lirisë dhe pavarësisë së vendit tonë. Por populli ynë, që ka derdhur aq gjak dhe ka vuajtur aq shumë për lirinë e pavarësinë e tij i udhëhequr nga Partia e Punës, nuk lejoi dhe nuk do të lejohet kurrë që ato të merren nëpër këmbë nga imperialistët, nga revizionistët dhe nga kushdo qoftë. Armiqtë që kanë guxuar të ngrenë

dorën kundër atdheut tonë socialist janë detyruar dhe do të detyrohen kurdoherë të zbrapsen para vendosmërisë dhe forcës së popullit tonë vigjilent e gjithmonë të gatshëm për të mbrojtur fitoret dhe të ardhshmen e tij socialiste.

18 vjet kanë kaluar që kur agoi jeta e re për popullin shqiptar. Një vend i shkatërruar fund e krye nga lufta, i zhytur në prapambetje e në mjerim ishte Shqipëria 18 vjet më parë. Kurse sot 50-vjetori i shpalljes së pavarësisë e gjen vendin tonë të shndërruar në një vend socialist, e gjen Republikën Popullore të Shqipërisë më të fortë se kurrë, pjesëtare të denjë të kampit socialist. Sundimi i kapitalit të huaj, mbeturinat feudale, prona kapitaliste në qytet dhe në fshat, mjerimi dhe analfabetizmi, sëmundjet shfarosëse i përkasin tani në Shqipëri vetëm historisë. Fabrikat, uzinat dhe minierat e vendit tonë, këtë vit, vëllimin e prodhimit industrial të gjithë vitit 1938 e nxjerrin vetëm në 12 ditë. Klasa punëtore e Shqipërisë, fshatarësia kooperativiste, inteligjencia jonë popullore, gjithë populli ynë, me një vrull të paparë i janë përveshur punës për ndërtimin e plotë të shoqërisë socialiste. Këto fitore kolosale janë rezultat i punës dhe i përpjekjeve të popullit tonë, i udhëheqjes së drejtë marksiste-leniniste të Partisë së tij të Punës. Për arritjen e këtyre fitoreve populli shqiptar ka pasur njëkohësisht ndihmën dhe përkrahjen e popujve vëllezër të vendeve socialiste — Bashkimit Sovjetik, Republikës Popullore të Kinës dhe të vendeve të tjera socialiste.

Garanci për sigurimin e lirisë dhe të pavarësisë së plotë kombëtare për t'i ruajtur ato të paprekura dhe për ndërtimin e socializmit në vendin tonë ka qenë, është dhe do të jetë, në radhë të parë, uniteti i çelniktë i popullit shqiptar rreth Partisë së tij të Punës dhe Komitetit Qendror të saj me shokun Enver Hoxha në krye. Ky unitet i popullit me Partinë është krijuar në zjarrin e Luftës nacional-çlirimtare, është kalitur me gjak dhe nëpërmjet vuajtjeve e vështirësive, është forcuar në punë e në përpjekje për ndërtimin e socializmit, është çelnikosur në luftën e pareshtur kundër imperializmit dhe veglave të tyre revizionistëve modernë. Ai ka kaluar përmes provash të shumta dhe është bërë i pathyeshëm. Në këtë unitet të çelniktë të popullit tonë janë ndeshur dhe janë shkatërruar të gjitha planet djallëzore të imperialistëve dhe të revizionistëve jugosllavë. Përballë këtij uniteti u dërmuan synimet antimarksiste e presionet e N. Hrushovit dhe të grupit të tij revizionist kundër Partisë së Punës të Shqipërisë dhe Republikës Popullore të Shqipërisë.

Me qëndresën e papërkulur përpara armiqve, me heroizmin që tregojnë në mbrojtjen e lirisë, të pavarësisë kombëtare, të rendit socialist dhe të paqes, populli dhe Partia jonë kanë fituar simpatinë e komunistëve, të popujve të kampit socialist, të popujve të shtypur dhe të të gjitha forcave përparimtare në botë.

Uniteti i patundur i popullit tonë dhe besimi i tij i thellë te Partia u manifestuan në mënyrë të shkëlqyer në zgjedhjet e qershorit të këtij viti për Kuvendin Popullor ku pothuajse qind për qind e zgjedhësve votuan për kandidatët e Frontit Demokratik, për vijën e drejtë të Partisë. Në këtë unitet të mrekullueshëm qëndron forca jonë. Ky unitet rreth PPSH është çelësi i fitoreve të mëdha që ka arritur populli ynë, është kështjella ku armiqtë kanë thyer dhe do të thyejnë kurdoherë kokën, është garancia për fitore të reja edhe më të mëdha në të ardhshmen.

Fitoret e arritura, lufta dhe përpjekjet titanike të popullit shqiptar e të Partisë sonë për ta bërë atdheun sa më të begatshëm, sa më të fortë dhe të zhvilluar nga çdo pikëpamje, bindja e thellë e masave në politikën e drejtë të Partisë, përkrahja që kanë populli dhe Partia jonë në lëvizjen revolucionare ndërkombëtare e kanë bërë të sigurtë realizimin e programit të ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste, që u aprovua në Kongresin IV të Partisë. S'ka forcë në botë që të ndalojë ecjen përpara të vendit tonë. Asnjë plan i armiqve, asnjë intrigë, asnjë bllokadë nuk do ta largojë popullin tonë nga rruga e tij. Ditë më të mira e më të bukura e presin popullin shqiptar. Prandaj, ai do të shkojë përpara, gjithmonë përpara, edhe më me guxim, për ta bërë Shqipërinë socialiste të lulëzuar, të përparuar dhe më të fortë në të gjitha drejtimet.

Por imperialistët nuk heqin dorë asnjëherë nga planet për ta penguar me çdo mënyrë punën paqësore të popullit tonë, nga veprimtaria e tyre për të na rrëmbyer lirinë e pavarësinë e për të përmbysur rendin socialist në Shqipëri, ashtu si nuk heqin dorë nga synimet për të likuiduar kampin socialist dhe çdo lëvizje revolucionare e çlirimtare të popujve. Për këtë arsye dhe për shkak të gjendjes së sotme ndërkombëtare të ndërlikuar e të nderë, populli shqiptar ka shtuar dhe çdo ditë shton edhe më shumë vigjilencën, gatishmërinë dhe fuqinë mbrojtëse të atdheut. Populli shqiptar e ka provuar në jetë dhe e ka të qartë se derisa ekziston imperializmi ekziston edhe rreziku i luftës, se imperialistët, me ata amerikanë në krye, kanë qenë dhe mbeten gjithnjë agresorë, të pabesë dhe armiqtë më të egër të lirisë e të pavarësisë së popujve. Pikërisht këtë tregojnë ngjarjet që po ndodhin sot në botë. Imperializmi, i plagosur rëndë, bën përpjekje të dështuara për të rifituar pozitën e humbura. Por asgjë s'mund ta shpëtojë atë nga vdekja. Rrota e historisë nuk kthehet prapa. Popujt nuk i tremben imperializmit, as armëve të tija atomike. Ata hedhin poshtë thirrjet e revizionistëve modernë për t'u pajtuar me shtypësit gjaksorë imperialistë, për t'u bërë atyre lëshime, që janë në dëm të pavarësisë kombëtare, të socializmit dhe të paqes botërore.

Duke festuar 50-vjetorin e shpalljes së pavarësisë, populli

shqiptar sjell ndërmend gjakun që ka derdhur dhe vuajtjet e shumta që ka hequr gjatë shekujve për të fituar këtë pavarësi dhe për të vendosur rendin socialist. Prandaj, ai nuk do të kursejë asgjë, as mundin dhe, po qe nevoja, as gjakun e tij për të mbrojtur kurdoherë lirinë, pavarësinë kombëtare, socializmin dhe paqen.

Në këto ditë të shënuara ai përulet me nderimin më të thellë përpara kujtimit të atyre që dhanë jetën për ta bërë Shqipërinë zonjë, të lirë dhe sovranë, të atyre që sollën fitoren e 28 Nëntorit 1912 dhe që siguruan fitoren e 29 Nëntorit 1944.

Komiteti Qendror i Partisë, Presidiumi i Kuvendit Popullor e Këshilli i Ministrave të RPSH u bëjnë thirrje gjithë popullit tonë, punëtorëve, fshatarëve, intelektualëve, të rinjve dhe grave që t'i njohin sa më mirë, t'i ruajnë si gjënë më të shtrenjtë dhe t'i zhvillojnë më tej traditat e lavdishme të të parëve tanë dhe të partizanëve në luftë për liri e pavarësi dhe për vendosjen e pushtetit popullor. Ato përbëjnë një thesar të madh dhe një forcë të tillë jetëdhënëse, të cilat do t'i ndihmojnë që, nën udhëheqjen e Partisë sonë, ashtu si deri më sot të kapërcejnë çdo pengesë e vështirësi dhe të korrin fitore të reja.

Duke festuar 50-vjetorin e shpalljes së pavarësisë dhe 18-vjetorin e çlirimit të atdheut masat tona punonjëse le të shtërngojnë edhe më shumë radhët e tyre rreth Partisë së Punës të Shqipërisë, trashëgimtares së denjë të traditave të shkëlqyera të të parëve, udhëheqëses së sprovuar të popullit, arkitektes së realizimit të ëndrrave të tyre më të guximshme. Partia e Punës e Shqipërisë dhe Komiteti Qendror i saj, me në krye shokun Enver Hoxha do të qëndrojnë si kurdoherë besnikë deri në fund ndaj interesave të popullit, do të ecin pa asnjë lëkundje në rrugën fitimtare të marksizëm-leninizmit, të ndërtimit të socializmit, për lavdinë e atdheut tonë, se ato mbështeten e kanë përkrahjen e gjithë popullit.

Le të manifestohet me një forcë të re vendosmëria e popullit tonë për të vënë në jetë vijën e drejtë marksiste-leniniste të Partisë, vendimet historike të Kongresit IV të PPSH, planet madhështore për lulëzimin e mëtejshëm të atdheut, për forcimin e Republikës sonë, që ajo të qëndrojë në shekuj si kështjellë e pamposhtur nga asnjë dallgë e stuhi, mburojë e çelniqtë dhe e lavdishme e jetës së saj të re dhe e socializmit në këtë pjesë të Ballkanit.

Le të kalitet gjithnjë më shumë në zemrat e punonjësve tanë patriotizmi i thellë popullor dhe internacionalizmi proletar, miqësia me popujt e vendeve të kampit socialist dhe solidariteti me popujt që luftojnë për liri, pavarësi, paqe e socializëm. Le të rritet vazhdimisht vigjilenca revolucionare në mënyrë që edhe në të ardhshmen të bëhen shkrumb e hi planet e agresorëve imperialistë

e të veglave të tyre revizionistëve modernë, për triumfin e çështjes së paqes dhe të socializmit.

Në këto ditë feste le të buçasë kudo në atdheun tonë të lirë gëzimi për jetën e re, le të kumbojë nga zemrat tona betimi solemn se do ta mbajmë gjithmonë lart e të nderuar flamurin e lirisë, të pavarësisë kombëtare, të socializmit e të komunizmit për të ardhshmen e lumtur të popullit e për lavdinë e përjetshme të atdheut tonë socialist.

Rroftë 50-vjetori i pavarësisë sonë kombëtare!
Lavdi popullit tonë heroik, punëtor e lirisdashës!

Rroftë Partia e Punës e Shqipërisë, organizatore dhe udhëheqëse e të gjitha fitoreve të popullit tonë!

KOMITETI QENDROR I PPSH
PRESIDIUMI I KUVENDIT POPULLOR TË RPSH
KËSHILLI I MINISTRAVE TË RPSH

Botohet sipas gazetës

«Zëri i Popullit»,

Nr. 278, 21 nëntor 1962

PLENUMI IX I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Tiranë, 25-26 janar 1963

K O M U N I K A T E

MBI MBLEDHJEN E PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR
TË PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË

Më 25-26 janar 1963 u mbledh nën kryesinë e Sekretarit të Parë të Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, shokut Enver Hoxha, Plenumi i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë.

Plenumi dëgjoi dhe diskutoi raportin e Byrosë Politike të Komitetit Qendror «Mbi plotësimin e planit dhe të buxhetit për vitin 1962 dhe mbi masat për plotësimin e planit dhe të buxhetit për vitin 1963», të mbajtur nga anëtari i Byrosë Politike të Komitetit Qendror dhe zëvendëskryetar i parë i Këshillit të Ministrave të RPSH shoku Spiro Koleka.

Plenumi aprovoi njëzëri vendimin përkatës¹.

Në plenum muarën pjesë edhe sekretarët e parë të komiteteve të Partisë dhe kryetarët e komiteteve ekzekutive të rretheve, kuadro të dikastereve dhe ndërmarrjeve ekonomike, institucioneve arësimore, kulturele e shëndetësore, punonjës të aparatit të Komitetit Qendror të PPSH dhe të organizatave të masave etj.

Në plenum e mori fjalën edhe Sekretari i Parë i Komitetit Qendror të PPSH, shoku Enver Hoxha, i cili foli mbi disa probleme kryesore aktuale.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Botohet sipas gazetës

«Zëri i Popullit» Nr. 23,

27 janar 1963

1 Shih broshurën: Vendim i Plenumit të KQ të PPSH «Mbi plotësimin e planit dhe të buxhetit për vitin 1962 dhe mbi masat për plotësimin e planit e buxhetit për vitin 1963». Tiranë, 1963.

PLENUMI X I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Tiranë, 6-8 qershor 1963

KOMUNIKATË

MBI MBLEDHJEN E PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Nga 6 deri më 8 qershor 1963, u mbledh Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH, i cili dëgjoi raportin e Byrosë Politike të Komitetit Qendror të PPSH «Mbi gjendjen ekonomike, sociale e kulturele të fshatit dhe masat për ngritjen e mëtejshme të saj», mbajtur nga Sekretari i Parë i Komitetit Qendror të PPSH, shoku Enver Hoxha.

Plenumi diskutoi gjerësisht rreth raportit dhe e aprovoi atë njëzëri.

Në plenum muarën pjesë edhe sekretarët e parë të komiteteve të Partisë dhe kryetarët e komiteeve ekzekutive të këshillave popullore të rretheve, kuadro nga dikasteret dhe nga institucionet qendrore, nga organizatat e masave, nga aparati i Komitetit Qendror të PPSH, kryetarë të këshillave popullore të lokaliteteve, kryetarë të kooperativave bujqësore, arësimtarë, përgjegjës të shtëpive dhe të vatrave të kulturës, mjekë, punonjës të tregëtisë, përfaqësues të shtypit e të tjerë.

Në përfundim të punimeve të plenumit, në fjalën e mbylljes, shoku Enver Hoxha foli edhe për disa çështje të situatës ndërkombëtare.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

RAPORT I MBAJTUR NGA SEKRETARI I PARË I KQ TË PPSH, SHOKU ENVER HOXHA, «MBI GJENDJEN EKONOMIKE, SOCIALE E KULTURALE TË FSHATIT DHE MASAT PËR NGRITJEN E MËTEJSHME TË SAJ»

6 qershor 1963

Shokë dhe shoqe,

Partia jonë, duke u udhëhequr kurdoherë nga marksizëm-leninizmi fitimtar, ka luftuar dhe lufton vazhdimisht për arritjen e qëllimeve më humane e fisnike në botë, për ndërtimin e socializmit e të komunizmit, për ta bërë jetën e njeriut, jetën e popullit, sa më të lumtur e të begatshme. Dhe në këtë luftë ajo ka korrur fitore kolosale. Por në luftën për socializmin e komunizmin, për të mirën e popullit, që është një luftë e gjatë, pas çdo kalaje ne duhet të pushtojmë kala të reja. Këtij qëllimi do t'i shërbejë edhe mbledhja e sotme e Plenumit të Komitetit Qendror të PPSH ku, veç anëtarëve të tij, marrin pjesë edhe një numër i madh kuadros të tjerë të interesuar.

✓ Kjo mbledhje e plenumit bëhet për të shqyrtuar përmirësimin e mëtejshëm të gjendjes ekonomike, sociale e kulturele në fshat, mbi bazën e shfrytëzimit të rezervave të shumta që lindin nga një administrim më racional i vlerave materiale të krijuara nga punonjësit e vendit tonë.

Duke vlerësuar rëndësinë e madhe që paraqet ky problem në ndërtimin e plotë të shoqërisë socialiste, Komiteti Qendror i Partisë bëri një studim të hollësishëm dhe të gjithanshëm. Si kurdoherë edhe për këtë çështje Partia organizoi një konsultim të gjerë popullor, ku muarën pjesë gjallërisht organizatat e Partisë, organet e pushtetit, organizatat e masave, kryesitë e kooperativave bujqësore, fshatarësia punonjëse dhe shumë specialistë të ndryshëm. Mendimi kolektiv krijues i masave punonjëse dhe propozimet e shumta, të shprehura prej tyre gjatë konsultimit, shërbyen jo vetëm si bazë për hartimin e këtij raporti, por janë edhe një pasuri me vlerë të madhe, që do ta ndihmojnë shumë Partinë tonë në punën e saj të ardhshme në fshat.

Partia, duke ndërmarrë këtë studim, nisat nga teza e mirënjohur marksiste-leniniste se ndërtimi i plotë i shoqërisë socialiste kërkon edhe marrjen e masave që çojnë drejt ngushtimit të ndryshimit esencial midis qytetit dhe fshatit, nisat nga vendi që zë dhe roli që luan fshati në zhvillimin e përgjithshëm të ekonomisë popullore si dhe nga nevoja për perfeksionimin e mëtejshëm të marrëdhënjëve socialiste në fshat.

✓ Qëllimi kryesor i këtij studimi është që, duke u mbështetur në rezultatet e arritura në ndërtimin socialist të fshatit, në premisat

dhe në kushtet e reja që janë krijuar, të përcaktojmë rrugët që e bëjnë të mundur shpejtimin e ritmeve të ngritjes së mirëqenjes e të nivelit kultural të fshatarësisë duke shfrytëzuar në mënyrë më racionale dhe efektive mundësitë e shumta që krijon sistemi ynë shoqëror.

Mësimet e marksizëm-leninizmit dhe lufta e deritanishme e Partisë për t'i vënë ato në jetë, na japin të drejtën të pohojmë se ndërtimi i socializmit në fshat është një proces i gjatë, që përfshin një varg transformimesh revolucionare me karakter social, ekonomik, teknik, kultural dhe ideologjik. Duke ndjekur një vijë të përgjithshme të drejtë dhe konsekuente marksiste-leniniste, Partia ka punuar që detyrën e ndërtimit të plotë të socializmit në fshat ta zgjidhë dora-dorës me krijimin e premisave përkatëse që kërkon ky proces revolucionar.

Në të kaluarën Shqipëria ishte një vend thellësisht i prapambetur bujqësor. Prandaj Partia, që në krijimin e saj, dhe sidomos pas vendosjes së pushtetit popullor, tregoi një kujdes të veçantë për zgjidhjen e drejtë dhe të shpejtë të çështjes agrare. Drejtësia e tezës së Leninit mbi nevojën e shndërrimit të fshatarësisë në aleate besnike të klasës punëtore, si në marrjen e pushtetit politik ashtu edhe gjatë ndërtimit të socializmit, u vërtetua plotësisht edhe në veprimtarinë e Partisë sonë në të gjitha etapat e zgjidhjes së çështjes agrare dhe në të gjithë politikën e saj ekonomike në fshat, që është kurorëzuar kurdoherë me sukses.

Në procesin e zgjidhjes së problemeve ekonomike, reforma agrare shënoi *revolucionin e parë në marrëdhënjet social-ekonomike të fshatit*. Tipari kryesor i këtij revolucioni ishte transformimi demokratik i marrëdhënjeve të pronësisë mbi tokën, fshirja nga faqja e dheut përfundimisht e mbeturinave të feudalizmit në ekonomi, likuidimi i klasës së çifligarëve, dhënja e tokës falas fshatarësisë sipas parimit «toka i përket atij që e punon». Si rezultat i zbatimit të reformës agrare, shumica e madhe e ekonomive të fshatarëve të varfër, nga pikëpamja e sasisë së tokës, u ngrit deri në nivelin e ekonomive të fshatarëve të mesëm dhe kështu filloi procesi i shndërrimit të fshatarit të mesëm në figurë qendrore të fshatit. Me ndalimin e shitblerjes, të dhënjes me qira e të jetërsimit të tokës si dhe me masat e tjera që ka marrë Partia e pushteti, u kufizua shumë diferencimi i fshatarësisë në dy pole ekstreme, në të varfër dhe në të pasur. Shtetëzimi i industrisë, i bankave, vendosja e monopolit shtetëror mbi tregëtinë e jashtme dhe masat e tjera të kësaj natyre i dhanë fund shfrytëzimit të fshatit nga qyteti dhe e çliruan fshatarësinë nga barra e rëndë e borxheve dhe e fajdesë, që ishte e detyruar të paguante. Si rrjedhim, fshatarësia punonjëse, për të parën herë, u bë zot i tokës dhe filloi të punojë e të prodhojë për vete, të ushqehet dhe të

jetojë më mirë, të përmirësojë gjendjen e saj ekonomike, sociale e kulture.

Por Partia e ka pasur kurdoherë të qartë se rruga e vetme për ndërtimin e socializmit në fshat ishte krijimi i marrëdhënjeve të reja socialiste në prodhim duke zëvendësuar pronën e vogël individuale të fshatarësisë me pronën e madhe kolektive. Për këtë arësye Partia, e mbështetur në frymën revolucionare të fshatarësisë dhe në premisat e krijuara pas vendosjes së pushtetit popullor, i bëri thirrje fshatarësisë të hynte vullnetarisht në rrugën e kooperimit të bujqësisë, në rrugën e socializmit.

Dhe fshatarësia jonë ju përgjeggj me entuziazëm kësaj thirrjeje. Tani marrëdhënjet socialiste në prodhim janë vendosur edhe në fshat. Kolektivizimi i bujqësisë që *revolucioni i dytë, kthesa revolucionare më rrënjësore në marrëdhënjet social-ekonomike të fshatit*. Zëvendësimi i prodhimit të vogël fshatar me prodhimin e madh socialist, i cili është në gjendje të sigurojë riprodhimin e zgjeruar, ka hapur rrugën për zhvillimin e shpejtë të fshatit.

Fitorja e socializmit solli edhe ndryshime të thella sociale. Klasa shfrytëzuese e kulakëve u likuidua. Vetë natyra e fshatarësisë punonjëse ndryshoi: në vend të fshatarësisë individuale lindi dhe po forcohet klasa e re, fshatarësia kooperativiste. Si rezultat i vendosjes së pronës shoqërore në qytet dhe në fshat, u likuidua gjithashtu kontradikta antagonistike shekullore midis qytetit dhe fshatit, e cila, sikurse shkruante K. Marksi, mund të ekzistojë «vetëm në kuadrin e pronës private» dhe përbënte një nga bazat më të thella të prapambetjes ekonomike dhe kulture të fshatit në të kaluarën.

Mbi bazën e rritjes së prodhimit janë shtuar gjithnjë e më shumë të ardhurat e fshatarësisë dhe është përmirësuar gjendja e saj materiale. Revolucioni kultural vazhdon të zhvillohet dhe të shtrihet gjithnjë më thellë në fshat. Numri i shkollave, i nxënësve, i shtëpive e i vatrave të kulturës, i institucioneve shëndetësore dhe i kuadrove të kualifikuar në fshat po rritet pareshtur.

Papunësia e fshehtë agrare, e cila, para vendosjes së pushtetit popullor, ishte një plagë e madhe shoqërore për vendin tonë, u zhdruk një herë e përgjithmonë. Në të kaluarën, çdo vit, me mijëra fshatarë, të shtyrë nga skamja dhe nga uria, ishin të shtërnguar të merrnin rrugët e largëta të kurbetit për të kërkuar punë larg atdheut, larg familjes dhe fafesisit, duke ju nënshtruar shfrytëzimit të egër dhe të pamëshirshëm të kapitalistëve të huaj. Kurse sot në fshatin e ri socialist jo vetëm që ka punë për të gjithë dhe jeta po bëhet çdo ditë më e bukur dhe më e lumtur, por zhvillimi i mëtejshëm i forcave prodhuese shoqërohet gjithnjë e më shumë me rritjen e nevojës për forca të reja pune.

Në përputhje me kushtet e reja ekonomike, sociale e kulture, fshatarësia jonë kooperativiste ka filluar të transformojë

dalëngadalë edhe mënyrën e vjetër të jetesës, duke përqaftuar një jetesë të re, të kulturuar. Ajo ka filluar të ndërtojë shtëpi të bukura e të rehatshme, të përpiqet për pastërtinë dhe mbajtjen e higjienës, të përmirësojë mënyrën dhe strukturën e të ushqyerit, të ndryshojë mënyrën e vjetër të veshjes etj. Në fshatin e ri kooperativist janë ngritur çerdhe e kopshte fëmijësh, të cilat janë një ndihmë e mirë për rritjen e shëndoshtë e të kulturuar të brezit të ri, për edukimin e tij me frymën e kolektivitetit dhe që lehtësojnë pjesëmarrjen e gruas në prodhim.

Edhe në fushën e ideologjisë e të psikologjisë së fshatarit janë bërë ndryshime të dukshme. Sot bëhet një luftë e vazhdueshme bindëse kundër paragjyqimeve fetare e zakoneve prapanike dhe shumë prej tyre po zhduken. Në ndërgjegjen e fshatarit kooperativist po rrënohet botëkuptimi i ri socialist, po lindin zakone e qëndrime të reja ndaj çështjeve në shoqëri e në familje.

Këto janë disa nga sukseset më të rëndësishme të transformimit socialist të fshatit dhe kjo është gjendja në pamjet e tija të përgjithshme. Këto suksese janë rezultat i politikës së Partisë sonë dhe i punës së madhe që ka bërë fshatarësia punonjëse. Në rrugën për zbatimin e kësaj politike Partisë i është dashur të bëjë një luftë të vendosur dhe të papajtueshme kundër të gjitha shfaqjeve oportuniste, revizioniste dhe sektare, brenda dhe jashtë radhëve të saja, për të mbrojtur vijën e përgjithshme politike, ekonomike dhe ideologjike. Prandaj, ne kemi arësye të plotë të themi se politika që ka ndjekur Partia për fshatin në procesin e transformimit të tij socialist, ka qenë një politikë e drejtë marksiste-leniniste, e matur dhe e zbatuar në mënyrë krijuese, në përputhje me gjendjen reale të fshatit dhe të vendit në tërësi. Sado që të shpifin imperialistët, revizionistët modernë, Nikita Hrushovi, Titua dhe pasuesit e tyre, gjithë armiqtë e tjerë të Partisë e të popullit tonë, rezultatet e kësaj politike shkëlqejnë si asnjëherë dhe nuk do të errësohen kurrë nga asnjëri.

Por studimi i gjendjes së sotme të fshatit nxjerr në shesh edhe disa çështje e probleme të rëndësishme, për zgjidhjen e të cilave duhet të mendojnë e të punojnë më shumë organet e Partisë e të shtetit, të gjitha masat tona punonjëse. Këto probleme janë të lidhura ngushtë me gjendjen dhe kushtet e reja që janë krijuar në vendin tonë, me mundësitë dhe pasuritë që ka sot fshatarësia, me administrimin më të mirë dhe më me vend të këtyre pasurive, për rritjen e mëtejshme të mirëqenjes së fshatit.

Lind pyetja: Pse e shtrojmë edhe sot këtë problem, në tërësi-në e tij dhe me forcë kaq të madhe?

Së pari, sikurse e theksuam edhe më lart, në vendin tonë marrëdhënjet socialiste në prodhim u vendosën si në qytet ashtu edhe në fshat. Vendosja e tyre zhduku çdo bazë për kontradiktën

antagoniste midis fshatit dhe qytetit. Megjithatë, midis fshatit dhe qytetit ekzistojnë akoma ndryshime të mëdha dhe esenciale, të cilat kanë të bëjnë me nivelin e zhvillimit të forcave prodhuese, me shkallën e shoqërizimit të mjeteve të punës dhe të vetë punës, me kushtet dhe me mënyrën e jetesës, me zhvillimin e kulturës, të arësimit, të shëndetësisë etj. Natyrisht, për zhdukjen e këtyre ndryshimeve duhet një periudhë e gjatë, por ndërtimi i plotë i shoqërisë socialiste kërkon që ato të ngushtohen gjithnjë më shumë. Në këtë rast ne nisemi nga teza e Leninit, i cili thotë se për ndërtimin e komunizmit «duhet të zhduket ndryshimi ndërmjet fshatit dhe qytetit...»¹.

Së dyti, ndërtimi i plotë i socializmit në fshat është i lidhur ngushtë me perfeksionimin e mëtejshëm të marrëdhënjeve në prodhim. Krijimi i bazës materialo-teknike të socializmit nënkupton një zhvillim të madh të forcave prodhuese në fshat. Prandaj, ne duhet të kujdesemi që, krahas me këtë zhvillim, të marrim masa për perfeksionimin e anëve të ndryshme të marrëdhënjeve në prodhim me qëllim që ato të luajnë rolin e tyre të vërtetë historik si fuqi lëvizëse për t'i çuar përpara forcat prodhuese.

Së treti, detyrat e mëdha që shtrohen për ndërtimin e plotë të shoqërisë socialiste, për zhvillimin dhe për intensifikimin e bujqësisë, nuk mund të zbatohen me sukses në qoftë se nuk do të marrim masat e nevojshme për të ngritur më lart gjendjen ekonomike, sociale dhe kulturele të fshatit. Dihet se ekonomia socialiste ecën përpara mbi të dy këmbët, mbi industrinë dhe bujqësinë. Prandaj, nga gjendja dhe nga zhvillimi i bujqësisë varet në një shkallë të madhe edhe zhvillimi i industrisë. Si rrjedhim, ndërtimi i plotë i shoqërisë socialiste kërkon që fshati të zhvillohet me ritme të shpejta në të gjitha drejtimet.

Së katërti, për zgjidhjen e detyrave të reja që na dalin përpara, ne kemi mundësi më të mëdha e kushte më të favorshme, që atyre t'u kushtojmë gjithë vëmendjen dhe kujdesin e Partisë e të shtetit. Ne përfundam me sukses kolektivizimin e bujqësisë dhe kështu krijuam në fshat kushte të reja organizative dhe ekonomike për zhvillimin e tij të vullshëm. Tani ne kemi krijuar një bazë industriale, e cila mund t'i vijë në ndihmë më shumë fshatit për zgjidhjen e detyrave të reja në fushën ekonomike e kulturele, për ngritjen e mirëqenjes dhe për përmirësimin e mënyrës së jetesës. Kemi krijuar një rrjet të gjerë institucionesh arësimore e kulturele. Më së fundi, ne kemi krijuar një ushtri të tërë kuadrosh të lartë e të mesëm, të cilët, nën udhëheqjen e Partisë janë të gatshëm të vënë tërë forcat dhe dijet e tyre në shërbim të ndërtimit të plotë të socializmit në vendin tonë.

¹ Shih: V. I. Lenin. Veprat, vëll. 29, f. 467.

Kuptohet vetiu se zgjidhja e detyrave të mëdha që na shtron përpara ngritja e mëtejshme e gjendjes ekonomike, sociale e kulturele të fshatit, do ta forcojë dhe konsolidojë akoma më shumë aleancën midis klasës punëtore dhe fshatarësisë.

Si konkluzion, mund të themi se Partia e shtron me forcë të tillë këtë problem të madh, sepse zgjidhja e tij është një domosdoshmëri objektive, që diktohet nga vetë etapa e re e zhvillimit historik të vendit tonë — ndërtimi i plotë i shoqërisë socialiste.

Natyrisht, ne jemi të bindur dhe të vetëdijshëm se për zgjidhjen me sukses të problemeve që shtrohen sot lidhur me ngritjen e mirëqenjes së fshatarësisë, rolin vendimtar do ta luajë rritja e prodhimit. Megjithatë rritja e pareshtur e prodhimit nuk mund të arrihet pa siguruar njëkohësisht një shpërndarje të drejtë të produktit shoqëror, pa ngritur në një shkallë më të lartë mënyrën e jetesës, arësimin, kulturën, shërbimet komunale e të shëndetësisë. Midis prodhimit, nga njëra anë, dhe shpërndarjes e nevojave materiale e kulturele, nga ana tjetër, ekziston një lidhje dhe bashkëveprim reciprok i përhershëm dhe organik. Vendosja e një shpërndarjeje të drejtë të produktit rrit konsumin, i cili është një kusht i domosdoshëm për zhvillimin e pareshtur të prodhimit. Futja e teknikës së re dhe zbatimi i agroteknikës së përparuar në bujqësi, pa të cilat nuk mund të ketë zhvillim të shpejtë të prodhimit bujqësor varen në një shkallë të madhe edhe nga niveli arësimor e kultural i masave fshatare.

Ne jemi gjithashtu të bindur e të vetëdijshëm se për të rritur më tej prodhimin dhe mirëqenjen në fshat, një rëndësi të madhe ka edhe faktori subjektiv, roli udhëheqës i Partisë dhe i shtetit, gjithë veprimtaria e tyre politike, ekonomike, kulturele dhe organizative.

Partia jonë, duke e shtruar në këtë kohë dhe në këtë mënyrë këtë problem, zbaton në mënyrë krijuese marksizëm-leninizmin, duke bashkuar shkencërisht në një të tërë të vërtetën e përgjithshme të doktrinës sonë fitimtare me kushtet konkrete të vendit tonë.

Në këtë plenum ne nuk do të ndalemi në çështjet agroteknike që kanë të bëjnë me zhvillimin e shpejtë të prodhimit bujqësor, pasi këto u përcaktuan me hollësi në mbledhjen e Plenumit të torit 1962 mbi intensifikimin e bujqësisë, por do të shqyrtojmë gjendjen ekonomike, sociale e kulturele të fshatit dhe masat për ngritjen e mëtejshme të saj. Detyrat që do të caktojë ky plenum, do ta pasurojnë edhe më shumë eksperiencën e madhe, të grumbulluar nga Partia jonë, lidhur me zbatimin krijues të marksizëm-leninizmit për ndërtimin e socializmit në fshat.

ZHVILLIMI I FORCAVE PRODHUESE MBI BAZËN E MARRËDHËNJEVE SOCIALISTE NË PRODHIM — FAKTOR VENDIMTAR PËR NGRITJEN E MIRËQENJES NË FSHAT

Siç dihet, vendi ynë trashëgoi nga e kaluara një prapambetje shumë të madhe në të gjitha fushat e jetës shoqërore. Në fshat mbisundonin marrëdhënjet gjysmëfeudale. Bujqësia kishte karakter primitiv. Në të mbizotëronte monokultura dhe ajo zhvillohej në mënyrë ekstensive, kryekëput mbi bazën e ekonomive të vogla e të copëtuara. Toka punohej me metoda dhe me vegla primitive. Mjetet e mekanizuara moderne, plehurat kimike dhe farërat e zgjedhura mungonin; ujitja ishte shumë e kufizuar, ndërsa numri i specialistëve ishte krejt i pamjaftueshëm. Si rrjedhim, rendimenti i kulturave bujqësore, produktiviteti i blegtorisë dhe gjithë prodhimi bujqësor ishin të ulët.

Kjo gjendje si dhe politika ekonomiko-sociale e klasave sunduese, frenonin zhvillimin e lirë të forcave prodhuese në fshat. Fshatarësia punonjëse kishte si bashkudhëtarë të saj të pandarë skamjen, varfërinë, urinë, sëmundjet dhe padijen. Në të njëjtën kohë, ajo shtypej nga tatimet e shumta, ripej nga fajdexhinjtë dhe vuante nga arbitrariteti i plotë i shtetit dhe i çifligarëve. Partia e kishte të qartë se me nivelin e trashëguar të forcave prodhuese dhe me marrëdhënjet e vjetra në prodhim, nuk mund të ecej përpara drejt përmirësimit rrënjësor të gjendjes materiale e kulturele të fshatit. Prandaj, fill pas vendosjes së pushtetit popullor, ajo u kushtoi një vëmendje të veçantë e të vazhdueshme problemeve të zhvillimit ekonomik, social e kultural të fshatit. Nga reforma agrare te kolektivizimi i bujqësisë, nga futja e mekanikës bujqësore deri te veprat madhështore të bonifikimit dhe të ujitjes, nga ndihmat me farëra të zgjedhura e me plehra kimike deri te përkrahja e gjerë me anë të politikës financiare e të kreditit, nga pregatitja e kuadrove deri te ngritja e nivelit arësimor dhe agroteknik të fshatarësisë e shumë e shumë të tjera, të tilla janë hallkat e panumërta të vargut të gjatë të masave që ka marrë Partia për transformimin socialist të fshatit.

Tani kolektivizimi i bujqësisë në përgjithësi ka përfunduar; kooperativat bujqësore përfshijnë 86 për qind të sipërfaqes së tokës arë në pronësi të fshatarësisë dhe 71,4 për qind të ekonomive fshatare. Ato janë bërë baza kryesore e prodhimit bujqësor dhe kanë rritur shkallën e prodhimit për treg. Një zhvillim të mëtejshëm kanë shënuar edhe forcat prodhuese në fshat, si rezultat i të cilit është rritur edhe pasuria që ka sot fshatarësia.

Sipërfaqja e tokës nën kulturë, e cila përbën mjetin kryesor të prodhimit në bujqësi, në vitin 1962 u rrit 196 000 ha. në kra-

hasim me vitin 1938, ose 67 për qind më shumë. Rritja e sipërfaqes së mbjellë, kundrejt vitit 1938, ka qenë më e theksuar në rrethet e Krujës, Tiranës, Fierit, Durrësit, Lushnjës, Shkodrës, Elbasanit dhe më e kufizuar në rrethet e Përmetit, Skraparit, Pukës, Pogradecit, Gjirokastrës dhe Mirditës.

Sipërfaqja e tokës nën kulturë ka shënuar një rritje absolute si Republikë dhe për frymë të popullsisë, pavarësisht nga fakti që popullsia është rritur shumë: nga 1 040 353 në vitin 1938, në 1 727 945 më 1962. Kështu, për shembull, në vitin 1938 çdo frymë të popullsisë i takonte 2,81 dynym tokë nën kulturë, kurse në fund të vitit 1962 i takonte 2,85 dynym. Mirëpo në këtë mesatare të përgjithshme përfshihen ndryshime midis rretheve. Në një kohë kur rretheve të Lushnjës, të Fierit, të Krujës dhe të Lezhës u takon nga 4—6 dynym tokë nën kulturë për frymë të popullsisë, në disa rrethe të tjera, si në Pukë, Mirditë, Mat, Tropojë, Shkodër, Vlorë dhe Elbasan, kjo mesatare është shumë më e ulët dhe lëviz nga 0,8 në 2,7 dynym për frymë të popullsisë.

Edhe në blegtori ne kemi arritur rezultate të mira në përmirësimin e racës, në rritjen e numrit të lopëve, të dhive dhe, në mënyrë të veçantë, në rritjen e derrit. Në vitin 1961, në krahasim me vitin 1938, numri i lopëve ishte 34 mijë më shumë ose 30 për qind më shumë, i derrave 113 mijë më shumë ose mbi 8 herë më shumë, i dhive 210 mijë më shumë ose 23 për qind më shumë, kurse për dhentë është tejkualuar në 12 000 kre-rë numri i paraluftës. Një zhvillim i madh është arritur edhe në rritjen e bletëve, numri i të cilave gati është dyfishuar në krahasim me paraluftën.

Rezultatet e arritura në zhvillimin e blegtorisë kanë një rëndësi edhe më të madhe, po qe se marrim parasysh dëmet shumë të mëdha që ju shkaktuan asaj nga pushtuesit e huaj dhe nga tradhëtarët e vendit. Gjatë kohës së pushtimit u therën dhe u grabitën 20—30 për qind e numrit të përgjithshëm të krerëve të blegtorisë dhe sidomos u dëmtuan shumë qetë e punës. Përveç kësaj, përsa u përket qeve, numri i tyre edhe sot është më i vogël se ai i paraluftës, për arsye se, krahas me rritjen e shkallës së mekanizimit të punimeve bujqësore, nuk është treguar kujdes i duhur për shtimin e numrit të tyre. Për bujqësinë tonë, për konfiguracionin e tokës, për reshjet e shumta, qetë e punës janë të domosdoshëm, bile shpeshherë të pazëvendësueshëm. Prandaj, është e arsyeshme dhe e nevojshme që pakësimi i numrit të qeve, i cili është krijuar gjatë vjetëve të kaluar, të ndreqet patjetër në vjetët e ardhshëm duke shtuar me ritme më të shpejta fuqinë e gjallë tërheqëse në fshat.

Në të ardhshmen problemit të zhvillimit të blegtorisë duhet t'i kushtohet një vëmendje e posaçme, pasi kjo degë e bujqësisë jo vetëm që zë një peshë të madhe në prodhimin e përgjithshëm

bujqësor, por edhe i siguron fshatarësisë të ardhura relativisht më të qëndrueshme.

Një rritje veçanërisht e madhe është arritur në fondin e kulturave drusore. Në vitin 1961 janë rritur më shumë se në vitin 1938: ullinjë 62,5 për qind, vreshtat 148,8 për qind dhe pjergullat afro 5 herë, kurse po në vitin 1961 në krahasim me vitin 1947, pemët frutore janë rritur 3,6 herë dhe agrumet mbi 6 herë.

Ne përmendëm këtu vetëm një pjesë të rëndësishme të pasurisë që ka sot fshatarësia. Përveç kësaj, shteti ynë ka vënë në dispozitim dhe në shërbim të fshatarësisë edhe pasuri të tjera shumë të mëdha. Që nga çlirimi e deri në fund të pesëvjeçarit të dytë, vetëm për veprat e bonifikimit dhe të vaditjes, shteti investoi rreth 6 miliard lekë, ndërsa plani i tretë pesëvjeçar parashikon të shpenzohen po për këtë qëllim edhe rreth 4 miliard lekë të tjerë. Si rezultat i këtyre investimeve, sipërfaqe të mëdha toke në Myzeqe, në Maliq, në Vurg, në Thumanë etj., që dikur ishin moçalishite, sot janë kthyer në toka nga më pjelloret të vendit tonë. Në të njëjtën kohë është arritur aftësia ujitëse, nga 29 100 ha. më 1938 në 166 900 ha. më 1962, ose afro 474 për qind më shumë.

Gjatë vjetëve të pushtetit popullor një masë e rëndësishme për zhvillimin e bujqësisë ka qenë edhe krijimi e zgjerimi i ndërmarrjeve bujqësore shtetërore, të cilat sot zënë rreth 15 për qind të sipërfaqes së përgjithshme të tokës nën kulturë. Ato, duke qenë të pajisura me të gjitha mjetet e nevojshme dhe me kuadro specialistë, i kanë dhënë një ndihmë të gjithanshme fshatarësisë punonjëse dhe janë një mbështetje e mirë në plotësimin e nevojave të industrisë me lëndë të parë dhe të nevojave të popullit me prodhime bujqësore e blegtoriale. Në vitin 1962 sektori shtetëror i bujqësisë prodhoi 14 për qind të prodhimit të përgjithshëm të drithërave të bukës, 32 për qind të panxhar sheqerit, 27 për qind të perimeve, 19 për qind të rrushit dhe 11 për qind të qumështit.

Një kthesë e madhe është shënuar sidomos në mekanizimin e punimeve bujqësore. Numri i traktorëve me 15 HP., nga 30 që ishte në vitin 1938, u rrit në 6 207 në vitin 1962; ndërsa numri i autokombajnave, që para çlirimit nuk njiheshin fare arriti në rreth 400. Rritja e fuqisë mekanike ka sjellë ndryshime të dukshme cilësore në bilancin e fuqisë së përgjithshme energjitive të bujqësisë. Ndërsa në vitin 1938 fuqia tërheqëse e kafshëve të punës përfaqësonte 99,2 për qind të fuqisë së përgjithshme energjitive të bujqësisë, në vitin 1961 ajo përfaqësonte 21,3 për qind.

Për të rritur pasurinë e fshatarësisë shteti i ka dhënë asaj një ndihmë efektive edhe në drejtime të tjera. Në vitin 1962, në krahasim me vitin 1950, bujqësia u furnizua më shumë: me farëra të zgjedhura 2,6 herë, me plehra kimike mbi 4 herë, me insekticide 8,3 herë, me vegla bujqësore për kafshë mbi 4 herë. Që nga

viti 1945 e deri më sot shteti i ka dhënë fshatarësisë mbi 7 miliard e gjysmë lekë kredit agrar.

Sikurse shihet, gjatë 18 vjetëve të pushtetit popullor në bujqësi është arritur një zhvillim i konsiderueshëm i forcave prodhuese. Mbi bazën e këtyre ndryshimeve të thella është siguruar rritja e rendimentit në punë, e prodhimit të përgjithshëm bujqësor dhe përmirësimi i strukturës së tij. Sipas të dhënave parapra-ke, në vitin 1962 prodhimi i përgjithshëm bujqësor arriti 28 miliard e 400 milion lekë, ose 117 për qind më shumë se në vitin 1938. Po këtë vit, sipas disa llogarive të përafërta, për çdo frymë të popullsisë bujqësore, duke përfshirë edhe ndërmarrjet bujqësore shtetërore, i takonte mesatarisht 26 150 lekë prodhim i përgjithshëm bujqësor bruto, që do të thotë rreth 73 për qind më shumë se në vitin 1938.

Duhet thënë se në prodhimin e përgjithshëm për frymë të popullsisë bujqësore midis rretheve ka ndryshime. Kështu, në vitin 1961, ndërsa në rrethet malore, siç janë ai i Gramshit, i Pukës, i Kukësit, i Matit, i Mirditës, prodhimi për frymë i popullsisë bujqësore arrin nga 17 500 deri në 19 500 lekë, në rrethet fushore, si në atë të Durrësit, të Lushnjës, të Fierit dhe të Sarandës, prodhimi për frymë llogaritet nga 28 000 deri në 36 000 lekë.

Ne të gjithë gëzohemi me të drejtë për këto përfundime të mëdha që janë arritur në zhvillimin e fshatit dhe për këto fitore të shkëlqyera që ka korrur vija e përgjithshme e Partisë në zgjidhjen e drejtë të çështjes agrare.

Megjithatë Partia është e ndërgjegjshme se përfundimet e arritura janë akoma të pamjaftueshme dhe larg cakut që kërkon ndërtimi i plotë i shoqërisë socialiste. Sot ne i kemi të gjitha mundësitë për ta shpejtuar ngritjen e mirëqenjes dhe të nivelit kultural të fshatit, ku banon pjesa më e madhe e popullsisë së vendit. Në tetor të vitit 1962 popullsia e fshatit prej 963 mijë frymësh dhe ajo e qendrave të punës që nuk janë në rang qyteti prej 205 mijë frymësh, arrinte gjithsejt në 1 168 000 frymë, ose 67,6 për qind e popullsisë së përgjithshme të vendit.

Në Plenumin e Komitetit Qendror që u mbajt në tetor të vitit të kaluar, u shqyrtuan rezultatet e arritura në zhvillimin e bujqësisë dhe të blegtorisë së vendit tonë. Atje u trajtuan dhe u përcaktuan në mënyrë të gjithanshme kushtet e krijuara dhe rrugët për zhvillimin e mëtejshëm të bujqësisë e të blegtorisë, për rritjen e vazhdueshme të prodhimit bujqësor e blegtoral, me qëllim që prodhimi i drithit, i mishit, i qumështit, i perimeve, i patateve, i frutave etj., të plotësojë më mirë nevojat e popullsisë dhe të ekonomisë. Tani në të gjitha rrethet janë përpunuar me hollësi masat që duhen marrë për të rritur prodhimin për njësi dhe ne nuk do të ndalemi në këto masa, por e theksojmë se sot çështja kryesore për organet e Partisë, të pushtetit dhe për gjithë fshatarësinë

është që masat e shumta që shtrun intensifikimi i prodhimit bujqësor e blegtoral të zbatohen një nga një, me përpikmëri dhe në kohën e duhur. Për të gjithë duhet të bëhet edhe një herë e qartë se zbatimi i masave të shumta që shtrun intensifikimi i prodhimit bujqësor e blegtoral, është e vetmja rrugë e sigurtë dhe reale për të zgjidhur kontradiktën kryesore që ekziston sot në fshat midis marrëdhënjeve socialiste në prodhim dhe forcave prodhuese që kanë mbetur më prapa. Ne jemi vënë në rrugën e kapërcimit të kësaj kontradikte, por megjithatë e theksojmë edhe një herë, se pa zgjidhjen e saj nuk mund të mendohet për një rritje edhe më të shpejtë të mirëqenjes materiale e kulturele në fshat.

Programi ynë është i madh. Qëllimet tona janë fisnike, por këto nuk mund të vihen në jetë po qe se kënaqemi vetëm me rezultatet e arritura, po qe se nuk mobilizohemi me të gjitha forcat për të zbatuar detyrat e mëdha e të rëndësishme që kemi shtruar lidhur me rritjen e prodhimit bujqësor e blegtoral. Përveç këtyre, ne na dalin edhe detyra të reja, të cilat kërkojnë që, krahas zhvillimit ekonomik të fshatit, të ngremë në një shkallë të re, më të lartë, edhe mirëqenjen e nivelin e tij kultural. Rruga që kemi përshkuar, ndërgjegjja e lartë, vendosmëria e patriotizmi i masave tona punonjëse, dhe sidomos rritja e rolit udhëheqës të Partisë për të gjitha çështjet e jetës së fshatit, na japin bindjen të pohojmë se këto detyra do të plotësohen me sukses dhe se politika kurdoherë e drejtë marksiste-leniniste e Partisë do të korrë fitore të reja edhe në të ardhshmen.

Kapitulli II

MBI SHPËRNDARJEN DHE RISHPËRNDARJEN E PRODHIMIT BUJQËSOR DHE TË ARDHURAVE NË FSHAT

Partia jonë, duke vlerësuar drejt rolin vendimtar të prodhimit, si bazë për rritjen e mirëqenjes, në të njëjtën kohë ka vlerësuar drejt edhe rolin aktiv që luan shpërndarja mbi prodhimin dhe konsumin, prandaj vazhdimisht i ka kushtuar asaj një kujdes të madh. Ajo është përpjekur që organizimi, caktimi i formave dhe i përpjesëtimeve të shpërndarjes të nxitin sa më shumë rritjen e prodhimit dhe të konsumit, të sigurojnë përdorimin racional të produktit shoqëror, të fuqisë punëtore dhe të mjeteve të tjera të punës, t'u mbyllin rrugën të gjitha shpenzimeve materiale e financiare të panevojshme dhe të ndihmojnë për forcimin e aleancës midis klasës punëtore e fshatarësisë.

Fitorja e revolucionit popullor dhe vendosja e marrëdhënjeve të reja socialiste në prodhim përmbyshën përfundimisht marrë-

dhënjat e vjetra të shpërndarjes në fshat. U zhduk përvetësimi dhe konsumi parazitari i një pjese të madhe të prodhimit bujqësor, nga ana e çifligarëve dhe pronarëve të tjerë të mëdhenj të tokës, si dhe sistemi i së dhjetës. Sipas të dhënave të përafërta, në vitin 1938 shteti, çifligarët dhe pronarët e mëdhenj të tokës, vetëm në formën e së dhjetës, të gjysmës dhe të së tretës, kanë përvetësuar pa asnjë shpërblim rreth 30 për qind të sasisë së përgjithshme të drithit të prodhuar nga fshatarësia punonjëse. Në tokat e çifçinjve dhe të paraqendëve¹ ky përvetësim arrinte deri në 60 për qind të sasisë së drithit të prodhuar prej tyre.

Rendi socialist në fshat krijoi jo vetëm marrëdhënje krejt të reja të shpërndarjes, por edhe kushtet për planifikimin dhe për organizimin e drejtëpërdrejtë të shpërndarjes, si brenda fshatit ashtu edhe midis fshatit e qytetit, duke lehtësuar gjithashtu në mënyrë të dukshme vetë zhvillimin e procesit dhe përmirësimin e formave të shpërndarjes.

Në vitin 1955 procesi i shpërndarjes përfshinte 140 000 ekonomi individuale, nga të cilat sigurohej 89,7 për qind e fondit të përgjithshëm të grumbullimeve shtetërore të drithit, ndërsa nga kooperativat e pakta bujqësore që ishin atëhere, sigurohej 10,3 për qind e këtij fondi. Me bashkimin e ekonomive të panumërta të vogla individuale në ekonomi të mëdha kolektive, me rritjen e numrit të kooperativave dhe me fuqizimin e tyre, procesi i shpërndarjes është thjeshtuar. Tani baza kryesore e grumbullimeve shtetërore janë 1 353 kooperativat bujqësore, të cilat në vitin 1961 siguruan 90 për qind të fondit të drithit që u grumbullua, kurse nga ekonomitë individuale u sigurua një sasi e vogël, e cila përfaqësonte vetëm 10 për qind të vëllimit të drithit që u grumbullua në gjithë Republikën.

Në të gjitha etapat e ndërtimit socialist Komiteti Qendror i Partisë ka ndjekur dhe ka zbatuar një politikë ekonomike të drejtë në lëmin e shpërndarjes së prodhimit dhe të të ardhurave në fshat. Kjo politikë është vënë në jetë duke marrë masa të tilla siç janë zbatimi i statutit tip të kooperativave bujqësore, ndërtimi i një sistemi të drejtë të grumbullimit, të tatimit dhe të taksave, ulja e normave të grumbullimit të detyrueshëm, heqja e detyrimeve për disa prodhime dhe për disa zona, rritja e çmimeve të grumbullimit, falja e detyrimeve dhe e tatimeve të prapambetura dhe masa të tjera të kësaj natyre, të cilat kanë rritur sasinë e prodhimeve dhe të ardhurave të fshatarësisë.

Në rritjen e të ardhurave të fshatarësisë ka influencuar shumë ulja e tatimeve dhe e taksave. Në vitin 1955 fshatarësia pagu-

¹ Është fjala për bujqit që kishin pak tokë dhe detyroheshin të merrnin tokë me qira nga tregëtarët dhe fajdexhitë. Qiraja bëhej qesim midis pronarit të tokës dhe bujqut. Kjo lloj qiraje quhej paraqende.

ante tatime e taksa, në të holla dhe në natyrë, 2 miliard e 116 milion lekë, ndërsa në vitin 1961 ajo pagoi vetëm 874 milion lekë, ose rreth 2 herë e gjysmë më pak. Vetëm ky fakt tregon qartë përfitimet e mëdha që ka pasur fshatarësia nga politika e Partisë në lëmin e shpërndarjes.

Partia vëren me kënaqësi se, si rezultat i ndryshimeve të mësipërme, procesi i shpërndarjes së prodhimit bujqësor e blegtoral është perfeksionuar vazhdimisht.

Tani detyra jonë është që format ekzistuese të shpërndarjes t'i shpiem edhe më përpara, të mënjanojmë të metat që vihen re dhe në këtë mënyrë të sigurojmë një administrim më efektiv të prodhimit bujqësor dhe të ardhurave në fshat.

I. — TË ZHVILLOJMË MË TEJ FORMAT E SHPËRNDARJES SË PRODHIMIT DHE SIDOMOS TË DRITHIT NË FSHAT

Një nga problemet e rëndësishme dhe të ndërlikuara që sot preokupon si vetë fshatin ashtu edhe Partinë, është përcaktimi i përpjesëtimeve sa më të drejta në shpërndarjen e prodhimit bujqësor e blegtoral dhe sidomos të drithërave të bukës. Këto përpjesëtime duhet të jenë të tilla që të sigurojnë sa më mirë nevojat e riprodhimit të zgjeruar, nevojat e përgjithshme shtetërore si dhe nevojat e konsumit të vetë fshatit.

Jeta ka vërtetuar se format e sotme të shpërndarjes së prodhimit bujqësor në ekonomitë kolektive, në përgjithësi, kanë qenë e mbeten të drejta. Ato kanë shërbyer për të zbatuar një politikë ekonomike të matur dhe elastike ndaj fshatit, e cila ka nxitur rritjen e forcave prodhuese dhe të mirëqenjes dhe ka ndihmuar për forcimin e aleancës midis klasës punëtore dhe fshatarësisë.

Në bazë të formave ekzistuese, përpjesëtimet e shpërndarjes së drithërave të bukës për disa vjet në kooperativat bujqësore, pa përfshirë këtu prodhimin e oborreve kooperativiste, paraqiten si më poshtë:

(në përqindje)

Emërtimi	1959	1960	1961
Prodhimi i përgjithshëm	100,0	100,0	100,0
— për riprodhimin	8,8	19,2	16,2
— shitje shtetit	29,0	18,8	27,4
— shpërndarë anëtarëve	62,2	62,0	56,4

Nga llogaritjet e bëra del se gjatë tre vjetëve shteti ka blerë me anën e kanaleve të shpërndarjes rreth 26 për qind të prodhi-

mit të përgjithshëm të drithit të prodhuar nga kooperativat bujqësore. Duke analizuar të dhënat mbi tërheqjen e drithit nga fshati, sot dhe para çlirimit, nuk mund të mos nxjerrim dy përfundime kryesore:

Së pari, ndërsa në vitin 1938 fshatarësisë punonjëse i tërhiqej rreth 45 për qind e sasisë së përgjithshme të drithit të prodhuar prej saj, tani, sikurse e theksuam më sipër, nga fshati tërhiqet rreth 26 për qind.

Së dyti, para çlirimit 65—70 për qind e sasisë së drithit që tërhiqej nga fshati, përvetësohej pa shpërblim dhe pjesa tjetër bliehej nga tregëtarët e mëdhenj të drithit dhe nga spekulatorët me çmime të ulëta. Kurse tani e gjithë sasia e drithit që tërhiqet nga fshati paguhet dhe pjesërisht përfaqëson shpërblimin e punës së kryer nga SMT-ja.

Në sasinë e përgjithshme të drithit që shteti tërheq nga kooperativat bujqësore, grumbullimi i detyrueshëm, gjatë vjetëve 1959—1961 ka përfaqësuar mesatarisht rreth 50 për qind të kësaj sasive. Me masat e marrura në të kaluarën, dhe sidomos me heqjen e detyrimit të drithit në 12 rrethe, vëllimi i grumbullimeve të detyrueshme ka ardhur duke u ulur. Megjithatë, sasia e drithit që shteti ka tërhequr nga kooperativat në këta vjetët e fundit, ka qëndruar pothuajse e pandryshuar. Kjo ka rrjedhur kryesisht për arsye se, si rezultat i zgjerimit të mekanizimit të punimeve bujqësore, ujemi i SMT-ve nga viti në vit është rritur. Gjatë katër vjetëve të fundit ujemi i SMT-ve ka përbërë një të tretën e sasisë së përgjithshme të drithit që shteti ka tërhequr nga kooperativat bujqësore dhe në vitin 1962 ai është rritur mbi 50 për qind më shumë se në vitin 1959. Nga ana tjetër, duhet vënë në dukje se jo të gjitha rrethet i plotësojnë me prodhimin e vet nevojat e tyre për drithë. Prandaj, për t'u ardhur në ndihmë këtyre rretheve, shteti i ka furnizuar sistematikisht fshatarët me drithë duke plotësuar kështu të gjitha nevojat e tyre.

Ne paraqitëm më lart shpërndarjen e drithit. Përsa i përket shpërndarjes së prodhimeve blegtorale, sipas të dhënave të vitit 1961, bilanci i shpërndarjes së tyre në kooperativat bujqësore, pa përfshirë oborret kooperativiste, ka qenë si vijon:

EMËRTIMI	Prodhimi i përgjithshëm në përqindje	Shpërndarja në përqindje	
		Shitje shtetit	Për riprodhimin e zgjeruar dhe shpërndarë anëtarëve
1. Mish, peshë e gjallë	100	82	18
2. Qumësht	100	85	15
3. Lesh	100	94	6
4. Vezë	100	64	36

Të dhënat e mësipërme tregojnë se kooperativat bujqësore shumicën dërmuese të prodhimeve të tyre blegtorale e caktojnë për treg. A është e drejtë një shpërndarje e tillë? Pa dyshim, kjo është e drejtë, pasi nevojat e fshatarësisë kooperativiste në këtë drejtim plotësohen tërësisht nga prodhimi i oborreve, ku sot akoma është përqëndruar një pjesë e madhe e krerëve të kafshëve produktive. Nga ana tjetër, në kushtet e sotme, kur popullsia e qytetit dhe kërkesat e saja shtohen me ritme të shpejta, nuk është e arësyeshme që, siç ndodh në disa raste, kooperativat bujqësore t'u shpërndajnë anëtarëve prodhime blegtorale për ditë-pune, në një kohë kur nga oborret ata sigurojnë si nevojat e tyre ashtu edhe teprica për treg. S'ka dyshim se kjo është një rezervë, e cila u lejon kooperativave bujqësore t'i shesin shtetit edhe më shumë prodhime blegtorale dhe të sigurojnë kështu në mënyrë ritmike të ardhura në të holla.

Shqyrtimi i formave ekzistuese të shpërndarjes nxjerr para nesh problemin e kontradiktës në shpërndarjen e drithit dhe perspektivën e sistemit të grumbullimeve. Mund të thuhet me bindje të plotë se rruga kryesore dhe më efikase për zgjidhjen e këtij problemi është rritja e prodhimit mbi bazën e intensifikimit të bujqësisë. Megjithatë, duke u nisur nga kushtet e reja, ne duhet të ndërmarrim disa studime, me qëllim që t'i perfeksionojmë edhe më shumë format e sotme të sistemit të grumbullimit. Ndërkohë, tarifatat e pagesës në natyrë dhe në të holla të punimeve që kryejnë SMT-të të ulen mesatarisht 19 për qind për afro 70 për qind të proceseve të punës që bëjnë këto stacione në tokat e klasit të tretë e lart. Gjithashtu, ujemi në natyrë për punimet qilizmë të zëvendësohet me pagesë në të holla. Nga këto ulje të pagesës në natyrë dhe në të holla për vitin 1963 kooperativat bujqësore përfitojnë rreth 66 milion lekë. Këto masa favorizuese do të nxitin zgjerimin e punimeve qilizmë, mekanizimin e punimeve bujqësore, do të krijojnë mundësi që për qilizmë të jepen kredi me afate 2—3 vjeçare dhe do të influencojnë në rritjen e prodhimeve bujqësore.

Shokë,

Me gjithë përmirësimet e arritura në përdorimin me kursim të drithit dhe të bukës, duke marrë parasysh rëndësinë e veçantë që ka ky problem për vendin dhe për ekonominë tonë, ne duhet të bëjmë përpjekje të mëtejshme dhe të marrim masa që të rritim edhe më shumë kujdesin për një kursim më të madh të drithërave gjatë mbledhjes, ruajtjes dhe konsumit të tyre.

Ne buka s'na ka munguar asnjëherë, sepse shteti ka siguruar gjithnjë drithin e nevojshëm dhe rezervat e tija. Por kjo nuk na lejon në asnjë mënyrë që të mos rritim kujdesin për bereqetin. Dhe ky kujdes duhet të fillojë që nga mbledhja e drithit në arë,

ku mbeten çdo vit me dhjetëra mijëra kuintalë. Po kështu, humbje të drithit shkaktohen gjatë transportimit, ruajtjes në depot, në mullinj të e blojes e deri në furrat. Këtë gjendje duhet ta ndreqim sa më shpejt dhe këto të ashtuquajtura firo nuk duhet t'i bëjmë sehir, por të marrim të gjitha masat që të mbledhim edhe kokrrën e fundit të drithit dhe ta ruajmë atë me kujdesin më të madh.

Familjet tona gjithnjë na kanë edukuar për të pasur një respekt të madh për bukën dhe për ta kursyer atë. Kjo traditë e mirë vazhdon edhe sot, por ne duhet të bëjmë një punë edukative edhe më të madhe, që atë ta rrënjosim thellë në ndërgjegjen e gjithë popullit tonë, nga të mëdhenjtë deri te fëmijët. Përveç kësaj, ne duhet të përhapim sa më shumë metodat e përparuara dhe kursimtare në gatimin e bukës. S'ka dyshim se po ta përgatitësh bukën në formë kulaçi dhe ta përdorësh atë të ngrohtë, do të harxhohet më shumë drithë, që, përveç dëmit ekonomik, nuk i sjell ndonjë dobi as organizmit. Prandaj përhapja e metodave më të përparuara dhe kursimtare në gatimin e bukës me rreze të lartë, mbetet një ndër detyrat tona të rëndësishme që duhet të zgjidhim në fshat. Edhe në familjet tona, në restorantet, në mensat, në spitale dhe kudo kujdesi për të kursyer bukën, që të mos na shkojë dëm asnjë thërrime, duhet të jetë gjithashtu i vazhdueshëm. Me këtë nuk duam të themi që njerëzit të lënë «barkun bosh». Sasinë e domosdoshme të bukës ne duhet ta hamë, por në të njëjtën kohë, qoftë për të mëdhenjtë dhe veçanërisht për të vegjëlit, ne duhet të përdorim më shumë perime, patate, leguminoze e fruta, të cilat përmbajnë të gjitha substancat e domosdoshme për forcimin e shëndetit dhe për zhvillimin më të mirë të organizmit të fëmijëve. Le të jetë e qartë për të gjithë ne se kursimi i drithit dhe i bukës është dhe mbetet një detyrë e jonë patriotike e përhershme.

II. — TË MËNJANOJMË TË METAT NË SHPËRNDARJEN E PRODHIMEVE BUJQËSORE E BLEGTORALE

Tani në fshat nuk kemi të bëjmë më me ekonomi të vogla individuale, prodhimi për treg i të cilave është i kufizuar, por me ekonomi të mëdha socialiste, që e rritin shumë sasinë e prodhimit për treg. Në të njëjtën kohë, kërkesat e qytetit për prodhime bujqësore dhe blegtorale rriten vazhdimisht. Prandaj, zhvillimi dhe forcimi i mëtejshëm i marrëdhënjeve midis qytetit dhe fshatit, i marrëdhënjeve monetare dhe të mallit në fshat merr një rëndësi të veçantë.

Në këto rrethana, më tepër se kurrë, shtrohet detyra që të përmirësojmë organizimin e shpërndarjes dhe të sigurojmë përdorimin sa më racional të prodhimit bujqësor duke mënjanuar dëmtimet dhe duke harmonizuar më mirë nevojat e përgjithshme shtetërore me ato të ngritjes së mirëqenjes në fshat.

Për çështjet e mësipërme, me gjithë punën e bërë nga Partia dhe nga organet shtetërore, ka akoma të meta, të cilat shfaqen në këto drejtime kryesore:

1. — Organet shtetërore dhe kooperativiste të përmirësojnë punën e tyre për grumbullimin e prodhimeve bujqësore e blegtorale

Përsa u përket disa prodhimeve kryesore, siç janë mishi, qumështi, yndyrnat, mjalti, vezët, fasulet e lëkurët, shteti në përgjithësi ka siguruar grumbullimin e tyre dhe fshatarësia nuk has vështirësi për shitjen. Megjithatë, organet e grumbullimit e të industrisë dhe kooperativat e konsumit, në disa raste, nuk i studjojnë me kujdes të gjitha mundësitë që ka fshati për disa prodhime, sidomos për perimet, për frutat, për rrushin dhe grumbullimi i tyre bëhet me të meta. Nga ana tjetër, këto organe nuk i lidhin kontratat në kohë, nuk i përgatitin mirë dhe në kohën e duhur qendrat e grumbullimit dhe të përpunimit. Si rrjedhim, nuk tërhiqen të gjitha tepricat e këtyre prodhimeve nga fshati, pavarësisht nga fakti se një pjesë të mirë të tyre fshatarët e kanë shitur pastaj në treg. Kështu ndodhi në vitin 1961, kur organet e grumbullimit tërhoqën vetëm 29 për qind të perimeve të prodhuara nga kooperativat bujqësore të rrethit të Durrësit, 63 për qind të rrushit në rrethin e Gramshit, ose 31 për qind të frutave në rrethin e Elbasanit, megjithëse sasinë e ofruara nga kooperativat bujqësore ishin më të mëdha. Në rrethin e Korçës ka ndodhur që vetëm nga pakujdesia e kooperativave të konsumit t'u sillen pengesa kooperativave bujqësore dhe fshatarëve për shitjen e disa prodhimeve, sikurse janë patatet, qepët, preshtë, lakrat e mollët, që në disa raste edhe janë dëmtuar. Natyrisht, një gjë e tillë pakëson të ardhurat e fshatarësisë dhe pengon furnizimin e rregullt të popullsisë qytetare.

Krahas me këtë, një rëndësi të veçantë ka vlerësimi i prodhimeve bujqësore nga organet e grumbullimit. Partia gjithmonë ka porositur që të caktohen drejt çmimet, të zbatohen pa lëshime parimet dhe rregullat e vendosura në klasifikimin e prodhimeve sipas cilësisë, në peshimin dhe në përcaktimin e firove të tyre, të cilat, të marrura së bashku, duhet të sigurojnë leverdinë si të prodhuesit ashtu edhe të konsumatorit, leverdinë e zhvillimit të prodhimit bujqësor dhe zgjerimin e shkëmbimit në mes të qytetit dhe fshatit. Megjithatë, në punën e organeve të grumbullimit ndeshen akoma të meta, të cilat gjejnë shprehje veçanërisht në vlerësimin më të ulët të prodhimeve, gjëra këto që nxiten nga dëshira për të siguruar fitime të paligjshme. Ndryshe nuk mund të shpjegohet fakti që në rrethin e Vlorës, Kombinati i konservimit «Ernest Telman», gjatë muajve gusht e shtator të vitit të kaluar, bleu sasi të mëdha

domatesh me një çmim shumë të ulët. Ndërmarrjet e Komitetit Shtetëror të Grumbullimit patën 22 milion lekë suficit në vitin 1961, kryesisht nga moszbatimi i drejtë i rregullave në blerjen e produkteve bujqësore nga fshatarësia. Raste të tilla hasen edhe në grumbullimin e artikujve bujqësorë e blegtoralë nga kooperativat e konsumit dhe nga ndërmarrje të tjera. Këto veprime janë të dëmshme dhe, si të tilla, duhen dënuar rëndë.

Një çështje tjetër, që duhet të tërheqë vëmendjen e organeve shtetërore, është edhe niveli i shpenzimeve të grumbullimit. Është fakt se sot për disa prodhime bujqësore këto shpenzime arrijnë deri në 30 përqind mbi çmimin e blerjes dhe kjo rëndon, padyshim, si prodhuesin ashtu edhe konsumatorin. Në këtë nivel relativisht të lartë të shpenzimeve të grumbullimit influencojnë hallkat e ndërmjetme të tepërta dhe fitoret e shumta në rrjetin e tregëtisë. Prandaj, duhet të bëhen të gjitha përpjekjet dhe të merren masa që shpenzimet e grumbullimit të ulen vazhdimisht dhe kursimet e arritura nga kjo ulje t'i përfitojnë prodhuesit dhe konsumatorët.

Në të ardhshmen këto çështje duhet të zgjidhen drejt, në mënyrë që Komiteti Qendror i Partisë të mos dëgjojë më ankesa nga fshatarësia për organet e grumbullimit, të industrisë dhe të tregëtisë. Për këtë arsye organet e Partisë dhe të pushtetit të marrin masat që të gjitha tepricat e prodhimeve që ka fshatarësia për shitje, të grumbullohen, të përpunohen dhe të ruhen, me qëllim që asgjë të mos shkojë dëm. Nga ana tjetër, edhe fshatarësia, meqenëse tregun e shitjes e ka plotësisht të siguar duhet të kujdeset dhe të përpiqet që tepricat e produkteve të saj t'i dorëzojë sipas të gjitha kushteve të parashikuara në kontrato.

Në përmirësimin e punës lidhur me çështjet që përmendëm më lart, përveç masave që duhet të marrin Partia dhe pushteti, një rol shumë të madh duhet të luajë organizimi i kontroleve të shpeshta, me pjesëmarrjen e gjerë të popullit, për të kontrolluar saktësinë e peshimit, klasifikimin e prodhimeve, zbatimin e drejtë të çmimeve, kontrollin e peshave, të veglave matëse, të analizave laboratorike si dhe të dispozitave të tjera që rregullojnë blerjen nga fshatarësia të prodhimeve bujqësore e blegtorale. Organet shtetërore përkatëse dhe organizatat e Partisë e të masave t'i udhëheqin e t'i organizojnë mirë këto kontrole; shteti të dënojë rreptë të gjithë ata që dëmtojnë, sado pak, interesat e prodhuesve.

2. — Të përmirësojmë punën e organeve shtetërore për çështjet e shpërndarjes

Organet e Partisë dhe ato shtetërore në rreth, ndërsa kujdesen për çështjet teknike të bujqësisë, për problemet e shpërndarjes nuk tregojnë sa duhet interesim, bile në disa raste qëndrojnë

larg tyre. Roli i këtyre organeve sot për sot është mjaft i kufizuar në formimin e çmimeve të prodhimeve bujqësore dhe në shpërndarjen e tyre.

Një problem tjetër që lidhet me punën e organeve të pushtetit, është përmirësimi i bashkërenditjes në planifikim të prodhimit me shpërndarjen. Praktika e ndjekur deri tani ka të meta dhe nuk u përgjigjet sa duhet kërkesave të kohës. Për artikujt kryesorë, si për drithin, mishin, qumështin, lëkurët etj., ekziston një bashkërendim dhe saktësim më i mirë i prodhimit me nevojat e grumbullimit dhe të industrisë, d.m.th. me tërheqjen e prodhimeve nga fshati në qytet. Për prodhimet e tjera si perime, fruta, rrush, ka të meta.

Duke u nisur nga rritja e shpejtë e prodhimit bujqësor, sidomos e perimeve, frutave e rrushit, dhe me qëllim që organet e pushtetit të influencojnë më shumë e në mënyrë të organizuar për zgjidhjen e detyrave që na dalin përpara lidhur me shpërndarjen, duhet të merren këto masa:

Së pari, organet qendrore dhe komitetet ekzekutive të rretheve duhet të ndjekin në mënyrë më operative realizimin e planit të prodhimit dhe të grumbullimit të perimeve, të frutave dhe të rrushit, duke bërë në prakun e vjeljeve një bashkërendim e saktësim sa të jetë e mundur më të plotë për nevojat në shkallë rrethi dhe jashtë rrethit.

Së dyti, për të përballuar nevojën e përpunimit të perimeve, të frutave dhe të rrushit në periudhën pik të pjekjes së tyre dhe me qëllim që të mënjanohen dëmtimet dhe zhvlerësimi i produkteve bujqësore, organet e grumbullimit dhe të industrisë duhet të sigurojnë aftësi prodhuese rezervë, të thjeshta dhe që nuk kërkojnë investime të mëdha. Për rastet e veçanta, kur prodhimet bujqësore nuk tërhiqen nga organet e grumbullimit dhe rrezikohen të prishen, kooperativat bujqësore të krijojnë aktivitete ndihmëse për përpunimin e tyre.

Së treti, me qëllim që të sigurohet përdorimi më racional i vlerave materiale të prodhuara në fshat, organet e grumbullimit, të industrisë dhe të tregëtisë të rritin influencën e tyre në procesin e shpërndarjes, sidomos duke forcuar e zgjeruar sistemin e kontraktimeve me detyrime të dyanshme. Për të forcuar rolin dhe efektin e këtij sistemi në jetën ekonomike të fshatit dhe të qytetit, kontratat duhet të vlerësohen nga të dy palët si një akt i rëndësishëm juridiko-ekonomik ku përcaktohet përgjegjësia dhe domosdoshmëria e plotësisht të zotimeve të marrura. Prandaj, ato të mos jenë formale, por të mbështeten mbi bazën reale të planit të prodhimit dhe të shpërndarjes së prodhimeve bujqësore.

Së katërti, këtej e tutje duhet që organet e Partisë dhe të pushtetit të tregojnë për shpërndarjen të njëjtin kujdes që tregojnë edhe për prodhimin. Për një vlerësim më të drejtë të prodhimeve

bujqësore, duke marrë parasysh si interesat e prodhuesit ashtu edhe ato të konsumatorit, do të jetë mirë që në komisionet e çmimeve pranë komiteteve ekzekutive të marrin pjesë edhe organet e bujqësisë dhe të planit.

III. — TË SIGUROJMË NJË PËRPJESËTIM MË TË DREJTË NË SHPËRNDARJEN E TË ARDHURAVE KOMBËTARE NË FSHAT NË FOND AKUMULIMI DHE FOND KONSUMI

Si rezultat i zhvillimit të pandërprerë të forcave prodhuese, janë rritur edhe të ardhurat kombëtare të krijuara në bujqësi. Ndërsa në vitin 1955 këto të ardhura, pa ndërmarrjet bujqësore shtetërore, llogariteshin në 15 miliard e 190 milion lekë, në vitin 1961 arritën në 16 miliard e 330 milion lekë, ose 7,5 për qind më shumë. Kjo rritje është siguruar sidomos nga zhvillimi i blegtorisë, të ardhurat kombëtare të së cilës në vitin 1961 ishin 20 për qind më të mëdha se në vitin 1955. Por ritmet më të larta në rritjen e të ardhurave kombëtare janë shënuar në frutikulturë, ku në vitin 1961, kundrejt vitit 1955, të ardhurat kombëtare ishin dy herë më shumë. Në vitin 1961 të ardhurat kombëtare të krijuara në blegtori dhe në frutikulturë përfaqësojnë 50 për qind të shumës së përgjithshme të të ardhurave kombëtare të krijuara në bujqësi, kundrejt 35 për qind që përfaqësonin në vitin 1955.

Krahas me rritjen e të ardhurave kombëtare, është përmirësuar më tej edhe procesi i shpërndarjes së tyre, sidomos përsa i përket përpjesëtimit midis fondit të akumulimit dhe të konsumit. Në këtë drejtim ne jemi udhëhequr gjithmonë nga parimi që ky përpjesëtim të plotësojë dy kërkesa objektive kryesore: të sigurojë nevojat e riprodhimit të zgjeruar socialist dhe të plotësojë nevojat e mirëqenjes në fshat.

Nga të dhënat e përafërta del se në vjetët 1960—1961, nga të ardhurat kombëtare të krijuara në kooperativat bujqësore, rreth 22 për qind janë përdorur për fondin e akumulimit në vetë kooperativat, 10—12 për qind për fondin e centralizuar të akumulimit shtetëror dhe 66—68 për qind për fondin e konsumit vetjak. Në të vërtetë, fondi i konsumit vetjak në fshat ka qenë më i madh, pasi në përqindjen e mësipërme nuk janë përfshirë të ardhurat kombëtare të krijuara në oborret kooperativiste dhe që përdoren kryesisht për plotësimin e nevojave të konsumit të fshatarësisë kooperativiste.

Përpjesëtimet e krijuara në shpërndarjen e të ardhurave kombëtare në fshat dëshmojnë se vija që ka ndjekur Partia në këtë çështje, në përgjithësi, ka qenë e drejtë dhe është përputhur me nevojat e zhvillimit objektiv të ekonomisë sonë. Ajo ka siguruar

zhvillimin e forcave prodhuese në fshat dhe, në të njëjtën kohë, ka sjellë rritjen e mirëqenjes së fshatarësisë.

Me përfundimin në përgjithësi të kolektivizimit të bujqësisë, shtrohet detyra që në të ardhshmen t'i kushtohet një vëmendje më e madhe harmonizimit të përpjesëtimeve midis fondit të akumulimit e të konsumit dhe të mënjanohej të metat që vihen re akoma në disa rrethe e kooperativa. Në qoftë se ritmet e rritjes së fondit të akumulimit do të jenë të ulëta, zhvillimi i forcave prodhuese në fshat do të ngadalësohet; dhe anasjelltas, po që se fondi i akumulimit rritet me ritme dhe në përpjesëtime më të mëdha se mundësitë ekonomike reale, atëherë do të vështirësohet plotësimi i detyrave të caktuara nga Partia për ngritjen e mirëqenjes.

Lidhur me këtë çështje, në praktikën e deritanishme të kooperativave bujqësore vihen re tri tendenca kryesore, që, natyrisht, nuk ndihmojnë sa duhet si zhvillimin e forcave prodhuese në fshat ashtu edhe rritjen e mëtejshme të mirëqenjes.

1. — Njëra tendencë është se në disa kooperativa fondi i akumulimit caktohet në një nivel më të ulët se mundësitë ekonomike që ato kanë për riprodhimin e zgjeruar. Kështu kanë vepruar, për shembull, një pjesë e kooperativave të rretheve të Durrësit, të Peshkopisë, të Korçës, të Krujës etj., të cilat gjatë vjetëve 1960—1961 kanë derdhur në fondet e pandara 8—10 për qind të të ardhurave bruto në të holla. Bile ka kooperativa bujqësore, si ajo e Laknasit në rrethin e Tiranës, e Çerkovinës në rrethin e Vlorës, «Tetori i Kuq» në rrethin e Shkodrës, që, megjithëse kanë ndarë të ardhura të mëdha për ditë-pune, në fondin e pandarë kanë caktuar më pak se 8 për qind të të ardhurave në të holla.

2. — Një tendencë tjetër është se disa kooperativa e caktojnë fondin e akumulimit në një nivel më të lartë se mundësitë e tyre ekonomike reale duke pakësuar kështu fondin e konsumit. Në rrethin e Skraparit, gjatë vitit 1961, kooperativat bujqësore caktuan në fondin e pandarë 17,6 për qind të të ardhurave në të holla, në një kohë kur kanë ndarë mesatarisht 47 lekë për ditë-pune. Mirëpo, për të pasur një tablo më të plotë të fondit të akumulimit, theksojmë se, përveç shumës së caktuar për fondin e pandarë, kooperativat e këtij rrethi kanë shpenzuar për të shlyer kreditë e përdorura për investime edhe 12 për qind të të ardhurave në të holla. Në tërësi në këtë rreth për qëllime investimi janë përdorur 34 për qind të të ardhurave në të holla kooperativave, pa përfshirë këtu 87 400 ditë-pune, të harxhuara gjithashtu në punime investimi. Raste të tilla vihen re edhe në disa rrethe të tjera, ndërsa ka kooperativa të veçanta ku fondi i akumulimit arrin mbi 40 për qind të të ardhurave sikurse ka ndodhur p.sh. në kooperativën e Ramicës në rrethin e Vlorës.

3. — Tendenca e fundit është se në disa kooperativa bujqësore pjesa e fondit të akumulimit që shpenzohet për investime joproduhuese është akoma e madhe, gjë që ul efikasitetin e përdorimit të këtij fondi. Riprodhimi i zgjeruar socialist kërkon që pjesa kryesore e fondit të akumulimit të përdoret për rritjen e prodhimit, ndërsa një pjesë e tij, krahas me mjetet shtetërore, duhet përdorur për plotësimin e nevojave social-kulturale në fshat. Faktet tregojnë se në këtë çështje nuk janë ruajtur gjithnjë përpjesëtime të drejta. Në disa raste kooperativat bujqësore kanë kryer investime të mëdha për qëllime social-kulturale, duke bërë ndërtime të parakohshme e të kushtueshme në një kohë kur fuqia e tyre ekonomike nuk i lejonte. Në kooperativën e Gjocajt, në rrethin e Elbasanit, në vitin 1960—1961, për qëllime social-kulturale, u investuan 2 milion lekë, megjithëse asaj i mungojnë objekte të rëndësishme që kanë të bëjnë me prodhimin; dhe këto shpenzime i bëri në një kohë kur nuk kishte shlyer akoma kreditë e marrura nga banka për investime. Raste të tilla kanë ndodhur edhe në kooperativa bujqësore të rretheve të tjera.

Me qëllim që shpërndarja e të ardhurave kombëtare në kooperativat bujqësore t'i shërbejë më mirë plotësimin të detyrave që na dalin përpara në lëmin e ngritjes së mirëqenjes së fshatarësisë, duhet të merren këto masa:

Së pari, në të ardhshmen organizatat e Partisë, organet shtetërore dhe kryesitë e kooperativave bujqësore t'i kushtojnë një vëmendje më të madhe çështjes së shpërndarjes së të ardhurave në fshat. Duke pasur gjithmonë parasysh rëndësinë e madhe politike dhe ekonomike që paraqet kjo çështje, orientimi ynë i përgjithshëm që të mos caktojmë fonde të mëdha akumulimi mbi mundësitë në kurriz të konsumit, por edhe të mos mbetemi prapa në këtë drejtim e të pengojmë procesin e zhvillimit të forcave prodhuese në fshat, ka qenë dhe mbetet i drejtë. Në këtë çështje duhet të udhëhiqemi nga parimi që fondi i akumulimit të caktohet në bazë të prodhimit dhe të nivelit të arritur të jetesës. Që të mos cënohet niveli i të ardhurave për ditë-pune të kooperativistëve në vjetët jo të mbarë bujqësorë, norma e planifikuar në fillim për fondin e akumulimit mund të reduktohet, në përputhje me rezultatet e arritura në plotësimin e planit të prodhimit. Për të siguruar uniformitetin në rritjen e qëndrueshme të të ardhurave të kooperativistëve për ditë-pune dhe për të përballuar çdo situatë që mund të shpinte në pakësimin e fondit të konsumit, kooperativat bujqësore të forcojnë dhe të rritin nga viti në vit fondin tranzitor të shpërndarjes.

Së dyti, për të mënjanuar investimet e parakohshme dhe të tepërta në sferën joproduhuese, të merren masa për të caktuar në formë limitesh përpjesëtimin e përdorimit të mjeteve të akumuluar në sferën prodhuese dhe joproduhuese. Lidhur me këtë

të mbahet parasysh që fondet e caktuara për investime joproduhuese të mos përdoren tërësisht brenda vitit, në qoftë se nuk realizohen të ardhurat e planifikuara për ditë-pune.

Së treti, e shohim të arësyeshme të theksojmë se, duke marrë parasysh nivelin e të ardhurave të kooperativave bujqësore, tani për tani nuk do të ishte e kohës që të shtrihemi më tej në dhënjën e pensioneve anëtarëve, por familjet nevojtare të ndihmohen nga fondet sociale që krijohen për këtë qëllim, sipas dispozitave në fuqi dhe të marrim të gjitha masat për të zbatuar sa më mirë vendimin e qeverisë për këtë çështje.

Së katërti, ruajtja dhe administrimi më i mirë i vlerave materiale e monetare mbetet një detyrë e përhershme e organizatave bazë të Partisë, e organizatave të masave dhe e gjithë punonjësve në kooperativat bujqësore, për të ngritur ndërgjegjen e çdo anëtari që asgjë të mos priset e dëmtohet, që asnjë lek i përbashkët të mos shpenzohet pa menduar mirë se çfarë dobie sjell. Forcimi i ndërgjegjes për ta rritur e forcuar çdo ditë e më tepër pronën e përbashkët, për të zbatuar me përpikmëri rregullat në shpërndarjen e drejtë të të ardhurave në të holla midis anëtarëve, është kusht i domosdoshëm për të rritur fondin e akumulimit dhe fondin e konsumit.

IV. — TË ARDHURAT NGA EKONOMIA KOLEKTIVE — BAZË PËR NGRITJEN E MIRËQENJES NË FSHAT

Dihet se, me fitoren e rendit kooperativist në fshat, ekonomia kolektive shndërrohet në burimin kryesor për rritjen e të ardhurave dhe të mirëqenjes së fshatarësisë. Vjetët e fundit, me gjithë kushtet e vështira klimaterike, të ardhurat nga ekonomia kolektive e kooperativave bujqësore kanë shënuar një rritje të mëtejshme. Është kuptimplot fakti se në vitin 1961 të ardhurat për një krah pune të kooperativave kanë qenë mesatarisht 9 për qind më shumë se në vitin 1959.

Shumica dërmuese e kooperativave bujqësore në vitin 1961 u shpërndanë anëtarëve mbi 80 lekë për ditë-pune. Por ka edhe kooperativa që kanë ndarë nën 80 lekë për ditë-pune. Megjithatë, ne duhet të jemi të ndërgjegjshëm se përfundimet e arritura nuk u përgjigjen sa duhet detyrave të mëdha që shtron Partia për rritjen e mëtejshme të mirëqenjes në fshat. Prandaj shtrohet detyra që në të ardhshmen të shtohen përpjekjet për ngritjen e të ardhurave për ditë-pune dhe sidomos në ato kooperativa që paraqiten prapa në këtë drejtim.

Por dihet se anëtarët e kooperativave bujqësore përveç të ardhurave nga ekonomia kolektive, kanë edhe burime të tjera të ardhurash, ndër të cilat një vend me rëndësi zënë të ardhurat

që ata marrin nga oborret si dhe nga puna në ndërmarrjet dhe nga institucionet e tjera shtetërore.

Në kushtet e sotme të ardhurat nga oborret përfaqësojnë një pjesë të mirë të të ardhurave të përgjithshme që kanë kooperativistët.

Nga studimet e bëra në vend del se të ardhurat nga oborret kooperativiste ndryshojnë sipas rretheve. Në shumicën dërmuese të kooperativave bujqësore të ardhurat nga oborret janë shumë më të vogla se sa të ardhurat nga ekonomia kolektive dhe luajnë rol ndihmës. Kjo vërtetohet në të gjitha zonat fushore dhe në një pjesë të zonave kodrinore. Por ka akoma kooperativa, sidomos në zonat malore, ku të ardhurat nga ekonomia ndihmëse ngandonjëherë janë barazi ose më të mëdha se të ardhurat nga ekonomia kolektive.

Megjithëse ekonomia kolektive duhet të jetë burimi kryesor i të ardhurave dhe bazë e mirëqenjes së fshatarësisë kooperativiste, ndërsa oborri kooperativist duhet të luajë një rol ndihmës, në të vërtetë në disa kooperativa ngjet e kundërta dhe kjo është, pa dyshim, një kontradiktë.

Me të drejtë lind pyetja: Pse ndodh një gjë e tillë? A mos vallë në politikën e kolektivizimit të bujqësisë Partia ka lejuar të meta parimore për këtë çështje? Jo, politika e Partisë ka qenë dhe mbetet e drejtë për të gjitha çështjet e kolektivizimit. Atëherë ku duhet kërkuar shkakun e kësaj kontradikte, që prek një pjesë të kooperativave bujqësore dhe kryesisht të atyre të zonave më pak prodhuese, kodrinore e malore?

Duhet thënë që në fillim se kjo kontradiktë është një fenomen i përkohshëm i ecjes sonë përpara, që lidhet me një varg faktorësh të tillë siç janë niveli akoma i ulët i prodhimit në këto ekonomi kolektive, shkalla e ulët e kolektivizimit të blegtorisë, krijimi i fondit të akumulimit kryekëput nga të ardhurat e ekonomisë kolektive. Përveç këtyre, ka influencuar edhe fakti se në psikologjinë e fshatarit kooperativist ruhen akoma aty-këtu edhe mbeturina të së kaluarës, të cilat janë shfaqur në caktimin e tokave më të mira për oborret, në përpjekje për të mbajtur në ekonominë ndihmëse bagëti më shumë nga sa lejon statuti si dhe në kujdesin më të madh që ai tregon për ekonominë e tij ndihmëse, në krahasim me ekonominë kolektive.

Cila është rruga e daljes nga kjo gjendje?

Është e qartë se kapërcimi i kësaj kontradikte do të dojë kohë, prandaj çdo nxitim në këtë rast mund të kishte pasoja të dëmshme. Kapërcimi i saj është i lidhur, në radhë të parë, me vënjen në jetë të programit të Partisë për intensifikimin e bujqësisë, me zgjerimin dhe me fuqizimin e ekonomisë kolektive.

Pa plotësuar detyrat në këtë drejtim, nuk mund të pritët një ndryshim rrënjësor në raportin midis të ardhurave nga ekonomia kolektive dhe nga oborri.

Por duhet të jetë e qartë se kur ne shtrojmë çështjen e ndryshimit të raportit midis të ardhurave nga ekonomia kolektive dhe oborri, nuk duam në asnjë mënyrë që të nënvleftësohet ose të lihet pas dore ekonomia e oborrit. Përkundrazi, duke i dhënë rëndësinë e dorës së parë, duke rritur kujdesin dhe punën për fuqizimin e ekonomisë së përbashkët, anëtarët e kooperativave duhet ta shfrytëzojnë oborrin në mënyrë sa më racionale, me qëllim që të shtojnë të ardhurat dhe të rritin mirëqenjen e tyre. S'ka dyshim se edhe në të ardhshmen, brenda dispozitave të përcaktuara në statutin e kooperativave bujqësore, oborret do të vazhdojnë të luajnë një rol ndihmës për të plotësuar më mirë nevojat e familjeve të kooperativistëve si dhe për të rritur tepricat për treg. Është e nevojshme që organet përkatëse të studjojnë në kompleks masat e tjera që duhet të marrin, sidomos për kooperativat malore e kodrinore, për të përmirësuar në të ardhshmen raportin midis të ardhurave nga ekonomia kolektive dhe nga oborret dhe brenda vitit 1964 t'ja paraqesin për shqyrtim Byrosë Politike të Komitetit Qendror të PPSH.

Sikurse e përmendëm edhe më lart, fshatarësia ka të ardhura edhe nga puna në sektorin shtetëror, nga pensionet dhe nga burime të tjera.

Është e kuptueshme se edhe në të ardhshmen të ardhurat që siguron fshatarësia nga sektori shtetëror do të vazhdojnë të jenë një burim i rëndësishëm për rritjen e mirëqenjes së saj. Por detyra jonë është që ato të kanalizohen sa më drejt në fshat, bile edhe brenda familjeve të një fshati, duke mënjanuar një farë spontaneiteti që ka ekzistuar deri më sot si dhe prirjen që nga këto të ardhura të përfitojnë vetëm disa kategori njerëzish, që nganjëherë kanë edhe më pak nevojë për to. Për këtë qëllim duhen marrë masa që, në caktimin e fshatarëve për të punuar në sektorin shtetëror, të nisemi kurdoherë nga përbërja dhe nga numri i krahëve të punës në familjet, nga nevoja që ato kanë, pa shkelur, sigurisht, parimin e vullnetarizimit për të gjithë ata që do të dërgohen të punojnë jashtë fshatit duke zbatuar plotësisht dispozitat në fuqi.

V. — PJESËMARRJA MË E GJERË E FSHATARËSISË NË PUNË
PRODHUESE — FAKTOR I RËNDËSISHËM PËR RRIJTJEN
E TË ARDHURAVE

Dihet se rritja e të ardhurave në çdo sektor të ekonomisë popullore varet mbi të gjitha nga numri i njerëzve që marrin pjesë në prodhim dhe nga rendimenti i punës së tyre. Prandaj, për rritjen e mëtejshme të të ardhurave si në fshat ashtu edhe në qytet, është e domosdoshme të tërhiqen në prodhim sa më shumë forca të afta për punë.

Në të kaluarën në fshat në punë bujqësore prodhuese ishte e zënë vetëm një pjesë e fuqisë punëtore e aftë për punë. Tani gjendja ka ndryshuar rrënjësisht. Në vitin 1961, sipas të dhënave të bilancit të fuqisë punëtore, numri i krahëve të punës të zënë në prodhimin bujqësor është rritur mbi 50 për qind në krahasim me vitin 1938. Në të njëjtën kohë është rritur shumë sidomos pjesëmarrja e gruas në prodhim, e cila sot përfaqëson 41 për qind të krahëve të aftë për punë në fshat. Këto përfundime janë arritur në saje të sistemit socialist që ekziston në bujqësinë tonë dhe në saje të punës së madhe edukative dhe të masave organizative që ka marrë Partia, veçanërisht pas përfundimit të kolektivizimit, për tërheqjen e gruas në prodhim, për rritjen e mesatares së ditë-punëve të kryera nga çdo anëtar, për zgjerimin e fronteve të punës në kooperativa etj. Rendi ynë socialist në fshat jo vetëm nuk përmban në vetëvete asnjë premisë për papunësi, por përkundrazi, stimulon dhe kërkon vazhdimisht forca të reja pune.

Por në lidhje me aktivizimin e mëtejshëm të fshatarësisë në punë prodhuese, na dalin përpara disa probleme kryesore, për zgjidhjen e të cilave duhet të mobilizohen organet e Partisë dhe të pushtetit.

Para së gjithash, duhet të përpiqemi të rritim numrin e pjesëmarrësve në punë prodhuese duke e konsideruar këtë si një rezervë të rëndësishme për rritjen e të ardhurave të kooperativave bujqësore. Për mobilizimin e plotë të fuqisë punëtore në fshat ekzistojnë shumë rrugë, por ne do të ndalemi vetëm në disa prej tyre.

Është theksuar vazhdimisht se rruga kryesore për të rritur pjesëmarrjen në punë dhe të ardhurat në kooperativat, është kryerja e të gjitha shërbimeve që kërkojnë kulturat bujqësore sipas agrorregullores si dhe krijimi i një bujqësie shumëdegëshe dhe intensive. Në qoftë se ne do të arrijmë që këto detyra t'i plotësojmë me sukses, ashtu sikurse porosit edhe Plenumi i tetorit 1962, atëherë me siguri do të krijohen kushtet përkatëse për aktivizimin më të gjerë, gjatë gjithë vitit, të fuqisë punëtore në fshat si dhe për rritjen e numrit të ditëve kalendarike në

punë të kryera nga çdo anëtar i kooperativës dhe mbi këtë bazë të shtohen të ardhurat në natyrë dhe në të holla, si burim kryesor për rritjen e mirëqenjes.

Për aktivizimin e krahëve të aftë për punë, sidomos në periudhat kur fuqia punëtore është më pak e zënë në punët bujqësore, shërben edhe zgjerimi i sektorëve ndihmës pranë kooperativave. Në këtë drejtim ka mundësi të mëdha, të pashfrytëzuara në shkallën e duhur. Konsultimi popullor nxori në shesh se në kooperativat bujqësore të rrethit të Shkodrës mund dhe duhet të prodhohen artikuj prej xunkthi, kashte, fshesa, rrogoza, tulla e tjegulla, gëlqere, qerre e karro, samarë, mund të zgjerohet më shumë prodhimi i mëndafshit, mund të grumbullohen më shumë rrënjë shqope e bimë mjekësore. Në kooperativat bujqësore të rrethit të Korçës, përveç disa artikujve të mësipërm, mund të prodhohen poçeri, qymyr druri, gurë të gdhendur; në ato të rrethit të Gjirokastrës — voza, kade, bucela, pëlhurë gjineshtre, rrasa guri për mbulim çatie; në ato të Elbasanit — kapistra kafshësh, litar prej kërpi etj. Të tilla mundësi kanë edhe kooperativat bujqësore të rretheve të tjera. Nga ana tjetër, disa kooperativa bujqësore që ndodhen afër lumenjve dhe liqejve kanë mundësi dhe duhet të merren me gjuajtjen e peshkut, kurse disa të tjera mund të krijojnë rezervuarë të vegjël për rritjen artificiale të tij. Kjo do të ndihmojë edhe në përmirësimin e strukturës së ushqimit. Është e qartë se nga zhvillimi i këtyre aktiviteteve kooperativat bujqësore do të sigurojnë të ardhura suplementare. Ja një shembull: vetëm për grumbullimin e bimëve mjekësore shteti planifikon çdo vit mbi 200 milion lekë. Në rast se kooperativat bujqësore do t'i organizojnë më mirë aktivitetet ndihmëse që përmendëm më sipër për të plotësuar më mirë nevojat e tyre dhe të tregut, shteti ka mundësi të rritë edhe më shumë fondet e blerjes dhe nga kjo do të ketë dobi të madhe si vetë fshatarësia ashtu edhe ekonomia në tërësi.

Është fakt, për shembull, se me gjithë ekzistencën e këtyre fronteve të punës të pashfrytëzuara mirë, gjatë vitit 1961 mbi 17 mijë vetë, ose 7 për qind e fuqisë punëtore të aftë, nuk kanë marrë pjesë në punët prodhuese të fshatit dhe kjo gjë vihet re, ku më shumë e ku më pak, në të gjitha rrethet. Për këtë arsye janë humbur mbi 4 milion ditë-pune. Nga ana tjetër duhet të shtojmë se edhe mesatarja e ditë-punëve të kryera nga çdo kooperativist është akoma e ulët.

Mbetja e një numri kaq të madh të fuqisë punëtore jashtë sferës së prodhimit në kooperativa dhe nivelit akoma i ulët i ditëve kalendarike të punës të kryera mesatarisht nga çdo anëtar, për arsye të pajustificuara, subjektive, është një problem i mprehtë ekonomik dhe shoqëror, për të cilin duhet të punojnë më shumë, në radhë të parë, organizatat e Partisë. Që t'ja dalim

në krye këtij problemi duhet një punë e gjithanshme, bindëse, për të tërhequr sa më shumë në prodhim gruan, këtë forcë të madhe në fshat.

Në degët e tjera të ekonomisë popullore çdo rritje e numrit të fuqisë punëtore, në kushte të barabarta, shoqërohet patjetër me rritjen e vëllimit të prodhimit. Ky është një parim i njohur dhe i padiskutueshëm, i provuar në shkencë dhe në praktikë. Por si paraqitet kjo çështje në kooperativat bujqësore?

Kuptohet vetiu se zbatimi i këtij parimi në bujqësi, përveç të tjerave, varet shumë edhe nga veprimi i faktorëve të jashtëm, klimaterikë. Por në kushte normale, si rregull, edhe në bujqësi rritja e numrit të fuqisë punëtore dhe e ditë-punëve të kryera, e shoqëruar edhe me masa të tjera agroteknike, duhet të çojë në shtimin e prodhimit dhe të të ardhurave. Përndryshe nuk do të kishte asnjë kuptim rritja e fuqisë punëtore dhe e sasisë së punës së harxhuar. Megjithatë, duhet të theksojmë se rruga kryesore e zhvillimit të bujqësisë sonë dhe e rritjes së prodhimit bujqësor është dhe mbetet rritja e rendimentit të punës së punonjësve të fshatit. Për të rritur sa më shumë rendimentin e punës së tyre, ne duhet të synojmë që, në radhë të parë, të ngremë edhe më lart shkallën e mekanizimit të punimeve bujqësore, të organizimit të punës, të shfrytëzojmë më shumë e më mirë kohën e punës dhe normat e punës të shkojnë duke u ngritur krahas me ngritjen e shkallës së mekanizimit dhe të aftësive agroteknike të vetë punonjësve të fshatit. Një ndihmë të mirë në këtë drejtim mund dhe duhet t'u japin kooperativave ndërmarrjet bujqësore shtetërore, të cilat kanë një eksperiencë më të pasur lidhur me rritjen e rendimentit të punës në bujqësi.

Përfundimet e deritanishme tregojnë se në mjaft kooperativa bujqësore rritja e pjesëmarrjes në punë ka qenë një faktor i rëndësishëm për shtimin e prodhimit e të ardhurave. S'ka dyshim se përfundimet e arritura në këtë drejtim do të kishin qenë më të ndjeshme në qoftë se fuqia punëtore dhe ditë-punët e harxhuara në kooperativat bujqësore do të përdroreshin në mënyrë më racionale dhe efektive.

Që ky problem të gjejë një zgjidhje më të drejtë në të ardhshmen, është e nevojshme të mbahen parasysh edhe këto çështje:

Së pari, të bëjmë të gjitha përpjekjet që në psikologjinë e drejtuesve dhe të anëtarëve të kooperativave bujqësore të rrënjoset thellë ndjenja e kursimit, e harxhimit me vend, me cilësi dhe me efekt të lartë të ditë-punës.

Së dyti, të përmirësojmë përpjesëtimin midis ditë-punëve të harxhuara në sferën prodhuese dhe joprodhuese duke e kufizuar më tej numrin e ditë-punëve që harxhohen në administratë, për masat social-kulturale e të tjera të kësaj natyre.

Në lidhje me këtë nuk mund të mos vëmë në dukje faktin se në vitin 1961 vetëm për administratën dhe për punë të tjera të këtij karakteri janë harxhuar 13 për qind e numrit të përgjithshëm të ditë-punëve të kooperativave bujqësore, d.m.th. aq ditë-punë sa janë harxhuar për gjithë blegtorinë kolektive, ose më shumë se ditë-punët e harxhuara për perimet, patatet, bimët foragjere dhe për pemët frutore të marrura së bashku.

Pas vendosjes së pushtetit popullor, dhe sidomos si rrjedhim i industrializimit, në vendin tonë u intensifikua shumë procesi i shpërnguljes së popullsisë fshatare në qytet dhe në qendra pune. Vetëm gjatë pesëvjeçarit të dytë (1956-1960) nga fshati janë shpërngulur 100 mijë vetë dhe rreth 50 000 të tjerë janë integruar në ndërmarrjet bujqësore shtetërore. Bile ka raste të tilla, si në fshatin Sevaster, Lekdush, Boboshticë, Vuno e në disa fshatra të Përmetit e të Skraparit, ku është shpërngulur shumica e fshatarëve. Në rast se edhe në të ardhshmen do të lejohet që ky proces të vazhdojë me ritme të tilla, pa e disiplinuar dhe organizuar mbi baza më të shëndosha, do të krijohen vështirësi të ndryshme si për fshatin ashtu edhe për qytetin. Në zonat bujqësore ku zhvillohen kultura intensive do të krijohet një mungesë e ndieshme e fuqisë punëtore, gjë që mund të komprometojë realizimin me sukses të detyrave që shtrohen për zhvillimin e bujqësisë dhe për ngritjen e mirëqenjes në fshat.

Prandaj, organizatat e Partisë dhe organet e pushtetit duhet të zbatojnë me tërë kujdesin e tyre dispozitat e caktuara për këtë çështje nga qeveria, sipas porosive të Komitetit Qendror. Në të njëjtën kohë, nën drejtimin e drejtorive ekonomike të Komitetit Qendror të PPSH, të bëhet një studim i plotë, ku të përcaktohen të gjitha masat me karakter edukativ, organizativ e të tjera, që do të shërbejnë për mënjanimin e lëvizjes së pa-nevojshme të fuqisë punëtore nga fshati në qytet dhe ky studim t'i paraqitet Byrosë Politike të KQ të PPSH brenda këtij viti.

Lëvizja e fuqisë punëtore nga fshati në qytet është një problem i madh, për të cilin Partia dhe qeveria janë interesuar vazhdimisht. Edhe në të ardhshmen, me zhvillimin e mëtejshëm të industrisë, të ndërtimit dhe të degëve të tjera të ekonomisë, do të lindë nevoja që nga fshati të tërhiqet fuqi punëtore. Por, në radhë të parë, ne duhet të përpiqemi që fuqinë punëtore të nevojshme ta sigurojmë nga qyteti, sidomos nëpërmjet zëvendësimit të disa lloj punëve, ku sot punojnë burrat, me punën e grave, si në industri, në ndërtim, në ndërmarrjet bujqësore shtetërore, në tregëti, në komunale etj., kurse fuqia punëtore e burrave të liruar të përdoren në ato procese dhe lloje pune që kërkojnë punën e burrit. Kjo është, padyshim, një rezervë e madhe që duhet mbajtur mirë parasysh, me qëllim që fuqia punëtore të përdoret sa më drejt.

Pastaj një pjesë të nevojave për fuqi të re punëtore ne duhet të përpiqemi ta përballojmë duke ngritur më tej shkallën e mekanizimit të punimeve, rendimentin dhe organizimin e punës si dhe duke marrë çdo masë tjetër që shpie në përdorimin sa më racional të punës së njeriut. Edhe kur të paraqitet nevoja për të tërhequr patjetër fuqi punëtore nga fshati, kjo tërheqje duhet të bëhet e organizuar, mundësisht në periudhat kur fuqia punëtore në fshat është më e lirë nga punët bujqësore, me qëllim që një pjesë e saj të mund të kthehet përsëri në punët e bujqësisë dhe të synohet që fuqia punëtore të sigurohet në ato zona ku punët e bujqësisë dhe të blegtorisë e lejojnë largimin e saj nga fshati.

Dëshiroj të ndalem edhe në një pamje tjetër të këtij problemi. Ne vëmë re se në fshat, aty-këtu, dhe sidomos në të rinjtë, shfaqet dëshira për të shkuar në qytet. Shkaku i kësaj dëshire, deri-diku është i kuptueshëm, sepse qyteti, në krahasim me fshatin, është më përpara në shumë drejtime të jetës sociale e kulture. Kjo është një shprehje e njohur e ndryshimit esencial midis qytetit dhe fshatit, i cili, siç e theksuam edhe më parë, shkon drejt ngushtimit në të ardhshmen. Dhe shkalla e zvogëlimit të këtij ndryshimi varet shumë nga vetë zhvillimi ekonomik e kultural i fshatit, nga shfrytëzimi sa më racional dhe i shpejtë i të gjitha burimeve të pasurive të shumta natyrore që ka vendi ynë. Kjo është rruga kryesore për të rritur mirëqenjen në fshat, për ta bërë edhe atje jetën më të bukur, më të gëzueshme dhe më të begatshme. Prandaj, te fshatarësia jonë duhet të rrënohet thellë dashuria për punën në bujqësi e në blegtori, për ta çuar përpara jetën e fshatit, për ta shndërruar fshatin dhe bujqësinë në një bazë edhe më të fuqishme të ndërtimit të plotë të socializmit në vendin tonë. Kështu ajo do t'u përgjigjet edhe më mirë interesave të larta të atdheut tonë socialist dhe me punën e saj krijuese do t'i bëjë realitet perspektivat e mëdha e të shkëlqyeshme që i ka çelur fshatit Partia jonë.

Për të nxitur pjesëmarrjen më të gjerë të fshatarësisë në punën prodhuese dhe për të forcuar stabilizimin e saj në fshat, duhet gjithashtu të sigurojmë një farë qëndrueshmërie në të ardhurat për ditë-pune nga njëri vit në tjetrin si dhe shpërndarjen e tyre ritmike gjatë vitit. Eksperienca e deritanishme ka treguar se në ato kooperativa bujqësore që e kanë pasur parasysh këtë çështje, anëtarët janë lidhur më mirë me punën në ekonominë kolektive. Natyrisht, në këtë drejtim ka edhe mungesa. Disa kooperativa bujqësore të rrethit të Vlorës, të Tepelenës dhe të Tropojës e kanë kufizuar shpërndarjen e të ardhurave për ditë-pune gjatë vitit dhe nuk kanë krijuar fonde tranzitore për të siguruar pak a shumë një qëndrueshmëri në shpërndarjen e tyre nga njëri vit në tjetrin.

Kuptohet, pra, se në të ardhshmen këtij problemi duhet t'i kushtohet një kujdes më i madh, në mënyrë që të ardhurat e anëtarëve të kooperativës të rriten për çdo vit dhe të zgjerohet më shumë ndarja e paradhënjeve për ditë-pune gjatë vitit. Në këtë drejtim një rol të rëndësishëm luan edhe forcimi i mëtejshëm i sistemit të kontraktimit me organet grumbulluese duke rritur edhe masën e paradhënjeve që jepen për këto qëllime. Në të njëjtën kohë, mund të jetë e nevojshme të rishikohen dispozitat në fuqi që rregullojnë kreditin agrar, me qëllim që afati i kthimit të tij të përputhet me kohën e vjeljes së prodhimit për të cilën jepet krediti. Përveç kësaj, brenda vitit të ardhshëm të studjohet eksperimenti që po bëhet me kreditin që u jepet kooperativave bujqësore për ta shpërndarë në formë paradhënjeje për ditë-pune, për të nxjerrë konkluzionet përkatëse.

Kapitulli III

MBI NIVELIN DHE MËNYRËN E JETESËS, SHËRBIMET KOMUNALE, ARTIZANATIN DHE SHËNDETËSINË NË FSHAT

Deri tani folëm për punën dhe për prodhimin si burim i të ardhurave, për të ardhurat si bazë për rritjen e mirëqenjes. Tani le të shohim si përdoren këto të ardhura dhe nëse ato përdoren me efikasitetin e duhur për rritjen e mirëqenjes dhe të mënyrës së jetesës në fshat.

Mënyra e jetesës dhe shërbimet e tjera janë probleme të mëdha e të rëndësishme sociale, që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me rritjen e mëtejshme të mirëqenjes në fshat. Megjithatë, nganjëherë vihet re një kuptim i ngushtë dhe i kufizuar i këtyre problemeve dhe i rolit që ato luajnë për zhvillimin e mëtejshëm socialist të fshatit. Nganjëherë ndodh që niveli dhe mënyra e jetesës kuptohen vetëm si plotësimi i nevojave të ushqimit. Ky kuptim i ngushtë ka bërë që në ndonjë rast organizatat e Partisë dhe organet e pushtetit vëmendjen e tyre ta përqëndrojnë më shumë në çështjet e prodhimit, ndërsa problemet e tjera të rëndësishme të mënyrës së jetesës dhe të përdorimit racional të produktit të prodhuar nuk kanë zënë vendin e merituar në punën e tyre të përditshme.

Në të vërtetë, niveli dhe mënyra e jetesës janë një nocion shumë i gjerë, i cili përmbledh në vetëvete kushtet ekonomike, materiale, kulture, të shërbimit komunal, të shëndetësisë, të artizanatit, me fjalë të tjera, të tëra kushtet ekonomiko-sociale që përcaktojnë jetën në fshat, në të gjithë larinë e saj të për-

ditshme. S'ka dyshim se, pa ngritur në një shkallë të re, më të lartë, këto pamje të jetës në fshat, nuk mund të parafytyrohet dhe të kuptohet as vetë ecja e shpejtë drejt ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste.

Sikurse e theksuam edhe më lart, rritja e prodhimit përbën faktorin vendimtar për ngritjen e mirëqenjes në fshat. Ndërkaq, një rol të rëndësishëm në këtë drejtim luan edhe mënyra e përdorimit të vlerave materiale, mënyra e jetesës në fshat. Mënyra e jetesës ushtron një ndikim nxitës në rritjen e prodhimit, sepse duke i përdorur drejt vlerat materiale, duke shtuar kërkesat për një jetë më të mirë, do të rritet dëshira për punë, do të shtohen përpjekjet për të rritur prodhimin dhe për të siguruar sa më shumë të ardhura.

Në rendin e vjetër çifligaro-borgjez niveli i jetesës në fshat ishte shumë i ulët. Shumica dërmuese e fshatarësisë vuante për bukën e gojës, e cila përbënte kërkesën themelore në tërësinë e mënyrës së jetesës së saj. Të shumtë ishin fshatarët që, për të siguruar disa kilogram misër ose pak kripë e vajguri, duhej të harxhonin ditë të tëra për t'i blerë ato në qytet me çmime të larta spekuluese. Në atë kohë poeti ynë i shquar Migjeni, duke paraqitur gjendjen tragjike të fshatarësisë shkruante: «Një kokërr Misri asht një kokërr dhimbje kur ka shumë u e aspak misër... Emën perëndish sot nuk zejnë me gojë fëmijtë që posa kanë fillue të belbëzojnë, — por Misër! Misër! — asht fjala e ditës, asht sinonim i jetës...»¹. Në tablonë e përgjithshme të fshatit të vjetër dilnin në plan të parë kisha dhe xhamia, sarai i çifligarit dhe kulla e bajraktarit, ndërsa masat e fshatarësisë jetonin në kasolle dhe në shtëpi përdhese, ku sëmundjet, epidemitë kishin bërë fole dhe bënin kërdrinë duke rrëmbyer jetën e mijëra njerëzve.

Transformimet e thella revolucionare që u kryen në lëmin politik, ekonomik, social dhe kultural ngritën, në mënyrë të pakrahasueshme me të kaluarën, edhe nivelin e jetesës së fshatarësisë. Tani në fshat kanë lindur kërkesa të reja të jetesës, të panjohura më parë. Sot fshati kërkon më shumë dritë elektrike, radio, biçikleta, maqina qepëse, orendi shtëpiake, veshje të bukura, e shumë e shumë sende të tjera. Pamja e dikurshme e fshatit të vjetër po zhduket gjithnjë më larg në horizont dhe ajo po mbetet vetëm si një kujtim i hidhur i së kaluarës. Sot, krahas me shtëpitë e reja, po ndërtohen me hapa të shpejtë shkolla, shtëpi kulture, çerdhe dhe kopshte për fëmijët, ambulanca dhe qendra sanitare, rrugë dhe lulishte, të cilat po e bëjnë më të mirë, më të bukur e më të gëzueshme jetën e fshatit tonë të ri.

Ndalimi i jetërsimit të tokës, kolektivizimi i bujqësisë, e

¹ Migjeni. Vepra të zgjedhura, f. 114, botim i vitit 1969.

çliruan në një shkallë të madhe fshatarin nga botëkuptimi i vjetër mbi pasurinë dhe bënë që të ardhurat e tija ai t'i përdorë për të ngritur mirëqenjen. Tanimë u zhduk fenomeni kur disa fshatarë mundoheshin vjete me radhë të grumbullonin para për të blerë tokë e mjete të tjera prodhimi dhe, në shumë raste, bëheshin robër të fajdexhiut.

Tani, më tepër se kurrë, duket qartë drejtësia e politikës që ndoqi Partia lidhur me tokën në zgjidhjen e çështjes agrare. Jeta vërtetoi plotësisht se rruga e ndjekur nga revizionistët jugosllavë dhe nga pasuesit e tyre në këtë çështje, solli te ata ruajtjen e marrëdhënjeve kapitaliste në fshat, rrënimin dhe varfërimin e mëtejshëm të fshatarësisë punonjëse. Përkundrazi, politika e urtë e Partisë sonë shpuri në fitoren e socializmit në fshat dhe në ngritjen e vazhdueshme të mirëqenjes së fshatarësisë.

Bisedat e zhvilluara me fshatarët gjatë konsultimit popullor treguan edhe një herë drejtësinë dhe urtësinë e politikës që Partia ka ndjekur me ndalimin e jetërsimit të tokës. Shumë kuptimplotë janë fjalët e një fshatari plak nga Vlora, i cili përmirësimin e jetesës e shpjegonte në këtë mënyrë: «Ne sot punojmë dhe fitojmë. Ç'nevojë kishim dhe ç'gjë na duhej na e dha Partia. Atëhere ku t'i çojmë paratë? Duam s'duam do të hamë e do të pimë më mirë, do të vishemi e të mbathemi më mirë, do të bëjmë edhe shtëpi të ra».

Megjithatë, shqyrtimi i problemit të mirëqenjes në fshat nxori në shesh edhe një varg problemesh, për zgjidhjen e të cilave duhet të bëhet një punë e madhe në të ardhshmen.

Cilat janë disa nga këto çështje?

Së pari, në fshat ka fituar mënyra socialiste e prodhimit, ndërsa mënyra e jetesës ka mbetur më prapa nga ajo. Kërkesat e fshatarësisë për të përmirësuar mënyrën e jetesës janë akoma të kufizuara dhe në të mbisundon mentaliteti «për t'u kënaqur me pak». Kjo nuk e nxit pjesëmarrjen e gjerë të fshatarësisë në punë dhe ngadalëson zhvillimin e forcave prodhuese në bujqësi.

Së dyti, ritmet e rritjes së të ardhurave në natyrë dhe në të holla janë, në mjaft raste, më të larta se përmirësimet e bëra në administrimin e tyre, për të ndryshuar mënyrën e jetesës. Në këtë shpërpjesëtim ka influencuar shumë edhe prapambetja e madhe shekullore e trashëguar nga e kaluara si dhe botëkuptimi i vjetër për mënyrën e jetesës.

Së treti, midis fshatrave, zonave brenda një rrethi dhe midis vetë rretheve që kanë pothuaj të ardhura të barabarta, në mënyrën e jetesës ekzistojnë ndryshime të mëdha.

Së katërti, tregëtia socialiste, shërbimet komunale, të artizanatit dhe të shëndetësisë, megjithëse janë zhvilluar mjaft në krahasim me të kaluarën, ushtrojnë akoma një influencë të pamjaftueshme në përmirësimin e mënyrës së jetesës në fshat, se-

pse në veprimtarinë e tyre nuk pasqyrohen sa duhet kërkesat e reja, nga plotësimi i të cilave varet shumë edhe ndryshimi i mënyrës së jetesës.

Kapërcimi me sukses i këtyre kontradiktave do të shpjerë patjetër në ngritjen e mëtejshme të mirëqenjes dhe të mënyrës së jetesës në fshat. Natyrisht, kjo kërkon kohë, kërkon përmirësimin e mëtejshëm të punës së organizatave të Partisë dhe të organeve shtetërore, me qëllim që në ndërgjegjen e fshatarësisë të rrënjohet më thellë dëshira për të jetuar më mirë, në mënyrë më të kulturuar dhe për t'i përdorur sa më drejt dhe me nikoqirllëk të ardhurat e saja.

Prandaj, krahas shtimit të përpjekjeve për më shumë të ardhura nga fshatarësia, edukimi i rritjes së kërkesave të saja ndaj mënyrës së jetesës dhe administrimi më i mirë i të ardhurave të saj janë probleme shumë të rëndësishme të etapës së tanishme të zhvillimit socialist të fshatit. Është detyra jonë të marrim të gjitha masat e nevojshme me karakter edukativ e organizativ që këto çështje të pasqyrohen më gjerë në punën e përditshme të Partisë, të shtetit dhe të organizatave të masave që ato të ndjehen si një nevojë jetike nga vetë masat fshatare.

I. — TË NGREMË MË LART NIVELIN DHE MËNYRËN E JETESËS NË FSHAT

Ndër problemet themelore të nivelit dhe të mënyrës së jetesës, që zënë një vend me rëndësi në këtë çështje të madhe, duhen përmendur sasia e produkteve ushqimore të përdorura për frymë, mënyra e gatimit dhe struktura e të ushqyerit, sasia e artikujve industrialë të përdorur për frymë dhe mënyra e veshmbathjes, pajisja e shtëpisë me orënditë e nevojshme, mënyra e fjetjes etj.

Sot në vendin tonë ka fshatra dhe zona të tëra ku ndryshimet e bëra gjatë këtyre tetëmbëdhjetë vjetëve, në pamjet e mësipërme të mënyrës së jetesës, nuk mund të krahasohen në asnjë mënyrë me të kaluarën. Të tillë janë, për shembull, fshatrat e Devollit dhe të fushës së Korçës, fshatrat e Gjirokastrës, ato të bregdetit të Sarandës dhe të Vlorës, të Shupenzës dhe të Maqellarës në Peshkopi, të fushës së Shkodrës etj., ku mënyra e të ushqyerit, e veshjes, e mbathjes, e fjetjes dhe pamjet e tjera të jetesës nuk kanë ndonjë dallim shumë të madh nga mënyra e jetesës në qytet. Unë përmenda vetëm disa zona, por të tilla ka edhe në rrethet e tjera dhe në përgjithësi përparimet e bëra në mënyrën e jetesës gjatë pushtetit popullor kanë përfshirë të gjitha fshatrat.

Për ndryshimet e mësipërme dëshmon edhe xhiroja e shitjes me pakicë të mallrave të konsumit të gjerë, e cila vetëm për

kooperativat e konsumit, që kryesisht i shërbejnë fshatit, është rritur nga 4 miliard e 800 milion lekë në vitin 1955 në 7 miliard e 200 milion lekë në vitin 1961, ose 50 për qind më shumë. Në të njëjtën kohë, ka ndryshuar shumë edhe struktura e mallrave që përdor fshati. Krahas me artikujt tradicionalë të konsumit, në fshat po futen gjithnjë e më shumë artikuj të rinj industrialë. Në këtë drejtim një faktor i rëndësishëm ka qenë, natyrisht, edhe politika e Partisë në lëmin e prodhimit dhe të importimit të mallrave të konsumit të gjerë si dhe ulja sistematike e çmimeve të këtyre mallrave. Lidhur me këtë po përmendim vetëm efektin e njërit prej treguesve që ka ndihmuar në rritjen e konsumit të mallrave në fshat. Nga viti 1956 e këtej janë bërë 7 ulje të çmimeve. Si rrjedhim, në vitin 1961 çmimet e mallrave të konsumit të gjerë që i janë shitur fshatarësisë, kanë qenë 31 për qind më të ulëta se çmimet e të njëjtave mallra që i janë shitur asaj në vitin 1956.

Por ngritja e mëtejshme e mënyrës së jetesës në fshat shtrou detyrën që të ardhurat e familjes fshatare të përdoren më mirë e më drejt dhe të përmirësohet struktura e artikujve që konsumon fshati. Nga studimet e bëra në vend del se shpenzimet për artikujt ushqimorë dhe industrialë përfshijnë 90—95 për qind të të ardhurave të buxhetit të familjes fshatare. Prandaj, administrimi racional i të ardhurave për këto qëllime ka një rëndësi të veçantë dhe në përmirësimin e strukturës së shpenzimit të tyre, duhet kërkuar një nga rezervat për ngritjen e mëtejshme të mënyrës së jetesës.

Më poshtë po përqëndrohem në disa nga çështjet më kryesore që lidhen me nivelin dhe me mënyrën e jetesës në fshat.

1. — Niveli i përdorimit të artikujve ushqimorë dhe mënyra e të ushqyerit në fshat

Niveli i ushqimit, struktura e artikujve ushqimorë, koha dhe ritmika e përdorimit të tyre, mënyra e përgatitjes së ushqimit dhe format e ngrënjes së tij kanë një rëndësi të madhe për zhvillimin e përgjithshëm harmonik dhe të shëndoshë të njeriut. Është e padiskutueshme se nga këta faktorë varet shumë ruajtja e shëndetit të njeriut si dhe shkalla e pjesëmarrjes së tij aktive në të gjitha fushat e krijimtarisë shoqërore.

Prandaj, duke u nisur nga vendi shumë i rëndësishëm që zë ushqimi në jetesën e njeriut, atij i duhet kushtuar vazhdimisht një kujdes i madh. Në të ardhshmen vëmendja jonë duhet të përqëndrohet në këto drejtime kryesore:

a) Të sigurojmë në një kohë sa më të shkurtër një ndryshim rrënjësor të strukturës së produkteve ushqimore që për-

dor fshatarësia dhe të zgjerojmë burimet e tyre në fshat. Gjatë vjetëve të pushtetit popullor përdorimi i produkteve ushqimore në fshat ka pësuar ndryshime të mëdha, sidomos përsa i përket sasisë dhe strukturës së tyre. Në vitin 1961 përdorimi mesatar për frymë i produkteve ushqimore nga fshatarësia, në përgjithësi, është më i lartë se niveli i arritur në shkallë kombëtare në vitin 1938. Kjo rritje për produktet kryesore, sipas të dhënave të përafërta, paraqitet si vijon: drithëra buke e nënprodukte të tyre 18 për qind më shumë, fasule 198 për qind më shumë, sheqer 48 për qind më shumë, perime e patate 69 për qind më shumë, yndyrna 10 për qind më shumë dhe fruta 320 për qind më shumë.

Një tregues tjetër i rëndësishëm që flet për ndryshimet që janë bërë në nivelin dhe në strukturën e ushqimit në fshat, është edhe sasia e kalorive, e hidrokarbureve, e yndyrnave dhe e proteinave. Në vitin 1961, në bazë të përlllogaritjeve të përafërta, çdo frymë e popullsisë fshatare ka marrë mesatarisht në ditë 2 600 kalori, ndër të cilat ato me origjinë shtazore zënë 15 për qind, në një kohë kur popullsia qytetare ka marrë mesatarisht në ditë 2 400 kalori.

Ndonëse fshati në tërësi merr më shumë kalori se qyteti, në përdorimin e produkteve ushqimore kryesore fshati është akoma prapa nga qyteti.

Midis rretheve dhe zonave ekzistojnë ndryshime, si përsa i përket sasisë, ashtu edhe strukturës së produkteve ushqimore që përdor fshati. Karakteristikë është se zonat malore dhe kodrinore përdorin kryesisht bukë, mish e qumësht dhe shumë pak perime; ndërsa zonat fushore përdorin relativisht më pak bukë, mish e qumësht dhe i zëvendësojnë këto duke përdorur më shumë perime. Kështu, p.sh. në rrethet e Kukësit, Matit dhe Skraparit përdorimi mesatar për frymë i perimeve në vitin 1961 nuk arrinte as 25 kg. Në zonat fushore gjendja paraqitet më ndryshe. Në rrethet e Lezhës dhe Lushnjës përdorimi mesatar për frymë i perimeve në vitin 1961 arrinte deri në 40 kg., megjithëse edhe kjo sasi është e vogël.

Sikurse shihet, në përdorimin e perimeve në fshat, sidomos në zonat malore dhe kodrinore, jemi prapa. Është krejt e qartë se me këtë gjendje ne nuk duhet të pajtohemi në asnjë mënyrë. Rritja e përdorimit të perimeve në fshat është bërë një nevojë e ngutshme, pasi ajo përbën një rezervë të madhe për përmirësimin e strukturës së ushqimit, kursimin e bukës e të produkteve të tjera dhe për një administrim më të drejtë të të ardhurave të fshatarësisë.

Sasia e produkteve ushqimore që përdor fshati dhe struktura e tyre janë të lidhura ngushtë dhe përcaktohen nga burimet e formimit dhe nga mundësitë e furnizimit që ka shteti. Si rre-

gull, pjesën kryesore të këtyre produkteve fshatarësia e siguron, në radhë të parë, nga prodhimi i vet, ndërsa një pjesë tjetër e merr nëpërmjet shkëmbimit fshat-qytet. Në vitin 1961 fshatarësia në tërësi ka siguruar nga blerjet në treg: 34 për qind të nevojave të saja për drithë dhe nënprodukte të tij, mbi 42 për qind të nevojave për yndyrna, mbi 97 për qind të nevojave për oriz, ndërsa nevojat për produktet e tjera, si fasule, mish, qumësht, vezë, fruta, perime, patate, i ka siguruar nga prodhimi i vet. Kuptohet se këto shifra janë mesatare për tërë vendin, pasi ka zona dhe fshatra ku furnizimi nëpërmjet tregut përbën burimin kryesor për sigurimin e mjaft produkteve ushqimore me origjinë bujqësore, sikurse është drithi etj. Kështu, për shembull, në vitin 1961, nëpërmjet furnizimeve nga shteti, fshatarësia e rrethit të Skraparit ka plotësuar 55 për qind të nevojave të konsumit për drithë e nënprodukte të drithit, ajo e Kukësit 45 për qind, e Përmetit 30 për qind, e Matit 40 për qind etj. Më 1961, kundrejt vitit 1956, kooperativat e konsumit kanë shitur më shumë: yndyrna 269 për qind, sheqer 132 për qind, makarona 117 për qind, fasule e oriz 47 për qind.

Një nga format e mobilizimit të burimeve të brendshme ushqimore në fshat dhe që krijon një qëndrueshmëri më të madhe në strukturën e ushqimit gjatë gjithë vitit, është konservimi i produkteve nga vetë familjet fshatare, ose, siç thotë populli, «vënja e zahireve» në kohën e prodhimit për periudhën e mëvonshme. Në mjaft zona dhe fshatra ka qenë i përhapur konservimi i produkteve ushqimore, si për shembull mishi në formën e pastërmasë në zonën e Kurveleshit, të Korçës dhe në malësitë e Veriut, në shumë fshatra konservoheshin brumëra në formën e trahanasë, petëve, osave etj. Duhet t'i mësojmë dhe t'i nxitim fshatarët që të konservojnë zarzavate në formën e turshive, por zarzavatet dhe frutat mund të përdoren shumë mirë edhe të thara në diell. Të tillë nikogjirllëk duhet të tregojë çdo familje në fshat, sepse kështu do të ketë gjithë vitin çka të përdorë për të përgatitur gjellë të ushqyeshme. Por këto tradita të mira të fshatarësisë aty-këtu, kanë filluar të lihen pas dore, megjithëse sot ekzistojnë mundësi materiale më të mëdha se në të kaluarën për t'i vënë në jetë. Ne duhet të bëjmë përpjekje dhe të marrim çdo masë që këto mënyra të konservimit jo vetëm të mos kufizohen, por përkundrazi, t'i zhvillojmë më tej dhe t'i përhapim në të gjithë fshatarësinë.

b) *Të përmirësojmë mënyrën e përgatitjes dhe të përdorimit të ushqimit në fshat.* Më sipër ne folëm për disa nga çështjet më kryesore që kanë të bëjnë me sasinë e përdorimit, strukturën e produkteve ushqimore dhe burimet e sigurimit të tyre në fshat. Por ndryshimi i mënyrës së jetesës dhe ngritja e nivelit të saj varen në një shkallë të madhe edhe nga mënyra e përgatitjes dhe e përdorimit të ushqimit.

Mënyra e përgatitjes dhe e përdorimit të ushqimit në fshat në përgjithësi, duhet të kishte pësuar ndryshime më të mëdha në krahasim me të kaluarën. Si rrjedhim, niveli relativisht i ulët i përdorimit të produkteve ushqimore ulet edhe më shumë nga mënyra e gatimit të ushqimit dhe nga koha e përdorimit të tij.

Në fshat gatimi i bukës dhe i gjellëve nuk bëhet kudo me cilësinë e duhur, në kushtet e nevojshme higjienike dhe, me disa përjashtime, mbisundon kuzhina «orientale», e cila është e lidhur me shpenzime të mëdha dhe përdorim joracional të produkteve. Kjo kuzhinë mbështetet kryesisht në brumërat, në mishin e zier e të pjekur, duke përdorur pak zarzavatet, patatet etj. Një mënyrë e tillë gatimi, në një kohë kur edhe sasia e produkteve është akoma e kufizuar, e ngushton shumë numrin e gjellëve. Kjo gjendje shtrton nevojën për të marrë masat përkatëse, që e përmirësojnë dhe e bëjnë më ekonomike mënyrën e gatimit në fshat.

Një mënyrë e tillë gatimi në fshat e ka burimin edhe në faktin se njohuritë e grave mbi kuzhinën janë të kufizuara. Këto njohuri zakonisht formohen nga dhënja e shprehive brez pas brezi. Me gratë në këtë drejtim nuk bëhet ndonjë punë e organizuar e vazhdueshme. Përpjekjet e organizatës së gruas nëpërmjet revistës «Shqiptarja e re» dhe botimet e pakta që janë bërë për këtë çështje, nuk kanë ndihmuar sa duhet për kushtet konkrete të fshatit tonë. Prandaj, të shumta janë amvisat që përdorin pa masë yndyrën, nuk racionojnë mirë mishin për pjesëtarët e familjes, përdorin shumë pak erëzat natyrale, nuk njohin sa duhet përdorimin e zarzavateve dhe të salcave. Nga kjo ndodh që, megjithëse shpenzimet materiale bëhen të rënda, gjellët nuk dalin të shijshme.

Në përmendëm më sipër mënyrën e gatimit në fshat. Por një rëndësi jo më pak të vogël ka edhe çështja e rregullit të ushqimit ditor. Zakonisht ushqimi ditor karakterizohet në darkë me gjellë, kurse mëngjezi dhe dreka janë të lehta. Si rrjedhim, marrja e energjive nga ushqimi nuk përputhet me kohën e harxhimit të tyre, në procesin e punës, gjë që ul edhe aftësitë në punë. Marrja e ushqimit të bollshëm në mbrëmje nuk është racionale, sepse në kohën kur ushqimi duhet të absorbohet nga organizmi dhe lëndët kimike kalojnë nga kaloria në energji, pikërisht në këtë kohë organizmi pushon (njeriu fle) dhe nuk harxhon energji. Si rrjedhim, një pjesë e lëndëve nuk konsumohet në kohën e duhur, por depoiztohet, duke i krijuar kështu vështirësi të shumta aparatit tretës. Këtu e kanë burimin edhe shumë sëmundje, si ulçera etj. Prandaj është e nevojshme dhe e këshillueshme që marrja racionale e kalorive ditore me anën e ushqimit të ndahet përafërsisht: në mëngjez — rreth 30 për qind e kalorive të përgjithshme ditore, në drekë — rreth 45 për qind dhe në darkë — rreth 25 për qind e tyre. Një regjim i tillë në marrjen e ushqimit jo vetëm që përballon më mirë zëvendësimin e energjive të humbura nga njeriu gjatë punës,

por e forcon edhe më shumë organizmin e tij dhe e mbron nga sëmundje të ndryshme.

Në mënyrën e të ushqyerit dhe administrimit racional të produkteve ushqimore në fshat një influencë çrregulluese ushtrojnë edhe zakonet prapanike dhe paragjykimet fetare që ekzistojnë akoma aty-këtu, si kreshmat, ramazani etj. Në këto raste grumbullohen shumë njerëz në gostira dhe fshatari detyrohet të thërë bagëtitë, bile të hyjë edhe në borxh për të përballuar shpenzimet. Në disa fshatra të rretheve të Durrësit, Tepelenës, Elbasanit e kanë zakon që në darkat ose drekat që shtrohen në të tilla raste, të jepen disa lloje suprash, byreqesh, gjellësh, ëmbëlsirash dhe kurdoherë nuk mungon mish i pjekur. Forca e këtyre zakoneve është më e ndieshme në zonat ku ne kemi trashëguar një prapambetje më të madhe dhe ku feja ka pasur rrënjë më të thella, si për shembull në malësitë e Shkodrës, në Dukagjin, në rrethin e Dibrës e të Beratit, ndërsa ajo është më e dobët në fshatrat e rrethit të Korçës, në disa zona të rrethit të Gjirokastrës, ku niveli i përgjithshëm i zhvillimit ka qenë relativisht më përpara.

Këto zakone bëjnë që përdorimi i produkteve, dhe sidomos i mishit në fshat, të ketë karakter të theksuar disproporcional e sporadik. Për pasojë, ato e keqësojnë gjendjen ushqimore të përditshme të fshatit, pengojnë ripërtëritjen normale të energjisë që harxhon fshatari në punë dhe, në përgjithësi, dëmtojnë shëndetin e tij.

Duke folur për mënyrën e ushqimit, nuk mund të lëmë pa përmendur edhe formën e marrjes së tij. Në të kaluarën ne kemi pasur fshatra, sidomos në rrethin e Korçës, të Pogradecit dhe të Dibrës, ku për këtë çështje tregohej një kujdes më i madh. Në vjetët pas çlirimit janë bërë përmirësime të mëtejshme, jo vetëm në këto rrethe, por edhe në krahinat e tjera, si në Lushnjë, Fier, Vlorë. Megjithatë, forma e marrjes së ushqimit mbetet akoma një problem i madh. Në Vurgun e Delvinës, në rrethin e Tiranës, në atë të Elbasanit, të Krujës, të Shkodrës, ndeshen akoma raste kur fshatarët hanë së bashku, në një sahan, në sofër, buka copëtohet me dorë, pajisjet e ngrënjes janë shumë të varfëra ose mungojnë fare.

Me fitoren e kolektivizimit në fshat kooperativat bujqësore kanë filluar të ngrenë mensa, të cilat u shërbejnë kryesisht traktoristëve, punonjësve që venë me shërbim në fshat dhe më rrallë arësimtarëve. Këto mensa janë në fazën e tyre fillestare, pa kuzhinierë të aftë dhe në to nuk zbatohen sa duhet rregullat e nevojshme për gatimin e ushqimit. Në gjendjen e tyre të sotme ato nuk po shërbejnë si shembull për të përmirësuar mënyrën e përgatitjes së ushqimit në familjet fshatare. Që këto të luajnë rolin e tyre të vërtetë, në të ardhshmen kooperativat bujqësore duhet ta marrin mirë në dorë drejtimin e tyre dhe, me ndihmën e komiteteve ek-

zekutive dhe të kooperativave të konsumit, të përgatitin kuzhinierë të aftë për to.

Në përfundim mund të themi se në përgatitjen, përdorimin dhe format e ngrënjes së ushqimit ne jemi akoma prapa kërkesave që shtron mënyra e re socialiste e jetesës në fshat. Natyrisht, rezultatet në këtë drejtim nuk mund të jenë të menjëhershme, pasi ato lidhen me botëkuptimin, me forcën e zakoneve, me kundërshtimin që paraqet e vjetra për të mos i lëshuar vendin së resë.

Por shqyrtimi i këtij problemi shtron me forcë para nevojën e marrjes së masave që të sigurojnë administrimin më të mirë të produkteve ushqimore nga fshatarësia dhe të përmirësojnë dalëngadalë strukturën e ushqimit të saj. Duke u nisur nga ky qëllim është e domosdoshme të punohet në këto drejtime kryesore:

Së pari, meqenëse, tani për tani, sasia e mishit dhe e bulmetrave që përdoret në ushqimin e fshatit është relativisht e kufizuar dhe rritja e shpejtë e saj nuk mund të arrihet menjëherë, shtrohet detyra që shtimi i proteinave në bilancin ushqimor të bëhet kryesisht nga rritja e prodhimit të kulturave bimore, sidomos të leguminozeve. Në të njëjtën kohë, për të përmirësuar strukturën e ushqimit, të arrihet sa më parë zbatimi i orientimit të dhënë nga Kongresi IV i Partisë që, brenda këtij pesëvjeçari, të zgjidhet përfundimisht plotësimi i nevojave të popullsisë me patate dhe perime, duke pasur parasysh kushtet konkrete të rretheve.

Për zgjidhjen e këtij problemi duhen shfrytëzuar më mirë edhe sipërfaqet e oborreve të anëtarëve të kooperativave, duke mbjellë në to leguminoze, perime, patate etj., për të plotësuar, në radhë të parë, nevojat e familjeve kooperativiste dhe pastaj për të hedhur edhe në treg.

Së dyti, për të pasur një përdorim më racional të produkteve bujqësore e blegtorale, të cilat sigurohen nga vetë burimet e fshatit, për të rritur gamën dhe qëndrueshmërinë e strukturës së ushqimit, është e domosdoshme që në të ardhshmen të bëhet një punë më e organizuar për hedhjen e zahireve, si turshi, bulmetra, pastërma, zarzavate e fruta të thata etj., dhe të nxitet përhapja e tyre kudo. Me këtë punë duhet të merret çdo familje fshatare, ajo të mbështetet nga organizata e gruas, e cila ta shpallë atë një aksion të saj.

Së treti, që të përmirësohet mënyra e gatimit në fshat është me vend të merren edhe disa masa nga shteti, siç mund të jenë organizimi i kurseve për gatuarjen e gjellëve mbi bazë rrethi, ku të marrin pjesë gra nga çdo fshat, përgatitja e disa materialeve të thjeshta për botim, ku të trajtohen çështjet më kryesore të gatuarjes së gjellëve, të konservimit dhe masa të tjera të kësaj natyre, që duhet të dijë gruaja e fshatit dhe që të jenë të përshtatshme dhe të zbatueshme në kushtet e fshatit.

2. — Niveli i përdorimit të artikujve industrialë, mënyra e veshmbathjes dhe e fjetjes në fshat

Niveli i përdorimit të artikujve industrialë është një ndër treguesit më të rëndësishëm që shpreh fuqinë ekonomike të fshatit. shkallën e zhvillimit të tij kultural dhe administrimin e të ardhurave nga familjet fshatare. S'ka dyshim se mënyra e veshmbathjes dhe e fjetjes ka për qëllim jo vetëm të përmirësojë pamjen e jetës së njeriut, por në radhë të parë të sigurojë kushtet më të mira për mbrojtjen dhe zhvillimin e gjithanshëm të shëndetit të tij.

Prapambetja shekullore e së kaluarës dhe varfëria ekonomike e kishin detyruar fshatarësinë që të vishej, të mbathej dhe të flinte keq. Niveli i ulët i prodhimit dhe zhvillimi i paktë i marrëdhënjeve fshat-qytet e shtërngonin atë që pjesën kryesore të këtyre nevojave ta plotësonte me prodhimin e saj vetjak. Si rrjedhim, në fshat ka qenë i zhvilluar mjaft artizanati shtëpiak për përgatitjen e veshmbathjes, të orendive shtëpiake etj.

Me çlirimin e vendit filluan të bëhen ndryshime të ngadalshme, por të vazhdueshme, edhe në mënyrën e veshmbathjes, të pajisjes së shtëpisë dhe të fjetjes. Megjithatë, niveli i përdorimit të artikujve industrialë, mënyra e veshmbathjes dhe e fjetjes nuk u përgjigjen sa duhet mundësive ekonomike dhe jetës së re që po lind në fshat. Përveç kësaj, në mënyrën e jetesës dhe të fjetjes ekzistojnë ndryshime midis krahinave, rretheve, zonave e fshatrave, bile edhe midis familjeve të të njëjtit fshat, të shkaktuara shpeshherë nga administrimi i diferencuar i të ardhurave.

Duke u nisur nga rëndësia që paraqet ky problem për mënyrën e jetesës në fshat, në të ardhshmen vëmendja jonë duhet të përqëndrohet sidomos në këto çështje kryesore:

a) *Të rritim nivelin e përdorimit të artikujve industrialë dhe të përmirësojmë mënyrën e veshmbathjes në fshat.* Në vjetët e fundit është rritur përdorimi i artikujve industrialë dhe është përmirësuar vazhdimisht mënyra e veshmbathjes në fshat.

Përmirësime më të dukshme në veshmbathjen e fshatit janë bërë veçanërisht në ato zona ku, krahas me rritjen e të ardhurave për frymë të fshatarësisë, është bërë edhe një punë më e madhe për të futur të renë, sikurse ndodh me fshatrat e rrethit të Lushnjës dhe të Fierit. Në të kundërtën, në mjaft fshatra të rretheve të Tiranës, Librazhdit, Mirditës, Gramshit e Elbasanit, me gjithë rritjen e të ardhurave, veshmbathja e fshatarësisë ka pësuar ndryshime më të ngadalshme. Këto ndryshime shprehen edhe në sasinë e artikujve industrialë që ble fshatarësia, të cilat në vitin 1961 kanë qenë mesatarisht, për frymë, në rrethin e Kukësit — 2 210 lekë dhe në atë të Gramshit — 2 220 lekë, ndërsa në atë të Peshkopisë — 2 580 lekë dhe në atë të Lezhës — 2 750 lekë (pa përfshirë stofat e leshta që prodhon vetë fshatarësia në këto krahina).

Me rritjen e të ardhurave të fshatarësisë janë krijuar të gjitha mundësitë që të shtohet edhe përdorimi i artikujve industrialë nga ana e saj. Në kemi krijuar gjithashtu industrinë e lehtë dhe kemi zhvilluar mjaft artizanatin e kooperuar, të cilat janë në gjendje të hedhin në treg sasi më të mëdha mallrash, artikuj e asortimente të ndryshme. Të gjitha këto e bëjnë të mundur që në jetën e fshatit të futen forma të reja, më të thjeshta, më të bukura dhe më të lira të veshmbathjes.

Në këtë drejtim ne kemi arritur disa rezultate të mira, sidomos në rrethin e Korçës, të Gjirokastrës, të Lushnjës, të Fierit dhe të Durrësit, ku në përgjithësi fshatarësia ka përmirësuar mënyrën e vjetër të veshmbathjes dhe ka filluar të bëjë diferencimin në veshmbathjen e punës, jashtë punës dhe të fjetjes. Kështu, për shembull, në zonën e Devollit fshatarësia përdor rroba pune, si tuta, kapela prej kashte etj., dhe, kur mbaron punën, fshatari i Devollit vishet me rroba të tjera, duke siguruar në këtë mënyrë një përdorim më racional të veshmbathjes. Në shumë fshatra të rrethit të Lushnjës, si në Bubullimë e Divjakë, fshatarësia përdor gjerësisht konfeksionet dhe, në përgjithësi, veshja në këto fshatra pak ndryshon nga ajo e qytetit të Lushnjës. Një përhapje të gjerë ka marrë në fshat edhe kadifeja, e cila përdoret si për rrobat e burrave ashtu edhe për veshjet e grave.

Por jo kudo është treguar i njëjti kujdes për këtë çështje. Kështu shpjegohet që edhe sot në disa zona, si të rrethit të Elbasanit e të Tiranës, ku, megjithëse klima e tyre në përgjithësi është e ngrohtë, të burrat, gratë e fëmijët mbisundon veshja me rroba të trasha prej leshi. Në shumicën e fshatrave të jugut për burrat përdoret shajaku.

Këto dhe disa lloje të tjera veshjeje nuk janë të leverdishme, si për vetë fshatarin ashtu edhe për ekonominë popullore. Ato shpien në përdorim joracional të lëndëve të para deficitare, sikurse është leshi. Kështu, për shembull, në vitin 1961 shteti grumbulloi vetëm 50 për qind të sasisë së leshit të prodhuar, kurse pjesa tjetër u përdor për nevojat vetjake të fshatarësisë. Ka rrethe, si ai i Peshkopisë e i Krujës, që dorëzuan bile edhe më pak se mesatarja e mësipërme. Është llogaritur gjithashtu se ato gra që vishen me çitjane (dimitë) përdorin deri në 10—15 metra basme, me të cilën mund të bëhen 3—4 fustane të zakonshme. Nuk duhen shumë llogari për të kuptuar përfitimet e mëdha që do të kishin fshatarësia dhe ekonomia popullore nga zëvendësimi i disa lloj veshjeve të sotme me veshje më racionale, më të bukura dhe më higjienike. Në këtë rast, me të njëjtat shpenzime dhe me të njëjtin material që fshatari përdor sot, në vend të një palë rrobave, ai do të mund të bënte dy e më shumë palë më të bukura dhe më të përshtatshme. Në këtë drejtim një ndihmë të madhe duhet të japin industria dhe artizanati, duke prodhuar më shumë rroba të gatsh-

me prej leshi, doku, kadifeje etj., me motive të thjeshta, të bukura e të përshtatshme për fshatin, duke prodhuar imitacion shajaku më të lirë se ai i sotmi etj. Një çështje tjetër, për të cilën duhet treguar kujdes, është edhe mirëmbajtja e rrobave, meremetimi i tyre në kohë, larja në rregull dhe me kujdes.

Në të ardhshmen organizatat e Partisë duhet ta shtojnë më shumë kujdesin për këto çështje. Në radhë të parë të rriten kërkesat ndaj komunistëve, që ata të japin shembullin personal, duke përdorur veshje të bukura, të përshtatshme dhe higjienike. Veçanërisht një punë më të madhe duhet të bëjnë arësimtarët, punonjësit e shëndetësisë dhe organizata e gruas dhe e rinisë, të cilat të shpjegojnë me durim dëmin ekonomik që ka fshatari nga disa lloj veshjeje të sotme të papërshtatshme. Organizata e gruas dhe e rinisë, brenda vitit 1964, të ndër marrin si aksion të tyre zëvendësimin e dimiteve, shallvareve dhe të gjitha llojeve të tjera të veshjeve joracionale dhe antihigjienike nga të rinjtë dhe të rejat e fshatit.

b) *Të zgjerohet përdorimin e orendive shtëpiake, ta bëjmë më higjienike dhe më të rehatshme mënyrën e fjetjes në fshat.* Një ndër pamjet e mënyrës së jetesës në fshat, ku përmirësimet janë më të dukshme, është pa dymim, ajo e pajisjes së shtëpisë me orenditë më të nevojshme dhe mënyra e fjetjes. Në të kaluarën në mjaft zona të Tropojës, të Mirditës, të Myzeqesë, të Delvinës dhe të Elbasanit shumica e familjeve banonte bashkë me bagëtitë, flinte pothuajse për tokë, nuk përdorte as dysheqe e jorgane dhe nuk njihte lugën metalike, pirunin dhe enët e fajancës.

Tani gjendja e rëndë e së kaluarës ka ndryshuar. Në fshat kanë filluar të përdoren gjithnjë më shumë krevati, kanapeja e minderi, po ndahen bagëtitë nga vendi i fjetjes së njerëzve dhe po kufizohet fjetja e përbashkët e të gjithë pjesëtarëve të familjes në një dhomë. Në të njëjtën kohë, po përdoren më gjerë mobiljet dhe pajisjet e ngrënjes. Këta elementë të rinj të mënyrës së jetesës në fshat pasqyrohen edhe në strukturën e mallrave që tregëtojnë kooperativat e konsumit, të cilat në vitin 1961 shitën më shumë se në vitin 1956 mobilje e orendi — 154 për qind, prodhime qelqi e fajance — 105 për qind, jorgana, batanie e dysheqe — 218 për qind, lugë, thika e piruj — 28 për qind. Të gjitha këto, të marrura së bashku, i kanë bërë më të rehatshme kushtet e brendshme të jetesës në shtëpitë fshatare.

Këto përfundime shpjegohen jo vetëm me rritjen e të ardhurave të fshatit, por edhe me punën më të madhe që është bërë në këtë drejtim nga organizatat e Partisë dhe veçanërisht nga organizatat e gruas. Iniciativa e organizatës së Bashkimit të Grave të Shqipërisë për bërjen e fshatrave model, e mbështetur nga organizatat e Partisë të rretheve, ka qenë një faktor organizativ i rëndësishëm për pajisjen e shtëpisë me orenditë e nevojshme dhe për

ndryshimin e mënyrës së fjetjes në fshat. Megjithatë, në këtë drejtim mbetet akoma shumë për të bërë, që kjo iniciativë të zbatohet gjerësisht.

Në disa rrethe, si në atë të Pukës, të Tropojës, të Mirditës dhe në malësitë e Shkodrës vihen re akoma raste të fjetjes duke shtruar diçka për tokë. Në disa fshatra nuk përdoren sa duhet çarçafë e këllëfë jastëku dhe nuk janë larguar kafshët nga vendi i banimit.

Natyrisht, është keq kur në fshat mungojnë orenditë shtëpiake. Por, nga ana tjetër, nuk është e drejtë dhe nuk është mirë kur familjet fshatare i kanë këto dhe nuk i përdorin për vete, por i ruajnë vetëm për miqtë, sikurse ndodh në fshatrat e rretheve të Tepelenës, Elbasanit dhe Shkodrës.

Që në të ardhshmen të arrijmë përfundimet e dëshiruara, duhet të shtojmë më tepër kujdesin dhe punën për këto çështje. Kjo punë duhet të jetë e matur, me takt dhe e diferencuar, të mbështetet në kushtet konkrete ekonomike të çdo zone, fshati dhe familjeje, sepse kështu masat fshatare do të binden më mirë për nevojat e përmirësimit të kushteve të banimit dhe të fjetjes.

c) *Të forcojmë influencën e tregëtisë për përmirësimin e mënyrës së jetesës në fshat.* Tregëtia socialiste luan një rol të rëndësishëm për plotësimin e nevojave në rritje të fshatarësisë. Për ta ushtruar këtë funksion ajo nuk duhet të jetë vetëm një ndërmjetëse e thjeshtë në shitblerjen e mallrave, por një hallkë e rëndësishme për të nxitur kërkesa të reja të fshatarësisë, që kjo të përmirësojë me ritme më të shpejta mënyrën e jetesës.

Në fshat kjo detyrë u është ngarkuar kooperativave të konsumit, të cilat, duke e zgjeruar rrjetin e dyqaneve, i kanë krijuar fshatarësisë kushte lehtësuese për një përdorim më të gjerë të artikujve industrialë. Tani gati në të gjitha qendrat e lokaliteteve është ngritur një bazë për shitjen e këtyre artikujve, ndërsa në dyqanet e fshatit gjenden kurdoherë asortimentet e nevojës së përditshme.

Në vitin 1961, në 2 220 fshatra me më shumë se 25 familje kishte 1 870 dyqane, pa përfshirë këtu pikat e grumbullimit, punishtet, baxhot etj. Për t'ju përgjigjur më mirë dhe në kohë kërkesave në rritje të fshatarësisë, rrjeti i tregëtisë në fshat vazhdon të zgjerohet, sidomos në thellësi. Tregëtarët, matrapazët e fajdexhinjtë e dikurshëm, që shfrytëzonin e ripnin fshatarësinë me anën e çmimeve, të pengjeve, fajdesë etj., ka kohë që janë zhdukur. Fshatarët kanë organizuar kooperativat e shitblerjes, të cilat, me ndihmën e madhe që u jep shteti, janë bërë hallka kryesore e shkëmbimit të mallrave midis klasës punëtore dhe fshatarësisë.

Megjithatë, në tregëtimin e artikujve industrialë nga kooperativat e konsumit vërehen disa dobësi. Tregëtia kooperativiste, në përgjithësi, akoma nuk po u përgjigjet si duhet kërkesave në rritje të fshatarësisë. Në disa rrethe, si në atë të Tiranës dhe të Librazhdit, në dyqanet e kooperativave të konsumit nuk gjenden artikuj të

nevojshëm dhe të domosdoshëm për fshatin, si çarçafë, këllëfë jastëku, basme të qepura për mindere, muslluke, enë e pajisje kuzhine prej fajance, konfeksione etj. Ka pasur gjithashtu raste që aksionet e organizatës së gruas për bërjen e fshatrave model nuk janë mbështetur si duhet me mallrat përkatëse nga kooperativat e konsumit.

Në të njëjtën kohë, në ndërtimin e strukturës dhe të asortimentit të mallrave, kooperativat e konsumit nuk mbajnë parasysh sa duhet detyrën që ato të influencojnë sa më shumë në përmirësimin e mënyrës së jetesës në fshat. Kështu mund të shpjegohet fakti që ato shesin në sasi të mëdha djepe për fëmijë, ndërsa nuk tregëtojnë pothuajse fare krevate të thjeshta dhe të lira për të vegjëlit, që mund të prodhohen me lehtësi nga artizanati. Mjaft i kufizuar është në fshat edhe tregëtimi i mobiljeve, i karriqeve, i rafteve, i tavolinave dhe në dyqanet e kooperativave të konsumit gjen më tepër sofra, syndyqe për pajë dhe artikuj të tjerë të kësaj natyre. Këto tregojnë se kooperativat e konsumit nuk po u përshtaten me kohë dhe sa duhet kërkesave të reja, transformimeve të mëdha që po kryhen në fshat.

Por s'ka dyshim se për mungesat e mësipërme kanë të meta edhe organet prodhuese dhe veçanërisht industria lokale e artizanati. Nganjëherë ndërmarrjet prodhuese nisen nga plotësimi i planit si prodhim global, nga prodhimi i artikujve me çmime të larta, që e bëjnë më të lehtë plotësimin e planit, por nuk mbajnë parasysh sa duhet kërkesat që ka fshati dhe nuk zgjerojnë sa duhet prodhimin e artikujve të thjeshtë dhe të nevojshëm për të. Për të plotësuar më shumë dhe më mirë nevojat e ndryshme të jetesës që ka fshati, industria lokale dhe artizanati duhet të marrin masa për të rritur prodhimin, për të shtuar asortimentin dhe për të përmirësuar cilësinë, sidomos të artikujve të tillë siç janë enët prej balte, prej fajance dhe qelqi, orenditë prej druri, rrogozët, kanistrat e shumë e shumë të tjera si këto, duke u mbështetur në burimet e lëndëve të para lokale dhe në bazën e tyre materiale ekzistuese. Me qëllim që të nxitet edhe më shumë prodhimi i sendeve të nevojshme për të plotësuar më mirë kërkesat e fshatit për orendi dhe mobilje, përveç librave të propozimeve dhe të kërkesave, do të ishte e arësyeshme që pranë dyqaneve të kooperativave të ekspozohen mostra mobiljesh, orendish, artikujsh prej hekuri, në mënyrë që fshatarët të zgjedhin ato që u pëlqejnë më shumë dhe, në bazë të tyre, të bëhen porosinë pranë organeve prodhuese.

Të metat që vihen re në punën e kooperativave të konsumit në shkëmbimin e mallrave, e kanë nxitur fshatarësinë të zbrësë më dëndur në qytet, veçanërisht në ditët e pazarit, gjë që i largon nga pjesëmarrja në punët e bujqësisë.

Kushtet e reja të krijuara në fshat, kërkojnë një kuptim më të thellë të detyrës që u është ngarkuar organeve të prodhimit dhe të tregëtisë për të përmirësuar jetesën e fshatarësisë. Ka ardhur

koha që këtyre të metave t'u jepet fund dhe gjallërimi i mëtejshëm i tregëtisë, i prodhimit të artikujve të nevojshëm për fshatin, të merret në dorë seriozisht nga organet e Partisë dhe të pushtetit.

Kooperativat e konsumit, si organizata ekonomike të fshatarësisë, nuk duhet ta përqëndrojnë punën e tyre vetëm në fushën e shkëmbimit të mallrave midis qytetit dhe fshatit. Ato duhet pajtjetër të mendojnë vazhdimisht dhe të gjejnë format më të përshtatshme për t'i ndihmuar anëtarët e tyre edhe në ngritjen e mënyrës së jetesës. Për këtë qëllim do të ishte e arësyeshme që kooperativat e konsumit të ndihmojnë anëtarët në përpunimin e konservimit e produkteve bujqësore e blegtorale, duke e marrë vetë përsipër këtë detyrë, ose duke u dhënë atyre ndihmën teknike, kundrejt një shpërblimi të caktuar në natyrë ose në të holla. Krahas kësaj, kooperativat e konsumit mund të ndihmojnë organizatën e gruas ose vetë gratë e fshatit në organizimin e kurseve mësimore për rrobaqepësi, për gatuarjen e gjellëve, për ekonomi shtëpiake, duke u dhënë këtyre kurseve kuadro teknike dhe mjetet e nevojshme mësimore; mund të organizojnë shfaqje filmi për anëtarët dhe familjet e tyre etj. Për plotësimin e këtyre detyrave kooperativat e konsumit mund të përdorin fondet që ato krijojnë për kulturën dhe ndoshta edhe një pjesë të fitimeve. Masa të tilla dhe të tjera si këto do t'i lidhin më shumë anëtarët me kooperativën dhe do të shërbejnë për forcimin e mëtejshëm organizativ të saj.

Është e padiskutueshme se ndërtimi i plotë i socializmit në vendin tonë duhet të shoqërohet me përmirësimin e mëtejshëm të veshmbathjes në fshat dhe me ndryshimin rrënjësor të mënyrës së fjetjes. Kjo, natyrisht, do të dojë disa vjet, por ne duhet qysh tani të marrim një varg masash me karakter të ngutshëm dhe perspektiv, me karakter edukativ dhe administrativ, të cilat të sigurojnë që me këto çështje të merren pa përjashtim organizatat e Partisë, organet shtetërore, në qendër e në bazë dhe të aktivizohet gjithë fshatarësia. Për këtë qëllim, krahas me masat e gjithanshme që duhet të marrin vetë rrethet, është e nevojshme të mbahen parasysh edhe këto detyra:

Së pari, të punohet që fshatarësia të rritë përdorimin e artikujve industrialë. Që ky problem të merret më mirë në dorë nga organet shtetërore dhe të mos i lihet spontaneitetit, brenda këtij viti organeve prodhuese dhe të tregëtisë t'u caktohen detyra për të hedhur në treg artikuj të rinj, të thjeshtë dhe me çmime të arësyeshme, që t'u përshtaten më mirë nevojave të fshatit, sikurse janë mobiljet dhe punimet e drurit, orenditë e shtëpisë, enët prej fajance e qelqi, konfeksionet etj. Në këto detyra të parashikohen gjithashtu masa për të kufizuar tregëtimin e artikujve që ndihmojnë në ruajtjen e veshjeve të papërshtatshme dhe për të zëvendësuar shajakun, që prodhon fshatarësia, me tipe shajaku industrial.

Së dyti, të konsiderohet si aksion i rëndësishëm i organizata-

ve të Partisë dhe organeve të pushtetit ngritja e fshatarit nga fjetja për tokë, kufizimi në maksimum i fjetjes së shumë kurorave në një dhomë dhe largimi i bagëtive nga vendi i banimit. Në dy-tre vjetët e ardhshëm të merren masa të tilla që këto probleme komitetet e Partisë dhe komitetet ekzekutive të këshillave popullore të rretheve t'i kenë zgjidhur përfundimisht dhe, brenda vitit 1966, t'i raportojnë Komitetit Qendror të Partisë për plotësimin e këtyre detyrave.

Së treti, organet e Partisë, të pushtetit dhe organizatat e masave të hartojnë një plan tre-katërvjeçar për bërjen e fshatrave model. Kjo lëvizje të përhapet duke u mbështetur në punën bindëse paraprake, në të ardhurat që ka çdo familje fshatare, në mundësitë që ajo ka për të bërë investime në pajisjen e shtëpisë me orendi etj.

Në shumë qendra prodhimi të vendit tonë, si miniera, kantierë ndërtimi, bonifikimi etj. punojnë me mijëra punëtorë, të cilët familjet e tyre i kanë në fshat. Kjo jo vetëm që ka ndihmuar në përmirësimin e kushteve të jetesës të këtyre punonjësve, por në të njëjtën kohë ka influencuar për ngritjen e mirëqenjes së familjeve të tyre që punojnë e jetojnë në fshat. Në të ardhshmen ky numër i punonjësve nga fshati do të rritet dhe, krahas kësaj, do të ngrihet edhe më lart niveli arësimor e kultural i tyre. Duhet, pra, që këta punëtorë të influencojnë akoma më shumë pranë familjeve të tyre për të përmirësuar mënyrën e jetesës dhe për të futur në jetën e fshatit gjithshka të mirë që ata mësojnë në qendrat e punës.

II. — TË FUTIM MË THELLË NË JETËN E FSHATIT SHËRBI MET KOMUNALE DHE TË ARTIZANATIT

Në tërësinë e mënyrës së jetesës në fshat një vend të veçantë zënë shërbimet komunale dhe të artizanatit. Është vështirë të arrihet një përparim i shpejtë dhe i gjithanshëm në jetën e fshatit, pa zhvilluar në të njëjtën kohë llojet e ndryshme të shërbimit, sidomos ndërtimet, elektrikun, gjelbërimin dhe zbukurimin, rrugët dhe kanalizimet, ndërlidhjen dhe artizanatin. Zgjerimi i këtyre shërbimeve jo vetëm që krijon kushtet e nevojshme për një jetë më të rehatshme dhe të kulturuar në fshat, por është edhe një faktor i rëndësishëm për kursimin e kohës dhe çlirimin e gruas nga shumë punë të lodhshme të shtëpisë.

Në të kaluarën prapambetja ekonomike e fshatit tonë rëndojë edhe më shumë nga mungesa, pothuajse absolute, e shërbimeve komunale dhe të artizanatit. Ndërtimi i fshatrave i ishte lënë spontaneitetit të plotë. Në të mbisundonte tipi i shtëpisë primitive,

përdhese dhe, shpeshherë, pa dritare dhe oxhak. Askush nuk mendonte për rrugët, kanalizimet, ujin e pijshëm, ndërsa për elektrikun as që bëhej fjalë fare. Në vend të gjelbërimit, në çdo hap të fshatit dhe rreth çdo shtëpie takoje gjerdhe e ferra.

Sot fytyra e fshatit tonë ka ndryshuar shumë. Brenda një periudhe relativisht të shkurtër, prej vitit 1951 deri në vitin 1961, përveç objekteve me karakter prodhimi dhe social-kulturale, në fshat janë ndërtuar 55 500 shtëpi të reja, janë elektrifikuar 300 fshatra, janë çelur me qindra kilometra rrugë të reja automobilistike, të cilat kanë lidhur edhe krahina e fshatra me të largëta të atdheut tonë. Janë bërë përpjekje për sistemimin e fshatrave, si dhe për gjelbërimin dhe zbukurimin e tyre. Të gjitha këto e kanë gjallëruar dhe e kanë bërë më të bukur e më të rehatshme jetën e fshatit.

Problemet e shërbimit komunal dhe të artizanatit në fshat janë të shumta, por ne do të kufizohemi vetëm me disa nga çështjet më kryesore që shtrihen zhvillimi socialist i fshatit në etapën e tashme.

1. — Të ndërtojmë më mirë dhe ta zbukurojmë më shumë fshatin tonë socialist

Në vështrimin e problemit të ndërtimeve të reja në fshat në plan të parë dalin këto çështje kryesore: hartimi i planimetrisë për çdo fshat, goftë edhe me dorë të lirë, projektimi i tipeve të shtëpive të banimit, të objekteve me karakter prodhimi e social-kulturale, sigurimi i materialeve të ndërtimit dhe format e zbatimit të ndërtimeve.

Deri më sot, në përgjithësi, ndërtimet në fshat janë bërë me hamendje, ku ka dashur vetë çdo familje, pa pasur një planimetri të caktuar, ose një plan orientues të vendosjes dhe të shtrirjes së fshatit në perspektivë. Edhe ato pak skica planimetrie që janë hartuar, nuk kanë qenë të plota dhe nuk i janë përmbajtur orientimit të dhënë nga organet qendrore të pushtetit. Kështu, në vend që në planimetritë të parashikoheshin 400—500 m² për ndërtimin e çdo shtëpie banimi, janë parashikuar deri 1 200 m². Është lejuar që banesat më të mira të ndërtohen në thellësi, ndërsa depot dhe stallat janë ndërtuar shpesh në qendër të fshatit. Është gjithashtu për të ardhur keq që, për mungesë kujdesi dhe kontrolli, ndërtimet e reja, fushat sportive, kumitë e tullave e të tjegullave kanë zënë, në mjaft raste, tokat më të mira bujqësore. Këto të meta kanë prishur bukurinë e fshatit, kanë penguar përqëndrimin e tij dhe kanë çuar në shpërdorimin e fondit të tokës bujqësore, e cila, edhe kështu, është mjaft e kufizuar.

Në shumë fshatra dhe krahina të ndryshme të rretheve, si të Korçës, Vlorës, Peshkopisë, Sarandës, shtëpitë e reja janë ndërtuar me dy kate, me dritare të mëdha, me dysheme e tavan. Kjo është një gjë e mirë, sepse kursen tokën, shtëpitë dalin më të mira, më të lira, më të pastra, më higjienike dhe e zbukurojnë fshatin. Por, krahas kësaj, mjaft shtëpi dhe vepra të tjera të reja në fshat nuk janë ndërtuar sipas kushteve dhe kërkesave të kohës. Takohen raste që ndërtesat e banimit janë bërë të një tipi, me dhoma dhe një hajat, pa tavan e dysheme, me dritare të vogla, me hauret e kafshëve brenda ose në afërsi të tyre. Këto lloj ndërtimesh janë të papërshtatshme, pasi në to mungojnë kushtet e nevojshme higjienike dhe të banimit, nuk ka ajrosje të plotë, ruhet lagështia dhe nuk ngrohen mirë. Ndërtime të tilla janë bërë veçanërisht në disa zona fushore, si në Lushnjë, Berat, Fier, Krujë dhe Elbasan.

Dihet se mundësitë e zgjerimit të ndërtimeve dhe vlera e tyre varen në një shkallë të madhe nga sasia, llojet e materialeve të ndërtimit dhe mënyra e sigurimit të tyre. Natyrisht, ky nuk është një problem i ri. Partia prej kohësh ka shtruar me forcë që si në qytet dhe veçanërisht në fshat, në ndërtimet të përdoren në radhë të parë, burimet lokale, materialet e lehta dhe më pak të kushtueshme. Por çfarë ndodh në të vërtetë? Në shumë raste ndërtimet në fshat bëhen akoma me materiale të rënda dhe të kushtueshme, nuk njihen dhe nuk përdoren sa duhet ndërtimet me kallam e qerpiç, përdoret mbulimi me lëndë druri, që është shumë e kushtueshme dhe deficitare. Kooperativat bujqësore, në përgjithësi, nuk e kanë organizuar në vend prodhimin e materialeve të ndërtimit dhe detyrohen t'i marrin ato larg fshatit, bile shpeshherë edhe jashtë rrethit, duke bërë shpenzime të mëdha.

Organizimi i kryerjes së ndërtimeve në fshat bëhet në forma të ndryshme. Në mjaft kooperativa bujqësore janë ngritur skuadrat e ndërtimit, të cilat i shërbejnë kooperativës dhe anëtarëve. Megjithatë, organizimi i ndërtimeve në fshat ka akoma të meta. Në të shumtën e rasteve skuadrat e ndërtimit në kooperativë përbëhen nga njerëz të moshës së kaluar dhe nuk punohet për përgatitjen e mjeshtërive të rinj. Disa herë ndërtimet kryhen me ustallarë të ardhur nga rrethet e tjera.

Ndërtimet e reja që janë bërë në fshat, e kanë përmirësuar pamjen e tij. Por është e qartë se pamja e përgjithshme e fshatit nuk përcaktohet vetëm nga ndërtimet, ajo varet shumë edhe nga faktorë të tjerë, sikurse janë rrugët, kanalizimet, gjelbërimet, parqet dhe lulishtet.

Tani pothuajse në çdo rreth gjen fshatra të pastër, të gjelbëruar e të zbukuruar, ku, si rezultat i kujdesit të treguar nga vetë banorët, shtëpitë janë të lyera me gëlqere, të rrethuara me bahçe, pemë e lule, ndërsa rrugët dhe oborret janë të shtruar me kall-

drëm. Pastërtia dhe bukuria e fshatrave të Rrëzës dhe Devollit të Korçës, të bregut të detit, Vlorës dhe Sarandës, të Dropullit në Gjirokastrë, të Shishtavecit në Kukës e shumë të tjerëve si këta, duhet të jenë shembull dhe nxitje për gjithë fshatrat e vendit.

Por duke prekur këtë problem, dua të theksoj se me gjithë punën e bërë, organet e pushtetit lokal, dhe sidomos këshillat popullore të fshatrave, akoma merren shumë pak si me ndërtimet ashtu edhe me gjelbërimet, zbukurimet, kanalizimet dhe rrugët e fshatit. Këtu e ka burimin e meta që në disa fshatra të rretheve të Shkodrës, Elbasanit dhe Beratit, meqenëse çështjet e mirëmbajtjes së fshatit nuk janë vlerësuar sa duhet, mungojnë gjelbërimet, zbukurimet dhe kanalizimet, rrugët në përgjithësi paraqiten keq, të pasistemuara dhe të pashtuara me kalldrëm ose zhavor.

Në këtë etapë të zhvillimit të vendit më shumë se kurrë shtrohet detyra që fshatin tonë socialist ta ndërtojme më mirë dhe ta zbukurojmë më tepër. Për të vënë në jetë këtë detyrë, të mbahen parasysh edhe këto çështje kryesore:

Së pari, për zhvillimin e ardhshëm të fshatit si problem qendror komunal mbetet çështja e planimetrisë dhe, atje ku nuk është e mundur një gjë e tillë, të kihet një farë plani me dorë të lirë. Ky problem nuk është zgjidhur akoma. Prandaj, është e nevojshme që, brenda vitit 1964, të lëshohen udhëzimet përkatëse dhe të caktohen afatet, radha e kriteret për zgjidhjen përfundimtare të këtij problemi. Në hartimin e planimeve të mbahen parasysh këto kriteret kryesore: perspektiva e zhvillimit të fshatrave, lidhur kjo edhe me bashkimin e kooperativave, kursimi në maksimum i fondit të tokës bujqësore, caktimi i një sheshi në qendrën e fshatit, ku të përqëndrohen ndërtesat e institucioneve social-kulturale, rrjeti i tregëtisë, caktimi i vendit për këndin sportiv, sigurimi i ujit të pijshëm etj. Kjo punë duhet të fillojë, në radhë të parë, nga kooperativat bujqësore të zmadhuara dhe pastaj të shtrihet në kooperativat e fshatrat e tjera.

Së dyti, që në fshat të përhapen tipe ndërtimi të bukura, të rehatshme dhe të lira, u rekomandohet organeve shtetërore që, brenda vitit 1964, të aprovojnë disa projekttype shtëpish komode e të bukura dhe objektesh të tjera me karakter prodhimi dhe social-kulturale, të ndara veças për zona malore, kodrinore dhe fushore duke u mbështetur në kushtet klimaterike dhe burimet e materialeve të ndërtimit të çdo zone.

Së treti, për ta vënë në rrugë më të drejtë dhe të organizuar paraqitjen e jashtme të fshatit, këshillat popullore, të drejtuara nga komitetet ekzekutive dhe të udhëhequra nga komitetet e Partisë, duke filluar nga viti 1964, të hartojnë çdo vit një program konkret për zbukurimin, rregullimin dhe shtruarjen e rrugëve të brendshme me kalldrëm, për ndërtimin dhe mirë-

mbajtjen e kanalizimeve të brendshme në fshatin e vet. Zbatimi i këtij programi të mbështetet kryekëput në aksionet lokale, duke përdorur të gjitha rezervat dhe burimet e brendshme që ka fshati.

2. — Të përhapim dritën elektrike, të sigurojmë ujin e pijshëm dhe të zgjerojmë shërbimet e tjera komunale në fshat

Partia jonë i ka kushtuar një vëmendje të posaçme përhapjes dhe përdorimit të energjisë elektrike në fshat. Elektrifikimi dhe shkalla e përdorimit të energjisë elektrike janë një nga treguesit më të rëndësishëm që karakterizojnë ngritjen e nivelit të jetesës dhe të kulturës në fshat. Për këtë qëllim Komiteti Qendror i PPSH ka aprovuar një studim perspektiv për elektrifikimin e fshatrave deri në vitin 1985¹.

Në bazë të këtij orientimi të dhënë nga Komiteti Qendror i Partisë, janë arritur disa rezultate. Sot në fshat furnizohen me energji elektrike mbi 23 000 shtëpi. Por meqë përmendëm rezultatet, le të vëmë në dukje se disa rrethe paraqiten prapa me përhapjen e energjisë elektrike në fshat dhe nuk i kanë shfrytëzuar të gjitha mundësitë që kanë pasur në këtë drejtim. Ndërsa në rrethin e Korçës në fshat janë elektrifikuar mbi 7 000 shtëpi, në rrethin e Shkodrës — 755 shtëpi dhe në atë të Elbasanit — vetëm 500 shtëpi.

Në elektrifikimin e fshatrave orientimi ynë i përgjithshëm duhet të jetë që ai të bëhet mbi bazën e ngritjes së hidrocentraleve të vogla, për fshatra të veçantë ose grupe fshatrash, pasi burime hidrike gjenden në shumicën e fshatrave tona dhe aty ku nuk ka, ato të mund të krijohen duke çelur kanale, ose duke krijuar rezervuarë të vegjël uji. Në të njëjtën kohë theksojmë se fuqia mekanike e këtyre burimeve nuk duhet të përdoret vetëm për të prodhuar energji elektrike, por në kompleks: për vaditje, për ngritje sharrash, për mullinj të blojës dhe për nevoja të tjera.

Me qëllim që elektrifikimi në fshat të realizohet sipas afateve të caktuara nga Byroja Politike e Komitetit Qendror, organet shtetërore të planifikojnë çdo vit importimin e pajisjeve përkatëse, ndërsa me forcat tona të brendshme të zgjerojmë prodhimin e

1 Plenumi i Komitetit Qendror i PPSH, i nisur nga orientimi që dha Kongresi V i PPSH për zhvillimin e gjithanshëm e me ritme të shpejta të fshatit, pas përfundimit të plotë të kolektivizimit të zonave malore në vitin 1966, në dhjetor 1967 mori vendimin për të përfunduar elektrifikimin e të gjitha fshatrave të vendit deri në datën 8 nëntor 1971, — në 30 vjetorin e themelimit të Partisë, d.m.th. 14 vjet para afatit të parashikuar. Në të vërtetë ky vendim i dhjetorit 1967 u plotësua një vit përpara, në tetor 1970.

turbinave të vogla dhe të përhapim më shumë përdorimin e tubave gres, prej druri, prej beton armeje, duke kursyer sa më shumë tubat e çelikut dhe materialet e tjera të importit. Krahas me këtë, komitetet ekzekutive dhe këshillat popullore të rretheve të marrin masa për të siguruar një administrim dhe përdorim më të mirë të centraleve elektrike ekzistuese në fshat.

Një ndër elementet më të rëndësishme për jetën e njeriut është uji. Sot furnizimi i popullsisë fshatare me ujë të pijshëm bëhet nëpërmjet afro 11 000 burimeve e çesmave, 4 600 puseve arteziane, përveç mijëra puseve me kovë. Kujdesi për mirëmbajtjen dhe zgjerimin e këtyre burimeve në përgjithësi ka shkuar duke u rritur.

Megjithatë, furnizimi me ujë të pijshëm i fshatrave mbetet një ndër problemet kryesore komunale, për të cilin duhet të tregojnë një kujdes të madh organizatat e Partisë dhe organet e pushtetit lokal. Është fakt se burimet ekzistuese të ujit të pijshëm nuk i plotësojnë nevojat e popullsisë fshatare dhe, nga ana tjetër mirëmbajtja e tyre është shumë primitive. Shpesh pusët, çesmat, burimet nuk janë të izoluar me mure guri ose çimentoje, për të ruajtur ujin e pijshëm nga ambienti përreth, duke u bërë kështu shkak infeksioni dhe sëmundjesh.

Ndërsa në fshatrat malore furnizimi me ujë të pijshëm është më i rregulluar, në fshatrat fushore, gjendja nuk paraqitet mirë. Një pjesë e madhe e fshatrave fushore furnizohet me ujë nga lumenjtë, i cili, duke u përdorur jashtë një kontrolli të rreptë, paraqet edhe rrezikshmëri për shëndetin e njerëzve. Ndërsa në qytet ka një regjim shumë të fortë për ruajtjen e ujësjellësve, dezinfektimin e tyre dhe analizën bakteriologjike të ujit, në fshat për këto çështje nuk bëhet asgjë dhe, për më tepër, është bërë zakon të mos përgjigjet asnjëri.

Në një kohë kur për elektrifikimin e fshatit, sikurse e theksuam më sipër, ekziston një studim perspektiv, për furnizimin e fshatrave me ujë të pijshëm nuk ka pothuaj asgjë të përcaktuar. Duke marrë parasysh rëndësinë e madhe që ka furnizimi i fshatit me ujë të pijshëm me qëllim që këtij problemi t'i dilet përpara, është e nevojshme të ndërmerret një studim i gjithanshëm dhe, në bazë të tij, të hartohet një program perspektiv duke u dhënë precedencë fshatrave fushore. Ky program të hartohet dhe të aprovohet brenda vitit 1965.

Që të mënjanohet rreziku i infeksionit dhe i përhapjes së sëmundjeve në fshat nga uji i pijshëm, si masë imediate të organizohet herë pas here kontrolli bakteriologjik i tij, duke marrë edhe masa përkatëse dezinfektimi etj. Kjo punë të organizohet dhe të drejtohet nga qendrat bakteriologjike të rretheve.

Në lidhje me shërbimet komunale të tërheq vëmendjen edhe problemi i sigurimit të lëndës djegëse, i mullinjve të blojës dhe

i shërbimit të varrimit në fshat. Problemi i lëndës djegëse për fshatin është shqyrtuar disa herë nga Komiteti Qendror i Partisë dhe janë caktuar detyrat përkatëse. Tani mbetet të vazhdojë puna për vënjen e tyre në jetë dhe të udhëhiqemi gjithnjë nga porosia e Partisë që të ruajmë dhe të kursejmë lëndën e drurit, e cila është një pasuri e madhe, por deficitare për ekonominë popullore. Për këtë qëllim dhe për t'i ardhur në ndihmë fshatarësisë, duhet që artizanati dhe industria lokale të prodhojnë më shumë soba të thjeshta, ekonomike dhe mundësisht prej qeramike. Përsa u përket mullinjve të blojës, është mirë që të planifikohet prodhimi i mullinjve me çekiç, të cilët do të shërbejnë për bluarjen e drithërave, si dhe për përgatitjen e ushqimit të bagëtive.

Ndryshe qëndron puna me varrezat dhe shërbimin e varrimit në fshat. Duhet pranuar se kjo çështje është lënë pothuajse pas dore dhe për të nuk interesohet njeri. Në mjaft fshatra varrezat janë të shpërndara në shumë pika, afër banesave, të pathurura, bile në disa raste këto janë vendosur në kopshtet personale. Për këtë arsye është me vend të udhëzohen organet përkatëse të pushtetit lokal që, brenda vitit 1963, të caktojnë vendin e varrezave të reja dhe të mos lejohet asnjë varrim jashtë këtij vendi. Këshillat popullore të fshatrave të mendojnë njëkohësisht edhe për shërbimin e varrimit dhe të mos e lënë këtë në dorë të xhamisë dhe të kishës.

3. — Të zgjerojmë rrjetin e komunikacionit dhe të ndërlihdjes midis fshatit e qytetit dhe ndërmjet fshatrave

Përmirësimi dhe zgjerimi i rrjetit të komunikacionit e të ndërlihdjes së fshatit me qytetin dhe ndërmjet fshatrave është një faktor i rëndësishëm për zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë bujqësore, për afrimin e fshatit me qytetin dhe ndihmon në krijimin e kushteve më të mira materiale e jetësore në fshat.

Procesi i ndërtimit të socializmit ka përfshirë edhe zgjerimin e rrjetit të komunikacionit në fshat. Nga njëri vit në tjetrin është rritur numri i lokaliteteve dhe i fshatrave që janë lidhur me rrugë automobilistike të ndërtuara nga shteti dhe me aksione të vetë fshatarëve. Dikur rrethi i Skraparit, së bashku me fshatrat, ishte i izoluar nga qendrat e tjera të vendit. Sot, ky rreth dhe fshatrat e tij janë lidhur me rrugë automobilistike. Ky ndryshim vihet re edhe në rrethet e Tropojës, Gjirokastrës, Lushnjës e Përmetit, të cilat tani përshkohen nga një rrjet i gjerë rrugor. Mjaft lokalitete, si ai i Progonatit dhe i Kuçit dhe dhjetëra të tjera si këto, janë lidhur prej kohe me qytetin me linja të rregullta automjetesh. Në këtë mënyrë janë krijuar kushte më të mira për lëvizjen e mallrave dhe të fshatarëve.

Ndonëse në këtë drejtim është bërë një punë e madhe, ne jemi akoma larg nga zgjidhja përfundimtare e këtij problemi. Ka fshatra që nuk janë të lidhura me rrugë automobilistike direkte ose ndërmjetëse. Shpeshherë, sidomos në zonat fushore, rrugët janë krijuar spontaneisht, me dredha të shumta dhe sipas kufizimeve që përcaktonte prona private. Një pjesë e rrugëve janë në gjendje të keqe dhe të papërdorshme, meqenëse për mirëmbajtjen e tyre nuk tregohet kujdes.

Prandaj, ky problem duhet të merret në dorë nga organet e Partisë e të pushtetit, të bëhen studime dhe programe të veçanta, me qëllim që, brenda 10—15 vjetëve të ardhshëm, kjo detyrë të jetë zgjidhur në përgjithësi. Nuk ka dyshim se ky problem i madh e i vështirë nuk mund të plotësohet me sukses pa mobilizimin e gjerë të fshatarësisë. Ndoshta mund të ishte e arësyeshme që ndërtimi i rrugëve të reja t'u besohej organizatave të rinisë, të cilat, edhe në të kaluarën, kanë dhënë kontributin e tyre të vlefshëm për këtë çështje. Në studimin për çeljen e rrugëve të reja dhe ndërtimin e tyre mund dhe duhet të ndihmojë edhe ushtria me topografë, inxhinierë etj.

Me rrjetin rrugor lidhen ngushtë edhe llojet e mjeteve të transportit. Ndërsa më parë në fshat përdoreshin për transport vetëm qerret dhe kafshët, sot kooperativat bujqësore zotërojnë disa qindra automjete, përveç mijëra karrove e qerreve. Rritja e mjeteve të transportit, pa dyshim, ka lehtësuar kushtet e punës dhe të jetesës në fshat. Por shumë kooperativa bujqësore po i përdorin automjetet për transportime të shkurtëra dhe të lehta, që mund të kryhen fare mirë me mjetet e transportit primitiv. Kësaj praktike të dëmshme duhet t'i jepet fund, pasi në këtë mënyrë nxirren jashtë përdorimit shpejt dhe para kohe automjetet. Në kushtet tona shtrohet detyra për forcimin dhe zgjerimin e transportit primitiv. Me qëllim që nevojat e fshatit për mjete transporti të plotësohen sa më mirë, të merren masat e duhura që, brenda një kohe sa më të shkurtër, për çdo pendë që të sigurohen qerre ose karro. Përveç kësaj, duhet të merren gjithashtu masa që, krahas me rritjen e numrit të kafshëve tërheqëse në fshat, këto të përdoren në mënyrë më efektive.

Një çështje tjetër me rëndësi që ka të bëjë me zgjidhjen e shpejtë të problemeve të jetesës në fshat, është edhe zgjerimi i mëtejshëm i rrjetit post-telegrafik. Në këtë drejtim përfundimet e arritura janë shumë të mëdha në krahasim me të kaluarën. Sot të gjitha lokalitetet kanë zyra për shërbimet postare, të telegrafit dhe të telefonit dhe shumë kooperativa bujqësore janë të lidhura me telefon. Megjithatë, perspektiva e fshatit kërkon patjetër që edhe ky shërbim të zhvillohet më tej. Veç kësaj, ne duhet të kujdesemi që të krijohet edhe një lidhje e brendshme telefonike për fshatrat që përbëjnë kooperativat e zmadhuara. Nga

ana tjetër, do të ishte e arësyeshme që, për zgjerimin e shërbimit post-telegrafik të ngarkohen organet përkatëse për të hartuar një program perspektiv të hollësishëm, ku të parashikohet lidhja e shumicës së fshatrave me rrjetin telefonik, deri në vitin 1980-1985¹. Më në fund, për të përmirësuar shërbimin post-telegrafik në fshat dhe për të rritur përgjegjësinë e këtij institucioni në shpërndarjen e korrespondencës, korrierët e lokaliteteve t'u kthehen zyrave postare, sikurse ishte më parë.

4. — T'i shtrijmë shërbimet e artizanatit deri në fshatrat më të largëta

Fshati ka nevojë të përditshme për shërbimet e ndryshme të artizanatit, që lidhen me nevojat e prodhimit, social-kulturale, si dhe të vetë familjeve fshatare. Për këto arsye shtrirja e shërbimeve të artizanatit duhet të konsiderohet si një kusht i domosdoshëm për përmirësimin e mënyrës së jetesës në fshat.

Vjetët e fundit, sidomos pas kolektivizimit të bujqësisë, duke u mbështetur në vendimet e Komitetit Qendror të Partisë, është bërë një punë e kënaqshme për zgjerimin dhe ngritjen e aktiviteteve të ndryshme të prodhimit, të riparimeve dhe të shërbimeve të artizanatit në fshat. Krahas artizanatit të kooperuar, privat dhe shtëpiak, në fshat ka lindur dhe po zgjerohet artizanati i kooperativave bujqësore.

Në periudhën e tanishme bëhet e domosdoshme që artizanati i kooperativave bujqësore të forcohet dhe të zgjerohet edhe më shumë. Deri më sot në kooperativat janë zhvilluar, pak a shumë, sektorët e artizanatit, që lidhen me plotësimin e nevojave të prodhimit, sikurse janë kovaçanat, zdruktharitë etj. Kjo, natyrisht është një gjë e mirë dhe duhet të përkrahet. Por kooperativat bujqësore duhet të mendojnë njëkohësisht edhe për shërbimet e tjera të artizanatit, ku ne jemi më prapa. Si rregull, kudo fshatarët, për të qepur edhe gjërat më të thjeshta, për t'u qethur, për të meremetuar këpucët, janë të detyruar të vijnë në qytet. Prandaj, ka ardhur koha që disa kooperativa bujqësore të fillojnë të ngrenë, sipas kushteve, sektorë të ndryshëm të shërbimeve, si për riparim këpucësh e opingash, rrobaqepësi etj.

Shtrirja e mëtejshme e shërbimeve të artizanatit pranë kooperativave bujqësore nuk mund të arrihet pa siguruar specialistët e nevojshëm. Meqenëse përgatitja e zejtarëve të fshatit me anën e dërgimit të zejtarëve nga qyteti nuk po jep rezultate, do të ishte

1 Në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 55 datë 23 prill 1968, lidhja e fshatrave të vendit tonë me rrjetin telefonik do të përfundojë më 29 Nëntor 1974, në 30-vjetorin e çlirimit të atdheut.

e arësyeshme që kooperativat bujqësore, në bazë të planeve që duhet të hartojnë komitetet ekzekutive, të dërgojnë me shpenzimet e tyre në kooperativat e artizanatit ose në ndërmarrjet shtetërore, nxënës për të mësuar profesione të ndryshme.

Pavarësisht nga këto masa, artizanati i kooperuar duhet të vazhdojë të ndihmojë fshatin. Ne duhet të arrijmë që, brenda 5—6 vjetësh, në të gjitha qendrat e lokaliteteve të kemi ngritur ose zgjeruar repartet e riparimeve dhe shërbimeve, me të gjitha specialitetet, të cilat të plotësojnë nevojat e popullsisë fshatare. Veç kësaj, duhet që, herë pas here, artizanati i kooperuar të organizojë dërgimin në fshatra të brigadave shëtitëse me zejtarë të ndryshëm.

Konsulta popullore nxori në shesh se për problemet e ndërimit dhe të shërbimeve komunale në fshat janë bërë shumë vërejtje që pak a shumë janë të një natyre. Kjo tregon se gjendja për këto çështje është e njëllotë kudo. Me sa duket, këtu nuk kemi të bëjmë vetëm me të meta të shokëve në fshat, megjithëse këto, natyrisht ekzistojnë në një farë mase. Kjo gjendje shpjegohet, ndoshta, në radhë të parë, edhe me faktin se ka munguar drejtimi i ndërgjegjshëm dhe i organizuar i këtyre çështjeve nga lart deri në fshat dhe se për to nuk është treguar vëmendje e duhur. Me një fjalë, në çështjet komunale dhe të ndërimit në fshat pothuajse nuk është ndërë roli drejtues dhe dora e organeve të pushtetit.

Tani që ne përfundam kolektivizimin e bujqësisë dhe ndodhemi përpara detyrash të reja të zhvillimit socialist të fshatit, duhet që problemet e ndërimit dhe të shërbimeve komunale të drejtohen nga organet e pushtetit, nga qendra deri në bazë. Prej kaq vjetësh duket se është grumbulluar si eksperienca ashtu edhe njohuritë për çështjet komunale e të ndërimit dhe ato mund të zbatohen edhe në fshat nga organet e pushtetit.

Për këtë qëllim të ngarkohen organet përkatëse të pushtetit që, brenda vitit 1963, të studjojnë variantin më të mirë për riorganizimin e sektorit komunal në qendër dhe në bazë, i cili të sigurojë drejtimin e problemeve komunale dhe të ndërimit në fshat. Në këtë rast të përcaktohen kompetencat e sektorit komunal për fshatin, kuadrot që duhen, mënyra e planifikimit dhe shkalla e pjesëmarrjes së shtetit me fondet e tij për zgjidhjen e këtyre detyrave në fshat. Në këtë studim të shikohet gjithashtu edhe mundësia që, në të ardhshmen, për të gjitha çështjet e shërbimeve komunale, fshati të hartojë planin dhe buxhetin e vet, ku të parashikohen nevojat, shpenzimet dhe mundësitë e burimet për t'i përbulluar këto nevoja.

III. — TË NGREMË ORGANIZIMIN E SHËRBIMIT SHËNDETËSOR NË NIVELIN E KËRKESAVE QË SHTRON PËRMIRËSIMI I MËTEJSHËM I MIRËQENJES NË FSHAT

Mirëqenja e popullit nuk mund të kuptohet pa mbrojtjen e shëndetit të tij. Gjendja shëndetësore e një populli varet jo vetëm nga shkalla e zhvillimit ekonomik, por edhe nga shumë faktorë të tjerë, sikurse janë kujdesi i shtetit për këtë çështje, niveli i kulturës dhe tërësia e mënyrës së jetesës. Natyrisht, në këtë drejtim një rol i veçantë i takon edhe organizimit të shërbimit shëndetësor në fshat.

Prapambetja shekullore që ne trashëguam nga e kaluara, nuk mund të mos shoqërohej nga pasoja të rënda edhe në gjendjen shëndetësore të fshatarësisë. Shumë sëmundje si malarja, tifoja, sifilizi dhe rakitizmi, ishin bërë kronike, e brenin fshatarësinë, e dërmonin atë fizikisht dhe e bënë të plogët e të paaftë për punë. Mbrojtja e shëndetit të saj ishte lënë në mëshirë të fatit.

Para kësaj gjendjeje Partisë dhe pushtetit popullor ju desh të ndërmerrnin masa të ngutshme dhe të gjithanshme. Për këtë arsye, fill pas çlirimit, u organizua shërbimi shëndetësor mbi baza krejt të reja dhe ju dha atij karakteri i theksuar profilaktik. Për herë të parë u vu dorë nga shteti në mënyrë të organizuar për zhdjekjen e shumë sëmundjeve ngjithëse dhe epidemike.

Sot ndihma që i jepet fshatarësisë as që mund të krahasohet me të kaluarën. Nga 14 ambulanca që kishte fshati më 1938, tani kemi 746 të tilla, pa përfshirë këtu 32 shtëpi lindjeje, 28 spitale dhe 9 ambulanca dhëmbësh. Me zgjerimin e rrjetit të institucioneve shëndetësore në fshat, është rritur vazhdimisht edhe numri i kuadrit mjekësor që punon në to. Sot në institucionet shëndetësore të fshatit punojnë 47 mjekë, 144 ndihmësmjekë, 86 mami dhe 580 infermiere. Kurse me masat që janë marrë për shtimin e mëtejshëm të numrit të kuadrit mjekësor, në vitin 1966 në fshat do të punojnë 230 mjekë, 324 ndihmësmjekë, 700 mami dhe 825 infermiere. Përveç këtyre, fshatarësisë i jepet një ndihmë e madhe edhe nga mjekët e punonjësit e tjerë të shëndetësisë që punojnë në qendrat e rretheve.

Fshatarësia jonë përfiton falas ndihmën mjekësore ambulatorë, kurimin e sëmundjeve ngjithëse, të tuberkulozit, të tumorëve, si dhe ndihmën mjekësore për lindjet. Gjithashtu, kurohen falas në institucionet shëndetësore fëmijët deri në katër vjeç, kurse ata deri në një vjeç marrin falas edhe barërat për kurat në shtëpi.

Efekti i masave të marrura nga Partia për mbrojtjen e shëndetit të fshatarësisë, duket edhe në të dhënat demografike, të cilat janë pasqyrë e jetës së çdo populli. Në vitin 1961 për fshatin kishim këta tregues demografikë kryesorë të krahasuar me vitin 1938, për të gjithë vendin:

Emërtimi	1938 gjithsejt	1961	
		gjithsejt	për fshatin
Lindje për 1000 banorë	34,7	41,2	44,5
Vdekje për 1000 banorë	17,8	9,3	10,4
Vdekje të fëmijëve nën një vjeç për 1000 të lindur gjallë	100,8	79,4	85,5
Shtesa natyrale për 1000 banorë	16,9	31,9	34,1

Të dhënat e mësipërme tregojnë se fshati ka ecur shumë përpara në krahasim me mesataren e gjithë vendit në vitin 1938. Mbi këtë bazë është siguruar një rritje natyrale e popullsisë shumë më e shpejtë, e cila, nga 16,9 për mijë që ishte në të gjithë vendin në vitin 1938, vetëm në fshat në vitin 1961 arriti në 34,1 për mijë ose dy herë më shumë, ndërsa jeta mesatare e njeriut në vendin tonë sot është mbi 62 vjeç.

Ndërsa në tërësi në mbrojtjen e shëndetit në fshat ne kemi arritur suksese të mëdha, nuk mund të mos na tërheqë këtu vëmendjen fakti se përsa u përket vdekjeve, dhe sidomos të fëmijëve nën një vjeç dhe 1—4 vjeç, midis qytetit dhe fshatit ka akoma shpërpjesëtime të dukshme. Kështu, për shembull, në vitin 1962 vdekjet e fëmijëve nën një vjeç për 1 000 të lindur gjallë kanë qenë për qytetin 73, kurse për fshatin 99. Vdekjet në fëmijët 1—4 vjeç kanë qenë për qytetin 10, kurse për fshatin 14, kundrejt vdekjeve të përgjithshme.

Treguesit e lindjeve dhe të vdekjeve ndryshojnë edhe nga njëri rreth në tjetrin dhe ky ndryshim nuk kondicionohet kryesisht nga faktorët ekonomikë. Rrethi i Shkodrës, për shembull, me gjendjen ekonomike dhe bazën materiale shëndetësore që ka, nuk duhet të ketë një nga treguesit më të lartë në Republikë për vdekjet në përgjithësi dhe sidomos për vdekjen e fëmijëve. Të bie në sy gjithashtu se në këtë rreth takohen akoma raste të sëmundjeve të tilla ngjitëse si tuberkulozi, tifua e morrit etj. Pothuajse e njëjta gjëndje paraqitet edhe në rrethet e Tropojës, Kukësit, Pukës e Librazhdit.

Në disa krahina, sidomos të rretheve malore, siç janë Mokra në rrethin e Pogradecit, Gorë-Opari në rrethin e Korçës, malësitë e rrethit të Burrelit etj., vërtetohen akoma shfaqje të sëmundjes së strumës, e cila prek kryesisht të rriturit, por që nuk përjash-tohet edhe në fëmijët. Për luftimin e saj është e nevojshme që, nga studimet në vazhdim, të nxirren përfundime paraprake dhe të fillohet sa më parë nga marrja e masave përkatëse.

Ministria e Shëndetësisë nuk ka bërë akoma një studim të plotë mbi sëmundjet më të përhapura në fshat dhe mbi shkaqet e vdekjeve të popullsisë fshatare. Megjithatë, në bazë të të dhënave jo të plota që disponohen, del se sëmundjet e aparatit të frymëmarrjes, e aparatit të tretjes dhe sëmundjet ngjitëse zënë vendin kryesor dhe përbëjnë më shumë se gjysmën e numrit të përgjithshëm të të sëmurëve në fshat. Nga këto sëmundje shkaktohet edhe pjesa më e madhe e vdekjeve.

Të shpeshta janë në fshatin tonë sëmundjet e bronkopneumonisë, dizanteria, tifua e zorrëve dhe tuberkulozi, të cilat në disa raste sjellin vdekje, sidomos në fëmijët. Nga të dhënat e vitit 1961 del se për 100 fshatarë të sëmurë të vizituar, 22 për qind kanë vuajtur nga sëmundje të aparatit të frymëmarrjes, 17 për qind nga sëmundje të aparatit të tretjes, 13 për qind nga sëmundje ngjitëse dhe pjesa që mbetet nga sëmundje të tjera. Edhe sëmundjet që përhapen nga kafshët dhe që rrjedhin kryesisht nga mungesa e kulturës shëndetësore të fshatarësisë, si bruce-loza, ekinokoku, plasja e tërbimi, paraqesin rrezikshmëri, për faktin se ato shfaqen çdo vit, aty-këtu, në zona të caktuara, sidomos në fshatrat e Gjirokastrës, Sarandës, Përmetit, Korçës dhe Ersekës.

Në fëmijët e vegjël të fshatit akoma haset shpesh rakitizmi, i cili e dobëson shumë organizmin e tyre dhe bën që ata të preken më lehtë nga çdo sëmundje tjetër. Ai është bile një nga faktorët e rëndësishëm të tërthortë të sëmundjeve dhe vdekjeve të fëmijëve në fshat. Shkaqet kryesore të përhapjes së kësaj sëmundjeje janë se fëmijët e vegjël nuk nxirren sa duhet në ajër të pastër dhe në rrezet e diellit, se ata nuk marrin disa nga lëndët më të nevojshme ushqyese, si vezën, lëngun e mishit, zarzavatet etj., të cilat në fshat nuk mungojnë. Për luftimin e kësaj sëmundjeje, përveç masave dhe kujdesit që duhet të tregojë çdo prind, për të menjanuar shkaqet që përmendëm më sipër, një rëndësi të veçantë ka edhe zbatimi i gjerë nga organet e shëndetësisë i vendimit të qeverisë lidhur me dhënjen falas të vitaminës «D» fëmijëve të fshatit.

Shqyrtimi i problemit të ruajtjes së shëndetit në fshat nxjerr në shesh se sëmundjet dhe vdekjet nuk e kanë burimin kryesisht në shkaqet ekonomike. Te ne ka ikur, për të mos u kthyer më kurrë, ajo kohë kur fshatari vdiste për një copë bukë, ose dergjej në shtëpi deri në vdekje, sepse nuk kishte para për t'u vizituar te mjeku, për të blerë barërat, apo për t'u shtruar në spital. Sot në vendin tonë janë krijuar mundësi të shumta për t'i ardhur në ndihmë çdo të sëmuri, qoftë ky edhe në skajet më të largëta të atdheut.

Atëhere ku duhen kërkuar shkaqet e sëmundjeve dhe të vdekjeve në fshat?

Duke analizuar sëmundjet dhe vdekjet në fshat, të bie në sy se ato e kanë burimin në dy arësye kryesore: së pari, në nivelin e ulët të kulturës shëndetësore dhe të higjienës dhe së dyti, në të metat e organizimit të shërbimit shëndetësor në fshat. Fakti që 65,5 për qind e fëmijëve të vdekur në moshën e gjirit, vdesin nga bronkopneumonitë dhe barku i verës, tregon, nga njëra anë, se prindërit nuk e njohin kulturën shëndetësore dhe nuk kujdesen për mirërritjen e fëmijëve gjatë muajve të parë të jetës së tyre, dhe, nga ana tjetër, punën e pamjaftueshme që bëjnë organet e shëndetësisë për luftimin e këtyre sëmundjeve.

Natyrisht, në këtë drejtim ka influencuar edhe fakti se numri i sotëm i kuadrove shëndetësore në fshat është akoma i pamjaftueshëm. Në përgjithësi sot institucioni shëndetësor kryesor në fshat është ambulanca, që drejtohet nga infermieri. Të paktë janë ndihmësmjekët që punojnë në fshat dhe të rrallë janë mjekët. Ekziston një ndryshim midis ndihmës mjekësore që i jepet popullsisë së qytetit dhe asaj të fshatit. Në vitin 1961, për çdo 100 banorë të qytetit janë bërë 214 vizita mjekësore, ndërsa për 100 banorë të fshatit janë bërë vetëm 45 vizita. Në një kohë kur në qytet pothuajse të gjitha lindjet bëhen në maternitete, në fshat bëhen vetëm 24 për qind e tyre, ndërsa pjesa tjetër e grave fshatare lindin në kushte higjieniko-sanitare jo të mira. Edhe shpërndarja e institucioneve shëndetësore nuk është proporcionale për të gjitha rrethet.

Gjendja e mësipërme shtrun detyrën që të forcohet më tej dhe të ngrihet në një shkallë më të lartë mbrojtja e shëndetit të fshatarësisë. Organet e shëndetësisë duhet të marrin masa të tilla që të sigurojnë një përmirësim rrënjësor të punës së tyre në fshat. Ato, në bashkëpunim me organet e Partisë, të pushtetit lokal, me organizatat e masave dhe të Kryqit të Kuq, duhet të intensifikojnë propagandën për ngritjen e kulturës shëndetësore në fshat, të forcojnë karakterin profilaktik të shërbimit shëndetësor, si dhe ta zgjerojnë atë më tej.

Në të ardhshmen ne duhet ta ngushtojmë dalëngadalë, por në mënyrë të vendosur, ndryshimin që ekziston në shkallën e shërbimit shëndetësor midis qytetit dhe fshatit. Prandaj, në punën për ruajtjen e shëndetit të fshatarësisë duhet të forcojmë institucionet shëndetësore në fshat, ndërsa në qytet të kurohen vetëm rastet kur kërkohen ndërhyrje të rënda mjekësore dhe me karakter special. Në këtë mënyrë shërbimi mjekësor do të ndodhet më afër të sëmurit edhe në fshat.

Për t'ja arritur këtij qëllimi është e nevojshme që organizimi i shërbimit shëndetësor për fshatin të marrë formën që i përshtatet më shumë kohës, kërkesave dhe mundësive tona. Në këtë kuptim, duke u mbështetur në rrjetin e sotëm shëndetësor, të punohet që për çdo grup fshattrash, sidomos në zonat e thella,

të ngrihen qendra mjekësore, të cilat të jenë bërthama të shërbimit shëndetësor dhe dalëngadalë të plotësohen me mjetet e duhura, për të kryer një punë më të kualifikuar. Për këtë çështje është mirë që organet shtetërore, brenda vitit 1964, të bëjnë një studim të veçantë, ku të parashikohet ngritja graduale e këtyre qendrave në përputhje me mundësitë që lejon plani i shtetit, ose kontributin që mund të japin vetë kooperativat bujqësore.

Detyrat kryesore të këtyre qendrave duhet të jenë:

Së pari, të përhapin në masën fshatare kulturën shëndetësore, t'i mësojnë asaj mënyrën më të përshtatshme të ushqimit, të veshjes, të fjetjes, mënyrën e mbrojtjes nga sëmundjet dhe të rrënjësinë të ajo bindjen për të kërkuar në kohë ndihmën e mjekut. Këtë punë të madhe duhet ta kryejnë së bashku me aktivistët më të mirë të fshatit, duke organizuar kurse, konferenca, demonstrime të ndryshme etj.

Së dyti, nëpërmjet diagnostikimit, të studjojnë shkaqet e sëmundjeve më të përhapura në fshat dhe pastaj të organizojnë luftën efektive kundër tyre.

Për t'u bërë ballë detyrave të mëdha që shtrohen lidhur me shërbimin shëndetësor në fshat, duhet të dërgohen më shumë mjekë të aftë në fshat. Është shumë më mirë sikur të kishim një mjek për çdo grup fshattrash, se sa t'i presim të gjithë të sëmurët në spitalet e qytetit. Prandaj, në shpërndarjen e mjekëve për qytetin dhe fshatin të vendoset një përpjesëtim më i drejtë, duke dërguar mjekë, në radhë të parë, në ato krahina ku rastet e sëmundjeve dhe të vdekjeve janë më të shpeshta.

Përveç këtyre masave, për t'i ardhur në ndihmë fshatarësisë edhe më tepër në ruajtjen e shëndetit të saj, duke filluar nga 1 janari 1964, të hiqet pagesa që bën sot fshatarësia për kurimet në institucionet shëndetësore. Marrja e kësaj mase tregon edhe një herë kujdesin e Partisë për ruajtjen dhe forcimin e shëndetit të fshatarësisë punonjëse. Masa të tilla mund të merren vetëm atje ku populli është në fuqi, ku çdo gjë bëhet për të mirën e tij. Kjo dhe masat e tjera të marrura më parë nga Partia dhe pushteti në lëmin e mbrojtjes së shëndetit, janë një nga fitoret e mëdha të punonjësve tanë, për të cilën vetëm mund të ëndërronjë punonjësit edhe të vendeve më të përparuara kapitaliste në botë.

Por përmirësimi i organizimit të shërbimit shëndetësor në fshat nuk do të jepte rezultatet e dëshiruara po qe se nuk do të shoqërohej me ngritjen në një shkallë më të lartë të punës për përhapjen e kulturës shëndetësore. Propaganda shëndetësore duhet të synojë në përmirësimin e higjienës, në kujdesin e prindërve për rritjen e fëmijëve, në njohjen e popullsisë me rrezikshmërinë e sëmundjeve ngjitëse dhe në mënyrën e luftimit të tyre. Në këtë punë rolin kryesor duhet ta luajnë kuadrot mjekësorë,

të cilët tërë aktivitetin e tyre shoqëror duhet ta përqëndrojnë në këtë drejtim. Por kuptohet vetiu se ngritja e kulturës shëndetësore nuk është një detyrë vetëm për kuadrot e mjekësisë. Me këtë çështje duhet të merren organizata e gruas, e Frontit, e rinisë, e Kryqit të Kuq, të gjithë pa përjashtim.

Shokë,

Analiza e problemeve të nivelit dhe mënyrës së jetesës, të shërbimeve komunale, të artizanatit dhe të shëndetësisë në fshat, tregon se ne kemi bërë hapa të mëdhenj përpara në zhdukjen e prapambetjes shekullore që trashëguam nga e kaluara. Në të ardhshmen programi ynë në këtë fushë është i madh. Ndërtimi i plotë i bazës materialo-teknike të socializmit do të shpjerë patjetër në ngritjen në një shkallë të re, më të lartë, të mirëqenjes në fshat. Një fitore tjetër do të shënojë në këtë drejtim plotësimi i detyrave që ka caktuar plani i tretë pesëvjeçar.

Por, sikurse dihet, detyrat që shtron programi i Partisë për çështjet e mirëqenjes në fshat gjatë pesëvjeçarit të tretë janë të mëdha. Shqyrtimi i kësaj çështjeje nxori në shesh se ne kemi një varg të metash dhe kontradiktash, që lindin nga ecja jonë e vrullshme përpara, të cilat mund dhe duhet të kapërcehen. Por që kjo të shndërrohet në realitet, duhet të mobilizohet veprimtaria e ndërgjegjshme e Partisë, e fshatarësisë dhe e gjithë masave punonjëse të vendit.

Ne duhet të kemi mirë parasysh se zbatimi i vendimit të Kongresit IV të Partisë për ngritjen e mëtejshme të mirëqenjes së popullit tonë, varet shumë nga zbatimi i tij në radhë të parë në fshat, ku jeton dhe punon pjesa më e madhe e popullsisë, ku realizohet 45 për qind e të ardhurave kombëtare dhe ku niveli i mirëqenjes është më i ulët në krahasim me qytetin. Është kjo, pra, arsyeja që duhet t'u futemi sa më thellë e me guxim këtyre çështjeve, që nga gjërat që mund të duken të vogla e deri te më të mëdhatë, pasi në këtë mënyrë do të çohet përpara tërë çështja jonë e përgjithshme.

Kapitulli IV

MBI ZHVILLIMIN E ARËSIMIT E TË KULTURËS NË FSHAT

Deri tani ne shqyrtuam në përgjithësi njërën anë, aspektin kryesor të problemit të rritjes së mirëqenjes së masave të fshatit, atë të rritjes së mirëqenjes materiale të tyre. Tani duam të ndalemi edhe në anën tjetër të këtij problemi, në aspektin e tij të dytë, në atë të pasurimit të gjendjes shpirtërore, të rritjes së

nivelit arësimesor e kultural të këtyre masave. Të dyja këto anë përbëjnë një të tërë, ato janë të lidhura ngushtë midis tyre në mënyrë dialektike dhe influencojnë reciprokisht në njëra-tjetrën. Mirëqenja materiale është bazë për ngritjen e nivelit arësimesor e kultural, por edhe kjo e fundit ndihmon ose pengon në rritjen e mëtejshme të mirëqenjes materiale. Sepse si mund të kuptohet zgjidhja e detyrave të mësipërme, zhvillimi i mëtejshëm i forcave prodhuese, shtimi i të ardhurave, përmirësimi i mënyrës së jetesës, futja e së resë në fshat, pa dituritë dhe kulturën e nevojshme? Ja sepse Partia që në fillim, pas triumfit të revolucionit popullor dhe krahas luftës për transformimet e mëdha ekonomike revolucionare, hodhi parullën dhe nisi luftën për zhvillimin e revolucionit kultural. Në këtë çështje ajo, duke u nisur nga mësimet e marksizëm-leninizmit dhe nga realiteti i vendit tonë, duke shfrytëzuar traditat e lashta kulturalo-arësimore të popullit tonë, të cilat i pasuroi e i ngriti lart e më lart, dhe duke u bazuar në etjen e pafund dhe në vullnetin e çelniktë të popullit tonë për arësim e kulturë, i hyri punës me vetëdije të plotë, me guxim e besim të patundur se do t'ja dilte mbanë. Dhe Partia, si kurdoherë, fitoi. Sot të gjithë ne jemi dëshmitarë të fitoreve kolosale në këtë drejtim.

Dihet se për shkak të shtypjes shekullore dhe regjimeve anti-popullore e obskurantiste, që me qëllim mundoheshin të mbanin popullin në errësi, në lëmin e arësimit e të kulturës, sidomos në fshat, ne trashëguam një prapambetje shumë të rëndë. Më shumë se 90 për qind e popullsisë fshatare ishte analfabete. Në vitin 1938 kishte shkolla fillore vetëm në 529 fshatra, ose në një të pestën e fshatrave të Shqipërisë. Për këtë arsye në arësimin fillor përfshihej vetëm një e katërta e fëmijëve të fshatit të moshave përkatëse. Bijtë dhe bijat e fshatarëve që merrnin arësim të mesëm numëroheshin me gisht. Në të gjithë Shqipërinë në fshat, në një kohë kur kishte me qindra kisha, xhami e teqera, nuk kishte as edhe një institucion kultural të vetëm.

Por zbatimi i programit të Partisë bëri të mundur që, brenda një periudhe historikisht të shkurtër, krahas me transformimet e mëdha politike, ekonomike e sociale dhe mbi bazën e tyre të kryhet një revolucion i thellë e i gjithanshëm kultural. Ky revolucion që përfshiu gjithë vendin, ngriti nivelin arësimesor e kultural të popullsisë fshatare dhe influencoi në ndryshimin e botëkuptimit dhe të psikologjisë së saj.

Si rezultat i këtyre realizimeve, analfabetizmi u zhduk në brezin e ri dhe në pjesën më të madhe të popullsisë së rritur të fshatit. U realizua plotësisht dhe në të gjithë vendin arësimi i detyrueshëm fillor. Nga hiçi u krijua një rrjet i gjerë shkollash shtatëvjeçare, në të cilat këtë vit shkollor hynë 75 për qind e nxënësve të fshatit që mbaruan shkollën fillore, kurse në rrethe

të veçanta, si në atë të Gjirokastrës, të Sarandës, të Fierit dhe të Durrësit, hynë 90—95 për qind. Në shkollat e mesme të arësimit të përgjithshëm dhe profesional sivjet u regjistruan 56 për qind e nxënësve që mbaruan shkollën shtatëvjeçare të fshatit, gjë që është një fitore e shkëlqyer e revolucionit tonë kultural. Për bijtë dhe bijat e fshatarësisë tani janë hapur gjerësisht edhe portat e shkollave të larta. Në të njëjtën kohë, me mijëra të rinj e të reja fshatare, si dhe burra e gra të fshatit, vazhdojnë shkollat e të rriturve pa ndërprerje nga puna. Në saje të gjithë këtyre realizimeve, tani në fshatin tonë në çdo pesë vetë njëri mëson rregullisht në shkollë.

Shkolla jonë, krahas realizimit të edukimit komunist të brezit të ri, ka shërbyer dhe shërben si qendër e rëndësishme për futjen dhe përhapjen e së resë në jetën e fshatit në përgjithësi dhe në mënyrën e jetesës në veçanti. Ajo po lidhet gjithnjë e më ngushtë me të gjitha anët e jetës së popullit.

Por krahas shkollave, në fshat është krijuar edhe një rrjet i gjerë institucionesh të tjera kulturele, po zhvillohet një lëvizje masive diletante kulturalo-artistike dhe fiskulturale dhe në jetën e tij të përditshme po hyjnë në përpjesëtime gjithnjë më të mëdha gazeta, libri, radioja, filmi dhe mjete të tjera të edukimit ideologjik e kultural.

Revolucioni i thellë kultural që po kryhet, ka çliruar energjitë e talentet e fshatarit dhe ka shtuar më shumë etjen e dashurinë e tij për kulturë. Ai ka sjellë ndryshime të mëdha në jetën shpirtërore të fshatarësisë, e cila po çlirohet nga barra e rëndë e padijes, paragjyqimeve dhe bestytnive. Gruaja fshatare po merr frymë më lirisht. Hendeku në zhvillimin kulturalo-arësimit midis fshatit dhe qytetit ka filluar të ngushtohet. Të gjitha këto kanë ushtruar influencën e tyre edhe në ndryshimin e mënyrës së jetesës së fshatarit.

Realizimet e mëdha të revolucionit kultural në fshat u arritën në saje të vijës e të udhëheqjes së drejtë të Partisë, të ndihmës së gjithanshme që i ka dhënë fshatit shteti ynë socialist për këtë problem kaq jetik, si dhe të kontributit material e të interesimit të gjithanshëm të vetë fshatarësisë sonë përparimtare arësimsdashëse.

I. — TË NGREMË AKOMA MË LART ROLIN E SHKOLLËS DHE NIVELIN ARËSIMOR TË FSHATARËSISË

Problemet e arësimit janë të shumanshme dhe për zgjidhjen e tyre Kongresi IV i Partisë i ka përcaktuar qartë detyrat. Prandaj, këtu do të ndalemi në ato çështje të arësimit që ndikojnë drejtpërsëdrejti në zhvillimin e përparimin e gjithanshëm

social-kultural të fshatit, në ngritjen e mëtejshme të nivelit arësimitor të brezit të ri dhe të gjithë popullsisë fshatare, në përmirësimin e mëtejshëm të mënyrës së jetesës në fshat.

Duhet thënë se me gjithë realizimet kolosale që kemi arritur në shtrirjen e arësimit në fshat, me gjithë ritmet e shpejta të këtyre realizimeve, megjithëse tendenca e zhvillimit të mëtejshëm në këtë drejtim shënon ngritje të vazhdueshme, tani për tani kemi mjaft probleme të pazgjidhura e rezerva të pasfrytëzuara. Rrjeti i tanishëm shkollor në fshat nuk u përgjigjet plotësisht kërkesave gjithnjë në rritje të popullsisë fshatare për arësim. Në ndjekjen e shkollave ka shpërpjesëtime të theksuara midis djemve dhe vajzave, burrave dhe grave. Po kështu, ka shpërpjesëtime në shtrirjen e arësimit shtatëvjeçar midis rrethëve të ndryshme, brenda vetë rrethëve, midis zonave fushore e malore, midis nxënësve që hyjnë në shkollat shtatëvjeçare dhe atyre që i mbarojnë ato. Kurse rrjeti i gjerë i shkollave fillore dhe shtatëvjeçare që kemi në fshat, shfrytëzohet shumë pak për organizimin e arësimit pa shpëputje nga puna për rininë fshatare dhe për burrat e gratë e moshave relativisht më të reja. Njohja konkrete e këtyre problemeve dhe mundësive të pashfrytëzuara është një kusht i domosdoshëm për përcaktimin e masave të nevojshme, për zgjidhjen e tyre dhe për të mobilizuar drejt në këtë punë organet e arësimit dhe mësuesit, organizatat e Partisë dhe pushtetin lokal, organizatat shoqërore dhe gjithë fshatarësinë.

Në vendin tonë tani mbeten pa u përfshirë çdo vit në arësimin fillor rreth 600 fëmijë të fshatrave me shumë pak shtëpi, ku nuk mund të hapet në asnjë mënyrë shkollë fillore. Megjithëse ky është një numër shumë i vogël nxënësish, është një problem shqetësues, pasi këta fëmijë, si rregull rriten analfabetë. Është e nevojshme që Ministria e Arësimit dhe e Kulturës të studjojë dhe të përcaktojë masat që duhen marrë për zgjidhjen e kësaj çështjeje, në mënyrë që edhe këta fëmijë të përfshihen në arësim duke filluar nga viti shkollor 1965—1966.

Në arësimin shtatëvjeçar, krahas rrethëve ku tërhiqen afro 80—90 për qind e fëmijëve që mbarojnë filloren, kemi edhe rrethë si ai i Pukës, i Librazhdit, i Mirditës, i Kukësit, i Elbasanit, i Shkodrës, i Skraparit, i Tiranës, ku e vazhdojnë shkollën shtatëvjeçare vetëm 50—60 për qind e fëmijëve. Shpërpjesëtime të tilla ka edhe brenda rrethëve — midis lokaliteteve të ndryshme, midis zonave fushore e malore. Të theksuara janë këto në rrethet e Krujës, Lushnjës, Shkodrës, Korçës, Tiranës etj. Kjo gjendje ka arsyeet e shkaqet e veta, si konfiguracioni gjeografik e dendësia e popullatës së zonave të ndryshme, traditat kulturalo-arësimore dhe, në raste të veçanta, edhe interesimi i pamjaftueshëm i organeve planifikuese në qendër dhe në bazë për një zhvillim

sa më proporcional të arësimit shtatëvjeçar. Por këtu influencojnë edhe të meta të tjera të karakterit subjektiv, si mospërcaktimi i drejtë i rrezes së detyrimit shkollor, mosrealizimi i tij etj. Sivjet, duke luftuar për zgjidhjen e të metave të kësaj natyre, në rrethin e Tiranës, me rrjetin ekzistues të shkollave, u rrit edhe 10 për qind përfshirja e fëmijëve në arësimin shtatëvjeçar.

Një nga mjetet kryesore për emancipimin e plotë të femrës, për ngritjen e personalitetit dhe të dinjitetit të saj është edhe ngritja e nivelit të saj arësitor. Në kushtet tona, tani për tani, kjo mund të arrihet, në radhë të parë, duke siguruar pjesëmarrjen e vajzave në arësimin shtatëvjeçar. Por megjithëse arësimi shtatëvjeçar te ne është i detyruar dhe i barabartë, numri i vajzave në shkollat shtatëvjeçare, në krahasim me atë të djemve është më i vogël. Gjatë vitit shkollor në vazhdim në shkollat shtatëvjeçare të fshatit vajza janë vetëm 39 për qind e nxënësve. Në klasat e pesta vajzat përbëjnë 42 për qind të nxënësve, kurse në klasat e shtata — 36 për qind. Në rrethet e Skraparit, Përmetit, Pukës e Librazhdit vajzat përbëjnë nga 20 deri 30 për qind të nxënësve të shkollave shtatëvjeçare. Është me të vërtetë për të ardhur keq, por ne kemi edhe shkolla shtatëvjeçare në të cilat në klasën e shtatë nuk ka asnjë vajzë. Kuptohet se një pjesë e vajzave të fshatit i shpëtojnë detyrimit shkollor dhe, nën pretekstet dhe arësytet më të ndryshme, e lënë shkollën shtatëvjeçare pa e mbaruar. Sigurisht, në këtë çështje influencojnë konservatorizmi dhe fanatizmi i disa prindërve fshatarë, të cilët përpiqen t'i largojnë vajzat nga shkolla, t'i mbajnë në shtëpi e t'i përdorin për punë. Është një detyrë e ngutshme e organizatave të Partisë, e organizatave shoqërore dhe e mësuesve që me këta prindër të bëjnë një punë edukative e sqaruese më të madhe dhe t'i bindin për dëmin që u shkaktojnë vajzave të tyre dhe krejt shoqërisë sonë.

Tani ne po fillojmë kalimin nga arësimi i përgjithshëm i detyrueshëm shtatëvjeçar në atë tetëvjeçar, i cili do të përfundojë brenda 4—5 vjetëve. Në të njëjtën kohë, ne kemi shtruar detyrën që, brenda këtij dhjetëvjeçari, ta shtrijmë atë në të gjithë vendin. Ky është hapi më i rëndësishëm në zhvillimin e arësimit popullor e të revolucionit kultural përgjithësisht, dhe sidomos fitorja më e madhe e fshatarësisë sonë në lëmin e arësimit e të kulturës. Brenda këtij dhjetëvjeçari, çdo i ri ose e re fshatare do të ketë mundësi të marrë, së paku, arësim të mesëm jo të plotë, tetëvjeçar. Kështu do të arrihet një ngritje e ndieshme e nivelit arësitor-kultural e të gjithë popullsisë fshatare.

Por realizimi i arësimit të përgjithshëm të detyrueshëm tetëvjeçar në fshat është një detyrë e vështirë, sidomos po të marrim parasysh shpërpjesëtimet, të metat dhe rezervat e pashfrytëzuara akoma në arësimin shtatëvjeçar. Kuptohet se për të realizuar arë-

simin tetëvjeçar, neve do të na duhet të hapim shkolla të reja tetëvjeçare edhe në zona të thella malore. Por këto shkolla nuk ka kuptim të hapen atje ku ka shumë pak fëmijë. Prandaj, hapja e shkollave të reja duhet kombinuar me hapjen e konvikteve të vogla, si nga shteti ashtu edhe nga vetë kooperativat bujqësore e popullsia fshatare. Në të njëjtën kohë, është e domosdoshme të shfrytëzohen edhe të gjitha rezervat e tjera të mundshme.

Kalimi në arësimin tetëvjeçar kërkon përmirësimin rrënjësor të realizimit të detyrimit shkollor dhe mënjanimin e largimeve nga shkolla, sidomos nga vajzat. Duke u shtuar shkolla edhe një vit, fëmijëve u duhet ta vazhdojnë atë së paku deri në moshën 15—16 vjeçare. Duke pasur parasysh mentalitetin prapanik, i cili në një pjesë të fshatarësisë nuk është çrrënjësor akoma, mbajtja e fëmijëve në shkollë, sidomos e vajzave, deri në një moshë të tillë do të hasë në vështirësi. Prandaj, mësuesit, organet e pushtetit dhe organizatat e Partisë, të gjitha organizatat shoqërore, duhet të bëjnë një luftë akoma më të madhe për mbarimin e shkollave tetëvjeçare nga të gjitha vajzat, duke e konsideruar këtë si një nga rrugët kryesore për ngritjen e rolit të gjithanshëm të gruas në jetën e fshatit, për ngritjen e figurës së saj, të personalitetit dhe të dinjitetit të saj.

Tani në fshat ka filluar të shtrihet edhe rrjeti i shkollave të mesme. Ne kemi shkolla të mesme të arësimit të përgjithshëm edhe në qendra rrethesh, kryesisht fshatare, siç janë Tropoja, Puka, Gramshi, Librazhdi, Skrapari, Erseka etj., si dhe në qendra të rëndësishme prodhimi ku jeton edhe popullsia fshatare, si Kamza, Rrogozhina, Cërriku, Maliqi, Memaliaj, Selenica etj. Por duhet thënë se ky rrjet i gjerë shkollash nuk shfrytëzohet akoma racionalisht. Në disa prej tyre në klasat e larta ka shumë pak nxënës, prandaj ne duhet të luftojmë që të rritim sa më shumë pjesëmarrjen e rinisë fshatare në to. Sepse nuk është as racionale as e leverdishme që të kemi klasa mature me 6, 9, 10, 13 nxënës, siç ndodh në disa shkolla të tilla. Kjo çështje duhet parë mirë nga organet përkatëse, në mënyrë që edhe nxënësit të mësojnë, por edhe shteti të mos dëmtohet kot.

Një rezervë e madhe e pashfrytëzuar është edhe arësimi i të rriturve në fshat, sidomos arësimi fillor. Tani aty-këtu shfaqet mendimi se arësimi fillor i të rriturve në fshat duhet konsideruar si një problem i kapërcyer dhe i zgjidhur. Në vitin shkollor 1955—1956 në shkollat e mbrëmjes në fshat ishin regjistruar 4 597 nxënës, kurse në vitin 1961—1962 në këto shkolla u regjistruan vetëm 1 159. Mos do të thotë kjo se në fshatrat tona nuk ka më njerëz pa arësim fillor? Në asnjë mënyrë. Përkundrazi, në bazë të regjistrimit të popullsisë në vitin 1960, gjendja arësimore e fshatit, me gjithë ndryshimet e mëdha që janë bërë, është akoma e ulët. Sipas këtij regjistrimi, del se në disa zona ka akoma

djem e vajza që dinë pak shkrim e lexim, ose që janë analfabetë. Për moshat më të rritura kjo gjendje, natyrisht, është më e theksuar.

Por një gjendje e tillë, veç prapambetjes së trashëguar nga e kaluara, shpjegohet edhe në dobësitë e formalizmin në luftën kundër analfabetizmit, me mosvazhdimin e punës së mëtejshme të organizuar me analfabetët që mbaruan kurset, sidomos me gratë, në mënyrë të veçantë me zhvillimin e kufizuar të arësimit fillor të mbrëmjes në fshat.

Prandaj, do të bënim gabim të madh në qoftë se këto probleme do t'i konsideronim të kapërcyera e të zgjidhura. Përkundrazi, është e domosdoshme të shpëtohen të gjithë ata analfabetë të moshave relativisht të reja që mund të shpëtohen, duke përdorur të gjitha format e mundshme, që nga patronazhi individual, te grupet e leximit e deri te organizimi i shkollave fillore të mbrëmjes, kudo që kjo të paraqitet e nevojshme. Në të njëjtën kohë, të luftohet që njerëzit në fshat të mos mbeten vetëm në të mësuarit e shkrimit e të leximit, por të regjistrohen, të ndjekin e të përfundojnë me rezultate sa më të mira shkollat e mbrëmjes. Një gjë e tillë vazhdon të mbetet detyrë me rëndësi e organizative të Partisë në fshat.

Të ngremë rolin e shkollës, të arësimitarëve dhe të gjithë inteligjencies për përmirësimin e mënyrës së jetesës në fshat

Vjetët e fundit, sidomos pas diskutimit dhe aprovimit të tezave të Komitetit Qendror për riorganizimin e sistemit të arësimit popullor, edhe në shkollën e fshatit kanë filluar të bëhen përpjekje më të mëdha për një forcim të gjithanshëm të punës së saj mësimore-edukative. Rezultate të mira janë arritur edhe në përmirësimin e cilësisë së mësimin, në lidhjen e shkollës me jetën, në shtimin e interesimit shoqëror për mësimin dhe edukimin e brezit të ri, si dhe në shtimin e interesimit të shkollës e të mësuesve për jetën dhe problemet e fshatit. Por megjithatë ne jemi akoma larg plotësimin të detyrës për ta lidhur më ngushtë shkollën me jetën, për ta kthyer atë në një vatër përparimi në të gjitha drejtimet e jetës në fshat.

Në etapën e tanishme roli i shkollës, dhe në mënyrë të veçantë i shkollës së fshatit, si qendra kryesore e përhapjes së kulturës dhe të diturisë në popull, rritet shumë. Kjo kërkon që shkolla të lidhet akoma më ngushtë me jetën, të përgatitë brezin e ri duke u mbështetur edhe në nevojat e perspektivat e fshatit, ta bëjë atë të aftë që të jetë në ballë të luftës për përhapjen e së resë në të gjitha fushat, për ndryshimin dhe përmirësimin e mëny-

rës së të menduarit dhe të mënyrës së jetesës në familje. Në të njëjtën kohë kjo kërkon që organizatat e Partisë dhe të pushtetit të merren më shumë me çështjet e arësimit, që këto të bëhen probleme të të gjithë fshatit.

Rinisë fshatare që mbaron shkollën shtatëvjeçare e më vonë atë tetëvjeçare, mësuesit duhet t'i zgjojnë etjen për përparim dhe kulturë, t'i edukojnë dashurinë për dije dhe shkencë, ta mësojnë të dojë librin dhe të jetë në gjendje ta studiojë atë në mënyrë të pavarur, t'i rrënjosin një ndjenjë aktive mospajtimi me prapambetjen, me të kënaqurit me pak, me fanatizmin, ta pajisin me njohuri dhe shprehje të ndryshme pune, higjienë dhe jete të kulturuar. Pa bërë këtë punë mësuesit nuk mund ta luajnë rolin e tyre si edukatorë të rinisë fshatare dhe si pishtarë të përparimit e të kulturës në fshat.

Në kuadrin e forcimit të lidhjeve të mësimin me jetën dhe të përmirësimin të gjithanshëm të edukatës së punës te nxënësit, shkolla e fshatit duhet t'u japë fëmijëve disa njohuri dhe shprehje të domosdoshme pune, të vlefshme edhe për jetën e përditshme shoqërore e familjare. Tani në shkollat e fshatit, krahas punës në parcelat bujqësore dhe punës së dobishme shoqërore në bujqësi, duhet të organizohet edhe puna e nxënësve në punishtet e shkollës, punë të cilat mund të jenë me dru, metal, kashtë, xunkth etj., si dhe mësimi «ekonomi shtëpiake» për fëmijët. Organizimi i këtyre punëve dhe mësimëve, përveç rolit që luan në edukimin e fëmijëve, është edhe praktikisht i dobishëm për fshatin dhe ndihmon për përhapjen e një jetese më higjienike dhe më të kulturuar. Duhet kuptuar mirë se pa u mësuar fëmijëve që në shkollë ekonominë shtëpiake, pa u dhënë një minimum shprehish higjienike, pa i mësuar si të gatujnë ushqimin dhe të administrojnë ekonominë shtëpiake, nuk mund të bëhet fjalë për një përmirësim rrënjësor të jetesës në fshat.

Por deri tani për organizimin e këtyre punëve dhe mësimëve të reja bëhet shumë pak. Lënda e sotme e ekonomisë shtëpiake zbatohet vetëm rrallë dhe vetëm pjesërisht në ndonjë shkollë. Prandaj, Ministria e Arësimit dhe e Kulturës dhe organet e saj duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme për zbatimin e orientimit të dhënë nga Komiteti Qendror i Partisë lidhur me këtë çështje. Për këtë është e nevojshme të merren masa për të përgatitur kuadrin e ri arësitor me njohuri të gjera teorike e praktike dhe, në të njëjtën kohë, për të kualifikuar në këtë drejtim edhe kuadrin ekzistues.

Mësimi «ekonomi shtëpiake» për fëmijët duhet të bëhet i detyrueshëm dhe të jetë i tillë që jo vetëm të japë njohuri teorike e praktike, por edhe t'u shërbejë atyre për jetën e përditshme praktike familjare. Nga ky mësim fëmijët duhet të mësojnë që në shkollë, jo vetëm teorikisht, por edhe praktikisht, mjeshtërinë e

të gatuarit, të prerjes dhe të qepjes, mënyrën e rregullimit të shtëpisë, të veshjes e të mbathjes etj. Që njohuritë e fituara gjatë mësimit t'i zbatojnë në praktikë, nxënësit, bashkë me mësuesit, duhet të venë shpeshherë në shtëpitë e fshatarëve dhe këtu t'u tregojnë atyre se si përgatitet gjella e shijshme, e ushqyeshme dhe higjienike. Kështu mund dhe duhet të veprohet edhe për çështje të tjera që lidhen me ekonominë shtëpiake dhe mënyrën e jetesës në familjet fshatare. Në këtë mënyrë jo vetëm që do të forcohet lidhja e shkollës me jetën, por kjo do të jetë edhe një ndihmë e madhe praktike e konkrete që shkolla do të japë për ngritjen e mënyrës së jetesës në fshat.

Në përgjithësi mësuesve të fshatit u bie barra të bëjnë një luftë këmbëngulëse për një mënyrë jetese më të kulturuar atje ku punojnë, kundër të gjitha paragjykimeve dhe zakoneve të vjetra që pengojnë ndryshimin dhe transformimin e jetesës në fshat. Shkolla, mësuesi dhe brezi i ri që edukojnë ata, duhet të qëndrojnë në ballë të kësaj lufte.

Sot mësuesit përbëjnë shumicën dërmuese të inteligjencies në fshat. Përveç kësaj, edhe nga natyra e punës së tyre ata qëndrojnë në radhët e para të luftës për përparimin social-kultural, për futjen e së resë në mënyrën e jetesës në fshat. Pikërisht këtë rol të mësuesve të fshatit kishte parasysh Lenini kur i quante ata si përcuesit e politikës së partisë në fshat, si ndërlihdës midis klasës punëtore dhe fshatarësisë punonjëse, si propagandistë të radhëve të para të vijës së partisë.

Mësuesit tanë, duke punuar deri në skajet më të largëta të atdheut, duke përhapur atje arësimin dhe kulturën, duke edukuar brezin e ri, kanë dhënë një kontribut të çmuar në përparimin e fshatit. Në të njëjtën kohë, ata e kanë ndihmuar fshatarin në të gjitha fushat e jetës, sidomos në përhapjen e kulturës dhe në përmirësimin e mënyrës së jetesës. Pikërisht, për këto arësye figura e mësuesit është e dashur dhe popullore për masat fshatare.

Por megjithatë përpjekjet e mësuesve brenda dhe jashtë shkollës për kryerjen e misionit të tyre si aktivistë shoqërorë, si edukatorë të rinisë e të popullsisë së fshatit, për futjen e së resë në mënyrën e jetesës, janë akoma të kufizuara dhe të pamjaftueshme.

Prandaj, organizatat e Partisë duhet të tregojnë një interesim më të madh për rritjen e rolit dhe aktivizimin e mësuesve në jetën e fshatit, për t'i bërë ata akoma më shumë agjitorë të flaktë për ngritjen e gjithanshme të mirëqenjes së fshatarësisë. Arësimtarët tanë duhet të kuptojnë rolin e tyre fisnik si misionarë dhe arkitektë të kulturës socialiste në fshatin tonë të ri. Puna e tyre nuk përfaqëson një zanat të thjeshtë, por një nga profesionet më të komplikuar e të vështira dhe nga më të rëndësishmet,

që udhëhiqet nga idealet më të larta për të transformuar dhe pasuruar shpirtrat e mendjet e njerëzve, për t'u dhënë atyre thesaret më të vyera të njerëzimit, shkencën e pavdekshme të marksizëm-leninizmit, mësimet jetëdhënëse të Partisë sonë të lavdishme. Le të frymëzohen ata në misionin e tyre nga patriotët tanë të rilindjes, Papa Kristo Negovani, Petro Nini Luarasi, Koto Hoxhi, nga arësimtari i popullit Ndrec Ndue Gjoka e sa e sa të tjerë, që s'kursyen as jetën për t'i dhënë dritë popullit. Populli atyre do t'u mbetet për jetë mirënjohës dhe në të ardhshmen e tij të lumtur, në socializëm e komunizëm, do të ndritë për shekuj edhe vepra e tyre e pavdekshme.

Por krahas mësuesve, në fshat punojnë me mijëra kadro intelektualë me arësim të mesëm dhe të lartë. Në vitin 1961 në fshat, së bashku me mësuesit, kishte 550 kadro me arësim gjysmë të lartë e të lartë dhe 4 430 vetë me arësim të mesëm. Kjo është një forcë e madhe, një ushtri e tërë kuadrosh, që mund dhe duhet të japë një kontribut të rëndësishëm në ngritjen e nivelit kultural të fshatarësisë dhe në përmirësimin e mënyrës së jetesës në fshat.

Ashtu si mësuesit, edhe intelektualët e tjerë të fshatit qëndrojnë në radhët e para të luftës për përhapjen e së resë, futjen e teknikës, propagandimin e shkencës dhe për zhvillimin e gjithanshëm të kulturës. Në këtë prizëm ata të gjithë, pa përjashtim, janë propagandistë të vijës së Partisë, përcues të ideve të saja në masat e fshatarësisë, agjitorë për mobilizimin e fshatarësisë në plotësimin e detyrave që shtron Partia.

Është fakt se specialistët e ndryshëm kanë dhënë një ndihmë të vlefshme për zgjidhjen e shumë problemeve bujqësore në fshat. Agronomët, zooteknikët, veterinerët dhe kuadrot e tjerë teknikë të rinj, çdo ditë e më shumë, po bëhen këshilltarë të denjë të fshatarësisë për zbatimin e metodave shkencore në të gjitha fushat e intensifikimit të bujqësisë. Kjo është një gjë shumë e mirë, por e pamjaftueshme për inteligjencien tonë popullore. Në disa raste pak ndihet roli i tyre për ndryshimin e mënyrës së jetesës në fshat, për të futur të renë, kulturën në këtë drejtim. Është për të ardhur keq që disa nga intelektualët, kryesisht nga ata që vijnë nga qyteti, e shikojnë veten si mysafirë të përkohshëm në fshat dhe interesohen vetëm për punën e tyre si specialistë të ngushtë të një dege të caktuar. Në këtë mënyrë ata shpeshputen nga jeta e fshatit dhe nuk ndihmojnë për përparimin e tij social-kultural të gjithanshëm. Megjithatë këta përbëjnë një pakicë shumë të vogël, ne duhet t'i aktivizojmë dhe t'i vëmë krahas me të tjerët, në krye të punës së madhe dhe fisnike që ka ndërmarrë Partia për transformimin e mënyrës së jetesës në fshat. Intelektualët e ardhur nga qyteti dhe gjithë inteligjencia jonë e fshatit duhet të kuptojë se atje, në fshat, është fronti

i tyre në luftën e përgjithshme që bën populli ynë për ndërtimin e socializmit. Prandaj, aty të vërshojë pa asnjë ngurrim gjithë dituria e talenti i tyre; ata fshatit t'i kushtojnë gjithë shpirtin e jetën e tyre.

Natyrisht, në të ardhshmen intelektualët e fshatit, nën udhëheqjen e Partisë, do ta kryejnë edhe më mirë rolin e tyre për futjen e kulturës e të jetesës së kulturuar në fshat. Këtë detyrë ata do ta plotësojnë me sukses në qoftë se edhe organizatat bazë të Partisë në fshat do të bëjnë një punë më të madhe për t'i afruar dhe aktivizuar të gjithë intelektualët, për t'u këshilluar me ta, për të kërkuar ndihmën e tyre dhe për t'u krijuar kushtet e nevojshme. Si kurdoherë, Partia s'do të kursejë asgjë dhe do të jetë gjithmonë pranë tyre.

II. — TA BËJMË KULTURËN PJESË ORGANIKE TË JETËS SË RE SOCIALISTE NË FSHAT

Kultura përbën një pamje të rëndësishme të jetesës së fshatit tonë. Ajo luan një rol të dukshëm në edukimin ideologjik të punonjësve, në brumosjen e tyre me ndërgjegjen socialiste, me qëndrimin e ri ndaj punës, pronës dhe në shoqëri. Ajo e bën më të bukur dhe të këndshme jetën e punonjësve.

Sot në fshat po lulëzon kultura e re, nacionale nga forma dhe socialiste nga përmbajtja. I tërë vendi përshkohet nga një rrjet i gjerë institucionesh kulturore dhe vetëm në shërbim të fshatarësisë janë vënë rreth 1 300 shtëpi e vatra kulture. Libri shqip, për të cilin aq shumë luftuan patriotët tanë, çdo ditë e më tepër po bëhet i masave.

Megjithatë, ne jemi të vetëdijshëm se niveli kultural në fshat është akoma i ulët dhe përbën një pengesë serioze për zhvillimin e përgjithshëm të fshatit me ritme më të shpejta. Në të njëjtën kohë, si rezultat i ngritjes së mirëqenjes materiale, po rriten kërkesat e fshatarësisë për një jetë më të kulturuar. Pak vjet kanë kaluar nga fitorja e rendit kooperativist dhe sa shumë janë rritur kërkesat për një jetë të kulturuar në fshat! Por shumë më të mëdha do të jenë këto kërkesa pas 10—15 vjetësh, kur kooperativat bujqësore do të jenë më të forta, më të begatshme, kur elektriku, radioja, kinemaja do të futen më thellë në jetën e fshatit dhe kur në fshat do të ketë më shumë kuadro të mesëm e të lartë. Për këtë arsye përpara nesh shtrohet më me forcë detyra të marrim të gjitha masat e duhura që kulturën ta bëjmë pasuri të të gjithë fshatarësisë, pjesë të pandarë të jetës socialiste në fshat.

1. — TA ÇLIROJMË FSHATARËSINË NGA PARAGJYKIMET E MBETURINAT E SË KALUARËS

Ne kemi arritur përfundime të kënaqshme në çlirimin e fshatarësisë nga paragjykimet e mbeturinat e së kaluarës. Kjo shprehet në të gjithë veprimtarinë ekonomiko-shoqërore të jetës në fshat. Tani në përgjithësi nuk ndihet ndarja fetare, është zhdukur zakoni barbar i hakmarrjes, si dhe shumë zakone të tjera prapanike, që shkurtonin jetën e njerëzve dhe dëmtonin ekonominë familjare. Veçanërisht ka ndryshuar mjaft qëndrimi ndaj gruas, roli dhe personaliteti i së cilës po rriten përditë e më tepër në jetën politike, ekonomike dhe shoqërore të fshatit.

Por a mund të thuhet se fshatarësia është çliruar përfundimisht nga paragjykimet dhe mbeturinat e së kaluarës? Sigurisht, jo. Për të arritur këtë objektiv, ne na duhet të bëjmë akoma një punë të madhe, të vazhdueshme ideo-politike me të gjitha masat e fshatarësisë, dhe sidomos me rininë, së cilës i përket e ardhshmja.

Në fshat, ku më pak e ku më shumë, ruhen akoma paragjykimet fetare. Vajtja në kishë, xhami e teqe, ceremonitë fetare në rastet e vdekjeve, pjesëmarrja në panairët fetare e të tjera si këto i sjellin dëme të mëdha bujqësisë, pasi i largojnë fshatarët nga puna dhe përhapin ndër ta pikëpamjet fetare, që helmojnë mendjen dhe ndjenjat e tyre.

Të forta janë akoma në fshat disa zakone prapanike që ulin dinjitetin e gruas dhe e kufizojnë pjesëmarrjen e saj gjithnjë më aktive në jetën politike, ekonomike dhe shoqërore. Në disa zona të rrethit të Shkodrës, Vlorës, Tepelenës dhe Sarandës, në kundërshtim me urdhëresën në fuqi ndeshen akoma raste, megjithëse të kufizuara, kur gratë ngarkohen me barrë në kurriz, ndërsa burrat e kanë për turp të merren me drutë, ujë dhe të tjera punë si këto. Bile, është për të ardhur shumë keq, që në fshatrat e Kurveleshit, si në Nivicë, Rexhin dhe Progonat, gratë, duke përfshirë edhe ato të komunistëve, përdoren për mbajtjen e druve, megjithëse çdo shtëpi ka kafshë ngarkese. Gruaja ka fituar ligjërisht të gjitha të drejtat, por ndeshen akoma zakone që janë në kundërshtim me pozitën e saj të re në shoqërinë socialiste. Në rrethin e Peshkopisë, të Durrësit, të Gramshit, të Librazhdit bëhen akoma fejesa që në djep, martesë të imponuara nga prindërit, me para dhe me diferenca të mëdha moshe, veç shfaqjeve të tjera, që nuk pajtohen me normat juridike dhe të moralit komunist.

Shokë, ne kemi folur shpeshherë për punën me gruan, për rolin dhe vendin që ajo zë si pjesëtare e denjë e aktive në ndërtimin e shoqërisë socialiste. Dhe Partia e ka ngritur kurdoherë me forcë këtë çështje, sepse është e ndërgjegjshme që gruas shqiptare nuk i ka munguar kurrë, dhe aq më tepër nuk i mungon sot,

as dëshira, as aftësia për punë për ta zbukuruar jetën, për ta çuar atdheun përpara. Sot, si kurrë ndonjëherë tjetër, në vendin tonë socialist ajo i ka të gjitha mundësitë e kushtet objektive për të treguar personalitetin e saj dhe ç'është e zonja të bëjë në çdo fushë të jetës qoftë në punë, shoqëri dhe familje, si punëtore dhe si drejtuese, si edukatore, si amvise, si nënë. Dhe ne të gjithë jemi dëshmitarë të qindra e mijëra grave që, me heroizëm dhe talent të pashoq, punojnë në fabrika e artizanat, në kooperativa, në ara e stalla, në çerdhe, shkolla, në tregëti, financë e shëndetësi, në laboratore e në familje duke u bërë shembull i madh për të gjithë.

Por megjithatë roli i gruas akoma nuk vlerësohet kudo e nga kushdo drejt, ashtu siç kërkon Partia. Për këtë flasin më së miri edhe të metat e dobësitë që u përmendën më lart. Akoma një pjesë të mirë të njerëzve, bile dhe të kuadrove, sidomos në fshat, paragjykimet dhe mbeturinat e së kaluarës i heqin pas, i pengojnë ta shohin çështjen drejt në sy. Partia sot thekson me forcë se në etapën e re të ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste ngrihet si domosdoshmëri tjetër objektive çështja e rritjes së personalitetit të gruas në punë, shoqëri e familje. Ne po shqyrtojmë çështjen e rritjes së mirëqenjes në fshat. E mirë, pra, le të kuptohet se pa pjesëmarrjen e gruas, pa rritur personalitetin e saj, ajo s'mund të arrihet: as prodhimi nuk mund të shtohet, as të ardhurat nuk mund të rriten, as administrimi i tyre nuk mund të bëhet drejt, as ushqimi e veshmbathja nuk mund të rregullohen, as shtëpia nuk mund të bëhet më komode, as fëmija nuk mund të edukohet, as jeta nuk mund të bëhet më e gëzuar. Prandaj, nga të gjithë ne, në radhë të parë nga burrat, që duhet ta kuptojnë thellë dhe drejt këtë gjë, nga vetë gratë që duhet të luftojnë më shumë e të forcojnë besimin në forcat e tyre, nga organizatat e Partisë, organizata e gruas, e rinisë etj., nga organet shtetërore, me një fjalë nga gjithë shoqëria duhet të krijohen me ritëm më të shpejtë të gjitha kushtet subjektive për ngritjen e mëtejshme të rolit të gruas, për rritjen dhe forcimin e personalitetit të saj, duke shkëlmuar çdo paragjykim e mbeturinë të së kaluarës që pengon në këtë drejtim. Atëhere do të shohim edhe sa më shpejtësi do të vihen në jetë edhe detyrat që do të caktojë ky plenum për rritjen e mirëqenjes materiale e kulturele të fshatit.

Ne kemi arritur të zhdukim mjaft paragjykimet edhe në drejtime të tjera; kemi likuiduar mjaft zakone prapanike. Kështu, p.sh. kemi çrrënjësuar nga masa e fshatarësisë zakonet e keq të hakmarrjes, nga i cili në të kaluarën shkatërroheshin për çdo vit me qindra familje fshatare. Por ka akoma, aty-këtu, njerëz që nga grindjet e vogla shkojnë deri në përdorimin e armëve. Ka ndodhur që në disa fshatra të rrethit të Pukës, të Fierit e të Burrelit të kryhen krime të rënda, të huaja për moralin e shoqë-

risë sonë të re, të shkaktuara kryesisht nga grindjet për çështje grash, uji etj., gjë që tregon se nuk është bërë një punë e dëndur e bindëse për të kuptuar drejt rolin e gruas, ligjshmërinë mbi pronën dhe normat e tjera të rendit tonë socialist.

Ruajtja e paragjykimëve fetare dhe zakoneve prapanike të së kaluarës në një shkallë akoma të ndieshme, e ka burimin edhe në punën e pamjaftueshme që bëjnë organizatat e Partisë për formimin e ndërgjegjes së saj socialiste. Ka disa organizata partie që punën e gjallë edukative me fshatarësinë e zëvendësojnë me masa administrative, metodën e bindjes me atë të detyrimit, në më tepër në dukje dëmin ekonomik të paragjykimëve dhe zakoneve prapanike, pa argumentuar mbi baza ideologjike nevojën për t'i çrrënjësuar këto nga ndërgjegjja e fshatarit. Duke u nisur nga qëllimi për të luftuar krenmtimin e festave fetare, ka pasur raste që konsultat e Frontit Demokratik i kanë bërë thirrje fshatarësisë që këto festa ose mortje t'i krentojnë pa mish dhe vetëm me fasule. Për më tepër ka pasur edhe fshatra që kanë propozuar t'u hiqej triska e Frontit shkelësve të këtij rregulli.

Natyrisht, është naive të mendohet se masa të tilla mund të japin sado pak rezultate të mira për zhdukjen e paragjykimëve fetare, besimeve të kota dhe zakoneve prapanike. Lufta për çrrënjësien e këtyre mbeturinave të së kaluarës të trashëguara për shekuj të tërë, është mbi të gjitha, një luftë ideologjike, që ka për qëllim çlirimin shpirtëror të njerëzve. Në qoftë se njerëzit kanë të tilla mbeturina, është vetëm një fatkeqësi, por jo faj i tyre. Prandaj, me ta duhet mbajtur një qëndrim shumë i matur, miqësor e shoqëror.

Në luftimin e paragjykimëve fetare, besimeve të kota dhe zakoneve prapanike një vend me rëndësi duhet të zërë propagandën ateiste shkencore, e cila duhet t'i edukojë me durim njerëzit me botëkuptimin shkencor, pa i fyer dhe pa i prekur ata drejtpërsëdrejti. Çrrënjësia e këtyre mbeturinave është një punë e vështirë dhe delikate. Ato nuk mund të zhduken as me dekrete dhe as me mitingje. Kjo është një punë që kërkon durim, zgjuarësi dhe takt. Për këtë qëllim duhen aktivizuar më mirë të gjitha format e propagandës së Partisë, institucionet tona kulturele, shkollat, arësimtarët dhe gjithë intelektualët e tjerë, shtypi dhe radioja, letërsia dhe artet, të cilët luftën për edukimin e punonjëseve me moralin dhe botëkuptimin e ri komunist duhet ta shohin si një detyrë të tyre kryesore. Rëndësi e madhe i duhet dhënë shpjegimit të drejtë shkencor të fenomeneve të natyrës, popullarizimit të sukseseve të shkencës e të teknikës, kritikës së dogmave fetare, duke i vënë në dukje fshatarësisë kotësinë e tyre dhe dëmin që i sjellin ato. Në këtë çështje një vëmendje të posaçme duhet të tregojnë shkollat, organizatat e rinisë dhe institucionet kulturele për edukimin e rinisë.

Më shumë kujdes duhet të tregohet për të mbajtur të gjallë dhe për të zhvilluar më tej zakonet e mira dhe virtytet e larta që ka trashëguar brez pas brezi fshatarësia jonë, si trimërinë, besën, mikpritjen, nderin, bujarinë, duke futur në to një përmbajtje të re. Në të njëjtën kohë, duhen zhvilluar e përhapur më shumë zakonet e reja, që lindin nga jeta socialiste, për ngjarje të shënuara të jetës politike, ekonomike, shoqërore, kulturele, të vendit apo krahinës, të fshatit e të familjeve kooperativiste.

2. — Të bëhen më shumë përpjekje për ngritjen kulturele të fshatrave malore

Thellimi i revolucionit kultural në fshat ka si pikësynim kryesor ngritjen e përgjithshme të nivelit kultural në të gjitha pamjet e jetës së fshatarësisë. Kjo detyrë e madhe do të plotësohet me sukses në qoftë se, përveç të tjerave, do të mbahen mirë parasysh shpërpjesëtimet që ekzistojnë sot në zhvillimin kultural ndërmjet fshatrave dhe zonave të ndryshme dhe do të merren masa të tilla që të sigurojnë zhdukjen e tyre brenda një kohe sa më të shkurtër.

Partia e ka pasur parasysh gjithmonë këtë çështje dhe i ka kushtuar një kujdes të veçantë zhvillimit të kulturës në fshatrat malore. Këtij qëllimi i kanë shërbyer zgjerimi i rrjetit arësorimor e i institucioneve kulturele dhe masat e tjera të kësaj natyre.

Megjithatë, vazhdon të ketë një shpërpjesëtim në zhvillimin kultural, sidomos ndërmjet fshatrave të zonave malore dhe të zonave fushore. Kjo ka ardhur, përveç arsyeve objektive, siç janë ndryshimet ekonomike e kulturele, vështirësitë e konfiguracionit etj., si edhe për shkak të kujdesit të pamjaftueshëm që kanë treguar organet e Partisë dhe të pushtetit, të mungesës së një pune të diferencuar dhe në përshtatje me kushtet dhe veçoritë e këtyre zonave.

Mirëpo a duhet që këto veçori të zonave malore të pengojnë zhvillimin kultural të kësaj pjese të fshatarësisë? A janë këto vështirësi të pakapërcyeshme?

Ne jemi të bindur se, me gjithë veçoritë dhe vështirësitë e mësipërme, janë të gjitha mundësitë që nivelin kultural të fshatrave të zonave malore ta ngremë në një shkallë më të lartë, që kulturën ta çojmë deri në fshatrat më të thella, dhe kështu të zhdukim sa më shpejt shpërpjesëtimin që ekziston ndërmjet tyre dhe fshatrave të zonave fushore.

Për të arritur këtë ne duhet të forcojmë punën e organizatave të Partisë dhe të organeve të pushtetit në këto zona. Ato duhet të bëjnë një punë të diferencuar, duke u përqëndruar veçanërisht në problemet kulturele që preokupojnë më shumë këto kra-hina, dhe duke përdorur mundësitë, mjetet dhe format më të për-

shtatshme. Puna kulturele të mos kufizohet vetëm në aktivitetin brenda shtëpisë ose vatrës së kulturës, të cilat, në kushtet konkrete, nuk mund të tërheqin të gjithë masën e fshatit. Të praktikohen edhe aktivitete kulturele në grupe të ngushta në bazë lagjesh, grupe familjesh, duke shfrytëzuar traditën e mirë të fshatarit tonë të vajtjes e ardhjes të njëri-tjetri, të organizohen pasdreke, biseda për probleme të ndryshme politike e kulturele, argëtime, lojna etj.

Një ndihmë më e madhe t'u jepet këtyre fshatrave edhe nga institucionet kulturele të qytetit. Por që të kemi rezultatet e dëshiruara, duhet të bëhet një kthesë e madhe në përmirësimin e punës të vetë institucioneve kulturele të këtyre zonave. Shtëpitë, dhe sidomos vatrave të kulturës, krahas me shkollat, janë institucionet bazë që duhet të merren kryekëput me organizimin e punës kulturele në fshat. Në 1515 fshatra të zonave malore ka 668 institucione të tilla, ose afërsisht një në çdo dy fshatra. Kjo është një bazë e fuqishme për të ndërmarrë një aktivitet kultural më të gjerë; mirëpo në fakt ajo po shfrytëzohet në një masë të pamjaftueshme. Prandaj, komitetet e Partisë dhe komitetet ekzekutive të k.p. të rretheve duhet të merren në të ardhshmen më shumë me organizimin e punës të këtyre institucioneve, që ato të gjallërohen dhe të zhvillojnë një veprimtari të gjithanshme me masat fshatare dhe të zgjerojnë aktivitetin diletant në fshat.

Në të njëjtën kohë, një vëmendje e veçantë t'i kushtohet zgjedhjes dhe përgatitjes së kuadrit të kulturës për këto fshatra. Dobësitë në punën kulturele e kanë burimin edhe në faktin që kuadri i ngarkuar me këto detyra nuk ka përgatitjen e duhur. Nga 591 përgjegjës të shtëpive dhe të vatrave të kulturës, vetëm 157 kanë arësim të mesëm, ndërsa pjesa tjetër kanë arësim shtatëvjeçar dhe fillor. Jeta ka treguar se në ato fshatra ku me punët e kulturës janë ngarkuar arësimitarët e fshatit dhe ku ata janë ndihmuar dhe kontrolluar më mirë nga organet e Partisë, kryesia e kooperativave bujqësore dhe organet e pushtetit në rreth, rezultatet kanë qenë më të mëdha. Prandaj, në të ardhshmen, krahas me masat që duhet të marrin Ministria e Arësimit dhe e Kulturës dhe komitetet ekzekutive të rretheve për të kualifikuar përgjegjësit e vatrave dhe të shtëpive të kulturës, duhet që në këto detyra të ngarkohen sa më shumë kuadro me arësim të mesëm dhe veçanërisht mësuesit.

3. — Ta bëjmë kulturën çështje të masave dhe të zhvillojmë në mënyrë të harmonishme të gjithë sektorët e saj

Partia vazhdimisht ka theksuar që kultura të bëhet një pa-suri e masave, një ushqim për të zbukuruar jetën e tyre. Dhe në fakt në fshat kultura po bëhet çështje e masave. Kjo ka një rë-

ndësi të madhe, pasi eksperiencia ka treguar se kur masat fshatare ndjejnë nevojën për arësim dhe një jetë më të kulturuar, kur ato marrin pjesë në drejtimin dhe zhvillimin e kulturës, atëherë kultura vuan më pak nga formalizmi, bëhet me të vërtetë një forcë materiale për ngritjen e ndërgjegjes së tyre dhe të mënyrës së jetesës.

Një detyrë të rëndësishme në këtë drejtim kanë organizatat e masave — Fronti Demokratik, Bashkimi i Grave dhe Bashkimi i Rinisë. Iniciativat e organizatave të masave, si ajo e organizatave të Frontit në vjetët e parë për luftën kundër analfabetizmit, për sqarimin e luftimin e disa zakoneve prapanike, aksionet e organizatës së gruas për një jetë më të kulturuar, aktivitetet kulturalo-artistike e sportive të rinisë, i kanë dhënë një hov të ri punës kulturele në fshat dhe kanë rritur interesimin e masave për kulturë.

Në periudhën e tanishme, për të ngritur më lart nivelin kultural të fshatarësisë, shtrohet edhe më me forcë thellimi i mëtejshëm i karakterit masiv të kulturës. Por duke folur për këtë çështje, ne duhet të nënkuptojmë ngritjen kulturele, në radhë të parë të rinisë, pjesëmarrjen e saj më të gjerë në aktivitetet kulturele. Ndërmjet rinisë dhe kulturës ka një lidhje shumë të ngushtë. Nga njëra anë, institucionet kulturele zhvillojnë një punë të frutshme me rininë për edukimin e saj ideo-politik dhe kultural, ndërsa, nga ana tjetër, rinia është bërë jo vetëm masa kryesore që merr këtë ushqim, por edhe forca lëvizëse e aktivitetit artistik dhe kultural në fshat. Në të njëjtën kohë nëpërmjet punës së organizuar kulturele me rininë, masat fshatare grumbullohen më lehtë dhe efekti i punës edukative është më i madh. Por në këtë drejtim ka akoma të meta, nuk përdoren sa duhet format e lehta dhe tërheqëse që kombinojnë mirë punën kulturele me atë politike dhe nuk tregohet një kujdes i mjaftueshëm për të organizuar dëfrimin dhe çlodhjen e kulturuar të rinisë. Po kështu, edhe rezervat e mundësitë e mëdha të rinisë dhe të organizatës së saj, BRPSH, nuk përdoren e shfrytëzohen kudo plotësisht për një jetë sa më të kulturuar në fshat.

Është e natyrshme të kërkojmë më shumë nga rinia e fshatit, që ajo të mësojë, të punojë dhe të jetojë në mënyrë të kulturuar, ashtu siç e kërkon rendi i ri socialist. Por në të njëjtën kohë ne duhet të mendojmë për ta ndihmuar atë më tepër dhe t'i krijojmë asaj kushte më të mira pune dhe mësimi, çlodhjeje dhe dëfrimi të kulturuar.

Puna edukative dhe kulturele me rininë e fshatit duhet të shërbejë në të ardhshmen edhe më shumë për të rrënjosur në ndërgjegjen e saj dashurinë për punën e pronën e përbashkët dhe për ta lidhur atë me jetën e fshatit. Nuk është aspak e hijshme

që në fshatrat e Dropullit, të Himarës e gjetkë, takohen akoma të rinj që sillen poshtë e përpjetë dhe mendojnë se «puna e fshatit u përket vetëm grave», sipas zakonit të dikurshëm, kur burrat, për të mbajtur familjen, ishin të detyruar të emigronin. Tani ajo kohë ka kaluar për të mos u kthyer më kurrë. Rinia, edhe pasi të mësojë ose të kryejë shërbimin ushtarak, duhet të kthehet në fshat dhe të punojë për ta bërë këtu jetën sa më të gëzueshme.

Natyrisht, sot për sot jeta në qytet është më e pasur se në fshat në aktivitetet politike, shoqërore, kulturele etj. Por mund të themi dhe një gjë tjetër: edhe në fshat këto po bëhen e mund të përmirësohen akoma. Veç kësaj, romantikën e fshatit s'e gjen dot në qytet. Kujtoni se me ç'nostalgji i kënduan atij Naimi, Çajupi etj. Sigurisht, romantika duhet ditur, zbuluar, kuptuar, shfrytëzuar, ndryshe jeta në fshat mund të duket e të bëhet e mërziqshme. Ja këtu, në zbulimin, bile do të thosha në organizimin e kësaj romantike rinia e fshatit duhet të luajë një rol të dorës së parë. Ku ka më bukuri se me punë të palodhur, nga balta t'u japësh jetë bimëve, pemëve, të krijosh ato pa të cilën njerëzit s'rrojnë dot? Ku ka më bukuri se në vend të shtëpive, stallave, rrugëve të vjetra të ngresh të reja? Ku ka më mrekulli që pas punës të lexosh libra e të mësosh, të mblidhesh tok me shokët e shoqet e t'ja marrësh këngës në shtëpinë e vatrën e kulturës, apo në hije të rrapit shekullor, buzë përroit me ujë të kristaltë, kur përpara syve të shtrihen panorama mahnitëse? Dhe sa e sa mundësi të tjera ka sot në fshatin tonë! Rinia, në radhë të parë, është zot i këtij thesari, ajo mund të bëjë që atë ta shijojë jo vetëm ajo, por të gjithë fshatarët. Prandaj, me vullnetin e saj të çelniqtë, të luftojë, nën udhëheqjen e Partisë, për ta bërë fshatin sa më të pasur e të bukur; atje është një nga frontet më të lavdishme ku me vrull të ri mund të shpërthejnë energjitë e saja krijuese, patriotizmi dhe heroizmi në luftën për ndërtimin e plotë të socializmit. Nga ana tjetër, edhe organizata e Partisë dhe ajo e rinisë, kryetari i kooperativës bujqësore dhe vatra e kulturës në fshat duhet të mendojnë për dëfrimin e rinisë, jo vetëm në kohën më pak të ngarkuar me punë, por edhe në valën më të madhe të punëve bujqësore. Edhe në këto periudha ata duhet të sigurojnë për rininë një film, të organizojnë një mbrëmje dëfrimi ose një ndeshje sportive. Duke vepruar kështu, rinia do të lidhet më tepër me punën dhe te ajo nuk do të gjejë vend mendimi se vetëm në qytet ka jetë të kulturuar, ka vend për dëfrim.

Dihet se për formimin fizik të njeriut dhe ruajtjen e shëndetit të tij një rol të veçantë luajnë fiskultura dhe sporti. Prandaj Partia ka kërkuar kurdoherë zhvillimin e tyre të gjithanshëm në masat fshatare. Në fakt në këtë drejtim, veçanërisht këta vjetët e fundit, është bërë një hap i madh përpara. Vlen të përmën-

det këtu organizimi i Spartakiadës së parë kombëtare të kooperativave bujqësore, ku u aktivizuan 60 000 vetë, nga të cilët 12 500 vajza, u ndërtuan 165 fusha sportive dhe u përgatitën mbi 3 000 sportistë të kategorizuar. Tani janë krijuar të gjitha mundësitë objektive për zhvillimin edhe më të shpejtë të fiskulturës dhe të sportit në fshat. Mbetet që këto mundësi të shfrytëzohen më shumë e më mirë nga organizatat e rinisë, të cilat, të ndihmuara edhe nga komiteti i fiskulturës dhe i sportit, t'i çojnë më përpara, t'i bëjnë më masive këto aktivitete, që gjithnjë janë mirëpritur dhe mirëpritur nga fshatarësia. Në fshatin tonë në të kaluarën kanë qenë zhvilluar shumë lojna, si kalaja dibrance, vrapimi, mundja, ecja maleve, noti etj., etj., të cilat i argëtonin fëmijët e të rinjtë, i kalitnin e i forconin. Është detyrë e organeve të fiskulturës, shkollave dhe organizatave të rinisë që t'i ruajnë dhe t'i zhvillojnë këto lojna, duke i organizuar më mirë dhe duke i përhapur më shumë.

Përhapja e kulturës në fshat dhe forcimi i karakterit të saj masiv lidhen ngushtë me zhvillimin harmonik të të gjithë sektorëve të kulturës me pjesëmarrjen e të gjithë fshatarësisë në këto aktivitete, pavarësisht nga mosha dhe gjinia. Ne kemi arritur mjaft rezultate të mira në këtë drejtim. Puna e kryer nga organizatat e Partisë, i ka dhënë një hov të madh, të padëgjuar më parë, lëvizjes artistike amatore, përhapjes së librit etj. Sot në fshat veprojnë 5 500 grupe artistike me mbi 53 000 amatorë, 860 biblioteka me mbi 450 000 libra, përveç bibliotekave personale, që tanimë kanë filluar të hyjnë në familjet fshatare.

Megjithatë, jo kudo dhe kurdoherë është zbatuar drejt orientimi i Partisë për të zhvilluar në mënyrë harmonike të gjithë sektorët e kulturës në fshat. Si rrjedhim, ndërsa lëvizja artistike amatore dhe fiskultura janë zhvilluar relativisht mirë, lëvizja për përhapjen dhe leximin e librit është më prapa dhe akoma më prapa jemi me lëvizjen për një jetesë më të kulturuar në familje dhe në shoqëri. Është e vërtetë se trashëgimi ynë i pasur muzikor e koreografik, këngët, vallet dhe kostumet janë një bazë e shëndoshë që e lehtësojnë zhvillimin e shpejtë të lëvizjes artistike të amatorëve, ndërsa është më e vështirë ta mësosh fshatarin të lexojë libra, ose të ndryshojë mënyrën e tij të jetesës. Por kjo rrethanë nuk duhet t'i tërheqë organizatat e Partisë dhe organet shtetërore pas aktiviteteve kulturore të lehta e me bujë dhe të lënë pas dore zhvillimin e sektorëve të tjerë të kulturës, ku puna është më e vështirë dhe rezultatet nuk duken aq shpejt.

Në zhvillimin e harmonishëm të sektorëve të kulturës në fshat një rëndësi të veçantë ka sigurimi dhe përdorimi i drejtë i fondeve dhe i bazës materiale. Në këtë çështje ne gjithmonë duhet të udhëhiqemi nga fjala e urtë popullore «të shtrijmë këmbët sa kemi jorganin», me fjalë të tjera, zgjerimi i fondeve dhe bazës

materiale të kulturës të bëhen në përpunime të plotë me të ardhurat dhe mundësitë që kanë kooperativat bujqësore. Natyrisht, për këto çështje duhet të ndihmojë patjetër edhe shteti, i cili në të ardhshmen duhet të angazhohet më tepër dhe të marrë në dorë më mirë veçanërisht plotësimin e nevojave të fshatit me mjetet e kulturës, sikurse janë veglat muzikore, pajisjet e sportit dhe fiskulturës, literatura e thjeshtë dhe e domosdoshme për zhvillimin e lëvizjes amatore kulturore-artistike etj.

Megjithatë, në kushtet e tanishme të fshatit duhet të shfrytëzohet me efikasitetin më të madh baza materiale ekzistuese dhe puna kulturore të mbështetet kryesisht mbi parimin e vullnetarizmit, në pjesëmarrjen sa më të gjerë të fshatarësisë. Në këtë kuptim duhet t'i japim fund sa më parë praktikës së deritanishme, kur pjesëmarrësit e aktiviteteve kulturore, fiskulturale dhe sportive shpërblehen me ditë-pune nga kooperativa. Nga ana tjetër është e nevojshme që organet përkatëse, brenda këtij viti, të caktojnë disa normativa, të cilat të shërbejnë si kritere të domosdoshme për pajisjet kulturore, shpërblimin e kuadrove të shtëpive dhe vatrave të kulturës dhe për masën e kontributit që mund të japin shteti dhe vetë kooperativat bujqësore.

Zhvillimi i të gjithë sektorëve të kulturës në fshat do të bëhet më me sukses, në qoftë se, përveç masave të mësipërme, edhe qyteti do t'i japë fshatit në të ardhshmen një ndihmë më të madhe dhe të vazhdueshme. Kjo ndihmë duhet të drejtohet dhe të organizohet më mirë nga Partia dhe pushteti në rreth, e për këtë qëllim duhet të aktivizohen të gjitha institucionet ekonomike e kulturore të qytetit.

Deri më sot ndërmarrjet ekonomike dhe institucionet kulturore të qytetit e kanë ndihmuar fshatin kryesisht me anën e patronazhit. Kjo është një formë e mirë, veçse ndihma e dhënë nëpërmjet saj, në përgjithësi, ka qenë e pamjaftueshme, e paorganizuar mirë dhe e rastit. Në të ardhshmen forma e patronazhit duhet të zgjerohet, të organizohet, të drejtohet dhe të kontrollohet më mirë. Ndërmarrjet ekonomike dhe institucionet e tjera të qytetit duhet ta bëjnë rregull që t'i japin fshatit në patronazh një ndihmë sistematike, duke dërguar më shumë e më shpesh brigada kulturore, teknike e specialistë, të cilët, krahas zhvillimit të aktivitetit kultural, t'i mësojnë masat fshatare edhe për organizimin e një mënyre jetese më të kulturuar, për një administrim më të mirë e më racional të pasurisë që ato kanë.

Qyteti duhet ta ndihmojë fshatin edhe në drejtime të tjera. Veçanërisht një mjet i rëndësishëm për edukimin dhe dëfrimin e kulturuar të fshatarësisë është kinemaja. Sot autokinetat dhe kinematë lëvizëse kanë hyrë edhe në zonat më të thella malore të fshatit. Qysh tani rrethet e Gjirokastrës, Shkodrës, Korçës, Sarandës, Durrësit dhe Lushnjës kanë arritur të japin shfaqje

në të gjitha fshatrat, bile edhe atje ku mungojnë rrugët automobilistike. Kjo punë duhet të zgjerohet edhe më shumë në të ardhshmen. Për këtë qëllim Ministria e Arësimit dhe e Kulturës dhe drejtoria e Kinostudios duhet të marrin masa që, duke filluar nga viti 1965, në çdo fshat të shfaqen të gjitha filmat e dokumentarët kryesorë të vendit, si dhe disa herë në vit filma artistikë të përshtatshëm e të kuptueshëm për masat fshatare, duke mos përjashtuar edhe fshatrat më të largëta.

Edhe ushtria mund t'i japë një ndihmë më të madhe fshatit. Ajo ka qenë dhe mbetet një shkollë e madhe edukimi për bijtë e fshatarëve. Çdo vit ajo përgatit nga bijtë e fshatit me qindra shoferë, traktoristë, motoristë, elektrikistë, karpentierë, marangozë etj. dhe zhvillon një aktivitet të gjerë ideo-politik dhe kultural me masat fshatare. Edhe për të ardhshmen të udhëzohen në mënyrë të veçantë repartet e ushtrisë që ta shtojnë edhe më shumë punën e tyre me të rinjtë e fshatit, me qëllim që këta, kur të lirohen nga ushtria të kthehen në fshat, të stabilizohen dhe të përhapin atje të rejtat që kanë mësuar dhe veçanërisht për një mënyrë jetese më të kulturuar.

Por pavarësisht nga masat që përmendëm më sipër, për përhapjen më të gjerë të kulturës në masat fshatare të mbahen parasysh edhe këto detyra:

Së pari, t'i kushtohet një vëmendje e veçantë ngritjes dhe organizimit të shtëpive dhe vatrave të kulturës në ato fshatra ku këto mungojnë. Për këtë qëllim organet përkatëse, brenda vitit 1964, të hartojnë një plan perspektiv për shtrirjen e këtyre institucioneve kulturele në përgjithësi në të gjitha fshatrat e Republikës. Në hartimin e këtij plani të udhëhiqemi nga orientimi që kjo detyrë të zgjidhet dalëngadalë në përputhje me mundësitë tona, por jo më vonë se në vjetët 1970—1975.

Së dyti, për të siguruar një punë më të kualifikuar në shtëpitë dhe vatrave të kulturës në fshat, të konsiderohet si problem kryesor zgjedhja dhe përgatitja e kuadrit të përshtatshëm për këto institucione, që në krye të shtëpive dhe vatrave të kulturës të kemi kuadro me nivelin e nevojshëm arësimesor e kultural. Për këtë qëllim, brenda vitit 1964, të bëhet një studim i plotë mbi numrin e kuadrove që nevojiten për zgjidhjen e kësaj detyre dhe mbi kriteret e shpërblimit të tyre nga shteti e kooperativat bujqësore.

Së treti, nga ana e qytetit të sigurohet një ndihmë sa më e gjerë dhe efektive për fshatin. Prandaj komitetet e Partisë të marrin të gjitha masat që, brenda vitit 1963, të mos mbetet asnjë ndërmarrje ose institucion me rëndësi që të mos ketë në patronazh ndonjë nga fshatrat e rrethit për përhapjen e kulturës në masat fshatare. Ndiham që duhet t'i jepet fshatit nga qyteti të drejtohet e të kontrollohet nga organizatat bazë të Partisë të qen-

drave të punës, të cilat duhet të ndiejnë përgjegjësi për punën e tyre në ndihmë të fshatit.

Së katërti, problemet e përhapjes dhe të zhvillimit të kulturës në fshat të drejtohen drejtpërdrejt nga komitetet e Partisë dhe të rritet përgjegjësia e komiteteve ekzekutive për këto probleme. Seksionet e arësimit-kulturës në rrethe duhet të mbajnë përgjegjësi të plotë për të gjitha problemet e kulturës në fshat; të organizojnë funksionimin e rregullt të vatrave dhe të shtëpive të kulturës dhe të zhvillojnë seminare e kurse me përgjegjësit e tyre. Institucionet kulturele të qytetit, si shtëpitë e kulturës, teatrot, muzeumet, bibliotekat të ndërmarrin një ndihmë konkrete më të madhe e të vazhdueshme në drejtim të fshatit.

Kapitulli V

MBI PUNËN E ORGANEVE TË PARTISË E TË SHTETIT PËR PROBLEMET E MIRËQENJES NË FSHAT

...Partia jonë është forca udhëheqëse dhe drejtuese e gjithë veprimtarisë politike, ekonomike e sociale të vendit. Jeta ka vërtetuar se të gjitha ndryshimet dhe përparimet që ka realizuar populli ynë, qofshin këto të mëdha apo të vogla, janë bërë nën udhëheqjen dhe drejtimin e Partisë. Prandaj edhe plotësimi i programit të punës që ne shtrojmë lidhur me zhvillimin e mëtejshëm socialist të fshatit, varet në një shkallë të madhe nga puna e gjithanshme organizative e Partisë dhe e levave të saja.

Sikurse e theksuam edhe më lart, ne, padyshim, kemi arritur rezultate të mëdha historike në transformimin socialist të fshatit, në ndryshimin e përgjithshëm të pamjeve kryesore të jetës së tij. Por ne jemi të ndërgjegjshëm se në rrugën e përshkuar kemi hasur edhe vështirësi jo të pakta, se në punën e organeve të Partisë, të shtetit dhe të organizatave të masave kemi pasur të meta dhe boshllëqe, që pengojnë ecjen tonë përpara me një hap me ritmet e kohës. Këto të meta janë shfaqur, kryesisht, në vendin e pamjaftueshëm që ka zënë në punën drejtuese të organeve të Partisë dhe të shtetit i gjithë kompleksi i problemeve që lidhen me ngritjen e mënyrës së jetesës në fshat.

Problemet që ne paraqitëm më sipër lidhur me mirëqenjen dhe mënyrën e jetesës në fshat, kërkojnë që edhe puna e organeve të Partisë e të shtetit të ngrihet në një shkallë të re, më të lartë. Që organizatat e Partisë t'u dalin përpara këtyre problemeve, ato duhet të njohin më mirë e më thellë zhvillimin e gjithanshëm socialist të fshatit, detyrat që lindin nga ky zhvillim, si dhe të kërkojnë rrugët për zgjidhjen e tyre. Dhe i gjithë sukcesi

i kësaj pune varet shumë nëse organizatat e Partisë do t'ua bëjnë të qartë këto probleme masave fshatare dhe nëse do t'i mobilizojnë ato në kohë për vënjen e tyre në jetë. Si gjithnjë, edhe në këtë rast forcimi i lidhjeve të Partisë me masat, konsultimi i saj me to, mbetet çelisi kryesor i çdo fitoreje në të ardhshmen.

Përmirësimi i mëtejshëm i drejtimit të Partisë për problemet e ngritjes së mirëqenjes dhe të mënyrës së jetesës në fshat është i lidhur ngushtë me marrjen e masave të mëposhtme:

1. — Të forcojmë më shumë rolin udhëheqës të organizatave të Partisë në fshat

Partia jonë, duke u nisur nga mësimet e marksizëm-leninizmit dhe nga eksperiencia e saj, gjithnjë ka theksuar se për çdo problem, pasi të jetë përcaktuar drejt e qartë vija e Partisë dhe të jenë konkretizuar detyrat, hallka vendimtare për zbatimin e tyre me sukses mbetet kurdoherë roli udhëheqës i organizatave të Partisë, organizimi i punës me njerëzit për vënjen në jetë të kësaj vije. Prandaj, ajo ka kërkuar me këmbëngulje që të forcohet pareshtur roli udhëheqës i organizatave të saja dhe që puna e tyre t'u përshtatet gjithnjë kushteve dhe detyrave të reja.

Rezultatet e arritura në të gjitha drejtimit e jetës në fshat tregojnë se roli udhëheqës i organizatave të Partisë është ngritur vazhdimisht. Mjaft organizata partie po merren seriozisht me problemet më të rëndësishme ekonomike të fshatit dhe kanë filluar të hyjnë edhe në çështjet e mënyrës së jetesës. Organizatat e Partisë të rretheve të Lushnjës e Fierit kanë shqyrtuar disa probleme me karakter social e kultural të fshatit, kanë përcaktuar detyrat për pushtetin e organizatave të masave dhe kanë kontrolluar më mirë zbatimin e tyre.

Mirëpo duhet theksuar se në përgjithësi veprimtaria e organizatave të Partisë në fshat ka qenë e njëanshme dhe thaujse tërësisht për problemet e prodhimit. Natyrisht, është mirë, bile shumë mirë që organizatat e Partisë në fshat po orientohen drejt lidhur me problemet e prodhimit bujqësor. Por fakti që ekipet nuk gjetën në mjaft fshatra gjurmë të një pune serioze për problemet e mënyrës së jetesës, vërteton se organizatat e Partisë në fshat janë marrë pak me drejtimin e këtyre problemeve dhe prandaj lind nevoja e domosdoshme që në të ardhshmen ato t'i udhëheqin më mirë edhe këto çështje.

Ne kemi në fshat një ushtri të tërë komunistësh, e cila po të drejtohet mirë, është në gjendje të zgjidhë me sukses të gjitha problemet e mënyrës së jetesës, sado të vështira dhe të ndërlikuara të jenë ato. Për këtë ekzistojnë të gjitha mundësitë.

Atëhere ku qëndron e keqja? S'ka dyshim se kjo e metë e ka burimin në faktin që organizatat e Partisë në fshat, duke u tërhequr pas problemeve të prodhimit, nuk i njohin sa duhet problemet e mënyrës së jetesës.

Prandaj, komitetet dhe organizatat e Partisë duhet të luftojnë për t'i njohur më mirë këto probleme, të mobilizohen dhe të qëndrojnë në krye të punës për zgjidhjen e tyre. Por që kjo detyrë të kryhet me sukses, në radhë të parë duhet të forcohet bindja e ndërgjegjja e komunistëve për mundësitë dhe për nevojën e ngritjes së mënyrës së jetesës në fshat dhe të jenë ata, së bashku me familjet e tyre, që të japin shembullin personal për futjen e së resë në këtë drejtim. Duke qenë komunistët të bindur e të ndërgjegjshëm për detyrën që u ngarkohet në lidhje me ngritjen e mënyrës së jetesës, vetëm atëhere do të jenë në gjendje të sigurojnë rolin e tyre udhëheqës për zgjidhjen e detyrave të reja që Partia shtron sot para tyre.

2. — Të ngremë më lart udhëheqjen e Partisë në organet e pushtetit dhe në organizatat e masave

Që organizatat e Partisë në fshat t'i kryejnë mirë detyrat ato duhet të sigurojnë udhëheqjen e përditshme mbi levat e tyre, mbi organet e pushtetit dhe organizatat e masave.

Për zgjidhjen e detyrave të shumta lidhur me mënyrën e jetesës, një rol shumë të madh dhe me rëndësi luajnë organet e pushtetit. Pas kolektivizimit të bujqësisë, roli i këshillave popullore dhe i komiteteve të tyre ekzekutive në rrethet, lokalitetet e në bazë jo vetëm nuk dobësohet, por përkundrazi, shtohet.

Megjithatë, niveli i punës së organeve të pushtetit nuk u përgjigjet sa duhet kërkesave të reja të drejtimit të problemeve të fshatit. Mjaft këshilla popullore të rretheve, lokaliteteve dhe fshatrave, si dhe komitetet e tyre ekzekutive, merren tani kryesisht me probleme operative që lidhen me përballimin e kësaj ose asaj fushate ekonomike, por nuk studjojnë mirë e thellë problemet që kanë të bëjnë me perspektivën e zhvillimit të mënyrës së jetesës, të arësimit, të kulturës, të shërbimeve komunale, të artizanatit dhe të shëndetësisë. Ka ardhur koha që këto probleme të drejtohen drejtpërdrejt nga organet e pushtetit dhe të mos i lihen pothuajse rrjedhjes së natyrshme të gjërave, sikurse ka ndodhur deri tani. Janë organet e pushtetit ato që, të udhëhequra nga Partia, mund dhe duhet të merren kryesisht me zgjidhjen e të gjitha problemeve që kanë të bëjnë me jetesën në fshat.

Natyrisht, për zgjidhjen e problemeve të mënyrës së jetesës organizatat e Partisë në fshat duhet të aktivizojnë gjerësisht orga-

nizatat e masave, dhe sidomos atë të Frontit, të gruas dhe të rinisë. Deri më sot organizata e gruas ka bërë përpjekje të mira dhe ka marrë disa iniciativa të vlefshme për jetesën në fshat. Përsa i përket organizatës së rinisë, është e vërtetë se puna e saj ka ndihmuar mjaft për përhapjen e lëvizjes artistike, kulturele e fiskulturale diletante, por ajo nuk ka prekur thuajse fare problemet e tjera të mënyrës së jetesës. Sikur vetëm rinia të ishte mobilizuar për të përmirësuar mënyrën e fjetjes, të ngrënjes, të veshmbathjes e shumë të tjera si këto, me siguri përpaketimet në pamjet e ndryshme të jetës së fshatit do të ishin më të mëdha.

Prandaj, problemet e mënyrës së jetesës duhet të zënë një vend të rëndësishëm në të gjithë punën dhe veprimtarinë e organizatave të masave. Duke zhvilluar më tej traditat e periudhës së luftës dhe të pasqirimit, organizata e rinisë dhe ajo e gruas duhet të kontribuojnë më shumë për zgjidhjen e problemeve të ndryshme të mënyrës së jetesës në fshat. Të rinjtë dhe të rejtat duhet të jenë në ballë të luftës për të përmbysur gjithshka të vjetëruar që pengon ecjen përpara të jetës së re socialiste, hovin revolucionar të rinisë.

3. — Të intensifikojmë punën ideo-politike për problemet e jetesës në fshat

Puna ideo-politike e Partisë në fshat, veçanërisht vjetët e fundit, ka shënuar një ngritje të fuqishme. Si rrjedhim i kësaj pune, pjekuria dhe interesimi i masave fshatare për ngjarjet politike ndërkombëtare e të brendshme janë rritur shumë. Ne konstatojmë me kënaqësi se masat fshatare kanë kuptuar dhe mbështetur gjithnjë vijën e përgjithshme të Partisë dhe qëndrimin e saj të drejtë për të gjitha çështjet e politikës së jashtme dhe të brendshme, për të gjitha çështjet e luftës që ajo bën sot kundër imperializmit dhe revizionizmit modern, për mbrojtjen e interesave të larta të atdheut, për mbrojtjen e pastërtisë së marksizëm-leninizmit, të paqes, demokracisë dhe socializmit në botë.

Por, ndërsa për problemet e mësipërme organizatat e Partisë kanë bërë një punë të madhe, puna e tyre ideo-politike për çështjet e jetesës ka qenë e kufizuar. Në përgjithësi komitetet dhe organizatat bazë të Partisë, në punën e tyre me masat e fshatarësisë, shumë pak kanë trajtuar probleme që lidhen me anët e ndryshme të jetesës në fshat. Kjo e metë e punës ideo-politike të Partisë ka bërë që përmirësimi i mënyrës së jetesës në fshat të ketë mbetur prapa transformimeve të tjera socialiste që janë kryer atje.

Jeta ka vërtetuar se asnjë ndryshim i thellë e rrënjësor nuk mund të arrihet po qe se masat nuk përgatiten ideologjikisht,

nuk bëhen të vetëdijshme për nevojën e këtij ndryshimi. Marksizëm-leninizmi na mëson se bindja ideologjike e masave punonjëse është një ndër forcat më të mëdha materiale për çdo përpaktim të jetës shoqërore. Prandaj, për të siguruar zbatimin me sukses të detyrave që ne shtrojmë tani, duhet, në radhë të parë, të forcojmë punën ideo-politike të Partisë lidhur me problemet e jetesës në fshat. Kjo punë duhet të jetë e gjithanshme. Ajo duhet të synojë në sqarimin, organizimin dhe mobilizimin e masave fshatare dhe t'i bindë ato për t'u hedhur në aksione konkrete, që lidhen me masat e shumta që u paraqitën në këtë raport.

Është e padiskutueshme, dhe ne jemi të bindur, se suksesi dhe qëndrueshmëria e rezultateve të punës së Partisë dhe aktivizimi i gjerë i masave varen dhe përcaktohen nga fuqia e punës ideologjike e bindëse që do të bëhet lidhur me të gjitha detyrat që shtrohen sot për ngritjen e mirëqenjes dhe të jetesës në fshat.

Shokë dhe shoqe,

Këto janë problemet më të rëndësishme që lindin nga zhvillimi objektiv i sotëm dhe perspektiv i fshatit, lidhur me përmirësimin e gjendjes së tij ekonomike, sociale e kulturele dhe që Byroja Politike e quajti me vend e të kohës t'ja paraqesë këtij Plenumi të Komitetit Qendror.

Analiza e këtyre problemeve nxjerr në dritë edhe një herë drejtësinë e vijës së përgjithshme të Partisë sonë për të gjitha çështjet e ndërtimit socialist në fshat, fitoret e mëdha që janë arritur dhe transformimet e thella revolucionare që janë kryer. Në sajë të zbatimit konsequent të kësaj vije, sot në fshat ka lindur një jetë e re, jeta socialiste, dhe gjendja materiale e kulturele e fshatarësisë ka pësuar ndryshime aq të mëdha, saqë ato nuk mund të krahasohen me të kaluarën. Në sajë të kësaj vije, edhe në fshat po shohim sot njeriun e ri, njeriun e epokës së socializmit, që Partia po e pajis dhe kalit me virtytet e larta të moralit komunist, atë njeri që, nën udhëheqjen e Partisë, po krijon në mënyrë të ndërgjegjshme historinë e lavdishme të atdheut tonë të dashur.

Detyra historike e Kongresit IV të Partisë për ndërtimin e plotë të socializmit, i ka çelur fshatit, si gjithë vendit tonë perspektivën e shkëlqyer për një zhvillim të ri, të fuqishëm. Plani i tretë pesëvjeçar, i cili mishëron hapin tonë të parë të kësaj perspektive, po plotësohet me sukses.

Problemet që paraqiten në këtë raport, i përkasin si të tanishmes ashtu edhe të ardhshmes së fshatit tonë socialist. Ato janë një program konkret dhe rrugë e pashmangshme e zhvillimit objektiv të fshatit në etapën e re të ndërtimit socialist. Partia është e bindur se kjo është e vetmja rrugë reale që e bën të mundur shpejtimin e ritmeve të ngritjes së mirëqenjes e të mënyrës

së jetesës të fshatarësisë, ngushtimin e ndryshimit esencial midis fshatit dhe qytetit. Duke ecur në këtë rrugë jeta e fshatit do të bëhet më e bukur dhe më e begatshme.

Detyrat që do të dalin nga ky plenum për ngritjen e mëtejshme të gjendjes ekonomike, sociale e kulturele të fshatit janë të mëdha, por Partia është e bindur se ato janë plotësisht të mundshme për t'u realizuar. Suksesi i realizimit të tyre përcaktohet nga fakti se ato mbështeten në mësimet ngadhnyese të marksizëm-leninizmit, në kushtet konkrete të vendit tonë dhe në epërsinë e rendit socialist, që është krijuar në fshat dhe në qytet, në forcën krijuese dhe patriotizmin e flaktë të popullit tonë, në besimin e patundur që kanë masat për vijën gjithmonë të drejtë të Partisë.

Detyrat lidhur me ngritjen e mëtejshme materiale e kulturele të fshatit kërkojnë që komitetet e Partisë dhe organizatat e masave dhe të pushtetit në rreth të hartojnë programe e plane pune për zbatimin e tyre konkret, në shkallë rrethi dhe fshati, duke analizuar herë pas here rezultatet e arritura dhe duke caktuar masat e tjera të nevojshme që duhen marrë. Gjithashtu, është e nevojshme që Këshilli i Ministrave i RPSH, ministrinë dhe organet e tjera qendrore të Partisë dhe të shtetit të hartojnë planet e tyre të punës dhe të ndërmarrin studime përkatëse që lindin nga zbatimimi i detyrave që shtrun ky plenum.

Gjatë shqyrtimit të gjendjes ekonomike, sociale e kulturele të fshatit ne paraqitëm disa nga kontradiktat më kryesore, që karakterizojnë zhvillimin e tij në etapën e sotme. Ato e kanë burimin në realitetin objektiv, në ligjet e zhvillimit të shoqërisë sonë dhe, si të tilla, ato janë të pashmangshme. Detyra jonë është që këto kontradikta t'i zbulojmë, t'i njohim thellë shkaqet e lindjes së tyre, dhe, duke u mbështetur fort në kushtet konkrete të ndërtimit tonë socialist, të përcaktojmë drejt rrugët më të efektshme për kapërcimin e tyre të shpejtë. Njohja dhe zgjidhja e tyre e drejtë përbëjnë një forcë lëvizëse që ndihmon dhe shpejton ecjen tonë përpara, ajo është një kusht i domosdoshëm për të përdorur me sukses ligjet ekonomike të socializmit, për të mos gabuar në praktikë.

Ne jemi gjithashtu të vetëdijshëm se kapërcimi i kontradiktave të sotme do të shpjerë patjetër në lindjen e kontradiktave të reja, se misioni ynë historik për ta çuar vendin gjithnjë përpara drejt majave të larta të socializmit dhe të komunizmit, do të ndeshet vazhdimisht në kontradikta joantagoniste. Por ne jemi të bindur se Partia jonë do të dijë të gjejë kurdoherë drejt rrugën e kapërcimit të tyre dhe do t'i udhëheqë me sukses masat punonjëse për ndërtimin e plotë të socializmit, sepse ajo ndriçohet vazhdimisht dhe mbështetet fuqimisht në idetë ngadhnyjtare të Marksit, Engelsit, Leninit e Stalinit.

Fitoret e deritanishme dhe detyrat e reja që po shtrojmë sot, të cilat e kanë burimin dhe mbështeten tërësisht në vijën largpamëse të Partisë sonë, tregojnë edhe një herë sa në rrugë të drejtë jemi, sa me realizëm, mençuri e guxim vepron Partia në çdo fushë dhe në çdo kohë. Situatat e vështira që mundohen të na krijojnë dhe lufta që na bëjnë imperialistët dhe veglat e tyre — revizionistët e grupit Hrushov-Tito etj. — nuk e pengojnë dot Partinë tonë ta hedhë, si kurdoherë, hapin të matur e të sigurtë. Ne marshojmë përpara. Marksizëm-leninizmi, që revizionistët modernë e luftojnë hapur ose e shtrembërojnë fshehurazi, do t'i dërmojë pa mëshirë. Kurse për Partinë tonë, që bazohet fort në marksizëm-leninizmin, që i qëndron atij besnike për jetë dhe e zbaton në mënyrë me të vërtetë krijuese në çdo drejtim, fitoret do të jenë të pashmangshme.

Shokë, Byroja Politike e Komitetit Qendror, duke i paraqitur këtë problem plenumit, ka besim të plotë se ai do të kurorëzohet me sukses dhe do t'i sjellë një shërbim akoma më të madh ngritjes së mirëqenjes së fshatarësisë dhe të gjithë popullit tonë. Tërë historia e Partisë sonë ka vërtetuar se çdo gjë, që ajo ka ndërmarrë, pavarësisht nga pengesat dhe vështirësitë, e ka çuar deri në fund, nga që u është përgjegjur gjithmonë aspiratave dhe interesave jetike të masave punonjëse dhe ka gjetur përkrahjen e tyre të pakufishme. Edhe detyrat që do të caktojë ky plenum, janë për të mirën e fshatarësisë dhe të të gjithë popullit tonë, shprehin aspiratat dhe idealet e tyre. Prandaj, Partia ta marrë mirë në dorë drejtimin e këtyre çështjeve, ajo të zgjojë gjithnjë e më shumë dhe të udhëheqë drejt e me urtësi vazhdimisht veprimtarinë e ndërgjegjshme të masave të fshatit e të qytetit dhe të të gjitha organizatave, institucioneve e organeve politike, ekonomike, shoqërore e shtetërore, në mënyrë që të gjitha përpjekjet të përqëndrohen drejt objektivave të caktuara.

Ne jemi të sigurtë që, si kurdoherë, edhe kësaj radhe masat punonjëse të fshatit dhe të qytetit do t'i përgjigjen me punë vetëmohuese thirrjes së Partisë, për të vënë në jetë detyrat e reja që shtrun ky plenum për fshatin, duke korrur kështu një fitore të re në luftën për realizimin e planit të tretë pesëvjeçar, të perspektivës së ndritur që ka çelur para popullit dhe vendit tonë Kongresi i IV i Partisë, në rrugën e gjatë, por të lavdishme, të ndërtimit të socializmit e të komunizmit.

*Botohet sipas librit:
Enver Hoxha «Mbi gjendjen
ekonomike, sociale e kulturele
të fshatit dhe masat për ngritjen
e mëtejshme të saj».
Tiranë, 1963*

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Zëri i Popullit»
Nr. 137, 9 qershor 1963*

V E N D I M

I PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH MBI APROVIMIN E RAPORTIT «MBI GJENDJEN EKONOMIKE, SOCIALE E KULTURALE TË FSHATIT DHE MASAT PËR NGRITJEN E MËTEJSHME TË SAJ»

8 qershor 1963

Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH në mbledhjen e tij të datës 6-8 qershor 1963, pasi dëgjoji dhe diskutoi raportin e Byrosë Politike «Mbi gjendjen ekonomike, sociale e kulturele të fshatit dhe masat për ngritjen e mëtejshme të saj», mbajtur nga Sekretari i Parë i Komitetit Qendror të PPSH, shoku Enver Hoxha,

V e n d o s i :

Të aprovojë njëzëri raportin e mësipërm si program pune për përmirësimin e vazhdueshëm dhe për ngritjen e mëtejshme të nivelit ekonomik, social dhe kultural të fshatit.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë

Botuar për herë të parë në
gazetën «Zëri i Popullit»,
Nr. 137, 9 qershor 1963.

PLENUMI XI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Tiranë, 13-14 dhjetor 1963

K O M U N I K A T Ë

MBI MBLEDHJEN E PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË

Më 13—14 dhjetor 1963 zhvilloi punimet e tij Plenumi i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë nën kryesinë e Sekretarit të Parë të Komitetit Qendror të PPSH, shokut Enver Hoxha.

Me propozimin e shokut Enver Hoxha plenumi mbajti një minutë heshtje për humbjen e parakohshme të anëtarit të Komitetit Qendror të PPSH, shokut Josif Pashko.

Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH dëgjoji dhe shqyrtoi raportin e Byrosë Politike «Mbi forcimin e mëtejshëm të Partisë», të mbajtur nga anëtari i Byrosë Politike dhe sekretar i Komitetit Qendror të PPSH, shoku Rita Marko.

Në punimet e plenumit muarën pjesë edhe sekretarët e parë të komiteteve të Partisë të rretheve, sekretarët që drejtojnë sektorin e punës organizative të Partisë në komitetet e Partisë të rretheve, përgjegjës kryesorë të punës së Partisë në forcat e armatosura, shefa të sektorëve të organizimit në komitetet e Partisë në rrethe, punonjës të aparatit të Komitetit Qendror të PPSH, të organizatave të masave etj.

Në plenum, Sekretari i Parë i Komitetit Qendror të PPSH, shoku Enver Hoxha mbajti një fjalim të rëndësishëm lidhur me detyrat mbi forcimin e mëtejshëm të Partisë, të rolit të saj udhëheqës, si dhe mbi disa çështje të gjendjes ndërkombëtare.

Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH aprovoi njëzëri raportin e Byrosë Politike dhe detyrat e përcaktuara në të për forcimin e mëtejshëm të Partisë, të punës së saj organizative, në përshtatje me detyrat e sotme.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

RAPORT

I BYROSE POLITIKE TË KQ TË PPSH «MBI FORCIMIN E MËTEJSHËM TË PARTISË»

13 dhjetor 1963

Shokë,

Kongresi IV i Partisë dhe plenumet e mëvonshme të Komitetit Qendror kanë përcaktuar një program të madh pune për një periudhë të caktuar të ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste. Ky program synon shpejtimin e ritmeve për ngritjen e bazës materialo-teknike të socializmit, rritjen e mirëqenjes ekonomike e shoqërore dhe të nivelit kultural të popullit tonë. Puna e madhe drejtuese, edukuese e organizuese e Partisë, hovi dhe mobilizimi i paparë në punë, që ka përfshirë të gjithë punonjësit tanë, po e kthejnë çdo ditë e më mirë këtë program në realitet, po bëjnë të kapërcehen pengesat e vështirësitë e krijuara nga armiqtë dhe, krahas me këtë, të dërmohen planet e shpresat e tyre. Për të vazhduar më tej me sukses këtë rrugë, për të ecur kurdoherë përpara në ndërtimin socialist, detyra e parë është forcimi i mëtejshëm e i vazhdueshëm ideologjik e organizativ i Partisë, rritja e rolit të saj drejtues, rritja e aftësive luftarake të organizatave të Partisë.

Eksperienca historike ka vërtetuar plotësisht rëndësinë jetike që kanë për fitoren e socializmit e të komunizmit partia politike e klasës punëtore si dhe parimet e normat e ndërtimit organizativ dhe të jetës së saj të brendshme.

Pastërtia dhe uniteti i radhëve të partisë, gjallëria, fryma revolucionare e organizatave të saja, organizimi i shëndoshë dhe rritja e veprimtarisë së të gjithë anëtarëve të partisë, në bazë të centralizmit demokratik e të disiplinës së çelniqtë, lufta e pamëshirshme dhe e papajtueshme kundër të gjithë armiqtë, deviatorëve, oportunistëve, kapitulluesve e likuidatorëve janë faktorë të tillë vendimtarë, pa të cilët as nuk mund të mendohet roli udhëheqës i partisë, pa të cilët nuk mund të shpihet përpara çështja e klasës punëtore.

Qëllimi i punës organizative është që partia, si reparti pararojë dhe i organizuar i klasës punëtore, si armë e diktaturës së proletariatit, të jetë kurdoherë revolucionare dhe e re, e bashkuar me një disiplinë e vullnet të vetëm, të jetë e papajtueshme me fraksionizmin e oportunizmin, e zonja për të kryer si duhet e me sukses, në çdo situatë, detyrat e shumta që ka.

Në etapën e sotme të ndërtimit socialist të vendit është e domosdoshme të shqyrtojmë thellësisht, në bazë të kritereve të shëndosha e shkencore, gjendjen e punës organizative të Partisë, në

mënyrë që të përcaktojmë masa të drejta, të tilla që të sigurojnë një përparim të vazhdueshëm të punëve, që të ngrenë gjithnjë më lart rolin udhëheqës të Partisë, rolin pararojë të anëtarëve të saj.

Kongresi IV i Partisë shënoi një hap të rëndësishëm përpara për ngritjen në një nivel më të lartë të punës organizative të Partisë. Fryma luftarake, besimi i patundur dhe gatishmëria për zbatimin e vendimeve, që u shprehën me aq zjarr në Kongresin IV të Partisë, janë mbajtur kurdoherë gjallë dhe kanë marrë një zhvillim të mëtejshëm në tërë Partinë. Është rritur në mënyrë të dukshme interesimi për çështjet që kanë të bëjnë me forcimin organizativ të Partisë. Një punë më e thelluar, më e afërt e më e gjallë ka karakterizuar, në këtë drejtim, veprimtarinë e organeve udhëheqëse të Partisë. Në qendër të vëmendjes së Komitetit Qendror të Partisë ka qenë forcimi e gjallërimi i mëtejshëm i jetës së brendshme të Partisë, rritja e veprimtarisë dhe kalitja e anëtarëve të saj, rritja e rolit dhe e nivelit të organizatave të Partisë dhe të organeve të saj udhëheqëse, forcimi i vazhdueshëm i radhëve të Partisë, i përbërjes së saj. Komiteti Qendror ka mbajtur kurdoherë një qëndrim të drejtë e parimor, ka luftuar me këmbëngulje çdo shfaqje të huaj që mund të dobësojë sado pak aftësinë luftarake të organizatave të Partisë, çdo gjë që pengon zhvillimin e rregullt e të shëndoshë të jetës së Partisë, që nuk shkon krahas me rritjen e rolit e të nivelit të punës së organizatave të saja. Në çdo situatë Komiteti Qendror është mbështetur fort në veprimtarinë e gjallë të Partisë, në dinamizmin bolshevik të anëtarëve të saj. Dhe kjo ka qenë dhe është e vetmja rrugë e drejtë. Problemet më të rëndësishme e preokupante, siç janë ato që kanë të bëjnë me luftën për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit kundër tradhëtisë së N. Hrushovit dhe të atyre që e pasojnë, udhëheqja e Partisë i ka shtruar haptazi para të gjitha organizatave të saja. Në fakt ky ishte një diskutim i gjerë, i përgjithshëm në Parti, që solli jo vetëm një aprovim unanimit të vijës së drejtë marksiste-leniniste, por siguroi një qëndrim unik, të qartë e të vendosur nga e gjithë Partia e nga i gjithë populli.

Në tani mund të ritheksojmë me forcë rezultatet e vijës së përgjithshme të drejtë të Partisë, të qëndrimit heroik, të luftës parimore të saj në të gjitha fushat e drejtimeve, të zbatimit konsequent të parimeve marksiste-leniniste të ndërtimit të Partisë, të marrëdhënjeve të saja të drejta me masat, dhe që këtej të nxjerrim në pah përsëri karakteristikat e saja themelore: së pari, uniteti i çelniqtë e luftarak i mendimit dhe i veprimit në Partinë tonë është tani më i fortë se kurrë dhe përbën karakteristikën më dalluese të saj; së dyti, lidhjet e Partisë me masat punonjëse janë gjithashtu më të ngushta se kurrë; këto lidhje të pathyeshme përbëjnë karakteristikën më dalluese të jetës në vendin tonë socialist. Ky realitet i shkëlqyer gjen pasqyrimin dhe shprehjen e

tij më të mirë në heroizmin e komunistëve dhe të masave punonjëse në të gjithë vendin për kryerjen e detyrave e për kapërcimin e vështirësive e të pengesave të ndryshme, në mobilizimin dhe në iniciativat e shumta të tyre për ta shpënë përpara në çdo fushë ndërtimin tonë socialist. Karakteristikat e mësipërme janë bërë një forcë kolosale, para së cilës kanë gjetur e do të gjejnë varrin të gjitha komplotet, diversionet e orvatjet djallëzore të imperialistëve dhe të shërbëtorëve të tyre besnikë, revizionistëve modernë.

Duke zbatuar me konsekuencë parimet organizative marksiste-leniniste, Partia jonë si parti e tipit të ri, që mishëron të re në përparimtare dhe punon në mënyrë krijuese, ka mbajtur gjithnjë parasysh kushtet konkrete në të cilat vepron, çështjet që dalin gjatë ndërtimit me sukses të socializmit në vendin tonë e në përputhje me to ka ndërtuar tërë punën e saj. Puna organizative e Partisë, ndërtimi e jeta e saj nuk qëndrojnë në vend. Përkundrazi, ato ecin kurdoherë përpara, disa forma organizative vjetërohen dhe ua lënë vendin të reja. Realizimi i vijës së Partisë, qëndrueshmëria e fitoreve dhe e sukseseve të saj varen në një shkallë të madhe nga puna organizative e Partisë, dhe sa u për-gjigjet niveli i kësaj pune detyrave të kohës që shtron vija e përgjithshme e Partisë.

Si në të gjitha fushat e veprimtarisë edhe në punën organizative, eksperiencia e Partisë sonë është tashmë mjaft e pasur. Studimi e përgjithësimi shkencor marksist-leninist i kësaj eksperiencie, i problemeve që nxjerr jeta e gjallë e organizatave të Partisë, lidhja e ngushtë e punës organizative me problemet që preokupojnë Partinë, përcaktimi i masave organizative që sigurojnë zgjidhjen e këtyre problemeve janë çështje që zënë një vend të dorës së parë në të gjithë punën udhëheqëse të Partisë. Në të ardhshmen ne duhet ta ngremë në një nivel edhe më të lartë përpunimin e përgjithësimin e kësaj eksperiencie.

Për zgjidhjen e një detyre të tillë, sa të rëndësishme aq edhe delikate, Partia jonë është mbështetur në mënyrë të patundur në parimet themelore që ka përpunuar Lenini i madh mbi rolin dhe ndërtimin e partisë. Kjo është garancia e drejtësisë së vijës së saj organizative.

Çdo largim nga parimet leniniste, çdo ulje e rolit udhëheqës të partisë krijojnë rrezikun e madh që klasa punëtore të mbetet e çarmatosur në luftën e saj. Ato janë burimi i lindjes së sëmundjeve dhe i shfaqjeve të huaja në parti, i degjenerimit ideologjik e organizativ, i kalbëzimit dhe pastaj i likuidimit të saj. Shembulli më tipik është degjenerimi i ish-Partisë Komuniste Jugosllave në një parti revizioniste, trockiste, vegël e imperializmit. Por ky nuk është i vetmi shembull. Fenomene të tilla degjenerimi vihen re dhe në parti të tjera, ku në udhëheqje janë revizionistët. Nën

parullën mashtruese, hipokrite të «zhvillimit krijues» e të «zbatimit krijues të marksizmit», nën maskën e të ashtuquajturës luftë kundër formave e metodave dogmatike që kanë lulëzuar në periudhën e kultit të Stalinit revizionistët modernë, krahas sulmit frontal kundër mësimëve themelore të marksizëm-leninizmit, i drejtojnë goditjet e tyre në mënyrë të veçantë, kundër partive marksiste, kundër doktrinės së V.I. Leninit mbi partinë e proletariatit, për të shkalluar themelet organizative leniniste të saj. Dhe kështu do të ndodhte.

«Oportunizmi në program është lidhur në mënyrë të natyrshme me oportunizmin në taktikë dhe me oportunizmin në çështjet organizative»¹.

Synimi kryesor i revizionistëve është dobësimi e likuidimi i rolit pararojë të partisë, i rolit udhëheqës të saj. Sulmi kundër mësimëve të Marksit e të Leninit mbi partinë, i filluar qysh në Kongresin XX të PK të BS, po kthehet në një revizionim sistematik e të plotë me vendimet që u muarën në Kongresin XXII dhe me masat që u zbatuan pas tij.

N. Hrushovi nga njëra anë çirret për «mbrojtjen e parimeve të partisë», nga ana tjetër shtron të tilla teza dhe zbaton të tilla masa organizative që godasin rëndë rolin udhëheqës të partisë, ndërtimin e partisë e, në radhë të parë, parimin e madh leninist, centralizmin demokratik. Shumë e rrezikshme është teza e formuluar në programin dhe në statutin e PK të BS, e aprovuar në Kongresin XXII, se partia e klasës punëtore është bërë parti e të gjithë popullit. Kjo nuk ka asnjë bazë dhe është në kundërshtim të plotë me marksizëm-leninizmin. Dihet se partitë politike kanë pasur dhe kanë kurdoherë karakter klase, ato shprehin e përfaqësojnë gjithnjë interesat e klasave të caktuara. Kjo është elementare për marksist-leninistët. Qysh në vitin 1848, në Manifestin e Partisë Komuniste, Marksit dhe Engelsit treguan se, për të përmbushur misionin e tij historik, proletariati duhet të ketë partinë e tij politike të pavarur. Pikërisht me kryerjen e këtij misioni të madh, kur të hyhet në fazën më të lartë të shoqërisë komuniste, kur komunizmi të mos jetë më objekt lufte dhe gjithë klasa punëtore të jetë bërë komuniste, kur të jenë zhdukur plotësisht klasat, duke mos përjashtuar këtu edhe faktorët e jashtëm, atëhere nuk do të jetë më e nevojshme ekzistenca e partisë politike të klasës punëtore, atëhere mbaron roli pararojë i klasës punëtore dhe i partisë së saj. Ky është i vetmi qëndrim i drejtë marksist-leninist i përpunuar dhe i pranuar nga lëvizja komuniste ndërko-

1 V. I. Lenin. Veprat, vëll. 7, f. 468.

mbëtare. Çfarë kushtesh të reja janë krijuar për të revizionuar parimin themelor leninist mbi partinë e proletariatit? Vetë «shpikësit» e kësaj teze nuk janë në gjendje të japin ndonjë argumentim pak a shumë serioz. A mund të ketë për këtë çështje ndonjë vlerë pohimi se partia komuniste u bë parti e gjithë popullit, sepse «zgjeroi ndikimin e vet drejtues mbi të gjitha anët e jetës shoqërore»?

Është detyrë e partisë së klasës punëtore që të sigurojë ndikimin e saj, rolin udhëheqës të saj në të gjithë jetën e vendit. Pa këtë nuk mund të ketë ndërtim të socializmit dhe të komunizmit. Me të drejtë në Statutin e Partisë sonë theksohet funksioni i partisë si forcë udhëheqëse e gjithë popullit. Partia marksiste-leniniste, duke qenë repartit pararojë i klasës punëtore, i klasës që ka rolin udhëheqës në ndërtimin e socializmit e të komunizmit, përfaqëson interesat e klasës punëtore dhe zbaton në mënyrë konsekuente politikën revolucionare të kësaj klase, politikë që u përgjigjet njëkohësisht interesave dhe aspiratave të të gjithë punonjësve të tjerë, të të gjithë popullit.

Tabloja e qëllimeve të N. Hrushovit bëhet më e plotë me «tezën» tjetër antimarksiste të zëvendësimit të diktaturës së proletariatit me shtetin e të gjithë popullit. Kur hyrja në fazën më të lartë të komunizmit është akoma një çështje e largët, kur ekzistojnë mbeturinat e klasave të vjetra shfrytëzuese, pra, ekziston edhe lufta e klasave, kur ka ndryshime klasore midis punëtorëve e fshatarëve, dhe kur përballë vendeve socialiste qëndron imperiazimi, ngritja e një «teze» të tillë në programin e PK të BS dhe, lidhur me të, formulimi në Statutin e PK të BS, i «kalimit gradual nga organizimi socialist i shtetit në vetëqeverisjen shoqërore», si një detyrë aktuale, ka vetëm një qëllim: dobësimin e veprimtarisë së organizatave të partisë, çmobilizimin e tyre, çmobilizimin e klasës punëtore e të punonjësve të tjerë, dobësimin e kontrollit të shëndoshë, të disiplinës, të vigjilencës dhe të luftës kundër armikut.

Partia jonë ka vënë në dukje me kohë se e ashtuquajtura luftë kundër kultit të individit ishte një perde tymi për të revizionuar bazat e marksizëm-leninizmit. E zhvilluar, në radhë të parë, nën pretekstin e mbrojtjes së parimeve organizative leniniste, të rivendosjes së tyre ajo ishte një vello për të mbuluar largimin nga ato, për të mbuluar goditjet që drejtoheshin kundër vetë partisë dhe rolit të saj. Njëkohësisht, siç është bërë e qartë, ajo është në kundërshtim të hapët me mësimet e V. I. Leninit mbi marrëdhënjet midis udhëheqësve, partisë, klasave dhe masave. Në veprën e tij të famshme «Sëmundja foshnjore e «majtizmit» në komunizëm» duke kritikuar komunistët gjermanë të cilët ngatërronin kuptimin e këtyre marrëdhënjeve, V. I. Lenini shkruan:

«...partitë politike, si rregull i përgjithshëm, drejtchen nga grupe pak a shumë të qëndrueshme njerëzish që quhen udhëheqës, njerëz më me autoritet, më me influencë, më me eksperiencë, të zgjedhur në funksionet më me përgjegjësi»¹.

Lufta pa parim kundër kultit të individit, rregullat organizative shumë të dyshimta të vendosura lidhur me të, i vënë në fakt masat e partisë kundër udhëheqësve të vërtetë, godasin rëndë centralizmin demokratik, disiplinën e partisë dhe, në këtë mënyrë, e lënë partinë pa udhëheqje të sigurtë, pa shtabin qëndror të domosdoshëm, e çorganizojnë dhe e çarmatosin atë. Fakte të shumta tregojnë se çdo fushatë në lidhje me të ashtuquajturën luftë kundër kultit të individit, të zhvilluar nga N. Hrushovi e pasuesit e tij, shoqërohet me dobësimin dhe me uljen e mëtejshme të rolit e të aftësive të partisë, me heqjen e kuadrove besnikë dhe me vendosjen në vend të tyre të njerëzve të përshtatshëm e të sigurtë për të ndjekur kursin revizionist. Nënshtrimi i partisë ndaj qëllimeve të përbuzshme të revizionistëve, këtyre agjentëve të rrezikshëm të imperializmit, ky është synimi dhe kuptimi i kësaj lufte dhe i këtyre masave.

Partitë marksiste-leniniste në bazë të centralizmit demokratik kanë përpunuar norma të drejta e efektive të vërtetuara nga praktika e në radhë të parë, të vërtetuara nga praktika e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, mbi kontrollin e drejtë e të shëndoshë të organizatave të partisë e të masave të partisë mbi organet udhëheqëse, siç janë dhënja llogari periodikisht, zhvillimi i zgjedhjeve demokratike etj. Ato gjithashtu kanë përpunuar norma efektive për të siguruar kolegjalitetin në punën udhëheqëse të partisë, për të mos lejuar çdo shtrembërim që mund të shfaqet në këtë çështje me rëndësi të madhe parimore e praktike. Rruga e drejtë, e sprovuar për forcimin e udhëheqjes kolegji në parti është zbatimi i përpiktë, i vërtetë i demokracisë së brendshme. Në luftë e në punë për vënjen në jetë të programit e të detyrave revolucionare të partisë, në procesin e jetës së shëndoshë e të gjallë të organizatave të partisë dalin në pah njerëzit, të cilëve organizatat mund t'u besojnë dhe t'i zgjedhin në organet udhëheqëse si dhe ata që nuk mund t'u përgjigjen detyrave, që nuk janë të përshtatshëm për të qëndruar më tej në vendet që u ka besuar partia. Eksperienca shumëvjeçare ka vërtetuar se udhëheqësit e ngritur mbi këto baza gëzojnë autoritetin dhe besimin e madh të organizatave të partisë. «Parime» të tilla si ai i «ripërtëritjes sistematike në proporcione të caktuara të përbërjes së të gjitha organeve të zgjedhura të partisë» nuk

1 V. I. Lenin. Veprat, vëll. 31, f. 29.

mund të mos kenë karakter të dyshimtë dhe tendencioz. Këtu nga njëra anë predikohet kundërshtimi i organizuar për krijimin e kuadrove me eksperiencë, të kalitur e të qëndrueshëm, nga ana tjetër, bëhet përjashtim nga rregulli i përgjithshëm për individë të caktuar për shkak të «autoritetit të tyre, të cilësive të larta politike, organizative dhe të cilësive të tjera», duke shkelur kështu edhe atë «demokraci» boshe që ata rekomandojnë për partinë. Dhe një privilegj i tillë vetëm për një pjesë të caktuar, i sanksionuar në program dhe në statut, konsiderohet luftë kundër kultit të individit. Megjithatë faktet janë kokëfortë, ato tregojnë qartë, dhe këtë në një mënyrë ose tjetër e pohojnë edhe vetë udhëheqësit sovjetikë, se qëllimi i vërtetë është mënjanimi i kuadrove të shëndoshë, besnikë, të padëshirueshëm për ta.

Aftësia e partisë marksiste për të përcaktuar format dhe metodat e punës, në përshtatje me situatën konkrete, është kusht i domosdoshëm për të siguruar udhëheqjen e pandërprerë të saj. Por garat për organizime e riorganizime të njëpasnjëshme, me gjithë mburrjet për «gjenialitetin e atyre që i shpikin», janë shumë larg nga një gjë e tillë. Ato janë të destinuara të ndihmojnë krijimin e konfuzionit dhe të çorganizimit. Zaten ky është pikërisht edhe qëllimi. Ç'mund të thuhet pastaj kur vetë përmbajtja e këtyre formave vjen në kundërshtim të hapur me parimet organizative themelore të ndërtimit të partisë e të punës udhëheqëse të saj, kur ato dobësojnë udhëheqjen politike të partisë, minojnë centralizmin, minojnë hallkat më të rëndësishme të strukturës organizative të partisë dhe krijojnë kushte për likuidimin e plotë të formave organizative leniniste të sprovuara të partisë. Këtu dhe vetëm këtu synonin rekomandimet e N. Hrushovit në plenumin e KQ të PK të BS në nëntorin e vitit të kaluar lidhur me riorganizimin e partisë «në përshtatje me detyrat e ndërtimit ekonomik». Ai propozoi të futet «në themel të rindërtimit të organeve të partisë, nga lart deri poshtë në bazë, parim i prodhimit, në vend të atij territorial, për të siguruar një udhëheqje më konkrete të partisë në industri, në ndërtim e në bujqësi». Këtu natyrisht nuk ishte fjala për të forcuar rolin efektiv të partisë në ndërtimin ekonomik, por, nën këtë maskë, të minohej roli udhëheqës i përgjithshëm i partisë në të gjitha hallkat e saja duke e shmangur atë nga roli kryesor si udhëheqëse politike e ideologjike dhe duke e identifikuar, ose duke e shkrirë me organet apo me organizatat ekonomike. Këtu kemi të bëjmë me revizionimin e hapët të tezës marksiste për ndërtimin e partisë si në bazë të parimit të prodhimit, ashtu dhe të territorit. Natyrisht drejtimi unik ose frenat mbeten në Moskë në forumin më të lartë, në presidiumin e KQ të PK të BS, nga i cili futet helmi revizionist në të gjitha fushat e jetës, kurse më poshtë ky drejtim thërmohet në byro dhe në komitete për udhëheqjen e prodhimit

industrial dhe në byro e në komitete për udhëheqjen e prodhimit bujqësor.

Edhe përsa i përket politikës me kuadrin, N. Hrushovi revizionoi parimet leniniste të njohura duke i zëvendësuar ato me rekomandimin e njëanshëm që «të krijohen mundësi më të mira për një zgjedhje më të drejtë, që të punojnë në udhëheqje të partisë kuadro të tillë, të cilët e njohin mirë prodhimin dhe kanë eksperiencë në degët përkatëse të ekonomisë». Një gjë e tillë do të thotë që kuadrot udhëheqës të partisë të mos jenë në radhë të parë kuadro politikë, por thjesht ekonomikë. Kështu, në fund të fundit, këto rekomandime nuk synonin tjetër veçse ta konkretizonin idenë e «partisë së të gjithë popullit» në kornizat e partisë me funksionarë thjesht ekonomikë. Sido që të thonë autorët e tyre, fenomene të tilla kanë të bëjnë me thelbin e doktrinës marksiste-leniniste mbi partinë; ato nuk janë çështje të brendshme të një partie, prandaj me të drejtë ngjallin shqetësimin më të madh të revolucionarët e vërtetë në të gjitha vendet.

Situatat e favorshme që orvaten të krijojnë për vete udhëheqësit revizionistë me anën e këtyre masave, zhurma që ata bëjnë rreth tyre me qëllim që t'i mbajnë njerëzit në pritje të rezultateve të mëdha të pretenduara nuk mund të kenë jetë të gjatë, nuk mund të sjellin dobi. Praktika është kriteri më i mirë i së vërtetës dhe ajo e bën punën e saj. Në fund të fundit «efektet e mira» të këtyre teorive dhe masave «për të forcuar ekonominë» po i shohim, veç të tjerash, në katastrofat në bujqësi, gjë që e bëri BS të kërkojë të importojë sivjet nga vendet kapitaliste sasinë më të madhe të drithit që njuh historia e kontraktiveve të tilla.

Shumë zhurmë bëjnë sidomos revizionistët lidhur me zhvillimin, nga ana e tyre, të demokracisë në parti. E vërteta është se ata nuk kanë bërë dhe nuk mund të bëjnë ndonjë gjë pozitive në këtë drejtim. Në rrugën e tradhëtisë, ku ata po futen gjithnjë më thellë jo vetëm që nuk mund të mbështeten në demokracinë e brendshme të partisë, në kritikën e autokritikën e shëndoshë e parimore, në forcimin e vërtetë të kolegjalitetit, por i tremben për vdekje diskutimit të hapur marksist-leninist dhe bëjnë çmos për të fshehur të vërtetën, për të mbytur çdo zë që e zbulon atë. Faktet tregojnë se ata ja kundërvenë demokracinë e brendshme centralizmit, unitetit dhe disiplinës së partisë. Konfuzioni ideologjik, politik dhe organizativ, përhapja e lloj-lloj pikëpamjesh e shfaqjesh të huaja, liberalizmi, kthimi i organizatave të partisë në klube diskutimesh janë rezultatet e pashmangshme të kësaj «pune krijuese».

Në kushte të tilla, krahas me mbrojtjen në tërësi të parimeve themelore të marksizëm-leninizmit, të vijës marksiste-leniniste, të lëvizjes komuniste, rëndësi të madhe ka mbrojtja e doktrinës mbi partinë revolucionare të proletariatit, e parimeve

organizative leniniste të ndërtimit e të jetës së partisë. Është detyrë e shenjtë e marksistë-leninistëve që të ngrenë në një nivel më të lartë shkencën e organizimit të partisë, si armë të mprehtë e të sprovuar kundër oportunitizmit, kundër regresit, kundër rrymës revizioniste në lëvizjen komuniste ndërkombëtare, ta shpien atë përpara, ta pasurojnë me eksperiencë të re dhe të zhvillojnë kështu më tej parimet organizative, ndërtimin e partisë.

*
* * *

Lidhur me forcimin e mëtejshëm të Partisë në këtë raport do të trajtojmë këto probleme kryesore:

Mbi detyrat për forcimin e përbërjes së Partisë; mbi rritjen e nivelit të pregatitjes marksiste-leniniste dhe kalitjen e mëtejshme të komunistëve; mbi ngritjen e nivelit të punës së organizatave të Partisë; mbi gjallërimin e jetës së brendshme dhe mbi përmirësimin e metodës së punës.

I

FORCIMI DHE PËRMIRËSIMI I VAZHDESHËM I PËRBËRJES SË PARTISË. NË MËNYRË TË VEÇANTË PËRMIRËSIMI I SHTRIRJES DHE I SHPËRNDARJES SË FORCAVE TË PARTISË NË FSHAT ËSHTË ÇËSHTJE KRYESORE E PUNËS ORGANIZATIVE TË PARTISË

Partia jonë udhëhiqet nga mësimi leninist se mbrojtja e pastërtisë së marksizëm-leninizmit, mbrojtja e parimeve, mbrojtja me vendosmëri e vijës së drejtë të Partisë është e lidhur ngushtë me pastërtinë e radhëve të saja, me ruajtjen e forcimin e kompaktësisë dhe të unitetit të saj.

Partia, si kurdoherë, është kujdesur për të mbajtur të forta, të shëndosha e të reja radhët e saja. Provat e rënda e të shumta, nëpërmjet të cilave ka çarë përpara, vërtetojnë se ajo u është përmbajtur plotësisht mësimëve të V. I. Leninit për të ruajtur pastërtinë, vendosmërinë e qëndrueshmërinë e Partisë, për ta ngritur gjithnjë e më lart emrin e anëtarit të Partisë. Në bazë të rezultateve të arritura nxjerrim me të drejtë përfundimin se përbërja e Partisë u përgjigjet plotësisht detyrave të mëdha revolucionare që ajo ka përpara.

Forcimin dhe përmirësimin sistematik të përbërjes së Partisë Komiteti Qendror i Partisë vazhdimisht e ka konsideruar si detyrën më të rëndësishme për rritjen e rolit e të aftësisë së saj. Prandaj, përcaktimi i orientimeve dhe i masave organizative që sigu-

rojnë zbatimin në mënyrë konsekuente të kësaj detyre ka qenë objekt i një kujdesi të veçantë.

Për pranimet në Parti Kongresi IV dha këtë orientim të përgjithshëm:

«Shumicën dërmuese të të pranuarve në Parti ta përbëjnë njerëzit e prodhimit (të fshatit e të qytetit), ndër ta vendin e parë ta zënë punëtorët, kryesisht punëtorët e industrisë, të minierave e të transportit dhe pastaj anëtarët e kooperativave bujqësore. Ndaj nëpunësve dhe shtresave të tjera të ketë kërkesa më të larta»¹.

Gjatë vjetëve të fundit radhët e Partisë janë rritur e forcuar në mënyrë të dukshme. Janë pranuar në Parti njerëzit më të mirë e më të pastër, që kanë dhënë prova besnikërie e vendosmërie për çështjen e saj. Nga Kongresi IV i Partisë e deri më 1 tetor 1963 janë pranuar 8 612 kandidatë për anëtarë partie, nga të cilët punëtorë 38,88 për qind, anëtarë të kooperativave bujqësore 32,62 për qind, fshatarë individualë 5,57 për qind dhe nëpunës, studentë etj. 22,93 për qind. Nga kandidatët e pranuar 18,41 për qind janë shoqe.

Gjendja shoqërore e efektivit të Partisë, në krahasim me 1. I. 1961, paraqitet si vijon:

Nr.	Gjendja shoqërore	1. I. 1961		1. X. 1963		Diferenca
		Numri	Përqindja	Numri	Përqindja	
1.	Punëtorë (të sektorëve shtetërorë dhe të kooperativave të artizanatit)	15 919	29,66	18 607	30,66	+ 1
2.	Anëtarë të kooperativave bujqësore.	12 678	23,63	13 772	22,69	- 0,93
3.	Fshatarë individualë	1 691	3,15	1 775	2,92	- 0,23
4.	Nëpunës	22 500	41,94	25 678	42,30	+ 0,36
5.	Të ndryshëm (studentë, nxënës etj.)	871	1,62	869	1,43	- 0,19
Shuma:		53 659	100	60 701	100	+ 7 042

Në tërësi rritja e Partisë ka ecur në mënyrë normale. Rregullimi i mëtejshëm i përbërjes shoqërore të Partisë — ky ka qenë

¹ Enver Hoxha. Raport mbi aktivitetin e Komitetit Qendror të PPSH. Kongresi IV i PPSH, f. 122-123, Tiranë 1961.

drejtimi, të cilit i janë përmbajtur pranimet e reja në Parti. Njerëzit e prodhimit përbëjnë shumicën dërmuese të të pranuarve, megjithëse si përqindje ndryshimi në efektivin e Partisë nuk është aq i dukshëm (1 për qind), rritja e numrit të punëtorëve është e mirë. Gjithashtu është rritur numri i anëtarëve të kooperativave bujqësore. Rritja e vogël e përqindjes së nëpunësve në efektivin e Partisë ka ardhur si rezultat i sjelljes në Parti të kuadrove besnikë, me origjinë shoqërore të shëndoshë, që punojnë në sektorë kyç e të rëndësishëm. Por duhet pranuar se këtu ka ndikuar edhe kujdesi i pamjaftueshëm i komiteteve të Partisë në rrethe për një shpërndarje më të drejtë të komunistëve që punojnë në administratë. Akoma po tërhiqen për në administratë shumë komunistë nga prodhimi, si nga qyteti, ashtu edhe nga fshati.

Shumë pozitive është që organizatat e Partisë kanë rritur kujdesin për cilësinë e atyre që pranohen në Parti, kanë rritur kërkesat kundrejt tyre. Ritmi i pranimeve në Parti ka qenë më i madh gjatë dy vjetëve të fundit. Ky është rezultat i fitores së vijës së drejtë të Partisë në të gjitha fushat, i punës më të mirë të organizatave të Partisë me masat, me njerëzit.

Rezultate janë arritur edhe në shtrirjen e organizatave dhe në shpërndarjen e forcave të Partisë. Tani kemi gjithsej 3 593 organizata bazë partie ose 257 më shumë se në Kongresin IV. Në sektorët shtetërorë të prodhimit kemi 169 organizata bazë më shumë. Gjendja këtu ka qenë dhe është e kënaqshme. Tani detyra më e rëndësishme është forcimi i punës së organizatave të Partisë në sektorë e në reparte dhe vazhdimi i ndërtimit të tyre në sektorët ku shtrirja e organizatave të Partisë është më e dobët, si në ndërtim, në NBSH dhe në ndërmarrje të veçanta të sektorëve të tjerë. Edhe në fshat, megjithëse efektiviteti i Partisë ka pak ndryshime, kemi disa përmirësime. Pranimet e reja në kooperativa bujqësore e në fshatra, ku forcat e Partisë kanë qenë më të pakta, bashkimi i kooperativave bujqësore dhe masa të tjera në ndërtimin e organizatave bazë kanë ndihmuar për përmirësimin e shtrirjes së Partisë. Ka një rritje relative të numrit të organizatave bazë që veprojnë në një kooperativë bujqësore ose në një fshat të vetëm kurse numri i atyre që veprojnë në 2 dhe 3 kooperativa bujqësore ose fshatra është ulur në 21,65 për qind. Ndërsa më 1 Janar 1961 kishim 442 fshatra me 1—2 komunistë dhe 75 pa komunistë, tani kemi përkatësisht 302 dhe 53.

Byronë Politike dhe Sekretariatit e Komitetit Qendror e ka preokupuar shumë drejtimi i punës për forcimin dhe rregullimin e përbërjes së Partisë. Në bazë të udhëzimeve të dhëna vitin e kaluar dhe gjatë këtij viti, ky problem ju nënshtrua një diskutimi dhe ristudimi të gjerë dhe të kujdesshëm, gjatë të cilit organizatat e Partisë shqyrtuan hollësisht punën e bërë dhe nxuarën konkluzione të rëndësishme për të ardhshmen. Por, natyrisht, rregullimi

i përbërjes të radhëve të Partisë dhe i rritjes së saj është një punë e tërë shkencore dhe shumë delikate. Ajo duhet t'i përgjigjet si rolit dhe detyrave që ka Partia, ashtu edhe realitetit objektiv për forcimin e gjallërimit e organizatave, për përmirësimin e shtrirjes e tyre etj. Njëkohësisht ajo nuk është diçka statike; përkundrazi, pasqyron ndryshimet e thella që bëhen në shoqërinë tonë, zhvillimin fitimtar të ndërtimit të socializmit në të gjitha frontet. Shkëputja nga këta faktorë, qëndrimi subjektiv, të shpien në mungesën e drejtimit të saktë, ata mund të të çojnë në sektarizëm ose në oportunizëm organizativ, në kufizimin ose në zgjerimin e dëmshëm të rritjes së Partisë në disa sektorë. Prandaj, punën për forcimin e përbërjes së Partisë ne e shikojmë në mënyrë dialektike, në rritje e zhvillim, të lidhur ngushtë me kushtet konkrete e me detyrat e reja.

Mbi këtë bazë është e nevojshme që:

1) Organizatat e Partisë të drejtojnë forcimin e përbërjes në tërë kompleksin e saj, duke bërë një zbrëthim më konkret të orientimit të Kongresit IV të Partisë

Disa herë në çështjen e pranimeve në Parti, në punën për rregullimin e përbërjes së Partisë ka një kuptim të ngushtë. Quhet e kryer detyra në qoftë se ndiqen disa të dhëna kryesore, në bazë të shifrave mesatare, të cilat edhe pse janë shumë të nevojshme, mund të tregojnë vetëm në vija të përgjithshme zbatimin e orientimit të Partisë për shtimin e rregullt të radhëve të saja. Kjo në një farë mase të ndan nga jeta e gjallë e organizatave të Partisë. Për të pasur një drejtim sa më të mirë është e domosdoshme si për Partinë në tërësi, për organizatat e Partisë të rretheve, ashtu dhe për çdo organizatë bazë të veçantë të studjohen thellë e konkretisht kushtet e çdo rrethi, të çdo sektori, të çdo qendre ose vendi pune, mundësitë reale që ekzistojnë për rritjen e Partisë dhe të nxirren kështu në mënyrë të argumentuar detyrat për të ardhshmen.

Në këtë mënyrë drejtimi i pranimeve në Parti është më efektiv dhe më i frutshëm. Shembull konkret, gjatë këtyre vjetëve të fundit, në të cilët në përgjithësi drejtimi i pranimeve ka qenë i rregullt, është pranimi i punëtorëve, të cilët zënë vendin e parë. Nga 3 347 punëtorë të pranuar nga 1. I. 1961 deri më 1. X. 1963, 49,08 për qind vijnë nga industria dhe nga transporti, 10,27 për qind nga minierat e nga gjeologjia. Por, megjithkëtë, edhe rritja e Partisë me punëtorë jo kudo e kurdoherë ka ecur në përshatje me rritjen në cilësi e në sasi të klasës punëtoare. Analiza më e hollësishme e këtij problemi, tregon se herë-herë nuk është treguar kujdes i duhur për forcimin me gjak të ri të organizatave të

Partisë në disa sektorë ose ndërmarrje të rëndësishme. Kështu p.sh. kanë qenë mundësitë që të ecte më mirë forcimi i organizatave të Partisë në ndërmarrjet shtetnore bujqësore, në profesionet kryesore të shumë degëve të ndërtimit etj., në përputhje me rritjen e zhvillimin e tyre.

Rritja e Partisë nuk është një qëllim në vetëvete, ajo duhet t'i shërbejë forcimit e gjallërimit të organizatave, përmirësimit të shtrirjes së tyre, pra, duhet t'i përgjigjet forcimit të funksionit udhëheqës të Partisë në të gjitha anët e veprimtarisë së saj.

2) Forcimi dhe përmirësimi i përbërjes së Partisë në fshat, përmirësimi i shtrirjes së organizatave të Partisë të shihet si problem aktual shumë i rëndësishëm, i cili në vjetët e ardhshëm duhet të zgjidhet me ritme më të shpejta

Të dhënat që përmendëm në fillim vërtetojnë se vjetët e fundit edhe në fshat ka pasur përmirësime në jetën e organizatave të Partisë. Por në punën për rritjen e Partisë aty dalin disa probleme të rëndësishme, të cilat duhet t'i shikojmë drejt e t'u dalim përpara. Para së gjithash, çështja që duhet të na preokupojë është kujdesi i pamjaftueshëm për forcimin e organizatave të Partisë në fshat. Komitetet e Partisë në rrethe, si p.sh. ai i Shkodrës, i Durrësit, i Elbasanit, i Pukës, krahas me drejtimin e punës për pranimin e punëtorëve, nuk kanë mundur t'u japin një ndihmë më të afërt organizatave të Partisë në fshat. Bashkimi i kooperativave bujqësore, ka nxjerrë në shesh mungesën e forcave të Partisë në brigada, në ferma etj., ku, siç dihet, gjejnë zbatim vendimet e Partisë, zgjidhen detyrat e prodhimit. 17 për qind e brigadave dhe e fermave blegtorale në kooperativat bujqësore nuk kanë asnjë komunist dhe 49 për qind e tyre kanë vetëm nga 1—2 komunistë. Në rrethin e Elbasanit nuk kanë asnjë komunist 23 për qind e brigadave dhe e fermave, ndërsa 73 për qind kanë 1—2 komunistë; në rrethin e Shkodrës nuk kanë asnjë komunist 35 për qind, kurse 59 për qind kanë nga 1—2 komunistë. Përveç kësaj në disa rrethe, sidomos në ato të Veriut, në zonat e malësisë, në mjaft raste kemi një shtrirje të dobët të forcave të Partisë. Në rrethin e Kukësit, p.sh. janë 4 fshatra pa komunistë dhe 26 me 1—2 komunistë, 6 organizata bazë kontrollojnë nga 3 e më shumë kooperativa bujqësore ose fshatra. E dobët është shtrirja edhe në fshatrat e rrethit të Pukës e të Mirditës, në mjaft zona të rrethit të Shkodrës, të Dibërës etj. Një numër organizatash bazë, edhe pse i kanë mundësitë, që prej një kohe të gjatë nuk po bëjnë pranime. Disa komunistë, që bëjnë pjesë në këto organizata bazë, janë mësuar me këtë gjendje, mbajnë qëndrim konservator dhe pengojnë hyrjen e forcave të reja në Parti. Shpeshherë pranimet e reja në Parti përqë-

ndrohen më tepër atje ku është shumica e komunistëve dhe mbeten jashtë shumë kandidatë të devotshëm që janë më larg qendrave të organizatave bazë.

Duhet të na tërheqë gjithashtu vëmendjen fakti që efektivi i Partisë në fshat, edhe pse është rritur vjetët e fundit, prapë vazhdon akoma të jetë më i vogël se sa ka qenë disa vjet para Kongresit IV të Partisë. Këtu kemi parasysh shifrat absolute si edhe rritjen e popullsisë e të krahëve të punës. Në vitin 1957 komunistët zinin 1,53 për qind të popullatës së fshatit, kurse tani zënë 1,31 për qind. Këtu ndikojnë disa faktorë të pandarë nga zhvillimi i procesit të ndërtimit socialist në gjithë vendin dhe, në mënyrë të veçantë, në fshat. Kështu është rritur shumë, në krahasim me të kaluarën, numri i komunistëve që punojnë në SMT, mjaft fshatra kanë kaluar në ndërmarrjet shtetërore bujqësore. Zhvillimi i minierave dhe i qendrave të reja të banuara do të tërhiqte patjetër disa komunistë nga organizatat e Partisë të fshatit. Këtu çdo gjë është e rregullt e normale. Një zhvillim i tillë, pa dyshim, ka ndikuar drejtpërdrejt ose tërthorazi në forcimin e punës së Partisë në fshat. Por, në mjaft raste, sidomos në të kaluarën organizatat dhe komitetet e Partisë nuk kanë ndjekur me kujdes transferimet e komunistëve, kanë bërë lëshime dhe prandaj, ka pasur edhe mjaft largime, të cilat duhej të mënjanoheshin. Edhe tani në disa rrethe e zona të veçanta si në Përmet, në Tepelenë, në Berat, në Korçë ka një tendencë të theksuar për t'u larguar nga fshati e për t'u vendosur në qendra të mëdha. Ne duhet të punojmë që komunistët e fshatit të kuptojnë se edhe aty ku janë, ka perspektiva zhvillimi dhe nga ana tjetër, të kontrollojmë me rreptësi lëvizjet e parregullta.

Duhet thënë gjithashtu se ekzistenca e përqindjeve orientuese për pranimin në Parti të punëtorëve, veçanërisht në disa rrethe, ka përmbajtur në vetëvete një farë kufizimi për pranimet në fshat. Por duhet pranuar se ndryshimet e përparimet që kanë ndodhur në fshatin tonë, rritja e kërkesave dhe e detyrave kundrejt organizatave të Partisë, nuk janë ndjekur kurdoherë si duhet me një punë sistematike e të kujdesshme për forcimin e përbërjes, për rritjen e nivelit të tyre. Numri i të pranuarve nuk i është përgjegjur rritjes së punës së Partisë në fshat, rritjes e zhvillimit të fshatit. Tani janë të gjitha kushtet objektive dhe të gjitha mundësitë për ta kryer këtë detyrë. Transformimi socialist i fshatit, krijimi i organizatave të mëdha ekonomike, siç janë kooperativat bujqësore, lufta heroike që zhvillohet kudo, edhe në zonat më të largëta të malësisë, për zbatimin e mbrojtjen e vijës së Partisë, i kanë rritur njerëzit në fshat, kanë shënuar një hap të madh përpara në formimin e kalitjen e tyre. Rreth organizatave të Partisë punon tani një aktiv i gjerë njerëzish me perspektivë për t'u pranuar në radhët e tyre. Mjafton të përmendim se vetëm në rrethin

e Shkodrës këta e kalojnë më tepër se tri herë numrin e të pranuarve në fshat pas Kongresit IV e këtej. Problemet dhe detyrat e rëndësishme që shtrën sot ngritja e mëtejshme e bujqësisë, zhvillimi i përgjithshëm i ndërtimit socialist në fshat e bëjnë veçanërisht të ngutshme dhe të rëndësishme zgjidhjen e detyrës së zgjerimit dhe të forcimit të organizatave të Partisë në fshat.

3) Për të siguruar rritjen e rregullt e normale të Partisë, për përmirësimin sistematik të përbërjes së saj të bëhet një punë e veçantë, e vazhdueshme, e organizuar e me perspektivë për edukimin, përgatitjen e për aktivizimin e njerëzve

Puna e palodhur e vetëmohuese për ndërtimin e socializmit, lufta heroike për mbrojtjen e fitoreve të mëdha të popullit tonë dhe të vijës marksiste-leniniste të Partisë sonë janë kushtet kryesore, nën prizmin e të cilave shquhen qartë cilësitë e larta të atyre që pranohen në Parti, vihet në provë besnikëria dhe vendosmëria e tyre. Transformimet e mëdha që janë kryer nën udhëheqjen e Partisë, puna shumë e gjerë për krijimin e njeriut të ri të shoqërisë sonë socialiste përgatitin e kalitin mijëra e mijëra luftëtarë pararojë për çështjen e saj. Por përmirësimi i përbërjes së Partisë, dinamika e rregullt e rritjes së radhëve të saja shtrojnë me forcë nevojën e një pune të veçantë, më të organizuar e më me perspektivë për aktivizimin e përgatitjen e njerëzve. Në Parti duhet të vijë ata që duhen dhe që e meritojnë plotësisht. Përcaktimi i orientimeve konkrete për pranimet e reja, megjithëse shumë i domosdoshëm, është vetëm fillimi i punës, kurse thelbi i saj është puna e gjallë me njerëzit, puna për përgatitjen e edukimin e tyre për në Parti. Këtu duhet të përqëndrohet vëmendja dhe kësaj duhet t'i shërbejë edhe përcaktimi i vetë orientimeve. Pikërisht këtë punë, me gjithë përparimet e arritura, akoma nuk po e vëmë si duhet në rrugë; vazhdojmë të kemi mjaft dobësi, të cilat me doemos duhet t'i ndreqim. Në radhë të parë duhet t'i japim fund mosinteresimit që vërehet shpesh, sidomos në disa anëtarë partie më me përgjegjësi, të cilët kujtojnë se përgatitja e njerëzve për në Parti është punë që nuk u takon atyre drejtpërdrejt dhe harrojnë këto detyra numër një të tyre, këta shokë shumë rrallë lëshojnë rekomandime për pranimet në Parti. Disa anëtarë partie kanë një mendim jo të drejtë lidhur me përgatitjen e njerëzve për në Parti, nuk e kuptojnë këtë si një proces pak a shumë të gjatë e të vazhdueshëm gjatë të cilit organizatat e Partisë duhet të punojnë për edukimin e aktivizimin e njerëzve, të kontrollojnë e të ndjekin nga afër provat që ata japin në veprimtarinë e përditshme, sjelljet, përparimin e tyre etj. Të tjerë përgatitjen e njerëzve për në Parti e shohin në mënyrë të njëanshme, marrin për bazë vetëm

një aspekt të veprimtarisë së tyre, më shpesh vetëm me disa të dhëna mbi rezultatet e tyre në punë, në prodhim, pa i parë në mënyrë të plotë, në tërë kompleksin kushtet dhe cilësitë që përbëjnë figurën e kandidatit për në Parti, kërkesat e larta që shtrën Partia kundrejt tyre. Ka dhe raste kur përgatitja për në Parti thjeshtohet në nxitjen e njerëzve për të bërë lutje e për të plotësuar dokumentat që kërkohen. . .

Një formë e rëndësishme pune për edukimin e mobilizimin e njerëzve, për forcimin e lidhjeve me ta, për ta bërë çështjen e pranimeve në Parti një mjet të rëndësishëm të kalitjes komuniste të tyre, është zhvillimi i mbledhjeve të hapura të organizatave bazë. Pa e tepruar ne duhet të praktikojmë më shumë mbledhje të tilla, të përgatitura e të organizuara me kujdes. Duke vepruar kështu, vëmë më mirë në jetë pikëpamjen e njohur të Partisë se anëtarët e saj janë përfaqësuesit më të denjë të klasës punëtore dhe të punonjësve të tjerë. Si të tillë, ata vijnë në Parti në radhë të parë të zgjedhur e të dërguar nga vetë klasa punëtore dhe nga masat e tjera punonjëse.

Përgatitjen e njerëzve për në Parti duhet ta lidhim ngushtë me punën që zhvillojnë organizatat e masave për edukimin e tyre, për ngritjen e nivelit të tyre kultural, arësitor e profesional etj., si edhe me aktivitetin politik e shoqëror që ata zhvillojnë në këto leva të rëndësishme të Partisë. Si deri tani, edhe në të ardhshmen, rinia është për Partinë burim forcash luftarake, të freskëta, të pastra, pa peshën e mbeturinave të së kaluarës.

Më shumë punë duhet të bëhet për përgatitjen e grave për në Parti dhe në shembullin e Lushnjës dhe të Korçës duhet të ecin edhe rrethet e tjera. Gratë janë bërë një forcë e madhe, roli i tyre për të vënë në jetë detyrat e mëdha që kemi përpara po rritet e gjithnjë po bëhet më aktiv, sidomos në bujqësi, në arësim, në shëndetësi, në tregëti etj., pesha e tyre është mjaft herë vendimtare. Në të katër anët e vendit punojnë e drejtojnë mijëra gra e të reja, jo vetëm të çliuara nga mentalitetet e zakonet prapanike, por edhe të përgatitura e të kualifikuara. Në punë e me vepra po rritet autoriteti i tyre. Por gjithë ky realitet i gjallë duhet të gjejë pasqyrimin e tij edhe në ritmin e pranimeve të grave në Parti. Pranimi i grave në Parti duhet të konsiderohet si treguesi më i lartë i rritjes së rolit e të personalitetit të tyre dhe si një metër i saktë për gjithë punën që organizata e Partisë zhvillon me gruan.

Forcimi i radhëve të Partisë, i përbërjes së saj shoqërore, ka qenë dhe mbetet një detyrë me përgjegjësi të madhe. Për ta çuar edhe më përpara forcimin organizativ të Partisë, në përshtatje me detyrat që nxjerr zhvillimi i pandërprerë i vendit tonë, në bazë të orientimit të përgjithshëm që ka dhënë Kongresi IV, Byroja Politike ka arritur në këto përfundime:

1) Është plotësisht me vend dhe e dobishme që dhe në të ardhshmen të kemi disa orientime të përgjithshme. Në këtë drejtim, si gjithnjë, duhet të ruajmë parimet organizative bazë të Partisë, të ndërtimit të saj. Pranimi në Parti i punëtorëve ka qenë dhe është treguesi cilësor udhëheqës më i rëndësishëm i forcimit të përbërjes së Partisë. Është sukses i madh për Partinë fakti që tani ka në radhët e saja një bërthamë të shëndoshë me njerëz të klasës punëtoare, të cilën, lidhur me rritjen dhe kalitjen e mëtejshme të radhëve të Partisë, do ta forcojmë vazhdimisht. Por zgjidhja e kësaj detyre nuk duhet të bëhet duke u nisur nga disa konsiderata subjektive që nuk përputhen me gjendjen konkrete, nuk duhet të shikohet e veçuar nga problemet e tjera të forcimit organizativ të Partisë.

Funksioni i madh i Partisë, si reparti pararojë i klasës punëtoare, kërkon që të rritet njëkohësisht roli i saj drejtues, ndikimi i saj, forca e saj mobilizuese e organizuese, puna e saj edukuese në të gjithë sektorët e anët e jetës së vendit. T'i përgjigjet si duhet ky funksion rritjes, zhvillimit, zgjerimit e rëndësisë që marrin sektorët e ndryshëm ekonomikë, shoqërorë e kulturalë. Janë këto detyra themelore, nga të cilat niset Partia jonë për të përcaktuar orientimet për forcimin e përbërjes së saj në etapat e ndryshme që kalon.

Të dhënat që parashtruan më lart tregojnë në mënyrë të qartë se tani detyrë e rëndësishme është forcimi i organizatave të Partisë në fshat, prandaj forcimin e mëtejshëm të Partisë me punëtorë duhet ta zgjidhim në lidhje të ngushtë me të. *Me qëllim që në 3—4 vjetët e ardhshëm të arrihet një forcim më i shpejtë i organizatave të Partisë në fshat, Byroja Politike mendon që të rritet ritmi i pranimeve në fshat, si edhe përpjesëtimi i tyre në numrin e të pranuarve. Në Plenumin e shtatorit të vitit 1960 dhamë orientimin që punëtorët të zënë rreth 45 për qind të të pranuarve në Parti. Këtij orientimi konkret i jemi përmbajtur deri kohët e fundit, kurse për 3—4 vjetët e ardhshëm mendojmë që punëtorët të zënë rreth 30—35 për qind të pranimeve, dhe anëtarët e kooperativave bujqësore e fshatarët individualë rreth 50—55 për qind.*

Me rëndësi të madhe është këtu ritmi i pranimeve në Parti. Rritja e rregullt e normale e radhëve të Partisë nuk pajtohet me nxitime e shpejtime të dëmshme. Në një çështje të tillë jetike për Partinë nuk lejohen as puna me hope, as çdo përpjekje për rregullimin e përpjesëtimeve me fushata. Këto mënyra veprimi duhet të çrrënjosen nga praktika e organizatave dhe e komiteteve të Partisë. Partia jonë kurrë nuk ka lakmuar sasinë në dëm të cilësisë. Megjithatë rritja e rolit udhëheqës dhe edukues të Partisë, rezultatet e vijës së saj të drejtë, lufta heroike për ta vënë atë në jetë e për të kapërcyer vështirësitë, zgjerimi i sektorëve të ndryshëm të ndërtimit socialist të vendit e, lidhur me të, edhe zgjerimi

i fushës së veprimtarisë së organizatave të Partisë, bëjnë të mundshme një rritje të ritmit të pranimeve në Parti, në krahasim me vjetët e kaluar. Ritmi i pranimeve në Parti gjatë vjetëve 1962—1963 është pasqyrimi i këtyre faktorëve dhe njëkohësisht në përgjithësi mund të shërbejë si bazë për rritjen e Partisë në vjetët e ardhshëm. Në qendrat e punës, në qytete, në fshatra, rreth organizatave të Partisë është rritur në sasi e cilësi aktiviteti i njerëzve pa parti që mund të bëhen në të ardhshmen anëtarë të vlefshëm të Partisë. Ky është një rezultat mjaft pozitiv i punës së organizatave të Partisë, por këtë rezultat ta forcojmë edhe më tepër duke e rritur aktivitetin rreth Partisë sidomos me gra e me të reja.

2) Edhe në të ardhshmen të rritim më tepër kujdesin e organizatave të Partisë për punëtorët. Në pranimet e reja vëmendja të përqëndrohet në mënyrë të veçantë në degët e në ndërmarrjet më të rëndësishme si dhe në sektorë të veçantë brenda degëve e ndërmarrjeve, ku është më i domosdoshëm forcimi i organizatave të Partisë me njerëz të rinj të pararojës, të aftë për të udhëhequr punën për zbatimin e vijës së Partisë. Kujdesi i veçantë të tregohet për forcimin e organizatave të Partisë në ndërmarrjet e reja, të rëndësishme.

Në të gjitha degët e në ndërmarrjet të përgatitimi një bërthamë të shëndoshë punëtorësh nga aktiviteti pa parti, me të gjitha cilësitë e virtytet që kërkohen për anëtarët e Partisë. Atje ku për vjetët e ardhshëm, në përshtatje me kushtet konkrete, mund të ngadalësohet diçka ritmi i pranimeve në Parti, më vonë, kur të kemi zgjidhur më mirë detyrat e forcimit të Partisë në fshat e në sektorët e tjerë, ne do t'i pranojmë këta aktivistë pa parti me ritme më të shpejta e të përgatitur si duhet.

3) Detyrë kryesore organizative në fshat është ngritja e rolit të organizatave të Partisë në kooperativat bujqësore, sidomos në ato të bashkuarat, në nivelin e organizatave të Partisë të ndërmarrjeve të mëdha ekonomike. Në dritën e kësaj detyre duhet të drejtojmë pranimet e reja në Parti duke siguruar dhe një shpërndarje më të mirë të forcave të Partisë në brigada, në ferma etj. Detyrë tjetër e rëndësishme organizative në fshat është të përmirësojmë shtrirjen e Partisë në zona, sidomos në ato të malësisë, ku kemi kooperativa e fshatra pa komunistë. Ne duhet të synojmë që në çdo kooperativë bujqësore dhe fshat të kemi organizata bazë. Një gjë e tillë do të sjellë ndryshime rrënjësore në fshat, do të bëjë që të forcohet puna e Partisë, duke ju përgjegjur plotësisht detyrave e situatave që kalojmë. Si kudo, edhe në këto zona, jo vetëm ka njerëz që punojnë e luftojnë për të zbatuar vendimet e Partisë, por shumë herë atje ka edhe një fushë të gjerë konkrete për të provuar vendosmërinë e kalitjen e tyre të lartë.

Vënja në jetë e këtyre detyrave të rëndësishme kërkon që t'i drejtojmë pranimet në Parti më me kujdes, pjekuri e zgjuarësi.

Problemet organizative të Partisë, detyrat që shtrohen për pranimin në Parti janë të tilla që mund të zgjidhen vetëm me një punë të vazhdueshme. Nuk kërkohet që brenda 2—3 apo 4 vjetëve të arrihet në çdo kooperativë bujqësore ose fshat rregullimi i plotë i shtrirjes dhe i shpërndarjes së forcave të Partisë. Kjo mund të na shpinte në nxitime shumë të dëmshme. Ashtu si në qendrat e punës në qytet, edhe në fshat nuk mund të ecet kudo me ritme të njëjta pa marrë parasysh ndryshimin e treguesve që vendosin në përcaktimin e ritmeve, por marrja e këtyre masave do të japë rezultate mjaft të mira dhe do të ngrejë nivelin e punës së organizave të Partisë.

4) Rritja e drejtë e normale e Partisë kërkon që të mos lëmë jashtë kujdesit tonë forcimin organizativ të Partisë edhe në sektorë të tjerë. Me të drejtë organizatat e Partisë kohët e fundit po u kushtojnë më tepër vëmendje pranimeve në Parti nga radhët e inteligjencies, pjesës më të përparuar të saj që punon direkt në sektorët më të rëndësishëm të prodhimit, si edhe njerëzve pararojë në frontin e arësimit e të kulturës që vazhdimisht japin prova besnikërie e vendosmërie për Partinë. Do të ishte gabim, në kundërshtim me realitetin tonë, me ndryshimet që kanë ndodhur në vend, t'u mbyllim dyert e Partisë ose t'u sillnim pengesa e vështirësi të pajustificuara njerëzve të sprovuar nga radhët e inteligjencies sonë popullore. Këta janë kuadrot tanë të përgatitur me aq kujdes nga Partia dhe nga pushteti popullor, në shumicën e tyre bij punëtorësh, fshatarësh të varfër e të mesëm, të mbrujtur me ideologjinë e klasës punëtore, që kanë vënë të gjitha forcat e tyre në shërbim të Partisë e të popullit.

Duke e parë drejt pranimin e tyre në Parti duhet, njëkohësisht, të tregohemi shumë të vëmendshëm, që këtë problem në asnjë mënyrë mos ta lëmë të ecë në mënyrë spontane. Presioni për të hyrë në Parti nga radhët e nëpunësve, veçanërisht, në sektorët administrativë, ka qenë dhe është i madh. Për këtë të mbajnë gjithnjë parasysh orientimin e përgjithshëm të Partisë, të rritim kërkesat kundrejt atyre që dëshirojnë të pranohen në Parti dhe këto t'i shohim në gjithë kompleksin e tyre. Të mos harrojmë përveç kësaj se përqindja e madhe që zënë nëpunësit në efektivin e Partisë vazhdon të mbetet një problem për ne. Kjo do të rregullohet, në radhë të parë, nëpërmjet rritjes së numrit të njerëzve të prodhimit, gjë që ne po e ndjekim me këmbëngulje si edhe nëpërmjet shpërndarjes më të mirë të tyre, por edhe kujdesi e qëndrimi i matur në pranimin nga radhët e nëpunësve luan një rol kryesor.

5) Pranimi në Parti është i lidhur ngushtë me gjithë jetën dhe veprimtarinë e Partisë. Rritja e nivelit të punës së organizave të Partisë për forcimin sistematik të përbërjes përfshin një rreth të gjerë çështjesh, që vazhdimisht duhen pasur parasysh.

Por nuk duhet të harrojmë kurrë se për Partinë tonë marksist-leniniste përpunimi i masave dhe i detyrave organizative nuk është një qëllim në vetëvete. Forcimi i përbërjes së Partisë do të thotë në thelb forcimi i mëtejshëm i saj, rritja e rolit dhe e nivelit të organizatave të Partisë, rritja e aftësive të tyre luftarake, mobilizuese e organizuese, gjallërimi i mëtejshëm i jetës së brendshme të Partisë. Përcaktimi i disa orientimeve konkrete është një gjë e drejtë dhe e dobishme. Por në zbatimin e tyre nuk duhet të lejojmë asnjë shfaqje administrative e burokratike; puna e gjallë e Partisë, puna e gjallë me njerëzit nuk e duron një gjë të tillë. Objektivi i përgjithshëm që duhet të na udhëheqë është detyra themelore për të forcuar rolin e çdo ndërmarrjeje, të çdo kooperative bujqësore etj., si qendra luftarake të Partisë. Po të kuptojmë këtë drejt e thellë, të gjitha çështjet e tjera do të zgjidhen drejt.

Çështje tjetër themelore ku duhet përqëndruar kujdesi ynë kryesor është pastërtia e cilësia e radhëve të Partisë. Detyrat që ne caktojmë, sado të drejta të jenë, sado që t'u përgjigjen kushteve konkrete, sado që të përputhen me realitetin, nuk duhet të bëhen shkak që të ulen kërkesat për cilësitë e larta të atyre që pranohen në Parti, nuk duhet të dobësojnë sado pak zgjedhjen e kujdesshme individuale të njerëzve. Në qoftë se organizojmë drejt zbatimin e tyre, ato janë disa masa organizative të vlefshme që na ndihmojnë për drejtimin më të afërt, më konkret e të gjallë të punës për forcimin e përbërjes së Partisë, na ndihmojnë që të bëjmë në këtë drejtim një punë më shkencore.

Ajo që vendos, ajo që ka fjalën e fundit në pranimet në Parti është zgjedhja individuale. Si kurdoherë, duhet të udhëhiqemi nga mësimi i njohur leninist që Partia e klasës punëtore është e fortë jo vetëm nga numri i anëtarëve të saj, por para së gjithash nga cilësia e tyre. Çështja e rritjes së kërkesave nuk është një gjë që u përket vetëm atyre që vijnë nga radhët e nëpunësve siç mendohet ndonjëherë. Në asnjë mënyrë, për hir të sasisë, ose për hir të rritjes së Partisë në sektorë të ndryshëm, për hir të përmirësimit të shtrirjes e të shpërndarjes së forcave të Partisë, apo për hir të pranimin të punëtorëve, të grave etj., nuk duhet të ulen kërkesat ndaj atyre që pranohen në radhët e Partisë.

Detyra është ta bëjmë Partinë sa më të aftë e luftarake, kurse çdo pranim i pakontrolluar krijon rrezikun që të hyjë në Parti një element i padenjë dhe, për më tepër, ndikon për keq në jetën e veprimtarinë e organizatës së Partisë. Prandaj, ata që pranohen në Parti duhet të jenë jo vetëm njerëzit më luftarakë, më besnikë e të sprovuar, por edhe me aftësi më të mëdha, më të pastër e të përparuar, njerëz që janë me të vërtetë pararojë, që përpiqen seriozisht të ecin krahas me Partinë në nivelin që kërkon zgjidhja e detyrave në sektorët e ndryshëm ku ata punojnë.

Në gjithë Partinë ka filluar puna për ndërrimin e dokumentave të anëtarëve të Partisë. Ky është një aksion i rëndësishëm. Ndërrimi i dokumentave të anëtarëve të Partisë do të bëhet në bazë të të dhënave të dokumentave që kemi tani. Kjo është plotësisht e drejtë, pasi nuk ka ndonjë arsye që të bëjmë verifikimin e dokumentave të anëtarëve të Partisë. Çështjet që mund të dalin për persona të veçantë do të zgjidhen, ashtu si deri tani, në rrugën e zakonshme. Por ndërrimi i dokumentave të anëtarëve të Partisë, si një punë e madhe që është, do të vlejë e do të ndihmojë shumë për përmirësimin e administrimit të brendshëm të Partisë, për forcimin e mëtejshëm të rregullit në këtë sektor të rëndësishëm të punës organizative të Partisë, për ndreqjen e mungesave që vërtetohen në plotësimin e pasurimin e dokumentave të anëtarësisë në Parti. Komitetet e Partisë në rrethe, organet udhëheqëse të Partisë në ushtri, si dhe të gjitha organizatat e Partisë duhet të tregojnë kujdes që kjo detyrë të realizohet plotësisht.

II

NGRITJA E NIVELIT MARKSIST-LENINIST TË ANËTARËVE TË PARTISË, EDUKIMI DHE KALITJA E TYRE ME VIRTYTET E MORALIT KOMUNIST, DETYRË TJETËR KRYESORE PËR FORCIMIN E PARTISË, PËR FORCIMIN E RADHËVE TË SAJA

Edukimi marksist-leninist i anëtarëve të Partisë dhe i punonjësve ndikon drejtpërsëdrejti në forcimin e Partisë. Sa më të qartë dhe sa më të ngritur nga pikëpamja politike dhe ideologjike janë komunistët, aq më të ndërgjegjshëm janë ata për misionin dhe për detyrat e tyre, aq më shumë do të luftojnë ata për zbatimin e vijës së Partisë, aq më e fortë do të jetë Partia. Prandaj, me të drejtë ky problem ka tërhequr kurdoherë vëmendjen e KQ të PPSH dhe në këtë plenum e theksojmë si një nga detyrat kryesore për forcimin e Partisë.

Gjatë vjetëve të fundit puna ideologjike e Partisë është ngritur si nga përmbajtja ashtu edhe nga format. Materialet e Kongresit IV, vendimet e plenumeve të KQ, artikujt e botuar në shtyp mbi çështjet e zhvillimit të sotëm botëror dhe mbi luftën kundër revizionizmit, përpunimi i një sërë çështjesh të ndërtimit tonë socialist etj., e kanë gjallëruar punën ideologjike në Parti dhe e kanë ngritur nivelin politik e ideologjik të komunistëve. Për këtë flasim uniteti i Partisë dhe i popullit, lufta e vendosur kundër imperializmit e revizionizmit, mobilizimi i madh në punë etj.

Por etapa e re e ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste në të cilën ndodhet tani vendi ynë dhe ashpërsimi i luftës me imperia-

listët e me revizionistët modernë, shtrojnë përpara Partisë detyrën që të forcojë edhe më tej punën e saj ideologjike. Në këto kushte, kur problemet ideologjike kanë dalë në plan të parë, duhet të rritet edhe vëmendja e organizatave të Partisë për një punë më të gjerë e më të mirë për edukimin marksist-leninist të komunistëve dhe të punonjësve.

Për të bërë këtë duhet, nga njëra anë, të kuptohet drejt prioriteti i udhëheqjes politike dhe ideologjike, duke e lidhur atë në mënyrë të pazgjidhshme me udhëheqjen organizative dhe ekonomike, nga ana tjetër, të përfeksionohen format dhe mjetet e propagandës së Partisë.

Kur flasim për prioritet të udhëheqjes politike dhe ideologjike kemi parasysh që çdo detyrë partie ose shtetërore, qoftë kjo organizative ose ekonomike, të shikohet me syrin politik. Prandaj, në punën e vazhdueshme për drejtimin dhe zgjidhjen e problemeve e të detyrave të Partisë, në praktikën e përditshme duhet të zbatojmë porosinë e KQ të Partisë që, krahas me dijet e duhura profesionale, arësimore etj., të gjithë kuadrot tanë dhe komunistët të jenë udhëheqës politikë, të qartë nga pikëpamja ideologjike. Vetëm kështu ata do të jenë kurdoherë në lartësinë e detyrave, do të jenë në gjendje të kapin në kohë problemet kyçe, do të punojnë me perspektivë dhe do të përcaktojnë drejt masat organizative.

Forcimi i Partisë dhe i përbërjes së saj kërkon edhe luftën kundër ideologjisë borgjeze e revizioniste si edhe luftën për formimin e ndërgjegjes socialiste të njeriut tonë të ri. Puna në këto drejtime përbën sot frontin kryesor ku është përqëndruar veprimtaria ideologjike e Partisë.

Lufta kundër ideologjisë borgjeze, kundër ideologjisë revizioniste, është një luftë që duhet të bëhet përditë, në çdo sektor të jetës sonë dhe nga çdo kuadër, nga çdo komunist e nga çdo punonjës, prandaj edukimi marksist-leninist i komunistëve kërkon një vëmendje të madhe nga ana e organizatave të Partisë, sepse sa më të përgatitur nga ana teorike dhe sa më të qartë e më të kalitur nga ana politike e ideologjike të jenë komunistët, aq më mirë ata do ta bëjnë këtë luftë. Po kështu, për të luftuar kundër mbeturinave të ideologjisë borgjeze në ndërgjegjen e njerëzve dhe për të rrënjosur te ata një botëkuptim të ri, si edhe norma të reja morale, duhet që komunistët të përvetësojnë marksizëm-leninizmin, të edukohen me parimet e larta të Partisë dhe të kaliten ideologjikisht.

Për të gjitha këto arsye kërkohet që në të ardhshmen organizatat e Partisë, duke filluar nga organet më të larta, nga komitetet e Partisë dhe nga byrotë e tyre në rrethe dhe deri te çdo komunist në veçanti, t'i kushtojnë një kujdes më të madh studimit të marksizëm-leninizmit nga ana e komunistëve dhe ngritjes së tyre politike e ideologjike.

Një nga format kryesore që përdor Partia sot për këtë qëllim është rrjeti i arësimit në Parti e në rini, i cili ka ardhur gjithnjë duke u zgjeruar dhe përmirësuar, por ka nevojë të përfeksionohet vazhdimisht. Vjetët e fundit programet e arësimit në Parti kanë qenë më të lidhura me problemet që aktualisht zgjidh Partia dhe që e preokupojnë atë, prandaj edhe interesimi i pjesëmarrësve ka qenë më i madh, edhe rezultatet kanë qenë më të mira. Është ngritur edhe niveli i propagandistëve, shumë prej të cilëve tani janë me arësim të lartë. Në disa rrethe si në Tiranë, në Lushnjë, në Shkodër, në Fier etj., ata përbëjnë shumicën. Është shtuar edhe kujdesi i organizatave bazë dhe i komiteteve të Partisë për drejtimin e arësimit në Parti e në rini. Përmirësimi i metodës së punës të komiteteve të Partisë dhe të organizatave bazë për çështjet politike e ideologjike ka dhënë rezultate pozitive. Por mbetet për të bërë akoma shumë, qoftë për përmirësimin e programeve, duke i lidhur ato më shumë me jetën, qoftë për ngritjen e kualifikimin e propagandistëve, sidomos nga ana metodike, qoftë edhe për udhëheqjen më të mirë nga ana e komiteteve të Partisë dhe organizatave bazë. Drejtoria e agjitacionit dhe e propagandës e KQ duhet t'i studjojë dhe t'i konkretizojë këto çështje më mirë. Rrjeti i arësimit në Parti dhe në rini nuk është e vetmja formë për edukimin marksist-leninist të komunistëve dhe të masave. Partia duhet të përdorë në një shkallë më të gjerë dhe me rezultate më të mira edhe punën me leksione, botimet, shtypin etj. dhe sidomos të rritë kërkesën ndaj komunistëve që ata të studjojnë më shumë vetë, të kërkojnë më shumë nga pjesëmarrësit në rrjetin e arësimit në Parti e në rini, që ata të studjojnë dhe të përgatiten më mirë për bashkëbisedimet, të kërkojnë që çdo kuadër dhe çdo komunist të lexojë vazhdimisht libra, revista e gazeta dhe të punojë pa u lodhur për ngritjen e tij teorike, politike e ideologjike.

Me një fjalë, në qoftë se themi që problemet ideologjike kanë dalë sot në plan të parë, dhe kjo është krejt e vërtetë, duhet që edhe organizatat e Partisë të vënë në plan të parë të punës së tyre çështjet politike e ideologjike, të vënë në plan të parë të punës së tyre problemet e edukimit marksist-leninist të komunistëve e të masave. Kjo do të bëjë që të kemi komunistë kurdoherë të qartë për vijën e Partisë dhe të vendosur në luftën për ta mbrojtur e zbatuar atë në jetë, të forcojmë edhe më shumë unitetin e Partisë, të kemi një Parti edhe më të fortë, në gjendje për t'u bërë ballë të gjitha furtunave dhe për ta çuar vendin tonë përpara drejt fitores së plotë të socializmit e të komunizmit.

Në të njëjtën kohë të zgjidhim më mirë, me ritme më të shpejta detyrën e ngritjes së nivelit kulturalo-arësitor të komunistëve e të punonjësve të tjerë. Për ta bërë më të qartë këtë po japim disa të dhëna mbi nivelin arësitor të efektivit të Partisë: me fillore të pambaruar 6,51 për qind, me fillore 36,93 për qind,

me 7-vjeçare 40,80 për qind, me të mesme 10,96 për qind dhe me të lartë 4,80 për qind.

Në krahasim me gjendjen në Kongresin IV ka mjaft përmirësime. Tani kemi 8,94 për qind më tepër me 7-vjeçare e 4,03 për qind më tepër me shkollë të mesme e të lartë. Shifrat flasin si për punën e mirë që është bërë, ashtu edhe për punën e madhe që mbetet për t'u bërë. Duhet të rritet sidomos ritmi i marrjes së arësimit fillor e 7-vjeçar nga të gjithë ata që i kanë mundësitë dhe pjesës më të madhe këto nuk i mungojnë, në mënyrë që të plotësohen detyrat në afatet e caktuara.

Por edhe këtë problem ne nuk duhet ta gryojmë vetëm nga disa të dhëna të përgjithshme. Çështja që na preokupon është pajisja e komunistëve me dijenitë e nevojshme për të rritur aftësitë e tyre, për të rritur rolin e tyre pararojë. Prandaj duhet të ndjekim përfitimin dhe përparimin real të tyre, rezultatet konkrete. Këto duhet t'i matim, para së gjithash, me jetën e gjallë dhe, po të shpreheshim më thjesht, me rritjen e rendimentit në vendin e tyre të punës. Po ta shohim çështjen kështu, atëherë nuk do të ketë rast për formalizëm dhe për atë komunist ose punonjës, të cilin masha ose kushte të tjera nuk e lejojnë të mbarojë 7-vjeçaren, ne nuk do të ngulnim këmbë që ta kryente këtë, por do të shtronim si detyrë që ai të bëjë mjeshtër në profesionin e tij. Nuk ka dyshim se kjo do të ishte më e frutshme.

Ngritja e nivelit arësitor e kultural të komunistëve, ashtu si edhe e punonjësve të tjerë nuk mund të kufizohet vetëm me kryerjen e arësimit të caktuar. Kushdo duhet të punojë në mënyrë sistematike për zgjerimin e njohurive të tija, pse vetëm në këtë mënyrë ai nuk do të mbetet prapa. Veprimtaria e madhe që zhvillohet në vendin tonë kërkon gjithnjë e më tepër dhe është gjithashtu për cilindo thesar i madh për të mësuar. Nuk ka dyshim se këtu duhen më shumë përpjekje nga të gjithë pa përjashtim, pasi edhe vështirësi e pengesa ka. Detyra e organizatave të Partisë është të mos u rrinë larg këtyre problemeve, të mos kufizohen vetëm me qortime ose me masa kur diskutojnë këtë problem në mbledhjet e tyre, por t'u sigurojnë komunistëve një ndihmë më të kujdesshme, më të ngrohtë e më efektive dhe individuale, sa herë del e nevojshme për kapërcimin e vështirësive e të pengesave.

Është e domosdoshme të forcojmë edhe më shumë kujdesin për rritjen e ndërgjegjes së efektivit të Partisë, për kalitjen e tyre me cilësitë e virtytet e moralit komunist nëpërmjet jetës së Partisë, të luftës për zbatimin e vijës së Partisë e të vendimeve të saj, nëpërmjet edukimit në bazë të kërkesave të Statutit të Partisë. Kjo është një çështje shumë e rëndësishme. Marksizëm-leninizmi nuk mësohet vetëm me anën e librave, dhe aq më tepër komunist i mirë nuk mund të bëhesh vetëm duke lexuar e studjuar

ata. Edukimi ideologjik duhet të lidhet ngushtë me luftën e përditshme që zhvillon Partia për ndërtimin e socializmit. Idetë që marrim nga librat gjallërohen dhe marrin forcë kur luftojmë për t'i vënë në jetë. Pjesëmarrja e gjallë në jetën e Partisë, në punë, në veprimtarinë shoqërore është kusht i domosdoshëm për forcimin e bindjeve të shëndosha ideologjike te njerëzit. Kërkesa për të punuar në mënyrë socialiste duhet të lidhet ngushtë me kërkesën për të jetuar në mënyrë socialiste, për të ecur këmba-këmbës me parimet e Partisë në gjithë veprimtarinë tonë në shoqëri, në familje e kudo.

Në këtë drejtim duhet të mbajmë kurdoherë parasysh se në ndërtimin e socializmit e të komunizmit Partia ka për detyrë themelore, në radhë të parë, të edukojë anëtarët e saj dhe pastaj masat e popullit. Kjo është detyrë kryesore, kyçi kryesor për zgjidhjen e të gjitha problemeve. Po ta zgjidhim si duhet dhe në gjithë gjerësinë e saj këtë detyrë, atëhere kemi hedhur bazat për të plotësuar në mënyrë të kënaqshme të gjitha detyrat e tjera. Anëtarët e Partisë janë nga njerëzit më të përparuar, më të pastër, por nuk duhet harruar se ata në Parti nuk janë pranuar të larë nga çdo gjë, pa asnjë të metë. Kur hyjnë në Parti ata sjellin me vete shumë gjera të mira, por sjellin edhe të këqia, mbeturina të së kaluarës, që ruhen akoma në shoqërinë tonë të re e nuk do të zhduken edhe për një kohë të gjatë. Është një realizim i madh fakti që në saje të punës së madhe të Partisë, masat punonjëse të ne udhëhiqen në veprimtarinë e tyre nga mësimet e Partisë. Por në ndërgjegjen e njerëzve të veçantë ndeshen akoma botë-kuptime e pikëpamje të huaja ideologjike, lufton e reja me të vjetrën, e përparuara me të prapambeturën, idetë e socializmit me pikëpamjet reaksionare të klasave shfrytëzuese të prapambetura dhe me presionin e ideologjisë borgjeze që na rrethon etj. Nuk do të ishte reale e objektive të mendonim se te anëtarët e Partisë nuk do të gjente vend, në përpjesëtime herë më të vogla e herë më të mëdha, kjo luftë, ky zhvillim dialektik, se nuk do të ndikonin në ta elementët negativë të trashëguar nga e kaluara. Një qëndrim i tillë do të dobësonte kujdesin për forcimin e aftësive luftarake të organizatave të Partisë, për kalitjen e komunistëve dhe për punën e tyre me masat, me njerëzit. Prandaj, me të drejtë Komiteti Qendror i Partisë është ndalur disa herë me radhë në këto çështje që ndikojnë drejtpërdrejt në veprimtarinë e Partisë. Një punë më e mirë dhe e organizuar u bë për kapërcimin e disa shfaqjeve negative siç janë tarafet, grindjet, mëritë e thasethemet, në bazë të të cilave qëndrojnë mbeturina e pikëpamje krejtësisht të huaja për botëkuptimin, moralin e shpirtin revolucionar të Partisë sonë. Edhe në të ardhshmen duhet të punojmë me kujdes dhe me këmbëngulje që miqësitë e sëmura në bazë farefisi etj., të cilat shfaqen në ndonjë organizatë partie të mos

kenë vend në marrëdhënjet e shëndosha komuniste, kurse goditjet e paramenduara, intrigat, mëritë etj., të mos gjejnë vend para kritikës së sinqertë, të hapur e parimore të Partisë.

Por lufta për çrrënjosjen e mbeturinave të së kaluarës në ndërgjegjen e komunistëve, për kalitjen e tyre të mëtejshme nuk mund të kufizohet vetëm në këto shfaqje, siç kuptohet ndonjëherë nga disa shokë ose organizata bazë, kur fjala bie për çështje të tilla. Megjithëse është kritikuar mjaft herë, përsëri puna që zhvillohet në format e arësimit të Partisë, me leksione etj., nuk lidhet si duhet me veprimtarinë e qëndrimet e komunistëve, me punën e organizatave të Partisë, me të dhënat që kanë këto dhe organet e tyre udhëheqëse. Shpesh edhe kur bëhet, nuk kemi një përgjithësim të kujdesshëm të tyre, një punë të goditur që të ndikojë me të vërtetë si duhet në komunistët, në njerëzit. Çështjet që përbëjnë edukimin komunist janë të shumta; detyra jonë është të dimë të nxjerrim më në pah ato më aktualet dhe që ndikojnë më tepër në ngritjen e ndërgjegjes së komunistëve.

Duhet theksuar gjithashtu se mbeturinat e moralit të vjetër, edhe pse herë-herë ngrenë kokën në disa anëtarë partie, ose disa shfaqje të shëmtuara të kryera nga disa elementë të futur kontrabandë në radhët tona, nuk janë aspak ato që dallojnë jetën e organizatave të Partisë. E pikërisht se nuk është kështu, se pregatitja e kalitja e komunistëve ka shkuar përpara, ato tani më tepër se kurrë tingëllojnë keq, duken si pikat e zeza në një pëlhurë të bardhë. Si të tilla ato janë të papajtueshme me detyrat e mëdha që kryen Partia, me nivelin e punës së saj dhe zvarrisen si ferrë e pengojnë ecjen tonë të vullshme. Prandaj duhet të vlerësohen drejt e të goditen më tërë forcën e duhur.

Tregues i rëndësishëm i nivelit të ndërgjegjes së anëtarit të Partisë, i devotshmërisë ndaj çështjes së komunizmit dhe i partishmërisë së tij është shkalla e marrëdhënjeve midis interesit personal dhe atij të përgjithshëm, midis interesit personal dhe atij të Partisë, e parë kjo në tërësinë e saj, në konceptet, në dëshirat, në synimet e në veprimet e komunistit. Në qoftë se interesi personal shkrihet bashkë me atë të Partisë, atëhere do të ketë më pak gabime. Shumë shfaqje të dëmshme që vërehen aty-këtu shpjegohen në një masë të madhe me largimin nga ky parim i Partisë, që është shprehje e lartë e moralit komunist. Ka edhe njerëz të tillë që me fjalë tregohen të zjarrtë për zbatimin e kërkesave të Partisë, por kjo zgjat për aq sa nuk është çënuar interesi i ngushtë personal, «qetësia e tyre», mentalitetet e tyre të padrejta, individualizmi dhe egoizmi i tyre etj. Përpara provës së parë ata fillojnë të çalojnë me të dyja këmbët. A nuk flasin për një gjë të tillë qëndrimet e palejueshme të disa shokëve, të cilët në asnjë mënyrë nuk pranojnë të punojnë larg qendrave të mëdha ose kryeqytetit, përpiqen për këtë të shpikin lloj-lloj justifikimesh,

pa u bërë merak fare për punën e Partisë, për zbatimin e porosive të saja? Shumë të theksuara janë te disa mbeturinat e bajraktarizmit, shfaqjet e mendjemadhësisë, të individualizmit borgjez. Zakonisht tipa të tillë çdo gjë e shikojnë me gjyslykët e karrieristit, nga qëllimet personale që ndjekin, nga vendi që përpiqen të zënë etj. Nga këto pozita atyre u duhet të shkelin patjetër rregullat e Partisë, të thyejnë disiplinën e saj, të bëhen ortakë me lajkatarët e intrigantët, të bien disa herë dhe në pozitë e zakoneve dhe të mentaliteteve më prapanike.

Le të marrim edhe një çështje tjetër. Fjala është te qëndrimi ndaj punës dhe pronës socialiste. Në këtë çështje, siç dihet, pasqyrohet ndërgjegjja e lartë, ndershmëria dhe heroizmi i komunistëve dhe i punonjësve tanë. Por aty del njëkohësisht në pah edhe morali i shoqërisë së vjetër, nxjerrin krye tendencat prapanike për t'i bërë bisht punës, për të marrë më shumë nga shoqëria. Në disa individë, te të cilët janë akoma të forta mbeturinat borgjeze e mikroborgjeze, vërehen orvatje për ta frenuar zhvillimin tonë përpara në rrugën e ndritur të socializmit, bile për ta kthyer edhe prapa këtë zhvillim. Nuk është puna vetëm për rastet e vjedhjeve të organizuara, që mund të bëhen nga disa njerëz krejtësisht të degjeneruar. Çështja e tyre është e qartë dhe me të drejtë i kemi dënuar rëndë. Edhe në të ardhshmen duhet të forcohet puna e Partisë në këtë drejtim, duke përqëndruar më shumë vëmendjen e duke ngritur më tepër vigjilencën politike të komunistëve e të punonjësve tanë kundër shfaqjeve të huaja të kësaj natyre. Por nuk duhen nënvleftësuar edhe shpërdorimet më të zakonshme, në formë të hapur e të legalizuar disa herë, që shpesh janë një lloj me vjedhjet e organizuara, në mos më tepër të rrezikshme. Në disa kooperativa bujqësore, p.sh., shpërdorohet pa të keq pasuria e përbashkët dhe disa herë rrethi i njerëzve të komprometuar është shumë i gjerë. Në vështirimin e parë shpërdorime të tilla mund të duken si gjera të vogla, ndërsa në të vërtetë nuk është kështu. Zakonisht, bëjnë shumë përpjekje për t'u dhënë këtë karakter vetë ata që i kryejnë. Po kur janë gjëra të vogla atëherë përse nuk ndodhin këto në oborret e tyre kooperativiste? Përkundrazi, atje tregohen shumë fanatikë, i ngrenë veshët me vend e pa vend edhe për majën e gjilpërës, si i thonë fjalës.

Një luftë më e vendosur duhet t'i bëhet shfrytëzimit të posteve të besuara për përfitime personale, ose në dobi të të afërmeve e miqve, frymës së hatëreve që është e theksuar në disa shokë. Dëmet që rrjedhin nga qëndrime të tilla janë të mëdha e megjithatë ato disa herë nuk luftohen si duhet. Gjatë vitit 1962 drejtuesit e 29 ndërmarrjeve e organizatave ekonomike kanë marrë pa të drejtë 3 milion lekë shpërblim për tejkalimin e planit dhe për ta ndrequr këtë u desh të vinte dorë qeveria. Organizatat

e Partisë duhet të ndalen seriozisht qysh në hapat e parë të këtyre veprimeve dhe t'i dënojnë ato me ashpërsi. Nga ana tjetër, në të gjitha institucionet e qendrat e punës duhet të krijohet një gjendje e tillë që të mos gjejë vend asnjë ndërhyrje e paautorizuar, në çdo formë e nga kushdo qoftë. Duhet të jetë mirë e qartë se çdo lëshim, veç të tjerave, dëmton Partinë në një nga pikat e saja më nevralgjike, në lidhjet e saja me masat. Populli ynë i njeh mirë përpjekjet e mëdha të Partisë dhe të pushtetit popullor për plotësimin e nevojave të tija, i kupton shumë mirë edhe vështirësitë. Por ai me të drejtë nuk mund të mos ngrejë zërin kur shikon se apartamenti i ri, p.sh. nuk bie në dorën e atij që ka më shumë nevojë, apo futet në punë ose merr bursë jo ai që e meriton, por ai që ka pasur të njohur etj.

Lidhur me sa u tha më sipër, ka rëndësi të madhe edukimi i komunistëve e i punonjësve me frymën e ligjshmërisë socialiste. Njohja dhe zbatimi i përpiktë i ligjeve tona është detyrë e çdo anëtarit të Partisë dhe punonjësi pa parti. Kjo do të bënte që mjaft dëme dhe shkelje të mënjanoheshin me kohë. Prandaj, organizatat e Partisë duhet të punojnë më mirë në këtë drejtim. Duhet të vihen para përgjegjësisë së Partisë dhe të masave punonjëse ata që, me dashje ose edhe pa dashje, i cënojnë e i shkelin ligjet; me një punë e kujdes më të madh duhet të ngrihet vigjilenca e komunistëve dhe e masave të popullit, duke u bërë gjithnjë më e qartë se përpara ligjit të gjithë pa përjashtim janë njëlloj.

Për të radhitur aspektet e ndryshme të mbeturinave të shoqërisë së vjetër dhe për të sqaruar me shembuj rrezikshmërinë e tyre, kur ato nuk vlerësohen drejt, nuk zbulohen e luftohen që në embrion me tërë seriozitetin e duhur, do të na duhej shumë vend. Organizatat e Partisë duhet të zhvillojnë luftë në të gjithë frontin, duke filluar qysh nga qëndrimi kundrejt punës e pronës e deri në jetën personale, me shturjet që vërehen te disa njerëz, deri te zakonet prapanike e besimet fetare. Dhe kjo duhet të jetë një punë e vazhdueshme dhe e gjerë. Kalitja e komunistëve është një proces i gjatë që do të ecë krahas, hap për hap me ndërtimin e shoqërisë së re dhe bashkë me të do të ngjitet gjithnjë më lart. Kudo dhe Partisë do të punojë për këtë kurdoherë dhe fort. Edukimi ideologjik, propaganda e Partisë do të japin rezultat e duhura kur të kapen mirë çështjet që kanë të bëjnë me veprimtarinë e jetën e organizatave të Partisë, me veprimtarinë e jetën e komunistëve. Por në këtë drejtim duhet të tërheqim vëmendjen në mënyrë të veçantë në këto çështje:

1) Të rritim rolin e organizatave bazë si shkolla të edukimit komunist. Në mbledhjet e Partisë të bëhet një punë më e kujdeshme për shqyrtimin e çështjeve dhe të qëndrimeve të komunistëve. Të bëhet një diskutim i gjallë, i bazuar në parimet e Partisë, në kërkesat e statutit. Ky diskutim jo vetëm duhet të dënojë fa-

jin ose gabimin e bërë, por duhet të ndihmojë sa më efektivisht atë që e ka kryer dhe të vlejë si një mësim i mirë për gjithë të tjerët. Patjetër, edhe në të ardhshmen, do t'i përdorim masat ndëshkimore të Partisë, por përdorimi i tyre i drejtë, jo i tepruar, i shoqëruar nga një punë e gjerë bindëse, do të rritë më tepër rolin e tyre edukativ. Çështja më e rëndësishme është të arrijmë që të gjithë komunistët të mbajnë qëndrim të drejtë, parimor e të kritikojnë pa ngurrim në kohën e duhur. Çdo shfaqje e padrejtë që mund të lindë dhe që është e papajtueshme me moralin komunist duhet të ndeshë përnjëherësh në kundërshtimin e vendosur të vetë komunistëve dhe të organizatave bazë të Partisë.

Punën e Partisë nuk e karakterizon pritsshmëria, përkundrazi ajo duhet të shkojë përpara, duke u prerë rrugën shfaqjeve negative që ngrenë kokën sa herë gjejnë ndonjë shteg. Në mbledhjet e organizatave bazë, krahas me problemet politike, ekonomike etj., duhet të trajtohen edhe çështjet që kanë të bëjnë me edukimin komunist, me rritjen e rolit pararojë të anëtarëve të Partisë. Këtu duhet të lidhim ngushtë parimet me jetën e gjallë duke përgjithësuar me kujdes eksperiencën që del nga gjendja e çdo organizate bazë, qendre ose vendi pune.

Organizatave të Partisë duhet t'u hyjnë më thellë problemeve që kanë të bëjnë me punën e sjelljet e komunistëve. Kontrolli i drejtë e shoqëror i tyre të përfshijë më mirë të gjitha anët e veprimtarisë e të jetës së anëtarëve të Partisë. Atëhere ai do të jetë i plotë e i dobishëm. Të luftohen, sidomos, si shfaqje të papajtueshme me moralin e Partisë sonë qëndrimet, si të thuash, me dy faqe të ndonjë anëtari partie, i cili ndryshe sillet ndaj përgjegjësve e ndryshe ndaj vartësve, ose ndryshe në punë dhe ndryshe në shoqëri ose në familje.

2) Në punën për ngritjen e nivelit marksist-leninist të anëtarëve të Partisë, për edukimin komunist të tyre nuk mjafton të përcaktojmë programet për rrjetin e arësimit të Partisë dhe të ndjekim zbatimin e tyre. Vazhdimisht duhet t'i pasurojmë, t'i konkretizojmë këto me gjëra që nxjerr jeta, po të jetë nevoja të bëjmë edhe ndryshime, të zbatojmë forma të tjera të përshtatshme e të rëndësishme që ndihmojnë për ta lidhur më mirë teorinë me praktikën. Puna me leksione, si një formë shumë e dobishme, duhet të bëhet sa më e gjallë në bazë të njohjes më të mirë e konkrete të eksperiencës së përditshme të organizatave të Partisë.

3) Lufta kundër mbeturinave të kapitalizmit e të feudalizmit në ndërgjegjen e njerëzve, kundër pikëpamjeve prapanike, besimeve fetare etj., mund të zhvillohet drejt e me sukses po të mbajmë gjithnjë parasysh veçoritë e shfaqjes së tyre, kushtet e veçanta të rrethit, të fshatit, të qendrës së punës etj. Kjo është një premisë e domosdoshme sidomos për punën me njerëzit pa parti. Njohja më e mirë, më e thellë e karakteristikave të veçanta të

rrethit ka ndihmuar, . . . për të përdorur masa më të matura e më të drejta në zbatimin konkret të vijës e të vendimeve të Partisë.

Arti i punës udhëheqëse e edukuese është i pandarë nga aftësia e organizatave të Partisë për të zhvilluar një punë të tillë të zgjuar, e cila t'i sjellë sistematikisht masat në pozitë e përparuar të Partisë, t'i ngrejë ato në lartësinë e ndërgjegjes së Partisë.

*
*
*

Në kushtet e luftës për ndërtimin e plotë të shoqërisë socialiste e të luftës së madhe që zhvillon Partia jonë në kuadrin ndër-kombëtar, formimi i njeriut të ri është një nga detyrat më të rëndësishme të Partisë dhe të organizatave të saja. Njerëzit tanë duhet të jenë revolucionarë të vërtetë. Bindja ideologjike marksist-leniniste, kalitja me cilësitë e virtytet e moralit komunist i bëjnë ata të përballojnë me sukses çdo situatë e armik, të jenë luftëtarë aktivë e të paepur për çështjen e Partisë e të popullit, të jenë gjithnjë në pararojë.

III

NGRITJA NË NJË NIVEL MË TË LARTË E ROLIT TË ORGANIZATAVE TË PARTISË ËSHTË GJITHNJË PROBLEMI RËNDËSISHËM I PUNËS ORGANIZATIVE TË PARTISË

Udhëheqja e organizatave të Partisë, veprimtaria e palodhur e tyre në të gjitha anët dhe në të gjitha instancat është garancia më e shëndoshë për realizimin e planeve tona, është forcë e pashtershme që vë në lëvizje punën dhe siguron suksesin e përpjekjeve të mëdha të masave punonjëse. Në luftën për zgjidhjen e problemeve, që kemi pasur gjatë kësaj periudhe, është rritur forca e organizatave të Partisë, hovi dhe aftësia e tyre organizuese e mobilizuese për realizimin e detyrave e për kapërcimin e pengesave. Është një ndër sukseset e rëndësishme të punës së Partisë fakti që kudo tani ndihet ngritja e rolit dhe e nivelit të punës së organizatave dhe të organeve të tyre udhëheqëse. Janë bërë hapa përpara për njohjen më të thellë të sektorëve, të çështjeve të veçanta e konkrete të tyre dhe, lidhur me këtë, për zhvillimin e iniciativës për të zgjidhur detyrat që nxjerr zhvillimi dhe rritja e sektorëve. Mbështetja më e fortë në kolektivat punonjës dhe tërheqja më e organizuar e mendimit të tyre krijues po bëhet gjithnjë e më tepër karakteristikë e punës së tyre dhe faktor kryesor për realizimin e detyrave.

Por rritja e rolit të organizatave bazë të Partisë për mobilizimin e të gjitha forcave krijuese të Partisë e të popullit, duhet të

jetë, si gjithnjë, në qendër të vëmendjes sonë. Detyra e përgjithshme është që ta sigurojmë këtë në të gjithë sektorët, në të gjitha degët që asnjë të mos qëndrojë më prapa e të pengojë ecjen e rregullt.

Para së gjithash, në kushtet kur është rritur niveli dhe roli i organizatave të Partisë, kur janë rritur kërkesat kundrejt tyre, kur problemet e drejtimit janë bërë më të shumta e më të ndërlikuara, kujdesi kryesor i komiteteve të Partisë duhet t'i kushtohet rritjes së iniciativës dhe të vetëveprimit të organizatave bazë të Partisë. Organet udhëheqëse të Partisë gjithë veprimtarinë e tyre duhet ta mbështetin fort dhe tërësisht në veprimtarinë e gjallë krijuese të organizatave bazë dhe të punonjësve.

Drejtimi nga qendra ose nga rrethi, sado i organizuar që të jetë, sado që t'i përgjigjet objektivisht nivelit dhe nevojave të bazës, nuk mund të kapë veçse çështjet dhe anët më kryesore të punës. Çdo ndërmarrje, qendër pune etj., ka veçoritë dhe kushtet e saja të veçanta, ka mundësitë, rezervat dhe eksperiencën e saj dhe, në radhë të parë, ka njerëzit me dijenitë e aftësitë e tyre krijuese. Prandaj, për vënjen në jetë të detyrave të Partisë, për zgjidhjen e një sërë çështjesh që dalin në mënyrë të pashmangshme gjatë zbatimit në praktikë duhet që organizatat bazë të punojnë me iniciativë dhe me shkathtësi. Në këtë drejtim ne mund të vëmë në dukje se gjatë vjetëve të fundit kemi pasur shembuj shumë pozitivë: prodhimi në vend i maqinave shirëse të markës «Adriatik» u bë me iniciativën e organizatës së Partisë në UMB-në e Durrësit; ngritja e kolonës atmosferike që solli dyfishimin e trajtimit të naftës dhe përvetësimin e prodhimit të vajrave lubrikante, kaq të nevojshme për ekonominë tonë popullore, u bënë me iniciativën e organizatës bazë të Partisë në Rafinerinë e naftës në Cërrik. Shembuj të tillë mund të sillen shumë. Mbështetja në punën e organizatave bazë të Partisë, mobilizimi më i mirë i forcave të komunistëve kanë qenë hallkat më kryesore ku me të drejtë u kap Komiteti i Partisë i rrethit të Korçës, . . . për kryerjen me sukses të detyrave. Organizata e Partisë e rrethit të Korçës jo vetëm po i kapërcen dobësitë e vërtetuara, por fitoi flamurin e kuq të garave socialiste për fazën e dytë.

Plenumi i Komitetit Qendror dhe qeveria, kanë bërë studime dhe kanë marrë vendime të rëndësishme, si për shfrytëzimin e rezervave të brendshme, për shpikjet e racionalizimet, ashtu edhe për intensifikimin e bujqësisë, për ngritjen e nivelit ekonomik, kultural e social të fshatit. Këto kanë mobilizuar organizatat e Partisë, komunistët e punonjësit dhe rezultatet janë të njohura, ato i kemi diskutuar disa herë me radhë. Studimet e rëndësishme që kanë organizuar Komiteti Qendror dhe qeveria kanë ndihmuar njëkohësisht për zgjerimin e horizontit dhe të perspektivës së organizatave të Partisë. Kjo është shumë e dobishme, sepse çështjet

të tilla të rëndësishme kërkojnë punë më të kualifikuar dhe një organizim më sistematik. Megjithatë, puna me iniciativë, vazhdimësia në ndjekjen e vendimeve nga ana e organizatave bazë të Partisë, nuk është bërë si duhet çështje e pandarë e veprimtarisë, metodë e përhershme e punës se tyre. Shumë herë ka një punë mekanike, nuk zbërthehen detyrat, prandaj vihet rrotull disa detyrave të përgjithshme dhe të njohura. Disa herë puna për zbatimin e rregullt të vendimeve merr karakter fushate dhe ndiqet vetëm atëhere kur tërhiqet vëmendja nga lart.

Një metodë e tillë nuk çel perspektiven në punë për shfrytëzimin e drejtë të të gjitha kapaciteteve materiale e njerëzore, nuk vë si duhet në veprim energjitë e njerëzve dhe krijohet rreziku që punën e gjallë të Partisë ta mbulojë rutina. Vëmendja nuk përqëndrohet kurdoherë në ato probleme, nga vënja në rrugë e të cilave sigurohet realizimi i vendimeve në tërësi dhe mobilizimi i njerëzve në këto raste nuk bëhet si duhet.

Detyra e organizatave të Partisë është të zhvillojnë më tej hovin revolucionar e krijues të komunistëve e të masave punonjëse, ta drejtojnë këtë në mënyrë të organizuar drejt objektivit të caktuar për zgjidhjen e problemeve më të ngutshme e më të nevojshme, që çojnë përpara punën e Partisë në të gjithë sektorët dhe në mënyrë të veçantë, në sektorët vendimtarë të prodhimit.

Jeta shtron përpara gjithnjë kërkesa të reja. Rritja e iniciativës së organizatave bazë duhet të shprehet në radhë të parë në faktin se sa veprojnë ato si iniciatore në kapjen me kohë të këtyre kërkesave dhe në organizimin e punës për zgjidhjen e tyre. Zotësia për të shikuar përpara, më larg nga e sotmja, për t'u kujdesur për të nesërmen, duke pasur gjithmonë parasysh perspektivat e zhvillimit, ky është tipari karakteristik i stilit të punës së Partisë.

Një fushë e gjerë veprimi ku duhet të tregohet me të gjithë forcën e saj iniciativa e organizatave bazë të Partisë është zbulimi, studimi dhe përgjithësimi i eksperiencës së përparuar. Në këtë drejtim, sidomos në prodhim, ato duhet të veprojnë si iniciatore të vërteta të novatorizmit, si përkrahëse efektive e të vendosura të së resë. Kjo përbën një moment të rëndësishëm në metodën e punës të komiteteve të Partisë dhe të organizatave bazë. Të luftosh për të zbatuar eksperiencën e përparuar, nuk do të thotë vetëm të përsëritësh pa pushim disa shembuj të shquar, të popullarizuar me të drejtë në të gjithë vendin dhe të lesh pas dorë iniciativat e shumta në shkallë rrethi apo ndërmarrjeje, kooperative bujqësore etj., të cilat, megjithëse jo të njohura, nga vetë karakteri masiv e nga pesha e tyre kanë një rol vendimtar.

Ekziston një metodë standard në ekspozimin e eksperiencës pozitive. Zakonisht, në raporte vihen përballë ndërmarrje shtetërore ose kooperative bujqësore, brigada apo skuadra që janë pak

a shumë në të njëjtat kushte, por që kanë arritur rezultate të kundërta. Por a është e mjaftueshme një praktikë e tillë? Të rëndësishme shembuj të kësaj natyre nuk do tanimë ndonjë mundim të madh; kryesorja është që, lidhur me to, të bësh një studim më të thelluar, të tregosh konkretisht rrugën që është ndjekur për të arritur suksesin dhe sidomos të marrësh masa konkrete për përgjithësimin e eksperiencës së përparuar në mënyrë që ndërmarrjet, kooperativat bujqësore, brigadat etj., që janë të prapambetura të ngrihen në nivelin e të përparuarave. Kjo duhet të bëhet më mirë nga çdo organizatë bazë për qendrën e saj të punës, nga çdo instruktor e sekretar partie për zonën, nga çdo komitet partie për rrethin dhe nga Komiteti Qendror për gjithë vendin.

Duke folur për rritjen e rolit e të nivelit të punës së organizatave të Partisë në tërësi dhe posaçërisht për rritjen e iniciativës e të vetëveprimit të tyre, është e nevojshme të ndalemi në disa probleme të organizatave bazë të Partisë në fshat.

Siç dihet, në fshat në organizimin dhe në drejtimin e prodhimit ne kemi bërë një hap më përpara duke kaluar nga kooperativa të vogla në kooperativa të bashkuara me një ekonomi më të madhe e të ndërlikuar. Në të gjithë vendin kemi 450 kooperativa të bashkuara të krijuara nga 1 324 ish-kooperativa, që përfshijnë 64 për qind të familjeve kooperativiste dhe 63 për qind të sipërfaqes së tokës. Krijimi i kooperativave të bashkuara si organizata të mëdha ekonomike, eksperiencia e deritanishme e fituar në punë dhe rezultatet e arritura deri më sot, janë një bazë e shëndoshë për të ecur përpara. Natyrisht, kjo nxjerr edhe detyra e kërkesa të reja për organizatat e Partisë, të pushtetit dhe të ekonomisë, kërkon një drejtim më të kualifikuar se deri tani; mirëpo duhet të nënvizojmë se me gjithë përmirësimet, përse u përket organizatave bazë të Partisë në fshat, ne kësaj nuk ja kemi arritur. Prandaj, kjo mbetet një nga detyrat më të rëndësishme për vjetët e ardhshëm.

Organizatave bazë të kooperativave bujqësore, sidomos të atyre të bashkuara, akoma nuk u janë përshtatur si duhet gjendjes dhe detyrave të reja më të gjera e më të ndërlikuara. Shpesh, ato drejtojnë pothuajse me ato metoda e forma, me ato ritme që ishin tipike për ekonomitë e vogla. Si rrjedhim, mjaft herë në punën e tyre krijohen boshllëqe në sektorë të rëndësishëm, sipas rastit blegtoria ose kultura të rëndësishme bujqësore mbeten pas. Shpesh, vëmendja e tyre përqëndrohet vetëm në problemet e ditës dhe harrohen problemet e tjera. Në këtë mënyrë kufizohet shumë rrethi i çështjeve që ato diskutojnë dhe problemet, që lidhen me vënjen në jetë të detyrave të mëdha që ka shtruar Partia për bujqësinë, nuk rrihen e thellohen si duhet, nuk vihen kurdoherë si duhet në rrugë. Me një mënyrë pune të tillë, patjetër, nuk mund të pritët që të zhvillohet si duhet iniciativa, puna me

perspektivë, në radhë të parë, për forcimin ekonomik, për zbulimin e shfrytëzimin e mundësive e të rezervave, që janë aq të mëdha në bujqësi.

Forcimi i punës organizative të Partisë në fshat nuk është një çështje që përfshin vetëm kooperativat bujqësore të zmadhuara. Mjaft detyra të rëndësishme ka Partia dhe në kooperativat e tjera bujqësore, sidomos në ato të zonave malore si edhe në fshatrat me ekonomi individuale. Mungesat këtu janë disa herë më të theksuara, sidomos në rastet kur kemi organizata bazë me një numër të vogël komunistësh. Për këtë, sigurisht, ndikon edhe niveli e eksperiencia e tyre më e paktë. Puna për forcimin ekonomik-organizativ të kooperativave bujqësore në këto zona është në shumë raste e pamjaftueshme. Organizatat bazë nuk i kanë si duhet në duart e tyre çështjet që kanë të bëjnë me rritjen dhe zhvillimin e ekonomisë. Puna e Partisë këtu duhet të bëjë që çdo njeri të marrë pjesë gjallërisht në punë dhe të gjitha forcat t'ja kushtojë rritjes së ekonomisë së përbashkët. Edhe njerëzit që janë më pak të mobilizuar në punë duhet ta kuptojnë e të binden thellë se forcimi i pronës së përbashkët është rruga për sigurimin e mirëqenjes së tyre.

Për ngritjen e mëtejshme të rolit të organizatave bazë në sektorët e prodhimit, një vend të rëndësishëm zë zbatimi më efektiv i së drejtës së kontrollit mbi veprimtarinë e administratave të ndërmarrjeve dhe të kryesive të kooperativave bujqësore. E drejta e kontrollit e organizatave bazë të prodhimit është kusht i rëndësishëm për veprimtarinë e tyre dhe shprehje konkrete e drejtimit të ekonomisë nga Partia, nëpërmjet organeve të pushtetit e të ekonomisë. Ajo është si një mjet i fortë për të luftuar të metat, për të shpënë përpara punën e ndërmarrjes si edhe për edukimin e komunistëve, të kuadrove e të gjithë punonjësve me ndjenjën e përgjegjësisë për realizimin e detyrave që u ngarkohen.

Përfshirja e gjithë veprimtarisë së ndërmarrjes ose të kooperativës në kontrollin e shëndoshë të organizatave bazë të Partisë është çështja më preokupante, për të cilën më tepër duhet të tërheqim vëmendjen. Kjo është një detyrë e domosdoshme për të zbuluar dobësitë e vështirësitë që pengojnë punën, për të vënë dorë me kohë në ata sektorë e probleme që ndalojnë ecjen e rregullt të planit të prodhimit në të gjitha hallkat dhe për të pasur një mobilizim më të mirë të të gjitha forcave të gjalla me parti e pa parti. Mjaft të meta, që kemi në qendra pune ose në sektorë të tjerë, shpjegohen edhe me mungesën e një kontrolli efektiv, me qëndrimin pajtues që mbajnë organizatat bazë, organet e tyre udhëheqëse e sekretarët kundrejt justifikimeve të disa drejtuesve të ekonomisë.

Po t'i quajmë drejt punët me emrin e tyre të vërtetë duhet të theksojmë se ka qëndrime e lëshime reciproke me karakter

thjesht oportunist. Nuk është fjala që, medoemos, me vend e pa vend, të ketë fërkime midis drejtorit e sekretarit të organizatës bazë, byrosë apo komitetit të saj, puna është që, duke u hyrë më thellë problemeve të prodhimit e të organizimit të tij, duke sjellë mendimet e gjithë komunistëve e punonjësve, të mbrohen në mënyrë parimore e pa asnjë lëshim interesat e Partisë e të shtetit, të zbatohen detyrat e planit që janë ligj dhe të mos tërhiqemi para vështirësive.

Nga vetë përmbajtja e tij kontrolli i Partisë është kontroll nga poshtë, është kontroll shoqëror. Si i tillë ai nuk i përket vetëm sekretarit, byrosë ose komitetit të organizatës bazë dhe nuk duhet të kufizohet në raportet që japin në mbledhjet e Partisë shokët që janë në drejtimin e ndërmarrjeve, të kooperativave etj., megjithëse kjo është formë e domosdoshme. Dobësitë e theksuara, shkeljet e rregullave e të ligjeve, shpërdorimi i pronës së përbashkët etj., që janë vërejtur në disa ndërmarrje dhe sidomos në disa kooperativa bujqësore si p.sh. në rrethin e Elbasanit, të Krujës etj., janë kryer para syve të organizatave bazë, të komunistëve dhe ata kanë qëndruar sehirxhinj ose s'kanë marrë guximin të luftojnë kundër tyre. Eksperiencia ka treguar se atje ku dobësohet sado pak interesimi i komunistëve për fatin e punëve në ndërmarrje, jo vetëm nuk realizohen detyrat e planit, por ulet shpirti luftarak i vetë organizatës së Partisë. Një shembull të tillë tipik paraqiste disa kohë më parë gjendja në organizatën bazë të SMT-së së Bilishtit. Veprimet hakmarrëse të drejtorit kundrejt njerëzve, shpërdorimi i pasurisë socialiste, mbyjtja e kritikës, mospërfillja e mendimit dhe e vërejtjeve të shokëve të tjerë, ishin në rendin e ditës, kishin gjetur shesh të lirë veprimi, kurse lufta e organizatës bazë kundër këtyre shfaqjeve, krejtësisht të huaja, ishte ulur në minimum. Një pjesë e komunistëve, ndër ta dhe sekretari i organizatës, u ishte nënshtruar këtyre veprimeve të drejtorit, ndërsa byroja e organizatës ishte shkrirë në këshillin teknik të ndërmarrjes.

Po si mund t'u lejohet komunistëve një qëndrim i tillë pasiv kur shkelet kaq rëndë vija e Partisë, interesat e saj të shenjta, si mund të pajtohet kjo me vetë anëtarësinë në Parti? Për anëtarin e Partisë nuk është e mjaftueshme të realizojë «detyrën e tij» në vendin e caktuar, qoftë edhe në mënyrë të shkëlqyeshme; ai përgjigjet për gjithë punën e Partisë dhe për këtë duhet të jetë luftëtar vigjilent e i patrembur. Pa këtë roli pararojë i anëtarit të Partisë do të kishte një kuptim krejtësisht të ngushtë dhe nuk do t'u përgjigjej qëllimeve të Partisë.

Organizatat bazë të Partisë në administratë duhet të ndikojnë në mënyrë të gjithanshme e rrënjësore për zbatimin e detyrave që kanë të bëjnë me forcimin e mëtejshëm të aparatit shtetëror dhe atij ekonomik. Në fillim duhet theksuar se organizatat bazë të Partisë nuk u hyjnë gjithnjë thellë problemeve që kanë të bëjnë me

punët e administratës, me veprimtarinë e të gjithë komunistëve e punonjësve të këtyre sektorëve delikatë e të rëndësishëm. Disa shokë, duke u nisur nga karakteri i punës së administratës, ose i shmangen kontrollit efektiv të organizatës bazë ose druhen ta shpien atë deri në fund. Të dyja këto shfaqje, që çojnë në një përfundim, në uljen e rolit të organizatave bazë, në kufizimin e tyre në çështje të dorës së dytë, duhet të mbahen mirë parasysh dhe me një punë të kujdesshme të mënjanohen. Duhet të jetë një herë e mirë e qartë se ndryshe nga ato të prodhimit, organizatat bazë të Partisë nuk kanë të drejtën e kontrollit mbi administratën, vetëm për faktin se veprimtaria e këtyre të fundit shtrihet edhe jashtë aparatit, disa herë në një territor të caktuar ose në tërë vendin. Për çështjet brenda aparatit, me përjashtim të atyre me karakter sekret, ato i kanë të gjitha të drejtat, ashtu siç i kanë të gjitha organizatat e tjera bazë të Partisë. Pa dyshim edhe këtu puna këmbëngulëse e Partisë ka dhënë rezultate. Një punë më të mirë për të ndihmuar organizatat bazë të administratës, për përgjithësimin e eksperiencës së tyre ka bërë, p.sh., Komiteti i Partisë i qytetit të Tiranës. Në këtë çështje Komiteti Qendror i Partisë është ndalur më se një herë dhe ka dhënë udhëzimet e nevojshme, por kërkesat rriten, puna e Partisë shkon kudo përpara, prandaj më të padurueshme bëhen mungesat.

Nga aparati ynë shtetëror dhe nga organet ekonomike kërkohet një punë më e thelluar për studimin e problemeve, një punë më operative e luftarake për zgjidhjen me kohë e drejtë të nevojave të bazës dhe të masave. Këto nuk bëhen si duhet. Përpjekjet për studimin e problemeve, për përgjithësimin e eksperiencës janë të pamjaftueshme. Në punën e përditshme ka akoma javashllëk e burokratizëm, disa rezervohen dhe nuk i vënë në veprim të gjitha forcat e mundësitë e tyre etj. Shkojnë njerëzit poshtë dhe në vend që të bëjnë një punë të gjallë për zgjidhjen e problemeve vijnë rrotull shkresave e akteve të kontrollit. Organizatat bazë duhet të luftojnë më mirë dhe më me kurajë kundër këtyre ose atyre shfaqjeve jo të shëndosha, duke pasur gjithnjë parasysh se njerëzit që punojnë në administratë janë më të ekspozuar të mbërthehen prej tyre. Duhet të forcojmë te çdo punonjës i administratës disiplinën e ndërgjegjshme e luftarake, përpjekjet që cilido të kryejë mirë detyrën në vendin ku punon.

Organizatat bazë në administratë nuk duhet të kujdesen vetëm se si ka punuar në një rast ose në tjetrin një anëtar i tyre ose në mënyrë të shkëputur një sektor i caktuar. Këto janë çështje që duhen shqyrtuar, bile mirë, por kujdesi ynë duhet të jetë, para së gjithash, në rritjen e rolit drejtues, ndikues e këshillues të tyre në tërë punën e institucioneve. Organizatat bazë duhet të shikojnë thellë veprimtarinë e sektorëve ku veprojnë, si i kryejnë ata detyrat, çfarë gabime, lëshime e mungesa ka në punën e tyre, çfarë

probleme nuk po zgjidhen si duhet etj. Gjithashtu ato duhet të jetojnë edhe më shumë me vendimet e Partisë e të qeverisë, të rritin luftën e përpjekjet për vënjen e tyre në jetë. Në këtë mënyrë nuk do të ketë mbledhje të njëlojta me çështje të përsëritura.

Përveç kësaj i duhet kushtuar më tepër kujdes gjallërimit të jetës së organizatave të Partisë në administratë. Është akoma një problem jo i zgjidhur si duhet fakti që disa komunistë, sidomos ata me më pak përgjegjësi, pak ose shumë pak marrin pjesë në diskutime dhe pak kritikojnë. Megjithëse aty punojnë disa herë shokë me shumë eksperiencë në punën e Partisë, një gjë e tillë elementare, por esenciale, kalon shumë herë pa u vënë re, si gjë e zakonshme.

Rritja e efektivit të komunistëve në përbërjen e organizatave bazë të Partisë, si në qytet ashtu dhe në fshat, gjerësia e problemeve me të cilat merren na vë si detyrë që t'u kushtojmë më tepër kohë e kujdes grupeve të Partisë dhe organizatave të Partisë në reparte, në sektorë, në brigada etj. Në të gjithë Partinë kemi më tepër se 1 700 grupe partie dhe rreth 840 organizata partie reparti e sektori. Jeta, praktika ka justifikuar ngritjen e tyre dhe ato po marrin një rëndësi përherë e më të madhe. Veçanërisht dy vjetët e fundit ka ecur më mirë puna për forcimin organizativ të tyre. Por eksperiencia e punës e mjaft grupeve të Partisë dhe e organizatave të Partisë në sektorë e në brigada, e sekretarëve të tyre, sidomos në fshat, është gjithnjë e paktë. Akoma ata nuk punojnë si duhet me iniciativë për kryerjen e problemeve që preokupojnë brigadën apo fermën, nuk punojnë si duhet e me këmbëngulje për organizimin e zbatimit të vendimeve dhe për aktivizimin e komunistëve. Prandaj, vëmendjen e grupeve të Partisë duhet ta drejtojmë sidomos në organizimin e zbatimit konkret të vendimeve të organizatave bazë, në aktivizimin e çdo komunisti me detyra shoqërore, në kontrollin dhe në ndihmën për kryerjen e tyre dhe në luftën e përditshme për realizimin e detyrave të sektorit, për zgjidhjen e çështjeve që dalin dhe nuk presin. T'i ndihmojmë ato që të ngrenë nivelin e punës me njerëzit. Grupet e Partisë dhe organizatat e sektorëve ndodhen më afër prodhimit, vazhdimisht midis njerëzve, prandaj, ato njohin mirë ku çalon puna, cilat janë të metat, hallet e nevojat e tyre, kanë më tepër mundësi të merren konkretisht me ta dhe, si rrjedhim, të marrin me kohë masat e duhura. Është e nevojshme që komitetet e Partisë në rrethe t'u japin një ndihmë më të afërt këtyre hallkave të rëndësishme të punës organizative të Partisë, të zbresin rregullisht në to, të përgjithësojnë e të rritin eksperiencën e tyre. Mund të thoshim, si rregull, që në qoftë se nuk ndalemi mirë në punën e grupeve të Partisë, të organizatave të sektorëve, në qoftë se nuk hyjmë thellë në çështjet e tyre, ndihma jonë për organizatat bazë të Partisë do të jetë kurdoherë gjysmake.

Ekzistenca e një numri më të madh organizatash bazë me një efektiv të konsiderueshëm komunistësh ka zgjeruar gjithashtu shumë fushën e veprimtarisë së byrove dhe të komiteteve, si organe udhëheqëse të zgjedhura të tyre. Problem serioz për organizatat bazë mbetet organizimi i zbatimit të vendimeve, vazhdimësia në ndjekjen e tyre. Ka raste që vetëm me shqyrtimin e problemit në mbledhjen e Partisë fillon dhe mbaron njëkohësisht gjithë puna, kurse dihet që ky është vetëm fillimi. Veçanërisht në disa organizata bazë është mjaft i dobët niveli i planifikimit të punës, konkretizimi dhe ndarja e detyrave dhe, lidhur me to, çështja shumë e rëndësishme e aktivizimit të komunistëve; nuk ndiqet me kujdes e sistematikisht shembulli personal i komunistëve etj. Praktika tregon se roli i byrove dhe i komiteteve, si bërthama drejtuese e organizuese, është shumë i rëndësishëm për t'i vënë më mirë në rrugë këto probleme që kanë të bëjnë me thelbin e punës së organizatave bazë.

Të gjithë e vërejmë se është rritur mjaft niveli dhe eksperiencia e sekretarëve të organizatave bazë. Por pikërisht një gjë e tillë kërkon që atyre t'u jepet një ndihmë më e kualifikuar për rritjen e nivelit, për zgjerimin e dijenive të tyre. Komitetet e Partisë në rrethe dhe aparatet e Komitetit Qendror të Partisë duhet të përmirësojnë rrënjësisht punën për ngritjen e aftësive të sekretarëve të organizatave bazë duke filluar nga ndihma në vend dhe deri te organizimi i seminarëve. Një rëndësi të dorës së parë për edukimin e tyre ka përgjithësimi dhe përpunimi i eksperiencës së organizatave të Partisë. Pa këtë në çdo formë që të jepet, ndihma nuk mund të jetë e gjallë dhe efektive.

Për forcimin e punës së organizatave të Partisë në disa qytete, që nuk janë qendra të rretheve dhe në disa zona të thella fshatare, rëndësi ka ngritja e komiteteve të Partisë. Në disa qytete që kanë rëndësi, por që nuk janë qendra rrethesh ndihet sa vjen e më tepër nevoja e një drejtimi e ndihme më të afërt, më konkrete e të përqëndruar. Mjaft probleme të tyre të rëndësishme mund të zgjidhen më mirë duke i parë në tërësi. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për disa zona të thella fshatare si p.sh. Dukagjini në Shkodër, Fani në Kukës etj. Për më tepër, niveli ekonomik, kultural e shoqëror më i ulët i këtyre zonave, mungesat në shtrirjen e organizatave të Partisë në vetë punën e tyre e në nivelin e komunistëve e bëjnë më urgjente zgjidhjen e një detyre të tillë.

Byroja Politike mendon se për këtë një masë e dobishme organizative është ngritja e komiteteve të Partisë për këto qytete e zona. Kjo do të ndihmojë për forcimin e punës së organizatave të Partisë, për gjallërimin e mëtejshëm të tyre, për aktivizimin më të mirë të komunistëve dhe për shfrytëzimin në mënyrë më të përqëndruar të forcave dhe të mundësive që ekzistojnë. Njëkohë-

sisht kjo do të vlejë për t'u thelluar më tepër në problemet e veçanta, për të përgjithësuar më me kujdes eksperiencën e organizatave të Partisë dhe do të lehtësojë kështu punën e komiteteve të Partisë të rretheve. Në mënyrë të veçantë për zonat e largëta fshatare ato do të jenë një bazë e shëndoshë organizative për forcimin e rritjen më të shpejtë e të drejtë të forcave të Partisë.

IV

PËR FORCIMIN E MËTEJSHËM TË PARTISË DETYRË SHUMË E RËNDËSISHME ËSHTË GJALLËRIMI I JETËS SË BRENDSHME TË ORGANIZATAVE TË SAJA DHE RITJA E VEPRIMTARISË SË KOMUNISTËVE

Në gjithë punën tonë duhet të mbajmë kurdoherë parasysh se forca e Partisë qëndron në veprimtarinë e anëtarëve të saj. Pa veprimtarinë e gjallë, pa pjesëmarrjen e shëndoshë, të lirë, të frutshme e krijuese të anëtarëve të Partisë në diskutimin dhe në zgjidhjen e problemeve nuk mund të ketë aktivitet partie, nuk mund të zgjidhen detyrat revolucionare e të mëdha të Partisë dhe jeta e saj dobësohet e fishket.

«Komunistët, ka thënë shoku Enver Hoxha, janë njerëz me horizonte të gjera, me mendime të zhvilluara e të përparuara, janë njerëz që përparojnë, që kanë mendime të reja dhe këto bëjnë forcën e vërtetë të Partisë sonë. Në qoftë se kjo forcë e madhe e Partisë, ky dinamizëm bolshevik i masave të Partisë nuk merret parasysh, atëherë u fishk forca e Partisë dhe mbeten komitetet e drejtuesit si burokratë të pavlefshëm»¹.

Se me ç'konsekuencë i ka vënë në jetë këto mësimet Partia jonë, e vërteton fryma luftarake dhe e freskët që sundon kudo në organizatat e Partisë, hovi revolucionar i komunistëve dhe i masave punonjëse. A mund të mendoheshin rezultatet që janë arritur, uniteti i çelniktë, aftësia luftarake dhe disiplina e hekurt, mobilizimi dhe iniciativat e mrekullueshme, në qoftë se Partia jonë nuk do të qe mbështetur fort te masat e Partisë e të popullit, në qoftë se nuk do të kishte shtruar hapur e nuk do të kishte zgjidhur me ta të gjitha çështjet, nuk do të kishte qarë të gjitha halllet? Por për ne është e qartë se, si në të gjitha çështjet e tjera, edhe në këtë fushë nuk duhet të kënaqemi me rezultatet e arritura, se sukseset që kemi pasur duhet të bëhen bazë për suksese të

¹ Enver Hoxha. Raport mbi situatën politike dhe problemet ekonomike, f. 86. Tiranë, 1950.

reja. Të bëjmë shumë më tepër përpjekje, në mënyrë që demokracia e Partisë, arma e mprehtë e kritikës dhe autokritikës të jetë kudo dhe kurdoherë bazë e sigurtë për të ecur përpara, për të flakur çdo gjë të vjetër e të huaj, për të kapërcyer çdo hendek. Prandaj, e shohim me vend të ndalemi në disa probleme që kanë lidhje me forcimin e mëtejshëm të demokracisë në Parti, të jetës së saj të brendshme.

1) Të ngulim këmbë më shumë për një pjesëmarrje sa më të gjerë dhe të gjallë të të gjithë komunistëve në diskutimin dhe në zgjidhjen e problemeve të Partisë

Kjo është një çështje me rëndësi të madhe për Partinë. Është e vërtetë se në përgjithësi kemi bërë një punë të mirë në këtë drejtim. S'ka indiferentizëm në Partinë tonë. Por prapa gjendjes së përgjithshme të kënaqshme, fshihen, natyrisht të kufizuara, disa fenomene të papëlqyera.

Ka shokë të ndryshëm në organizatat bazë të Partisë, bile edhe në forumet e Partisë që flasin rrallë, ose nuk flasin fare. Sigurisht, do të ishte e padrejtë të kërkosh që të gjithë komunistët ose anëtarët e forumeve gjithnjë të flasin medoemos për çdo çështje. Kjo do të ishte e tepërt. Por që të mos e hapin gojën asnjëherë në mbledhje të organizatës bazë apo të plenumit edhe kjo është e palejueshme. Në rrethin e Beratit e të Lushnjës gjatë vitit 1962, më tepër se gjysma e anëtarëve të plenumit nuk kishin marrë fare pjesë në diskutimin e çështjeve që kishin shqyrtuar mbledhjet e plenumit. Kjo flet për nënvleftësimin e mbledhjes ose për mungesë preokupacioni për çështjet e përgjithshme. Nuk është një formalitet i thjeshtë shtrimi në organizatën bazë apo në plenum i kësaj apo i asaj çështjeje. Jo ta bëjmë pse «duhet bërë», por sepse lind një nevojë, pse jeta na e nxjerr atë çështje në rend të ditës. Prandaj dhe duhet shoshitur mirë ajo, duhet të rrihen anët e mira e të këqia dhe të caktohen masat konkrete që duhen marrë. Çdo komunist duhet ta ndjejë për detyrë që të japë kontributin e tij në diskutimin dhe në zgjidhjen e problemeve.

Për këtë duhet të kemi parasysh sidomos:

a) *Të përgatitim dhe të organizojmë më mirë mbledhjet e organizatave bazë apo të plenumeve.* Para së gjithash duhet t'i kushtohet rëndësi zgjedhjes së çështjeve që do t'i shtrohen mbledhjes për diskutim. Një problem i zakonshëm, që është rrahur shumë herë, që s'ngjall interes të veçantë te komunistët, nuk nxit për diskutime, nuk elektrizon mbledhjen, e bën atë të mërzitshme. Plenumi i Komitetit të Partisë të qytetit të Tiranës p.sh. këta 2 vjetët e fundit ka marrë në diskutim disa herë dhe në të njëjtën

mënyrë problemin e shpikjeve, racionalizimeve dhe të prodhimeve të reja. Tema, s'ka dyshim, është interesante, por në rast se radhit njërën pas tjetrës shpikjet e bëra e llojet e mallrave të reja të prodhuara dhe në rast se në të njëjtën mënyrë e shtron këtë çështje disa herë me radhë në mbledhje, s'ka dyshim se ajo e humbet interesin, prandaj dhe nuk do të ketë diskutime ose do të bëhen diskutime që vlejné pak.

Zgjedhja e problemit që është me të vërtetë më i rëndësishëm, më preokupant dhe më interesant për t'u shqyrtuar, nuk duhet të jetë çështje vetëm e shokëve kryesorë, e sekretarëve ose byrove, por e gjithë organizatës bazë ose e plenumit. Eksperiencia e përbashkët dhe rrahja e mendimeve si kudo dhe këtu është e domosdoshme dhe e dobishme. Prandaj, këtë duhet ta bëjmë shumë më mirë se deri tani. Kjo do të ndihmojë në zhvillimin e një jete më luftarake në Parti. Pastaj, për ta organizuar më mirë mbledhjen, i duhet kushtuar, gjithashtu, më shumë kujdes përgatitjes së raporteve dhe të projektvendimeve, ose të detyrave që do të shtrohen. Përgatitja e mirë e mbledhjeve të Partisë ndihmon për zhvillimin e një jete të gjallë, për pjesëmarrjen e gjerë të komunistëve në jetën e Partisë.

b) *Për një pjesëmarrje më të gjerë të komunistëve në diskutime ndikon vetë preokupacioni që tregojnë ata për punën e Partisë në tërësi.* Vihet re një kuptim i ngushtë i detyrës si komunist, si anëtar i një forumi, vetëm për të bërë mirë e për t'u përgjegjës për punën e ngarkuar në sektorin ku komunisti punon. Kështu, jo vetëm në organizatat bazë, por dhe në plenumet dëgjon të diskutojnë vetëm për «punën e tyre» ose kur shtrohet ndonjë çështje e «sektorit të tyre». Kjo për komunistin, e sidomos për kuadrin drejtues, nuk është e mjaftueshme. Çdo anëtar partie duhet të ndjejë përgjegjësinë që ka për punën e Partisë. Në mbledhjet e organizatave të Partisë, aq më tepër në ato të forumeve duhet të sillt zëri i masës, eksperiencia e saj, kërkesat e saja. Po krijuam këtë ndërgjegje atëhere, kur të shtrohen çështjet në mbledhje të Partisë, çdo komunist, do të ketë ç'të thotë e ç'të diskutojë. Ne duhet të punojmë që të arrijmë që çdo komunist të vijë kurdoherë i përgatitur për të diskutuar, për të dhënë mendimin e tij për çështjet që do të shtrohen në këtë ose në atë mbledhje.

c) *T'i bëjmë mbledhjet e Partisë sa më luftarake e të gjalla, sa më efektive për rritjen e forcave e të iniciativës në punë të komunistëve.* Në mbledhjet e Partisë shqyrtohen, siç dihet, problemet më të rëndësishme, problemet kyçe, të cilat ndikojnë në ecjen e punëve dhe prandaj është i domosdoshëm diskutimi kolektiv i tyre, tërheqja e mendimit të të gjithë komunistëve, ndërhyrja energjike e forcës së kolektivitetit. Zhvillimi i mbledhjeve të Partisë është shprehje kryesore e demokracisë në Parti, shprehje kon-

krete e pjesëmarrjes së gjallë të masave të Partisë në diskutimin e në zgjidhjen e problemeve. Roli i tyre këtu është shumë i madh; mbledhjet e Partisë janë një formë e pazëvendësueshme për rritjen e forcave të Partisë, për t'i mbajtur ato të freskëta e me energji të reja. Pra, ato nuk ndikojnë shumë vetëm për problemin që shqyrtohet, por gjallërojnë gjithë punën e Partisë.

Megjithatë shumë herë në punën e përditshme kjo anë shumë e rëndësishme e tyre harrohet. Dhe kjo nuk ndodh vetëm në organizatat bazë, por edhe në plenumet, në aktivet etj. Prandaj, disa herë është zor të dallosh një mbledhje partie nga një mbledhje e organeve shtetërore ose ekonomike. Por nuk është vetëm kjo dhe nuk e kishim fjalën vetëm këtu. Mjaft preokupant është zhvillimi disa herë i mbledhjeve shumë zyrtare, të ngurta, të cilat nuk nxitin diskutime të lira, por i ndrydhin komunistët, i ndrydhin mendimet e tyre. Mjaft herë në këtë drejtim tregohen shumë të zellshëm disa shokë të rregullt e korrektë në punën e Partisë, por që nuk kanë mundur të kuptojnë akoma si duhet thelbin e formave organizative që përdor Partia jonë. Nuk ka dyshim se një gjë e tillë ul shumë vlerën e dobisë e mbledhjeve të Partisë, prandaj duhet ta çrrënjosim këtë praktikë si të huaj për jetën e brendshme të Partisë sonë.

2) Të zhvillojmë akoma më shumë e më mirë kritikën dhe autokritikën në Parti, si hallkën kryesore të forcimit të demokracisë në Parti, të gjallërimit të mëtejshëm të jetës së brendshme të saj

Partia jonë e ka pasur gjithnjë parasysh këtë ligj të zhvillimit dhe të forcimit dhe në radhët e saja është luftuar kurdoherë pa ngurrim kundër çdo gjëje të keqe, kundër çdo shfaqje të huaj, kundër çdo të metë e dobësie. Pikërisht për këtë, puna e përgjithshme e Partisë ka ecur kurdoherë përpara. Partia nuk ka zënë kurrë ndryshk, s'ka vuajtur kurrë nga skleroza.

Gabon ai që mendon se nuk do të ketë fare gabime. Çështja është t'i zbulojmë shpejt gabimet, t'i kritikojmë ato që të mos i përsëritim më, të nxjerrim mësim prej tyre. Duke qenë se gabime ka e do të ketë vazhdimisht gjatë punës, kundër tyre duhet luftuar vazhdimisht, prandaj edhe kritika e autokritika duhet të bëhet zakoni i jetës së brendshme të Partisë, të bëhet metodë e punës sonë të përditshme.

Për këtë, vëmendje e veçantë t'i kushtohet dhënjes llogari nga përgjegjësit, nga organet udhëheqëse të zgjedhura, para masës së Partisë.

Mbledhjet për dhënie llogari e zgjedhje në organizatat bazë të Partisë, në konferencat e Partisë, plenumet e aktivet e Partisë kanë një rëndësi të dorës së parë për gjallërimin e jetës së Partisë,

për forcimin e kritikës e të autokritikës. Fryma e tyre ndikon dhe përshkon gjithë jetën e organizatave të Partisë. Ky funksion i tyre i rëndësishëm në jetën e Partisë ashtu si edhe funksioni i mbledhjeve të tjera të Partisë është i lidhur ngushtë me zhvillimin e tyre plotësisht në frymën e dhënjes llogari, me qëndrimin e shokëve më me përgjegjësi, të anëtarëve të organeve më të larta të Partisë. Dhënja llogari, autokritika për dobësitë që vërtetohen, herë-herë nga disa shokë zëvendësohen me formula, tanimë mjaft të njohura. Zakonisht këta, për të qenë formalisht në rregull, pasi flasin për problemet, pasi e drejtojnë zjarrin kundrejt të tjerëve shtojnë se «për dobësitë mbaj përgjegjësi dhe unë që drejtoj këtë ose atë sektor». Që organet më të larta, kuadrot drejtues përgjigjen para organizatave të Partisë për sektorët që drejtojnë këtë e dinë të gjithë, kjo është abecea e punës sonë. Por për Partinë, për punën e saj si edhe për vetë kuadrin është e domosdoshme dhe e efektshme që të përcaktohet se ku qëndron përgjegjësia, ku janë mungesat dhe shkaqet e tyre. Kjo është elementare për zhvillimin e kritikës e të autokritikës. Vetëm kështu do të ndreqen ato mungesa për të cilat bëhet fjalë. Në këtë drejtim duhet të kërkojmë më tepër nga mbledhjet e plenumeve, por sidomos shumë të meta kemi në zhvillimin e aktiveve të Partisë. Ka dhe raste që këto kthehen në parada për përfundimet e arritura ose në mbledhje të zakonshme për të dhënë udhëzime. Niveli i dhënjes llogari, i kritikës e i autokritikës në plenumet, në rrethe, ndonjëherë pengohet edhe nga teprimet në mbledhjet e zgjeruara të tyre.

Duhet të kuptohet një herë e mirë se thirrjet për të diskutuar lirisht, për të kritikuar pa drojtje, pa shembullin konkret të kuadrove kryesorë, janë për anëtarët e Partisë fjalë boshe. Duhet që kuadrot të bëjnë autokritikë që të zhvillohet kritika. Në çdo forum partie, kritika duhet të fillojë në radhë të parë për vetë anëtarët e forumit. Por duhet të pranojmë hapur se kjo nuk bëhet kurdoherë dhe në disa raste këtë nuk e bëjnë as disa shokë me përgjegjësi. Disa kuadro përgjegjës i karakterizon ky qëndrim kundrejt kritikës: sa herë shkon puna mirë ajo është frut i punës së përbashkët, por lënë të nënkuptohet që më tepër është frut i vetë atyre; kur ajo nuk shkon mirë fajin e kanë të tjerët dhe autokritika që bëhet në këto raste është e tillë që në esencë faji përcillet prapa te të tjerët, te vartësit. Këtë mund ta shohim dhe në një çështje të thjeshtë, por të rëndësishme, siç është pregatitja e materialeve për byrotë e komiteteve të Partisë në rrethe. Për to përgjegjësinë e kanë sekretarët, sipas sektorëve këta edhe i firmojnë, por kritika, në të shumtën e rasteve, bëhet për instruktorët.

Qëndrimi i shokëve përgjegjës kundrejt kritikës ka rëndësi të veçantë në organizatat bazë të Partisë. Të metat disa herë kanë këtu një karakter më të gjerë e më të acaruar. Ka raste që shumë rrallë kritikohen përgjegjësit. Disa drejtorë, kryetarë kooperati-

vash bujqësore, përgjegjës të institucioneve administrative etj., kur janë vënë sidomos në pozita të privilegjuara, mbajnë në organizatat bazë pothuajse të njëjtin qëndrim si gjatë kryerjes së funksionit të tyre. Ata e vënë veten në rolin e atij që ndan «racionin e fajit» për secilin dhe përcakton detyrat. Duhet që këtyre njerëzve t'u tregohet vendi, t'i nënshtrohen plotësisht kudhrës së Partisë. Në organizatat bazë nuk ka dallime midis komunistëve, atje të gjithë janë njëlloj, anëtarë partie me të drejta të barabarta.

Nuk ka gjë më të keqe se kënaqja me vetëveten, me punën e bërë. Vetëkënaqësia çoi në tërë ato të meta që u vërtetuan në punën drejtuese të Partisë në rrethin e Korçës, që me të drejtë i ka dënuar Komiteti Qendror. Misioni dhe karakteri revolucionar i Partisë sonë kërkojnë që puna të shikohet gjithnjë me syrin kritik. Edhe puna më e mirë ka mundësi të bëhet edhe më mirë. Të kërkojmë nga vetja gjithmonë më të mirën. Kjo do të bëjë që kurrë të mos qëndrojmë në vend, por të ecim gjithnjë përpara.

Këto janë disa momente që duhet të mbahen parasysht për zhvillimin e kritikës dhe sidomos të kritikës nga poshtë.

Zbulimi i dobësive e i të metave, kritika e drejtë e tyre janë ndër detyrat kryesore të anëtarësisë në Parti. Qëndrimi kundrejt kritikës duhet të konsiderohet si një nga treguesit më të rëndësishëm të formimit komunist, të devotshmërisë së kuadrove, të anëtarëve të Partisë ndaj çështjes së socializmit dhe të komunizmit. Të kuptohet mirë nga të gjithë se kritika e autokritika janë metodë e përhershme e punës sonë, pa të cilën Partia nuk mund të ketë jetë, nuk mund të shqyrtojë e të zgjidhë si duhet problemet, nuk mund të hapë rrugën për zgjidhjen e detyrave të reja, për të ecur përpara. Prandaj, ajo duhet ta bëjë këtë vazhdimisht e pa frikë. Moskokëçarja, heshtja, miqësitë e sëmura etj., mund të tregojnë vetëm një gjë, se interesi i përgjithshëm, interesi i Partisë nuk është preokupacioni kryesor. Për mbarëvajtjen e punës së Partisë ka rëndësi të madhe që kritika të jetë e drejtë, parimore dhe e sinqertë, të nisët kurdoherë nga qëllimi për ta shpënë përpara punën e Partisë. Pas çdo kritike të tillë, sado e ashpër të jetë, njerëzit duhet të dalin më të fortë, më të shëndoshë, si shokë e vëllezër që i bashkon një qëllim i madh, të cilit i janë nënshtuar të gjitha energjitë, të gjithë interesat e veçantë.

3) Lufta e ndërgjegjshme dhe e vazhdueshme për zbatimin e të gjitha detyrave është faktor i domosdoshëm për gjallërimin e jetës së organizatave të Partisë, për forcimin e rolit të tyre

Në jetën e organizatave bazë të Partisë haset disa herë një fenomen që bie shpejt në sy: diskutojnë më tepër, bëjnë vërejtje, kritikë, propozime dhe ngarkohen me detyra vetëm një pjesë e

shokëve. Më e theksuar është kjo në mbledhjet e përgjithshme të organizatave bazë me një numër më të madh komunistësh. Por si është kujdesi për aktivizimin e të tjerëve? Kësaj në shumë raste i jepet një përgjegje e përgjithshme dhe kjo, sigurisht, jo pa arsye. Shumë herë bëhet fjalë për këtë mungesë serioze, por nuk ndalen për të përcaktuar masat e duhura organizative për të korrigjuar këtë të metë. Në organizatën bazë të kooperativës bujqësore «Jeta e Re», në rrethin e Sarandës 76 për qind të diskutimeve të zhvilluara gjatë vitit 1962 kanë qenë të shokëve me funksione në kooperativë. Dhe si të mos ndodhë kështu, kur 50 për qind e komunistëve të kësaj organizate nuk kanë ndonjë detyrë shoqërore? Këtë duhet nxjerrë mësimi që të shtojmë përpjekjet për t'i aktivizuar komunistët me detyra, për t'i hedhur në punë, në aksione të gjitha forcat pa përjashtim. Me këtë është e lidhur, në radhë të parë, rëndësia e grupeve të Partisë në organizatat e mëdha.

Por rëndësi të veçantë ka forcimi i frymës së disiplinës së ndërgjegjshme në të gjithë komunistët. Detyrat që ngarkohen, vendimet që merren duhet të zbatohen medoemos. Dhe kritika e autokritika në Parti duhet të zhvillohen pikërisht mbi këtë terren.

Forcimi i disiplinës në të gjitha këto drejtime mbetet akoma problem. Duhet të futim thellë në jetën e organizatave të Partisë praktikën e shëndoshë që detyrat e vendosura të zbatohen patjetër. Po nuk u zbatuan të alarmohet e tërë organizata. Mirëpo nuk ngjet kështu. Për këtë gjen kudo shembuj, por ne po marrim vetëm një. Në organizatën bazë të Partisë të katundit Gjinar, në rrethin e Elbasanit, u muar një vendim mjaft konkret për shfrytëzimin racional të ujit për ujitje, si faktor kryesor për rritjen e rendimenteve të kulturave bujqësore. Por në vend që disa komunistë të zbatonin vendimin e organizatës bazë, ata ujin nuk e përdorën për të ujitur parcelat e kooperativës, por ujitën oborret e tyre kooperativiste dhe të disa anëtarëve të kryesisë nga 3—4 herë, ndërsa misrin e kooperativës e ujitën vetëm një herë. Kështu për vitin 1962 kjo kooperativë mori vetëm 35 për qind të misrit të planifikuar.

Njëkohësisht duhet të ndiqet më me kujdes shembulli personal i komunistëve, duke e ngritur këtë në nivelin e kërkesave të kohës dhe duke e parë nga të gjitha anët. Është sidomos e nevojshme të kuptohet se ky problem përbën një forcë të madhe ndikuese jo vetëm mbi punonjësit pa parti, por edhe mbi vetë anëtarët e Partisë. Jeta tregon se kur disa shokë vetëm flasin për zbatimin e vendimeve, për disiplinën e Partisë etj., ndërsa vetë vepronë ndryshe, atëherë vendimet dhe detyrat e caktuara mbeten në gjysmë të rrugës. Në kooperativën e Qafëzëzit në rrethin e Kolonjës është problem pjesëmarrja e grave në punët e kooperativës. Për këtë gjë organizata bazë ka vendosur disa herë që, përveç punës sqaruese që duhet bërë me to, komunistët duhet të japin shem-

bullin personal, duke nxjerrë ata në radhë të parë gratë e tyre. Mirëpo shumica e tyre nuk e zbatuan këtë detyrë të organizatës bazë, duke shkelur në këtë mënyrë disiplinën e Partisë. Kjo ka bërë që vendimi të mos realizohet, dhe në vitin 1962 nga 118 krahe pune gra që ka kjo kooperativë muarën pjesë në punë vetëm 32; akoma më keq, gjatë 5 muajve të parë të këtij viti muarën pjesë në punë vetëm 12 gra.

Këta dhe mjaft shembuj të tjerë të kësaj natyre flasin për punën e pamjaftueshme për forcimin e disiplinës në Parti, për të krijuar dhe forcuar te çdo komunist ndjenjën e përgjegjësisë së lartë morale për zbatimin e detyrave të ngarkuara.

Demokracia jonë e Partisë nuk mund të kuptohet pa një disiplinë të hekurt, por të ndërgjegjshme. Prandaj, kur flasim për rritjen e rolit të organizatave bazë, për gjallërimin e jetës së tyre të brendshme, në radhë të parë e mbi të gjitha, duhet të mbajmë parasysh forcimin e disiplinës. Në ndihmën tonë për organizatat bazë kjo duhet të zërë vendin kryesor. Fryma e disiplinës së çelniktë duhet të karakterizojë të gjithë komunistët, të gjithë kuadrot tanë. Praktika ka treguar se atje ku ka shthurje discipline jo vetëm që nuk zbatohen detyrat, por atje s'ka as jetë partie të gjallë e luftarake. Për këtë arsye duhet ta vëmë më mirë në dorë të organizatave të Partisë kontrollin e zbatimit të vendimeve. Duhet medoemos në çdo mbledhje partie të raportohet se si u ka vajtur filli detyrave të shtruara më përpara, po qe nevoja të ndalet organizata bazë për të gjetur shkaqet e mosrealizimit të tyre, të kritikojë personat përgjegjës dhe të marrë masa të menjëherëshme për t'i vënë ato në rrugën e zgjidhjes. Kjo ka shumë rëndësi.

V

TE PËRMIRËSOJMË METODËN E DREJTIMIT NGA ANA E ORGANEVE TË PARTISË E TË SHTETIT. NË MËNYRË QË SECILI TË KRYEJË PLOTËSISHT DETYRAT E TIJA

Organet e Partisë dhe organet shtetërore e të ekonomisë kanë grumbulluar tani një eksperiencë të pasur në punën e tyre, e cila është me të vërtetë një thesar i çmuar për ta çuar edhe më përpara punën tonë.

Komiteti Qendror i Partisë, duke u nisur nga fakti se metoda e punës, stili në punë nuk kanë të bëjnë vetëm me disa forma të thjeshta organizative, por para së gjithash janë çështje botëkuptimi që bazohen në teorinë marksiste-leniniste, na ka porositur që të dimë t'ua përshtatim punën tonë interesave të vijës së përgjithshme të Partisë dhe të njohim gjithnjë e më mirë realitetin objektiv në sektorët ku punojmë. Sa herë që kanë dalë në shesh

kërkesa të reja Komiteti Qendror ka caktuar dhe detyra e forma të reja pune.

Tërë thelbi i metodës së punës është që të ngremë nivelin e punës së Partisë në lartësinë e detyrave. Kjo është një çështje shumë e gjerë. Këtu do të ndalemi vetëm në disa probleme të lidhura me metodën e punës.

1) Metoda e bindjes ka qenë dhe mbetet tipari kryesor i punës së Partisë, i të gjithë kuadrove kudo që ata punojnë

Partia jonë ka ditur gjithnjë, të vendosë një raport të drejtë midis metodës së bindjes dhe asaj të detyrimit. Në kushtet e tanishme ashtu siç e ka përcaktuar edhe Kongresi IV i PPSH kjo çështje merr gjithnjë e më shumë një rëndësi të veçantë.

Socializmi është vepër e masave të udhëhequra nga Partia. Vija e drejtë e Partisë dhe puna e dëndur e saj me masat rrit ndërgjegjen dhe aftësitë e tyre. Kur ne kemi një vijë të drejtë, e cila i ka kaluar me sukses të gjitha provat, rezultatet e pakënaqshme në disa kooperativa ose ndërmarrje e sektorë të ndryshëm si në rrethet Përmet, Vlorë e gjetkë shpjegohen në pjesën më të madhe me dobësitë e punës së Partisë me njerëzit. Ne kemi një eksperiencë shumë të vlefshme tonën si gjatë luftës dhe pas çlirimit për punën me masat, por ka anëtarë partie, bile edhe kuadro me përgjegjësi, që burokratizohen, u besojnë më shumë urdhërave e shkresave nga zyra, se sa punës së gjallë me njerëzit. Disa dehen nga sukseset, nga një lloj prestigji që ata kanë fituar dhe bëhen arrogantë e burokratë, nuk përfillin vërejtjet e kritikën e shokëve e të punonjësve, monopolizojnë punën, mbytin kritikën, bile hakmerren kundër atyre që i kritikojnë. Duhet bërë të gjitha përpjekjet për t'i shpëtuar nga një sëmundje e tillë këta shokë ose, në rast se nuk shërohen, të hiqen si të papërshtatshëm.

Në metodën e punës për të bindur masat duhet mbajtur mirë parasysh një kompleks i tërë gjërash. Njerëzit kanë probleme e detyra të veçanta për të zgjidhur, kërkesa të ndryshme nga njëri-tjetri kanë p.sh. minatori, kooperativisti, inxhinieri, mjeku, studenti, ushtari, gruaja etj., etj. Ata kanë prejardhjen e tyre, zakonet, psikologjinë, mentalitetet e tyre edhe këto duhen njohur me kujdes, duhen studjuar në mënyrë që të jetë më me efekt puna bindëse e Partisë. Jo të gjithë njerëzit, edhe ata që kanë kaluar një rrugë, një shkollë i kuptojnë përnjëherësh e njëjloj të gjitha gjërat, puna në përgjithësi nuk ndikon njëjloj mbi të gjithë, prandaj, puna e veçantë, e diferencuar, e përditshme e Partisë i bën ata që të mendojnë e të veprojnë si një trup i vetëm për zbatimin e vijës së Partisë.

Sfera e veprimtarisë së njerëzve është shumë e gjerë. Ajo për-

fshin një numër të madh problemesh si në marrëdhënjet në punë, ashtu edhe në shoqëri e në familje, që nga detyra për të mbajtur e shfrytëzuar mirë traktorin, tornon, te qëndrimi ndaj familjes, prindërve, shokut, te sjellja e veshja e kulturuar etj. e deri te gatishmëria për të bërë sakrificën më të lartë për mbrojtjen e atdheut. Prandaj, po kaq e gjerë, e gjithanshme dhe konkrete duhet të jetë edhe puna edukuese e Partisë.

Në punën bindëse me njerëzit nuk duhet lejuar nervozizmi ose mungesa e durimit. Përkundrazi, duhen dëgjuar njerëzit me kujdes, duhet futur thellë në psikologjinë e tyre, të flitet hapur me ta, t'u jepet përgjegje e drejtë e në kohë kërkesave e propozimeve të tyre, të mbahet në përgjithësi një qëndrim shumë me përgjegjësi e me respekt të plotë. Durimi, aftësia për t'i bindur njerëzit, pa bërë lëshime në vijën e Partisë, është tregues i rëndësishtëm i forcës, i kalitjes dhe i ndjenjës së përgjegjësisë së anëtarëve të Partisë, të kuadrove e të organizatave tona.

2) Të përmirësojmë edhe më tej metodën e drejtimit në ekonomi nga ana e Partisë

Për këtë është folur vazhdimisht. Në parim ky problem është i qartë dhe në praktikë rezultatet e punës janë të dukshme. Organizatat e Partisë i janë futur më mirë zbatimit të politikës ekonomike të Partisë dhe të vendimeve konkrete të saj. Megjithatë, në punën praktike, si të organizatave të Partisë, ashtu edhe në ato të ekonomisë, ka të meta. Shpeshherë komitetet e Partisë dublojnë, spostojnë ose zëvendësojnë organet e pushtetit dhe të ekonomisë në shqyrtimin e çështjeve ekonomike dhe sidomos në ndjekjen e tyre. Nga ana tjetër, disa sektorë e kuadro të ekonomisë, duke përfshirë edhe disa dikastere qendrore, nganjëherë mundohen të bëjnë një lloj ndarjeje artificiale e të dëmshme «midis asaj që është punë partie dhe asaj që nuk është».

Këto të meta dobësojnë drejtimin unik të Partisë, prandaj duhet t'i mënjanojmë sa më shpejt. Tani që niveli i kuadrove të Partisë, të ekonomisë, të kulturës etj., është rritur, jo vetëm mundësitë e shumta që kemi por edhe punët e mëdha shtrojnë me forcë që secili ta kryejë mirë detyrën e tij.

Lidhur me këtë problem duhet të jenë mirë të qarta këto çështje:

Së pari ne jemi Parti në fuqi që udhëheqim gjithë jetën e vendit, prandaj nuk mund ta ndajmë drejtimin e ekonomisë nga politika. Ne duhet t'ja nënshtrojmë gjithnjë gjithë veprimtarinë ekonomike politikës së Partisë. Ky parim rrjedh nga roli drejtues dhe organizues i Partisë në diktaturën e proletariatit gjatë gjithë periudhës së kalimit nga kapitalizmi në komunizëm. Në kundër-

shtim me pikëpamjet dhe përpjekjet e revizionistëve për ta dobësuar këtë rol të Partisë, ne duhet ta forcojmë atë, ashtu siç na mëson marksizëm-leninizmi dhe siç e vërteton eksperiencia e deritanishme. Duke u nisur nga sa u tha, Partia merret dhe do të merret me problemet ekonomike, ashtu si edhe me problemet kulturalo-shoqërore, me problemet organizative, ideo-politike, me të gjithë jetën e vendit.

Së dyti kur themi Partia duhet të merret me problemet ekonomike nënkuptojmë jo vetëm aparatet e Partisë dhe as vetëm komitetet e Partisë, por të gjithë Partinë, të gjithë komunistët atje ku punojnë. Organizatat e Partisë dhe vetë komitetet e Partisë gjithnjë duhet të luftojnë që të ngrenë rolin udhëheqës të çdo komunisti, shembullin e tij në punë dhe ndikimin e tij pozitiv atje ku punon. Në këtë kuptim edhe ata kadro partie që drejtojnë sektorët e ndryshëm ekonomikë nuk mund të katandisen në administratorë të thjeshtë, ata janë gjithnjë komunistë dhe si të tillë duhet të luftojnë për zbatimin e politikës së Partisë atje ku punojnë. Bile është e domosdoshme që çdo veprim të tyre ata ta shikojnë nga pikëpamja e zbatimit të politikës së Partisë, pa rënë në pozitë e ngushta të dikasterit ose të administratës së ndërmarrjes.

Së treti kur vjen puna për drejtimin konkret të problemeve ekonomike, Partia duhet të vëjë mirë në lëvizje organet shtetërore dhe të ekonomisë për të kryer detyrat e tyre. Mirë po punohet në këtë drejtim në rrethin e Durrësit. Komiteti i Partisë... ka ditur të mobilizojë, të aktivizojë, të vëjë para përgjegjësisë dhe t'u hapë perspektivën për punë kadrove të sektorëve të ndryshëm pa i spostuar. Kështu është rritur në këtë rreth përgjegjësia e sektorëve dhe e kadrove për detyrat që kanë dhe këto janë realizuar në përgjithësi në mënyrë të kënaqshme.

Por jo kudo punohet mirë në këtë drejtim. Në punën praktike për drejtimin e problemeve ekonomike nga organizatat e Partisë nuk bëhet mirë gërshetimi i domosdoshëm i problemeve ekonomike me ato politike dhe organizative. Këtu bëhen dublimet e spostimet. Midis shembujve të shumtë që ka, po ju sjellim vetëm një. Në fermën e Kukësit duhej të vinin rreth 500 fshatarë për të korrur të lashtat si punëtorë sezonalë. Sekretari i komitetit të Partisë kujdesohej ato ditë si mund të përdoreshin për strehimin e tyre disa hangare. A duhet që komiteti i Partisë, sekretari dhe organizata bazë, të preokupoheshin për korrjen dhe shirjen e të lashtave në fermë? Patjetër, duhet të preokupoheshin, por sigurimin e hangarëve duhet ta bënin kryetari i komitetit ekzekutiv me drejtorin e fermës, të cilët jo vetëm nuk janë më pak të interesuar, por kanë edhe kompetenca për ta bërë një gjë të tillë. Edhe ata janë persona po aq politikë sa edhe sekretari i komitetit të Partisë. Kurse sekretari i Partisë nga ana e vet duhet të mendonte se si do të punonte për t'i sjellë këta malësorë në fermë, se ka

edhe nga ata që kërkojnë bukë, por nuk zbresin të punojnë atje ku është buka, dhe si do ta organizonte punën edukuese me këta punëtorë. Kështu secili kryen detyrën e tij brenda kompetencave që ka dhe asnjë punë nuk mbetet.

Edhe në tematikën e problemeve që shqyrtojnë byrotë dhe komitetet ekzekutive të rretheve gjen gjëra ku shihet se ata i hanë bukën njëri-tjetrit, ose gjen vendime të komiteteve të Partisë që kanë krejtësisht detyra shtetërore. Ka sekretarë partie që hyjnë nga një mbledhje te tjetra me drejtorë, por që venë rrallë në mbledhjet e organizatave bazë, që bëjnë rrallë konferenca e leksione, që nuk mendojnë sa duhet si do ta ngrenë në këmbë Partinë dhe popullin për këtë ose atë problem.

Tendenca e disa kadrove të Partisë për t'u futur vetë në të gjitha çështjet dhe mungesa e aftësisë për të aktivizuar si duhet të tjerët, është një nga shkaqet e rëndësishme për këto që ndodhin. Nga ana e tyre aparatet shtetërore dhe ato të ekonomisë bëjnë presion dhe shpien në komitetet e Partisë problemet korrente dhe shtojnë burokracinë. Kjo gjë do të ekzistojë edhe në të ardhshmen, prandaj duhet mbajtur mirë parasysh, për të mos ju nënshtruar. Sigurisht, është më lehtë të shkosh nga një vend në tjetrin, të japësh udhëzime në këmbë e të kthehesh, të duket kështu se po merresh me punë, por në fakt s'ke bërë gjë ose ke bërë atë që mund e duhet ta kryente ndonjë tjetër. Puna e gjallë e Partisë, puna për edukimin e njerëzve është më e vështirë, por është një punë shumë fisnike e rezultatet e mira të saj duken në gjithë veprën e Partisë për ndërtimin e vendit dhe formimin e njeriut të ri.

Për këto dobësi kanë përgjegjësi edhe aparatet qendrore. Aparati i KQ me kërkesat e tija të shpeshta për shifrat e planit disa herë ndikon keq edhe mbi komitetet e Partisë. Evidencat ne mund t'i marrim edhe më të përpunuara nga organet e pushtetit, t'i studjojmë e të nxjerrim konkluzione për punën e Partisë dhe të organeve shtetërore e të japim edhe udhëzimet që duhen. Të dhënat, natyrisht, duhet t'i njohin veç organeve shtetërore edhe komitetet e Partisë, edhe organizatat bazë të Partisë e ato profesionale, por duhet t'i shfrytëzojnë ato për të ndërtuar punën e tyre. Dikasteret, nga ana e tyre, vazhdojnë akoma të mos u përgjigjen në kohë disa problemeve të ndërmarrjeve, prandaj këto përplasen në komitetet e Partisë.

Duke luftuar kundër këtyre të metave, ne do ta ngremë më lart udhëheqjen e Partisë, e cila është, para së gjithash, një udhëheqje politike. Ne kemi vënë detyra të mëdha për ndërtimin e bazës materialo-tekniqe të socializmit, për intensifikimin e bujqësisë, për përmirësimin e kushteve të jetës etj. Për këto detyra duhen pregatitur kadrot, duhen edukuar e mësuar njerëzit, duhet që punonjësit të bëhen plotësisht të ndërgjegjshëm. Ne ndër-

tojmë socializmin në kushte të vështira, të cilat armiqtë mundohen përditë të na i vështirësojnë. Kështu na duhet që njerëzit të kaliten gjithnjë e më mirë kundër vështirësive, t'i kapërcejnë ato me heroizëm, të jenë vigjilentë dhe të mbrojnë fitoret edhe me jetën e tyre, po të jetë nevoja.

3) Të kapim në çdo moment të caktuar hallkën kryesore në vargun e problemeve që na preokupojnë dhe të mësohemi të punojmë në mënyrë më të përqëndruar

Arti i të drejtuarit qëndron edhe në faktin nëse nga vargu i problemeve që paraqiten në një kohë të caktuar di të zgjedhësh, të dallosh e të kapësh atë që është kryesore, nga zgjidhja e së cilës varet ose lehtësohet kryerja e detyrave të tjera. Në këtë drejtim Komiteti Qendror u ka dhënë një ndihmë të vlefshme organizatave të Partisë të rretheve dhe organeve shtetërore, si nëpërmjet vendimeve e orientimeve konkrete, ashtu edhe nëpërmjet ndihmës në vend. Por gama e problemeve sa vete zgjerohet dhe gjen shpesh raste ku organizata dhe komitete partie hallakaten në shumë probleme, kapin pak nga të gjitha dhe nuk dinë ku të përqëndrohen. Këtë e shikon në tematikat, në vendimet e në detyrat që nxjerrin, në raportet e gjata e në udhëzimet që jepen në seminare ku shtrohen shumë gjëra, në planet e instruktorëve etj. Në mjaft raste detyra e përgjithshme që vihet nuk shoqërohet me masa konkrete. Që të kapësh mirë pas problemit kryesor duhet thelluar në punët, duhet vrarë më shumë mendja për shkaqet e prapambetjes ose edhe të përparimit të këtij apo të atij sektori. Këtë duhet ta bëjnë të gjithë sektorët, por më mirë se kushdo duhet ta bëjnë komitetet e Partisë, sekretari i Partisë, sepse ata i kanë edhe mundësitë më të mëdha për ta bërë një gjë të tillë. Komitetet e Partisë, e veçanërisht shokët sekretarë, duhet të dinë t'i studjojnë problemet në tërësinë e tyre, që në të gjitha hallkat të jenë udhëheqës dhe të dinë të kapin atë që është kryesore në një moment të caktuar. Sekretari i Partisë duhet të mendojë më shumë, të mos pranojë çdo gjë që i serviret, ai nuk duhet t'u nënshtrohet këtyre, nuk duhet të lejojë ta vënë përpara ose ta shtyjnë kërkesat e të tjerëve, por të studjojë mirë problemet, dhe, duke u mbështetur në këtë studim, të dijë të ndërtojë punën e Partisë. Në këtë drejtim ne kemi përparime të kënaqshme; në përgjithësi kuadrot kryesorë në rrethe... njohin më thellë dhe kapin më mirë, në punën e tyre drejtuese, hallkat më të rëndësishme të punës së Partisë. Por ne duhet të punojmë më mirë që jo vetëm sekretarët e komiteteve të Partisë në rrethe, por edhe ata të organizatave bazë, të gjithë kuadrot drejtues të jenë plotësisht në lartësinë e detyrave që kanë.

Për të siguruar rezultate të mira në zbatimin e detyrave kryesore është e domosdoshme që, për probleme të caktuara dhe në kohë të caktuar, të përqëndrohet vëmendja e të gjithë sektorëve të punës së Partisë. Në këtë drejtim kemi përdorur forma e mjete të ndryshme siç janë vendimet, seminarët, konferencat e shtypin, organizimin e fushatave dhe të aksioneve, konsultat e gjera etj. Për problemet vjetore e tremujore Komiteti Qendror ka dhënë gjithnjë orientimet kryesore. Të punosh në mënyrë të përqëndruar nuk do të thotë që brenda një kohe t'i tërheqësh të gjitha forcat dhe t'i përdorësh për një çështje të caktuar. Kryesorja është që të gjithë në rrugën e tyre të luftojnë për atë që është më preokupante. Le të marrim problemin e qëndrimit ndaj punës dhe pronës socialiste. Kush nuk ka për të bërë më shumë në këtë drejtim? Ose për problemet e fshatit, të gruas, të kursimeve etj. etj. Për këtë duhet të mendojë e të punojë më mirë edhe aparati i Komitetit Qendror, si për nxjerrjen e problemeve, për format dhe për mjetet që duhen përdorur për zgjidhjen e tyre ashtu dhe për të luftuar më mirë ngushtësinë dikasteriale në shikimin e problemeve.

4) Të luftojmë edhe më me forcë kundër formalizmit në punë

Këtu mendojmë se kemi një rezervë të madhe për të ngritur në përgjithësi nivelin e punës sonë dhe rezultatet e saj.

Kur themi të luftojmë kundër formalizmit, kjo nuk do të thotë se na ka mbytur formalizmi; jo aspak, përkundrazi karakteristika e përgjithshme e punës së Partisë është puna e gjallë, konkrete dhe me mjaft rezultate. Por ne nuk do ta kryenim detyrën, në qoftë se do të prisnim ta kritikonim formalizmin, kur ai të bëhej një sëmundje e dëmshme. Prandaj, duhet t'i kritikojmë ato shfaqje të formalizmit që kemi në disa drejtime:

Në radhë të parë, shfaqje formalizmi vihen re në shqyrtimin e çështjeve, në marrjen dhe në ndjekjen e vendimeve. Duke mos kryer një punë serioze për njohjen e plotë të gjendjes në sektorin që kontrollohet apo studjohet, disa herë bëhen analiza shumë të përgjithshme. Si pasojë, edhe detyrat e vendimet që merren nuk janë të atilla që të ndihmojnë për ta përmirësuar gjendjen. Gjashtë analiza në plenum dhe një në aktiv, shtatë, ka bërë rrethi i Pogradecit për blegtorinë gjatë 4 vjetëve e megjithatë bagëti ka më pak, ose, disa herë e ka analizuar Saranda problemin e furnizimit të qytetit me perime e përsëri gjendja nuk është përmirësuar. Kjo praktikë nuk ka të bëjë aspak me ato që mësonte Lenini dhe që ka theksuar vazhdimisht Partia jonë: — me nevojën e kontroleve e të rikontrolleve të vazhdueshme. Kontroll i vazhdueshëm nuk do të thotë që të përsëritësh gjithnjë të njëjtat gjëra

dhe as të mbetet gjendja në vend, përkundrazi qëllimi i tij duhet të jetë që sektorët dhe kuadrot të ndihmohen për ta çuar punën përpara. Prandaj, është e nevojshme, që kur shqyrtohet një sektor, të bëhet analizë e plotë e tij, të gjenden shkaqet e prapambetjes, rrugët e daljes, të kritikohen e të vihen përpara përgjegjësisë shkaktarët, të konkretizohen e të ndiqen mirë detyrat. Kjo ka të bëjë me përmirësimin rrënjësor të punës për zgjidhjen e problemeve. Sa herë që shqyrtohet, diskutohet e vendoset për një problem, në të gjitha instancat, duhet të ketë një ndryshim të dukshëm të punëve, duhet të duket një kthesë, në qoftë se mund të shpreheshim kështu. Por kjo nuk ndodh kurdoherë, sepse pregtitja dhe studimi i thellë i problemeve që analizohen nuk bëhet mirë, ndonjëherë vetë mbledhja nuk ka qenë e nevojshme, dhe sidomos sepse detyrat nuk shoqërohen me një punë të shëndoshë organizative dhe edukative. Këtu gjen vend një nga shfaqjet më të dëmshme të formalizmit në praktikën tonë të përditshme. Rezultatet e mbledhjeve dhe të vendimeve janë përsëri mbledhje e vendime të tjera gati me të njëjtat gjëra, si të thuash, mbledhja pjell mbledhjen e vendimi pjell vendimin.

Me të drejtë, nga mjaft shokë të organizatave bazë janë kritikuar komitetet e Partisë në rrethe se u dërgojnë shumë vendime. Gjatë 18 muajve p.sh. në organizatat e Partisë të naftës janë punuar mesatarisht 3 vendime në muaj. Shokë të rretheve kanë ngritur gjithashtu se edhe nga qendra u dërgohen shumë vendime të gjata dhe me detyra shtetërore. Këtë gjendje duhet ta përmirësojmë, të heqim dorë nga vendimet e shumta, në mënyrë që t'i lëmë më shumë iniciativë bazës, por të sigurojmë edhe më mirë kontrollin për zbatimin e tyre.

Në punën me vendimet ka akoma shumë të meta duke filluar që nga përpilimi i tyre. Gjen shpesh vendime të gjata me detyra të përsëritura dhe shumë të përgjithshme. Nganjëherë, përpjekjet për t'i konkretizuar vendimet përfundojnë në organizimin e disa mbledhjeve dhe analizave të tjera, siç ndodhi në Tepelenë ku në 9 vendime të byrosë caktohen 36 analiza për çdo organizatë brenda 1 viti. Këtu ka një punë shumë formale; përpilimi i projekt-vendimeve apo përpunimi i tyre pas mbledhjeve bëhet pa shumë përgjegjësi. Vendimi është një dokument me rëndësi, prandaj ai duhet përpunuar me kujdes. Ne duhet ta shtrojmë çështjen kështu: të mësohemi të bëjmë vendime të shkurtëra dhe konkrete për të gjithë sektorët.

Edhe praktika që përdoret për punimin e vendimeve nuk është në çdo rast e drejtë. Pse duhet që të gjitha vendimet të punohen në organizatat bazë? Edhe për disa vendime të qendrës, gjen rekomandime të tilla: të punohet në këtë datë, në këtë mbledhje etj. Ne duhet të lëmë më shumë iniciativë në këtë drejtim. Esencialja është që për çdo vendim sektorët përkatës të mobilizohen për ta

zbatuar, kurse cilat janë format që do të përdorë komiteti i Partisë për ta bërë të njohur vendimin, për t'i sqaruar punonjësit etj., këtë lë të mendojë konkretisht ai në çdo rast. Të heqim dorë nga një praktikë formale sipas së cilës bëhet një listë e të deleguarve, u jepet vendimi dhe nisen për ta punuar...

Disa herë me vendimet bëhet një punë e thatë, e ngushtë dhe mekanike, isi në zbërthimin e detyrave për ndjekjen e zbatimitin e tyre, ashtu edhe në punën për edukimin e njerëzve, për t'i bërë ata të ndërgjegjshëm jo vetëm për drejtësinë e vendimeve, por edhe për mundësitë praktike në zbatimin e tyre, për përfitimet që do të kenë. Kësaj ane duhet t'i kushtojmë shumë kujdes, të bëjmë me të vërtetë një punë të gjallë partie me të gjithë ata që do të punojnë për zbatimin e vendimit, që ta shoqërojnë atë me një sërë formash pune nga më të përshtatshmet.

Një aspekt tjetër ku duket formalizmi janë mbledhjet. Ne bëjmë jo pak mbledhje, por e vërteta është se jo të gjitha mbledhjet japin rezultatet e dëshiruara. Disa i konsiderojnë mbledhjet si masën më të rëndësishme organizative që marrin, kur punët nuk u shkojnë mirë dhe në vend që të raportojnë për gjendjen e punëve, raportojnë për mbledhjet.

... Edhe në të ardhshmen ne do të bëjmë mbledhje, por duhet të përgatitemi seriozisht për to. Vetëm atëherë ato do të jenë të dobishme, përndryshe, bëhen të dëmshme, dhe i zënë kuadrot me një punë pa fruit. Në raportet që paraqiten në to shpeshherë ka shumë gjëra të hedhura e të rreshtuara njëra pas tjetrës, ku pjesëmarrësit e tjerë e kanë vështirë të gjejnë cili është problemi kryesor. Prandaj, t'i bëjmë ato më të shkurtëra, të ngremë problemet kryesore, sintezën e punës së Partisë, t'i ndërtojmë ato në atë mënyrë që t'u japim mundësi të tjerëve të mendojnë e të diskutojnë. Përveç kësaj, në raportet e në diskutimet ka disa herë edhe lavdërime pa vend. Kështu p.sh., në raportin që u mbajt në plenumin e Komitetit të Partisë për rrethin e Pukës, pa u analizuar thellë dobësitë e të metat, ka konkluzione si këto: «... rezultate të tilla janë mahnitëse»... ose «kemi arritur rezultate të mira, të cilat janë për ne një mburrje e drejtë»... E vërteta është që ne kemi suksese, bile të mëdha, por kjo në asnjë mënyrë nuk duhet të lindë vetëkënaqësinë dhe mburrjen. Të forcojmë më tej kritikën, t'u futemi thellë problemeve, se edhe në sektorët që shkojnë mirë do të gjejmë boshllëqe.

Njëkohësisht duhet të shikojmë edhe praktikën e diskutimeve. Është e drejtë që për mbledhjet duhet të përgatitemi, diskutimet nuk duhet t'ja lëmë spontaneitetit. Gjithashtu veprojnë formalisht ata shokë, të cilët pasi kanë marrë një këshillë për të trajtuar ndonjë çështje e pregtitit atë me shkrim dhe e lexojnë në mbledhje, sikur para tij të mos jetë lexuar asnjë raport e asnjë diskutim tjetër. Disa herë diskutimet marrin formën e raporteve

që kapin nga pak e shumë çështje, por asnjë nuk analizon. Duhet që në to të ngrihen probleme dhe të sillen eksperiencat e punës, nga çdo diskutim të përfitojnë dhe të mësojnë të tjerët. Nga ana tjetër, duhet të kritikohen qëndrimet joserioze të disa shokëve, të cilët mund të rrinë shumë nëpër mbledhje, por nuk mbajnë asnjë shënim.

Jo gjithnjë udhëzimet e konkluzionet që merren në mbledhjet çohen të plota e të konkretizuara deri në bazë. Disa herë bëhet një shkarkim i thjeshtë mekanik i atyre gjërave që janë marrë. Kjo bëhet edhe nga disa sekretarë të parë, kur kthehen në rrethe: ata hapin fletoret e shënimeve dhe flasin. Po të ishte kjo një punë parapregatitore, mund të konsiderohej jo fort e keqe, por shpesh quhet fillimi dhe mbarimi i asaj që duhet bërë. Duke ndjekur këtë rrugë, mjaft sekretarë organizatash bazë disa herë nuk u thonë asgjë organizatave kur kthehen nga mbledhjet që bëhen në rrethe. Kjo e metë duhet luftuar. Duhet të heqim dorë nga shkarkimi mekanik i gjërave; pas çdo mbledhjeje, ata që kanë marrë pjesë në të duhet të mendojnë ç'do të bëjnë dhe të marrin masat konkrete, ndryshe fletoret e një numri të caktuar shokësh, që i thërresim më shpesh në mbledhje, do të mbusheshin, po udhëzimet e Partisë nuk do të shkonin si duhet deri në bazë, atje ku vendoset fati i zbatimit të tyre.

Ka edhe aspekte të tjera në jetën praktike, ku shfaqet formalizmi. Prandaj, është e nevojshme që të bëhet një luftë e vendosur kundër kësaj të metë, duke ngritur cilësinë e punës, duke u thelluar gjithnjë e më mirë në vijën dhe në vendimet e Partisë dhe në njohjen e plotë të gjendjes në sektorët ku punojmë. Formalizmi ndrydh iniciativat krijuese të njerëzve dhe të kuadrove, i edukon ata keq dhe i shkëput nga jeta. Kjo është një karakteristikë e huaj për ne dhe si të tillë duhet ta luftojmë.

5) T'i përdorim në mënyrë më të frutshme të gjitha format e punës sonë

E gjithë puna organizative e Partisë dhe e organizatave të masave apo e organeve të pushtetit shërben për të siguruar realizimin me sukses të vijës së Partisë në të gjithë sektorët dhe për të gjitha problemet. Me punë organizative merren e duhet të merren gjithnjë e më mirë që të gjithë sektorët e të gjithë kuadrot nën udhëheqjen e Partisë. Çdo pakujdesi në këtë drejtim ka pasoja negative.

Ne kemi një sistem të tërë pune, masash e formash organizative që sigurojnë zbatimin në jetë të parimit të ndërtimit të Partisë e të shtetit të demokracisë sonë socialiste. Këto janë forma të sprovuara të rrugës sonë revolucionare, të cilat duhet t'i zbatojmë me konsekuencë.

Ne zhvillojmë çdo vit konferenca partie, kemi plenumë, aktive, këshilla e komisione, asamble, këshilla prodhimi, kolegji etj., etj. Të gjitha këto forume e forma organizative, me parti e pa parti, kanë një rëndësi shumë të madhe parimore dhe praktike. Këto janë ndërtuar në bazë të centralizmit demokratik në parti dhe në shtet, prandaj funksionimi i mirë i tyre siguron zbatimin me sukses të këtij parimi shumë të njohur të drejtimit. Nëpërmjet këtyre formave ne sigurojmë udhëheqjen kolegjiale dhe tërheqjen e masës së Partisë e të punonjësve në drejtimin e problemeve të Partisë e të shtetit. Në këto forume rritim në mënyrë të vazhdueshme ushtrinë e pafund të kuadrove drejtuese të Partisë, të shtetit, të ekonomisë etj. Por edhe në këtë drejtim kemi të meta. Ndonjëherë lihen pas dore mbledhjet e tyre në bazë të rregullave e të afateve. Dhe jo vetëm kaq. Ajo që ka rëndësi themelore është përmbajtja e punës së tyre, rritja e përgjegjësisë së këtyre organeve dhe anëtarëve të tyre veç e veç. Disa herë ato spostohehen, nuk përdorin plotësisht kompetencat dhe nuk kryejnë detyrat që kanë, disa herë atë që duhet ta bëjë asambleja p.sh., e bën kryetari ose atë që duhet të bëjë këshilli i prodhimit e bën organizata bazë e Partisë etj. Këto të meta ne duhet t'i mënjanojmë dhe t'i japim secilit kompetencat që i takojnë. Partia duhet të punojë që t'i gjallërojë organizatat bazë duke rritur përgjegjësinë e komunistëve të zgjedhur në to. Duke edukuar kuadrot drejtues të tyre dhe duke i orientuar ata në punë, të bëhet që të shtrohen e të diskutohen në të gjitha format organizative që kemi probleme interesante e të përgatitura me kujdes, të jepet llogari rregullisht përpara masës dhe të nxirren mësim nga eksperiencia e fituar. Ne kemi shumë shembuj të mirë të përdorimit të frutshëm të formave ekzistuese organizative. Një shembull i mirë ishte p.sh., ajo që bëri Komiteti i Partisë i naftës me krijimin e organizatës bazë në pusin e Divjakës, për aq ditë sa vazhdoi puna e mbylljes së pusit, veprim që pati një rezultat të shkëlqyer.

Duhet thënë se disa herë këto forma organizative nuk aktivizohen edhe nga pakujdesitë e nënvleftësimet, nga mungesa e aftësisë së organeve dhe kuadrove drejtues, nga ngushtësia që shfaqet disa herë, duke u munduar që punët të kryhen kryesisht me anën e aparateve, apo të njerëzve me rrogë. Në këto raste nuk kuptohet rëndësia e punës me masat, tërheqja e mendimit krijues të tyre në të gjithë jetën e vendit.

Lidhur me këtë ne duhet të luftojmë edhe një sërë të metash që vihen re në punën e disa kuadrove që i ndrydhen e nuk u japin gjallëri këtyre formave, siç është tendenca e komandimit, fodullëku e mendjemadhësia. Ka shokë që harrojnë se në postet që mbajnë i ka zgjedhur Partia dhe populli, prandaj duhet të përgjigjen rregullisht për veprimtarinë e tyre dhe të mbështeten në

organin që i ka zgjedhur. Ata harrojnë se mendimi kolektiv i Partisë, i forumit, i asamblesë, i këshillit etj., është më i mirë se sa i një sekretari apo kryetari. Në asnjë mënyrë nuk i lejohet përgjegjësit t'i shikojë bashkëpunëtorët e tij nga lart poshtë dhe as të veprojnë prapa krahëve të tyre pa i pyetur ata. Përkundrazi, besimi i madh të shokët, të masat dhe, bashkë me këtë, kontrolli e ndihma për ta, respekti për punën, aftësitë dhe përgjegjësitë e tyre, shembulli në kritikë dhe në autokritikë, qëndrimi gjithnjë parimor, thjeshtësia dhe urtësia, të gjitha këto, duhet ta karakterizojnë udhëheqësin. Në duhet të bëjmë që masat e Partisë, masat e popullit, t'i shikojnë forumet dhe shokët e zgjedhur gjithnjë më mirë e në lartësinë e përgjegjësive që kanë.

Partia duhet të punojë që të bëhet një punë më e madhe për edukimin e kuadrit, nëpërmjet jetës në këto forume dhe formave të tjera. Po kështu, më shumë kujdes duhet treguar edhe për njerëzit që zgjidhen në to. Disa herë nuk i zbatojmë drejt kriteret, nuk mbajmë mirë parasysh cilësitë personale të këtij ose të atij kandidati, por anojmë nga posti që ai ka. Kjo ka bërë që disa kadro zgjidhen në këshilla apo plenum, venë e vijnë nëpër mbledhje, por e dinë se janë aty për funksionin shtetëror që kanë dhe jo si anëtarë të këtij forumi. Mund të kesh një përgjegjësi në administratën shtetërore ose në organet ekonomike, por mund të mos jesh jo vetëm në plenumin e Partisë, por as në atë të Bashkimeve Profesionale. Prandaj, kandidaturat për në organet e zgjedhura duhet t'i nxjerrim nga aktivistët më të mirë shoqërorë, nga ata që i kanë të gjitha cilësitë e virtytet e tjera të nevojshme.

Veç këtyre, në punën e Partisë dhe të sektorëve të tjerë përdoren shumë forma të tjera pune, kontrolli, edukimi etj. Edhe këtyre ne duhet t'u kushtojmë shumë kujdes, sidomos atyre që kanë të bëjnë me ndihmën për bazën, për edukimin e mobilizimin e punonjësve.

Baza ka nevojë për më shumë ndihmë, por jo për të deleguar formal dhe as për kujdestari të tepruar, ajo ka nevojë për ndihmë të kualifikuar që të rritë iniciativën dhe vetëveprimin e saj. Shumë të deleguar venë në bazë, por jo të gjithë japin rezultate. Shumica e të deleguarve venë për punim vendimesh. Komiteti i Partisë nuk mund ta njohë jetën dhe veprimtarinë e organizatave vetëm me të deleguarit që punojnë vendime. Në organizata duhet vajtur më shpesh kur ato kanë mbledhjet e tyre, duhet vajtur para mbledhjes për t'i përgatitur ato më mirë, duhet vajtur edhe mbas mbledhjes për të ndihmuar në zbatimin e vendimeve që merren. Komiteti i Partisë duhet t'i ndihmojë organizatat edhe për tematikën e problemeve, por këtë tematikë të mos ua diktojë nëpërmjet vendimeve që merr, po të diskutojë me shokët e organizatës dhe bashkë me ta të arrihet në përfundim se çfarë është më e rëndësishme të diskutohet.

Rëndësi të posaçme duhet t'u kushtojmë formave të kontrollit nga poshtë, mbledhjeve me punonjësit, konsultave, kontakteve të gjalla me njerëzit. Lidhjet e ngushta me masat kanë qenë gjithmonë karakteristikë dalluese e punës së Partisë, garanci për fitoret tona. Këtë traditë shumë të mirë të Partisë ne duhet ta mbajmë, ta zhvillojmë, ta pasurojmë. Kështu do të mund të gjallërojmë të gjitha format e punës, të ngremë përmbajtjen e punës sonë.

6) Të njohim më thellë dhe të drejtojmë më konkretisht punën e organizatave të masave, forcimin organizativ të tyre

Për punën e organizatave të masave kemi folur e diskutuar shpesh, janë bërë edhe plume të veçanta të KQ të Partisë, gjithashtu Byroja Politike ka shqyrtuar herë pas here çështje të veçanta të Bashkimeve Profesionale, të rinisë e të gruas. Të gjitha këto dhe vetë puna e kuadrove, që ka caktuar Partia të punojnë me këto organizata, kanë bërë që të përmirësohet në mënyrë të ndijshme puna për edukimin dhe për mobilizimin e masave. Prandaj, këtu do të ndalemi vetëm në disa çështje të punës së Partisë me organizatat e masave:

a) Organizatat e Partisë duhet t'u futen më thellë problemeve dhe jetës së organizatave të masave. Kjo gjë duhet bërë më mirë si nga organizatat bazë, ashtu edhe nga vetë komitetet e Partisë. Disa herë organizatat e Partisë i udhëheqin në përgjithësi organizatat e masave, merren me mbledhjet, me aksionet e këtyre organizatave dhe me kaq e konsiderojnë punën të kryer. Edhe me këto duhet marrë, por duhet të mendojmë më seriozisht për disa gjëra të jetës së rinisë, të punëtorëve e të grave të vendit tonë. Si jeton, si punon, si mëson e dëfren rinia e kooperativës, e ndërmarrjes ose e qytetit apo e fshatit — ja një problem preokupant për organizatat e Partisë, i cili duhet studjuar konkretisht për çdo organizatë, duhen studjuar mjetet dhe format që ato kanë, përmbajtja e punës në to, a i plotësojnë këto kërkesat e rinisë dhe ç'mundësi të tjera ka. Duhet të na preokupojë çdo shfaqje negative në radhët e të rinjve për ta mbajtur rininë gjithnjë të pastër, të gëzuar dhe të ndërgjegjshme për misionin e saj. Organizatat e rinisë nuk duhet të lejojnë që shoku i tyre të mos punojë e të mos mësojë mirë, të mos sillet në mënyrë të kulturuar në shoqëri e në familje, të mos jetë një aktivist i mirë shoqëror, të përbuzë punën, ose të mos shkojë atje ku e do interesi i Partisë e i popullit. Në këtë kuptim, duhet t'i forcojmë më shumë organizativisht organizatat e rinisë, të gjallërojmë jetën e tyre, t'i bëjmë ato më të zhdërvjellta, të rritet roli i tyre për edukimin dhe për mobilizimin e të rinjve. Problemet e rinisë janë të shumta dhe delikate, që nuk mund të trajtohen lehtë, ato duhen njohur thellë. Mbi të gjitha

duhet mbajtur parasysh se rinia është e ardhshme e Partisë, nga radhët e saja do të shtohet e përtërihet Partia, të rinjtë janë kuadrot, punëtorët, prindërit e ardhshëm që do ta çojnë edhe më përpara veprën e Partisë sonë heroike. Këto duhen mbajtur mirë parasysh, si nga organizatat e Partisë, ashtu edhe nga kuadrot e komitetet e rinisë. Vetëm kështu ato do të bëjnë një punë më të thelluar, do të bëhen më të shkathta, më me iniciativë, më krijuese e më konkrete në punën e tyre me rininë.

Po kështu, probleme të rëndësishme kanë punëtorët, radhët e të cilëve janë shtuar e do të shtohen gjithnjë me elementë të rinj, pa kalitjen dhe eksperiencën e nevojshme. Organizata profesionale është shkollë e edukimit komunist për punëtorët, por, që ajo ta kryejë mirë këtë rol, duhet një punë më konkrete si nga Partia, ashtu edhe nga shokët e Bashkimeve Profesionale, jo duke u mbytur në forma, por duke rritur rezultatit e tyre. Ose le të marrim, p.sh., çështjen e përpjekjeve për të rritur personalitetin e gruas. Kjo çështje nuk zgjidhet me një ditë dhe as duke e përsëritur këtë direktivë, po duhet studjuar konkretisht gjendja e grave në çdo fshat apo zonë, të përcaktohet ç'duhet bërë etj.

Partia duhet t'i ndihmojë organizatat e masave, t'i këshillojë, t'u hapë perspektiva të gjera për punën e tyre. Që të bëhet mirë kjo, duhet njohur mirë gjendja e rinisë, e punëtorëve, e grave dhe në përshtatje me vijën e vendimet e Partisë të përcaktohen masat konkrete. Orientime të qarta ka dhënë Partia bile për secilën organizatë dhe tani këto duhen zbrëthyer më mirë. Në këtë drejtim, edhe shokët e organeve qendrore të këtyre organizatave duhet të thellohen më shumë dhe të tregohen më të shkathët në këto probleme shumë të rëndësishme.

b) Duhet të kujdesemi më mirë për edukimin e aktivitetit të organizatave të masave. Dihet se organizatat e masave kryejnë punën e tyre me aktivitetin që kanë. Sa më i gjerë, sa më i përgatitur dhe i gatshëm të jetë ky aktiv, aq më mirë do të shkojnë punët. Puna bëhet në këtë drejtim, por megjithatë, kjo mbetet akoma një punë e ngushtë dhe jo e kualifikuar. Kuadrot e organizatave të masave në rrethe dhe në bazë kanë vështirësi në këtë çështje, sepse të aktivizosh mirë të tjerët nuk është e lehtë, duhet të dish, prandaj, ata kanë nevojë për udhëheqjen e Partisë edhe në këtë drejtim. Komitetet e Partisë duhet të kujdesen që të forcohen këto aktive rreth çdo organizate, të kujdesen për planet e edukimit të këtij aktiviteti, për t'i shtruar atij probleme konkrete, për të cilat duhet të mobilizohen dhe të mësohen si të punojnë, për ta përdorur këtë në mënyrë sa më të frutshme. Kjo duhet bërë më mirë në rreth, në bazë. Nga radhët e aktivitetit ne duhet të rritim kuadrot për këto organizata. Duhet thënë se deri tani në këtë çështje është ecur ngadalë. Po të heqësh, për shembull, sekretarin e rinisë ose përgjegjësen e gruas nga një rreth, të del shumë i vështirë zëven-

dësimi i tyre, jo se nuk ka njerëz, por se është punuar dobët për t'i njohur dhe përgatitur aktivitetin më të mirë. Prandaj, në përgjithësi duhet shtuar kujdesin për punën me aktivitetin e këtyre organizatave.

c) Organizatat e Partisë duhet të bëjnë një bashkëvendim më të përqëndruar të forcave të organizatave të masave për problemet kryesore që kanë. Organizatat e masave janë leva të Partisë, prandaj, këtë funksion do ta kryejnë gjithnjë e më mirë, kur organizatat e Partisë do të dinë t'i aktivizojnë plotësisht dhe në mënyrë të përqëndruar.

Në të gjithë vendin organizatat e masave janë udhëhequr në veprimtarinë e tyre nga vija dhe nga vendimet e Partisë. Kjo ka qenë dhe mbetet baza e bazave, jeta e këtyre organizatave. Por organizatat e Partisë nuk kanë treguar gjithnjë aftësitë e nevojshme për t'i mobilizuar si duhet këto leva. Në punën e përditshme asnjë problem nuk mund të zgjidhet pa pjesëmarrjen e masave. Prandaj, ato duhen mbajtur mirë në korrent me problemet që preokupojnë organizatën dhe jo vetëm në përgjithësi, por konkretisht për detyrat që kanë. Ka disa probleme të veçanta që duhen zgjidhur me pjesëmarrjen e më shumë se një organizate, siç janë p.sh. problemet e të rejave, të grave punëtore etj. Ç'duhet bërë për këto probleme, si duhet të punohet për zgjidhjen e tyre, ç'detyra duhet të kryejë çdo organizatë? Probleme të tilla duhen diskutuar bashkërisht. Duke punuar bashkërisht, problemet zgjidhen më lehtë e më shpejt.

Në këtë punë komitetet e Partisë duhet të kenë kujdes të mos i zëvendësojnë organizatat e masave, as të mos lënë pas dore problemet e veçanta të tyre, por përkundrazi t'i bëjnë ato të kryejnë me iniciativë të gjitha detyrat që u ngarkon Partia.

Edhe vetë shokët sekretarë të komiteteve të Partisë duhet të punojnë më mirë në këtë drejtim.

Partia ka gjetur gjithnjë një mbështetje shumë të fuqishme në organizatat e masave në tërë luftën dhe punën e tyre. Forcimi i mëtejshëm i punës së Partisë në këto organizata është një domoshmëri që lidhet me të gjitha detyrat e mëdha që kemi përpara.

Shokë,

Ne shqyrtojmë në këtë plenum të Komitetit Qendror një problem me rëndësi të madhe, atë të forcimit organizativ të mëtejshëm të Partisë.

Partia jonë, Komiteti i saj Qendror me shokun Enver në krye, duke u qëndruar kurdoherë besnike mësimëve të pavdekshme të marksizëm-leninizmit, duke pasur kurdoherë një vijë të përgjithshme të drejtë, kanë vënë në jetë me besnikëri doktrinën marksiste-leniniste mbi Partinë. Prandaj, ne kemi një Parti të mrekullueshme të kalitur politikisht dhe ideologjikisht, të fortë organi-

zativisht, të denjë e të zonjën, në nivelin dhe në lartësinë e qëllimeve dhe të idealeve të saj. Këto cilësi të larta të Partisë sonë u krijuan, u forcuan dhe u zhvilluan nëpërmjet betejave të ashpra me armiqtë e shumtë e të tërbuar. Tani, të gjithë e shohin qartë, edhe ata më skeptikët, se sa të drejtë ka pasur Partia jonë që, pa asnjë hezitim e në kohën e duhur, ka dënuar dhe flakur nga radhët e saja fundërina të tilla si Anastas Lulo e Koçi Xoxe, Tuk Jakova e Bedri Spahiu, Liri Gega e Liri Belishova, se sa largpamëse dhe njëkohësisht të vendosura e heroike kanë qenë qëndrimet e saj. Sa më shumë vjet luftërash për fitoren e çështjes së madhe të klasës punëtore, kalojnë, aq më madhështore del vepra e Partisë sonë, aq më shumë ndrit vija e saj e drejtë marksiste-leniniste.

Byroja Politike jorastësisht vendosi të shtrojë këtë problem para këtij plenumi. Në vitin 1960, siç dihet, për çështjet organizative të Partisë kemi bërë një plenum të veçantë. Në Kongresin IV këto probleme përsëri zunë një vend të rëndësishëm. Për zbatimin e detyrave të caktuara, shumë herë është ndalur Byroja Politike e Sekretariati dhe, kur janë shqyrtuar probleme të tjera, nuk i kemi ndarë këto nga puna për forcimin organizativ të Partisë. Por, duke marrë parasysh detyrat gjithnjë më të mëdha që kemi si para vendit tonë, ashtu dhe para lëvizjes komuniste ndërkombëtare, duke u nisur gjithnjë nga roli vendimtar i Partisë për realizimin e këtyre detyrave, nga disa të meta që vihen re në punën tonë të përditshme, menduam se është e nevojshme të diskutojmë përsëri, në mënyrë të posaçme, disa probleme shumë të rëndësishme që kanë të bëjnë me forcimin e mëtejshëm të Partisë dhe të tërë punës së saj.

Ne i kemi vënë vetes qëllime dhe detyra shumë fisnike, por njëkohësisht të mëdha e të rënda: të ndërtojmë plotësisht shoqërinë socialiste në vendin tonë, ta bëjmë jetën e popullit gjithnjë më të lumtur e më të gëzuar. Pa forcën organizuese, mobilizuese dhe edukuese të Partisë, këto detyra as që mund të mendoheshin.

Ndërtimi socialist në vendin tonë bëhet në kushte të vështira. Si një zinxhir i vetëm, duke filluar që nga krerët e imperializmit amerikan e deri te Titua e Hrushovi, qëndron kundër nesh fronti i armiqve. Të gjithë luftojnë kundër nesh jo vetëm të vështirësojnë marshimin tonë triumfal përpara, por ta ndalin atë, të na dobësojnë e mundësisht të na gllabërojnë. Në këto kushte ne duhet ta kemi gjithnjë në këmbë Partinë, të fortë, vigjilente dhe të aftë që të luftojë me sukses kundër çdo vështirësie e pengese, t'i kapërcejë ato, të dërmojë të gjitha planet që kurdisin armiqtë, të forcojë aftësinë mbrojtëse dhe të frymëzojë për akte heroizmi masat e gjera punonjëse. Në këto kushte çdo anëtar i Partisë, çdo punonjës i vendit tonë duhet të jetë një luftëtar i paepur për

çështjen e Partisë, i gatshëm për çdo situatë, për çdo detyrë, për çdo sakrificë.

Në botë po zhvillohet një luftë e madhe, me përpjesëtime të papara ndonjëherë për fitoren e socializmit mbi imperializmin e të marksizëm-leninizmit mbi revizionizmin. Kjo është luftë për jetë ose për vdekje dhe ne kemi bindjen e thellë se, si kurdoherë, do të kurorëzohet me fitoren e marksizëm-leninizmit. Ligjet objektive të zhvillimit të shoqërisë nuk mund të ndryshohen.

Në luftë për triumfin e marksizëm-leninizmit Partia jonë ka një vend nderi. Por lufta vazhdon dhe ashpërsohet. Sa më e ashpër të bëhet ajo, aq më e afërt është fitorja dhe aq më mirë, ashtu siç na ka hije, duhet t'i kryejmë detyrat tona internacionaliste.

Komiteti Qendror i Partisë ka qenë kurdoherë, edhe në momente më të rënda, i sigurtë se qëndrimet që ai ka mbajtur ishin plotësisht të drejta dhe shprehnin me gjithë forcën, mendimin dhe qëndrimin kolektiv të të gjithë Partisë sonë. Për këtë ne nuk u gabuam asnjëherë. Gjithë Partia, e jo vetëm Partia, por i gjithë populli ynë, janë të bashkuar si një trup i vetëm rreth Komitetit Qendror me shokun Enver në krye, me zemrën e me mendimet e tij, me luftën e me veprat e tija të pavdekshme në të gjitha anët e atdheut tonë socialist.

Byroja Politike mendon se pas këtij plenumi Partia do të forcohet edhe më shumë, do të rritet forca e saj, do të rritet edhe më shumë roli i saj pararojë në të gjithë jetën e vendit. Punimet dhe detyrat që do të caktojmë në këtë plenum do t'i japin një tjetër hov përpara forcimit të punës organizative të Partisë. Për të kryer si duhet e me nder detyrat tona, në radhë të parë, edhe në të ardhshmen të vazhdojmë ta forcojmë dhe ta kalitim edhe më shumë Partinë, të forcojmë akoma më tepër unitetin e çelniktë, kompartësinë dhe aftësinë luftarake të radhëve të saja.

*Botohet sipas origjinalit që
gjetet në Arkivin Qendror
të Partisë.*

PLENUMI XII I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Tiranë, 11-12 shkurt 1964

KOMUNIKATË

MBI ZHVILLIMIN E PUNIMEVE TË PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË

Më 11 e 12 shkurt u mbledh Plenumi i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë nën kryesinë e Sekretarit të Parë të Komitetit Qendror të PPSH, shokut Enver Hoxha.

Plenumi dëgjoi dhe shqyrtoi raportin e Byrosë Politike «Mbi përfundimet e plotësimit të planit dhe të buxhetit të shtetit për vitin 1963 dhe masat për plotësimin e planit dhe të buxhetit për vitin 1964», mbajtur nga kandidati i Byrosë Politike dhe President i Komisionit të Planit të Shtetit, shoku ~~Koço~~ Theodhosi.

Në punimet e plenumit muarën pjesë sekretarë të komiteteve të Partisë dhe kryetarë të komiteteve ekzekutive të rretheve, drejtues dhe punonjës të dikastereve qendrore dhe të ndërmarrjeve ekonomike, punonjës të shtypit dhe të organizatave të masave etj.

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror të PPSH, shoku Enver Hoxha, foli në plenum mbi detyrat që dalin përpara Partisë dhe popullit për realizimin e planit të shtetit të vitit 1964, mbi përfundimin me sukses dhe në unitet të plotë mendimi për të gjitha çështjet të bisedimeve që u zhvilluan midis udhëheqjes së PPSH dhe Qeverisë së RPSH me kryetarin e Këshillit të Shtetit të RP të Kinës dhe zëvendëskryetarin e Komitetit Qendror të PK të Kinës, shokun Çu En Lai me rastin e vizitës së tij në Shqipëri, si edhe mbi disa çështje të gjendjes ndërkombëtare.

Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH aprovoi njëzëri raportin e Byrosë Politike dhe mori vendimin përkatës¹.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Botohet sipas gazetës

«Zëri i Popullit», Nr. 37,

12 shkurt 1964

¹ Shih broshurën: Vendim i Plenumit të KQ të PPSH «Mbi plotësimin e planit dhe të buxhetit për vitin 1963 dhe masat për plotësimin e planit dhe të buxhetit për vitin 1964». Tiranë, 1964.

PLENUMI XIII I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Tiranë, 7-9 korrik 1964

KOMUNIKATË

MBI MBLEDHJEN E PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Nga 7 deri 9 korrik 1964, nën drejtimin e Sekretarit të Parë të Komitetit Qendror të PPSH, shokut Enver Hoxha, u mbledh Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH, i cili dëgjoi raportin e Byrosë Politike të Komitetit Qendror të PPSH «Mbi forcimin e mëtejshëm të punës ideologjike të Partisë për edukimin komunist të punonjësve», mbajtur nga anëtari i Byrosë Politike dhe sekretari i Komitetit Qendror të PPSH, shoku Ramiz Alia.

Plenumi diskutoi gjerësisht rreth raportit dhe e aprovoi atë njëzëri.

Në përfundim të punimeve të plenumit Sekretari i Parë i Komitetit Qendror të PPSH, shoku Enver Hoxha, mbajti një fjalim të rëndësishëm, ku theksoi disa probleme themelore të punës politike dhe ideologjike të Partisë.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

RAPORT I BYROSË POLITIKE TË KQ TË PPSH «MBI FORCIMIN E MËTEJSHËM TË PUNËS IDEOLOGJIKE TË PARTISË PËR EDUKIMIN KOMUNIST TË PUNONJËSVE»

7 korrik 1964

Shokë,

Njëzet vjet u mbushën që Partia jonë udhëheq popullin në luftën fisnike për transformimin socialist të vendit tonë. Këto janë vite të zhvillimit gjithnjë e më të thellë të revolucionit tonë socialist, vite të transformimeve të mëdha revolucionare, ekonomike dhe shoqërore. Rezultatet kryesore të punës dhe të luftës së Partisë dhe të popullit në ndërtimin e socializmit, shkurtimisht mund të përmbledheshin kështu:

Në fushën e zhvillimit të forcave prodhuese rezultati kryesor është shndërrimi i vendit tonë nga një vend i prapambetur bujqësor në një vend bujqësor-industrial, është industrializimi i vendit dhe zhvillimi i mëtejshëm i bujqësisë, pajisja e industrisë dhe e bujqësisë me një teknikë gjithnjë më të re, rritja e rendimentit të punës shoqërore në të gjithë sektorët e ekonomisë.) Si rrjedhim, sot në vendin tonë prodhimi industrial është rritur 30,4 herë në krahasim me vitin 1938 dhe zë mbi 50 për qind të prodhimit të përgjithshëm industrial e bujqësor të vendit; prodhimi bujqësor është rritur 2,4 herë në krahasim me vitin 1938. Janë krijuar degë të reja të industrisë që nuk ekzistonin fare në të kaluarën. Një zhvillim të madh kanë marrë sidomos minierat.

Mbi bazën e rritjes së prodhimit bujqësor e industrial, të rritjes së rendimentit dhe të uljes së kostos është rritur edhe mirëqenja materiale e kulturele e punonjësve tanë.

Në fushën e marrëdhënjeve në prodhim fitorja më e madhe është ndërtimi i bazës ekonomike të socializmit, likuidimi i pronës private dhe vendosja e pronës shoqërore mbi mjetet e prodhimit, likuidimi i ekonomisë shumëformëshe dhe krijimi i sistemit të vetëm të ekonomisë socialiste. Një nga sukseset më të mëdha në luftën për krijimin e bazës ekonomike të socializmit është zgjidhja me sukses e detyrës më të vështirë pas marrjes së pushtetit, — kolektivizimit të bujqësisë, që me të drejtë është quajtur revolucion i dytë. Sektori ekonomik socialist jep tani mbi 90 për qind të të ardhurave kombëtare. Ai përfshin 99 për qind të prodhimit industrial, 90 për qind të tregëtisë me pakicë, mbi 86 për qind të tokës së punuar në bujqësi.

Në fushën shoqërore ndryshimi themelor është likuidimi i klasave shfrytëzuese dhe i shfrytëzimit të njeriut prej njeriut, është krijimi i një shoqërie të re pa klasa antagoniste, të përbërë nga dy klasa mike, nga klasa punëtore e fshatarësia kooperativiste dhe nga shtresa e inteligjencies popullore. Ndryshime të mëdha janë bërë edhe në vetë klasën punëtore, në fshatarësinë kooperativiste dhe në inteligjencien popullore, si në gjendjen e tyre shoqërore, ekonomike, kulturele, tekniko-profesionale ashtu edhe ideologjike. Marrëdhënjet e tyre karakterizohen si marrëdhënje bashkëpunimi vëllazëror dhe të ndihmës reciproke shoqërore. Tani, në numrin e përgjithshëm të popullsisë, klasa punëtore zë mbi 225 për qind, fshatarësia — 62,7 për qind dhe inteligjencia — 13,6 për qind.

Në fushën politike rezultati më i rëndësishëm është forcimi dhe perfeksionimi i pushtetit tonë popullor, zgjerimi i mëtejshëm i demokracisë sonë socialiste, krijimi i unitetit të çelniktë të popullit me Partinë, rritja e fuqisë mbrojtëse të vendit, që është një garanci e sigurtë për mbrojtjen e lirisë e të pavarësisë kombëtare, forcimi i pozitës ndërkombëtare të Republikës Popullore

të Shqipërisë. Në saje të forcës së pushtetit tonë popullor, të unitetit të popullit me Partinë e qeverinë si dhe të vigjilencës së organeve tona të sigurimit, kanë dështuar të gjitha orvatjet dhe komplotet e imperialistëve dhe të revizionistëve titistë-hrushovianë për vendosjen e blokadave, për izolimin e Republikës Popullore të Shqipërisë në arenën ndërkombëtare si dhe për të minuar rendin tonë shoqëror-ekonomik. Një dëshmi e gjallë e gjendjes së shëndoshë politike të vendit tonë ishin edhe rezultatet e votimeve të 31 majit për këshillat dhe gjykatat popullore, në të cilat muarën pjesë në votime mbi 99,99 për qind e zgjedhësve dhe 99,99 për qind e të cilëve votuan për kandidatët e Frontit Demokratik.

Në fushën e kulturës suksesi më i madh është likuidimi në përgjithësi i analfabetizimit, vendosja e arësimit të detyrueshëm 7-vjeçar, ngritja për të parën herë e shkollave të arësimit të lartë, zhvillimi i shkencës e i teknikës, i letërsisë e i arteve, krijimi i inteligjencies së re të dalë nga radhët e popullit, të lidhur ngushtë me Partinë dhe të edukuar në frymën e socializmit. Tani në çdo 4 vetë një mëson në shkollë. Ne kemi sot operën dhe baletin tonë, kinematografinë tonë të re. Një rrjet i gjerë institucionesh kulturele masive, si klubet, këndet e kuqe, shtëpitë dhe vatrat e kulturës, shtrihen në të katër anët e vendit tonë. Një zhvillim të paparë kanë marrë shtypi dhe botimet. Të gjitha këto dëshmojnë se revolucioni ynë kultural është zhvilluar dhe po zhvillohet me sukses, si në gjerësi ashtu edhe në thellësi.

Në fushën ideologjike rezultati kryesor është fakti se ideologjia socialiste, marksizëm-leninizmi, është bërë ideologjia sunduese në vendin tonë, në bazë të së cilës zhvillohet gjithë jeta e shoqërisë, ndërtohet rendi i ri socialist. Partia, duke i qëndruar kurdoherë besnike kësaj doktrine dhe duke e konsideruar atë si një armë të fuqishme në luftën e saj për transformimin e shoqërisë, gjatë gjithë vjetëve të ekzistencës së saj e ka zbatuar atë në mënyrë krijuese dhe e ka pasuruar me eksperiencën e revolucionit dhe të ndërtimit tonë socialist. Partia ka bërë dhe bën një luftë të madhe, të vendosur e historike për mbrojtjen e doktrinës sonë revolucionare nga sulmet e ideologjisë borgjeze dhe, në mënyrë të veçantë, nga shtrembërimet dhe nga sulmet e revizionistëve modernë hrushovianë. Zëri i Partisë sonë, që shpreh të vërtetën marksiste-leniniste, sot dëgjohej e respektohet me simpati nga të gjithë komunistët e revolucionarët e botës.

Mbi bazën e transformimeve të mëdha shoqërore-ekonomike, në luftën për ndërtimin e socializmit dhe në saje të punës së gjithanshme edukative të Partisë, të shtetit dhe të organizatave të masave, ka ndryshuar edhe figura morale e njeriut punonjës, ndërgjegjja dhe botëkuptimi i tij, marrëdhënjet e tija ndaj shoqërisë e ndaj punonjësve të tjerë, qëndrimi i tij ndaj punës e pro-

nës shoqërore, ndaj shtetit e atdheut socialist. Bashkë me jetën e re ka lindur, po formohet e po kalitet çdo ditë e më shumë një njeri i ri, me ide e mendime të reja, me cilësi e virtyte të reja morale. Tabloja e sukseseve të revolucionit tonë socialist, e fitoreve të arritura në çdo fushë të veprimtarisë sonë, sado shifra e përqindje të përdorim, mbetet e zbetë, pa folur për këtë fitore të madhe, për njeriun e ri që ka edukuar Partia.

Secili nga ne, çdo ditë në punën dhe në luftën për ndërtimin e socializmit është i rrethuar nga njerëz të tillë. Këta i gjen në radhët e punëtorëve, i gjen në fshatin kooperativist, i gjen në rininë heroike dhe në gratë e lavdishme, në inteligjencien tonë, në kuadrot tanë. Këta i gjen në punën ndërtimore, por edhe në roje të atdheut, me pushkën në krah, pavarësisht nëse janë të veshur me rrobën e ushtarit apo jo.

Forca e rendit tonë ekonomik-shoqëror dhe fuqia e shtetit tonë kanë qenë dhe janë kondicionuar jo vetëm nga sukseset tona ekonomike, por edhe nga ndërgjegjja e lartë e masave tona punonjëse, nga vetëdija e tyre politike, nga vendosmëria për të mbrojtur rendin e ri socialist. V. I. Lenini kishte të drejtë kur thoshte se

«Nuk do të mundet kurrë ai popull shumica e punëtorëve dhe fshatarëve të të cilit e kanë mësuar, e kanë ndjerë dhe e kanë parë se mbrojnë pushtetin e tyre, Pushtetin Sovjetik — pushtetin e punonjësve, se mbrojnë atë çështje, fitorja e së cilës do t'u sigurojë atyre dhe fëmijve të tyre mundësinë për të gëzuar të gjitha të mirat e kulturës, të gjitha krijimet e punës njerëzore»¹.

Por me gjithë sukseset e arritura, ne kemi detyra shumë të mëdha në fushën e edukimit komunist të punonjësve. Është fakt i pamohueshëm se, pavarësisht nga ndryshimet kolosale, në radhët e punonjësve ruhen akoma, ku më shumë e ku më pak, gjithfarë lloj mbeturinash të së kaluarës, zakone, tradita, shprehje e koncepte të huaja, të cilat nuk ekzistojnë vetëm në kokët e njerëzve, në ndërgjegjen e tyre, por shfaqen në jetën dhe në punën e përditshme, në sjelljet, në qëndrimet e në veprimet e tyre praktike. Këto mbeturina e shfaqje të huaja me origjinë borgjeze, mikroborgjeze, bile edhe feudale e patriarkale, janë nga armiqtë më të rrezikshëm të socializmit, ato janë forma të rezistencës ideologjike të klasave të përmbysura, rezistencë që, siç ka thënë Lenini, është më e thellë dhe më e fuqishme se rezistenca e tyre ushtarake apo politike. Mbeturinat e shfaqjet e huaja janë baza kryesore ku mbështetet sot armiku i klasës në luftën e tij për minimin e rendit socialist, ato përmbajnë në vetëvete rrezikun e degjeneri-

1 V. I. Lenin. Veprat, vëll. 29, f. 352.

mit të njerëzve në elementë borgjezë e antisocialistë, ato vështirësojnë si punën për edukimin e drejtë të punonjësve ashtu edhe vetë çështjen e ndërtimit socialist. J. V. Stalini ka thënë:

«Zakonet dhe praktika e vjetër, traditat dhe paragjykimet e trashëguara nga shoqëria e vjetër janë armiku më i rrezikshëm i socializmit... Prandaj lufta kundër këtyre traditave dhe kësaj praktike, likuidimi i tyre i domosdoshëm në të gjitha sferat e punës sonë dhe, më në fund, edukimi i brezave të rinj në frymën e socializmit proletar, janë ato detyra imediate të partisë sonë pa kryerjen e të cilave është e pamundur fitorja e socializmit»¹.

Lufta kundër mbeturinave e shfaqjeve të huaja, lufta për edukimin komunist të punonjësve, merr sot për Partinë e vendin tonë një rëndësi të veçantë. Së pari, vendi ynë, siç e theksoi Kongresi IV i Partisë, është futur në një periudhë të re historike, në periudhën e ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste. Por të ndërtohet shoqërinë e plotë socialiste nuk do të thotë vetëm të ndërtohet bazën materiale-teknike të socializmit dhe të zhvillosh e të perfeksionosh më tej bazën ekonomike të tij. Kjo është vetëm njëra anë e çështjes që ka të bëjë me transformimin e botës objektive. Ana tjetër e ndërtimit të shoqërisë së plotë socialiste është transformimi i botës subjektive, formimi dhe kalitja e njeriut të ri, me një ndërgjegje të lartë socialiste në punë e në jetë. Tani që revolucioni socialist brenda vendit ka fituar plotësisht në fushën politike dhe ekonomike, lufta për fitoren e tij të plotë edhe në fushën e ideologjisë, në ndërgjegjen e njerëzve, merr një rëndësi të veçantë. Duke folur për këtë çështje në Kongresin IV të Partisë, shoku Enver tha:

«Ndërtimi i plotë i shoqërisë socialiste nuk mund të kuptohet pa krijuar njëkohësisht edhe një njeri të ri, me ide e mendime të reja, me cilësi e virtyte të larta morale. Mbeturinat borgjeze e mikroborgjeze në ndërgjegjen e njerëzve janë një pengesë serioze në rrugën për fitoren e plotë të socializmit në vendin tonë. Kontradikta midis bazës së re socialiste dhe mbeturinave kapitaliste në ndërgjegjen e njerëzve është një nga kontradiktat e rëndësishme të jetës sonë, për kapërcimin e së cilës duhet bërë një punë e madhe»².

1 J. V. Stalin. Veprat, vëll. 6, f. 257-258.

2 Enver Hoxha. Raport mbi aktivitetin e Komitetit Qendror të PPSH. Kongresi IV i PPSH, f. 148. Tiranë, 1961.

Së dyti, në goftë se përgjithësisht mbeturinat dhe shfaqjet e huaja «janë armiku më i rrezikshëm i socializmit», ato bëhen dy herë më të rrezikshme në kushtet tona konkrete historike, kur, siç dihet, vendi ynë ndërton socializmin i rrethuar gjeografikisht nga imperialistët e revizionistët dhe i ndodhur nën presionin e vazhdueshëm të ideologjisë së tyre. Rrethimi imperialist-revizionist, ideologjia borgjeze dhe revizioniste nuk janë nocione abstrakte, por faktorë të fuqishëm materialë e ideologjikë, që ushtrojnë ndikimin e tyre negativ mbi njerëzit tanë, që vështirësojnë ndërtimin me sukses të shoqërisë së plotë socialiste, që mbajnë gjallë dhe inkurajojnë mbeturinat dhe shfaqjet e huaja në ndërgjegjen e njerëzve tanë. Diversioni ideologjik është një nga drejtimet kryesore të luftës së armiqve të jashtëm kundër rendit socialist. Jo më kot borgjezia imperialiste shpenzon qindra milion dollarë për qëllimet e luftës ideologjike e psikologjike. Në luftën ideologjike kundër socializmit, krah për krah me borgjezinë, janë radhitur edhe revizionistët modernë, të cilët zotërojnë gjithashtu mjete të fuqishme të ndikimit ideologjik. Ideologjia borgjeze e revizioniste depërton edhe në vendin tonë nëpërmjet kanalesh të ndryshme, siç janë radioja, televizioni, shtypi dhe botimet e huaja, filmat dhe letrat që vijnë nga jashtë, turizmi etj., etj.

Në këto rrethana, lufta kundër mbeturinave e shfaqjeve të huaja në ndërgjegjen e njerëzve ka një rëndësi vendimtare; ajo në fakt është luftë për ndërtimin me sukses të socializmit, është luftë kundër ideologjisë borgjeze, është luftë për fitoren e plotë të revolucionit socialist edhe në fushën e ideologjisë. Pa këtë luftë as nuk mund të mendohet edukimi komunist i punonjësve. Kjo, ka thënë Lenini, është një detyrë jashtëzakonisht e vështirë, por është edhe një detyrë fisnike, sepse vetëm atëhere kur ne ta kemi zgjidhur atë në praktikë, vetëm atëhere do të ngulet gozhda e fundit në arkivolin e shoqërisë kapitaliste, të cilën ne po e varrosim.

Por, shokë, procesi i edukimit të njeriut të ri është një proces i gjatë dhe i vështirë. Ai është i lidhur me ndryshimin e botës së brendshme shpirtërore të njerëzve, që, siç dihet, është një çështje mjaft e koklavitur; është i lidhur jo me një ndryshim të çfarëdo lloji, por me një ndryshim rrënjësor, ku përmbyset të gjitha normat e moralit, të psikologjisë dhe të botëkuptimit të vjetër dhe zëvendësohen ato me norma krejtësisht të reja; është i lidhur jo me ndryshimin e ndërgjegjes së disa njerëzve të veçantë, por të ndërgjegjes së të gjithë punonjësve. Prandaj, për ta kryer me sukses këtë detyrë të rëndësishme, është e domosdoshme që Partia ta marrë në dorë atë me gjithë seriozitetin e duhur.

Duhet theksuar se tani ne kemi edhe kushte më të favorshme e mundësi më të mëdha për ta bërë këtë punë më me sukses. Ndryshimet ekonomike, shoqërore e kulturele kanë krijuar kushte

të reja pune dhe jetese, nën ndikimin e të cilave është ngushtuar baza për mbeturinat dhe shfaqjet e huaja dhe është zgjeruar baza për lindjen e tipareve të reja të moralit të ri socialist. Janë krijuar gjithashtu kushte më të mira për të ngritur nivelin e punës edukuese me njerëzit. Tani ne kemi më shumë kadro të aftë, më shumë mjete dhe më shumë eksperiencë në punë. Dhe, mbi të gjitha, shokë, ne kemi në anën tonë të vërtetën e madhe të socializmit dhe të komunizmit, kemi vijën e drejtë marksiste-leniniste të Partisë sonë, që janë armë shumë të fuqishme, me të cilat ne do të mposhtim me siguri mbeturinat e shfaqjet e huaja, bashkë me dollarët, me rublat dhe me çdo mjet të diversionit ideologjik që zotërojnë imperialistët dhe revizionistët modernë. Përpara kësaj së vërtete dhe kësaj vije të drejtë do të bëhen, ashtu si deri më sot, pluhur e hi të gjitha pengesat që do të hasim në rrugën tonë dhe çështja revolucionare e Partisë sonë do të shkojë fitimtare gjithmonë përpara.

1. — NDËRTIMI I SHOQËRISË SOCIALISTE ËSHTË I PANDARË NGA EDUKIMI ME QËNDRIMIN E RI NDAJ PUNËS

Edukimi me qëndrimin socialist ndaj punës është një ndër çështjet më themelore të edukimit komunist të punonjësve. Dihet se socializmi është vepër e masave, është vepër e punës së tyre krijuese. Prandaj, për realizimin e detyrave të mëdha që kemi përpara, për ndërtimin e plotë të shoqërisë socialiste, është e domosdoshme të rriten mobilizimi dhe hovi në punë i njerëzve, të forcohet në radhë të parë puna e Partisë për edukimin e masave me një qëndrim të ri socialist ndaj punës.

Puna nuk është vetëm burimi i të mirave materiale, por edhe një shkollë e madhe e edukimit komunist të punonjësve. «Vetëm në punë, — ka thënë Lenini, — mund të bëhet njeriu komunist i vërtetë»¹. Në punë e sipër njeriu transformon edhe vetëveten, botëkuptimin dhe ndërgjegjen e tij, në punë formohen cilësitë më të mira të figurës morale të njeriut të socializmit.

Në kushtet e vendit tonë, për disa arsye të njohura historike, ky problem merr një rëndësi të veçantë. Nuk duhet të harrojmë se vendi ynë hyri në rrugën e ndërtimit socialist drejtpërsëdrejti nga një rend gjysmëfeudal, ku prodhimi nuk kishte marrë një karakter të theksuar shoqëror dhe organizimi i tij ishte në një nivel shumë të ulët. Në këto kushte nuk mund të formoheshin në shkallën e duhur ndjenja e punës dhe disiplina në punë, të bëheshin ato shprehje, zakonet, të krijohej të paktën ajo që quhet ndërgjegje profesionale. Jo vetëm kaq, por ky nivel i ulët i organizimit të prodhimit, nga njëra anë, dhe marrëdhënjet e vjetra në

1 Shih: V. I. Lenin. Veprat, vëll. 31, f. 333.

prodhim, të cilat bazoheshin mbi shfrytëzimin e punës, nga ana tjetër, kanë rrënjësuar në ndërgjegjen e njerëzve koncepte e qëndrime të huaja ndaj punës, si rehatllëkun, parazitizmin, dembellëkun etj. Mirëpo prodhimi i madh socialist, i mbështetur në sistemin e maqinave dhe i organizuar mbi baza të reja teknike e shoqërore, kërkon një ndërgjegje të lartë në punë. Prandaj, sa më shumë ne shkojmë përpara drejt ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste, aq më të padurueshme dhe të dëmshme bëhen mbeturinat dhe shfaqjet e huaja ndaj punës.

Komiteti Qendror i Partisë dhe gjithë Partia i kanë kushtuar kurdoherë një rëndësi të madhe këtij problemi. Analizat e vendimet e ndryshme të Komitetit Qendror dhe të qeverisë mbi çështjet e organizimit, të normimit dhe të shpërblimit të punës, mbi përdorimin e sistemimit e fuqisë punëtore, mbi propagandën e prodhimit, mbi emulacionin socialist dhe përhapjen e eksperiencës së përparuar, mbi shpikjet e racionalizimet, mbi rritjen e pjesëmarrjes së punonjësve në drejtimin e prodhimit etj., kanë luajtur një rol të rëndësishëm për të krijuar te punonjësit një qëndrim të ri ndaj punës. Kjo çështje ka qenë objekt i kujdesit të vazhdueshëm të komiteteve të Partisë të rretheve dhe të organizatave bazë, ajo ka zënë një vend të rëndësishëm në gjithë punën e organizatave të masave.

Ne mund të themi me bindje të plotë se në këtë drejtim kemi arritur rezultate të mëdha. Në shumicën e tyre dërmuese punonjësit tanë punojnë mirë, me ndërgjegje dhe me vetëmohim. Për këtë flasin pjesëmarrja e gjerë e njerëzve në punë, rritja e vazhdueshme e rendimentit të punës dhe realizimi përherë e më mirë i planeve të prodhimit. Për një punë me ndërgjegje të lartë, disiplinë dhe vetëmohim flet sidomos realizimi me sukses i planeve të këtyre tre vjetëve të fundit, në kushtet e bllokadës së egër ekonomike të imperialistëve e revizionistëve, të vështirësive të natyrës dhe të vështirësive të rritjes. Për këtë flasin iniciativat dhe përpjekjet e punonjësve për shfrytëzimin e rezervave të brendshme të ekonomisë, zhvillimi i gjithanshëm i mendimit e i punës krijuese të punonjësve si dhe forcimi i regjimit të kursimit në përdorimin e vlerave materiale e monetare të shtetit. Për qëndrimin e ri ndaj punës dëshmojnë edhe rritja e vazhdueshme e numrit të herojnëve të punës socialiste, e punëtorëve të dalluar në emulacionin socialist, e qindra dhe mijëra pjesëmarrësve në lëvizjet për shpikje e racionalizime, e punonjësve që kalojnë nga brigadat e repartet e përparuara në ato të prapambeturat për t'i ngritur e çuar ato përpara, e mijëra punëtorëve e fshatarëve që marrin pjesë në lëvizjen e brigadave dhe skuadrave të punës socialiste, në këtë lëvizje të mrekullueshme, që bashkon në mënyrë të goditur rritjen e veprimtarisë prodhuese të punonjësve me edukimin dhe mënyrën e jetesës sipas normave të moralit komunist.

Por me gjithë sukseset e arritura na mbetet akoma shumë për të bërë. Duke pasur parasysh detyrat e mëdha që kemi përpara, ne nuk mund të kënaqemi as me shkallën e sotme të pjesëmarrjes së njerëzve në punë, as me nivelin e arritur të rendimentit të punës, as me disiplinën e punës dhe me cilësinë e prodhimeve. Përmirësimi i punës në këtë drejtim varet drejtpërsëdrejti nga lufta për kapërcimin e mbeturinave dhe shfaqjeve të huaja, për zhdukjen e të metave e dobësive që vihen re në veprimtarinë e organizatave të Partisë, të organizatave të masave dhe të organeve tona shtetërore.

Ku janë të metat dhe në ç'drejtim duhet ta forcojmë punën tonë për edukimin me qëndrimin socialist ndaj punës?

a) Kërkesa e parë e domosdoshme për qëndrimin socialist ndaj punës është pjesëmarrja aktive e të gjithë njerëzve të aftë në punën e dobishme shoqërore, që secili të rrojë me djersën e punës së tij dhe të japë kontributin e vet në veprën e ndërtimit socialist

Pjesëmarrja në punë nuk është vetëm një e drejtë, por edhe një detyrë kushtetuese për çdo qytetar të Republikës sonë, ajo nuk është një çështje private e secilit, por edhe një çështje e madhe shoqërore. Në socializëm zbatohet parimi «kush nuk punon, nuk ha», që do të thotë se asnjëri nuk mund dhe nuk duhet lejuar të rrojë në kurriz të të tjerëve, me të ardhura që nuk burojnë nga puna e dobishme shoqërore, se puna është bërë te ne e përgjithshme dhe e detyrueshme.

Gjatë këtyre vjetëve të pushtetit popullor, mbi bazën e zhvillimit të forcave prodhuese dhe të transformimeve të mëdha social-ekonomike, është rritur shumë pjesëmarrja e njerëzve në punë. Tani nuk punon më vetëm kryetari i familjes, siç ngjiste në të kaluarën, por punojnë të gjithë ata që janë të aftë për punë. Në qoftë se dje gratë punonin vetëm në fshat, bile edhe këtu jo kudo, sot gruaja është bërë një forcë e madhe në prodhim dhe në të gjithë sektorët e tjerë të ndërtimit socialist.

Por ne kemi akoma njerëz të aftë për punë, si në qytet ashtu edhe në fshat, që nuk marrin pjesë fare në punën e dobishme shoqërore, që punojnë shumë pak ditë gjatë vitit dhe bëjnë mungesa të shumta e të paarësyeshme në punë. Në 8 kooperativa bujqësore të rrethit të Vlorës, gjatë vitit 1963, nuk muarën pjesë në punë 700 kooperativistë. Në rrethin e Tropojës, po gjatë vitit që shkoi, rreth 35 për qind e gjithë kooperativistëve bënë vetëm deri në 100 ditë-punë, ose në kooperativën bujqësore të Kryeziut të rrethit të Durrësit u bënë mesatarisht 96 ditë-punë në vit, që në fakt do të thotë se është punuar vetëm 3 muaj gjatë gjithë vitit.

Edhe në qytet ka njerëz, sidomos gra, që nuk marrin pjesë në punë të dobishme shoqërore, jo sepse nuk ka punë, por sepse nuk duan të punojnë atje ku ka punë, ose nuk kanë nevojë të punojnë, sepse mbahen me të ardhurat e burrave, ose të njerëzve të tjerë të familjes. Të shumta janë edhe mungesat e paarësyeshme në punë. Në ndërmarrjet e Ministrisë së Minierave e të Gjeologjisë, të Industrisë, të Ndërtimit, të Bujqësisë dhe të artizanatit janë humbur pa arësye gjithsejt 800 mijë ditë-punë. Ajo që duhet të na preokupojë edhe më shumë është fakti se vjetët e fundit në disa ndërmarrje ditët e humbura për mungesa pa arësye kanë ardhur duke u rritur.

Faktet e sipërme dhe shumë të tjera si këto tregojnë se këtu kemi të bëjmë me shfaqje të hapura të dembelizmit e të parazitizmit, me tendenca për t'ju shmangur punës shoqërore. Këto qëndrime dëmtojnë jo vetëm interesat ekonomike të shoqërisë dhe të njerëzve të veçantë, por ushtrojnë një ndikim shumë negativ edhe në edukimin e punonjësve.

Detyra e organizatave të Partisë është të bëjnë një luftë të ashpër, sidomos në fshat, kundër dembelëve e parazitëve, të ngjallin përbuzjen për ata që i shmangen punës dhe t'i edukojnë punonjësit me dashurinë për punën, e cila nuk është vetëm një mjet për të jetuar, por edhe një detyrë themelore ndaj shoqërisë. Në rendin tonë socialist çështja nuk shtrohet «po të më pëlqejë, punoj, po të mos më pëlqejë, nuk punoj», ose: «po të kem nevojë, punoj, po nuk pata nevojë, nuk punoj». Jeta jonë, rendi ynë, nuk na japin të drejtë të zgjedhim. Partia duhet të përdorë të gjitha mjetet e ndikimit të saj ideologjik, ekonomik dhe administrativ që shmangja nga puna e dobishme shoqërore të bëhet e pamundur, që asnjëri të mos jetojë në mënyrë parazitare, që të zbatohet me rreptësi parimi socialist «kush nuk punon, nuk ha», i cili përbën një ligj, një normë të rreptë të jetës sonë.

b) Partia gjithmonë ka theksuar se një element tjetër i rëndësishëm i qëndrimit socialist ndaj punës është dashuria për çdo lloj pune dhe respekti për të gjithë njerëzit e punës

Kjo është një kërkesë e drejtë, që diktohet nga ndarja shoqërore e punës në socializëm, nga zhvillimi i vrullshëm dhe i gjithanshëm i ekonomisë dhe nga domosdoshmëria për ta shndërruar gradualisht punën në një nevojë e kërkesë jetike të vetë njerëzve. Por në këtë drejtim ne kemi shfaqje e qëndrime të padrejta, që vihen re në shtresa të ndryshme të punonjësve tanë. Dihet se në jetën e përditshme nuk janë të rralla rastet që punonjës të ndryshëm refuzojnë të punojnë në sektorë të tillë të rëndësishëm të

ekonomisë si në ferma, në ndërtim, në industrinë e materialeve të ndërtimit, në komunale etj., ose që kërkojnë punë «të lehta» dhe sa më afër qendrave të tyre të banimit. Bile ndodh që kur ndonjërit i ofrohet punë në sektorët që përmendëm, e quan këtë si një fyerje të «dinjitetit» të tij personal, si një punë të ulët, që duhet ta bëjnë «të tjerët»! NSHN-ja «21 Dhjetori» dhe NBSH-ja «Gjergj Dimitrov» në Tiranë prej disa vjetësh kanë hasur në vështirësi për plotësimin e nevojave për fuqi punëtore, për arësye se krahët e lirë të punës në qytetin e Tiranës nuk marrin pjesë në sektorët e ndryshëm të punës së këtyre ndërmarrjeve, kështu që për plotësimin e nevojave të tyre është dashur të tërhiqen punëtorë nga fshati. Një fenomen i tillë vërehet edhe në ndërmarrjet e tjera të ndërtimit, në shumë ndërmarrje bujqësore, në disa fabrika tullash, si në Durrës, në Lushnjë etj.

Shfaqje të tilla vihen re edhe në disa anëtarë të kooperativave bujqësore që nuk duan të punojnë në sektorin e blegtorisë dhe të rritjes së derrave, që përpiqen të zënë ndonjë vend në administratë ose në sektorët ndihmës me ditë-punë fikse, që kërkojnë të largohen nga puna në fshat etj.

Me konceptet e huaja ndaj punës janë të lidhura edhe qëndrimet e disa të rinjve e punonjësve të tjerë që me vështirësi pranojnë të shkojnë për të punuar larg qytetit, në sektorë të ndryshëm të prodhimit, ose që përçmojnë disa profesione të domosdoshme për ekonominë tonë dhe anojnë më shumë drejt atyre profesioneve që nuk janë të lidhura drejtpërsëdrejti me sferën e prodhimit material.

Këto koncepte për punën në përgjithësi, sidomos për punën e thjeshtë fizike, për punën në prodhim, për punën në fshat, janë koncepte krejt të huaja dhe të papajtueshme me socializmin. Ato i kanë rrënjët e tyre në kontrastin midis punës mendore e fizike, si dhe midis fshatit e qytetit, karakteristikë për shoqërinë e vjetër, në atë përbuzje që kanë rrënjosur prej shekujsh klasat shfrytëzuese për punën në përgjithësi, për punën fizike dhe për njeriun e thjeshtë punonjës në veçanti. Ato i kanë rrënjët në mentalitetin mikroborgjez, që e konsideron punën e thjeshtë si të turpshme.

Partia duhet të luftojë kundër këtyre koncepteve sepse ato, veç të tjerave, i sjellin dëme të mëdha ndërtimit ekonomik të vendit dhe krijojnë për shtetin vështirësi suplementare. Lëvizjet e panevojshme dhe mekanike të popullsisë që kanë shkaktuar fryrjen artificiale të qyteteve dhe largimi i forcave punëtore nga fshati, vështirësitë për realizimin e planit të disa degëve të ndryshme të ekonomisë e të prodhimit, mosplotësimi i nevojave për disa profesione të domosdoshme për ekonominë tonë etj., janë të lidhura kryesisht me koncepte e tendenca të tilla.

Është e nevojshme që organizatat e Partisë dhe ato të masa-ve të bëjnë përpjekje më të mëdha për t'i luftuar këto shfaqje të huaja, që përcmojnë punën dhe njeriun punonjës si dhe të luftojnë me këmbëngulje për të rrënjosur në njerëzit dashurinë për çdo lloj pune dhe respektin për çdo punonjës, pavarësisht nga lloji i profesionit që ushtron dhe nga vendi ku punon. Në këtë drejtim detyra të mëdha bien sidomos mbi shkollën dhe organizatat e rinisë, me qëllim që brezi i ri të jetë i gatshëm për çdo punë.

Një punë të madhe edukative duhet të bëjnë organizatat e Partisë, sidomos për të ngjallur e forcuar dashurinë për punën në bujqësi, si një sektor shumë i rëndësishëm i ekonomisë popullore, dhe për të mos lejuar, veçse në mënyrë të organizuar, largimin e krahut të punës nga fshati. Detyra e organizatave të Partisë, dhe veçanërisht e atyre të rinisë, është që të forcojnë punën edukative, sidomos me rininë, me qëllim që rinia fshatare dhe të gjithë ata që janë ngarkuar të punojnë në fshat, të lidhen ngushtë me jetën dhe me punën e fshatit, të gjejnë kënaqësi e gëzim në këtë punë, të luftojnë në mënyrë aktive për vënjen në jetë të programit të Partisë për përmirësimin e gjendjes ekonomike, sociale dhe kulturele të fshatit.

Duke punuar për edukimin me dashurinë për punën, një rëndësi të veçantë ka t'i edukojmë njerëzit që të kenë dashuri për profesionin që kanë zgjedhur, që të çmojnë vlerën e tij dhe të bëjnë përpjekje të vazhdueshme për ta zotëruar atë sa më mirë, për t'u bërë mjeshtër të vërtetë. Në këtë drejtim propaganda e Partisë dhe sidomos bashkimet profesionale, duhet të jenë më aktive dhe të shfrytëzojnë më me efekt format e ndryshme të punës edukative me njerëzit, si festimi i ditëve të profesioneve të ndryshme, shpallja e më të mirëve në profesion etj.

Organizatat e Partisë dhe ato të masave duhet të kenë kurdoherë parasysh porosinë e Leninit, i cili ka thënë:

«Çdo punë, sado e ndotur dhe e vështirë që të jetë, ne duhet ta organizojmë në mënyrë të tillë, që çdo punëtor dhe fshatar të thotë: unë jam një pjesë e ushtrisë së madhe të punës së lirë dhe do të di ta ndërtoj vetë jetën time pa çifligarë dhe kapitalistë, do të di të vendos rendin komunist»¹.

1 V. I. Lenin. Veprat, vëll. 31, f. 334.

c) Të mbash qëndrim socialist ndaj punës nuk do të thotë vetëm të marrësh pjesë aktive në punë, të duash çdo lloj pune dhe të respektosh gjithë njerëzit e punës, por edhe të punosh me rendiment e cilësi të lartë, duke qenë i rregullt dhe i disiplinuar në punë, duke shfrytëzuar në mënyrë sa më efektive kohën e punës, duke realizuar e tejkaluar normat etj.

Nga analizat e fundit të bëra nga Partia dhe qeveria për këto çështje, kanë dalë shumë probleme që duhet të tërheqin seriozisht vëmendjen tonë. Matjet e shfrytëzimit të kohës së punës që janë bërë në disa ndërmarrje dhe organizata ekonomike, kanë treguar se në disa prej tyre një numër punëtorësh punojnë 5 deri 6 orë në ditë. Këtë e vërtetojnë qartë fotografimet që i janë bërë ditës së punës të disa punëtorëve të ngarkim-shkarkimit të Drejtorisë së përgjithshme të hekurudhave dhe të Portit në Durrës, të disa oficinave mekanike, të ndërmarrjeve komunale, të industrisë, të tregëtisë etj. Shfrytëzimi i keq i kohës së punës vihet re edhe në mosplotësimin e normave. Ndërsa realizimi mesatar i normave në përgjithësi është i kënaqshëm, në disa ndërmarrje dhe organizata ekonomike numri i punëtorëve që nuk i realizojnë ato është akoma shumë i madh. Gjatë vitit 1963 në ndërmarrjet e Ministrisë së Minierave e të Gjeologjisë afro 22 për qind e punëtorëve nuk kanë plotësuar normat e punës, në një kohë kur realizimi mesatar i tyre ka qenë 110,2 për qind. Në ndërmarrjet e Ministrisë së Industrisë afro 14 për qind e punëtorëve nuk kanë plotësuar normat e punës, në një kohë kur realizimi mesatar i tyre është lëkundur rreth shifrës 114 për qind. Një gjendje e tillë ekziston edhe në disa ndërmarrje të komunikacionit e të artizanatit dhe të sektorëve të tjerë. Kjo, natyrisht, ka influencuar që këto ndërmarrje të mos realizojnë edhe detyrat e caktuara në plan për rritjen e rendimentit. Në këto rrethana dhe të ndodhur përpara detyrës për të realizuar planin e prodhimit, disa prej tyre kanë mbajtur fuqi punëtoresh më të madhe nga sa ka qenë planifikuar, duke shkelur kështu përpjesëtimet e vendosura midis rendimentit të punës dhe fondit të pagave etj.

Një problem tjetër serioz është fakti që mjaft punonjës vazhdojnë të nxjerrin produkte e të kryejnë punime me cilësi të dobët e skarco, gjë që shpesh vjen nga rendja pas sasisë, për të siguruar më shumë të ardhura. Partia dhe qeveria kanë kritikuar më se një herë cilësinë e dobët të materialeve të ndërtimit dhe të vetë ndërtimeve, të prodhimeve të drurit, të këpucëve, të cigareve, të shërbimeve të artizanatit e të komunales. Dobësi të tilla ka edhe në sektorë të tjerë. Kështu vitin e kaluar, nga seleksionimi i dobët i mineralit të kromit në Minierën e Bulqizës janë transportuar për në Durrës mbi 4 000 ton gurë dhe përqindja e pluhurit në mineral është rritur rreth 10 për qind mbi masën e planifikuar. Në

Fabrikën e letrës në Kavajë, për pakujdesinë e theksuar të drejtuesve teknikë, betonimet e plintave të ndërtesës kryesore u kryen me cilësi të dobët. Për të siguruar qëndrueshmërinë e këtij objekti u bënë punime përforcimi me një mbishpenzim prej 2 milion lekësh. Për shkak të mosrealizimit të cilësisë së parashikuar të duhanit të vendit «Samsun» dhe «Oriental», gjatë sezonit 1963—1964 fshatarësia punonjëse dhe shteti patën humbje të konsiderueshme prej rreth 240 milion lekësh.

Shembuj të tillë tregojnë se disiplina e ndërgjegjshme, mobilizimi në punë dhe qëndrimi ndaj saj duhet të ngrihen në një shkallë më të lartë, që t'u përgjigjen kërkesave gjithnjë në rritje të shoqërisë sonë. Ne duhet të forcojmë punën edukative të Partisë, sepse fenomenet negative që u përmendën më lart, nuk shpjegohen vetëm me dobësitë në organizimin e punës, me mungesën e aftësive tekniko-profesionale, por në një masë të madhe ato janë të lidhura me shkallën e ndërgjegjes socialiste të punonjësve, me dobësitë e punës sonë për edukimin e tyre. Për këtë arsye është e domosdoshme që organizatat e Partisë të bëjnë një luftë të vendosur kundër gjithë këtyre shfaqjeve e qëndrimeve jo të drejta dhe t'i edukojnë punonjësit që të punojnë me ndërgjegje e disiplinë të lartë, të japin maksimumin e energjive të tyre, të nxjerrin prodhime vetëm me cilësi të mirë, që të kryejnë me nder detyrat e tyre, ndaj shoqërisë, ndaj ndërtimit të socializmit. Ato duhet të përdorin për këtë qëllim të gjitha format dhe mjetet e punës edukative të Partisë, të ngrënë sidomos në këmbë vetë kolektivat punonjës, që ato të mos pajtohen me të metat e dobësitë, që të reagojnë dhe të ndërhyjnë drejtpërdrejt, të kritikojnë, të korrigjojnë dhe të ndihmojnë punonjësit, që gjithë kolektivi të punojë si një trup i vetëm për plotësimin e detyrave të planit.

Duhet theksuar se shpesh, kur flitet për qëndrimin socialist ndaj punës, duket sikur kjo ka të bëjë vetëm me njerëzit e punës fizike, me punëtorët e fshatarët. Por me qëndrimin e ri socialist ndaj punës duhen edukuar edhe njerëzit e punës mendore, gjithë inteligjencia jonë, sepse edhe në radhët e tyre ka shfaqje e qëndrime të padrejta. Disa prej tyre, pasi mbarojnë shkollat, e konsiderojnë studimin e mëtejshëm si një punë të kryer dhe nuk bëjnë përpjekjet e duhura për të zgjeruar dijet e tyre, për t'u njohur me të rejat e shkencës e të teknikës dhe për t'i vënë ato në jetë. Disa të tjerë, shpesh, në dëm të punës së tyre themelore, të cilësisë së saj, përpiqen të merren me lloj-lloj punësh të tjera, të nxitur kryesisht nga qëllimi për të siguruar të ardhura suplementare. Nuk janë të paktë edhe ata që mbyllën në guaskën e tyre dhe u shmangen punëve shoqërore, që me vështirësi shkojnë për të punuar atje ku ka nevojë vendi, sidomos në zonat e largëta apo në fshat, që preferojnë punën e zyrës, dhe sidomos ndonjë vend në universitet e institute të tjera të larta. Edhe në administratën

shtetërore ka nëpunës që nuk e shfrytëzojnë si duhet kohën e punës, që sillen lart e poshtë, që nuk japin rendimentin e duhur dhe nuk nxjerrin punë me cilësi të lartë, që nuk bëjnë përpjekje për t'u larguar nga stili burokratik i punës.

ç) Qëndrimi socialist ndaj punës nuk shprehet vetëm në faktin se si punon njeriu, si i kryen detyrat, por mbi të gjitha nga se udhëhiqet ai, ç'e shtyn në gjithë veprimtarinë e tij — interesi personal e përfitimi material, apo interesi i përgjithshëm, stimuli moral

Kjo është çështja themelore, pa të cilën as që mund të bëhet fjalë për ndërgjegjen socialiste në punë.

Konceptet e gabuara për punën dhe shfaqjet e huaja në qëndrimin ndaj saj, për të cilat u fol më sipër, e kanë burimin pikërisht në moskuptimin e thellë të karakterit, përmbajtjes dhe rëndësisë shoqërore që ka puna në rendin tonë socialist. Puna te ne nuk shërben vetëm si mjet për të siguruar jetesën e punonjësve dhe të familjeve të tyre, por është edhe një detyrë e lartë patriotike, një kusht kryesor për rritjen e prodhimit shoqëror, për zhvillimin dhe përparimin e shoqërisë sonë socialiste. Kjo do të thotë se motivi kryesor që duhet t'i shtyjë njerëzit tanë në gjithë veprimtarinë e tyre në punë, duhet të jetë jo interesi i tyre i ngushtë personal material, por kuptimi i rëndësisë së punës së secilit për të mirën e përgjithshme, dëshira që secili të japë kontributin e vet në luftën për fitoren e rendit të ri.

Te ne janë në masë shembujt që flasin për një kuptim të thellë dhe një qëndrim të lartë ndaj punës. Këtë e dëshmojnë, shembulli i punëtorëve të hidrocentralit të Bistricës, të cilët, në kushte shumë të vështira, në mes të ujit e të baltës, luftuan me heroizëm për hapjen e tunelit; iniciativa e punëtorëve të fabrikës së trikotazhit të Korçës, të cilët kërkuan vullnetarisht ngritjen e normave të punës; përkrahja nga më shumë se 100 traktoristë e iniciativës së Heroit të Punës Socialiste, Rako Pina, për të punuar me traktorë të vjetër duke lënë traktorët e rinj; heroizmi i punonjësve të naftës, të cilët luftuan me ditë të tëra për të mbyllur pusin me erupsion gazi në Divjakë etj., etj. Kuptohet se këta punëtorë dhe qindra e mijëra të tjerë si këta, kanë vepruar e veprojnë në këtë mënyrë jo për interesat e tyre të ngushta, por sepse mbi çdo gjë ata kanë vënë e vënë interesat e larta të atdheut e të popullit, interesat e shoqërisë.

Detyra jonë është që në këtë frymë t'i edukojmë gjithë punonjësit tanë, që secili prej tyre të jetë i ndërgjegjshëm për rëndësinë shoqërore dhe qëllimin e punës së tij, që të kujdeset jo vetëm për punën e tij, por edhe të shokëve të tij, të ndihmojë të prapa,

mbeturit, të interesohet për mbarëvajtjen e repartit e të ndërmarrjes në tërësi, të marrë pjesë aktive në gjithë jetën e kolektivit etj.

Për të formuar këtë kuptim e qëndrim të lartë ndaj punës, për të edukuar stimulin moral në punë, është e domosdoshme të bëhet një punë e gjithanshme sqaruuese e bindëse me njerëzit. Kjo punë duhet shoqëruar gjithashtu me përdorimin e drejtë dhe gjithnjë më të gjerë të formave të ndryshme të inkurajimit moral të punonjësve të dalluar e të përparuar, siç janë dekorimet, dhënjat e titujve të ndryshëm, fletë-lavdërimit, flamujt e kuq tranzitorë etj.

Por duke i dhënë rëndësi të dorës së parë stimullit moral, Partia jonë ka çmuar drejt edhe rëndësinë e stimullit material, ka përdorur forma të ndryshme të interesimit material të njerëzve për të punuar më shumë e më mirë. Derisa në socializëm ekzistojnë ndryshime esenciale midis punës së thjeshtë dhe punës së kualifikuar, midis punës mendore dhe punës fizike, derisa nuk është krijuar akoma bollëku i të mirave materiale dhe shoqëria socialiste është e shtërnguar të vendosë masa kontrolli mbi punën e konsumin dhe derisa puna nuk është bërë një nevojë dhe kërkesë jetike e njerëzve, është i domosdoshëm përdorimi i stimullit material. Siç ka thënë Lenini, ndërtimi i socializmit nuk mund të bëhet duke u mbështetur vetëm në stimulin moral, ai duhet shoqëruar patjetër me interesimin material të punonjësve për rezultatet e punës së tyre.

Stimuli material që realizohet nëpërmjet ligjit ekonomik të shpërndarjes sipas punës, ka një rëndësi të dyanshme: nga njëra anë, ai stimulon rritjen e rendimentit të punës, ngritjen e kualifikimit të punonjësve dhe perfeksionimin e teknikës së prodhimit dhe, nga ana tjetër, luan rol të rëndësishëm në edukimin e njerëzve, i mëson ata me disiplinën socialiste, e bën punën të detyrueshme e të përgjithshme. Por eksperiencat jonë e ndërtimit socialist na ka bindur se që ky parim të përdoret në mënyrë të efektshme në dobi të ndërtimit të socializmit dhe të vetë punonjësve, është e domosdoshme që ai të vendoset drejt, të ushtrohet kontroll i rreptë për zbatimin e tij, sepse çdo shtrembërim çënon drejtpërsëdrejti interesat e shoqërisë dhe të individëve, prish ndërgjegjen e punonjësve.

Revizionistët modernë, duke u larguar nga parimet e marksizëm-leninizmit, i kanë shtrembëruar keq mësimet e Leninit mbi vendin dhe rolin e stimullit material. Revizionistët e kanë shpallur interesimin material si forcën lëvizëse kryesore të prodhimit socialist dhe të veprimtarisë prodhuese të punonjësve në socializëm, si mjetin e vetëm për lidhjen e punonjësve me punën dhe për krijimin e qëndrimit të ri ndaj punës. Duke u nisur nga koncepte të tilla mbi interesimin material, krejt të huaja për socializmin, revizionistët hrushovianë veprojnë në fakt sipas parullës «gjithkush

të pasurohet sa të mundë dhe si të mundë». Ata kanë krijuar për kategori të ndryshme njerëzish stimuj materialë shumë të lartë, që kanë çuar në shkeljen e ligjit të shpërndarjes sipas punës. Fetishizimi i stimullit material nga revizionistët është krejt në kundërshtim me predikimet e tyre të bujshme mbi gjoja ndërtimin në shkallë të gjerë të komunizmit.

Të gjitha këto u duhen atyre për t'i hapur rrugën degjenerimit të rendit socialist në një rend kapitalist. Shtrembërimi i parimit të interesimit material nga ana e revizionistëve ka prishur ndërgjegjen socialiste të punonjësve në ato vende, i ka shtyrë ata të rendin pas interesit personal, pas parasë, të mos mendojnë për asgjë tjetër veçse si të pasurohen me çfarëdo mjeti dhe çfarëdo rruge. Si pasojë, kanë marrë përpjesëtime të mëdha pikëpamjet mikroborgjeze, ndjenja e pronës private, është krijuar një shtresë njerëzish të privilegjuar, me të ardhura shumë të mëdha, që kanë degjeneruar në elementë borgjezë dhe që në esencë përbëjnë bazën sociale të revizionizmit të sotëm.

Duke vlerësuar drejt si rolin e stimullit moral ashtu edhe të atij material, duhet theksuar se raporti midis tyre nuk është i dhënë një herë e përgjithnjë. Me zhvillimin e mëtejshëm socialist të vendit, me ngritjen e nivelit të jetesës së popullit dhe të shkallës së ndërgjegjes së punonjësve, rritet gjithnjë e më shumë edhe roli i stimullit moral në punë. Kjo nuk do të thotë se duhet lënë pas dore qysh sot përdorimi i drejtë dhe me vend i stimullit material në punë. Por është e natyrshme se një formë e stimullit material dhe masa e saj që mund të ishte e vlefshme dhe e justifikueshme dje, mund të mos jetë e tillë sot. Me ndryshimin e kushteve, duhet të ndryshojnë edhe format dhe masa e stimujve materialë, sepse po të vazhdojnë siç ishin më parë, në vend që të shërbejnë për të mirë, ndikojnë për të keq. Prandaj, dispozitat që rregullojnë stimujt materialë duhet të rishikohen kohë pas kohe.

d) Emulacioni socialist — shprehje e lartë e qëndrimit të ri ndaj punës dhe mjet i fuqishëm për edukimin e punonjësve

Stimuli moral në punë, kuptimi i thellë i rëndësisë shoqërore të punës gjen shprehjen e tij të qartë në pjesëmarrjen e gjerë të punonjësve në emulacionin socialist. Pikërisht për këtë arsye Stalini e ka quajtur emulacionin socialist si «metodë komuniste për ndërtimin e socializmit»¹.

Duke e vlerësuar në këtë mënyrë emulacionin socialist, Partia jonë i ka kushtuar gjithnjë kujdes të veçantë zhvillimit të tij. Një punë të madhe në këtë drejtim kanë bërë organizatat e masave,

1 Shih: J. V. Stalin. Veprat, vëll. 12, f. 108.

sidomos bashkimet profesionale. Por duhet theksuar se në disa raste rëndësi e dorës së parë i jepet emulacionit socialist si një mjet për arritjen e rezultateve ekonomike për tërheqjen e organizuar të punonjësve në prodhim, ndërsa rolit të emulacionit socialist si armë e fuqishme për edukimin e punonjësve, për ngritjen e ndërgjegjes së tyre, për formimin e një qëndrimi të lartë socialist ndaj punës, nuk i kushtohet vëmendja e duhur.

Të kujdesesh për zhvillimin me sukses të emulacionit socialist, ta udhëheqësh atë, nuk do të thotë aspak të merresh vetëm me grumbullimin e disa shifrave apo statistikave dhe me shpërndarjen e flamujve, siç ngjet ngandonjëherë në praktikën e punës sonë. Kjo, në qoftë se mund të shprehemi kështu, është vetëm ana formale e çështjes. Të kujdesesh për zhvillimin me sukses të emulacionit socialist dhe ta udhëheqësh atë, do të thotë, para së gjithash e kryesisht, të punosh përditë e vazhdimisht me njerëzit, që t'i bësh ata të ndërgjegjshëm për detyrat e tyre, që duke u kujdesur për punëtorët e përparuar, për iniciatorët e metodave dhe të lëvizjeve të reja, të mos lihen mënjanë punëtorët e tjerë, të mesmit e të prapambeturit, që përbëjnë shumicën e punonjësve, nga puna dhe nga ndërgjegjja e të cilëve varet shumë zgjidhja e detyrave që kemi përpara. Kjo është kërkesa themelore e emulacionit socialist.

Një kërkesë tjetër me rëndësi e emulacionit socialist është qëndrimi serioz që duhet mbajtur ndaj zotimeve. E theksojmë këtë sepse ka edhe raste kur zotimet merren me zhurmë, në mënyrë formale, pa një punë të gjerë edukative përgatitore, nuk ndiqen në mënyrë sistematike dhe, si rrjedhim, nuk realizohen. Detyra jonë është t'i edukojmë punonjësit që të mbajnë një qëndrim serioz ndaj zotimeve të marrura, ta konsiderojnë fjalën e dhënë si një ligj, të cilit i duhet përmbajtur patjetër, të mos e ndajnë kurrë fjalën nga vepra. Sidomos duhen dënuar rëndë ato raste, sado të pakta qofshin, kur nga dëshira për të fituar në garat socialiste, për të dalë gjoja me plan e zotime të realizuara, mashtrohen shteti dhe Partia, falsifikohen e manipulohen me gjithfarë lloj trukesh të dhënat mbi realizimin e detyrave. Në këtë vështrim është krejt antisocialist e antishtetëror qëndrimi i drejtuesve të Ndërmarrjes së ndërtimit në Durrës, e cila vitin e kaluar u nderua me fletë-nderi në garat socialiste jo sepse meritonte, por, siç u vërtetua më vonë, sepse kishte raportuar më shumë se 9 milion lekë si të realizuara. Është e qartë se qëndrime të tilla nuk kanë asgjë të përbashkët me emulacionin socialist.

Ne nuk u ndalëm në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me zhvillimin e emulacionit socialist, por, qoftë edhe shkurtimisht, deshëm të tërheqim vëmendjen e organizatave të Partisë, dhe sidomos të bashkimeve profesionale, në rolin e madh edukativ të emulacionit socialist, sepse pikërisht kjo është çështja themelore

e tij dhe sepse në këtë drejtim kemi edhe të metat më të mëdha në punën tonë. Në të ardhshmen është e domosdoshme të përmirohet puna për organizimin e zhvillimin e emulacionit socialist, në mënyrë që ai të shërbejë efektivisht për ngritjen e ndërgjegjes socialiste të punonjësve, për edukimin e një qëndrimi të ri ndaj punës, sepse vetëm kështu do të mund të arrihen edhe rezultate të mëdha ekonomike.

Duke folur për edukimin e qëndrimit socialist ndaj punës, ne deri tani u ndalëm kryesisht në detyrat e organizatave të Partisë dhe të organizatave të masave. Por detyra të mëdha kanë në këtë drejtim edhe organet shtetërore-ekonomike. Ne duhet të jemi të ndërgjegjshëm se vetëm me anën e punës edukative të Partisë nuk mund të luftohen me sukses shfaqjet e huaja në qëndrimin ndaj punës, nuk mund të rritet e të forcohet ndërgjegjja socialiste e punonjësve. Këtu është e domosdoshme të vihen në jetë me përpikmëri vendimet e Partisë e të qeverisë për një organizim e drejtim më të mirë të punës e të prodhimit, për të vënë rregull e disiplinë të fortë në punë, për të vendosur norma sa më të drejta, për të përcaktuar mirë detyrat e secilit dhe për të ushtruar kontroll të rreptë mbi sasinë dhe cilësinë e punës së kryer dhe të prodhimit që nxjerr çdo punëtor. Jeta ka treguar se atje ku mungojnë rregulli, disiplina dhe organizimi i mirë i punës, atje i lihet shteg shfaqjes së mbeturinave të së kaluarës në ndërgjegjen e njerëzve. Drejtuesit e organeve shtetërore dhe të ekonomisë duhet ta kuptojnë mirë se nga puna e tyre drejtuese dhe organizuese varen jo vetëm rezultatet e prodhimit, por në një masë të madhe edhe rezultatet e punës edukative me njerëzit. Çdo hap të veprimtarisë së tyre drejtuesit e organeve shtetërore dhe të ekonomisë duhet ta shohin jo vetëm nga pikëpamja e efektit të tij ekonomik, por edhe nga pikëpamja e rolit edukativ, që të ndihmojë në forcimin e ndërgjegjes socialiste të punonjësve.

2. — QËNDRIMI I RI NDAJ PRONËS SHOQËRORE — TIPAR I RËNDËSISHËM I NDËRGJEGJES SOCIALISTE TË PUNONJËSVE

Mbeturinat e së kaluarës në ndërgjegjen e njerëzve shfaqen në formën më të hapur në qëndrimet ndaj pronës socialiste. Këto qëndrime janë trashëguar te punonjësit nga shoqëria e vjetër dhe ideologjia e saj, që bazohej në pronën private mbi mjetet e prodhimit, janë shfaqje e atyre koncepteve mbi pronën shtetërore si mall i huaj, janë shprehje e asaj psikologjie të pronës private të rrënjosur prej shekujsh në ndërgjegjen e njerëzve. Kjo ndjenjë, kjo psikologji është një forcë e madhe mbi të cilën borgjezia u mbështet gjatë sundimit të saj dhe vazhdon ta përdorë atë në

luftën kundër socializmit edhe pas përmbysjes së saj. Në qëndrimin antisocialist ndaj pronës gërshetohen në një të vetme veprimtaria e ndërgjegjshme e armiqve të pushtetit popullor me psikologjinë mikroborgjeze të pronës private, me orvatjet për t'i dhënë shoqërisë më pak e për të zhvatur prej saj sa më shumë, për të berë një jetë të lehtë në kurriz të të tjerëve.

Qëndrimet antisocialiste ndaj pronës shoqërore shfaqen në forma të ndryshme dhe në drejtime të ndryshme:

Së pari, në vjedhjet e drejtëpërdrejta të pasurisë socialiste nga ana e njerëzve të veçantë, si në ndërmarrjet industriale, tregëtare, të ndërtimit, në institucionet social-kulturale, ashtu edhe në kooperativat bujqësore. Gjatë vitit 1963 veçanërisht serioze kanë qenë vjedhjet e bëra në NISH sharrat e Pukës e në Kavajë. Por vjedhje të pasurisë socialiste, ku më shumë e ku më pak, vihen re edhe në rrethe të tjera. Vjedhje ka edhe në sektorin socialist të bujqësisë, në kooperativat bujqësore. Në sektorin e tregëtisë shtetërore suficitet e deficitet janë një fenomen i përhapur.

Vjedhja e pasurisë socialiste është një shfaqje e theksuar e luftës së klasave. Pavarësisht nga origjina ose e kaluara politike e tyre, pavarësisht nga motivet që i shtyjnë të vjedhin, përvetësuesit e pasurisë socialiste, dashur padashur, u shërbejnë armiqve tanë, sepse ata ngrenë dorën kundër bazës materiale të rendit socialist, dëmtojnë interesat e popullit dhe të ndërtimit socialist në vendin tonë.

Së dyti, qëndrimet antisocialiste ndaj pronës shoqërore shfaqen në dëmtimin dhe në keqpërdorimin e pronës socialiste, që rrjedhin nga pakujdesia, nga shkeljet e rregullave dhe të dispozitave ligjore, nga indiferentizmi ndaj saj. Dëme të mëdha i shkaktohen ekonomisë nga trajtimi i keq i materialeve, lëndëve të para dhe maqinerisë, nga mosvjelja dhe transportimi në kohë i produkteve bujqësore, nga humbjet e dëmtimet gjatë ngarkim-shkarkimit, nga mosruajtja dhe mirëmbajtja e banesave shtetërore, nga lënja e pasurisë pa mbrojtje dhe në vende të papërshtatshme etj.

Nga kontrollat e ushtruara prej dikastereve dhe institucioneve qendrore vërtetohen dëmtime dhe shkelje të disiplinës financiare. Por, zakonisht organeve gjyqsore u kalohen për gjykim vetëm çështjet më flagrante. Ndërsa për pjesën tjetër janë marrë masa disiplinore, ose zhdëmtimi, por shumica e dëmit është bërë si rregull që të kalojë në kurriz të shtetit, në të ashtuquajturin «rezultat ekonomik financiar» të ndërmarrjeve.

Në përgjithësi dëmet që i shkaktohen ekonomisë, nga këto qëndrime, të cilat e kanë burimin te koncepti mbi mallin e shtetit si mall të huaj dhe pa zot, janë shumë më të mëdha se dëmet që i shkaktohen asaj nga përvetësimet e drejtëpërdrejta. Edhe

njerëzit që mbajnë qëndrime të tilla ndaj pronës socialiste, janë në një numër shumë më të madh se ata që e grabitin atë.

Së treti, qëndrimet e huaja ndaj pronës shfaqen edhe në fshehjen e rezervave për rritjen dhe fuqizimin e pareshtur të pronës socialiste. Ka raste që drejtues të ndërmarrjeve dhe të organizatave ekonomike hartojnë plane nën mundësitë e vërteta të kapaciteteve prodhuese, duke mbajtur rezerva për vete, planifikojnë shpenzime të fryra të prodhimit, krijojnë rezerva të tepërta për mallra importi dhe lëndë deficitare, që e shpenzojnë lekun e popullit pa vend, pa efektin e duhur etj. Po sjellim vetëm një shembull tipik. Ministria e Minerave dhe e Gjeologjisë, kur shqyrtoi planet e kostos për vitin 1963 të ndërmarrjeve të saja vartëse, i uli shpenzimet e përgjithshme të prodhimit afro 181 milion lekë. Në fakt kostua për vitin 1963 u ul edhe rreth 35 milion lekë të tjera, gjë që tregon se Ministria e Minerave dhe e Gjeologjisë veproi shumë drejt dhe se ndërmarrjet e saja kishin bërë një planifikim të fryrë të kostos.

Këto qëndrime, të cilat, pa dyshim, pengojnë zhvillimin dhe forcimin e mëtejshëm të pronës shoqërore, e kanë burimin në tendencën e njohur «për të qenë brenda», për të realizuar detyrat ekonomike pa telashe, për të siguruar shpërblime, dekorime e lavdërime të padrejta, në faktin se regjimi i kursimit nuk është kuptuar thellë dhe nga të gjithë si metodë socialiste e drejtimit të ekonomisë.

Konceptet, qëndrimet dhe veprimet e huaja dhe antisocialiste ndaj pronës shoqërore janë, pa dyshim, fenomene shumë negative, por ato nuk janë tipike, karakteristike për shoqërinë tonë. Punonjësit tanë në përgjithësi i dallon një qëndrim i lartë ndaj pronës që ka lindur mbi bazën e vetë kushteve të reja social-ekonomike dhe në saje të punës së gjithanshme edukative të Partisë. Si rrjedhim, të shumta janë aktet e heroizmit të punonjësve tanë për mbrojtjen e pasurisë socialiste dhe masive janë përpjekjet e tyre për të kursyer lëndët e para dhe materialet e ndryshme, për të administruar pasurinë socialiste me nikoqirllëk dhe për ta zgjeruar e forcuar atë, duke prodhuar më shumë mallra e me cilësi të mirë, duke ndërtuar vepra të reja, duke zhvilluar më tej ekonominë kombëtare. Në fushatën për kursime që u zhvillua në vitin 1961, ekonomia popullore pati një përfitim vjetor prej rreth 2 miliard lekësh; ndërsa gjatë konsultimit të gjerë popullor që u bë në vitin 1962 për shfrytëzimin e rezervave të brendshme, punonjësit tanë bënë mbi 10 500 propozime, të cilat i sollën ekonomisë popullore një përfitim vjetor prej rreth 650 milion lekësh. Në industrinë e naftës, me iniciativën e punëtorëve, u përhap lëvizja për të punuar me materiale të kursyera për tre muaj pa tërhequr asgjë nga magazinat. Për një ndërgjegje të lartë e qëndrim korrekt ndaj punës flet edhe shembulli i lëvizjes që ka marrë

përhapje të gjerë për rigjenerimin e pjesëve të këmbimit etj., etj.

Detyra jonë është që këtë qëndrim të lartë të punonjësve ndaj pronës, këtë ndërgjegje socialiste të tyre, këto përpjekje për të ruajtur, forcuar e zhvilluar më tej pasurinë e përbashkët t'i ngremë në një shkallë më të lartë, t'i bëjmë gjithnjë e më masive.

Qëndrimet antisocialiste ndaj pronës shoqërore duhet të na shqetësojnë seriozisht, sepse ato i sjellin ekonomisë një dëm të madh material. Por këto qëndrime duhet të na shqetësojnë edhe më shumë, sepse ato prishin ndërgjegjen e njerëzve, gjë që nuk mund të matet me asnjë shumë, sado të madhe, të hollash. Natyrisht, lekët e vjedhura në sharrat e Pukës kanë rëndësinë e tyre nga pikëpamja ekonomike, por implikimi dhe komprometimi në këtë krim i një grupi njerëzish, prishja e ndërgjegjes së tyre dhe pasojat e tjera negative për gjithë organizatën e Partisë të rrethit të Pukës, janë shumë më të rënda. Lënja e një maqine në rrugë të madhe, pavarësisht nga vlefata e saj, ose fshehja e rezervave nga ndonjë ndërmarrje, që në fund të fundit do të gjendet dikush t'i zbulojë e t'i vërë në shfrytëzim, sigurisht e dëmtojnë rëndë nga ana materiale ekonominë tonë. Por sa dëm të pallogaritshëm na sjellin këto veprime në ndërgjegjen e njerëzve! Shembuj të tillë negativë a nuk i influencojnë edhe punëtorët që të mos kujdesen për ruajtjen e veglave e mjeteve të punës që u janë besuar, ose të mbajnë rezerva në punën e tyre për të mbajtur të ulëta normat, për të mos shfrytëzuar kohën e punës, duke ndjekur parimin «të jemi brenda»? Duke vepruar kështu a mund të bëhet fjalë për edukimin e ndërgjegjes socialiste të punonjësve?

Prandaj, duke e parë çështjen me këtë sy, është e domosdoshme që organizatat e Partisë të bëjnë një punë e luftë të madhe për t'u prerë rrugën të gjitha veprimeve e qëndrimeve antisocialiste ndaj pronës shoqërore.

Prona socialiste është pronë e popullit, është frut i punës, i djersës së tij. Ajo duhet të jetë për ne e shenjtë dhe e paprekshme, në mbrojtje të saj duhet të qëndrojë i gjithë populli. Në këtë drejtim organizatat e Partisë duhet të bëjnë një punë të madhe edukative për t'u sqaruar njerëzve se kush vë dorë mbi pronën socialiste, ai vjedh vetëveten, vjedh shtëpinë e tij; t'i edukojnë ata që të jenë korrektë, të jenë të ndershëm, që të mos prekin asgjë, sado e vogël që të jetë, nga ajo që nuk u përket.

Lufta për t'u prerë rrugën krimeve kundër pronës socialiste nuk mund të bëhet me sukses pa forcuar vigjilencën në punonjësit, pa ngritur opinionin shoqëror kundër vjedhësve, që vetë punonjësit të kapin çdo dorë keqbërëse, pa krijuar atë atmosferë mbytëse dhe të padurueshme për vjedhësit që më se një herë ka porositur Partia, pa rrënjosur thellë në ndërgjegjen e punonjësve tanë se lufta kundër vjedhjeve është shfaqje e luftës së klasave.

Lufta për mbrojtjen e pasurisë së përbashkët dhe për forcimin e saj kërkon që të rriten kujdesi dhe interesimi i të gjithë punonjësve, që ata të jenë të papajtueshëm me indiferentizmin mikroborgjez, që arësyeton pak a shumë kështu: «Ç'më duhet mua ka kush merret me këtë punë». Prandaj, organizatat e Partisë duhet të punojnë me njerëzit që ata të mos mbajnë qëndrime pasive, por të ngrënë zërin sa herë që vënë re veprime të padrejta, në dëm të pronës socialiste, që jo vetëm ta mbrojnë atë nga vjedhësit, por edhe ta ruajnë, të kujdesen për të ashtu siç ruajnë dhe kujdesen për pasurinë e tyre.

Edukimi i qëndrimit socialist ndaj pronës kërkon që të rrënohet te punonjësit, te komunistët, bile edhe te kuadrot, një koncept më i gjerë mbi pronën shoqërore dhe mbrojtjen e saj. Të mbash qëndrim socialist ndaj pronës nuk do të thotë vetëm të luftosh kundër vjedhjeve, por edhe kundër dëmtimeve e shpërdorimeve të çfarëdo lloji, kundër administrimit të keq dhe pa nikoqirllëk të saj, kundër mosshfrytëzimit të plotë të kapaciteteve prodhuese, kundër fshehjes së rezervave etj., etj. Pa formuar një koncept të tillë të gjërë mbi qëndrimin ndaj pronës, pa luftuar njëkohësisht kundër të gjitha këtyre fenomeneve negative, nuk mund të bëhet fjalë për atë ndërgjegje të lartë socialiste që kërkon të edukojë Partia në punonjësit.

Jeta tregon se në shumë raste prona shoqërore vidhet ose dëmtohet pikërisht sepse shkelen ose nuk zbatohen ligjet dhe dispozitat që rregullojnë administrimin dhe përdorimin e saj. Prandaj, pa respektimin dhe zbatimin e tyre të rreptë nuk mund të ketë një administrim dhe përdorim të mirë të pronës shoqërore. Në këtë aspekt organet shtetërore dhe të ekonomisë kanë një përgjegjësi të madhe. Ato duhet t'i kushtojnë kujdes të veçantë çështjes së mbrojtjes dhe zhvillimit të pasurisë socialiste, administrimit dhe përdorimit të drejtë të saj, zbatimit me rreptësi të rregullave, urdhëresave e ligjeve, duke i plotësuar ato, nëse është e nevojshme, me dispozita të reja, me qëllim që t'u mbyllen shtigjet vjedhjeve, dëmtimeve dhe shpërdorimeve. Është e domosdoshme që organet qëndrore të shtetit të forcojnë kontrollin për ruajtjen e pronës. Drejtuesit e dikastereve dhe kolegjiutmet e tyre janë shumë mirë në korrent dhe drejtojnë efektivisht çështjet e realizimit të planit. Kjo është për t'u lavdëruar. Por të metat e dobësitë që vihen re në administrimin e pasurisë socialiste, janë një shfaqje negative në punën e tyre. Fakti që në sharrat e Pukës, apo në NTLAP-in e Kavajës, kanë shkuar disa herë me radhë inspektorë, kontrollorë e revizorë të shumtë të Ministrisë së Industrisë e të Tregëtisë dhe megjithkëtë vjedhësit vazhdonin të qetë punën e tyre, tregon se duhet ndalur më mirë në problemet ekonomiko-financiare, në çështjet e administrimit të pronës, se duhet luftuar më me këmbëngulje për t'u prerë rrugën qëndrimeve antisocialiste ndaj saj.

Kyçi kryesor për formimin dhe forcimin e ndërgjegjes socialiste të punonjësve, e qëndrimit të ri ndaj punës dhe pronës shoqërore, është rrënjosja në punonjësit e konceptit të drejtë që mbi të gjitha të vënë interesat e kolektivit, të shoqërisë, të atdheut e të socializmit, që «un-it» të shoqërisë borgjeze t'i vënë përballë «ne-në» e shoqërisë socialiste. Është fakt se shumica dërmuese e mbeturinave dhe e shfaqjeve të huaja në ndërgjegjen e njerëzve janë të lidhura pikërisht me vënjen e interesit personal mbi interesin e përgjithshëm. Partia jonë gjithnjë ka luftuar kundër këtij koncepti të huaj për socializmin dhe ka arritur suksese shumë të mëdha. Kjo duket qartë në realitetin tonë, në qëndrimin e klasës sonë punëtore, fshatarësisë kooperativiste, inteligjencies sonë popullore, të cilat së bashku punojnë dhe luftojnë për një çështje të vetme, për ndërtimin e socializmit, duke ja nënshtuar interesat e tyre personale interesit të përgjithshëm, duke bërë të tyre parimin e lartë socialist, «një për të gjithë e të gjithë për një».

Por shfaqjet e huaja për ta vënë interesin personal mbi interesin e përgjithshëm, kanë vend akoma në shoqërinë tonë. Këtu kemi të bëjmë me një koncept që ka rrënjë të thella, që e ka burimin në pronën private, në gjithë rendin e vjetër shoqëror, parimi i të cilit, sipas Leninit, është:

«...ose ti grabit tjetrin, ose tjetri të grabit ty, ose ti punon për tjetrin, ose ai punon për ty, ose je pronar skllëvërisht, ose je skllav»¹.

Te ne mirëqenja materiale e kulturele e çdo punonjësi nuk varet vetëm nga të ardhurat që ai merr sipas punës që bën, por nga zhvillimi i gjithë ekonomisë dhe kulturës sonë kombëtare, nga ndërtimi me sukses i socializmit. Prandaj, interesi i përgjithshëm është interesi kryesor, të cilit i duhen nënshtuar interesat personale.

Për këtë arsye është e nevojshme që organizatat e Partisë të bëjnë një luftë të vendosur kundër tendencave për t'i vënë interesat personale mbi interesat e përgjithshme që shfaqen në disa punonjës, të cilët shohin shpesh interesat e çastit, të ditës, dhe nuk kanë gjithnjë parasysh interesat e tyre themelore, perspektivën e tyre, që është e pandarë nga interesat e përgjithshme të shoqërisë. Partia duhet të bëjë një punë të madhe që punonjësit të shohin më lart, të dalin nga rrethi i ngushtë i interesave të tyre personale, të luftojnë shfaqjet e egoizmit dhe të individualizmit borgjez, psikologjinë e pronës private, t'i edukojë ata me frymën e kolektivizmit socialist, të marrëdhënjeve të bashkë-

¹ V. I. Lenin. Veprat, vëll. 31, f. 327.

punimit e të ndihmës reciproke, që mbi çdo gjë të vënë interesat e socializmit, sepse kështu ata mbrojnë edhe interesat e tyre themelore personale.

Parimi më i lartë i moralit komunist është që gjithshka t'i nënshtrohet çështjes së revolucionit, çështjes së triumfit të socializmit dhe të komunizmit. Të gjitha sjelljet, qëndrimet dhe veprimet e tyre punonjësit duhet t'i shikojnë në këtë prizëm, nëse i shërbejnë këtij parimi, nëse përputhen me këtë ideal. Ky është edhe kriteri themelor në bazë të të cilit ne gjykojmë për shkallën e ndërgjegjes socialiste të punonjësve. Lenini ka thënë:

«Lufta e klasës vazhdon dhe detyra jonë është që të gjitha interesat t'ja nënshtrojmë kësaj lufte. Dhe ne moralin tonë komunist ja nënshtrojmë kësaj detyre. Ne themi: morali është ajo gjë që shërben për shkatërrimin e shoqërisë së vjetër shfrytëzuese dhe për bashkimin e të gjithë punonjësve rreth proletariatit, i cili po ndërton shoqërinë e re të komunistëve»¹.

3. — TË LUFTOJMË PËR PASTËRTINË E FIGURËS MORALE TË KOMUNISTËVE DHE TË PUNONJËSVE

Partia jonë mishëron në vetëvete jo vetëm idealet politike të socializmit e të komunizmit, por edhe normat e moralit më të lartë proletar. Këto ideale politike dhe norma morale ajo i ka rrënjosur thellë në ndërgjegjen e çdo anëtari të Partisë si dhe në masat punonjëse. Në saje të punës së gjithanshme Partia ka edukuar luftëtarë të vendosur të çështjes së komunizmit, njerëz besnikë ndaj atdheut e popullit, që kanë qenë dhe janë gjithnjë gati të japin gjithshka kanë të shtrenjtë për çështjen revolucionare të Partisë.

Partia i ka edukuar komunistët e punonjësit tanë me një qëndrim kritik e aktiv ndaj jetës, me shpirtin e vendosmërisë e të guximit për të kapërcyer çdo vështirësi e pengesë, me ndjenjën e besimit të pashtershëm te populli, me frymën e nënshtimit të interesave personale ndaj interesave të popullit, të atdheut e të socializmit, me frymën e një principialiteti të lartë për të mos u pajtuar me të metat e dobësitë në punë, me çdo gjë që pengon ecjen tonë përpara.

Ajo i ka edukuar komunistët dhe kuadrot e saj që të jenë shembull në jetë e në punë, që t'i ndajnë të mirat dhe të këqijat bashkë me popullin, që t'i shërbejnë atij me një ndërgjegje të

¹ V. I. Lenin. Veprat, vëll. 31, f. 326-327.

lartë, që të jenë modestë dhe të dashur me popullin, që të luftojnë kundër arrogancës, servilizmit, mëndjemadhësisë etj.

Janë pikërisht kjo ndërgjegje e lartë politike dhe kjo pastërti morale ato që i kanë bërë Partinë dhe popullin tonë të pathyeshëm, që t'u bëjnë ballë të gjithë armiqve, që t'u rezistojnë të gjitha rrebesheve e bllokadave të imperialistëve e revizionistëve, që të ndërtojnë socializmin në kushtet e vështira të rrethimit imperialist revizionist.

Janë pikërisht kjo ndërgjegje politike e pastërti e lartë morale e Partisë dhe komunistëve ato që e kanë bërë Partinë tonë të gëzojë dashurinë, respektin dhe besimin e pakufishëm të popullit, që e kanë lidhur popullin si mishi me koskën me Partinë, që i shtojnë punonjësit e vendit tonë të ndjekin shembullin e komunistëve dhe të frymëzohen prej tyre.

Këto cilësi të larta morale e politike Partia duhet t'i ruajë, t'i forcojë e t'i zhvillojë më tej. duke bërë një luftë të papajtueshme kundër zakoneve dhe traditave të shoqërisë së vjetër, kundër mbeturinave dhe shfaqjeve të huaja, kundër ndikimit të ideve borgjeze, të cilat ndeshen ende në disa nga njerëzit tanë dhe që njollosin figurën e tyre morale, duke u bërë shkak për shumë të këqia të tjera.

Një luftë e vendosur duhet të bëhet kundër tendencave që në një formë ose në një tjetër shfaqen në disa punonjës dhe komunistë për t'i siguruar vetes një jetë të lehtë, për fitime dhe privilegje personale, shpesh duke abuzuar me postin që u kanë besuar Partia dhe populli.

Komiteti Qendror i Partisë, komitetet e rretheve dhe organizatat bazë të Partisë kanë kritikuar rëndë veprime të tilla sa herë që ato janë shfaqur. Siç dihet, kohët e fundit Komiteti Qendror i Partisë ka dënuar ashpër veprimet e kësaj natyre të disa shokëve të rrethit të Sarandës si dhe të rrethit të Pukës.

Në rrethin e Sarandës dhe në atë të Pukës ndonjë komunist e kuadër kishin siguruar në rrugë të shtrembër privilegje për vetë dhe për familjet e tyre. Ata merrnin nga ndërmarrjet e prodhimit e të tregëtisë drejtpërdrejt nga magazina mallra të ndryshme në rrugë jo të rregullta, merrnin nga kooperativat bujqësore prodhime me çmime më të ulëta nga të tregut etj.

Edhe në rrethe të tjera, në një formë ose në një tjetër ka fenomene të tilla. Nga tri-katër kooperativa bujqësore të rrethit të Gjirokastrës u janë shitur nga pasuria kolektive personave të ndryshëm me çmime të ulëta dhe jashtë rregullave të caktuara qingja dhe bagëti të imta, qumësht, shpendë etj. Disa nga ata që kanë ndërtuar shtëpi të reja nëpër qytete të ndryshme, kanë përdorur për këtë qëllim shpeshherë mjetet e materialet e shtetit, si maqina, lëndë druri, çimento, hekur, fuqi punëtore etj., jashtë çdo rregulli.

Ç'janë këto sjellje e qëndrime? Në fakt këto janë një shfaqje e psikologjisë, e ndjenjës së pronës private dhe e individualizmit, e egoizmit që lind mbi bazën e saj. Këto janë refleksi i ideve të ish-klasave shfrytëzuese dhe të ish-sundimtarëve të djeshëm, që përpiqeshin të siguronin për vetë një jetë më të mirë, pa çarë kokën për të tjerët, në kurriz dhe në dëm të popullit. Duke hyrë në rrugën e veprimeve të tilla, këta shokë janë larguar nga ajo që karakterizon gjithë komunistët e Partinë tonë për të qenë të parët në sakrifica e të fundit në pretendime. Ata e kanë vënë veten e tyre mbi të tjerët dhe kanë filluar të mendojnë si mikroborgjezë, vetëm ose kryesisht për vetë, për mirëqenjen e tyre personale.

Nga këto pozita ç'shembull mund të japë komunisti dhe si mund të luftojë ai kundër shfaqjeve dhe veprimeve të tilla që mund të bëhen nga të tjerët? Nga ana tjetër, është e pashmangshme se kush përpiket të sigurojë përfitime e privilegje për veten e vet, nuk mund të mos dobësojë kujdesin dhe përpjekjet për mirëqenjen e të tjerëve, për mirëqenjen e popullit.

Preokupacioni për përfitime dhe privilegje personale, për t'i siguruar vetes një jetë të lehtë, shpie në mënyrë të pashmangshme në dobësimin e frymës revolucionare, të shpirtit të sakrificës, të vendosmërisë për të përballuar vshtirësitë bashkë me popullin, i shtyn njerëzit të mos jenë parimorë dhe të bien në gabime edhe më të rënda. Është pikërisht kjo frymë liberalizmi dhe oportunizmi ajo që i çoi shokët e Pukës të mos shohin se nën hundën e tyre dëmtohej e vidhej me të dy duart prona shoqërore.

Partia duhet t'i luftojë me vendosmëri këto shfaqje e veprime fund e krye antisocialiste, që prishin vetë njerëzit që i bëjnë ato, që ndikojnë për keq dhe prishin ndërgjegjen edhe të mjaft njerëzve të tjerë dhe që dëmtojnë lidhjet e Partisë me masat, pavarësisht se shfaqje të tilla janë një përjashtim i rrallë në gjirin e shoqërisë e të Partisë sonë.

Duhet kuptuar mirë se duke kërkuar që figura morale e punonjësve dhe e komunistëve të jetë shembullore, Partia nuk nisët nga konceptet vulgare të barazisë, nuk kërkon që si ai që i jep më pak shoqërisë ashtu dhe ai që i jep më shumë të trajtohen njëllor nga shoqëria; Partia dënon vetëm ato veprime që janë në kundërshtim me ligjet dhe rregullat e vendosura, dënon përpjekjet për privilegje dhe përfitime personale që bëhen nga njerëz të ndryshëm, duke shfrytëzuar pozitën e tyre zyrtare.

Partia, nëpërmjet punës së saj edukative, duhet të rrënjosë thellë në ndërgjegjen e çdo komunisti dhe punonjësi nevojën për të bërë një jetë të thjeshtë dhe një luftë të ashpër, për të mos u pajtuar me zakonet e traditat e shoqërisë së vjetër. Ajo duhet të bëjë mirë të qartë se kush futet në një rrugë të tillë, veçanërisht në kushtet e presionit të madh të ideologjisë borgjeze e revizioniste

nga jashtë, futet në një rrugë të rrezikshme: korrupsionin moral vetëm një hap e ndan nga korrupsioni politik.

Një luftë e vendosur duhet bërë gjithashtu kundër tarafeve, hatëreve dhe ndërhyrjeve të padrejta, një e keqe tjetër kjo që vihet re aty-këtu te ne. Pushteti ynë është pushteti i popullit. Njerëzit që punojnë në të, siç ka thënë shoku Enver, janë shërbëtorë të popullit. Të gjithë qytetarët te ne kanë të drejta të barabarta. Ligjet tona, si shprehje e vullnetit të popullit, zbatohen njëloj për të gjithë dhe nuk bëjnë dallime midis njerëzve. Punonjësit, nga vetë eksperiencia e tyre, janë bindur në drejtësinë e veprimeve të pushtetit popullor, i cili çdo gjë e bën në emër të popullit dhe për të mirën e tij. Për këtë arsye ai ka një besim të padiskutueshëm në pushtetin popullor dhe në Partinë tonë.

Megjithkëtë, ka raste kur në disa çështje, si në ato të strehimit, pashaportizimit, marrjes e vendosjes së njerëzve në punë, të furnizimit të popullit etj., shkelen rregullat e ligjet e shtetit, bëhen hatëre, ka ndërhyrje në rrugë jo të drejtë, zgjidhen çështjet në bazë të miqësisë personale etj.

Partia në punën e saj duhet t'i ketë parasysh këto shfaqje, sepse ato kanë rrënjë të thella në vendin tonë. Ato janë një shprehje e asaj metode se si zgjidheshin punët në regjimin e vjetër feudalo-borgjez, janë mbeturina që lidhen ngushtë me të kaluarën e vendit tonë si një vend mikroborgjez dhe me faktin që ne jemi një vend i vogël, ku njerëzit shpesh janë të afërt dhe njihen me njëri-tjetrin.

Organizatet e Partisë dhe organet e pushtetit kanë luftuar kundër këtyre shfaqjeve sa herë i kanë zbuluar ato, por duke pasur parasysh rethanat e sipërme, Partia duhet të bëjë një luftë të vazhdueshme në këtë drejtim. Ajo duhet të dënojë ashpër jo vetëm ata që bëjnë hatëre, marrin parasysh akrobllëqe e që i zgjidhin punët me miqësi, por edhe ata që ndërhyjnë në organet e Partisë e të pushtetit dhe kërkojnë prej tyre që t'u bëhen favore të paligjshme për vete ose për shokët e të afërmit e tyre. Fajtorë nuk janë vetëm ata që bëjnë veprime të tilla, por edhe ata që i shtyjnë në këtë rrugë të keqe.

Me punën e saj edukative Partia duhet të edukojë njerëz të fortë e parimorë, që të mos u nënshtrohen ndërhyrjeve të njerëzve nga jashtë, njerëz të drejtë dhe luftëtarë të vendosur kundër të gjitha shfaqjeve që janë në kundërshtim me normat e jetës sonë socialiste. Puna e Partisë duhet të synojë që të ngrejë opinionin publik, që vetë masat të luftojnë kundër veprimeve të paligjshme, të marrin pjesë aktive në zgjidhjen e problemeve shtetërore e shoqërore.

Por që puna edukative e Partisë me njerëzit të japë rezultatet e dëshiruara, është e domosdoshme të forcohet e të përmirësohet puna e aparateve të pushtetit, nga qendra deri në bazë. Është

fakt se disa njerëz kërkojnë rrugë të shtrembëra për të zgjidhur problemet e hallet e tyre, sepse ka raste që organet e pushtetit i zvarrisin çështjet, i përcjellin njerëzit nga një zyrë në tjetrën, nuk i studjojnë me vëmendje dhe nuk u japin gjithmonë zgjidhje të drejta ankesave e kërkesave të popullit. Organizatat e Partisë duhet të bëjnë një luftë të ashpër kundër këtyre qëndrimeve, kundër burokratizmit, që është gjithashtu një mbeturinë e së kaluarës, një shfaqje e ndikimit të ideologjisë borgjeze mbi aparatet dhe organet shtetërore, si edhe kundër të metave e dobësive të tjera që vihen re në punën e disa nëpunësve të pushtetit tonë popullor. Në këtë drejtim duhet të përmirësojnë punën e tyre të gjitha organet e pushtetit duke filluar që nga organet qendrore, të cilat duhet të ushtrojnë një kontroll më të rreptë dhe të ndihmojnë më shumë në perfeksionimin e punës së aparatit tonë shtetëror, në përmirësimin e metodës e të stilit të punës së tij.

Do të ndalemi edhe në një problem tjetër të rëndësishëm lidhur me edukimin e figurës morale të komunistëve dhe të punonjësve. *Fjala është për përmbajtjen morale të jetës personale, për kuptimin e drejtë të saj.* Shpesh nga punonjës e komunistë të ndryshëm thuhet se çështjet e jetës personale ose familjare nuk kanë lidhje me jetën e shoqërisë, janë çështje që u përkasin vetëm të interesuarve dhe shoqëria nuk duhet të ndërhyjë në to. Ky është një koncept i gabuar, një mbeturinë e pikëpamjeve borgjeze mbi «jetën personale». Të rrosh në shoqëri dhe të jesh i shkëputur prej saj është e pamundur, ka thënë Lenini. Jeta personale dhe familjare është një pjesë e jetës së shoqërisë. Ajo zhvillohet në bazë të marrëdhënjëve mbi të cilat zhvillohet gjithë jeta e shoqërisë. Prandaj, shoqëria nuk mund të jetë indifferente se në ç'rrugë zhvillohet jeta personale e familjare e njerëzve. Natyrisht, këtu nuk është fjala për të ndërhyrë në gjërat e vogla dhe cikërrimat, siç e akuzon socializmin propaganda borgjeze, se gjoja skllavëron individin, zhduk personalitetin e tij etj. etj., po për ato çështje të mëdha që, në një mënyrë ose në një tjetër, dëmtojnë vetë të interesuarin dhe prekin interesat e shoqërisë.

Partia ka punuar dhe punon që normat morale të shoqërisë sonë socialiste të mishërohen në sjelljet e qëndrimet e përditshme të punonjësve, jo vetëm në punë e në shoqëri, por edhe në jetën e tyre personale e familjare. Si rrjedhim i kësaj pune të gjithanshme të Partisë dhe i kushteve të reja social-ekonomike, ne kemi sot një jetë të shëndoshë e të pastër jo vetëm në kolektivat punonjës, por edhe në jetën familjare e personale të njerëzve tanë. Te ne nuk janë problem preokupant shfaqje të tilla të huaja si huliganizmi e vagabondazhi, alkoolizmi e degjenerimi moral, që janë një plagë shoqërore jo vetëm në vendet kapitaliste, por që po marrin për-pjesëtime gjithnjë e më të mëdha dhe në vendet ku sundojnë revizionistët.

Por megjithatë Partia duhet të tregojë një kujdes të vazhdueshëm për një jetë të shëndoshë morale-politike të punonjësve, sepse ka punonjës, bile edhe komunistë, që në punë e në kolektiv përpiqen t'u përshtaten normave të moralit komunist, kurse në jetën familjare e personale udhëhiqen nga norma të tjera, që nuk janë tjetër veçse mbeturina të patriarkalizmit, të marrëdhënjeve feudale, të meskinitetit mikroborgjez etj.

Një nga fitoret më të mëdha të Partisë e të pushtetit tonë popullor është çlirimi i gruas, sigurimi i të drejtave të barabarta me burrin, rritja e personalitetit dhe rolit të saj në gjithë jetën e shoqërisë. Këtë realitet e pranojnë të gjithë. Të gjithë janë dakord se duhet punuar për rritjen e personalitetit dhe të rolit të gruas në shoqëri. Por megjithkëtë ka punonjës të cilët, sapo futen brenda mureve të shtëpisë së tyre, mbajnë ndaj grave një qëndrim krejt të kundërt, sillen ndaj tyre si tiranë, i përcmojnë dhe i nënvleftësojnë ato, i pengojnë të marrin pjesë në prodhim e në jetën shoqërore, politike etj. Një qëndrim i tillë ndaj gruas nuk është aspak një çështje personale, por një çështje që i përket gjithë shoqërisë.

Po kështu, nuk është vetëm çështje personale se çfarë qëndrimi mbajnë prindërit ndaj fëmijëve të tyre, se çfarë edukate u japin dhe sa kujdesen për ta. Problemi i edukimit të fëmijëve nuk është një çështje që i përket vetëm shkollës, shtetit apo organizatës së pionierëve dhe të rinisë, por është edhe një çështje e familjes, e prindërve. Prandaj, shoqëria ka të drejtë të kërkojë llogari nga ata prindër, aq më tepër kur ata janë komunistë, fëmijët e të cilëve nuk kanë sjellje të mira, ose janë futur në rrugë të shtrembër.

Nuk janë gjithashtu aspak çështje personale mënyra patriarkale e jetesës në familje, martesat e fejesat në kundërshtim me dëshirat e vetë të rinjve, që në të shumtën e rasteve nxiten nga interesa materiale të prindërve, sjelljet e pakulturuara në jetë, grindjet e ngatërresat me fqinjët etj., etj. Nuk janë të rralla rastet kur punonjës të ndryshëm dhe ndonjë komunist në punë dhe në kolektiv hiqen si njerëz të përparuar, që nuk u besojnë paragjyqimeve fetare etj., ndërsa në familjet e tyre kremtohen festa fetare, mbahet kreshmë e ramazan, pagëzohen e bëhen synet fëmijët, përdoren nuskat e vendet e shenjta për «shërimin» e njerëzve të sëmurë etj. Janë për t'u kritikuar e dënuar gjithashtu qëndrimet mospërfillëse që disa punonjës ose komunistë mbajnë ndaj prindërve të tyre pleq. Është e turpshme, por është fakt se ka edhe ndonjë rast që prindër të paaftë për punë kanë ngritur padi gjyqësore kundër fëmijëve të tyre që i kanë braktisur.

Të gjitha këto janë çështje që u interesojnë jo vetëm njerëzve të veçantë, por mbarë shoqërisë. Shoqëria jonë socialiste është e

interesuar në mënyrë jetike që jeta personale e familjare e punonjësve tanë të jetë një jetë e shëndoshë, e pastër moralisht, e kulturuar dhe e pasur shpirtërisht, të jetë një pasqyrë e jetës së re socialiste që po zhvillohet në vendin tonë.

Në lidhje me këto të ashtuquajtura «çështje personale» organizata e Partisë duhet të luftojë në dy drejtime kryesore:

E para, kundër konservatorizmit, kundër mbeturinave të marrëdhënjeve patriarkale e feudale, kundër një jete të mbyllur e të ngushtë brenda mureve të shtëpisë, kundër forcës së zakonit dhe traditave të shoqërisë së vjetër, të cilat ndrydhin njerëzit, mbytin iniciativën e tyre, nuk i lënë ata të ecin me hapin e kohës, pengojnë përparimin e shoqërisë sonë drejt socializmit.

E dyta, kundër liberalizmit, kundër shthurjes në jetën personale e familjare. Në këtë çështje ne nuk duhet të harrojmë se borgjezia, bile edhe revizionistët modernë, për të përhapur ideologjinë e tyre, shpesh tehun e drejtojnë në korrumpimin e mënyrës së jetesës së punonjësve, sepse një jetë e shthurur e dekadente çon në mënyrë të pashmangshme në degjenerimin politik.

Prandaj Partia, në luftën e saj për edukimin komunist të punonjësve, duhet të punojë që figura morale e tyre, dhe veçanërisht e komunistëve, të jetë një dhe e pandarë dhe, si e tillë, të shfaqet kudo, si në punë e në kolektiv ashtu edhe në jetën e tyre personale e familjare. Ne duhet të arrijmë që jetën e çdo familjeje, dhe veçanërisht të familjeve të komunistëve, ta përshkojë ajo frymë që karakterizon jetën e shoqërisë sonë të re, që në çdo familje, që nga fëmijët e deri te pleqtë, të rrojnë me pulsin e jetës sonë socialiste, të rrojnë me problemet e preokupacionet e ndërtimit tonë socialist.

4. — TË ZHVILLOJMË MË TEJ NDJENJËN E PATRIOTIZMIT SOCIALIST DHE TË RRITIM BESIMIN E POPULLIT NË FORCAT E VETA

Gjatë provave të rënda të historisë te populli ynë janë forcuar dashuria për atdheun dhe urrejtja për armiqët. Kjo ndjenjë e lartë patriotizmi frymëzoi popullin tonë në luftërat për pavarësi, ajo shpërtheu me një forcë edhe më të madhe gjatë Luftës nacional-çlirimtare, ajo frymëzon edhe sot të gjithë punonjësit në luftën për ta bërë atdheun socialist më të fortë, më të përparuar, të pamposhtur. Patriotizmi i popullit tonë ka gjetur shprehjen e tij më të plotë në parullën e Partisë: «Të ndërtojmë socializmin duke mbajtur në një dorë kazmën dhe në dorën tjetër pushkën». Ai shpërtheu edhe një herë me një forcë të paparë veçanërisht këta vjetët e fundit kur përballë sulmeve, presioneve, shantazheve e

blokadave të egra të revizionistëve hrushovianë punonjësit tanë shtërnguan edhe më fort radhët e tyre rreth Partisë, qëndruan të palëkundur e të guximshëm dhe ju përveshën punës me një mobilizim dhe entuziazëm të paparë për të kapërcyer gjithë pengesat e vështirësitë e reja që na u krijuan, për të vënë në jetë vendimet e Kongresit IV të Partisë.

Për këtë mund të sillen shembuj të panumërt. Gjatë tre vjetëve të fundit punonjësit e qytetit të Tiranës i kanë dhënë shtetit prodhime më shumë nga plani me një vlefë prej 1 098 000 000 lekësh. Inxhinierët, gjeologët dhe teknikët tanë muarën në dorë të gjitha veprat në ndërtim dhe të gjithë sektorët e prodhimit ku më përpara punonin specialistë të huaj, duke treguar aftësi të rralla në punë. Për ngritjen e fabrikës së trikotazhit në Korçë 5 inxhinierë tanë me një grup teknikësh bënë punën e dhjetëra inxhinierëve e teknikëve që ishin parashikuar të vinin nga jashtë. Njerëzit tanë bëjnë përditë heroizma në punë. Të shumta janë edhe rastet e patriotizmit e të guximit në luftë me armiqtë. Mbrojtja e atdheut tonë socialist është bërë një detyrë e shenjtë për çdo qytetar të Republikës sonë. Një bari nga fshati Podgorie në rrethin e Korçës, i cili kapi një shkelës kufiri, kur u pyet ç'e shtyri për të bërë këtë akt, u përgjegj: «Po të mos e kisha bërë, do të ishte një turp për mua si shqiptar, për Partinë, atdheun dhe fshatin tim».

Partia ka thënë gjithnjë se heroike nuk ishte vetëm koha e luftërave legjendare të Skënderbeut, periudha e shkëlqyer e Rilindjes dhe epopeja e lavdishme e Luftës nacional-çlirimtare; heroike, madhështore dhe e lavdishme është edhe koha e sotme. Mos vallë është më pak heroike të transformosh jetën e një populli të tërë mbi baza të reja socialiste, të likuidosh prapambetjen shekullore dhe të ndërtosh një shoqëri të përparuar, të krijosh një njeri të ri, me ide e mendime të reja, me botëkuptim të ri? Mos vallë më pak heroike është sot lufta e Partisë dhe e popullit tonë për mbrojtjen e atdheut, të çështjes së socializmit dhe të komunizmit nga imperialistët dhe revizionistët modernë? Shekuj do të kalojnë, por në jetë të jetëve do të përmendet se si një Parti dhe një popull i një vendi të vogël, Partia e Punës e Shqipërisë dhe populli shqiptar, u ngritën në një luftë për jetë e vdekje me tradhëtarët më të mëdhenj të komunizmit, me grupin e N. Hrushovit e pasuesit e tij dhe qëndruan të papërkulur në mbrojtje të çështjes së madhe të marksizëm-leninizmit.

Njerëzit tanë kanë plot të drejtë të krenohen për të kaluarën e lavdishme dhe traditat patriotike e revolucionare të popullit tonë. Por ata kanë plot të drejtë të krenohen akoma më shumë për të sotmen, për punën dhe luftën heroike të Partisë dhe të popullit tonë. Jo vetëm në të kaluarën, por edhe sot, bile në një fushë shumë më të gjerë, ka vend për akte patriotizmi, vetëmohimi, heroizmi. Të gjithë duhet të jenë të ndërgjegjshëm, dhe veçanërisht ri-

nia, se epoka jonë është e tillë që kërkon edhe akte patriotizmi, vetëmohimi dhe heroizmi.

Ashtu si deri tani, është e nevojshme që edhe në të ardhshmen Partia dhe organizatat e masave të punojnë, duke shtuar përpjekjet, për t'i mbajtur gjallë traditat patriotike të popullit tonë dhe për t'i zhvilluar e pasuruar ato në jetën e përditshme të punonjësve, veçanërisht të rinisë. Edukimi në këtë frymë do ta ngrejë edhe më lart ndërgjegjen socialiste të njerëzve, do të ndihmojë në luftën për kapërcimin e mbeturinave dhe shfaqjeve të huaja, për të cilat folëm më lart, për formimin e njeriut tonë të ri.

Nga ana tjetër, edukimi i punonjësve dhe veçanërisht i rinisë, në frymën e patriotizmit të lartë socialist, duhet forcuar edhe për t'u prerë rrugën disa mbeturinave e shfaqjeve të huaja që vihen re edhe në këtë drejtim. Të tilla janë, p.sh. disa shfaqje të nënvlef-tësimit dhe përcmimit të asaj çka është e jona, të idealizimit dhe përluljes ndaj asaj që është e botës kapitaliste, të cilat duken aty-këtu në mosbesimin ndaj specialistëve tanë, inxhinierëve, mjekëve, shkencëtarëve, në përcmimin e asaj që bëhet e prodhohet në vend dhe në lavdërimin e tepëruar të çdo gjëje që vjen nga jashtë, në prirjet e veçanta për të kopjuar mënyrën e jetesës së botës kapitaliste. Shfaqje të tilla duken në nënvlefësimin, që nganjëherë vete deri në nihilizëm, të vlerës së krijimeve tona në fushën e letërsisë, të artit e të muzikës, në tendencat për të imituar jo vetëm në formë, por ngandonjëherë edhe në përmbajtje nga bota kapitaliste ose nga revizionistët modernë.

Të gjitha këto janë mbeturina të së kaluarës, janë shfaqje të atyre koncepteve që klasat e vjetra shfrytëzuese dhe imperialistët e huaj janë përpjekur për një kohë të gjatë të rrënojnë thellë në ndërgjegjen e masave, për të ngjallur në to mosbesimin në forcat e popullit, në aftësitë, punën e talentin e tij. Nga ana tjetër, këto janë shfaqje të presionit të botës kapitaliste dhe të ideologjisë së saj borgjeze, shfaqje edhe të presionit të revizionizmit modern.

Prandaj, megjithëse këto shfaqje dhe bartësit e tyre sot për sot nuk përbëjnë ndonjë problem të madh, ato duhet të luftohen që në embrion, jo vetëm sepse nesër mund të bëhen të rrezikshme, pasi nga këto pozita mund të kalohet fare lehtë në qëndrime të hapura antisocialiste, por edhe sepse prej tyre infektohen në radhë të parë shtresat më delikate të popullsisë — inteligjencia dhe rinia.

Përballë këtyre shfaqjeve ne duhet të vëmë dashurinë, respektin dhe besimin për atë që ka bërë e bën populli ynë, për ndërtimet tona, për veprat tona letrare e artistike, për punën e specialistëve e të njerëzve tanë, për jetën e re socialiste, për popullin tonë të mrekullueshëm, për gjithshka ne kemi realizuar, për çdo gjë që është fruti i punës dhe i mendjes së punonjësve tanë të talentuar, të punëtorëve, fshatarëve, intelektualëve, të cilët, bren-

da 20 vjetëve, në kushtet e një lufte të ashpër kundër prapambetjes dhe vështirësive të shumta, kanë bërë atë për të cilën të tjerëve u janë dashur shekuj.

Kjo nuk do të thotë aspak se ne duhet të mohojmë e të nënvleftësojmë gjithshka ka të mirë jashtë. Kjo do të ishte shumë e dëmshme. Ne kemi nevojë dhe duhet të mësojmë nga eksperiencia, nga sukseset, nga realizimet, nga çdo gjë e dobishme që kanë krijuar teknika e kultura botërore, në radhë të parë ajo e vendeve socialiste, që mund të na ndihmojë për ecjen tonë përpara në rrugën e socializmit.

Nga ana tjetër, ne nuk duhet të kënaqemi me vetëveten, me ato që kemi arritur. Vetëkënaqësia apo të kënaqurit me pak është një koncept i huaj mikroborgjez, i papajtueshëm me frymën dhe shpirtin revolucionar të Partisë sonë e të ideologjisë së saj. Njerëzit tanë kurrë nuk duhet të kënaqen me atë që kanë arritur, ata duhet të shikojnë përpara, të brumosen me ndjenjën e së resë, të maten me të përparuarit e jo me të prapambeturit, t'i krahasojnë gjërat jo vetëm me të kaluarën, por të kenë gjithnjë parasysh objektivin e lartë që i kemi vënë vetes, atë që duam të arrijmë dhe drejt së cilës shkojmë.

Është e qartë se po të krahasojmë prodhimet tona, ndërtimet apo veprat tona letrare e artistike me ato të vendeve të zhvilluara ne na mbetet akoma shumë për të bërë. Ky është një realitet që nuk mund të mohohet. Megjithkëtë ne punojmë dhe jemi të bindur se mund t'ja arrijmë nivelit të vendeve të zhvilluara. Sukseset tona të deritanishme frymëzojnë popullin tonë, i japin atij forca e energji të reja, i shtojnë besimin, janë stimul për të shkuar gjithnjë përpara, për ta bërë vendin tonë një vend të zhvilluar e të përparuar në të gjitha fushat. Dhe këtë ne do ta arrijmë me punën e talentin e njerëzve tanë, duke zhvilluar, rritur e përmirësuar atë që kemi krijuar me duart tona gjatë këtyre 20 vjetëve.

Nga kjo pikëpamje një rëndësi të madhe merr edukimi i njerëzve me besimin në forcat e veta, me parimin e mbështetjes në radhë të parë në forcat e veta. Revizionistët modernë ngrihen kundër këtij parimi duke e quajtur atë si një «shkarje në pozitat e nacionalizmit të ngushtë», si «një largim nga internacionalizmi proletar», si një «veçim dhe mbyllje në guackën kombëtare». Në të vërtetë, parimi i mbështetjes kryesisht në forcat e veta është një parim marksist-leninist revolucionar e internacionalist. Ai buron nga fakti se çështja e revolucionit dhe e ndërtimit socialist është në radhë të parë një çështje e brendshme e çdo vendi dhe faktori vendimtar për kryerjen e tyre janë forcat e brendshme revolucionare të çdo populli. Parimi i mbështetjes në forcat e veta është një parim luftarak që shpreh frymën revolucionare, gatishmërinë dhe vendosmërinë për të luftuar, punuar e jetuar në çfarëdo

kushtesh e rrethanash, sado të ndërlikuara qofshin ato, për t'u bërë ballë të gjitha pengesave e vështirësive dhe për t'i kapërcyer ato me besim të patundur në fitore.

Ky parim është në të njëjtën kohë një shprehje e lartë e internacionalizmit proletar, sepse klasa punëtore dhe komunistët e çdo vendi detyrën e tyre themelore jo vetëm kombëtare, por edhe ndërkombëtare e kryejnë duke çuar në fitore revolucionin dhe duke ndërtuar me sukses socializmin në vendin e vet. Kush nuk ka besim te populli i vet, kush nuk mbështetet te populli i vet, kush nuk kryen detyrën revolucionare në vendin e vet, ai nuk mund të jetë kurrë internacionalist. Parimi i mbështetjes në forcat e veta nuk e përjashton aspak solidaritetin internacionalist dhe format e tjera të ndihmës e përkrahjes reciproke, që, pa dyshim, kanë rëndësinë e tyre të madhe.

Edukimi i njerëzve me parimin e mbështetjes në radhë të parë në forcat e veta merr gjithashtu rëndësi të madhe aktuale politike, sepse revizionistët hrushovianë, duke ju përgjegjur nevojave dhe kërkesave të imperializmit, përpiqen të mbytin frymën revolucionare të popujve, të mbjellin mosbesim në forcat e tyre, t'i largojnë ata nga lufta revolucionare dhe ndërtimi i socializmit, vendosin blokada e bëjnë presione të ndryshme ndaj vendeve socialiste, duke arritur deri në akte të hapura armiqësore, siç është rasti me qëndrimin ndaj vendit tonë dhe Republikës Popullore të Kinës etj. Në këto rrethana është e domosdoshme të forcohet gjithnjë e më shumë në popull optimizmi revolucionar, besimi i patundur në forcat e veta, bindja e thellë se ai mund të luftojë, të punojë e të ndërtojë me sukses socializmin, të arrijë qëllimet e veta edhe në këto kushte të ndërlikuara. Praktika e këtyre vjetëve të fundit vërteton se kur ky parim kuptohet dhe zbatohet drejt, njerëzit rritin besimin në forcat dhe aftësitë e tyre, lindin te ata iniciativa të guximshme, zhvillohet mendimi i tyre krijues, rriten hovi dhe mobilizimi në punë, bëhen mrekullira dhe mposhten të gjitha vështirësitë dhe pengesat.

Krahas me edukimin patriotik dhe për forcimin e besimit të popullit në forcat e veta, organizatat e Partisë, ashtu si deri sot, duhet të vazhdojnë punën e tyre për edukimin e punonjësve me frymën e internacionalizmit proletar, të solidaritetit dhe miqësisë me klasën punëtore, me popujt dhe forcat revolucionare të të gjitha vendeve. Kur në botë ekzistonte vetëm një vend socialist — Bashkimi Sovjetik — dhe partia që qëndronte në krye të tij, e udhëhequr prej Stalinit të madh ndiqte një politikë të drejtë marksiste-leniniste, guri i provës i internacionalizmit proletar për çdo parti komuniste dhe për çdo revolucionar të vërtetë ishte qëndrimi ndaj Bashkimit Sovjetik, mbrojtja me vendosmëri e vendit të parë të socializmit fitimtar. Por sot gjërat kanë ndryshuar shumë... Në krye të Bashkimit Sovjetik dhe në disa vende socialiste

të Evropës kanë ardhur në fuqi grupet revizioniste, që ndjekin një politikë tradhëtare. Në këto kushte guri i provës i internacionalizmit proletar për çdo komunist e revolucionar të vërtetë është mbrojtja me vendosmëri e unitetit të vendeve socialiste mbi bazën e marksizëm-leninizmit, mbrojtja e vijës dhe politikës marksiste-leniniste që duhet të ndjekin vendet socialiste, demaskimi i vijës dhe i politikës tradhëtare të revizionistëve hrushovianë. Me një kuptim të tillë të internacionalizmit dhe me një frymë të tillë internacionaliste duhet t'i edukojmë sot punonjësit tanë.

5. — T'I SHOHIM GJËRAT NË PRIZMIN KLASOR, TË ZOTËROJMË METODËN E ANALIZËS KLASORE, T'I EDUKOJMË PUNONJËSIT NË FRYMËN KLASORE E REVOLUCIONARE

Çdo luftë, ka thënë Engelsi,

«qoftë ajo në fushën politike, fetare, filozofike, ose në cilëndo fushë tjetër ideologjike, në të vërtetë nuk është gjë tjetër veçse shprehje pak a shumë e qartë e luftës midis klasave...»¹.

Edhe V. I. Lenini ka thënë:

«Njerëzit kanë qenë kurdoherë dhe kurdoherë do të jenë viktima naive të mashtrimit dhe të vetëmashtrimit në politikë, derisa të mësohen që prapa frazave, deklaratave dhe premtimeve të ndryshme morale, fetare, politike dhe sociale të shohin *interesat* e këtyre apo atyre klasave»².

Këtej del një mësim i madh: përderisa ekzistojnë klasat dhe lufta e klasave brenda vendit ashtu edhe në arenën ndërkombëtare, e vetmja metodë e drejtë, e vërtetuar nga gjithë eksperiencia historike, për të njohur, kuptuar e zgjidhur drejt fenomenet e ndryshme të jetës shoqërore, është shikimi i tyre në prizmin klasor, është metoda e analizës klasore. Këtej ne duhet të nisemi për të pasur të qartë rrezikun që paraqesin për socializmin mbeturinat e shfaqjet e huaja, këtej duhet të nisemi për të përcaktuar rrugët e luftës kundër tyre.

Ne kemi shkatërruar bazën ekonomike dhe politike të armiqve të klasës, ne kemi likuiduar klasat shfrytëzuese të qytetit dhe të fshatit. Por kjo në asnjë mënyrë nuk do të thotë se te ne ka marrë fund lufta e klasave, se nuk ka më terren për zhvillimin e luftës

1 K. Marks, F. Engels. Vepra të zgjedhura, vëll. I. f. 224.

2 V. I. Lenin. Veprat, vëll. 19, f. 9.

së klasave. Kanë ndryshuar vetëm format e saja. Shfaqje të luftës së klasave ne kemi si në fushën ekonomike ashtu edhe në atë politike e ideologjike.

Shfaqjet e luftës së klasave ekzistojnë dhe do të ekzistojnë akoma për një kohë të gjatë edhe pasi janë likuiduar klasat shfrytëzuese, për shumë arësyje.

Njerëzit e ish-klasave shfrytëzuese rrojnë në shoqërinë tonë dhe shumë prej tyre nuk kanë hequr dorë nga ëndrrat dhe orvatjet për të kthyer përsëri «parajsën» e humbur. Ata janë bartësit kryesorë të ideologjisë e moralit borgjez në shoqërinë tonë, mbështetja kryesore e armiqve të jashtëm në veprimtarinë e tyre kundër pushtetit popullor. Lufta e klasave vazhdon edhe për shkak se në ndërgjegjen e njerëzve ruhen dhe shfaqen në jetë gjithfarë mbeturinash, shprehish e zakonesh të huaja për socializmin, të cilat ekzistojnë akoma jo vetëm si rezultat i faktit se ndërgjegjja e njerëzve mbetet prapa qenjes shoqërore, por edhe si rezultat i disa kushteve e vështirësive tona konkrete të rritjes. Këta janë faktorët e brendshëm.

Por shfaqjet e luftës së klasave bëhen akoma më të theksuara për faktin se ne ndërtojmë socializmin në kushtet e një presioni të madh e të dyfishtë — imperialist e revizionist, në fushën politike, ekonomike dhe ideologjike. Lufta jonë kundër imperializmit dhe revizionizmit është një luftë e ashpër klasore në arenën ndërkombëtare. Fronti i jashtëm dhe fronti i brendshëm i luftës së klasave kanë qenë dhe janë gjithnjë të lidhur ngushtë. Armiqtë e brendshëm i kanë mbështetur dhe i mbështetin shpresat e tyre te ndihma e përkrahja nga jashtë, nga imperialistët, ndërsa tani edhe nga revizionistët hrushovianë. Kurse armiqtë e jashtëm, për realizimin e qëllimeve të tyre kundërrevolucionare, i kanë mbështetur dhe i mbështetin shpresat te klasat shfrytëzuese ose mbeturinat e tyre, si dhe te ata që, nën ndikimin e mbeturinave dhe shfaqjeve të huaja, nën ndikimin e ideologjisë borgjeze e revizioniste, degjenerojnë në elementë borgjezë e antisocialistë.

Konkluzionet që mund të nxirren që këtej janë:

Së pari, lufta kundër mbeturinave e shfaqjeve të huaja në ndërgjegjen e njerëzve është një shfaqje e luftës së klasave në vendin tonë.

Së dyti, në kushtet e sotme fronti kryesor i luftës së klasave, brenda vendit, është fronti ideologjik, lufta midis ideologjisë e moralit tonë komunist me mbeturinat e shfaqjet e ideologjisë e moralit borgjez e revizionist.

Së treti, bartësit më tipikë të mbeturinave e shfaqjeve të huaja përbëjnë sot, përveç elementëve të klasave të shpronësuara, bazën potenciale ku mund të gjejnë mbështetje armiqtë e klasës, imperializmi dhe revizionizmi. Në strategjinë e tyre të «evolucionit pa-

qësor» të vendeve socialiste në vende kapitaliste imperialistët e revizionistët t'han kryesor të diversionit të tyre ideologjik e kanë drejtuar në përkrahjen dhe ringjalljen e mbeturinave e shfaqjeve të huaja, në degjenerimin moral-politik të punonjësve.

Prandaj, luftën kundër mbeturinave e shfaqjeve të huaja për çrrënjosjen e tyre nga ndërgjegjja e njerëzve, për edukimin e gjithanshëm komunist të punonjësve, duhet ta konsiderojmë jo vetëm si konditën e domosdoshme për përfundimin me sukses të ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste të ne, si kushtin e domosdoshëm për fitoren e ideologjisë sonë në ndeshjen e saj klasore me ideologjinë e shoqërisë së vjetër, por edhe si konditë vendimtare, me qëllim që të priten rrënjët, të shkallmohen bazat për përhapjen e ideologjisë borgjeze e revizioniste, që janë pararoja e kundërrevolucionit politik.

Jeta ka treguar se çdo dobësim i luftës kundër mbeturinave dhe shfaqjeve të huaja, kundër diversionit ideologjik të imperializmit dhe revizionizmit, shpie në mënyrë të pashmangshme në pasojat shumë të rrezikshme për fatet e socializmit. Për këtë dëshmon qartë eksperiencia e hidhur e Bashkimit Sovjetik dhe e disa vendeve socialiste, në krye të të cilave janë sot revizionistët modernë. Duke u futur në rrugën e tyre tradhëtare, revizionistët kanë hequr dorë nga lufta kundër mbeturinave dhe shfaqjeve të huaja, bile i inkurajojnë ato me të gjitha mjetet, u kanë hapur portat depërtimit të ideologjisë borgjeze, mënyrës së jetesës borgjeze, si mjet efektiv për degjenerimin e rendit socialist, për evolucionin paqësor drejt kapitalizmit. Një gjendje të tillë, përveç të tjerave, ata e përgatitën edhe me propagandimin e bujshëm të tezave oportuniste se tanimë lufta e klasave është shuar, se socializmi ka fituar plotësisht e përfundimisht, se është e panevojshme diktatura e proletariatit, se shteti e partia janë shndërruar në shtet e parti «të të gjithë popullit», se është likuiduar përfundimisht rreziku i restaurimit të kapitalizmit etj.

Krejt në kundërshtim me gjendjen në vendet ku sundojnë revizionistët, në të cilat i është hapur rruga degjenerimit të tyre në republika të urta borgjeze, siç ka thënë Stalini, në vendin tonë, në sajë të vijës së drejtë të Partisë, ne kemi një gjendje shumë të shëndoshë moral-politike. Por megjithatë duhet të jemi gjithmonë vigjilentë dhe të nxjerrim mësim nga eksperiencia e keqe e Bashkimit Sovjetik dhe e vendeve të tjera revizioniste.

Në këto kushte ne duhet të forcojmë punën ideologjike të Partisë, duke bërë jo vetëm një luftë të vendosur e të vazhdueshme kundër mbeturinave e shfaqjeve të huaja për çrrënjosjen e tyre nga ndërgjegjja e njerëzve, për edukimin e gjithanshëm komunist të punonjësve, por edhe kundër ideologjisë borgjeze, kundër vetë rendit të shtypjes e të shfrytëzimit kapitalist, për demaskimin e së

ashtuquajturës parajsë kapitaliste me të gjitha plagët e të këqiat e saja, si dhe kundër revizionizmit modern, kësaj pjelle dhe aleate të borgjezisë dhe të ideologjisë së saj, kundër frymës së liberalizmit, humanizmit e degjenerimit borgjez që predikojnë revizionistët dhe që synon të mbytë shpirtin revolucionar të partisë e të masave, të shturë partinë, shtetin e popullin dhe t'i hapë rrugën riven-dosjes së kapitalizmit.

Përballë ndikimit korruptues e degjenerues të mbeturinave e shfaqjeve të huaja dhe të ideologjisë borgjeze e revizioniste, ne duhet të vëmë edukimin e kuadrove, komunistëve dhe gjithë punonjësve në frymën klasore revolucionare, që çdo gjë ta shohim nga pozitën e klasës punëtore dhe të ideologjisë së saj, që mbi çdo gjë të vëmë interesin e klasës, të popullit dhe të socializmit, që të jemi të papajtueshëm me armiqtë e klasës dhe me të gjitha shfaqjet e ideologjisë së tyre, që të jemi besnikë deri në vdekje dhe luftëtarë të vendosur për triumfin e çështjes së madhe të klasës punëtore — socializmit e komunizmit.

Një rëndësi të dorës së parë duhet t'i kushtojë Partia sidomos edukimit klasor revolucionar të rinisë. Ne kemi një rini të pastër e të shëndoshë, të edukuar nga Partia me cilësi e virtyte të larta morale. Kudo, në punë, në shkollë e në jetë, rinia tregon shembuj të heroizmit, vetëmohimit dhe patriotizmit të lartë, ajo është e bashkuar si një trup i vetëm me Partinë dhe pushtetin popullor, është luftëtare aktive dhe e ndërgjegjshme e socializmit, e gatshme të mbrojë me çdo sakrificë lirinë e pavarësinë e atdheut.

Por ne nuk duhet të harrojmë se brezi i ri nuk e ka njohur shtypjen dhe shfrytëzimin e egër të kapitalistëve, çifligarëve dhe imperialistëve të huaj, ai nuk ka kaluar nëpër zjarrin e luftërave të ashpra klasore: shumë gjëra mbi kapitalizmin, shfrytëzimin, klasat dhe luftën e klasave ai i di vetëm nga librat. Për këtë arsye të rinjtë, për mungesë eksperience e kalitjeje, mund të preken më shpejt nga ideologjia borgjeze e revizioniste. Në punën e tyre me rininë organizatat e Partisë duhet të synojnë që jo vetëm ta ruajnë rininë nga çdo ndikim i ideologjisë së huaj, por edhe ta bëjnë atë luftëtare të vendosur kundër të gjitha shfaqjeve të saja.

Këtu është e nevojshme që organizatat e Partisë dhe ato të rinisë të dallojnë mirë kërkesat e kohës, të zhvillimit të shoqërisë, të ecjes së saj përpara, nga mbeturinat e shfaqjet e huaja; të kuptojnë natyrën e rinisë dhe të dallojnë kërkesat e saja në rritje dhe prirjen e saj drejt së resë, nga kërkesat jashtë mundësive dhe nga kapja disa herë pas asaj «së reje» që në fakt është po aq e vjetër sa vetë bota borgjeze. Pra, në këtë drejtim organizatat e Partisë duhet të jenë të matura dhe të luftojnë kundër atyre që çdo gjë të re, çdo kërkesë e prirje të rinisë drejt asaj që është përparimtare dhe e kohës e shohin me syrin skeptik e të dyshimtë dhe e dënojnë si të huaj, ashtu edhe kundër atyre që lejojnë gjith-

shka dhe nuk shohin se prapa së resë në formë, shpeshherë fshihet një përmbajtje e vjetër e reaksionare.

Ne duhet ta edukojmë brezin e ri me një frymë të tillë revolucionare që të përjetësojmë vijën e drejtë marksiste-leniniste të Partisë, që rinia të jetë e denjë të marrë në dorë stafetën nga brezi që kreu revolucionin popullor dhe hodhi bazat e socializmit.

Merita e madhe e Partisë është se ajo ka bërë një edukim të drejtë klasor e revolucionar si të komunistëve ashtu edhe të rinisë e gjithë punonjësve. Dhe në këtë drejtim ne kemi arritur suksese të mëdha. Komunistët dhe punonjësit, të edukuar në këtë frymë, kanë dhënë prova të shumta të qëndrueshmërisë së tyre, të vendosmërisë, të shpirtit të sakrificës, të gatishmërisë luftarake, të pajtueshmërisë me armiqtë e brendshëm e të jashtëm, të devotshmërisë së lartë për çështjen revolucionare të Partisë. Partia duhet ta vazhdojë e forcojë gjithnjë e më shumë këtë punë, duke luftuar kundër çdo shfaqjeje të liberalizmit, tolerancës, oportunizmit, largimit nga fryma klasore-revolucionare, të cilat duken ngandonjëherë në forma të ndryshme e në njerëz të veçantë edhe të ne. Jehona e humanizmit abstrakt dhe e objektivizmit borgjez, e individualizmit dhe e meskinitetit mikroborgjez që predikojnë sot me të madhe revizionistët modernë në fushën e krijimtarisë artistike, është dukur në një formë ose në një tjetër, me ndërgjegje ose pa ndërgjegje, edhe në ndonjë krijim tonin letrar e artistik, si në muzikë, në pikturë apo në skenën e teatrit. Ose ka raste që elementëve reaksionarë të klasave të përmbysura u besohen akoma vlera materiale në sektorë të ndryshëm të ekonomisë. Ndonjë komunist, duke u nisur nga fakti se tani në vendin tonë janë likuiduar klasat shfrytëzuese, dobëson vigjilencën, bie në oportunizëm, mbyll sytë dhe hesht përpara propagandës së armikut, ose veprimeve që dëmtojnë interesat e shtetit e të popullit, pavarësisht se nga kush bëhen ato. Më në fund, a nuk flasim për një largim nga fryma klasore revolucionare dhe për një shkarje në pozitat e ideologjisë dhe të moralit borgjez shembujt që përmendëm në këtë raport e të tjerë si ata, kur mbi interesin e shoqërisë vihet interesi i ngushtë i individit, i «un-it» mikroborgjez, kur psikologjia e pronës private shfaqet në format e saja më të ndryshme etj., etj?

Të gjitha këto, shokë, ne duhet t'i dënojmë me vendosmëri dhe luftën kundër këtyre shfaqjeve ta shohim si një kusht të domosdoshëm për të përballuar me sukses presionin e ideologjisë borgjeze e revizioniste dhe për të kalitur ndërgjegjen socialiste të komunistëve e të gjithë punonjësve. Edukimi në frymën klasore revolucionare duhet të përbëjë shpirtin e gjithë edukimit komunist të punonjësve. Kjo është rruga më efektive për t'i mbyllur dyert depërtimit të ideologjisë borgjeze e revizioniste dhe për të luftuar me sukses edhe kundër të gjitha mbeturinave dhe shfaqjeve të huaja në ndërgjegjen e njerëzve.

6. — EDUKIMI KOMUNIST ËSHTË PUNË E GJALLË ME NJERËZIT DHE DETYRË E TË GJITHËVE

Partia jonë i ka kushtuar gjithnjë një vëmendje të madhe edukimit komunist të punonjësve. Këto probleme kanë zënë një vend të rëndësishëm, sidomos në punimet e plenumeve të fundit të Komitetit Qendror, si në atë të qershorit 1963 «Mbi gjendjen ekonomike, sociale dhe kulturele të fshatit», në atë të dhjetorit për çështjet organizative të Partisë si dhe në plenumin e shkurtit të këtij viti mbi detyrat e planit. Byroja Politike e Komitetit Qendror shumë herë ka marrë në studim dhe ka analizuar probleme të ndryshme të edukimit komunist, lidhur me shfaqjet e huaja që janë vënë re në ndërgjegjen e njerëzve. Një rol të rëndësishëm në këtë drejtim ka luajtur letra e Komitetit Qendror drejtuar gjithë organizatave të Partisë në janar 1960 «Mbi disa shfaqje të huaja që prishin ndërgjegjen e njerëzve».

Analizat, vendimet dhe letrat e Komitetit Qendror dhe të Byrosë Politike për këto çështje kanë qenë një program i gjerë pune për gjithë organizatat e Partisë. Duke u mbështetur në këto direktiva, komitetet dhe organizatat e Partisë janë marrë më shumë e më mirë me problemet e edukimit të punonjësve dhe kanë arritur rezultate të kënaqshme.

Detyra jonë është që në të ardhshmen ta forcojmë, ta përmirësojmë dhe ta ngremë në një nivel më të lartë gjithë punën ideopolitike të Partisë.

Baza ideologjike e edukimit komunist është marksizëm-leninizmi. Pa edukimin marksist-leninist nuk mund të kuptohen drejt problemet e formimit të ndërgjegjes socialiste të punonjësve, nuk mund të përcaktohen drejt as rrugët për çrrënjosjen e mbeturinave e shfaqjeve të huaja, nuk mund të formohet ndërgjegjja e lartë socialiste.

Vetë realiteti ynë socialist, kushtet e reja social-ekonomike krijojnë te punonjësit një farë ndërgjegjeje socialiste. Por kjo është një shkallë shumë e ulët e ndërgjegjes socialiste. Socializmi nuk mund të ndërtohet duke u mbështetur vetëm në këtë lloj ndërgjegjeje që lind në mënyrë spontane, nën dikimin e drejtëpërdrejtë të jetës së përditshme, të kushteve objektive. Ai kërkon një shkallë të lartë të ndërgjegjes socialiste, e cila nuk lind dhe nuk mund të lindë spontaneisht. Ajo formohet nga shkenca marksiste-leniniste, atë e fut në masa Partia nëpërmjet gjithë punës së përditshme edukative.

Këtë del se ç'rëndësi vendimtare merr roli i faktorit subjektiv, puna edukative e Partisë, shtetit dhe organizatave të masave. Prandaj, të metat e dobësitë që vihen re në ndërgjegjen e njerëzve, për të cilat folëm në këtë raport, nuk shpjegohen vetëm me kushte objektive, me atë çka kanë trashëguar punonjësit nga e

kaluara dhe me presionin e jashtëm ideologjik, por edhe me dobësitë e të metat e punës edukative. Është më se aktuale që, komitetet dhe organizatat e Partisë t'i përvishen me gjithë seriozitetin e duhur punës për edukimin komunist të masave, të kthejnë fytyrën edhe drejt luftës kundër mbeturinave dhe shfaqjeve të huaja, për kalitjen e ndërgjegjes socialiste të punonjësve. Për të realizuar këtë detyrë shumë të rëndësishme është e domosdoshme që komitetet dhe organizatat e Partisë ta përmirësojnë shumë punën e tyre. Është fakt i njohur se ato shpesh i rrëmben puna praktike, sidomos problemet ekonomike, në shumë raste dublojnë punën e organeve të pushtetit, duke lënë kështu pas dore detyrën e tyre themelore, punën për edukimin e njerëzve. Kjo ndodh jo aq se ndërtimi ekonomik është dhe mbetet gjithnjë fronti kryesor i ndërtimit socialist, por sepse puna për edukimin dhe riedukimin e njerëzve është një punë shumë më e ndërlikuar dhe më e vështirë se sa organizimi dhe drejtimi i prodhimit.

Në këtë drejtim është e nevojshme, të përmirësohet edhe puna e aparatit të Komitetit Qendror të Partisë, e të gjitha drejtorive të tija, të cilat kanë përgjegjësinë e tyre në të metat e dobësitë që vihen re në punën tonë. Problemet e edukimit komunist të punonjësve në të ardhshmen duhet të zënë një vend të dorës së parë në të gjithë veprimtarinë e drejtorive të Komitetit Qendror. Një përgjegjësi të madhe kanë sidomos kuadrot e frontit ideologjik dhe posaçërisht Drejtoria e Agjitacionit dhe e Propagandës e Komitetit Qendror.

Është e nevojshme që organet e propagandës dhe Drejtoria e Agjitacionit dhe e Propagandës ta përmirësojnë dhe ta ngrenë në një nivel më të lartë punën e tyre. Ato duhet të studjojnë, të zbërthejnë dhe të përpunojnë më mirë problemet e edukimit komunist, duke pasur gjithnjë parasysh se formimi i ndërgjegjes socialiste të punonjësve nuk bëhet vetëm duke propaganduar disa norma e parime të përgjithshme të moralit komunist, por duke i lidhur këto norma e parime me jetën, me realitetin tonë, me luftën praktike kundër gjithshkaje të huaj që kanë trashëguar dhe ruajnë akoma punonjësit e kategorive të ndryshme në ndërgjegjen e tyre. Normat e parimet e marksizëm-leninizmit, të moralit komunist, duhet të shndërrohen në bindje të thella dhe të brendshme të njerëzve, të mishërohen në sjelljet, qëndrimet e veprimet e tyre të përditshme kudo, në punë, në jetë, në familje.

Për ta çuar përpara dhe për ta ngritur në një nivel më të lartë gjithë punën e Partisë për forcimin e ndërgjegjes socialiste të punonjësve, duam të tërheqim vëmendjen në disa çështje që kanë të bëjnë drejtpërsëdrejti me metodën e punës për edukimin e njerëzve.

a) Puna konkrete e përditshme me njerëzit duhet të zëjë vendin kryesor në të gjithë veprimtarinë e organizatave të Partisë

Puna për formimin dhe forcimin e ndërgjegjes socialiste të punonjësve është një proces i gjatë edukimi dhe riedukimi. Para nesh shtrohet detyra jo vetëm të rrenjosim në ndërgjegjen e njerëzve tanë idetë, botëkuptimin dhe moralin e Partisë, por në të njëjtën kohë të çrrënjoshim nga ndërgjegjja e tyre edhe gjithshka të huaj që ata kanë trashëguar dhe ruajnë akoma nga e kaluara.

Për ta bërë me sukses këtë punë, organizatat e Partisë dhe ato të masave duhet të forcojnë punën e tyre me njerëzit, të bëjnë një punë të përditshme me ta. Kjo është metoda themelore e gjithë punës së Partisë, por në mënyrë të veçantë puna për formimin e ndërgjegjes socialiste të punonjësve është një punë e gjallë me njerëzit, bile ajo kërkon edhe një trajtim individual, sepse njerëzit nuk janë njëloj: ata dallohen nga karakteri, nga psikologjia, nga mbeturinat që trashëgojnë, nga shfaqjet e huaja që ata manifestojnë etj.

Natyrisht, për edukimin e njerëzve duhen përdorur edhe format masive të punës siç janë leksionet, konferencat, mbledhjet etj. Por në asnjë mënyrë nuk duhet të kufizohet puna jonë në këto forma. Pa një punë individuale me njerëzit, në brigada, në reparte, në zyra, kudo ku ata punojnë e jetojnë, nuk mund t'i arrihet qëllimit. Në këtë drejtim Partia jonë ka një eksperiencë kolosale. Le të kujtojmë punën e madhe që kanë bërë organizatat e Partisë gati me çdo fshatar për të luftuar ndjenjen e pronës private, për t'i bindur e sqaruar ata mbi të mirat e kolektivizimit, për t'i bashkuar ata në kooperativat bujqësore etj., etj., ose punën e durueshme që kanë bërë dhe bëjnë ato me intelektualët apo me shoferët, traktoristët, blegtorët dhe kategori të tjera punonjësish, karakteri i punës së të cilëve vështirëson organizimin e edukimit të tyre sistematik etj., etj.

Puna e Partisë për edukimin e ndërgjegjes socialiste do të ketë efektin e duhur në qoftë se bëhet e diferencuar, sipas klasave e shtresave të ndryshme të popullsisë, duke mbajtur parasysh shkallën e kulturës, të pjekurisë ideo-politike, moshën, profesionin, kracinën, sepse punëtorët, gratë, rinia, intelektualët dhe kategoritë e tjera të punonjësve kanë veçoritë e tyre, kanë edhe mbeturina e shfaqje të huaja që janë karakteristikë për ta. Në qoftë se p.sh. puna jonë me rininë synon kryesisht kundër shfaqjeve të huaja që mund të manifestohen te ajo si rezultat i presionit të ndikimit të jashtëm, me punonjësit e moshave të rritura ajo drejtohet kryesisht kundër mbeturinave të trashëguara nga e kaluara. Në qoftë se me fshatarësinë kooperativiste kërkohet që të punohet për të forcuar ndjenjën e pronës dhe të punës ko-

lektive, për të likuiduar psikologjinë e pronës private, me fshatarrësinë individuale, ekonomia e së cilës bazohet mbi pronën private, kërkohet që të luftohet kundër vetë konceptit të pronës private, kundër tendencave të spekulimit dhe të shfrytëzimit që lindin prej saj, në mënyrë që të bindet ajo për t'u futur në rrugën e kolektivizimit. Po kështu, puna e Partisë duhet të ketë specifikën e saj me punëtorët e rinj, të sapoardhur nga fshati, që zgjellin me vete bagazhin mikroborgjez të tij dhe me punëtorët e vjetër, të cilët dallohen nga një ndërgjegje më e lartë socialiste në punë. Aq më tepër e diferencuar duhet të jetë puna jonë edukative me inteligjencien, e cila jo vetëm dallon nga gjithë shtresat e tjera të popullsisë, por edhe brenda saj ka veçanti, p.sh. të tjera janë veçoritë e inteligjencies artistike nga ato të inteligjencies teknike etj.

Në punën e përditshme të organizatave të Partisë ka shumë shembuj të mirë që flasin qartë për një punë të kujdesshme të diferencuar me njerëzit. Në NSHN-në «21 Dhjetori» në Tiranë kishte një numër punëtorësh që thyenin disiplinën në punë, që shpifnin për punëtorë të tjerë, që ngatërronin kolektivin, që ishin dhënë pas pijes etj. Drejtorja e ndërmarrjes, për të zgjidhur problemin, mendonte të pushonte nga puna disa prej tyre. Mirëpo organizata e Partisë i doli çështjes përpara. Ajo, pasi i studjoi këta punëtorë një për një, u vuri detyrë disa komunistëve t'i shoqëronin ata gjatë punës dhe sidomos gjatë orëve të lira, të shkonin bashkë në kinema, sport, të vizitonin familjet e tyre. Si rezultat, jo vetëm u evitua pushimi i tyre nga puna, por u arrit që ata të ecnin përpara, të ngriheshin në kategori dhe të dalloheshin në punë. Familjet e këtyre punëtorëve falenderuan organizatën e Partisë për kujdesin që tregoi për t'i vënë ata në rrugë të drejtë. Por nuk punohet gjithnjë e kudo në këtë mënyrë. Shpesh puna e gjallë e me durim me njerëzit zëvendësohet me metoda burokratike, me urdhëra.

Puna për edukimin e ndërgjegjes së punonjësve nuk është dhe nuk mund të jetë një detyrë që u përket vetëm disa njerëzve, vetëm kuadrove të Partisë dhe posaçërisht atyre që punojnë në sektorë të ndryshëm të frontit ideologjik. Puna me njerëzit është punë e gjithë Partisë, e gjithë kuadrove, e gjithë komunistëve, pavarësisht nga përgjegjësia dhe nga vendi ku punojnë. Këtë në radhë të parë duhet ta kenë parasysh kuadrot e pushtetit dhe të ekonomisë, nga të cilët kërkohet të jenë jo vetëm specialistë e drejtues të mirë të punës e të sektorit të tyre, por edhe kuadro politikë, që ta konsiderojnë si një detyrë të tyre të pandarë punën me njerëzit, për edukimin e tyre. Detyra e tyre nuk është të merren vetëm me probleme thjesht ekonomiko-administrative, me analizat e shifrave e të treguesve të planit, por të punojnë edhe me njerëzit, sepse janë pikërisht njerëzit ata që realizojnë

planet, që çojnë përpara prodhimin, që në fund të fundit ua zbardhin faqen edhe vetë drejtuesve. Faktori njeri është faktori vendimtar që qëndron mbi të gjitha masat ekonomiko-organizative dhe administrative. Por që ky faktor të luajë rolin e tij në mënyrë sa më racionale dhe efektive, duhet punuar me njerëzit, duhet luftuar për ngritjen e ndërgjegjes së tyre. Duke e parë çështjen në këtë prizëm, është e nevojshme që drejtuesit e ndërmarrjeve ekonomike të përgjigjen jo vetëm për realizimin e planit, për gjendjen ekonomiko-financiare të ndërmarrjes, por të ndiejnë përgjegjësi edhe për gjendjen moralo-politike të punonjësve, për shkallën e ndërgjegjes së tyre.

b) Metoda kryesore e Partisë në punën për edukimin e njerëzve është metoda e bindjes

Të luftosh për transformimin e botës së brendshme, të ndërgjegjes së njerëzve, do të thotë, para së gjithash, t'i bindësh njerëzit për dëmin dhe rrezikun e mbeturinave dhe të shfaqjeve të huaja si për vetë bartësit e tyre ashtu edhe për shoqërinë, t'i bindësh ata për drejtësinë e parimeve dhe normave komuniste që duhet t'i udhëheqin ata në gjithë veprimtarinë e tyre.

Kontradiktat tona me mbeturinat dhe shfaqjet e huaja në ndërgjegjen e njerëzve janë kontradikta ideologjike. Si të tilla, ato nuk mund të zgjidhen me asnjë rrugë tjetër veç rrugës së sqarimit me durim dhe bindjes së njerëzve me argumente, duke bërë me ta një punë të vazhdueshme. Me metodat e detyrimit dhe ato administrative në këtë rast jo vetëm është e vështirë të zgjidhësh gjë, por mund edhe të prishësh punë. Është për t'u theksuar se, ngandonjëherë, organizatat e Partisë, në vend që të bëjnë punë të gjerë bindëse e edukative me njerëzit, gjejnë rrugën më të shkurtër, atë të masave ndëshkimore. Masat e ndryshme ndëshkimore janë të nevojshme dhe luajnë rolin e tyre edukativ, por ato në asnjë mënyrë nuk mund dhe nuk duhet të zëvendësojnë punën edukative-bindëse të Partisë. Vetëm kush humbet durimin, vetëm ai që nuk ka besim në fjalën bindëse të Partisë dhe në vetë njerëzit se mund t'i ndreqin të metat e tyre, vetëm ai është i prirë të zëvendësojë metodën e bindjes e të edukimit me masat disiplinore.

Në shembuj të shumtë nga veprimtaria e përditshme e Partisë duket qartë se ç'rrezulate pozitive arrihen kur bëhet një punë e mirë, sqaruese e bindëse me masat dhe, në të kundërtën, ç'rrezulate negative kemi kur mungon një punë e tillë. Po marrim një shembull karakteristik:

Për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave të marsit të këtij viti «Mbi masën e tokës në përdorim të punonjësve të

NBSH-ve, EDE-ve dhe NBL-ve», Komiteti i Partisë i rrethit të Durrësit bëri një punë të mirë paraprake sqaruese e bindëse me njerëzit, vuri në lëvizje të gjitha organizatat e Partisë për të luftuar tendencat mikroborgjeze të disa punonjësve e kuadro dhe pastaj mori masa për ta vënë atë në jetë. Kjo punë bindëse bëri që gjatë kohës së zbatimit të vendimit të mos ngjallen pakënaqësi dhe të mos ketë keqkuptime. Krejt ndryshe veprroi Komiteti i Partisë i rrethit të Elbasanit. Duke u nisur nga fakti se ky është vendim qeverie, ai nuk e gjeti të nevojshme të pregatiste terrenin për zbatimin e tij. Prandaj, pa bërë asnjë punë politike bindëse e sqaruese me njerëzit, urdhëroi të merren masa në vend për zbatimin e vendimit, i cili në disa raste, bile edhe u shtrembërua. Kjo ngjalli pakënaqësi dhe moskuptime nga të gjithë të interesuarit, të cilët, pa përjashtim, ju drejtuan me ankesa organeve të rrethit e të qendrës. Pas kësaj, komitetit të Partisë ju desh një punë më e madhe dhe një kohë më e gjatë për të sqaruar njerëzit dhe për të zbatuar drejt vendimin.

Në punën tonë edukative me njerëzit është e domosdoshme të bëhet mirë dallimi i kontradiktave tona me mbeturinat e shfaqjet e huaja në ndërgjegjen e njerëzve dhe kontradiktave tona me bartësit e këtyre mbeturinave e shfaqjeve të huaja. Kontradiktat tona me mbeturinat e shfaqjet e huaja janë kontradikta midis dy ideologjive të kundërta, ato janë një shfaqje e luftës së klasave, janë kontradikta antagoniste dhe si të tilla, kundër tyre duhet bërë një luftë ideologjike e papajtueshme. Kontradiktat tona me bartësit e këtyre mbeturinave dhe shfaqjeve të huaja, në shumicën dërmuese të rasteve, janë kontradikta joantagoniste, kontradikta në gjirin e popullit, sepse në masën e tyre bartësit e këtyre fenomeneve janë njerëzit tanë, politikisht të mirë e të lidhur me pushtetin popullor. Prandaj, me ta duhet të sillemi si me njerëzit tanë, të punojmë me durim, duke u nisur gjithnjë nga mësimet e Partisë që jo vetëm të luftojmë sëmundjen, por të shpëtojmë njëkohësisht edhe vetë të sëmurin.

Megjithkëtë, nuk përjashtohet mundësia, dhe për këtë ka fakte, se bartës të veçantë të këtyre mbeturinave e shfaqjeve të huaja, për arsye të ndryshme, duke përfshirë këtu edhe mungesën e vigjilencës dhe dobësitë e punës sonë edukative me ta, mund të kalojnë në pozita armiqësore, mund të kryejnë veprime antisocialiste e antishtetërore dhe t'i shndërrojnë kështu kontradiktat joantagoniste në kontradikta antagoniste. Në këto raste, kur gabimet e bartësve të mbeturinave dhe shfaqjeve të huaja shndërrohen në faje të dënueshme penalisht, kuptohet se metoda e bindjes ja lë vendin metodës së detyrimit, veprimeve të ligjeve të shtetit tonë. Përdorimi i metodës së detyrimit në këto raste është jo vetëm i domosdoshëm për t'u prerë rrugën veprimeve antishtetërore e antisocialiste, por luan edhe një rol të madh edu-

kativ, si për vetë njerëzit që i kryejnë këto veprime ashtu edhe për masën tjetër të punonjësve.

Detyra e Partisë është t'u dalë gjërave përpara, të mos i lërë njerëzit të bien në gabime e faje të rënda, sepse interesi i Partisë dhe i shtetit, nga çdo pikëpamje që ta marrësh qoftë nga ana politike, qoftë nga ajo ekonomike e shoqërore, nuk është që të dënohen e të futen nëpër burgje sa më shumë njerëz. Nuk duhet harruar, nga ana tjetër, se masat administrative, të detyrimit, luftojnë pasojën, veprimin, aktin, por jo shkakun, jo burimin që i shtyn njerëzit në veprime antishoqërore, antisocialiste. Shkaqet dhe burimet e të këqiave që janë mbeturinat dhe shfaqjet e huaja në ndërgjegjen e njerëzve, mund të luftohen me sukses në radhë të parë me anën e një pune të gjerë sqaruese bindëse, edukative me njerëzit. Me të drejtë Lenini theksonte:

«Më parë ne duhet të bindim, pastaj të detyrojmë. Ne duhet me çdo kusht më parë të bindim dhe pastaj të detyrojmë»¹.

c) Kolektivi, shembulli pozitiv, kritika dhe autokritika janë një forcë e madhe për edukimin komunist të punonjësve

Karakteristike për shoqërinë tonë, për gjithë jetën e vendit, për luftën tonë, janë shembujt pozitivë, është njeriu i ri i socializmit, njeriu që ka rritur dhe edukuar Partia, plot talent, i palodhur, guximtar, që vë mbi çdo gjë interesin e shoqërisë, që është luftëtar aktiv i ndërgjegjshëm i socializmit. Ky njeri i jep tonin gjithë jetës sonë, sipas pulsit të tij revolucionar ecën e zhvillohet gjithë jeta e vendit. Ky fakt ka një rëndësi jashtëzakonisht të madhe. Në qoftë se përpara nesh shtrohet detyra që të forcojmë e përmirësojmë punën për edukimin komunist të punonjësve, për këtë qëllim duhet të përdorim gjerësisht shembullin pozitiv.

Forca edukative e shembullit pozitiv është shumë e madhe. Sa mijëra e mijëra partizanë gjatë Luftës nacional-çlirimtare u frymëzuan për akte heroizmi nga shembulli i madh i jetës dhe veprës së Qemal Stafës, Vojo Kushit, Asim Zenelit e qindra e qindra luftëtarëve të tjerë të lirisë, që nuk kursyen as jetën për çështjen e popullit e të atdheut, që qëndruan si burrat përpara torturave të tmerrshme, përpara plumbit dhe litarit të armikut!

¹ V. I. Lenin. Veprat, vëll. 32, f. 242.

Dhe a nuk ka luajtur e luan një rol vendimtar në luftën për ndërtimin e socializmit, në formimin e forcimin e ndërgjegjes së punonjësve, shembulli i punës plot vetëmohim i vullnetarëve të rinj për ndërtimin e hekurudhave të para, i sulmuesve e racionalizatorëve të prodhimit, i iniciatorëve të lëvizjeve të reja të emulacionit socialist, i heronjve të punës socialiste dhe i qindra e mijëra punonjësve të tjerë të përparuar të vendit tonë?

Organizatave e Partisë dhe ato të masave kanë bërë e bëjnë një punë të madhe për popullarizimin e shembujve pozitivë dhe për edukimin e punonjësve në këta shembuj. Këtë punë ato duhet ta vazhdojnë edhe në të ardhshmen dhe ta ngrenë në një nivel më të lartë, duke përdorur forma të shumëllojshme. Por organizatat e Partisë dhe ato të masave është e nevojshme të kenë parasysh se punonjësit edukohen jo vetëm me shembullin e heronjve të punës socialiste, apo njerëzve të tjerë të dalluar të shoqërisë sonë, por edhe me shembullin e cilësive dhe vetive pozitive të njerëzve të thjeshtë, që shpesh nënvleftësohet dhe lihet pas dore.

Edukimi në shembullin e më të mirëve kërkon patjetër studimin dhe përhapjen e filizëve të rinj të ndërgjegjes socialiste, që shprehen qoftë në qëndrimin socialist ndaj punës e pronës, qoftë në sjelljet e kulturuar në jetë e shoqëri, qoftë në marrëdhënjet e reja socialiste midis punonjësve. Detyra e punës ideologjike të Partisë është t'i kapë këta filizë, t'i përhapë, të bëjë përgjithësime teorike dhe politike prej tyre. Ne kemi shumë fakte që tregojnë se shumë iniciativa dhe shembuj të mirë janë kapur e përhapur në masa, por duhet theksuar se shpeshherë këto iniciativa dhe shembuj nuk ndiqen e nuk çohen deri në fund. Në eksperiencën e përhapur dhe shembujt pozitivë në mjaft raste shihet vetëm efekti ekonomik i tyre dhe nuk zbulohet përmbajtja e thellë shoqërore, si dhe rëndësia e tyre për edukimin e gjithanshëm të njerëzve. Kur Lenini analizoi lëvizjen e të shtunave komuniste, para së gjithash e mbi të gjitha, ai pa jo efektin ekonomik të kësaj lëvizjeje, por atë revolucion të madh që shprehte ajo në ndërgjegjen e njerëzve, pa filizët e parë të ndërgjegjes së lartë komuniste.

Një armë e fuqishme në luftën kundër të metave, kundër mbeturinave e shfaqjeve të huaja është kritika e autokritika. Ajo është një forcë e madhe që e çon përpara zhvillimin e shoqërisë sonë, është shprehja e një qëndrimi aktiv e të ndërgjegjshëm të punonjësve, e ndjenjës së përgjegjshësisë ndaj vetes dhe kolektivit, e papajtuëshmërisë me indiferentizmin. Është e nevojshme që Partia ta përdorë gjerësisht këtë armë dhe të hedhë poshtë pikëpamjet e shtrembëra që duken aty-këtu. Është krejt i gabuar koncepti sipas të cilit nuk duhet kritikuar shumë dhe ashpër, sepse mund të thyhen njerëzit. Kritika e drejtë parimore, sado e fortë që të jetë, nuk i thyen njerëzit, përkundrazi, i ndihmon, i ndreq,

i bën ata të shkojnë përpara. Gjithashtu, duhet hedhur poshtë pikëpamja sipas së cilës nuk duhet kritikuar për të mos nxirë realitetin, sepse përpara anëve pozitive, anët negative të tija janë të parëndësishme. Kritika e drejtë parimore nuk e nxin në asnjë mënyrë realitetin, përkundrazi, duke luftuar shfaqjet negative, të metat, dobësitë, mbeturinat e huaja, ajo ndihmon për zhdukjen e tyre, për ta bërë realitetin tonë edhe më të pastër e më të shëndoshë. Që kritika të luajë rolin e saj pozitiv në edukimin e njerëzve dhe në përmirësimin e punës sonë, është e domosdoshme që, krahas me dënimin e të metave e të dobësive, të vëjë në dukje edhe sukseset, që krahas me mohimin e anëve negative, të afirmojë edhe atë çka është pozitive, që krahas me zbulimin e shkaqeve, të tregojë edhe rrugët e mjetet për kapërcimin e të metave e dobësive. Vetëm një kritikë e tillë e shëndoshë i shërben çështjes së edukimit të drejtë të njerëzve.

Për edukimin e njerëzve një rol të dorës së parë luajnë opinionit publik dhe kolektivi. Suksesi i punës edukuese të organizatave të Partisë dhe të masave varet në një shkallë të madhe edhe nga fakti se sa punojnë ato për të rritur rolin e opinionit publik dhe të kolektivit në luftën kundër mbeturinave dhe shfaqjeve të huaja. Forca edukuese e opinionit publik, e kolektivit, shpesh vepron mbi njerëzit më tepër se masat administrative. Për shembull, bën shumë më pak efekt vërejtja nga drejtori i një ndërmarrjeje një punëtori të pandërgjegjshëm se sa kur ai kritikohet për gabimet e fajet e tij përpara kolektivit. Jeta ka treguar se më shumë efekt edukativ kanë pasur gjyqet shoqërore, kur këto janë organizuar mirë e me vend, se sa masat e tjera administrative që mund të jenë marrë, ose mund të merreshin nga organet shtetërore.

Në stacionin e trenit të qytetit të Tiranës, ku punojnë 84 vetë, ishin vërtetuar shpeshherë thyerje të disiplinës nga ana e mjaft punonjësve. Drejtori i ndërmarrjes nuk i bëri ato problem të organizatës bazë të Partisë dhe të kolektivit, por u mjaftua me marrjen e masave administrative. Brenda 5 muajve e gjysmë të këtij viti ai mori 34 masa të tilla kundrejt 26 punonjësve dhe, megjithatë, nuk e ndreqi gjendjen. Krejt ndryshe u veprua në Uzinën «Partizani» të qytetit të Tiranës. Në këtë ndërmarrje merreshin nga punonjësit sende të ndryshme. Kur u kapën tre fajtorë, për ta u organizua gjyqi shoqëror, që bëri një efekt të madh në gjithë kolektivin e kësaj ndërmarrjeje. Pas kësaj nuk ndodhi më asnjë rast tjetër vjedhjeje, ndërsa punonjësit që dolën para kolektivit u vunë në rrugë të drejtë, bile njëri prej tyre u bë punëtor i dalluar. Ose komiteti profesional i reparteve ndihmëse të NSHN—bonifikimeve në Durrës thirri disa punonjës të padisiplinuar dhe pasi këta u zotuan të punonin mirë, shpalli në tabelën e agjitacionit emrat e tyre nën titullin «Vendosën të bëjnë

kthesë». Duke u ndodhur nën kontrollin e kolektivit, ata u ndreqën dhe njeri prej tyre u pranua në brigadën e punës socialiste.

Nga organizatat e Partisë dhe ato të masave kërkohet që të punojnë në mënyrë të tillë me njerëzit e kolektivit që ata të mos qëndrojnë kurrë indiferentë ndaj sjelljeve e qëndrimeve, qofshin këto negative ose pozitive. Kolektivi dhe opinioni publik duhet të reagojnë për çdo gjë, të japin vlerësimin dhe gjykimin e tyre, duke dënuar çdo gjë të huaj, duke afirmuar çdo gjë të mirë. Por vlerësimi i çdo akti të mirë ose të keq nga ana e shoqërisë ose kolektivit nëpërmjet shtypit, gazetës së murit, qendrës së zërit, gjyqeve shoqërore, mbledhjes së kolektivit dhe formave të tjera do të japë rezultatet e duhura në qoftë se bëhet me takt, me vend dhe pa teprime. Vetëm kështu ai do të jetë kurdoherë frutdhënës, si për vetë kolektivin ashtu edhe për njerëzit e veçantë.

c) T'i aktivizojmë më mirë gjithë levat e Partisë, gjithë armët ideologjike të saja

Zgjidhja e detyrave të mëdha që kemi përpara për edukimin komunist të punonjësve është e lidhur ngushtë me veprimtarinë e organizatave bazë të Partisë. Ato janë në kontakt të përditshëm me njerëzit, si në punë ashtu edhe jashtë saj, njohin nga afër anët e mira dhe dobësitë e punonjësve të veçantë, prandaj luftës kundër mbeturinave e shfaqjeve të huaja, luftës për edukimin e ndërgjegjes socialiste, ato duhet t'i kushtojnë vendin kryesor në të gjithë punën e tyre me njerëzit. Është e qartë se këto probleme nuk mund të zgjidhen me sukses në qoftë se ato nuk i merr mirë në dorë Partia, në qoftë se ajo nuk përdor për këtë qëllim me aftësi të gjitha format dhe mjetet e punës edukative, duke përfshirë arësimin në parti, punën me leksione, përdorimin e shtypit e të librit, agjitacionin individual e figurativ etj. Për këtë arsye është e domosdoshme që organizatat bazë të mësohen se si ta organizojnë e zhvillojnë më mirë punën e tyre edukative me njerëzit. Pikërisht në këtë drejtim komitetet e Partisë duhet të japin ndihmën e tyre kryesore për organizatat bazë.

Edukimi komunist i punonjësve është detyra themelore e të gjitha organizatave të masave, si leva të Partisë. Kjo vlen si për bashkimet profesionale ashtu edhe për organizatën e rinisë dhe atë të gruas, të cilat, nga gjithë sa u tha në këtë raport, duhet të nxjerrin konkluzionet e nevojshme për përmirësimin e punës së tyre, për përcaktimin e detyrave të tyre konkrete. Në mënyrë të veçantë bashkimet profesionale duhet të përmirësojnë punën e tyre. Ato duhet të kuptojnë mirë se roli i tyre kryesor është, siç

ka thënë Lenini, të bëhen «shkolla të edukimit komunist»¹ të punonjësve.

Edukimi i punonjësve në frymën e socializmit nuk është vetëm një detyrë e organizatave të Partisë dhe e atyre të masave, por edhe një detyrë me rëndësi e organizatave të pushtetit popullor. Si organe të diktaturës së proletariatit, ato nuk duhet të harrojnë se përveç detyrave të tjera, diktatura e proletariatit ka edhe një funksion shumë të madh edukativ, që vjen gjithnjë duke u rritur. Ky funksion nuk realizohet vetëm duke marrë masa organizative dhe administrative, me të cilat u mbyllen shtigjet shfaqjeve antisocialiste, ose vetëm duke zbatuar në kohën dhe masën e duhur dispozitat administrativo-ligjore kundër elementëve keqbërës. Kryerja e plotë e këtij funksioni kërkon edhe një punë të gjerë edukative me njerëzit për sqarimin e bindjen e tyre. Pra, është e nevojshme që organizatat e pushtetit të kombinojnë drejt në gjithë veprimtarinë e tyre me masat ekonomike, organizative e administrative në punën edukative. Këtu qëndron një nga të meta kryesore në punën e tyre.

Një rol të madh në edukimin e punonjësve luan propagandimi i ligjeve të pushtetit tonë popullor. Në ligjet tona, në normat juridike, gjejnë shprehjen e tyre edhe parimet dhe normat e moralit komunist, vija e Partisë sonë për ndërtimin e socializmit. Prandaj, popullarizimi dhe shpjegimi i ligjeve është një detyrë shumë e rëndësishme jo vetëm e organeve të pushtetit, por edhe e organizatave të Partisë dhe atyre të masave, e gjithë propagandës sonë. Me punën tonë të gjithanshme ne duhet të arrijmë që çdo qytetar i Republikës të respektojë me rreptësi ligjet, jo vetëm për shkak të pasojave që rrjedhin prej shkeljes së tyre, por në radhë të parë të arrijmë që secili ta konsiderojë respektimin e ligjeve si një detyrë të shenjtë, si një normë të lartë morale.

Në punën për edukimin komunist të punonjësve është e domosdoshme të përdoren më mirë të gjitha armët ideologjike, si shtypi, botimet, radioja, kinematografia etj., të cilat duhet të militojnë aktivisht në luftën kundër mbeturinave e shfaqjeve të huaja, për rrënjosjen dhe forcimin e botëkuptimit dhe moralit komunist në punonjësit. Një rol të madh në këtë drejtim luan shkolla jonë, e cila jo vetëm duhet ta pajisë brezin e ri me dije e kulturë, por edhe ta edukojë atë me një frymë të shëndoshë komuniste revolucionare.

Detyra të mëdha për edukimin e punonjësve kanë sidomos letërsia e artet. Ato duhet të përshkohen nga fryma e partishmërisë së thellë, të pasqyrojnë drejt realitetin tonë, të ngrënë lart figurën morale të njeriut tonë të ri, të luftojnë kundër çdo gjëje të huaj në ndërgjegjen e njerëzve. Është e nevojshme që

¹ Shih: V. I. Lenin. Veprat, vëll. 32, f. 100.

veprat letrare dhe artistike të përdoren gjerësisht në punën për edukimin e masave, sepse parimet e marksizmit dhe normat e moralit komunist nuk përvetësohen vetëm me leksione e konferenca ideo-politike, por edhe nëpërmjet leximit të letërsisë artistike.

Shokë,

Këto ishin çështjet që Byroja Politike pa të nevojshme t'ja paraqesë për diskutim këtij plenumi. Lufta kundër mbeturinave dhe shfaqjeve të huaja në ndërgjegjen e njerëzve, për rrënjosjen e ideologjisë, botëkuptimit e moralit tonë të ri, është luftë për ndërtimin e plotë të shoqërisë socialiste. Shfaqjet e huaja që vihen re në jetën tonë janë fenomene të veçuara jokarakteristike, janë një mish i huaj në trupin e shëndoshë të veprës së madhe që po ndërton populli ynë, nën udhëheqjen e Partisë. Këtë mish të huaj ne duhet ta luftojmë me rreptësi, që të mos kthehet në tumor, që të mos bëhet rrezik. Partia jonë, e udhëhequr nga Komiteti i saj Qendror me shokun Enver Hoxha në krye, do ta kryjë me nder edhe këtë detyrë të madhe e të vështirë, sepse ajo është një Parti revolucionare, një Parti e kalitur në luftëra të ashpra, një Parti që nuk i është shmangur kurrë asnjë vështirësie e pengese, një Parti që ka në gjirin e saj komunistë të mrekullueshëm, që ka besimin dhe mbështetjen e pakufishme të popullit tonë trim, punëtor e lirisdashës.

Botohet sipas broshurës: Raport i Byrosë Politike të KQ të PPSH «Mbi forcimin e mëtejshëm të punës ideologjike të Partisë për edukimin komunist të punonjësve», mbajtur nga shoku Ramiz Alia. Tiranë, 1964

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 165, 11 korrik 1964

V E N D I M

I PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH MBI APROVIMIN E RAPORTIT «Mbi forcimin e mëtejshëm të punës ideologjike të Partisë për edukimin komunist të punonjësve»

9 korrik 1964

Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH, në mbledhjen e tij të datës 7—9.7.1964, pasi dëgjoji dhe diskutoi raportin e Byrosë Politike të Komitetit Qendror të PPSH «Mbi forcimin e mëtejshëm të punës

ideologjike të Partisë për edukimin komunist të punonjësve», mbajtur nga sekretari i Komitetit Qendror të PPSH, shoku Ramiz Alia,

V e n d o s i :

1. — Të aprovojë njëzëri raportin e mësipërm i cili të shërbejë si program pune për përmirësimin e punës ideologjike të Partisë dhe për edukimin komunist të punonjësve.

2. — Raporti i Byrosë Politike të Komitetit Qendror të PPSH që u paraqit në këtë plenum si dhe fjala e mbylljes e shokut Enver Hoxha, të botohen.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

PLENUMI XIV I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Tiranë, 18—19 shkurt 1965

KOMUNIKATË

MBI ZHVILLIMIN E PUNIMEVE TË PLENUMIT XIV TË KOMITETIT QENDROR TË PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË

Më 18 dhe 19 shkurt 1965, u mbledh Plenumi i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, nën kryesinë e Sekretarit të Parë të Komitetit Qendror të PPSH, shokut Enver Hoxha.

Plenumi dëgjoi dhe shqyrtoi raportin e Byrosë Politike «Mbi përfundimet e plotësimit të planit dhe të buxhetit të shtetit për vitin 1964 dhe detyrat e planit dhe të buxhetit për vitin 1965», mbajtur nga kandidati i Byrosë Politike dhe President i Komisionit të Planit të Shtetit, shoku ~~Enver Hoxha~~ *Kaço Theodhosi*.

Në punimet e plenumit muarën pjesë edhe sekretarët e parë të komiteteve të Partisë të rretheve, si dhe disa nga kuadrot e organeve qendrore të Partisë dhe të shtetit.

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror të PPSH, shoku Enver Hoxha, foli në plenum mbi detyrat që dalin përpara Partisë dhe popullit për realizimin e planit të shtetit të vitit 1965 si dhe mbi disa çështje të gjendjes ndërkombëtare.

Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH aprovoi njëzëri raportin e Byrosë Politike dhe caktoi detyrat përkatëse.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

R A P O R T

I BYROSË POLITIKE TË KQ TË PPSH MBI PËRFUNDIMET E PLANIT DHE TË BUXHETIT TË SHTETIT PËR VITIN 1964 DHE DETYRAT E PLANIT DHE TË BUXHETIT PËR VITIN 1965

18 shkurt 1965

Shokë,

Byroja Politike mendon që në këtë mbledhje të Plenumit të Komitetit Qendror të Partisë të shqyrtohen përfundimet e arritura në plotësimin e planit dhe të buxhetit gjatë vitit 1964 dhe detyrat kryesore për të plotësuar me suksese planin e shtetit dhe buxhetin e vitit 1965, viti i fundit i planit të tretë pesëvjeçar.

Në vitin 1964 u arritën suksese të tjera të rëndësishme në zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë popullore. Edhe këtë vit populli ynë, nën udhëheqjen e drejtë të Partisë së Punës të Shqipërisë me shokun Enver Hoxha në krye, punoi dhe ndërtoi me entuziazëm dhe besim të patundur në forcat e veta për realizimin e detyrave madhështore, që shtroi Kongresi IV historik i PPSH. Viti 1964 ishte viti i 20-vjetorit të çlirimit të atdheut. Ky fakt ndikoi në një masë të ndijshme për mobilizimin më të madh të punonjësve të vendit tonë në plotësimin dhe tejkalimin e detyrave të planit të shtetit.

Gjatë 20 vjetëve të pushtetit popullor masat punonjëse të vendit tonë arritën suksese kolosale që ja ndryshuan pamjen atdheut tonë.

«20-vjetori i çlirimit — tha shoku Enver Hoxha në fjalimin e tij, mbajtur në mbledhjen solemne kushtuar këtij 20-vjetori — e gjen atdheun tonë, Shqipërinë, një vend të lirë e të pavarur socialist, me një bazë industriale të zhvilluar, me një bujqësi të madhe socialiste, me një kulturë të përparuar dhe me nivel jetese të ngritur, me një rend shoqëror të shëndoshë, të përbërë nga klasa punonjëse mike, të bashkuar në një unitet moralo-politik të pathyeshëm, me një pozitë ndërkombëtare më të fortë se kurrë ndonjëherë».¹

Në vitin 1964 populli dhe Partia jonë mbyllën me suksese të mëdha 20-vjetorin e çlirimit të atdheut dhe e festuan atë me madhësi.

Në vitin 1964 u vërtetua edhe një herë në mënyrën më bindëse drejtësia e vijës së Partisë sonë dhe e luftës së saj parimore kundër imperializmit dhe revizionizmit modern. Lufta e Partisë sonë, e partive të tjera marksiste-leniniste dhe e komunistëve revolucionarë në të gjithë botën për demaskimin e revizionizmit

¹ Enver Hoxha. 20 vjet Shqipëri e re Socialiste. F. 13. Tiranë, 1964.

hrushovian, në vitin 1964 u kurorëzua me një sukses të rëndësishëm që shpuri në largimin nga skena politike të N. Hrushovit, që ka qenë kreu i revizionistëve. Një rëndësi të madhe ndërkombëtare ka pasur në këtë situatë qëndrimi i drejtë i Partisë sonë dhe paralajmërimi me kohë se rrëzimi i N. Hrushovit nuk shënoi fundin e revizionizmit hrushovian, prandaj nuk duhet ushqyer në këtë drejtim asnjë iluzion, por duhet të vazhdojë me konsekuencë lufta kundër revizionizmit modern hrushovian apo titist, deri në shpartallimin e tij të plotë. Ky qëndrim i drejtë i Partisë sonë u vërtetua menjëherë nga ngjarjet e fundit dhe veprimtaria e grupit revizionist hrushovian pas largimit të kryetarit të tij në të njëjtën rrugë antimarksiste.

Tani ne kemi filluar nga puna për realizimin e planit të vitit 1965. Mbi bazën e punës dhe të përfundimeve të arritura gjatë vitit 1964 ne kemi hyrë në vitin 1965 më të përgatitur dhe më të sigurtë, për të plotësuar me sukses detyrat, që parashikon plani i këtij viti.

Detyrat e planit të vitit 1965 kanë një rëndësi të madhe për të plotësuar objektivat kryesorë të planit të tretë pesëvjeçar dhe për të siguruar një bazë sa më të fortë ekonomike dhe përgatitjen e nevojshme për fillimin e punës për realizimin e pesëvjeçarit të ardhshëm, të ri. Detyra e të gjitha organeve të Partisë, të shtetit dhe të ekonomisë është që gjatë vitit 1965 të punojnë më me ngulm, të rritin edhe më tej mobilizimin e masave punonjëse dhe të luftojnë në mënyrë të gjithanshme për të realizuar dhe tejkaluar detyrat e planit të vitit 1965 në të gjithë sektorët e ekonomisë dhe të kulturës.

Në këtë raport do të analizojmë shkurtimisht treguesit kryesorë të zhvillimit ekonomik dhe kultural gjatë vitit 1964 dhe do të ndalemi në mënyrë të veçantë në disa probleme të plotësimit të planit të vitit 1965, që lidhen edhe me zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë popullore në të ardhshmen.

I

MBI PËRFUNDIMET E PLOTËSIMIT TË PLANIT DHE TË BUXHETIT PËR VITIN 1964

Në Plenumin XII të Komitetit Qendror të PPSH të shkurtit të vitit të kaluar mbi plotësimin e planit dhe të buxhetit për vitin 1963 dhe masat për plotësimin e planit dhe të buxhetit për vitin 1964 u theksua se plani i vitit 1964 parashikonte detyra të mëdha dhe këto detyra kishin një rëndësi vendimtare për realizimin e planit të tretë pesëvjeçar. Plenumi i Komitetit Qendror të Partisë tërhoqi vëmendjen në mjaft çështje të rëndësishme dhe porositi

që të merreshin me kohë masat e gjithanshme për të siguruar kushtet e nevojshme për kapërcimin e pengesave dhe të vështirësive dhe për të arritur një mobilizim më të madh në plotësimin e planit.

Organizatata e Partisë, organet shtetërore dhe të Partisë kanë pasur mirë parasysh vendimet e plenumit të shkurtit dhe viti 1964 i 20-vjetorit të çlirimit të atdheut, u karakterizua nga një rritje e mëtejshme e mobilizimit dhe e përpjekjeve të popullit tonë për plotësimin e detyrave të planit të shtetit në të gjithë sektorët e ekonomisë dhe të kulturës. Në saje të këtij mobilizimi dhe të organizimit më të mirë të punës u arrit që detyrat e parashikuara në planin e vitit 1964 të plotësohen në përgjithësi në mënyrë të kënaqshme.

Plani i prodhimit të përgjithshëm industrial u realizua 100,7 për qind dhe u rrit 7,4 për qind më shumë kundrejt vitit 1963. Plani i prodhimit të përgjithshëm industrial plotësohet gati në të gjitha degët e industrisë dhe nga të gjitha dikasteret. Nuk plotësohet plani i prodhimit industrial në degën e industrisë së drurit, në industrinë e materialeve të ndërtimit dhe nga Komiteti Shtetëror i Grumbullimeve.

Prodhimi i përgjithshëm bujqësor, sipas të dhënave paraprake, plotësohet 91 për qind, me një rritje prej 2 për qind kundrejt prodhimit të vitit 1963. Në krahasim me vitin 1963, u prodhuan më shumë drithëra buke, panxhar sheqeri, perime, patate, rrush, qumësht etj. ndërsa paraqiten nën nivelin e arritur në vitin 1963 prodhimi i duhanit, pambukut, ullinjve, fasuleve, vezëve etj. . . Në blegtori, plani i rritjes së numrit të krerëve është realizuar për gjedhët, dhëntë dhe dosat, ndërsa nuk u realizua për dhitë dhe sidomos për shpendët. Për të gjitha llojet e gjësë së gjallë në vitin 1964 është rritur numri i tyre në krahasim me vitin 1963.

Përfundime të mira u arritën edhe në grumbullimin e prodhimeve bujqësore dhe blegtorale. Në vitin 1964 u grumbulluan drithëra buke 102,8 për qind kundrejt planit dhe 40 për qind më shumë nga plotësimi i vitit 1963. U tejkalua plani i grumbullimit për orizin, panxhar sheqerin, lule diellin, qumështin, leshin etj. Ndërsa nuk u realizua plani i grumbullimit të duhanit, pambukut, mishit, vezëve etj. Ndërmarrjet bujqësore shtetërore plotësuan 100 për qind dorëzimin e drithërave të bukës dhe të mishit, tejkaluan dorëzimet në oriz, panxhar sheqeri, fruta, lesh, gjalpë dhe nuk plotësuan pambukun, perimet, patatet, qumështin etj.

Gjatë vitit 1964 plani u plotësua në të gjithë treguesit kryesorë të transportit. Masat që u muarën gjatë vitit 1964 siguruan që, në përgjithësi, të kapërcehen vështirësitë kryesore të vërtetuara në vitin 1963 për lëvizjen e mallrave. Megjithatë duhet vënë në dukje se edhe gjatë vitit që shkoi u paraqitën disa vështirësi në transportimin e mineralit të hekurit, të mineralit të kromit dhe

sidomos të druve të zjarrit, të shkaktuara për faj të ndërmarrjeve prodhuese dhe të ndërmarrjeve të komunikacionit.

Plani i investimeve të vitit 1964 u plotësua 115 për qind dhe plani i ndërtimeve 97,6 për qind. Në krahasim me vitin 1963 investimet u rritën 31 për qind më shumë dhe ndërtimet 3 për qind më shumë.

Në vitin 1964 plani i eksportit të mallrave u plotësua 87 për qind me një rritje prej 24 për qind kundrejt vitit 1963, kurse plani i importit u plotësua 93 për qind dhe në krahasim me vitin e kaluar pati një rritje prej 39 për qind më shumë.

Qarkullimi i mallrave me pakicë u plotësua 101,2 për qind kundrejt planit dhe në krahasim me vitin 1963 u rrit 5,7 për qind më shumë. Ky është një tregues mjaft i rëndësishëm i rritjes së fuqisë blerëse të popullatës më shumë se rritja e numrit të popullsisë. Në përgjithësi furnizimi i popullit me mallra ushqimore dhe industriale ka qenë i rregullt dhe në mjaft artikuj janë shënuar përmirësime në krahasim me vitin e mëparshëm. Gjithashtu përfundime të mira janë arritur gjatë vitit 1964 në zhvillimin e arësimit, kulturës, pregatitjes së kuadrit dhe për mbrojtjen e shëndetit të popullit.

Buxheti i shtetit për vitin 1964 plotësohet dhe tejkalohet dhe në përgjithësi mbyllet me përfundime më të mira se në tre vjetët e parë të pesëvjeçarit të tretë. Të ardhurat e buxhetit u plotësuan 109,2 për qind dhe shpenzimet 107,5 për qind. Të ardhurat nga tatimi mbi xhiro dhe teprica e fitimit, që përbëjnë burimin kryesor të të ardhurave të buxhetit dhe që lidhen me plotësimin e planit të prodhimit nga degët e ndryshme të ekonomisë popullore, janë realizuar dhe tejkaluar. Shpenzimet e buxhetit janë kryer në bazë të planit për financimin e ekonomisë popullore, për zhvillimin e arësimit dhe kulturës, për ruajtjen e shëndetit të popullit dhe për fuqizimin e aftësisë mbrojtëse të atdheut tonë.

Përfundimet e arritura gjatë vitit 1964 përbëjnë një sukses të rëndësishëm dhe shënojnë një hap tjetër përpara në forcimin e ekonomisë sonë popullore. Këto suksese janë rezultat i punës dhe i mobilizimit të masave punonjëse të vendit tonë, i një pune më të organizuar dhe më këmbëngulëse nga të gjitha organet e Partisë, të shtetit dhe të ekonomisë.

Viti 1964 u karakterizua nga një punë e madhe dhe e përgjithshme për të vënë në jetë detyrat e rëndësishme që shtroi Partia në fushën e organizimit socialist të punës dhe sidomos të detyrave që shtroi Plenumi XIII i korrikut 1964 i Komitetit Qendror të PPSH në fushën e edukimit komunist të punonjësve të vendit tonë. Puna e bërë dhe sukseset e arritura në këto drejtime gjatë vitit 1964 janë të mëdha, por këto probleme janë të vazhdueshme dhe duhet një punë sa më e efektshme e këmbëngulëse edhe në

të ardhshmen për të siguruar rritjen dhe qëndrueshmërinë e fitoreve tona në ndërtimin e socializmit.

Gjatë vitit 1964, krahas sukseseve të arritura, në punën tonë janë vërejtur edhe të meta e mungesa, të cilat kanë penguar për përfundime edhe më të mira në plotësimin e detyrave të planit. Në disa sektorë dhe për mjaft prodhime nuk u realizua plani dhe u krijuan deficite që rëndojnë ekonominë popullore. . .

Mosplotësimi i planit nga të gjithë sektorët dhe në të gjithë treguesit e tij ka rrjedhime serioze që e rëndojnë shumë ekonominë popullore. Shumë arsye mund të numërohen nga shokë të ndryshëm për mosplotësimin e detyrave të parashikuara në plan, por Byroja Politike është e mendimit se mosplotësimi i detyrave të planit është rrjedhim i të metave dhe mungesave në punë, në organizimin e saj, në një luftë akoma të pamjaftueshme për të mobilizuar të gjitha mundësitë dhe rezervat, për t'u dalë me kohë përpara vështirësive dhe për të marrë masa konkrete për kapërcimin e tyre. Mënjanimi i këtyre të metave shtron para Partisë me forcë të madhe nevojën e një pune më të madhe në drejtim të një kuptimi më të gjerë të detyrave nga ana e kuadrove të shtetit dhe të ekonomisë dhe të forcimit të ndjenjës së përgjegjësisë e të disiplinës së punonjësve. Puna e Partisë duhet të ngrihet në një nivel më të lartë në të gjitha organizatat e Partisë për forcimin e ndërgjegjes dhe për mobilizimin në punë të punonjësve në çdo sektor të ekonomisë popullore për të plotësuar detyrat e planit në të gjithë treguesit e tij dhe nga të gjithë kolektivat punonjës.

II

MBI DETYRAT E PLANIT DHE TË BUXHETIT PËR VITIN 1965

Plani i vitit 1965 është hartuar në bazë të kushteve konkrete në të cilat zhvillohet ekonomia jonë dhe mbështetet në bazën e shëndoshë materialo-teknike të ekonomisë të krijuar deri më sot, në vendosmërinë e punonjësve të vendit tonë për të ecur përpara, duke u mbështetur kryesisht në forcat tona dhe mbi të gjitha në forcën e madhe drejtuese dhe organizuese të Partisë sonë dhe të unitetit të pathyeshëm të popullit tonë me Partinë. Plani i vitit 1965 parashikon detyra të mëdha, por plotësisht të mundshme për t'u realizuar nga të gjithë sektorët e ekonomisë popullore.

Prodhimi i përgjithshëm industrial parashikohet të ketë një rritje prej 4,7 për qind më shumë se në vitin 1964. Rritja e prodhimit të përgjithshëm industrial do të arrihet kryesisht nga shtimi i prodhimeve më të rëndësishme të ekonomisë sonë, siç janë prodhimet e industrisë së naftës që rriten 11 për qind, të industrisë

së bakrit — 110 për qind, të industrisë elektrike — 7 për qind, të industrisë së kromit — 7 për qind, të industrisë së drurit — 14 për qind, të industrisë mekanike — 14 për qind, të industrisë së hekur-nikelit — 10 për qind etj. Plotësimi i planit në këto degë duhet të përbëjë detyrën kryesore dhe të shikohet si kushti më i rëndësishëm për plotësimin e të gjitha detyrave që parashikohen për rritjen e prodhimit të përgjithshëm industrial.

Në vitin 1965 rritja më e madhe e prodhimit industrial, që është 20 për qind kundrejt vitit 1964, parashikohet për Ministrinë e Minerave dhe të Gjeologjisë. Prandaj, duhet të merren masa të gjithanshme për të siguruar plotësimin e këtyre detyrave. Rëndësi e dorës së parë t'u kushtohet masave për të plotësuar detyrat e prodhimit të naftës brut, duke u kushtuar vëmendje të veçantë si kërkimeve të naftës në zonat e gëlqerorëve, ashtu edhe intensifikimit për nxjerrjen e naftës brut nga fushat ekzistuese. Për të siguruar plotësimin e detyrave të planit në industrinë e minierave, një rëndësi të veçantë ka realizimi ritmik i nxjerrjes së mineraleve duke marrë masa për të pasur në çdo kohë rezerva të njohura dhe fronte pune të gatshme që prodhimi të vazhdojë pa ndërprerje.

Nga ana e Ministrisë së Industrisë vëmendje më e madhe duhet t'u kushtohet prodhimeve të industrisë mekanike për të plotësuar planin si sasi, për të përmirësuar cilësinë e tyre, sidomos në pjesët e këmbimit, si dhe të punohet më me kujdes për përvetësimin e prodhimeve të reja, që ka nevojë ekonomia.

Një nga degët e industrisë që nuk shkoj mirë vitin e kaluar ishte industria e drurit. Në këtë degë sigurohet ka vështirësi se punohet në zona të thella, ku duhen ndërtuar dhe rrugë. Por ky sektor nuk varet nga lënda e parë e importit dhe plani në krahasim me detyrat e pesëvjeçarit është ulur. Këtu problem ka qenë sigurimi i fuqisë punëtore, mbasi vitin e kaluar nuk u punua si duhet që krahas ndreqjes së të metave të shumta, që u vërtetuan, të bëhej edhe një punë bindëse e sqaruese me punëtorët që të vazhdonin të qëndronin në këtë sektor. Në fakt, në sharrat e Pukës, ku u tregua një kujdes më i mirë, nuk pati largime të shumta, ndërsa kjo nuk mund të thuhet dhe për sharrat e rretheve të tjera. Këtë vit me një punë më të mirë janë të gjitha mundësitë që të mos përsëriten çrregullimet e vitit të kaluar në industrinë e drurit. Në këtë drejtim Ministria e Industrisë duhet të marrë masa serioze për të siguruar realizimin e planit me çdo kusht edhe në këtë sektor.

Në sektorin e industrisë problem i dorës së parë mbetet detyra për përmirësimin e cilësisë së prodhimit. Në këtë drejtim duhet të forcohet puna për ngritjen e ndërgjegjes së punonjësve dhe të merren masat e nevojshme teknike dhe organizative nga dikasteret e ndërmarrjet, të cilat të sigurojnë një zbatim të rregullt dhe

pa asnjë lëshim të proceseve teknologjike. Krahas kësaj të punohet sistematikisht nga organet shtetërore dhe ekonomike për përmirësimin e proceseve teknologjike, për zgjerimin e asortimenteve dhe prodhimin e artikujve të rinj, për t'ju përgjegjur si duhet nevojave të ekonomisë dhe nevojave të popullsisë.

Një detyrë tjetër e vazhdueshme ku duhet të tregohet një kujdes i veçantë në sektorin e industrisë është zbulimi dhe shfrytëzimi i rezervave të brendshme, si dhe përdorimi e administrimi me nikoqirllëk i vlerave materiale e monetare, për të siguruar uljen e mëtejshme të kostos së prodhimeve.

Prodhimi i përgjithshëm bujqësor në vitin 1965 parashikohet të ketë një rritje prej 5 për qind, në krahasim me vitin 1964. Nga prodhimi i përgjithshëm bujqësor, prodhimi i bimëve të arave parashikohet të ketë një rritje prej 5,9 për qind, i fruti-vitikulturës 2 për qind, i blegtorisë 4,4 për qind dhe i pyjeve e bimëve mjekësore 6,6 për qind. Në prodhimin e bimëve të arave rëndësi më e madhe u është kushtuar drithërave të bukës, të cilat parashikohet të rriten 8,7 për qind më shumë se në vitin 1964. Mbi bazën e zhvillimit të prodhimit bujqësor është parashikuar që të rriten edhe grumbullimet e prodhimeve bujqësore e blegtorale.

Realizimi i planit të prodhimeve bujqësore e blegtorale përbën një nga detyrat më të mëdha për vitin 1965. Plotësimi i planit të prodhimit bujqësor është edhe kushti më i rëndësishëm për plotësimin e planit të ekonomisë popullore në tërësi. Në vitin 1964 ekonomisë sonë ju shkaktuan mjaft dëme nga mosplotësimi i planit në disa tregues të tij dhe sidomos për prodhimet bujqësore e blegtorale. Nga kjo del e qartë se plotësimi i planit të prodhimit bujqësor dhe të grumbullimeve është detyra më e madhe ku duhet përqëndruar vëmendja e të gjitha organeve të bujqësisë, të Partisë dhe të shtetit.

Problemet e bujqësisë vazhdimisht kanë tërhequr vëmendjen e Komitetit Qendror të Partisë dhe me kujdes të madh janë përcaktuar rrugët dhe masat për zhvillimin e bujqësisë. Prandaj, detyra themelore e Ministrisë së Bujqësisë dhe organeve të bujqësisë në radhë të parë si edhe e të gjitha organeve të Partisë dhe të shtetit, është përmirësimi i mëtejshëm i punës së tyre për të zbatuar si duhet masat e caktuara nga Partia dhe qeveria për të bërë punën e tyre më të organizuar dhe më të efektshme dhe për të mënjanuar të metat e dobësitë, që pengojnë në arritjen e përfundimeve më të mira. Komitetet e Partisë dhe organizatat bazë, krahas punës për edukimin e punonjësve, duhet të luftojnë për të ngritur ndjenjën e përgjegjësisë në kuadrot dhe specialistët e bujqësisë dhe puna e çdo kuadri dhe specialisti të bujqësisë të matet dhe të vlerësohet me rezultatet konkrete që arrihen në rritjen e prodhimeve bujqësore e blegtorale dhe me rritjen e vlerës së tyre nëpërmjet përmirësimit të cilësisë.

Detyra më e rëndësishme në fushën e bujqësisë është mobilizimi i të gjitha forcave dhe mjeteve për mbjelljet e pranverës në kohën e duhur dhe me cilësi të mirë. Në vjeshtën e vitit që shkoi, siç dihet, nuk u mboll e gjithë sipërfaqja e parashikuar dhe mbjelljet nuk u kryen në kushte të përshtatshme. Këto deficite duhet të plotësohen gjatë pranverës. Kjo e bën më të rëndë fushatën e mbjelljeve të pranverës.

Për zbatimin e kësaj detyre të madhe është e nevojshme që për çdo ekonomi të përcaktohet menjëherë sipërfaqja e tokës, që mbetet për t'u mbjellë, kulturat, që do të mbillen në përshtatje me detyrat e caktuara në plan, sigurimi i farërave, sigurimi dhe gatishmëria e të gjitha mjeteve të punës etj. Një kujdes i vecantë i duhet kushtuar punës përgatitore dhe gatishmërisë së SMT-ve. Masa të veçanta të merren për kullimin e çdo ngastre toke për të përfutur kohë dhe për të kryer mbjelljet në kushte optimale.

Plotësimi i detyrave të planit në bujqësi duhet të shikohet në radhë të parë me rritjen e pjesëmarrjes dhe mobilizimin më të madh në punë të fshatarësisë kooperativiste. Pjesëmarrja në punë e kooperativistëve dhe ditët e punës të kryera kanë ardhur duke u shtuar. Kështu, gjatë 9 muajve të vitit 1964 u kryen rreth 10 për qind më shumë ditë-punë në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar dhe pjesëmarrja në punë kundrejt të gjithë kraheve të punës arriti në 96 për qind. Megjithatë në këtë drejtim ka akoma rezerva të shumta. Mundësi për të rritur pjesëmarrjen në punë kanë të gjitha rrethet dhe kooperativat bujqësore, por duke shqyrtuar të dhënat sipas rretheve, del se në disa prej tyre rezervat janë akoma më të mëdha. Kështu p.sh. gjatë 9 muajve të vitit 1964 në rrethin e Durrësit u bënë mesatarisht nga çdo kooperativist 22 ditë-punë më pak se sa në rrethin e Fierit, që janë afërsisht në kushte të barabarta, në rrethin e Tiranës u bënë 39 ditë-punë më pak se në rrethin e Shkodrës, në rrethin e Vlorës 52 ditë-punë më pak se në atë të Sarandës dhe po kështu keq paraqiten në këtë drejtim rrethet Kukës, Dibër etj.

Ky problem, siç e ka theksuar vazhdimisht Partia, ka një rëndësi të veçantë dhe kërkon një punë të vazhdueshme bindëse për të edukuar punonjësit me qëndrimin socialist ndaj punës. Pjesëmarrja në punë e fshatarësisë, sidomos në zonat kodrinore e malore, duhet organizuar dhe ndjekur gjatë gjithë vitit. Në këtë mënyrë, përveç problemeve të fushatave të ndryshme, do të mund të realizohen më mirë edhe detyrat e tjera në bujqësi, si për sistemin e tokave, qilizmën, përmirësimin e kullotave, ndërtimin e vepërave ujitëse, hapjen e tokave të reja etj. Prandaj, mendojmë se ky është problemi ku duhet ndalur seriozisht nga organet e Partisë, të shtetit dhe sidomos nga organet e bujqësisë, në qendër dhe në bazë.

Për blegtorinë, një nga problemet më të rëndësishme është

përmirësimi, mirëmbajtja dhe administrimi i kullotave. Ky problem nuk po gjen zgjidhje dhe në këtë drejtim nuk po punohet mirë nga organet e bujqësisë. Pastrimi i kullotave vazhdon të bëhet i kufizuar dhe i përciptë, si nga ndërmarrjet bujqësore ashtu edhe nga kooperativat. Për plotësimin e detyrave, lidhur me përmirësimin e kullotave, gjendja është krejtësisht e pakënaqshme. Në kooperativat bujqësore është plotësuar vetëm 13 për qind e detyrës së caktuar. Problemi i kullotave sot vlerësohet aq pak sa Ministria e Bujqësisë dhe seksionet e bujqësisë në rrethe nuk dinë as gjendjen e saktë të tyre sipas sektorëve dhe kooperativave.

Përmirësimi, mirëmbajtja dhe administrimi i kullotave kërkon një punë të madhe dhe të vazhdueshme. Zhvillimi i blegtorisë në përgjithësi dhe në zonat kodrinore malore në mënyrë të veçantë, varet në një shkallë të madhe nga përmirësimi i kullotave. Këtu problemi duhet t'i dalin për zot një herë e mirë Ministria e Bujqësisë dhe organet e saj. Masat e përmirësimit, trajtimit dhe të administrimit të kullotave, të ngrihen në atë nivel, ashtu si veprohet për tokat e tjera nën kulturë. Ministria e Bujqësisë duhet të vendosë rregull dhe të marrë masa për zbatimin e detyrave të caktuara për këtë problem.

Për të përballuar nevojat e ekonomisë për lëvizjen e mallrave në planin e vitit 1965 është parashikuar që vëllimi i punës i transportit automobilistik të Ministrisë së Komunikacionit të rritet 11 për qind, i transportit hekurudhor 13 për qind dhe i transportit detar të jashtëm 9 për qind. Rritje parashikohet edhe në transportin e udhëtarëve.

Detyra kryesore për transportin është sigurimi në sasi dhe në kohë i transportimit të mallrave për t'ju përgjegjur nevojave të prodhimit, ndërtimit, furnizimit të popullit dhe eksportit. Lidhur me këto detyra, të vendoset një bashkëpunim më i ngushtë midis Ministrisë së Komunikacionit dhe dikastereve prodhuese, sidomos me Ministrinë e Minierave dhe të Gjeologjisë dhe Ministrinë e Industrisë. Ministria e Komunikacionit duhet të përmirësojë punën për ngritjen e gatishmërisë së automjeteve dhe për realizimin e planit për çdo automjet.

Plani i vitit 1965 parashikon që vëllimi i investimeve të rritet 5 për qind më shumë se në vitin 1964 dhe vëllimi i ndërtimeve 8 për qind më shumë. Në ndarjen e investimeve dhe ndërtimeve rëndësi e dorës së parë i është kushtuar ndërtimit të veprave të mëdha industriale, me qëllim që të shpejtohet në maksimumin e mundshëm përfundimi dhe vënja në shfrytëzim e tyre; gjithashtu fonde të rëndësishme janë parashikuar për bonifikimet dhe sidomos për ujtitjen.

Ndërtimi, montimi dhe marrja e masave të gjithanshme për vënjen në shfrytëzim të veprave të reja industriale është një nga detyrat e mëdha të planit të vitit 1965. Në këto vepra, parashiko-

hët të kryhen ndërtime industriale mbi 50 për qind më shumë se në vitin 1964. Ky vëllim ndërtimesh përbën një detyrë të rëndë për ndërmarrjet e ndërtimit. Përveç kësaj, këto vepra për fazën e punimeve, që hyjnë për vitin 1965, paraqitin probleme të vështira, si për ndërtimin, ashtu edhe për montimin e tyre. Gjatë këtij viti parashikohet të përfundojë ndërtimi dhe montimi për disa nga këto vepra siç janë, Uzina e metalurgjisë së zezë në Elbasan (reparti i petëzimit), Uzina e pjesëve të këmbimit për traktorë në Tiranë, Uzina e përpunimit dhe rafinimit të bakrit në Rubik, pjesa e parë e Kombinatit të tekstileve «Mao Ce Dun» në Berat, Fabrika e tullave silikate në Tiranë, Fabrika e tullave dhe tjegullave në Vorë, Fabrika e pllakave prej fibre në Shkodër, fabrikat e letrës në Kavajë dhe në Lushnjë etj.

Organet e Partisë dhe të shtetit duhet të vlerësojnë edhe më mirë ndërtimin e veprave të mëdha industriale; të marrin masat në mënyrë që të përballohen të gjitha vështirësitë dhe të arrihet me çdo kusht plotësimi i detyrave të caktuara. Në radhë të parë, për zbatimin e punimeve, detyra të rëndësishme ka Ministria e Ndërtimit, specialistët dhe gjithë punonjësit e saj, për organizimin më të mirë të punës dhe zbatimin pa lëshime të grafikëve të ndërtimit, duke i dhënë prioritet sigurimit në kohë të materialeve, fuqisë punëtore, specialistëve dhe kuadrove të tjerë të nevojshëm për ndërtim dhe montim. Në mënyrë të veçantë duhet të përqëndrohet vëmendja në zbatimin e punimeve për Uzinën e plehrave azotike në Fier, në TEC-in e Fierit dhe për Uzinën e plehrave fosfatike në Laç.

Ministria e Minierave dhe e Gjeologjisë dhe Ministria e Industrisë të ndjekin me kujdes punimet në objektet e reja industriale, duke i kushtuar vëmendje më të madhe plotësimit në kohë të të gjitha detyrimeve, që kanë lidhje me ndërtimin dhe montimin e tyre. Gjithashtu, të marrin të gjitha masat dhe të pregatiten me kohë për marrjen në dorëzim dhe vënjen në shfrytëzim si të veprave që përfundojnë në vitin 1965, ashtu edhe të atyre që do të përfundojnë më vonë. Kujdes sidomos i duhet kushtuar nga ana e tyre sigurimit dhe përgatitjes me kohë të punëtorëve të kualifikuar, të specialistëve dhe të kuadrove të tjerë të prodhimit.

Komitetet ekzekutive të këshillave popullore të rretheve të njohin nga afër dhe në mënyrë të vazhdueshme gjendjen e punimeve në këto vepra, t'u sigurojnë me kohë nevojat për fuqi punëtore dhe t'u ndihmojnë në mënyrë efektive për zgjidhjen e problemeve dhe kapërcimin e vështirësive, që atyre mund t'u paraqiten.

Mbi bazën e detyrave, që parashikohen për rritjen e prodhimit industrial dhe bujqësor, në planin e vitit 1965 është parashikuar të përmirësohen më tej furnizimi i popullit me mallra të përdorimit të gjerë dhe treguesit e tjerë të nivelit material e kultural të masave punonjëse. Të ardhurat kombëtare do të rriten 4 për

qind më shumë se në vitin 1964. Qarkullimi i mallrave të tregëtisë parashikohet të rritet 5,1 për qind dhe përmirësime do të ketë në furnizimin e gati të gjitha mallrave kryesore ushqimore dhe industriale. Parashikohen detyra për një zhvillim të mëtejshëm të arësimit, përgatitjes së kuadrove dhe në përmirësimin e shërbimit shëndetësor dhe të shërbimeve komunale.

Në drejtim të cilësisë së shërbimeve ka të meta të shumta, si në rrjetin e tregëtisë, sidomos në ushqimin social dhe hotelet, në shërbimet komunale, të artizanatit dhe të shëndetësisë dhe përmirësimet bëhen në mënyrë shumë të ngadalshme që nuk mund t'i përgjigjen zhvillimit të gjithanshëm të vendit tonë. Prandaj, është e nevojshme të përqëndrohet më shumë vëmendja e organeve përkatëse dhe e organizatave të Partisë për të përmirësuar në një mënyrë rrënjësore cilësinë e shërbimeve. Ministria e Tregëtisë, Ministria e Ekonomisë Komunale dhe organet e tjera qendrore, që kanë aktivitete shërbimi, duhet të kontrollojnë dhe të ndihmojnë konkretisht ndërmarrjet e sektorët e tyre vartës.

... Buxheti i shtetit për vitin 1965 është hartuar në përputhje me detyrat e planit për sektorët e ndryshëm të ekonomisë dhe të kulturës dhe shënon një rritje prej 4,7 për qind për të ardhurat dhe 5,2 për qind për shpenzimet.

Në kushtet tona, kur Partia shtron me forcë që të ndërtojmë socializmin duke u mbështetur kryesisht në forcat dhe burimet tona, plotësimi i detyrave kundrejt buxhetit të shtetit dhe zbatimi i një regjimi të fortë kursimi në përdorimin e vlerave materiale e monetare në të gjitha drejtimet merr një rëndësi akoma më të madhe.

Për këtë qëllim në radhë të parë, është e domosdoshme të tërhiqet vëmendja e të gjithë drejtuesve dhe personelit inxhinieroteknik për një punë më të thelluar dhe më me efekt në drejtim të uljes së shpenzimeve të prodhimit dhe të qarkullimit.

Në mënyrë të veçantë, një punë më e madhe duhet bërë në disa ndërmarrje dhe aktivitete që akoma vazhdojnë të planifikohen me humbje. Edhe për vitin 1965 janë planifikuar me humbje një numër ndërmarrjesh dhe aktivitetelesh... Të tilla janë p.sh. disa ndërmarrje të naftës, ndërmarrjet e tullave, shumica e ndërmarrjeve të qymyrgurit, aktiviteti i prodhimit të mishit të derrit në ndërmarrjet bujqësore shtetërore etj.

Detyrë e rëndësishme mbetet gjithnjë forcimi i regjimit të kursimit në sektorët social-kulturalë, duke mos lënë shteg për shpenzime të parakohshme e të tepërta dhe të forcohet puna për zbatimin e ligjshmërisë dhe të rregullave të caktuara në përdorimin e mjeteve materiale dhe monetare në sektorët social-kulturalë e në gjithë sektorët e tjerë joproduhues.

Shkurtimisht dhe në vija të përgjithshme këto janë detyrat që parashikon plani për zhvillimin e ekonomisë dhe të kulturës gjatë vitit 1965.

Viti 1965 është viti i fundit i planit të pesëvjeçarit të tretë. Byroja Politike e shikon të nevojshme të vejë në dijeni Plenumin e Komitetit Qendror mbi plotësimin e prishëm të detyrave që parashikonte plani i tretë pesëvjeçar për zhvillimin e ekonomisë dhe të kulturës, duke marrë për bazë realizimin e katër vjetëve dhe planin operativ të vitit 1965.

Siç dihet, plani i pesëvjeçarit të tretë u aprovua nga Kongresi IV i Partisë sonë në shkurt të vitit 1961. Por qeveria sovjetike, e udhëhequr nga grupi revizionist i Hrushovit dhe pasuesit e tyre në vendet e demokracisë popullore të Evropës, shkelën në mënyrë flagrante marrëveshjet e përfunduara me qeverinë tonë për kreditë që do të merrnim prej tyre për periudhën e planit të tretë pesëvjeçar. Në këtë mënyrë, vendi ynë u gjend përpara bllokadës ekonomike të dyfishtë imperialiste dhe revizioniste. Si rezultat i kësaj blokade, në fillim të realizimit të planit të tretë pesëvjeçar vendi ynë u ndodh në një situatë mjaft të vështirë ekonomike.

Megjithëse u muarën masa për të siguruar kredi nga Republika Popullore e Kinës, prapë se prapë dëmi që na shkaktuan revizionistët me prerjen e kredive që i madh, pasi ndërtimi i objekteve kryesore industriale në pesëvjeçarin e tretë filloi me shumë vonesë. Përveç kësaj, vendit tonë ju shkaktua një dëm i rëndësishëm edhe në bilancin e tregëtisë së jashtme për eksportin e një sërë mallrash.

Disa nga treguesit më kryesorë të planit të tretë pesëvjeçar, të aprovuar nga Kongresi IV, parashikohet të realizohen si vijon:

Prodhimi i përgjithshëm industrial në vitin 1965 parashikohet të jetë 36 për qind më shumë kundrejt vitit 1960 dhe për të pesë vjetët të marrë së bashku do të plotësohet 96 për qind.

Prodhimi i përgjithshëm bujqësor në vitin 1965 parashikohet të jetë 48 për qind më i madh kundrejt vitit 1960 dhe për të pesë vjetët të marrë së bashku do të plotësohet 84 për qind.

Vëllimi i investimeve si pesëvjeçar do të jetë 40 për qind më i madh se në pesëvjeçarin e dytë dhe vëllimi i ndërtimeve 66 për qind më shumë. Kundrejt detyrave që parashikonte pesëvjeçari i tretë investimet plotësohen 93 për qind, ndërsa ndërtimet 104 për qind.

Detyrat që parashikonte plani i tretë pesëvjeçar për zhvillimin e arsimit, kulturës, përgatitjes së kuadrit dhe mbrojtjes së shëndetit të popullit në përgjithësi janë plotësuar dhe tejkaluar.

Me organizimin e blokadës hrushoviane kundër vendit tonë, siç dihet, Komiteti Qendror i Partisë dhe qeveria kanë vendosur qysh pas vitit 1961, të mos bëhen gjatë pesëvjeçarit të tretë uljet e çmimeve dhe shtesat e pagave që parashikoheshin në planin e tretë pesëvjeçar. Në këtë mënyrë, paga reale e punonjësve në vitin

1965 do të jetë më e madhe se në vitin 1960 rreth 2,2 për qind dhe jo 30 për qind siç parashikohet në planin pesëvjeçar, kurse të ardhurat e fshatarësisë do të rriten 10 për qind dhe jo 35 për qind siç parashikohet në fillim.

Duke qenë të detyruar nga vështirësitë e mëdha objektive, gjatë hartimit dhe aprovimit të planeve operative vjetore, ne i kemi bërë disa ndryshime planit të tretë pesëvjeçar të aprovuar nga Kongresi IV i Partisë.

Ndryshimet që i janë bërë planit pesëvjeçar me planet vjetore kanë synuar që, krahas paksimit të planit për efekt të dëmeve dhe vështirësive të shkaktuara nga revizionistët, të sigurohet një mobilizim më i madh i rezervave të brendshme për rritjen e prodhimit dhe forcimin e regjimit të kursimit në të gjithë sektorët prodhues dhe joprodhues...

Treguesit më kryesorë të planit pesëvjeçar për të pesë vjetët të marrë së bashku, me ndryshimet që janë bërë në planet vjetore, parashikohet të realizohen afërsisht në këtë masë: plani i prodhimit të përgjithshëm industrial 101 për qind; plani i prodhimit të përgjithshëm bujqësor 90 për qind; plani i investimeve 100 për qind; i ndërtimeve 100 për qind; plani i qarkullimit të mallrave të tregëtisë me të holla në dorë plotësohet 100 për qind etj.

Duhet vënë në dukje se, në situatën e krijuar për vendin tonë, u desh që të merreshin masa të veçanta për të rritur rezervat shtetërore dhe për të forcur aftësinë mbojtëse të vendit...

Gjatë pesëvjeçarit të tretë arrihet zhvillimi i mëtejshëm i forcave prodhuese, duke u shënuar një hap i rëndësishëm përpara në ndërtimin e bazës materialo-teknike të socializmit në bazë të vendimeve të Kongresit IV të Partisë. Megjithëse në mjaft tregues nuk plotësohen detyrat që parashikonte plani pesëvjeçar, po të shohim rezultatet e arritura lidhur me vështirësitë që na u desh të kapërcejmë dhe me kohën e humbur, ato përbëjnë një fitore të madhe për Partinë dhe popullin tonë.

Arritja e këtyre përfundimeve në plotësimin e planit të tretë pesëvjeçar është e lidhur ngushtë me realizimin e planit të vitit 1965. Duke e parë çështjen në këtë mënyrë, realizimi i planit të vitit 1965 në të gjithë sektorët dhe në të gjithë treguesit e tij ka një rëndësi të veçantë. Plotësimi i planit të vitit 1965 ka një rëndësi të madhe si bazë e pikënisje për planin e pesëvjeçarit të ardhshëm.

Organizatata e Partisë dhe të gjitha organet shtetërore dhe të ekonomisë është e nevojshme të kuptojnë mirë rëndësinë e madhe ekonomike dhe politike, që ka për vendin tonë plotësimi i planit të vitit 1965. Në të njëjtën kohë duhet të luftohet për të gjetur mundësi dhe rezerva që të sigurohet tejkalimi i këtyre detyrave. Çdo tejkalim në planin e vitit 1965 do të sigurojë plotësimin më të mirë të detyrave, që parashikon plani pesëvjeçar. Me punën e gjith-

anshme të Partisë duhet të arrihet që detyra për të realizuar dhe tejkualuar planin e vitit 1965 të jetë parulla kryesore në luftën e përditshme që duhet të bëjnë të gjithë kolektivat punonjës gjatë këtij viti.

III

TË PËRMIRËSOJMË BILANCIN TONË TË TREGËTISË SË JASHTME NËPËRMJET RRRITJES SË MËTEJSHME TË EKSPORTIT DHE TË KURSIMIT E TË ZËVENDËSIMIT TË MALLRAVE TË IMPORTIT

Problemi i eksportit dhe i importit është ngritur vazhdimisht nga Partia dhe qeveria dhe janë vënë detyra për ta përmirësuar gjendjen në këtë drejtim. Por vështirësitë që kemi dhe të metat që vërtetohen akoma tregojnë se problemi nuk njihet dhe nuk kuptohet si duhet. Prandaj, po e shtrojmë edhe një herë këtë problem, me qëllim që organizatat e Partisë, organet shtetërore dhe Ministria e Tregëtisë të punojnë si duhet për zbatimin e detyrave dhe për një kuptim të drejtë dhe të thellë ekonomik dhe politik të bilancit të tregëtisë së jashtme nga të gjithë kuadrot e specialistët dhe gjithë punonjësit e sektorëve të ndryshëm.

Përmirësimi i gjendjes së bilancit të të ardhurave dhe shpenzimeve në valutë është një nga problemet më të rëndësishme të ekonomisë sonë. Treguesi më i mirë për një ekonomi të shëndoshë është barazimi i importit me eksportin dhe të ardhurat e tjera në valutë.

Me zhvillimin dhe forcimin e ekonomisë sonë popullore është rritur çdo vit eksporti dhe në krahasim me të kaluarën janë arritur mjaft përmirësime në bilancin tonë të tregëtisë së jashtme. Megjithkëtë ne kemi një gjendje të vështirë në bilancin e tregëtisë së jashtme, pasi ky mbështetet në një masë të ndjeshme në kreditë që marrim nga jashtë. Sipas planit të vitit 1965 eksporti ynë dhe burimet e tjera në valutë përballojnë vetëm 71 për qind të importit.

Këto të dhëna janë në bazë të planeve të shtetit të aprovuara për vjetët e fundit, por shpesh gjatë realizimit të planit vështirësitë në bilancin e tregëtisë së jashtme janë rritur nga deficitet, që janë krijuar në planin e eksportit dhe të nevojës për të importuar më shumë disa mallra kryesore, sidomos nga ato me origjinë bujqësore, kur nuk është realizuar plani i prodhimit të tyre në vend...

Një gjendje e tillë e bilancit të të ardhurave dhe shpenzimeve të valutës i sjell dëme serioze zhvillimit të planifikuar të ekonomisë; ajo na detyron të kufizojmë importin e mjaft pajisjeve komplete ose maqinerive të ndryshme, të parashikuara në planet perspektive për t'u sjellë me klering, për zhvillimin e forcave pro-

dhuese. Gjithashtu kufizohen mundësitë e importit për mallra të konsumit, që nuk prodhohen në vend, të nevojshme për rritjen e nivelit material e kultural të masave punonjëse etj.

Në këtë situatë shtrohet me forcë të madhe detyra për rritjen e mëtejshme të prodhimit industrial dhe bujqësor, duke u mbështetur kryesisht në forcat tona që të shtohet më shumë eksporti dhe të zëvendësohen artikujt e ndryshëm të importit.

... Lufta dhe përpjekjet për të plotësuar detyrat për eksportimin e mallrave dhe krahas kësaj gjetja e mundësive të reja për t'i tejkualuar këto detyra, të shikohen si çështje themelore dhe të përbëjnë kushtin kryesor në vlerësimin e punës për të gjitha organet shtetërore dhe të ekonomisë. Komitetet dhe organizatat e Partisë duhet të punojnë që secili të kuptojë mirë se çdo mosplotësim në detyrat, që parashikon plani dhe sidomos në ato që lidhen me eksportin ose importin, sjellin dëme serioze në ekonominë tonë dhe vështirësojnë ecjen e saj përpara.

Duke filluar që gjatë këtij viti dhe në të ardhshmen, të rritim më shumë sasinë e mallrave për eksport dhe të zgjerojmë nomenklaturën e tyre për të përmirësuar strukturën e eksportit tonë. Sot për sot, cigaret, duhani, minerali i kromit, minerali i hekurit, bitumet dhe nafta brut, zënë rreth 78 për qind të të gjithë eksportit. Ne duhet të luftojmë si në drejtim të rritjes së këtyre prodhimeve, ashtu edhe në drejtim të rritjes së mallrave të tjera që kërkohen më shumë në tregjet e jashtme. Nga Ministria e Tregëtisë dhe organet e ndryshme të prodhimit dhe të grumbullimit duhet të tregohet më shumë kujdes dhe iniciativë për të eksportuar edhe artikujt të ndryshëm që gjenden në vendin tonë dhe që edhe vende të tjera eksportojnë. Për këto nuk duhet pritur që çdo gjë të vihet në plan pa të eksportohet.

Një burim tjetër për shtimin e eksportit dhe përmirësimin e strukturës së tij është edhe përpunimi i disa prodhimeve, që ne i shesim si lëndë të para ose si gjysmë të përpunuara. Kjo punë ka një leverdi të madhe. Kështu për shembull nga përpunimi i bakrit dhe eksporti i telave të ndryshëm prej bakri do të përfitohet një sasi valute mbi dyfishin e asaj që merret nga eksporti i bakër-blisterit. Ne eksportojmë lëkurë të papunuara. Vitin që kaloi filluam që lëkurët e eksportit pjesërisht t'i përpunojmë, duke prodhuar për eksport pelice dhe doreza lëkure. Nga një përpunim i tillë rritet gati 2,5 herë vlera në valutë e lëkurëve që eksportohen.

Ky është një problem shumë i rëndësishëm se sigurojmë të ardhura më të mëdha dhe njëkohësisht sigurojmë zhvillimin e forcave prodhuese në vendin tonë. Ne duhet të zhvillojmë sa më shumë aktivitetet që kemi filluar në këtë drejtim, por edhe të studjohen mundësi të tjera për të përpunuar në vend lëndët e para. Edhe Ministria e Tregëtisë duhet të përmirësojë punën e saj për të gjetur treg shitje për disa artikujt të përpunuar në vend si qylyma

e sixhade, prodhime xunkthi, mobilje të përkulura, sapun nafte etj., për të cilat ka edhe mundësi për të rritur akoma më shumë prodhimin e tyre.

Një burim i rëndësishëm për të rritur të ardhurat nga eksporti është përmirësimi i cilësisë së mallrave për eksport dhe ngritja e vlerës së tyre. Gjatë vitit 1964 u tregua një kujdes më i madh për cilësinë dhe ambalazhimin e mallrave për eksport dhe në disa drejtime pati rezultate, si për shembull në eksportin e domateve dhe të rrushit. Po kështu treguesit e cilësisë së hekur-nikelit dhe të kromit ishin më të mirë se në vitin 1963. Megjithatë janë arritur disa përfundime, përmirësimi i cilësisë përbën një rezervë shumë të madhe për shtimin e të ardhurave nga eksporti.

Si rregull mallrat e eksportit kanë çmime, që ndryshojnë shumë sipas cilësisë së tyre. Veçanërisht mallrat tona kryesore të eksportit, siç janë mineralet e kromit, të hekur-nikelit, kanë çmime sipas cilësisë, në raport të drejtë me përmbajtjen e metaleve të dobishme në mineral. Kështu është edhe për cilësinë e naftës brut, për duhanin, cigaret etj. Prandaj, sa më e mirë të jetë cilësia ose sa më e lartë të jetë përmbajtja e mineralit të dobishëm, aq më shumë rriten çmimet e eksportit dhe në të kundërtën do të kemi ulje të tyre.

... Ministria e Minierave dhe e Gjeologjisë, ndërmarrjet e saja dhe organizatat e Partisë të merren si duhet me këtë problem, që në miniera të merren masa për seleksionimin e mineraleve dhe ruajtjen e cilësisë deri në Portin e Durrësit.

Një nga artikujt më kryesorë të eksportit tonë është duhani që eksportohet si duhan gjethe dhe cigare, në masën rreth 11 mijë ton në vit (për një prodhim normal). Për këtë artikull ne jemi shumë prapa me cilësinë: nuk grumbullojmë fare duhan të cilësisë së parë, shumë pak të cilësisë së dytë dhe vetëm rreth 25 për qind të cilësisë së tretë, pjesa tjetër grumbullohet e cilësive të ulëta. Në këta dy vjetët e fundit çmimi mesatar i grumbullimit i realizuar ka qenë rreth 20 për qind më i ulët nga sa ishte parashikuar nga qeveria, kur u caktuan çmimet sipas cilësive. . .

Dobësitë dhe të metat për cilësinë e duhanit janë në radhë të parë në kooperativat bujqësore, por të meta ka dhe në depot dhe uzinat e fermentimit të duhanit të Komitetit Shtetëror të Grumbullimeve. Është caktuar që një pjesë e duhanit të përpunohet «jarmapastall» në kooperativat bujqësore. Me përjashtim të rrethit të Pogradecit, që po e zbaton mjaft mirë këtë detyrë, rrethet e tjera nuk po e vlerësojnë si duhet. Në disa rrethe, si në Fier, Lushnjë, Lezhë dhe Përmet nuk është filluar fare nga zbatimimi i kësaj detyre.

Rritja e cilësisë së duhanit ngre peshë të madhe në të ardhurat e eksportit. Keqësimi i vazhdueshëm i cilësisë mund të rrezojë edhe tregjet e eksportit, duke na krijuar dëme të mëdha.

Prandaj, Ministria e Bujqësisë dhe Komiteti Shtetëror i Grumbullimeve duhet të merren seriozisht me këtë problem, duke vënë rregull që në fazën e mbjelljes së duhanit, në atë të vjeljes dhe të përpunimit bujqësor, në plotësimin e ndërtimit të bazës materiale sipas planit, në shkurtimin e kohës së dorëzimit të duhanit nga fshatarësia etj. Në këtë drejtim një punë më e madhe duhet bërë edhe nga organizatat e Partisë për mobilizimin dhe edukimin e punonjësve të bujqësisë për një kuptim më të drejtë të këtij problemi të rëndësishëm.

Si me duhanin, e njëjta gjendje është dhe me cilësinë e pambukut. Prodhimi i pambukut në vendin tonë ka ardhur duke u rritur, por në drejtim të cilësisë nuk janë bërë përmirësime. Për këtë arsye ne jemi të detyruar të eksportojmë pambuk të cilësive të ulëta dhe të importojmë pambuk të cilësisë së dytë; për të importuar 1 000 ton pambuk të tillë na duhet të eksportojmë mbi 2 000 ton pambuk të prodhimit tonë. Edhe për pambukun ka mundësi të shumta për të përmirësuar cilësinë, sidomos gjatë vjeljes së tij në fushë.

Përmirësimi i cilësisë së artikujve të eksportit lidhet shumë edhe me formën e paraqitjes, me ambalazhimin e mallrave, ku kemi shumë për të bërë, si dhe me kohën e shitjes së tyre. Për perimet e freskëta, frutat etj. që eksportojmë, përveç cilësisë një rëndësi të veçantë ka nxjerrja e tyre në treg sa më herët. Për shumë lloj perimesh e frutash, duke i nxjerrë herët në treg jo vetëm që sigurohet shitja e tyre, por realizohen dhe çmime shumë të larta.

Të gjitha këto fakte tregojnë se burimet për të rritur të ardhurat e bilancit të tregëtisë së jashtme janë të shumta dhe në shumë drejtime, por për realizimin e tyre duhen bërë përpjekje të vazhdueshme për të arritur nivelin e kërkesave të tregut ndërkombëtar.

Krahas punës që duhet bërë në drejtim të eksportit, për të përmirësuar bilancin e tregëtisë së jashtme, detyra të mëdha shtrohen për kursimin e mallrave kryesore të importit dhe për të shtuar prodhimin e tyre në vend, që të pakësohet importi.

Në bazë të planit të vitit 1965 zërat kryesorë të mallrave të importit janë: veprat e plota industriale që zënë 37 për qind të importit të përgjithshëm, drithërat e bukës, yndyrnat, sheqeri, orizi, mallra konsumi dhe lëndë e parë për prodhimin e tyre, që zënë 20 për qind, maqineri e pajisje të ndryshme 13 për qind dhe metale të zeza, goma automjetesh, materiale ndërtimi dhe mallra të tjera për nevoja të ekonomisë e kulturës që zënë 30 për qind.

Duke marrë parasysh natyrën e mallrave të ndryshme, që u përmendën më sipër, shkurtimi i importit mund të arrihet në dy drejtime. Për mallrat që nuk prodhohen në vend duhet luftuar në radhë të parë për përdorimin e tyre me nikoqirllëkun më të

madh dhe ku ka mundësi, për t'i zëvendësuar me prodhime vendi. Ky problem është i lidhur me të gjithë sektorët e ekonomisë, por ka disa sektorë që gati në të gjithë veprimtarinë e tyre kanë lidhje me mallrat e importit ose me mallra shumë të vlefshme që mund të eksportohen. Të tillë sektorë janë ndërmarrjet e naftës dhe të minierave, ato të transportit, të mekanikës bujqësore, të industrisë mekanike, një pjesë e ndërmarrjeve të industrisë, që prodhojnë kryesisht me lëndë të para e materiale importi dhe disa ndërmarrje të sektorëve të tjerë. Në këto ndërmarrje dhe sektorë të ekonomisë duhet punuar në mënyrë të veçantë për të kuptuar dhe zbatuar me ndërgjegje të lartë regjimin e fortë të kursimit për përdorimin e lëndëve të para dhe të materialeve.

Një grup mallrash, që importon vendi ynë, janë të natyrës që prodhohen në vend, por ky prodhim nuk plotëson të gjitha nevojat. Të tilla janë drithërat e bukës, yndyrnat, sheqeri, orizi, lëkurët e papunuara dhe prodhime të tjera me origjinë bujqësore. Për këto mallra, pa nënvleftësuar kujdesin për përdorimin e tyre me nikoqirllëk, vëmendja kryesore duhet përqëndruar në shtimin e prodhimit të tyre në vend. Kjo është një detyrë e përgjithshme e organeve të bujqësisë në radhë të parë dhe e gjithë organizatave të Partisë dhe organeve shtetërore. Duhet bërë mirë e qartë për të gjithë se çdo tejkalim i planit në këto prodhime pakëson importin në mënyrë të ndjeshme dhe në të kundërtën mosrealizimi i planit ndikon shumë në rritjen e importit. Me masat që u muarën në vitin 1964 për përdorimin me vend të drithërave të bukës, u arrit të kursehen në qytet rreth 12 400 ton drithëra buke, ndërsa në fshat janë shitur më shumë 4 700 ton.

Për kursimin e materialeve dhe sidomos të materialeve të importit, gjatë vjetëve të fundit ka filluar të bëhet një punë më e mirë, por me gjithë përfundimet e arritura mundësitë dhe rezervat e brendshme, që ka ekonomia jonë për përdorimin më me efekt të vlerave materiale, janë akoma mjaft të mëdha. Për këtë arsye Partia dhe qeveria edhe në planin e vitit 1965, kanë caktuar detyra të veçanta për kursimin e materialeve dhe lëndëve djegëse. Midis detyrave që parashikohen në planin e vitit 1965, në krahasim me vitin 1964, është caktuar të kursehen 5 për qind benzinë, 7 për qind gazoil dhe vajra lubrifikante, 5 për qind goma automjeteve etj. Detyrat për kursimin e materialeve është e nevojshme të bëhen mirë të qarta se, duke i mbledhur në shkallë republike, ato përfaqësojnë vlera të mëdha në valutë. . .

Kursimi sa më i madh i mjeteve materiale për t'i përdorur ato sa më racionalisht për plotësimin më të mirë të nevojave të masave punonjëse dhe për rritjen e forcave prodhuese përbën, pra, një detyrë të madhe dhe kërkon një punë të përhershme të organizuar dhe të drejtuar në mënyrë konkrete.

Për të siguruar një përdorim dhe administrim sa më të mirë të materialeve dhe pajisjeve të importit, një vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet përmirësimit të punës së planifikimit të nevojave për import në të gjitha instancat, që nga baza deri në qendër. Me gjithë eksperiencën e fituar dhe përmirësimet e arritura në planifikimin e importit, duhet theksuar se akoma nuk tregohet kujdesi që kërkon Partia në shqyrtimin e kërkesave nga importi.

Në radhë të parë, dikasteret e ndryshme vazhdojnë të paraqitin planet e importit mbi kufitë, që cakton qeveria, megjithëse titullarët e dikastereve e dinë se mundësi për të importuar mbi kufitë e caktuar nuk ka. Këto veprime çorientojnë punën dhe ndikojnë për keq në punonjësit e ministrive dhe të ndërmarrjeve. Paraqitja e kërkesave për import mbi kufitë e aprovuar është njëra anë e çështjes. Ana tjetër është se nga ministrinë dhe ndërmarrjet ka raste që përdoret pa vend valuta gjatë hartimit të planit, duke parashikuar disa mallra nga importi mbi nevojat e tyre, të parakohshme dhe me përmasa të papërshtatshme për qëllimet, që do të përdoren, duke lënë shpesh të paplotësuara disa nevoja më të domosdoshme. Kjo ndodh pasi në mjaft raste nuk njihen gjendja dhe nevojat reale të ndërmarrjeve vartëse dhe disa sektorë vepronë me pikëpamjen shumë të dëmshme «për të qenë brenda». Për shembull: Ministria e Bujqësisë, duke mos pasur një evidencim dhe administrim të saktë për pjesët e këmbimit, ka parashikuar dhe porositur pjesë këmbimi të panevojshme, duke krijuar gjendje shumë të mëdha. . .

Raste të tilla ndodhin edhe në dikastere e ndërmarrje të tjera, si në Ministrinë e Industrisë për pjesët e këmbimit të industrisë tekstile, në Ministrinë e Komunikacionit për pjesët e këmbimit të automjeteve etj. Siç shihet, në këtë drejtim duhet bërë një punë më e madhe për të ngritur ndjenjën e përgjegjësisë të kuadrove dhe specialistëve, si gjatë hartimit të planeve të importit, ashtu edhe në përdorimin dhe administrimin e vlerave materiale.

Byroja Politike, gjatë shqyrtimit dhe aprovimit të planit të vitit 1965, u ndal shumë në mënyrë të veçantë në bilancin e të ardhurave dhe shpenzimeve në valutë, balancimi i të cilit paraqitej me vështirësi. Byroja Politike vërejti se që nga ndërmarrjet dhe deri te ministrinë planet paraqiten me kërkesa të tepërta. Ky është rrjedhim i një pune të pamjaftueshme, që bëhet nga ana e tyre në njohjen dhe mobilizimin e rezervave dhe mundësive që ekzistojnë, është rrjedhim i moskuptimit akoma si duhet i detyrave të caktuara nga ana e Partisë për të përdorur me kursim vlerat materiale dhe monetare. Megjithëse kundrejt kërkesave u bënë shkurtime të mëdha, janë të gjitha mundësitë për të shtuar prodhimet sidomos për artikujt, që rritin eksportin dhe zëvendësojnë importin dhe të bëhen kursime të tjera në materialet e ndryshme.

Pikërisht, duke u nisur nga ky fakt me porosi të Byrosë Politike, siç jeni në dijeni, tani po zhvillohet një fushatë për këtë qëllim. Mbi bazën e rezultateve, që do të arrihen nga kjo fushatë, do të përcaktohen detyra më të hollësishme për rritjen e prodhimit, duke shfrytëzuar më mirë rezervat e brendshme për kursimin e materialeve, të fuqisë punëtore dhe për uljen e shpenzimeve të prodhimit dhe të shërbimeve. Në këtë mënyrë do të gjenden burime të tjera për të përmirësuar bilancin tonë të tregëtisë së jashtme.

Kryesia e Këshillit të Ministrave ka organizuar një studim të veçantë për rritjen e mëtejshme të eksportit dhe për rritjen e cilësisë së prodhimeve për eksport. Rëndësi ka tani marrja e masave, që sigurojnë zbatimin e detyrave që do të shtrohen, me qëllim që kjo detyrë e madhe për të përmirësuar bilancin e tregëtisë sonë të jashtme të merret si duhet në dorë nga organet shtetërore dhe të Partisë në bazë dhe në qendër.

Në të ardhshmen, sidomos tani që jemi duke përpunuar projektplanin e pesëvjeçarit të katërt, Komisioni i Planit të Shtetit duhet të studjojë me kujdes rrugët dhe mundësitë për të përmirësuar bilancin e tregëtisë sonë të jashtme dhe gradualisht të shkohet drejt barazimit të të ardhurave dhe shpenzimeve në valutë, kryesisht me forcat tona. Arritjes së këtij qëllimi duhet t'i nënshtrohen edhe treguesit e tjerë, që kanë lidhje me këtë problem.

Për të arritur një përmirësim të dukshëm në drejtim të rritjes së eksportit dhe të kursimit e përdorimit sa më me efekt të të gjitha mallrave e pajisjeve të importit, është e domosdoshme që ky problem i madh të kuptohet nga të gjitha ministratë, nga organet e Partisë dhe të shtetit, ndërmarrjet e ndryshme dhe gjithë punonjësit. Gjatë hartimit të planit dhe gjatë zbatimit të tij, organet shtetërore dhe të ekonomisë, në qendër dhe në bazë, të vlerësojnë dhe të zgjidhin me precedencë çdo problem, që lidhet me shtimin e eksportit dhe kufizimin e importit.

IV

ËSHTË E DOMOSDOSHME QË NË PËRSHTATJE ME KUSHTET E KRIJUARA ME KËRKESAT E KOHËS DHE POLITIKËN EKONOMIKE TË PARTISË, TË DREJTOHET MË MIRË DHE NË MËNYRË MË TË KUALIFIKUAR EKONOMIA JONË POPULLORE

Për të arritur objektivat që ka caktuar Partia në fushën ekonomike për ndërtimin socialist të vendit, për realizimin e planit të vitit 1965 dhe për të arritur përfundime sa më të mira në plotësimin në tërësi të planit të tretë pesëvjeçar, është e nevojshme të përmirësojmë më tej drejtimin e ekonomisë dhe të kombi-

nojmë më drejt punën politike dhe ekonomike për mobilizimin e punonjësve në plotësimin e detyrave. Në këtë drejtim duhet bërë një punë e përgjithshme për përmirësimin e metodës së drejtimit dhe stilit në punë, për të zhvilluar më tej iniciativën dhe shkathësinë e organeve të Partisë, të shtetit dhe të ekonomisë në zgjidhjen e detyrave ekonomike.

Lidhur me këto probleme Byroja Politike e sheh të nevojshme që të tërheqë vëmendjen në këto çështje kryesore.

1. — Në drejtimin e ekonomisë të udhëhiqemi kurdoherë nga momenti politik, nga teza e njohur leniniste e lidhjes organike reciproke e të përhershme midis politikës dhe ekonomisë

Siç dihet, ne vazhdojmë të ndërtojmë socializmin në kushte të vështira të rrethimit imperialist dhe revizionist. Në këtë situatë Partia jonë shtron edhe një herë si detyrë të parë njohjen dhe zbatimin deri në fund të tezës leniniste mbi prioritetin e politikës ndaj ekonomisë.

V. I. Lenini, që në fillim të periudhës së ndërtimit socialist në Bashkimin Sovjetik, ka theksuar se «Politika nuk mund të mos ketë epërsinë mbi ekonominë. Të mendosh ndryshe do të thotë të harrosh abecënë e marksizmit»¹. Natyrisht, teza e Leninit mbi epërsinë e politikës ndaj ekonomisë nuk e mohon aspak rolin vendimtar të ekonomisë në zhvillimin e shoqërisë, faktin që politika është shprehje e koncentruar e ekonomisë.

Partia në kushtet konkrete të ndërtimit socialist të vendit tonë, ka tërhequr gjithmonë vëmendjen mbi epërsinë që ka politika ndaj ekonomisë. Kjo do të thotë që kuadrot drejtues të Partisë, të organeve shtetërore e të ekonomisë, gjithë Partia, duhet të mbajnë kurdoherë parasysh që tërë zhvillimi i ekonomisë te ne u nënshtrohet detyrave politike të transformimit të mëtejshëm socialist të vendit, që masat ekonomike të Partisë e të pushtetit popullor të bëjnë efekt politik pozitiv, të shërbejnë për të mbajtur lart në punonjësit frymën revolucionare, për të forcuar aleancën e klasës punëtore me fshatarësinë, për luftën kundër shfaqjeve të huaja, që çështjet ekonomike duhen parë jo në kuadrin e ngushtë lokal apo dikasterial, por në interesin e përgjithshëm shtetëror. Kjo do të thotë gjithashtu që Partia, kuadrot drejtues të shtetit e të ekonomisë, gjithë punonjësit, nuk duhet të harrojnë për asnjë moment kushtet e vështira në të cilat ndërtohet socializmi në atdheun tonë, luftën kundër imperializmit dhe revizionizmit modern dhe në përputhje me këto të zgjidhin problemet e ekonomisë dhe të mobilizohen për zhvillimin e saj.

¹ Shih: V. I. Lenin. Veprat, vëll. 32, f. 81

Në punën e gjithanshme ideo-politike, që ka zhvilluar Partia është ngritur në një shkallë më të lartë ndërgjegjja e njerëzve dhe ka një kuptim më të gjerë të prioritetit të politikës mbi ekonominë. Por nuk do të ishte e drejtë që t'i lejonim vetes kënaqësi të tepruar në këtë drejtim dhe të mos vëmë në dukje të metat që vihen re akoma në punën tonë, në hartimin dhe plotësimin e detyrave ekonomike.

Byroja Politike gjatë shqyrtimit të planit të vitit 1965, si u theksua në këtë raport, vuri re se mjaft drejtues të ekonomisë, duke mos u udhëhequr si duhet nga momenti politik dhe duke mos pasur mirë parasysh kushtet, që kalon vendi ynë, paraqitin propozime dhe kërkesa të pastudjuara dhe nën mundësitë e tyre reale. Gjithashtu fakti që ka akoma degë, ndërmarrje, sektorë dhe reparte që prej kohësh nuk plotësojnë si duhet detyrat e planit, tregon se ndërgjegjja e punonjësve në këta sektorë nuk është akoma në lartësinë e duhur dhe se puna e organizatave të Partisë, e organeve shtetërore dhe e drejtuesve atje nuk u përgjigjet akoma detyrave që shtrohen. Për përmirësimin e punës sonë në këtë drejtim na dalin këto detyra kryesore:

Së pari, të forcohet puna ideo-politike e Partisë në mënyrë që të gjithë punonjësit të kuptojnë drejt momentin politik, kushtet në të cilat po zhvillohet ekonomia jonë dhe detyrat, që shtrohen në përshtatje me to.

Eksperiencia e këtyre vjetëve të fundit ka provuar se mbajtja gjallë e frymës luftarake, sqarimi i vazhdueshëm politik i masave i kanë shërbyer plotësimin të detyrave ekonomike.

Organizatave të Partisë e të masave dhe organet e pushtetit kanë rritur ndërgjegjen e masave punonjëse për luftën e madhe, që po bën Partia jonë kundër imperializmit dhe revizionizmit. Natyrisht, kjo është çështja më e rëndësishme në punën e Partisë. Por krahas kësaj duhet që lufta për ngritjen politike të masave punonjëse, të shoqërohet me luftën për mobilizimin e tyre në arritjen e rezultateve edhe në fushën ekonomike. Në këtë mënyrë do të çohet deri në fund zbatimi i vijës së përgjithshme të Partisë.

Për vitin 1965 organizatat e Partisë duhet të ngjallin akoma më shumë në masat punonjëse bindjen për plotësimin dhe tejkalimin e detyrave të planit dhe të sigurojnë mobilizimin e tyre për një punë të vazhdueshme gjatë gjithë vitit, që të punohet njëllë me ndërgjegje dhe disiplinë, si ditën dhe natën, pa marrë parasysh kohën dhe vështirësitë, në mënyrë që po dhamë fjalën, të fillojmë nga puna dhe, po filluam nga puna, ta shpiem atë deri në fund.

Së dyti, të ngrihen në një nivel më të lartë figura e roli politik i drejtuesit të ekonomisë dhe aftësitë e tija profesionale. Zbatimi i detyrave kërkon ndër të tjera si ngritjen e mëtejshme të

metodës së drejtimit nga organet shtetërore dhe të Partisë, ashtu edhe ngritjen e figurës e të rolit politik të drejtuesve të ekonomisë dhe të aftësisë së tyre profesionale.

Sukseset në fushën e prodhimit varen në një shkallë të madhe nga niveli i drejtimit. Por për të drejtuar duhet të jesh i aftë, të njohësh plotësisht kushtet e prodhimit, të njohësh teknikën e prodhimit dhe të kesh arësimin e duhur shkencor. Përgatitja dhe kualifikimi i drejtuesve të ekonomisë ka tërhequr vazhdimisht vëmendjen e Partisë. Sot niveli i tyre ka ecur përpara dhe ka ndryshuar rrënjësisht nga e kaluara, por nuk duhet të jemi të kënaqur me rezultatet e arritura, veçanërisht po të marrim parasysh detyrat e mëdha që dalin përpara.

Me gjithë punën e madhe që është bërë një pjesë e drejtuesve të ekonomisë kanë akoma nivelin arësor të pamjaftueshëm...

Në ndërmarrjet dhe organizatat ekonomike kemi sot edhe mjaft specialistë me arësim të lartë dhe të mesëm, por me një gjendje të tillë të nivelit arësor të drejtorëve, nëndrejtorëve dhe kryetarëve të kooperativave, aftësitë drejtuese janë të kufizuara, me gjithë eksperiencën e tyre të madhe të fituar në luftën e përditshme të ndërtimit socialist të vendit. Me këtë shpjegohet fakti që mjaft drejtues të ndërmarrjeve dhe organizatave ekonomike nuk janë marrë si duhet me problemet kyçe të organizimit të prodhimit, të veprimtarisë ekonomike financiare, të përdorimit me nikoqirllëk dhe mbi baza shkencore të lëndëve të para dhe materialeve etj.

Për këtë arsye ngritja arësimore dhe tekniko-profesionale e drejtuesve të ekonomisë, sikurse e ka theksuar më se një herë Partia, mbetet një nga detyrat më të rëndësishme me të cilat lidhen sukseset tona të mëtejshme në rrugën e ndërtimit socialist të vendit.

Natyrisht, aftësimi i pareshtur arësor e profesional i kuadrove drejtues të ekonomisë është njëra anë, ana tjetër, jo më pak e rëndësishme, është edhe ngritja e figurës së tyre si punonjës politikë. Në kushtet e socializmit ku mjetet e prodhimit janë pronë e përbashkët e popullit dhe punonjësit marrin pjesë aktive dhe të drejtëpërdrejtë në zbatimin e direktivave të Partisë dhe të politikës së saj ekonomike, nuk është e mjaftueshme që drejtuesit e ndërmarrjeve, organizatave ekonomike dhe kooperativave bujqësore ta kufizojnë veprimtarinë e tyre vetëm në kuadrin e zbatimit të detyrave të planit në rrugë thjesht administrative. Duhet kuptuar drejt se drejtuesit e ekonomisë janë njerëz politikë, të cilëve shteti dhe Partia u kanë besuar jo vetëm mbarëvajtjen e prodhimit, por edhe edukimin e kolektivit punonjës. Ne kemi tani shumë kadro drejtues dhe specialistë të ndryshëm, me të cilët duhet bërë një punë e madhe për t'i njohur thellë me problemet, që shtrun Partia, për t'u çelur perspektivën, për të zhvilluar te ata iniciativën

dhe vetëveprimin në punë që të mos merren vetëm me çështjet e thjeshta dhe të ambjentohen me rutinën, por të parandajjnë vështirësitë dhe të marrin masa me kohë për kapërcimin e tyre.

Aktivizimi i këtyre kuadrove të ndërmarrjeve dhe të organeve qendrore për punën sqaruese me masat do të ndikojë për një kuptim më të thellë të politikës së vendimeve të Partisë dhe të detyrave, që shtrihen para punonjësve në periudha të caktuara. Eksperienca ka treguar se në ato raste, kur drejtuesit e ekonomisë marrin pjesë direkt në jetën politike dhe ekonomike të qendrës së punës, problemet zgjidhen mirë, masat punonjëse i kuptojnë më drejt detyrat që shtron Partia dhe mobilizimi i tyre është më i madh. Ne kemi shembuj të shumtë kur kombinimi i masave organizativo-teknike me ato të edukimit të punonjësve ka siguruar jo vetëm suksese në plotësimin e detyrave, por dhe qëndrueshmërinë e tyre. I tillë është rasti në Kombinatin e tekstileve «Stalin», i Ndërmarrjes së prodhimit të naftës Patos, i ndërmarrjeve bujqësore në Maliq dhe Kamëz, i kooperativës bujqësore Sarava e dytë në Lushnjë etj.

Megjithatë ka kuadro që drejtimin e çështjeve ekonomike nuk e gërshetojnë me problemet e edukimit të punonjësve dhe si rrjedhim në sektorët ku ata drejtojnë shfaqen dobësi dhe të meta të përsëritura. Prandaj, komitetet e Partisë, si ai i Kukësit për Minierën e bakrit në Gjegjan, ai i Librazhdit, Elbasanit e Pogradecit për sektorin e sharrave, i Sarandës për bonifikimin, i Krugës për transportin, i rrethit të Tiranës për Ndërmarrjen bujqësore «Gjergj Dimitrov», si dhe dikasteret përkatëse, duhej që prapambetjen në plotësimin e detyrave të planit ta shikonin edhe në punën që bënin drejtuesit për trajtimin, edukimin e punonjësve dhe për shpjegimin e masave, që merrte Partia dhe qeveria. Raste të tilla ka edhe në disa ndërmarrje të qytetit të Tiranës, rrethit të Durrësit, Shkodrës etj.

Tani më tepër se kurrë duhet të kuptohet se drejtuesit e ekonomisë dhe të shtetit nuk janë vetëm organizatorë të thjeshtë të prodhimit, por edhe njerëz politikë, përcuesit e parë të vijës së Partisë në masa, sepse të marrësh vendime e të nxjerrësh urdhëra dhe të mos punosh për t'ua bërë të qarta masave punonjëse, do të thotë të vësh shenjën e barazimit midis detyrimit e bindjes, t'ua imponosh ato masave punonjëse, metodë kjo në kundërshtim me vijën e Partisë dhe si rrjedhim e papranueshme për metodën tonë të drejtimit. Është e domosdoshme të mbahet mirë parasysh porosia e Partisë se objektivat dhe programi i saj do të shndërrohen në një forcë të madhe lëvizëse, vetëm atëherë kur ato do të futen thellë në ndërgjegjen e njerëzve dhe do t'i mobilizojnë ata për vënjen e tyre në jetë.

2. — Të ngremë në një nivel më të lartë punën në drejtim të planifikimit për të forcuar akoma më shumë partishmërinë, karakterin direktiv dhe popullor të tij

Zhvillimi i planifikuar i ekonomisë dhe kulturës është një nga epërsitë kryesore të sistemit tonë socialist. Duke u bazuar në njohjen dhe përdorimin e drejtë të ligjeve ekonomike objektive të socializmit, Partia dhe qeveria jonë kanë përcaktuar në mënyrë të planifikuar drejtimet kryesore të zhvillimit ekonomik të vendit. Në përgjithësi, në planet tona janë pasqyruar detyrat që dalin nga programi i Partisë, janë përputhur detyrat e planit me politikën ekonomike të saj, gjë që ka shprehur parimin më të rëndësishëm të planifikimit, parimin e partishmërisë. Krahas kësaj është luftuar për rritjen e nivelit shkencor të planifikimit dhe pjesëmarrjes sa më të gjerë të masave.

Por niveli i arritur në zhvillimin e ekonomisë sonë, si dhe detyrat, që paraqiten për zhvillimin e saj në të ardhshmen, duke vlerësuar si duhet dhe kushtet në të cilat ne ndërtojmë socializmin, e bëjnë të domosdoshme që të përmirësojmë më tej punën e planifikimit. Për këtë qëllim të përqëndrohet vëmendja kryesisht në këto probleme:

a) Të punojmë më shumë dhe më me këmbëngulje për të vënë në jetë orientimin e Partisë që në ndërtimin socialist të mbështetemi në radhë të parë në forcat tona. Ky ka qenë një qëndrim kurdoherë i drejtë dhe revolucionar i Partisë, që buron nga teza marksiste-leniniste mbi rolin vendimtar të faktorit të brendshëm në revolucion e në ndërtimin socialist, por në kushtet e tanishme merr një rëndësi të veçantë.

Tani ne kemi bërë një hap të madh në zhvillimin e forcave prodhuese dhe kemi krijuar një bazë relativisht të fuqishme materialo-prodhuese në të gjitha degët e ekonomisë popullore, është krijuar një ushtri e tërë punëtorësh dhe kuadros të kualifikuar, është forcuar më tej uniteti i popullit rreth Partisë dhe aleanca e klasës punëtore me fshatarësinë. Këto edhe faktorë të tjerë të fuqishëm bëjnë të mundur që tani të shtrohet praktikisht çështja që, në procesin e mëtejshëm të ndërtimit tonë socialist, ekonomia jonë të mbështetet gjithnjë më shumë në këmbët e veta.

Çështja e ndërtimit të socializmit, duke u mbështetur kryesisht në forcat dhe mundësitë tona të brendshme, ka dy aspekte kryesore: atë politik dhe atë ekonomik.

Nga pikëpamja politike kjo kërkon një punë të madhe sqaruese edukative nga Partia, organizatat shoqërore dhe organet e ndryshme shtetërore për të ngjallur e forcuar pareshtur në masat e gjera punonjëse besimin e patundur se ne jemi në gjendje të çojmë përpara me duart tona, duke u mbështetur kryesisht në forcat tona, ekonominë socialiste, të ndërtojmë plotësisht socializ-

min në atdheun tonë, si dhe për të luftuar çdo tendencë e shfaqje të nënvleftësimit të forcave e mundësive të popullit tonë, të përuljes para çdo gjëje të huaj.

Nga pikëpamja ekonomike kjo kërkon mobilizimin sa më të plotë të të gjitha burimeve, rezervave e mundësive materiale e njerëzore të ekonomisë sonë socialiste.

Duke e parë çështjen nga kjo pikëpamje, duhet thënë se, me gjithë punën e madhe që është bërë, ka akoma rezerva e mundësi të pashfrytëzuara. Në hartimin e planeve organet shtetërore dhe të ekonomisë nuk mbajnë mirë parasysh momentin politik, nuk i lidhin si duhet detyrat ekonomike me kushtet konkrete të vendit, nuk pasqyrohen plotësisht mundësitë që ka çdo sektor dhe çdo ndërmarrje për rritjen e prodhimit. Problem mbetet në mjaft degë e ndërmarrje shfrytëzimi sa më i mirë i aftësive prodhuese, arritja e një kufiri maksimal të mundshëm për të kaluar në punën me dy e tri ndërresa, për ngritjen e rendimentit orar të punës dhe të përdorimit të maqinerisë etj.

Gjatë 9-mujorit të vitit të kaluar në ndërmarrjet e Ministrisë së Industrisë janë përdorur vetëm 86,5 për qind të maqinerive në inventar, në ato të Minierave dhe të Gjeologjisë 77,9 për qind, në ato të Ndërtimit 63,3 për qind etj. Rezerva ka gjithashtu edhe në plotësimin e planit të transportit për çdo automjet. Në 10 muajt e vitit të kaluar 43 për qind e automjeteve të Ministrisë së Komunikacionit nuk plotësuan planin. Po kështu në SMT-të 34 për qind e traktorëve nuk plotësuan planin dhe në NBSH-të 39 për qind. Këto fakte tregojnë se ka mundësi për të rritur prodhimin dhe shërbimet pa importuar maqineri të reja. Mundësi të brendshme ka sidomos në përdorimin me nikoqirllëk të lëndëve të para dhe materjaleve të ndryshme, një pjesë e të cilave sigurohen me vështirësi nga importi.

Një drejtim tjetër i madh dhe i vazhdueshëm për shfrytëzimin e rezervave të brendshme të ekonomisë është rritja e rendimentit të punës dhe shfrytëzimi më i mirë i kohës së punës në të gjithë sektorët. Kohët e fundit është bërë një punë e madhe në këtë drejtim. Megjithkëtë ne kemi akoma të meta në fushën e organizimit socialist të punës. Një rëndësi të veçantë ka, siç u përmend më lart, edhe pjesëmarrja në punë e fshatarësisë kooperativiste dhe shfrytëzimi më i mirë i kohës së punës në sektorin e bujqësisë.

Këto janë disa nga mundësitë, shfrytëzimi i të cilave do të fuqizonte më tej ekonominë. Prodhimi industrial për vitin 1965 është parashikuar të rritet 4,7 për qind; nga kjo 96 për qind e rritjes mbështetet në aftësitë ekzistuese, ndërsa 31 për qind nga objektet e reja. Megjithatë me një punë më të kujdesshme nga organet ekonomike dhe organizatat e Partisë në bazë, me një gatishmëri dhe kuptim më të drejtë nga dikasteret dhe me një punë më këmbëngulëse nga Komisioni i Planit të Shtetit, mund

të planifikohej një rritje më e madhe e prodhimit industrial, pa kërkuar lëndë të parë nga importi dhe për ato prodhime, që i nevojiten popullit dhe ekonomisë.

Është e nevojshme që parimin e rëndësishëm të mbështetjes kryesisht në forcat tona për ndërtimin socialist të vendit, ta kuptojnë dhe ta zbatojnë të gjithë kuadrot dhe punonjësit tanë, si gjatë hartimit të planeve, ashtu edhe gjatë zbatimit të tyre. Në këtë mënyrë ky orientim i Partisë do të realizohet me sukses.

b) Të luftohen si të dëmshme, antisocialiste dhe antishtetërore tendencat për të hartuar plane me kërkesa të fryra dhe «për të qenë brenda» për prodhimin dhe aktivitetet e tjera, në të gjitha sferat e jetës sonë ekonomike. Partia ka theksuar vazhdimisht që planet të jenë mobilizuese dhe të pasqyrojnë realitetin objektiv për zhvillimin e ekonomisë popullore. Hartimi i planeve të zhvillimit të ekonomisë duhet të bëhet me ndjenjën e përgjegjësisë së lartë ndaj interesave të shtetit dhe të popullit.

Vjetët e fundit është rritur niveli i planifikimit, gjë që ka shërbyer si një levë e fuqishme në zbulimin dhe mobilizimin e rezervave të shumta që fshihen në gjirin e ekonomisë. Mirëpo kjo është akoma e pamjaftueshme, sidomos po të marrim parasysh faktin se planifikimi nuk është vetëm punë e organeve të planifikimit, por një detyrë e madhe e të gjitha organeve shtetërore, detyrë e cila buron nga vetë karakteri dhe funksionet e shtetit socialist.

Ka mjaft raste që ndërmarrjet, organizatat ekonomike, komitetet ekzekutive dhe ministritë, hartojnë dhe paraqitin plane me rezerva, nuk parashikojnë të gjitha mundësitë për rritjen e prodhimit dhe bëjnë kërkesa të fryra për materiale, fuqi punëtore, investime etj.

Gjatë shqyrtimit të projektplaneve të vitit 1965 që u paraqitën nga ministritë dhe komitetet ekzekutive në Komisionin e Planit të Shtetit, u bënë shkurtime të shumta në kërkesat për materiale, fuqi punëtore, investime etj. dhe u rritën detyrat e prodhimit dhe të aktiviteteve të tjera. Megjithkëtë punë të madhe të Komisionit të Planit të Shtetit dhe të Kryesisë së Këshillit të Ministrave, Byroja Politike vërejti se ka akoma mundësi për ta përmirësuar planin e vitit 1965 dhe ngarkoi Kryesinë e Këshillit të Ministrave që të paraqitë brenda tremujorit të parë mundësitë e përmirësimit të mëtejshëm të disa treguesve kryesorë të planit.

... Për të mënjeluar të metat, është e domosdoshme që t'i përmbahemi me çdo kusht parimit të partishmërisë në të gjithë punën e planifikimit. Gjithashtu organet qendrore dhe Komisioni i Planit të Shtetit duhet të bëjnë një punë më të organizuar dhe më të efektshme në drejtim të bazës, duke e parë këtë si një domosdoshmëri për njohjen më të mirë të problemeve dhe për t'u dalë përpara të metave dhe tendencave të dëmshme, që vihen re

gjatë hartimit të planeve në bazë. Një rëndësi të madhe ka veçanërisht ngritja e nivelit dhe e përgjegjësisë së planifikimit në bazë dhe deri në ministritë. Puna ideo-politike, që të gjithë punonjësit të kuptojnë drejt momentin politik dhe kushtet në të cilat po zhvillohet ekonomia, duhet t'i shërbejë forcimit të ndërgjegjes së specialistëve e kuadrove për një planifikim sa më të drejtë e real në përputhje me mundësitë dhe kushtet tona. Në mënyrë të veçantë duhet treguar kujdes gjatë këtij viti që do të punohet për hartimin e planit të pesëvjeçarit të katërt 1966—1970.

c) Të rritet roli i organeve të Partisë dhe të pushtetit lokal për një pjesëmarrje më efektive në planifikimin dhe drejtimin e ekonomisë.

Komitetet e Partisë të rretheve merren me drejtimin e problemeve ekonomike dhe me organizimin e punës në ndërmarrje, kryesisht nëpërmjet organizatave bazë, ndërsa organet e pushtetit lokal merren si me problemet e planifikimit, ashtu edhe me përcaktimin e masave organizative për zbatimin e planeve ekonomike, kryesisht në ndërmarrjet dhe organizatat lokale dhe shumë pak në ndërmarrjet kombëtare.

Në periudhën e tanishme një metodë e tillë pune është e pamjaftueshme dhe nuk u përgjigjet detyrave që shtron Partia në drejtim të ngritjes së rolit të organeve të Partisë e të pushtetit me tërësinë e veprimtarisë ekonomike në shkallë rrethi. Kjo kërkon që komitetet e Partisë në rrethe, pa zvogëluar rolin e tyre në drejtim të ndjekjes së zbatimit të planeve, të përqëndrojnë një vëmendje më të madhe në planifikimin e treguesve kryesorë të ndërmarrjeve. Njëkohësisht edhe organet e pushtetit lokal duhet të shtrijnë veprimtarinë e tyre dhe në disa drejtime të ndërmarrjeve nacionale, sidomos për të ndihmuar në planifikimin e tyre. Kjo është një punë, që duhet filluar të bëhet më shumë dhe më mirë, sidomos tani me kalimin e disa ndërmarrjeve kombëtare në vartësi të komiteteve ekzekutive të rretheve dhe forcimin e aparatit të tyre.

Hartimi i planeve me kujdes dhe me përmbytje në nivelin e duhur, në përputhje me detyrat, që shtron Partia, kërkon jo vetëm punën e kujdesshme të vetë ndërmarrjeve, por edhe ndihmën e gjithanshme dhe të drejtëpërdrejtë të komiteteve të Partisë dhe të pushtetit lokal. Një punë e tillë do t'i vinte këto organe më në gjendje të jetonin nga afër me zhvillimin e sektorëve të ndryshëm dhe t'u delnin përpara problemeve të ndryshme. Është e kuptueshme që këto organe për ndërmarrjet kombëtare duhet të merren me disa tregues më kryesorë të aktivitetit të tyre.

Nuk ka dyshim se rritja e rolit të organeve të Partisë dhe të pushtetit në planifikimin dhe drejtimin e problemeve ekonomike. pjesëmarrja dhe ndihma e tyre më e gjerë në këtë drejtim, do të

shërbente për arritjen e rezultateve më të mira në përcaktimin e detyrave dhe në zbatimin e tyre.

3. — Të ngrihet roli dhe përgjegjësia e kuadrove specialistë për drejtimin teknik të prodhimit

Partia ka vënë në dukje se zhvillimi i sotëm i prodhimit të madh socialist, me nivelin e tij të teknikës moderne, është i lidhur ngushtë me ngritjen e rolit dhe të përgjegjësisë së personelit inxhiniero-teknik në të gjitha hallkat e administrimit të ekonomisë, me ngritjen e vazhdueshme të drejtimit teknik të procesit të prodhimit.

Në vendin tonë është krijuar një inteligjencie e madhe në numër, me një pregatitje të mirë teknike e profesionale dhe e edukuar me frymën e besnikërisë ndaj Partisë dhe popullit. Inteligjencia jonë popullore, krahe për krahe me klasën punëtore dhe fshatarësinë punonjëse, po punon me besim të patundur në vijën e përgjithshme të Partisë dhe po bën përpjekje të frutshme për zgjidhjen me sukses të problemeve tekniko-ekonomike dhe për të kapërcyer, si vështirësitë e rritjes dhe ato të krijuara nga blokada imperialiste revizioniste.

Përfundimet e arritura në këtë drejtim janë një garanci e sigurtë se edhe në të ardhshmen inteligjencia jonë do të punojë akoma më shumë për të vënë në jetë politikën ekonomike të Partisë. Kjo kërkon që inteligjencias sonë t'i bëhen të qarta problemet e mëdha teorike dhe praktike të etapës së sotme të ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste dhe perspektivat e këtij zhvillimi. Në këtë mënyrë këta kadro do të jenë më në gjendje të jetojnë me problemet e kohës, t'i kuptojnë drejt ato dhe, të ndërgjegjshëm për detyrat që u dalin, të marrin masa për zgjidhjen e tyre.

Organet ekonomike, shtetërore dhe të Partisë duhet të kombinonë punën politike dhe edukative me ngritjen e aftësive profesionale dhe përdorimin racional të kuadrove teknikë. Është më se e nevojshme që drejtuesit e ekonomisë në punën e tyre t'i mbajnë afër specialistët, të punojnë me ta, të dëgjojnë zërin e tyre, të kenë besim në punën e tyre, t'u hapin horizontin e punës dhe t'i inkurajojnë për rezultate të reja.

Një aspekt tjetër shumë i rëndësishëm i punës së kuadrove specialistë është jo vetëm përqëndrimi në zgjidhjen e detyrave të ditës, por edhe studimi nga ana e tyre i gjendjes dhe perspektivës së sektorit, që u është besuar të drejtojnë. Këto përbëjnë sot dy detyrat themelore të kuadrove specialistë, pavarësisht nga sektori ku punojnë, si në bazë ashtu edhe në qendër. Për këtë qëllim duhet të merren masa për t'i çliruar kadrot specialistë nga disa

punë të tepërta dhe që duhet t'i zgjidhin të tjerët, siç mund të jenë problemet e furnizimit materialo-teknik, të shpërndarjes etj. Kuadrot specialistë duhet të mësohen të punojnë në mënyrë të tillë që punët e ditës t'i kombinojnë me problemet e perspektivës. Kështu, ne do të bëjmë një hap të dukshëm përpara, për të ngritur punën teknike në dikastere dhe në ndërmarje në nivelin e detyrave të mëdha që shtrohen për drejtimin teknik të prodhimit.

Zgjidhja me sukses e problemeve të shumta e të ndërlikuara, që paraqet zhvillimi i mëtejshëm i prodhimit socialist, janë të lidhura ngushtë dhe me bashkërendimin e detyrave midis ndërmarrjeve, sektorëve dhe institucioneve kërkimore-shkencore, me aktivizimin e kuadrove për zgjidhjen e problemeve teknike dhe për një punë shkencore më të organizuar, me tematikë të pasur dhe probleme, që i shërbejnë ekonomisë popullore.

Një punë e tillë, mbi baza pak a shumë të organizuara, ka filluar të bëhet në sektorin e minierave dhe të gjeologjisë, të industrisë, në rrethin e Vlorës, Durrësit, në qytetin e Tiranës etj. Por kjo është vetëm fillimi i punës së madhe, që duhet bërë në aktivizimin dhe përdorimin e drejtë të kuadrove teknike dhe specialistë. Organet e Partisë dhe të shtetit duhet të bëjnë një punë sistematike dhe të organizuar që specialistët të jenë në gjendje të studjojnë dhe të përgjithësojnë problemet e ndryshme mbi baza shkencore. Në këtë mënyrë me një punë më të thelluar do të krijohen mundësitë për të përcaktuar më qartë drejtimit kryesorë të zhvillimit të prodhimit socialist.

4. — Të rritim mobilizimin e organeve të Partisë, të shtetit dhe të ekonomisë për të zbatuar deri në fund detyrat e caktuara në lëmin e ekonomisë

Komiteti Qendror i Partisë ka theksuar vazhdimisht se puna nuk mbaron me hartimin e planeve dhe me nxjerrjen e vendimeve. Kjo përbën vetëm fillimin, prandaj një punë shumë e madhe duhet të bëhet për vënjen e tyre në jetë. Kjo nuk është një detyrë e thjeshtë, përkundrazi është mjaft e vështirë, e cila kërkon të mobilizohen të gjitha forcat krijuese mendore dhe fizike të masave punonjëse për të zbatuar direktivat e Partisë në fushën e ekonomisë që gjejnë pasqyrim në planet tona dhe në vendimet e ndryshme që nxjerrin Partia dhe qeveria.

Komiteti Qendror i Partisë dhe qeveria vazhdimisht kanë porositur organet e Partisë e të shtetit mbi domosdoshmërinë e zbatimit me përpikmëri, në kohë dhe në mënyrë krijuese të vendimeve të Partisë e të qeverisë, të cilat shprehin interesat jetike të shoqërisë sonë. Në periudhën e tanishme shtrohet në mënyrë

të veçantë detyra që të kuptohen thellë vendimet e Partisë, të njihet mirë gjendja, të merren gjithë masat e nevojshme dhe të çohet deri në fund zbatimi i tyre. Arti i udhëheqjes politike në ekonomi qëndron në aftësinë për të bindur dhe tërhequr masat në mënyrë të ndërgjegjshme në zgjidhjen e detyrave dhe në këtë drejtim duhet caktuar hallka kryesore në vargun e problemeve që preokupojnë Partinë, nga zgjidhja e së cilës varet edhe mbarëvajtja e problemeve të tjera në tërësi.

Duke u mbështetur në vendimet e Kongresit IV të Partisë, Komiteti Qendror i PPSH dhe Këshilli i Ministrave kanë marrë një sërë vendimesh, në të cilat janë përcaktuar detyra dhe masa të rëndësishme që shërbejnë për shpejtimin e zhvillimit të vendit tonë dhe për ndërtimin e plotë të shoqërisë socialiste. Vendimet për gjendjen ekonomike, sociale dhe kulturele të fshatit, për intensifikimin e bujqësisë, për forcimin e mëtejshëm të regjimit të kursimit, për organizimin socialist të punës, për përmirësimin e mëtejshëm të punës ideologjike për edukimin e punonjësve dhe shumë vendime të tjera janë një bazë e shëndoshë nga e cila duhet të tërhiqen dhe të punojnë me këmbëngulje organizatat e Partisë, organet e shtetit dhe të ekonomisë në veprimtarinë e tyre. Në bazë të këtyre vendimeve janë marrë dhe vazhdojnë të merren një sërë masash për mobilizimin e të gjitha mundësive për t'i dhënë një hov të mëtejshëm zhvillimit tonë.

Por, ne duhet të jemi të ndërgjegjshëm se në zbatimin e detyrave e të vendimeve të Partisë dhe të qeverisë mbetet akoma shumë për të bërë, sidomos në kuptimin e thellë dhe zërthimin krijues të tyre dhe në marrjen e masave për të shpënë deri në fund detyrat. Këtu duhet të përqëndrohet vëmendja kryesore e organizatave të Partisë dhe e organeve shtetërore. Në mjaft raste, pas daljes së vendimeve hartohen plane dhe përcaktohen masa për zbatimin e tyre, por nuk ndiqen deri në fund dhe në mënyrë të organizuar, nuk shoqërohen me një punë intensive propagandistike për njohjen e tyre, për kuptimin e thellë të çështjeve, që ngrihen në vendime nga pikëpamja teorike, ideologjike dhe praktike, që këto të mos njihen vetëm nga një rreth i ngushtë njerëzish, nga kuadrot kryesorë, por nga të gjithë kolektivat punonjës, të cilët duhet të luftojnë për vënjen në jetë të detyrave që shtrojnë këto vendime.

Të gjithë jemi në dijeni që Plenumi X i Komitetit Qendror të PPSH i qershorit 1963 përpunoi dhe aprovoi një program të gjerë masash për zhvillimin e mëtejshëm të gjendjes ekonomike, sociale e kulturele të fshatit. Në këtë drejtim është bërë një punë e kënaqshme nga komitetet e organizatat e Partisë dhe nga organet shtetërore në qendër dhe në bazë. Por nuk mund të themi se çdo gjë shkon në rregull. Ai kërkon një shpjegim më të gjerë në masat punonjëse, kërkon krijimin e bazës materiale të nevoj-

shme si dhe kuptimin e karakterit perspektiv të direktivave të Komitetit Qendror të Partisë. Të marrim për shembull çështjen e përqëndrimit të fshatit. A shtrohet ky problem njëlloj, si për fshatrat fushore dhe ato malore, apo për fshatrat e Jugut dhe ato të Veriut? A mundet që kjo direktivë e Komitetit Qendror të zbatohet në një kohë pak a shumë të shkurtër? Sigurisht që jo, sepse kjo varet, si nga mundësitë ekonomike që ka fshatari, nga psikologjia e tij, si edhe nga mundësitë teknike dhe materiale që ka shteti në konditat e tanishme. Prandaj, nuk duhet të nxitohemi, por ta bindim fshatarin që me të hollat që disponon, deri sa ka shtëpi ta rregullojë e mirëmbajë atë, ta pajisë sa më mirë dhe kur t'i priset të kërkojmë që shtëpinë e re ta ndërtojë në vendin e caktuar të fshatit. Ndryshe, duke mos marrë parasysh të gjitha këto, duke vepruar në mënyrë arbitrare dhe të nxituar, krijojmë pakënaqësi dhe u hapim probleme Partisë dhe qeverisë.

I tillë është edhe rasti i kolektivizimit të bujqësisë, për të cilin Komiteti Qendror ka theksuar më se një herë nevojën e bindjes për tërheqjen e fshatarësisë në këtë rrugë. Me një metodë të tillë Partia arriti fitore të mëdha në këtë drejtim dhe kjo tani është e qartë për të gjithë. Po kush u tha komiteteve të Partisë të rretheve të Pukës dhe të Shkodrës që, me urdhëra dhe masa administrative, të ngrinin me nxitim kooperativa bujqësore në zonat malore, pa përgatitur me kujdes terrenin dhe njerëzit për këtë hop dhe krijuan kështu situata të rënda, acarime me fshatarësinë deri sa u desh ndërhyrja e Komitetit Qendror dhe e qeverisë për rregullimin e gjendjes?

Vitin që kaloi Komiteti Qendror i PPSH mori vendimin për përmirësimin e organizimit socialist të punës. Për këtë vendim është bërë një punë e madhe dhe janë zbatuar një sërë masash, të cilat kanë pasur dhe do të kenë efektet e tyre pozitive. Megjithatë rezultatet e zbatimit të këtij vendimi do të ishin më të mëdha në qoftë se si nga Partia edhe nga pushteti do të bëhej një punë e gjithanshme dhe e vazhdueshme politike dhe organizative. Puna politike nuk pati vazhdimësi dhe si rrjedhim problemet e ndërlikuar dhe të shumanshme të organizimit socialist të punës nuk ju bënë të qarta si duhet masave punonjëse. Nga ana tjetër, kjo nuk u shoqërua sa duhet me një veprimtari intensive të organeve të shtetit dhe të ekonomisë. Dikasteret nuk vazhduan punën deri në fund dhe ndihma ndaj bazës që e pamjaftueshme, gjë që ndikoi negativisht për përfundime më të mira. Edhe komitetet e Partisë nuk punuan si duhet për të zgjidhur problemet e ndryshme sipas radhës, por synuan t'i trajtojnë ato në front të gjerë dhe me kalimin e kohës kujdesi u pakësua dhe një sërë problemesh të rëndësishme nuk u zgjidhën në kohën e duhur.

Komitetet dhe organizatat bazë të Partisë, organet shtetërore dhe të ekonomisë është e nevojshme të forcojnë punën politike

për kuptimin e thellë të vendimeve dhe të organizojnë mirë e në kohë punën për zbatimin e tyre. Gjithashtu duhet punuar vazhdimisht që kuadrot në bazë të nxjerrin probleme të ndryshme që i dikton koha dhe që lindin nga vendime të cilat duhen vënë në jetë. Në këtë drejtim duhet punuar më me iniciativë dhe më me ngulm për të nxjerrë detyrat për veprimtarinë e përditshme dhe me perspektivë. Nuk ka dyshim se po të studjohen dhe kuptohen thellë vendimet e Partisë dhe të qeverisë, po të zërthehen këto në mënyrë krijuese dhe të shoqërohen me masat e nevojshme politike dhe organizative për vënjen e tyre në jetë, efekti i punës së Partisë, të organeve shtetërore dhe të ekonomisë do të jetë shumë më i madh.

Shokë,

Detyrat e planit të vitit 1965, si viti i fundit i planit të tretë pesëvjeçar, kanë një rëndësi të madhe. Këto detyra me zbulimin dhe përdorimin e mëtejshëm të rezervave të brendshme do të bëhen edhe më të ngjeshura. Në këto kushte zbatimi i detyrave të planit të vitit 1965 është i lidhur ngushtë me mobilizimin e gjithanshëm të masave punonjëse të qytetit dhe të fshatit, me luftën që duhet të bëjnë organizatat e Partisë për t'u vënë në krye të vrullit revolucionar dhe për ta udhëhequr atë drejt realizimit të objektivave që ka caktuar Partia.

Gjatë diskutimit të detyrave të planit të vitit 1965 kolektivat e ndryshëm punonjës treguan gatishmërinë dhe optimizmin e tyre për ta bërë atë realitet dhe muarën shumë zotime për tejkalimin e detyrave të planit të vitit 1965. Organizatat e Partisë duhet të mbajnë lart shkallën e mobilizimit të masave punonjëse dhe këtij qëllimi duhet t'i shërbejë organizimi më i mirë i emulacionit socialist për ta bërë vitin 1965 vitin e fitoreve të reja dhe një bazë të shëndoshë për pesëvjeçarin e ardhshëm.

Nuk ka asnjë dyshim se masat punonjëse të vendit tonë, nën udhëheqjen e drejtë të Partisë, të Komitetit të saj Qendror me shokun Enver Hoxha në krye, do të mobilizohen me një vendosmëri dhe patriotizëm më të madh për të arritur fitore edhe më të mëdha gjatë vitit 1965.

Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë

V E N D I M

I PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH MBI APROVIMIN E RAPORTIT «MBI PËRFUNDIMET E PLOTËSIMIT TË PLANIT DHE TË BUXHETIT TË SHTETIT PËR VITIN 1964 DHE DETYRAT E PLANIT DHE TË BUXHETIT PËR VITIN 1965»

19 shkurt 1965

Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH, në mbledhjen e datës 18—19.II.1965, pasi dëgjoji dhe diskutoi raportin e Byrosë Politike të Komitetit Qendror «Mbi përfundimet e plotësimit të planit dhe të buxhetit të shtetit për vitin 1964 dhe detyrat e planit dhe të buxhetit për vitin 1965», mbajtur nga kandidati i Byrosë Politike të KQ, zëvendëskryetar i Këshillit të Ministrave të RPSH dhe President i Komisionit të Planit të Shtetit, shoku Koço Theodhosi,

V e n d o s i :

Të aprovojë njëzëri raportin e mësipërm, i cili do të shërbejë si program pune për mobilizimin e të gjithë Partisë dhe masave tona punonjëse, për të realizuar detyrat që cakton plani i vitit 1965.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

T H I R R J E

E KOMITETIT QENDROR TË PPSH DHE E KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË RPSH MBI PJESËMARRJEN E MASAVE POPULLORE PËR DISKUTIMIN DHE HARTIMIN E PLANIT TË KATËRT PESËVJEÇAR TË ZHVILLIMIT TË EKONOMISË DHE KULTURËS PËR PERIU DHËN 1966—1970

23 tetor 1965

POPULL SHQIPTAR,

Komiteti Qendror i PPSH dhe Këshilli i Ministrave i RPSH janë duke studjuar shifrat kryesore të projektplanit të katërt pesëvjeçar të zhvillimit të ekonomisë dhe të kulturës popullore, për periudhën 1966—1970, i cili do të shënojë një hap tjetër të rëndësishëm në zgjidhjen e detyrave themelore të etapës së re historike të ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste në atdheun tonë. Plani i katërt pesëvjeçar do të hapë perspektiva të reja, më të mëdha, për zhvillimin ekonomik të vendit, për rritjen në një shkallë më të lartë të bazës materialo-teknike, për perfeksionimin e marrëdhënjeve socialiste në prodhim, për shtimin e prodhimit industrial e bujqësor dhe, si pasojë, për përmirësimin e mirëqenjes materiale e të nivelit kultural të popullit.

Partia dhe qeveria jonë i kanë dhënë e i japin gjithnjë një rëndësi të dorës së parë konsultimit me masat e gjera popullore për të gjitha çështjet e organizimit, të drejtimit dhe të zhvillimit të planifikuar të ekonomisë e të kulturës popullore. Gjykimi dhe mendimi krijues i klasës punëtore, i fshatarësisë punonjëse dhe i inteligjencies popullore, iniciativa e tyre, janë faktorë shumë të rëndësishëm për një planifikim të drejtë, real, mobilizues e revolucionar.

Së afërmi do të shpallen projektdirektivat e KQ të PPSH mbi planin e katërt pesëvjeçar 1966—1970, të cilat do të shërbejnë për t'u njohur me perspektivat e zhvillimit të vendit tonë dhe për të kuptuar thellë rëndësinë e orientimit të përgjithshëm të ndërtimit të socializmit në etapën e tanishme dhe si bazë për diskutimin e shifrave të projektplanit të katërt pesëvjeçar dhe për hartimin e tij nga të gjitha masat punonjëse, nga i gjithë populli. Prandaj,

Komiteti Qendror i Partisë dhe Këshilli i Ministrave u bëjnë thirrje punëtorëve, fshatarëve, intelektualëve, gjithë popullit punonjës të tregojnë, si kurdoherë, frymën revolucionare dhe të partishmërisë, ndjenjën e përgjegjësisë së lartë kombëtare në pjesëmarrjen e drejtëpërdrejtë dhe aktive në punën përgatitore, në diskutimin e projektplanit, në propozimet dhe iniciativat masive të punonjësve për hartimin dhe aprovimin e shifrave të planit të katërt pesëvjeçar.

Planifikimi i ekonomisë dhe i kulturës popullore mbi baza shkencore është një nga epërsitë e rendit tonë ekonomik-shoqëror. Partia dhe qeveria, duke u udhëhequr nga mësimet e marksizëm-leninizmit, duke u mbështetur në kërkesat e ligjeve objektive ekonomike të socializmit, në eksperiencën pozitive të fituar, kanë përcaktuar dhe po zbatojnë, në përshtatje me kushtet konkrete historike të vendit e të rrethanave ndërkombëtare programin e ndërtimit të socializmit, i cili ka gjetur pasqyrimin e vet në planin unik shtetëror.

Pikërisht sepse Partia dhe qeveria kanë ndjekur një politikë të tillë në zhvillimin ekonomik e kultural të vendit, planet e shtetit janë konsideruar me të drejtë si çështje e madhe kombëtare e gjithë popullit dhe realizimi në përgjithësi me sukses i tyre ka çuar në rritjen e vrullshme të forcave prodhuese, në sigurimin e vazhdimësisë së riprodhimit të zgjeruar socialist, në vendosjen e përpjesëtimeve të drejta në zhvillimin e degëve të veçanta të sferës së prodhimit material e të sektorëve social-kulturalë, në sigurimin e ritmeve të larta, në ngritjen e mëtejshme të mirëqenjes së popullit.

Këto parime, këto kritere e përpjesëtime të drejta është e nevojshme të mbahen mirë parasysh, ato duhet të bëhen çështje e të gjitha masave punonjëse sidomos tani, që jemi në fazën e hartimit të projektplanit të katërt pesëvjeçar.

Diskutimi, në mënyrë sa më të gjerë e të organizuar nga masat punonjëse, i shifrave orientuese të planit të katërt pesëvjeçar do të rritë shumë rolin dhe përgjegjësinë e masave në drejtimin e ekonomisë. Pjesëmarrja e tyre aktive dhe konkrete në këtë fazë, vënja në shërbim të ekonomisë e njohurive dhe e eksperiencës së punëtorëve, fshatarëve, kadrove drejtues inxhiniero-teknikë dhe e të gjithë popullit, është një kontribut i madh në arritjen e objektivave të Partisë për ta bërë planifikimin një instrument të rëndësishëm, ku të gjejnë pasqyrimin e vet në mënyrë sa më të plotë nivelit shkencor, karakteri direktiv, fryma e partishmërisë revolucionare dhe përmbajtja thellësisht popullore e planeve tona.

POPULL SHQIPTAR,

Duke diskutuar shifrat orientuese të planit të katërt pesëvjeçar të zhvillimit të ekonomisë e të kulturës sonë popullore, në punën për hartimin e planit mbani parasysh parimin themelor të ndërtimit socialist, parimin e mbështetjes në forcat tona njerëzore, materiale e financiare, në potencialin ekonomik të krijuar me punën e djersën e popullit tonë patriot e punëtor, në epërsinë ideologjike, shoqërore dhe ekonomike të rendit tonë shtetëror, në mënyrën socialiste të prodhimit, për të vënë në shërbim të shoqërisë rezervat e shumta që fshihen në gjirin e ekonomisë popullore. Mos harroni për asnjë çast rrethanat ndërkombëtare në të cilat po hartohet plani dhe do të punohet për realizimin e detyrave të tija të rëndësishme. Vlerësoni lart eksperiencën e madhe që kanë fituar masat punonjëse në luftën për realizimin e pesëvjeçarit të tretë dhe merrni masa efektive për përmirësimin e gjithanshëm të punës, për kapërcimin e të metave të vërtetuara si në hartimin e planeve ashtu edhe në zbatimin e tyre.

1. — Nën udhëheqjen e Partisë, gjatë vjetëve të pushtetit popullor, janë bërë transformime me përmbajtje të thellë revolucionare, të cilat ndryshuan rrënjësisht fizionominë ekonomike, shoqërore e kulture të vendit tonë. Brenda një periudhe historike relativisht të shkurtër vendi ynë u shndërrua në një vend agraro-industrial dhe tani ka hyrë në rrugën e shndërrimit në një vend industrialo-agrar. Kolektivizimi i bujqësisë, që nga përpjesëtimet dhe nga rëndësia e tij konsiderohet me të drejtë si revolucioni ynë i dytë, krijoi marrëdhënje të reja në fshat dhe mundësi reale për ta nxjerrë përfundimisht fshatarësinë nga skamja dhe nga gjendja e mjeruar. U forcua e u çelnikos aleanca midis klasës punëtore dhe fshatarësisë punonjëse, nën udhëheqjen e klasës punëtore, dhe mbi këtë bazë për ditë e më shumë forcohet uniteti moralopolitik i popullit shqiptar. Një ushtri e tërë punonjësish të kualifikuar punon sot në industri, bujqësi, ndërtim dhe në degët e tjera të ekonomisë e të kulturës. Investimet e mëdha kapitale, burim kryesor për të cilat ka shërbyer e shërben akumulimi i brendshëm socialist, po ja ndryshojnë pamjen atdheut tonë. Është duke u krijuar një industri shumëdegëshe, e cila po përpunon gjithnjë e më shumë lëndët e para të vendit. Në bujqësi, shtimi i mekanikës, përmirësimi ujqor, prodhimi në vend në një të ardhshme të afërt i plehrave kimike etj., kanë krijuar e po krijojnë mundësi të gjera për intensifikimin e prodhimit bujqësor. Një zhvillim të madh kanë marrë në përgjithësi edhe degët e tjera të prodhimit material, të qarkullimit si dhe arësimi, kultura e shëndetësia.

Një emulacion i paparë shpërtheu në gjirin e popullit punonjës për të vënë në jetë direktivat e Kongresit IV të PPSH për

realizimin e planit të tretë pesëvjeçar në kushtet e rrethimit gjeografik e të blokadës ekonomike imperialiste dhe revizioniste. Pesëvjeçari i tretë u bë pesëvjeçari i luftës heroike të popullit tonë për të thyer blokadën që ju imponua atij dhe që kishte për synim gju-njzimin e Partisë e të popullit tonë. Realizimi në përgjithësi me sukses i pesëvjeçarit të tretë, me gjithë vështirësitë e pengesat e krijuara, jo vetëm fuqizoi më tej ekonominë e vendit, por edhe rriti besimin në forcat tona, në potencialin ekonomik të vendit tonë.

Megjithëse gjendja ekonomike dhe shoqërore e vendit ka pësuar ndryshime të rëndësishme cilësore, në hartimin e planeve tona nuk duhet të nisemi nga dëshirat, por të mbajmë kurdoherë parasysh mundësitë tona reale. Në të kaluarën ka pasur edhe raste që në punën planifikuese nuk janë vlerësuar në shkallën e duhur, nuk janë shfrytëzuar në mënyrë të plotë e racionale të gjitha rezervat e mundësive ekonomike të vendit. Nga këto të meta masat punonjëse kanë nxjerrë mësim. Ato sot kanë një eksperiencë të pasur, kanë më shumë njohuri e pjekuri, e kuptojnë ndjenjën e lartë të përgjegjësisë në të gjykuarit e çështjeve ekonomike, të cilat bëjnë të mundur që në punën përgatitore për hartimin e projektplanit të katërt pesëvjeçar 1966—1970 të zotërojnë fryma realiste, mobilizuese, fryma e partishmërisë revolucionare që mbështetet në mundësitë reale të vendit, në zbulimin e shfrytëzimin e të gjitha rezervave, në vitalitetin e ekonomisë sonë, në forcën e popullit tonë. Le të zhvillohen në mënyrë të gjithanshme iniciativa dhe mendimi krijues i masave punonjëse për ta çuar përpara zhvillimin ekonomik të vendit, për të shtuar prodhimin e të mirave materiale dhe për të parashikuar shpenzimet më të nevojshme e të domosdoshme duke u udhëhequr nga fjala e urtë e popullit që thotë «të shtrijmë këmbët sa kemi jorganin».

Komiteti Qendror i Partisë dhe Këshilli i Ministrave u bëjnë thirrje gjithë popullit shqiptar, të gjitha organeve e organizatave të Partisë, shtetërore, ekonomike dhe shoqërore, që gjatë shqyrtimit të shifrave të projektplanit të katërt pesëvjeçar 1966—1970 të kenë parasysh mundësitë tona dhe të planifikojnë duke u mbështetur në këto mundësi reale dhe konkrete. Mundësitë tona shprehën, para së gjithash, në mobilizimin e të gjitha burimeve e rezervave të brendshme, të energjive të pashtershme të popullit tonë për të bërë, në këtë mënyrë, realitet parimin themelor marksist-leninist sipas të cilit *socializmi duhet të ndërtohet duke u mbështetur kryesisht në forcat e veta*.

Në këto rrethana ne duhet të bëjmë të gjitha përpjekjet që planet tona ekonomike të sigurojnë prodhimin maksimal, shtimin e të ardhurave kombëtare dhe, në vartësi të drejtëpërdrejtë me përpjesëtimet e realizimit të tyre, të vendosen raporte të drejta në shpërndarjen e të ardhurave kombëtare në fond akumu-

limi e konsumi duke u udhëhequr kurdoherë nga parimi themelor *për të siguruar në radhë të parë riprodhimin e zgjeruar socialist, për të shtuar rezervat e nevojshme, për të përballuar zbatimin ritmik të planit dhe nevojat e mbrojtjes së atdheut, për të siguruar, gjithashtu, edhe fondet e nevojshme për konsum*.

2. — Si rrjedhim i politikës agresive të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe i tradhëtisë së revizionistëve modernë gjendja ndërkombëtare është acaruar. Lufta që kanë shpërthyer agresorët amerikanë kundër popullit të Vietnamit dhe përkrahja që u japin agresorëve revizionistët modernë, sidomos revizionistët sovjetikë, rrezikon lirinë dhe pavarësinë e popujve në atë zonë. Por orvatjet e imperialistëve e të revizionistëve për të mposhtur socializmin, për të asgjësuar marksizëm-leninizmin, për të mbajtur nën zgjedhë popujt e shtypur, për të shkatërruar lëvizjet revolucionare nacional-çlirimtare, nuk do të kenë kurrë sukses. Raporti i forcave në arenën ndërkombëtare, me gjithë tradhëtinë e revizionistëve hrushovianë, është në favor të socializmit, të revolucionit dhe në dëm të imperialistëve e të revizionistëve. Kundër imperialistëve e revizionistëve luftojnë sot gjithë popujt e botës, gjithë marksistë-leninistët e vërtetë, gjithë revolucionarët, që përbëjnë shumicën dhe, në fund të fundit, fitorja do të jetë patjetër e socializmit, e marksizëm-leninizmit, e popujve.

Megjithatë populli shqiptar qëndron gjithmonë vigjilent. Ai nuk harron për asnjë çast faktin se vendi ynë ndodhet i rrethuar gjeografikisht nga të katër anët nga imperialistët e revizionistët, se për vendin tonë ekziston vazhdimisht blokada e tyre dhe se qëllimi i fundit i imperialistëve dhe i revizionistëve kundër vendit tonë ka qenë dhe është përmbysja e socializmit dhe rivendosja e kapitalizmit në Shqipëri. Këto rrethana objektive të gjendjes ndërkombëtare dhe të vendit tonë duhet t'i kemi kurdoherë parasysh jo vetëm në hartimin e planit të katërt pesëvjeçar, por edhe në çdo hap që bëjmë në punën tonë të përditshme për ndërtimin e socializmit.

Komiteti Qendror i Partisë dhe Këshilli i Ministrave u bëjnë thirrje gjithë punonjësve të vendit tonë, gjithë komunistëve, gjithë popullit që, duke shqyrtuar projektplanin e pesëvjeçarit të katërt 1966—1970, të kenë parasysh rrethanat objektive të gjendjes së acaruar ndërkombëtare dhe të blokadës imperialisto-revizioniste në të cilën gjendet vendi ynë. Rrethanat objektive, gjendja e sotme ndërkombëtare dhe ekzistenca e blokadës, në të cilat vendi ynë ndërton socializmin, kërkojnë mobilizimin me një frymë të lartë patriotike të të gjitha masave punonjëse të vendit për zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë, për forcimin e mbrojtjes së vendit, për të bërë që të dështojnë me turp si kurdoherë të gjitha planet djallëzore të armiqtë të Partisë dhe të popullit tonë. Këto rrethana kërkojnë që të forcohet vazhdimisht ndjenja e për-

gjithshme e kursimit, e përdorimit me nikoqirllëk të të gjitha fondeve materiale e monetare, e shfrytëzimit sa më të plotë të kapaciteteve prodhuese, e rritjes së prodhimeve për eksport dhe e pakësimit të importit, e shtimit të të ardhurave në valutë, e forcimit të ndjenjës së përgjegjesisë. Pa një kuptim të tillë politik nuk mund të bëhet një plan real, revolucionar, që të parashikojë shfrytëzimin e plotë të të gjitha rezervave e mundësive që ekzistojnë në çdo sektor dhe nuk mund të zbatohen detyrat e planit.

3. — Me gjithë punën e madhe që është bërë, me gjithë sukseset e mëdha që janë arritur, gjatë luftës së vendosur që kanë bërë masat punonjëse për realizimin e planit të tretë pesëvjeçar 1961—1965, janë vënë re edhe të meta e dobësi, si në planifikim ashtu edhe në zbatimin e planit në disa sektorë. Nga këto të meta e dobësi duhet të nxirren mësimet e nevojshme për përmirësimin e mëtejshëm të punës.

Ndonëse në vendin tonë është kryer një revolucion i tërë ekonomik, kultural e shoqëror drejt socializmit, ka akoma raste të mosaktivizimit sa më të gjerë të popullsisë së aftë në punën krijuese e prodhuese, të mosshfrytëzimit të plotë të kohës së punës, të mosrealizimit sa duhet të detyrave për rritjen e rendimentit, për forcimin e disiplinës së ndërgjegjshme socialiste në punë etj. Kjo është më e theksuar në fshat, ku, siç dihet, punohet shumë gjatë fushatave të pranverës e të vjeshtës dhe punohet relativisht pak në stinët e tjera të vitit. Sot, kur bujqësia jonë është duke ecur në rrugën e intensifikimit, kërkohet një punë e madhe, e vazhdueshme, kërkohet që të gjitha forcat e afta për punë të shfrytëzohen në maksimum kohën e punës gjatë gjithë vitit.

Në punët e përditshme të prodhimit dhe në drejtimin e ekonomisë popullore është grumbulluar një eksperiencë e mrekullueshme e përparuar, e cila nuk është përgjithësuar dhe përhapur gjithnjë në mënyrë të organizuar. E meta kryesore qëndron në faktin se deri tani nuk është marrë gjithnjë si kriter kryesor eksperiencia e përparuar, në bazë të së cilës të edukohen e të bëhen të ndërgjegjshme masat për zbulimin e rezervave, për hartimin e planit të shtetit dhe për realizimin e detyrave që shtrën ai. Eksperiencia e përparuar nuk është përfshirë si detyrë themelore në planin e shtetit.

Eksperiencia e përparuar gjendet kudo, në të gjithë sektorët e ekonomisë popullore. Kështu, ka shumë raste që një ndërmarrje apo kooperativë bujqësore merr prodhim më të lartë se ndërmarrjet apo kooperativat e tjera bujqësore në të njëjtat kushte. Nuk ka rreth që të mos ketë ndërmarrje ose kooperativa të përparuara. Nuk ka ndërmarrje ose kooperativë bujqësore që të mos ketë të paktën një brigadë shembëllore. Nuk ka brigadë që të mos ketë skuadër e cila të punojë më mirë nga të tjerat dhe nuk ka skuadër pune që të mos ketë të paktën një punëtor ose kooperativist që të

dallohet mbi të tjerët. Këtu qëndron një nga rezervat më të mëdha në ekonominë tonë. Asnjë detyrë për rritjen e vëllimit të prodhimit industrial ose bujqësor, të ndërtimeve etj., nuk mund të plotësohet si duhet pa organizuar përgjithësimin e shembullit të mirë në skuadër, në brigadë, në ndërmarrje, në kooperativë, në rreth, në degët e ekonomisë, në shkallë Republike. *Prandaj, çështja e organizimit të përhapjes dhe e përgjithësimit të eksperiencës së përparuar dhe të shembullit të mirë duhet të tërheqë vëmendjen kryesore të të gjitha organeve të Partisë, të shtetit dhe të ekonomisë, të klasës punëtore, të fshatarësisë punonjëse dhe të inteligjencies popullore, sepse këtu shprehet në mënyrë të koncentruar zbatimi i shkencës dhe i teknikës, sepse këtu qëndron një nga rezervat më të mëdha e të pashterueshme për rritjen e vazhdueshme dhe të hovshme të prodhimit.*

Në kuadrin e zhvillimit të përgjithshëm të ekonomisë popullore, me gjithë përparimet e mëdha që janë bërë në bujqësi, ajo është akoma larg objektivit që ka caktuar Partia për ta bërë atë me të vërtetë një bujqësi intensive, të aftë për të siguruar nevojat e vendit me prodhime të bollshme bujqësore e blegtorale. Në këto rrethana, a na lejohet të mos mendojmë seriozisht si të organizohet më mirë pjesëmarrja e të gjithë krahëve të aftë për punë gjatë gjithë vitit? A na lejohet të lëmë goftë edhe një pëllëmbë tokë pa e shfrytëzuar? A na lejohet që gjithë ato investime të mëdha që ka bërë e bën shteti ynë për mekanizimin, bonifikimin, për ujitet etj., të mos shfrytëzohen me nikoqirllëk të madh dhe të mos japin frute sa më të mëdha? A na lejohet të tregojmë goftë edhe pakujdesinë më të vogël duke mos shfrytëzuar sasisë e shumta të plehrave organike që disponohen dhe duke mos kryer me kohë të gjitha shërbimet kulture? *Shtimi i prodhimeve bujqësore e blegtorale, dhe në mënyrë të veçantë shtimi i prodhimit të drithërave të bukës, ndjekja me kujdes e të gjitha çështjeve që janë të lidhura me të, duhet të bëhet problemi themelor i ditës për çdo punonjës të bujqësisë, për çdo organizatë bazë partie dhe për çdo organ shtetëror që ka lidhje me bujqësinë.*

Në fushën e forcimit të ndërgjegjes socialiste ka shumë për të bërë. Kapërcimi i kontradiktës midis interesit personal dhe interesit të përgjithshëm është një nga detyrat më të rëndësishme. Për edukimin e njerëzve, për zhvillimin e ndjenjës së përgjegjesisë në punë, për kalitjen e ndërgjegjes socialiste, për të kombinuar më mirë interesin personal me interesin e përgjithshëm, del e nevojshme të zhvillohet një punë e vazhdueshme e sistematike.

Eksperiencia e deritanishme ka treguar se në disa sektorë të ekonomisë e të kulturës janë reflektuar të meta për të planifikuar prodhimin e të ardhurave më pak nga sa janë mundësitë dhe për të kërkuar shpenzime më shumë. Kështu shpjegohen kërkesat e fryra e pa vend që bëhen në disa raste për investime e ndërtime të

parakohshme e të panevojshme, për lëndë të para, materiale kryesore e ndihmëse, lëndë djegëse, pjesë këmbimi, për karburant etj. Ka gjithashtu, shfaqje të dëmshme në ruajtjen dhe administrimin e pronës socialiste, në kursimin e vlerave materiale e monetare, ka burokraci e vetëkënaqësi nga rezultatet e arritura.

Përparime janë arritur në përmirësimin e cilësisë së prodhimit, në ndërtimet dhe në shërbimet, por ka edhe raste kur punohet me cilësi të dobët. Kjo rrjedh edhe për arsye se akoma nuk është bërë sa duhet e qartë për të gjithë se shpërblimi për punën jepet *jo vetëm për sasinë, por edhe për cilësinë. Kthesa rrënjësore, revolucionare, për përmirësimin e cilësisë, kërkon të merren masa jo vetëm edukative, por edhe tekniko-organizative e ekonomike, në mënyrë që të interpretohet e të zbatohet drejt parimi socialist që secili t'i japë shoqërisë «sipas aftësisë» dhe të marrë prej saj jo vetëm «sipas sasisë», por «sipas sasisë dhe cilësisë» së punës që kryen efektivisht.*

Komiteti Qendror i Partisë dhe Këshilli i Ministrave u bënë në thirrje gjithë punonjësve që gjatë shqyrtimit të projektplanit të pesëvjeçarit të katërt të kenë mirë parasysh të metat e dobësitë e vërtetuara, mënjanimi i të cilave do të krijonte mundësi të shumta dhe rezerva të tjera në dobi të zhvillimit të mëtejshëm të ekonomisë e të kulturës popullore. Rritja e ndërgjegjes socialiste në punonjësit, në mënyrë që punëtori e fshatari të *punojnë për shoqërinë si për veten e tyre*, forcimi i dashurisë për punën dhe lufta e vendosur kundër javashllëkut, lufta revolucionare kundër burokracisë e zvarritjes, lufta kundër vetëkënaqësisë apo kundër të kënaqurit me pak, lufta për plane reale, kundër rasteve të planifikimit, «për të qenë brenda», ose «për të mbajtur rezerva pa emulacion», lufta për cilësinë e prodhimit etj., — të gjitha këto janë detyra të dorës së parë. *Zgjidhja me sukses e këtyre detyrave përbën për ekonominë dhe për kulturën tonë një rezervë të madhe materiale, e cila duhet të pasqyrohet në planin tonë të ri pesëvjeçar.*

SHOKË DHE SHOQE,

Pjesëmarrja juaj e drejtëpërdrejtë dhe aktive, si hartuesit e zbatuesit kryesorë të projektplanit të katërt pesëvjeçar, në diskutimin e shifrave orientuese të tij, është shprehje e fuqishme e demokracisë socialiste të shoqërisë sonë. Ajo është kusht vendimtar për mobilizimin sa më të plotë të rezervave të brendshme, për të kthyer në realitet mundësitë e mëdha të vendit tonë, për t'i vënë ato në shërbim të ngritjes së mëtejshme të nivelit material e kultural të popullit. Pra, merrni pjesë gjerësisht e gjallërisht për të dhënë mendimet tuaja shumë të vlefshme krijuese në skuadër, brigadë, repart, sektor, kooperativë, ndërmarrje, në institucion mësues, shkencor etj., për të hartuar një plan të drejtë, real dhe

maksimal duke shfrytëzuar të gjitha burimet e brendshme materiale dhe njerëzore. Gjithë populli në tërësi dhe çdo individ i marrë veças të jenë plotësisht të ndërgjegjshëm për *nevojën e mobilizimit të përgjithshëm shpirtëror, moral, politik e fizik*, për forcimin dhe lulëzimin e atdheut tonë, për kapërcimin e vështirësive që na dalin përpara. Një mobilizim i tillë i përgjithshëm do të bëjë që të shpërthejnë me një vull të paparë mendimet, sugjerimet, iniciativat revolucionare të masave punonjëse.

Në shqyrtimin e shifrave kryesore të projektplanit të katërt pesëvjeçar të orientohemi drejt rezultateve të arritura nga rrethet, degët, ndërmarrjet, kooperativat, repartet, sektorët, brigadat, skuadrat e nga individët e përparuar, të orientohemi *nga shembulli i më të mirëve* me qëllim që, në përshtatje me kushtet e mundësitë konkrete, të hartohen plane reale, të caktohen detyra mobilizuese e të mundshme për t'u zbatuar. Një planifikim i tillë do të thyejë normat e paragjykimet e vjetra, do t'i hapë rrugën së resë, e cila nuk njihet kufi por na mbush me optimizëm e entuziazëm për gjithshka që është arritur e do të arrihet me punën vetëmohuese të popullit punonjës. Një orientim i tillë *drejt të përparuarve* do të bëjë që ndërmarrjet, repartet dhe kooperativat e prapambetura të ngrihen në nivelin e të mirëve dhe të mirët në nivelin e më të mirëve. Kjo do të ishte një masë efektive për të shtuar prodhimin industrial e bujqësor, për fuqizimin e mëtejshëm të ekonomisë popullore dhe për ngritjen, mbi këtë bazë, të mirëqenjes materiale dhe të nivelit kultural të masave punonjëse.

SHOKË DHE SHOQE, FSHATARË, KOOPERATIVISTË, PUNONJËS DHE SPECIALISTË TË BUJQËSISË,

Pesëvjeçari i katërt, që do të fillojë me vitin 1966, do të karakterizohet nga një punë e madhe për të çuar përpara, me hapa më të mëdhenj e më të shpejtë, zhvillimin e bujqësisë e të blegtorisë, rritjen e produkteve të tyre shumë të rëndësishme për gjithë ekonominë e jetën e vendit tonë. Prandaj, në diskutimin tuaj rreth shifrave kryesore të planit të ri pesëvjeçar përqëndrohuni sidomos në detyrat më themelore:

1. — Merrni për bazë një sistem të ri revolucionar në klasifikimin e tokave duke i ndarë ato në disa kategori dhe për secilën nga këto lloje tokash bazohuni në rendimentin mesatar më të mirë të kooperativës të krahasueshme që ka marrë rendiment më të lartë dhe të brigadës së përparuar të krahasuar me kooperativën që merret për bazë. *Në planifikimin e kulturave bujqësore përcaktoni nivelin e rendimentit që duhet arritur në tokat e ujitshme, në tokat ku është bërë punim i thellë qilizëm, në lidhje kjo edhe me sasinë e plehut organik ose kimik të hedhur, me pu-*

nimin e tokave me traktorë, me llojin e farërave më të mira, me shërbime të domosdoshme që duhet të kryhen për çdo kulturë bujqësore. Edhe për shtimin numerik dhe për rritjen e produktit të blegtorisë ndiqni të njëjtat kritere duke pasur për bazë feramat, brigadat dhe individët më të dalluar, në raport me shtimin e prodhimeve bujqësore, me sigurimin e bazës ushqimore, me pasurimin e tokave të caktuara për blegtorinë, lidhur ngushtë me pastrimin, me përmirësimin e me zgjerimin e kullotave, me përmirësimin e racës dhe me masat për mbarështrimin e blegtorisë. Në të njëjtën mënyrë veproni edhe për planifikimin e fruti-vitikulturës. Të gjitha kooperativat bujqësore që disponojnë toka për frutikulturë duhet të arrijnë të krijojnë bloqet e tyre me llojet më të mira, por pa zënë në asnjë mënyrë tokat e bukës, qoftë ato që sot mbillen me drithëra buke, qoftë edhe ato që në të ardhshmen mund të kthehen në toka buke.

2. — Punoni ashtu si punohet edhe në ndërmarrjet shtetërore, gjatë gjithë vitit. Bujqësia ka punë për tërë vitin dhe jo vetëm në kohën e mbjelljeve, të shërbimeve e të vjeljes së produkteve. Siguroni organizimin e mirë dhe pjesëmarrjen në punë gjatë gjithë vitit të të gjithë krahëve të aftë për punë në çdo ekonomi kolektive, në çdo fshat duke përcaktuar drejt numrin e ditëve të punës që duhet të bëjë çdo kooperativist në mënyrë të diferencuar dhe në dinamikë, sipas moshës dhe seksit, ndërsa caktimi i normave të punës në kooperativat bujqësore të bazohet për analogji me normat e punës që zbatojnë ndërmarrjet bujqësore shtetërore.

Zhvillimi me hov i pronës kolektive në fshat dhe administrimi e drejtimi i saj më i mirë kërkon të studjohet një formë e re shpërblymshme për kuadrot drejtues, administrativë dhe të disa sektorëve të prodhimit, të cilët sot punojnë me ditë-punë fikse.

3. — Detyra më kryesore e juaja në planifikimin e pesëvjeçarit të katërt është të gjeni rrugët dhe mundësitë që çdo ekonomi, çdo fshat, çdo kooperativë, të synojë për të prodhuar gjithë sasinë e drithit që i duhet për konsumin e për nevojat e veta dhe të ndihmojë edhe në plotësimin e nevojave të popullit dhe të ekonomisë së vendit me maksimumin e mundshëm.

Për këtë bëni që çdo fshat e çdo kooperativë malore të prodhojë jo vetëm farën e nevojshme dhe gjithë bukën e vitit për popullsinë e vet, por të arrijë t'i japë edhe teprica shtetit. Kurse kooperativat dhe fshatrat fushore e kodrinore duhet të prodhojnë gjithë farën, gjithë bukën e vitit për popullsinë e vet, të sigurojnë plotësimin e planit të shtetit për grumbullimin e detyrimeve dhe, veç kësaj, t'i shesin shtetit edhe teprica të bollshme, si kurdoherë, në parime të shëndosha reciprociteti.

Për këtë qëllim është e domosdoshme që të shfrytëzohen mirë sipërfaqet që janë mbjellë deri sot me drithërat e bukës dhe të merren masa për t'i shtuar këto sipërfaqe duke hapur toka të reja

për drithëra. Të rezervohen tokat më të mira, më të përshtatshme për drithërat e bukës. Duhani të mos zërë tokat që japin prodhim të larta drithi, por sipërfaqja e nevojshme për këtë kulturë të sigurohet duke shfrytëzuar toka të tjera të përshtatshme për të si dhe duke hapur toka të reja. Si në zonat fushore ashtu edhe në ato malore të mos mbetet pa mbjellë e pa u shfrytëzuar asnjë pëllëmbë toke. Mbillni drithëra, sidomos në zonat kodrinore e malore, edhe në ato toka që deri sot janë lënë pa mbjellë, nën pretekstin se janë toka inprodutive dhe se japin prodhim të paktë. Këto toka i bëni qilizëm, i mirëmbani, i përtërin, i punoni ashtu si i kanë punuar me shekuj të parët tanë, duke u kujdesur për t'i sistemuar, për t'i mbrojtur nga gërryerjet, duke ndër-tuar mure, ledhe, taraca, në mënyrë që ato të mund të kthehen në toka prodhuese. Hapni toka të reja, qoftë edhe ato toka të cilat po të mbillen me drithëra buke japin rendiment të ulët.

Për shtimin e prodhimit të drithërave të bukës është e nevojshme në radhë të parë, të përqëndroni tërë kujdesin për kryerjen në kohën e duhur të të gjitha shërbimeve në përputhje me kodin agroteknik.

4. — Planifikoni dhe luftoni në mënyrë që çdo ekonomi, çdo fshat e kooperativë, çdo rreth, të sigurojë brenda një kohe sa më të shkurtër sasinë e nevojshme të pendëve të qeve dhe të kafshëve të tjera tërheqëse, e në radhë të parë në zonat kodrinore e malore. Por për të punuar të gjithë tokën nuk duhet pritur derisa të sigurohen plotësisht pendët e qeve kudo dhe kafshët tërheqëse. Atje ku kafshët e punës nuk i përballojnë plotësisht nevojat dhe ku traktorët nuk kanë mundësi të punojnë, të merren masa që të ngrihen në këmbë të gjitha forcat e afta për punë, të punojnë tokat, t'i bëjnë qilizëm, të hapin toka të reja, të luftojnë për të shtuar prodhimet bujqësore e blegtorale, për të prodhuar sa më shumë, sidomos drithëra buke.

5. — Për shtimin me ritme më të shpejta të prodhimeve bujqësore e blegtorale të bëhen të gjitha përpjekjet për shfrytëzimin e plotë, për grumbullimin, përpunimin, shpërndarjen dhe përdorimin me nikoqirllëk të plehrave organike, të cilat janë një rezervë shumë e madhe për rritjen e rendimenteve të kulturave bujqësore.

Edhe pasi të sigurohet prodhimi në vend i plehrave kimike, plehurat organike janë e do të jenë të domosdoshme e të pazëvendësueshme në bujqësi. Prandaj, planifikoni grumbullimin e plehrave organike duke i llogaritur në bazë të normave fiziologjike të kafshëve. E bëni grumbullimin e plehrave organike aksion të madh të masave punonjëse të fshatit e të qytetit, në asnjë mënyrë mos e lini pa e shfrytëzuar në maksimum këtë pasuri kolosale dhe aq të rëndësishme për shtimin e prodhimit bujqësor. Përdorni sa më racionalisht si plehurat organike ashtu edhe ato kimike duke u nisur nga parimi që plehërimi bëhet për bimën dhe jo për tokën.

Për këtë merrni masa për përhapjen e eksperiencës së përparuar për përdorimin e plehut në brazdën e farës, për plehërimin në kohën e ujitjes, sidomos për plehërimin rrënjë më rrënjë të bimëve prashitëse. Këto duhet të pasqyrohen konkretisht në planin e masave tekniko-organizative për sigurimin e realizimit të planit të prodhimit bujqësor.

Pjesa dërmuese e plehut organik, dhe veçanërisht e plehut kimik që do të prodhohet në vend, të planifikohet për t'u përdorur për shtimin e drithërave të bukës.

6. — Merrni masa për zgjerimin e sipërfaqeve nën ujë. Asnjë ekonomi, asnjë fshat, asnjë kooperativë, asnjë fermë të mos mbetet pa bërë, çdo vit me forcat dhe me mjetet e veta, maksimumin e mundshëm për të shtuar sipërfaqet e ujitshme. Çdo ekonomi bujqësore shtetërore, kolektive ose individuale të marrë masa që të vëjë në jetë metodat e njohura, të përparuara, për ujitjen. Çdo ekonomi bujqësore t'i shtrojë detyrë vetes të shfrytëzojë me niqoqirllëk të gjitha veprat e ndërtuara ujitëse duke mos lënë asnjë pikë uji të vejë dëm, por ta përdorë për nevojat e bujqësisë. *Ujitja me përmbytje* është antiekonomike, antishkencore dhe në kundërshtim me interesat e vetë ekonomisë bujqësore dhe të shtetit. Prandaj, përdorni metodat racionale dhe më të drejta që rekomandon agroteknika për ujitje.

Mobilizohuni për një pjesëmarrje më aktive të të gjitha forcave të afta për punë, për ndërtim, për mirëmbajtjen dhe administrimin e mirë të të gjitha veprave të bonifikimit dhe të ujitjes, qofshin këto me karakter nacional ose lokal, pasi këto vepra, për të cilat shteti ka shpenzuar miliarda lekë, janë për të mirën tuaj, për të mirën e ekonomisë bujqësore, në interes të përgjithshëm të ekonomisë popullore.

7. — Të kuptohet drejt përgjegjësia e madhe që ju takon për shfrytëzimin e plotë të të gjitha rezervave në bujqësi, për realizimin e planit të drithërave të bukës dhe të të gjitha prodhimeve të tjera bujqësore e blegtorale. Çdo pakujdesi dhe mosplotësim i detyrave në bujqësi i sjell dëm kooperativës, fshatit, gjithë ekonomisë popullore. Të kuptohen mirë parimet socialiste në lidhje me punën dhe shpërblimin e saj: *Kush punon ha; aq sa ka punuar, aq ka të drejtë të shpërblehet.* Prandaj, bëni të gjitha përpjekjet që të mos mbetet asnjë krah i aftë për punë, asnjë kooperativë ose fshat pa plotësuar në kohën e duhur detyrat e planit, të cilin ju vetë po e hartoni, do ta aprovoni dhe do ta zbatoni.

8. — Bimët industriale (duhani, pambuku, panxhari i sheqerit, lulja e diellit etj.) të vlerësohen si kultura të rëndësishme shumë të nevojshme për sigurimin e lëndës së parë për industrinë, për furnizimin e popullit dhe për eksport. Merrni masa për shtimin e prodhimit të këtyre bimëve që janë shumë të nevojshme për

ekonominë e vendit, duke treguar kujdes të veçantë sidomos për rritjen e rendimenteve për çdo hektar tokë.

9. — I kushtoni vëmendje të veçantë shtimit të sipërfaqes e të rendimentit të patates, e cila është ushqim nga më të rëndësishmit për popullin. Patatja, kjo bimë kaq e vlefshme, gjen kushte të përshtatshme rritjeje e zhvillimi në të gjithë vendin tonë dhe veçanërisht në zonat malore e kodrinore. Në zonat ku tokat japin prodhime të larta patatesh, në krahasim me çdo kulturë tjetër, mbillni sa më shumë patate, hapni sipërfaqe të gjera tokash të reja për patate në lartësi të përshtatshme për këtë kulturë. Zgjerimi i sipërfaqeve të mbjella me patate, shtimi i rendimentit për hektar dhe i prodhimit të përgjithshëm të patates ka rëndësi për ushqimin e popullit, pasi duke përdorur pataten si ushqim do të kursehet më shumë drithë dhe do të shtohen më shumë prodhimet ushqimore dhe mielli.

10. — Shtimi i prodhimit të perimeve është një detyrë tjetër e madhe që duhet të zgjidhet me sukses nga çdo ekonomi bujqësore. Për perime të freskëta ka nevojë populli, ka nevojë industria dhe eksporti. Sa më shumë perime të prodhohen, aq më mirë do të plotësohen nevojat e masave punonjëse, të industrisë dhe të eksportit me perime. Pra, të mbillen sa më shumë perime, të mbillen sa më shumë lloje perimesh, të ketë perime të freskëta gjatë gjithë vitit në vendin tonë.

11. — *Krediti që i jep shteti fshatarësisë duhet të përdoret me niqoqirllëkun më të madh, për të dhënë efektin maksimal ekonomik.* Për këtë është e domosdoshme që kooperativistët dhe gjithë fshatarësia të jenë në dijeni dhe të ndiejnë ndihmat e mëdha e të shumanshme që u jep shteti, të kuptojnë mirë detyrat që kanë për përdorimin me efektivitet të kredive e të ndihmave shtetërore në interes të kooperativës dhe të shoqërisë. *Synimi juaj duhet të jetë që vlerat materiale t'i krijoni në radhë të parë me forcat tuaja.* Shteti edhe në të ardhshmen do të vazhdojë t'i japë fshatarësisë maksimumin e ndihmës së mundshme, por kjo ndihmë nuk mund të jetë veçse faktor i dorës së dytë, *kurse faktori vendimtar për zhvillimin e ekonomisë kooperativiste duhet të jetë vetë puna prodhuese e kooperativistit.*

12. — Duke marrë parasysh se bujqësia është dega bazë e ekonomisë dhe se fshati ka gjithmonë nevojë për krahë pune, është e domosdoshme që masat punonjëse në fshat të lidhen ngushtë me punën, me ekonominë bujqësore, të frenohet lëvizja e popullsisë nga fshati në qytet, në mënyrë që të ndalohet edhe rritja mekanike e popullsisë së qytetit.

13. — Vini të gjitha forcat dhe aftësitë tuaja për organizimin e mirë të punës kolektive, për forcimin ekonomik dhe organizativ të kooperativave bujqësore, *për të zbatuar rregullat e marrëdhënjëve socialiste në prodhim, për të zhdukur mbeturinat mikrobor-*

gjeze në ndërgjegjen e njerëzve të cilat dëmtojnë interesat e kolektivit. Kjo punë e vazhdueshme, sistematike, e kujdesshme, që duhet të bëhet nga ju të gjithë, do të revolucionarizojë shpirtërat e njerëzve, do të ngrëjë në një shkallë më të lartë demokracinë në kooperativat bujqësore, për të gjallëruar mbledhjet e asamblesë së kooperativës dhe format e tjera të drejtimit, të cilat duhet të perfeksionohen në mënyrë që *asambletë të kthehen në një tribunë revolucionare e luftarake, ku të shqyrtohen, të gjykohen e të vendosen përfundimisht të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me interesin e kolektivit* dhe të mos mbetet gjykimi i këtyre çështjeve vetëm në dorën e disa personave. Çdo gjë të kryhet nën drejtimin dhe kontrollin e rreptë të masës së kooperativistëve.

PUNONJËS TË NDËRMARRJEVE BUJQËSORE, BLEGTORALE, SHTETËRORE, PUNONJËS TË SMT-ve, TË EKONOMISË PYJORE DHE TË EKONOMISË UJORE,

14. — Juve, Partia dhe populli ju kanë besuar detyrën të punoni dhe ta bëni ekonominë, që ju është ngarkuar shembull nga i cili mund të mësojë fshatarësia jonë mbi metodat e përparuara në bujqësi, të shohë dhe të mësojë mbi zbatimin e teknikës dhe të shkencës së përparuar bujqësore, mbi epërsinë e ekonomisë bujqësore socialiste intensive. Nga puna juaj të mësojnë kooperativistët se çfarë mund të bëjë secili për ta kthyer ekonominë bujqësore në ekonomi intensive me rentabilitet të lartë.

Mobilizohuni me të gjitha forcat për t'i dhënë *sa më shumë* prodhime bujqësore e blegtorale ekonomisë sonë. Shfrytëzoni në maksimum rezervat e mëdha që ekzistojnë në ndërmarrjet ku ju punoni. Me punën tuaj tregoni se si mund të arrihen tregues *sa më të lartë cilësorë*. Zbatoni me përpikmëri kodin agroteknik, shfrytëzoni racionalisht fondin e tokës, përdorni me nikoqirllëk ujin për ujitje dhe plehun.

Mbroni, shtoni dhe shfrytëzoni me kriter pasurinë pyjore dhe kullotat.

Shfrytëzoni kapacitetet e të gjithë traktorëve e maqinerive të tjera bujqësore, rritni shkallën e mekanizimeve të proceseve të punës, mbani gjithmonë në gatishmëri mekanikën bujqësore.

Forconi kudo disiplinën dhe ngrini shkallën e organizimit të punës për të treguar epërsinë e ekonomisë socialiste shtetërore. Bëhuni shembull dhe, me punën tuaj, ndikoni për përparimin e gjithanshëm të fshatit tonë.

SHOKË DHE SHOQE PUNONJËS TË INDUSTRIËSË, TË NDËRTIMIT, TË TRANSPORTIT, TË SHËRBIMEVE, TË ARËSIMIT, KULTURËS DHE SHËNDETËSISË

Një zhvillim të mëtejshëm në planin e katërt pesëvjeçar 1966—1970 do të marrin gjeologjia, minierat dhe degët e tjera të industrisë, ndërtimet, transporti, të gjitha degët e sferës së prodhimit material, të qarkullimit, të shërbimeve. Plani i ri parashikon gjithashtu një rritje të rëndësishme dhe një zhvillim të gjerë të shkollave, të kulturës dhe të shëndetësisë.

Komiteti Qendror dhe Këshilli i Ministrave u bëjnë thirrje gjithë punonjësvë, kolektivave, ndërmarrjeve e institucioneve, gjithë klasës sonë punëtore dhe inteligjencies popullore që gjatë punës për hartimin, shqyrtimin dhe për aprovimin e shifrave të planit të katërt pesëvjeçar ta përqëndrojnë vëmendjen dhe kujdesin e tyre në detyrat e mëposhtme:

1. — Të shtohet prodhimi industrial në bazë të shfrytëzimit *sa më të plotë e maksimal të kapaciteteve prodhuese ekzistuese dhe të përvetësimit sa më të shpejtë të veprave të reja*. Të sigurohet një pjesëmarrje sa më e gjerë e masave dhe të përkrahen iniciativat e mendimet krijuese të punëtorëve, të personelit inxhiniero-teknik dhe të kuadrove drejtues administrativë, për të ngritur sa më shumë, kryesisht me forcat tona, reparte, punishte e fabrika për përpunimin e lëndëve të para. Kriteri kryesor i përcaktimit të detyrave të planit të jetë *përgjithësimi i eksperiencës së përparuar* duke planifikuar treguesit e ndryshëm tekniko-ekonomikë në bazë të *mesatares progresive* të niveleve të arritura nga reparte, brigada e skuadra që janë në kushte të krahasueshme brenda një ndërmarrjeje dhe jo më ulët se niveli mesatar i ndërmarrjes më të përparuar të krahasueshme. Gjithashtu, kini parasysh të planifikoni të gjithë maqinerinë në inventar, shfrytëzimin e saj racional, rritni koeficientin e turnit, shfrytëzoni në maksimum kohën e punës etj.

2. — Për sektorin e minierave dhe të gjeologjisë të merren masa për të rritur efektivitetin ekonomik të investimeve për të vënë në shërbim të ekonomisë popullore pasuritë e nëntokës me anën e zbulimit të vendburimeve të reja dhe rritjes në kategori industriale të rezervave të mineraleve të dobishme, të rritet koha produktive e sondave në shpim. Shtoni nxjerrjen e mineraleve duke shpejtuar e harmonizuar ritmet e shfrytëzimit me punimet minerare e të zbulimit. Në industrinë e naftës rritni fondin e pusëve në shfrytëzim, intensifikoni nxjerrjen e naftës me metoda të përparuara, shpejtoni punën e përvetësimeve si dhe vënjen e pusëve në shfrytëzim. Në industrinë elektrike siguroni furnizimin e pandërprerë të ekonomisë popullore me energji duke shfrytëzuar e kombinuar më mirë punën e hidrocentraleve dhe termoelektrocen-

traleve, duke u dhënë prioritet hidrocentraleve, uljes së humbjeve në rrjet si dhe përmirësimin e koeficientit të fuqisë. Në industrinë e lëndës së drurit tregoni vëmendje të posaçme për plotësimin e nevojave të ekonomisë duke përdorur sa më racionalisht ekonominë pyjore dhe lëndën drusore. Në industrinë mekanike shfrytëzoni në maksimum maqinerinë metalprerëse, rritni gamën e prodhimit të pjesëve të këmbimit e të pajisjeve industriale e bujqësore duke pasur parasysh kooperimin dhe specializimin. Në industrinë e lehtë dhe ushqimore shtoni asortimentin e prodhimeve për t'ju përgjegjur më mirë nevojave, kërkesave e shijeve të konsumatorëve, përpunoni në kohë të gjitha produktet bujqësore e blegtorale duke zgatur ciklin e punës.

3. — Vendosni rregull të fortë në shpërndarjen dhe përdorimin e të ardhurave kombëtare, në mënyrë që akumulimi të shërbejë për fuqizimin e mëtejshëm të ekonomisë së sferës prodhuese, duke kryer investime e ndërtime *sa më rentabile*, të kohës dhe të domosdoshme.

4. — Organizoni punën në mënyrë të tillë që çdo vepër të fillojë të ndërtohet në rregull dhe të përfundojë në kohë sa më të shkurtër. Ndërtimi i objekteve të na shërbejë si shkollë për përgatitjen e specialistëve për vepra më të mëdha që na presin në të ardhshmen. Punoni me të njëjtin ritëm, pa ndërprerje të punës, gjatë gjithë muajve të vitit.

5. — Në transport, përmirësoni koeficientin e gatishmërisë teknike të mjeteve, shfrytëzoni me kujdes të gjitha llojet dhe mjetet e transportit, luftoni që çdo mjet transporti, dhe sidomos në autotransport, të realizojë planin. Merrni masa për të ulur kohën inproduktive gjatë ngarkim-shkarkimit të mjeteve të transportit.

6. — I kushtoni kujdes të veçantë kryerjes me kohë dhe mirë të shërbimeve popullit, duke zgjeruar aktivitetet ekzistuese dhe duke organizuar aktivitete të reja nga të gjitha ndërmarrjet dhe organizatat ekonomike që merren me një punë të tillë.

Në sektorin komunal, mirëmbani dhe administroni më mirë banesat dhe ambientet e përbashkëta, i bëni problemet komunale probleme të të gjithë popullit. Synoni që me të ardhurat të mbulonit shpenzimet dhe të siguronit gradualisht amortizimin e tyre.

Në artizanatin e kooperuar, nxitni iniciativën e vetëveprimit për zgjerimin e shërbimeve për të plotësuar më mirë dhe më shpejt nevojat e përditshme të popullit.

7. — Në fushën e arësimit, të kulturës, shkencës dhe arteve, bëni përpjekje të mëtejshme për të thelluar më tej revolucionin ideologjik e kultural, për të kalitur njeriun e ri, zhvillonit arësimin popullor në përshtatje me nevojat e reja të vendit, lidhni sa më shumë shkollën me jetën, të mësuarit me punën

praktike, për të forcuar shkollën tonë në mënyrë të gjithanshme edhe nga pikëpamja cilësore.

Bëjini kulturën dhe artin çështje të masave popullore, zhvillonit më tej punën kërkimore shkencore në dobi të prodhimit. I kushtoni kujdesin e duhur zhvillimit të mëtejshëm të kulturës fizike dhe sportive, për përgatitjen e brezit të ri të aftë për punë e për mbrojtje.

8. — Në sektorin e shëndetësisë, vini të gjitha energjitë për të kryer me ndërgjegje detyrën e lartë humanitare të ruajtjes dhe forcimit të shëndetit të popullit. Përhapni më gjerë e më thellë masat higjieno-profilaktike dhe shfrytëzoni në maksimum të gjitha mundësitë që ju janë krijuar për të ngritur në një shkallë më të lartë nivelin dhe kulturën e shërbimit shëndetësor. Ngrini vazhdimisht aftësitë tuaja profesionale, njihni, përvetësoni dhe zbatoni me kujdes e iniciativë të reja e shkencës mjekësore dhe përhapni eksperiencën e punës së mirë të institucioneve tona mjekësore.

9. — Të bëhet kthesë rrënjësore në drejtim të përmirësimit të cilësisë së prodhimit, të ndërtimit e të shërbimit, luftoni që të vihet plotësisht në jetë parimi socialist i shpërblimit të punonjësve «*sipas sasisë dhe cilësisë së punës*» efektivisht të kryer.

10. — Shqyrtimi i shifrave kryesore të projektplanit të katërt pesëvjeçar të karakterizohet nga një frymë e thellë revolucionare në ruajtjen e pronës socialiste, në kursimin e përdorimit të vlerave materiale e monetare, në rritjen e rendimentit të punës dhe rentabilitetit, për një regjim të rreptë kursimi dhe disiplinë të shëndoshë socialiste në punë.

Kini parasysh që jo vetëm t'u përmbaheni kuotave të importit, por edhe t'i ulni ato; rritja e mëtejshme e prodhimit mbi kuotat e parashikuara të arrihet *pa shtuar* investimet e ndërtimit.

Normativat e përdorimit të lëndëve të para e të materialeve të planifikohen *jo më të larta* se mesatarja progresive e arritur në fakt duke pasur për synim vendosjen e normativave teknike.

Të ulen në maksimum firot që krijohen në procesin e prodhimit industrial e bujqësor si dhe gjatë transportimit e depozitimit të mallrave.

Në këtë frymë shikoni *shkurtimin e shpenzimeve administrative* dhe rritjen e efektivitetit të institucioneve social-kulturale, për t'i bërë ato *sa më pak të kushtueshme* për shtetin dhe sa më të dobishme për popullin duke ulur në maksimum shpenzimet.

11. — Të përgatitim kuadro luftarakë të aftë dhe me ndërgjegje të lartë për ndërtimin e socializmit, shërbyes të devotshëm të popullit, të gatshëm për të punuar *në çdo vend* ku e do interesi i shoqërisë sonë socialiste.

12. — Komiteti Qendror i Partisë dhe Këshilli i Ministrave

u bëjnë thirrje të gjithë ushtarakëve, për të shkurtuar shpenzimet dhe për të siguruar shumë lloj prodhimesh bujqësore e blegtorale, për ta bërë sa më pak të kushtueshme mbajtjen e forcave të armatosura.

SHOKË DHE SHOQE,

Komiteti Qendror i Partisë dhe Këshilli i Ministrave u bëjnë thirrje të gjitha organeve dhe organizatave të Partisë, të gjitha dikastereve dhe institucioneve qendrore, të gjitha organeve dhe organizatave shtetërore, ekonomike, arësimore e kulturalë, të gjitha organizatave të masave në qendër dhe në rreth, të gjithë punonjësve të fshatit e të qytetit, të gjithë ushtarakëve dhe komandave të tyre që, në punën e madhe për hartimin e planit të katërt pesëvjeçar, të kenë në qendër të vëmendjes së tyre dhe të konsiderojnë si një nga detyrat më kryesore njohjen, zberthimin dhe reflektimin e këtyre orientimeve, me qëllim që të zbulohen e të planifikohen të gjitha mundësitë njerëzore, materiale e financiare të vendit për të bërë kështu një plan të drejtë, real, mobilizues dhe revolucionar.

SHOKË DHE SHOQE, DREJTUES TË EKONOMISË DHE TË KULTURËS,

Në punën tuaj për planifikimin dhe realizimin e detyrave punoni bashkë me popullin. Dëgjoni me vëmendje zërin e tij dhe në çdo hap që bëni mbështetuni te populli. Forca e kolektivit të bëhet mbështetja kryesore në luftën kundër çdo gjëje që është e papajtueshme me frymën revolucionare socialiste të shoqërisë sonë. Kështu mund të kryhen me sukses detyrat dhe të kapërcehen vështirësitë e rritjes dhe ato të krijuara nga bllokada e armiqve të Partisë e të popullit tonë.

Faktor vendimtar në realizimin e detyrave që do të shtrojë plani i katërt pesëvjeçar është puna e palodhur dhe e vazhdueshme e Partisë për edukimin ideo-politik të masave punonjëse, për kalitjen e ndërgjegjes socialiste të njerëzve. Në këtë drejtim roli i komunistëve është i madh. Ata duhet të jenë shembulli më i mirë, ata duhet të jenë pararoja në punë dhe në jetë. Puna edukative, politike dhe ideologjike duhet të lidhet konkretisht me punën ekonomike, me qëndrimin dhe veprimin e përditshëm të secilit dhe kjo të pasqyrohet në rezultatet e arritura. Ajo duhet të arrijë që t'i bëjë të gjitha masat punonjëse luftëtare aktive që jo vetëm të kryejnë mirë detyrat e tyre, por edhe të luftojnë e të mos rrinë indiferente ndaj të metave e gabimeve të të tjerëve. Duhet të luftohen shfaqjet e huaja të qëndrimit antisocialist, si në vendin e punës ashtu edhe jashtë punës, në shoqëri dhe në jetë. Shoqëria

jonë socialiste ka nevojë për luftëtarë aktivë, të cilët jo vetëm që kryejnë mirë detyrat që u ka ngarkuar shoqëria, por njëkohësisht veprojnë në mënyrë aktive për të bërë që edhe të tjerët t'i kryejnë mirë detyrat e tyre.

Puna e Partisë për edukimin komunist të njerëzve duhet të synojë në krijimin e njeriut të ri, që e konsideron pasurinë socialiste si pasuri të shenjtë të popullit dhe e mbron atë deri në fund nga çdo keqbërës. Njeriu i ri që po formohet në vendin tonë nuk duhet të bjerë në vetëkënaqësi, por të synojë që të shkojë kurdoherë përpara.

Populli ynë, si deri tani, edhe në pesëvjeçarin e katërt do të ketë ndihmën e madhe vëllazërore të popullit të madh dhe revolucionar kinez. Republika Popullore e Kinës për pesëvjeçarin e katërt i ka akorduar vendit tonë një kredi të re, më të madhe se në pesëvjeçarin e tretë, në bazë të së cilës do të ndërtohen në vendin tonë vepra të plota industriale, do të dërgohen nga Kina pajisje e materiale të ndryshme dhe do të na jepet prej saj ndihma teknike e nevojshme. Populli ynë do t'i jetë mirënjohës për jetë popullit të madh kinez për këtë ndihmë internacionaliste. Ne, si kurdoherë, duhet të tregohemi të denjë për këtë ndihmë të madhe dhe të mobilizohemi për ta përdorur atë sa më racionalisht.

Komiteti Qendror i Partisë dhe Këshilli i Ministrave kanë besim të plotë se i gjithë populli ynë i kupton drejt këto porosi dhe do t'i vërë, si kurdoherë, plotësisht në jetë.

Në të gjithë punën tonë për ndërtimin e socializmit ne duhet të udhëhiqemi nga parulla jonë themelore: «TË PUNOJMË MË SHUMË E MË MIRË, QË TË PRODHOJMË MË SHUMË, MË MIRË DHE MË LIRË, QË TË MUND TË JETOJMË MË MIRË».

Komiteti Qendror i Partisë dhe Këshilli i Ministrave janë thellësisht të bindur se organet dhe organizatat e Partisë, shtetërore, ekonomike dhe shoqërore, e gjithë Partia, mbarë populli ynë i mrekullueshëm, në unitet të plotë moralopolitik, do të plotësojnë, si gjithnjë, me nder detyrat e mëdha që shtrohen për diskutimin, hartimin dhe realizimin e shifrave të planit të katërt pesëvjeçar për të bërë një hap tjetër të madh e të sigurtë në rrugën e ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste në vendin tonë.

KËSHILLI I MINISTRAVE I
REPUBLIKËS POPULLORE
TË SHQIPËRISË

KOMITETI QENDROR
I PARTISË SË PUNËS TË
SHQIPËRISË

Botohet sipas gazetës
«Zëri i Popullit» Nr. 255,
24 tetor 1965

PLENUMI XV I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Tiranë, 25—26 tetor 1965

KOMUNIKATË

MBI MBLEDHJEN E PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Nga 25 deri 26 tetor 1965, nën drejtimin e Sekretarit të Parë të Komitetit Qendror të PPSH, shokut Enver Hoxha, u mbledh Plenumi XV i Komitetit Qendror të PPSH, i cili dëgjoi raportin e Byrosë Politike të Komitetit Qendror të PPSH «Mbi rritjen e rolit të letërsisë dhe arteve për edukimin komunist të masave», mbajtur nga anëtari i Byrosë Politike dhe sekretar i Komitetit Qendror të PPSH, shoku Ramiz Alia.

Plenumi diskutoi gjerësisht rreth raportit dhe e aprovoi atë njëzëri.

Në përfundim të punimeve të plenumit, Sekretari i Parë i Komitetit Qendror të PPSH, shoku Enver Hoxha, mbajti një fjalim të rëndësishëm, ku theksoi disa probleme themelore të punës së Partisë në fushën e letërsisë dhe të arteve.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

RAPORT

I BYROSË POLITIKE TË KQ TË PPSH «MBI RITJEN E ROLIT TË LETËRSISË DHE ARTEVE PËR EDUKIMIN KOMUNIST TË MASAVE»

25 tetor 1965

Shokë,

Partia gjithnjë i ka kushtuar një kujdes të veçantë forcimit të punës ideologjike për edukimin komunist të masave dhe për mobilizimin e tyre në luftën për ndërtimin e socializmit. Kongresi IV i Partisë shtroi një program të gjerë me afat të gjatë në këtë drejtim. Duke u mbështetur në orientimet e kongresit, Komiteti Qendror dhe Byroja Politike kanë bërë përpunimin dhe konkretizimin e shumë çështjeve ideologjike, si rezultat i të cilave është ngritur në një nivel më të lartë veprimtaria e Partisë në të gjitha fushat, ideologjike, politike dhe ekonomike.

Diskutimi, në këtë plenum, i problemeve që kanë lidhje me rritjen e mëtejshme të rolit të letërsisë dhe të arteve për edukimin komunist të masave, do ta forcojë edhe më shumë punën dhe luftën ideologjike të Partisë dhe do të sigurojë edhe më mirë një zhvillim të drejtë të letërsisë e të arteve tona, në mënyrë që të rritet funksioni i tyre si armë të fuqishme në duart e Partisë për edukimin e punonjësve në frymën e socializmit e të komunizmit.

Në kushtet e socializmit, nën udhëheqjen e Partisë, letërsia dhe artet tona kanë arritur suksese të mëdha. Vetëm dhjetë vjet më parë, për të mos shkuar më tej ne merreshim akoma me problemin e mësuesve të nevojshëm për shkollat fillore, përsëhëdënim romanet e para të letërsisë sonë të re, apo shqyrtonim mundësitë për zhvillimin e ardhshëm të kinematografisë dhe të operës shqiptare. Kurse sot ne kemi Universitetin shtetëror dhe shkojmë drejt krijimit të akademisë së shkencave, botojmë disa romane në vit, organizojmë ekspozita të rëndësishme të arteve figurative, shfaqim me sukses filmat tanë, kemi konservatorin, operat dhe baletet tona kombëtare. Gjatë vjetëve të pushtetit popullor kanë marrë një zhvillim të madh jo vetëm poezia, tregimi, kënga, piktura e skulptura, por u hodhën bazat e muarën një zhvillim të shpejtë edhe gjini të tilla letrare artistike, të patrajtuara, ose të trajtuara shumë pak në të kaluarën, si romani, drama, muzika simfonike, opera e baleti, artet grafike e dekorative, kinematografia etj. Pak shifra mund të shërbejnë për të krijuar një ide të

saktë mbi krijimtarinë tonë letraro-artistike. Vetëm në pesë vjetët e fundit te ne janë botuar 19 romane, 43 vëllime me poezi, 39 vëllime me tregime, janë vënë në skenë 30 drama, 3 opera, 2 balet klasike, janë kompozuar 22 vepra simfonike, janë hapur 15 ekspozita të arteve figurative etj. Të gjitha këto janë frut i punës së talentuar të shkrimtarëve e artistëve tanë, numri i të cilëve tani i kapërcen të 200 vetët.

Por rezultati më i madh që është arritur në fushën e letërsisë dhe arteve është fakti se ato, duke ecur në traditat më të mira patriotike e demokratike të së kaluarës, u vunë në rrugën e realizmit socialist, u bënë plotësisht letërsi dhe arte socialiste. Në këtë rrugë janë krijuar te ne vepra me vlerë të shquar artistike, mjaft nga të cilat kanë hyrë në thesarin e kulturës sonë kombëtare krahas vlerave më të mira të saja. Ato dallohen për trajtimin e problemeve të mëdha të jetës sonë shqiptare, për krijimin e një sërë tipash dhe ambientesh shqiptare. Në to pasqyrohet drejt e me vërtetësi e kaluara historike e popullit, Lufta nacional-çlirimtare, heroizmi e patriotizmi i tij, pasqyrohen transformimet e mëdha revolucionare, lufta për ndërtimin e socializmit, përshkruhet me realizëm triumfi i së resë mbi të vjetrën në jetën e shoqërisë sonë dhe në ndërgjegjen e njerëzve tanë.

Karakteristika themelore që dallon letërsinë dhe artet tona të reja është pastërtia ideologjike, fryma luftarake e revolucionare që i përshkon ato si dhe fryma e shëndoshë kombëtare. Letërsia dhe artet tona janë bërë një mbështetje e shëndoshë e Partisë për mobilizimin e masave punonjëse në luftën për ndërtimin e socializmit, për kalitjen e njeriut të ri, në luftën për mbrojtjen e pastërtisë së ideologjisë sonë marksiste-leniniste dhe të pavarësisë e sovranitetit të atdheut socialist.

Komiteti Qendror i Partisë përgëzon shokët shkrimtarë, kompozitorë, piktorë e skulptorë, gjithë inteligjencien artistike për punën fisnike e shumë të dobishme që kanë bërë, për rezultatet e arritura në punën e tyre. Komiteti Qendror u uron që edhe në të ardhshmen të krijojnë vepra të reja më të bukura e më të frymëzuara, që t'i shërbejnë edhe më mirë qështjes së Partisë e të popullit.

Partia dhe qeveria kanë marrë dhe do të marrin të gjitha masat e nevojshme për t'u dhënë njerëzve të artit e të letërsisë gjithë ndihmën e përkrahjen për zhvillimin dhe lulëzimin e artit e të letërsisë sonë socialiste. Krijimi i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe të Artistëve dhe i organeve të shtypit letrar e artistik, zgjerimi i madh i botimeve të letërsisë origjinale e të përkthyer, ngritja e shumë teatrove të dramës, operës e baletit dhe të estradës, theme-

limi i shkollave të larta artistike, caktimi i fondeve përherë e më të mëdha për zhvillimin e kulturës popullore, të gjitha këto, flasin qartë për kujdesin e pandërprerë të Partisë dhe qeverisë që letërsia dhe artet të ecin përpara me hapa të shpejtë.

Në periudhën e re historike të ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste, krahas zhvillimit të vullshëm të forcave prodhuese dhe perfeksionimit të mëtejshëm të marrëdhënjeve shoqërore socialiste, si detyrë themelore shtrohet edhe ngritja e shkallës së ndërgjegjes socialiste të punonjësve, thellimi i mëtejshëm i revolucionit ideologjik e kultural. Në këtë drejtim një rol vendimtar luan zhvillimi i mëtejshëm i arteve dhe i letërsisë, të cilat duhet të luftojnë me të gjitha forcat e mjetet për të kryer me sukses funksionin e tyre të lartë shoqëror-edukativ si armë të fuqishme për edukimin e njeriut të ri me idealet e socializmit dhe me parimet e moralit komunist.

Forcimi i rolit të arteve dhe të letërsisë për edukimin komunist të masave diktohet gjithashtu edhe nga fakti se janë rritur e rriten vazhdimisht kërkesat e njerëzve tanë për kulturë, për më shumë vepra letrare e artistike dhe të një niveli më të lartë. Revolucioni ideologjik e kultural që po zhvillohet me sukses në vendin tonë jo vetëm i nxori punonjësit nga errësira ku i kishin lënë për shekuj klasat shfrytëzuese e regjimet e tyre reaksionare, por i bëri të aftë për një jetë të pastër intelektuale e shpirtërore. Kultura, arti, letërsia janë bërë tani pronë e gjerë e popullit. Në çdo katër vetë njëri ndjek shkollën. Janë me mijëra kadro të mesëm e të lartë që mbushin çdo vit radhët e punonjësve e të inteligjencies sonë. Punonjësit tanë presin nga njerëzit e artit e të letërsisë vepra të reja me përmbajtje të thellë e me formë të lartë artistike, që t'u përgjigjen nivelit të tyre kultural, kërkesave ideologjike dhe shijeve të tyre estetike të zhvilluara. Dhe gjendja e letërsisë dhe e arteve tona, sukseset dhe pjekuria që ato kanë arritur janë të tilla që e bëjnë të mundshëm realizimin e një hopi të ri cilësor përpara, ngritjen e letërsisë dhe të arteve në një shkallë edhe më të lartë e më të përparuar.

Në mënyrë të veçantë kjo nevojë është e lidhur me luftën për përmirësimin e edukimit ideo-estetik, dhe përgjithësisht të edukimit komunist të brezit të ri. Rinia përfaqëson lexuesin më masiv dhe të etshëm të letërsisë artistike, ajo është një dashamirëse e apasionuar e gjithë artit dhe kulturës sonë të re. Te rinia çdo ditë lindin e zhvillohen dëshira dhe kërkesa të reja në përshtatje me kushtet dhe mundësitë që krijon shoqëria socialiste. Letërsia dhe artet duhet t'u përgjigjen më mirë se deri tani këtij niveli dhe këtyre kërkesave të brezit të ri. Në të njëjtën kohë ato duhet të qëndrojnë në radhët e para të luftës për të edukuar një rini të pastër ideologjikisht e moralisht, me shije të shëndosha komuniste. Ato duhet të ndihmojnë rininë që të formojë imunitetin e

nevojshëm ideologjik e moral kundër helmit të ideologjisë borgjeze dhe revizioniste, të ndihmojnë aktivisht Partinë për të edukuar një rini revolucionare, të pjekur e të kalitur politikisht.

Krahas këtyre rrethanave të brendshme, ekziston edhe një faktor tjetër shumë i rëndësishëm, që e bën të nevojshëm diskutimin e problemeve të letërsisë e të arteve në këtë Plenum të Komitetit Qendror. Ky faktor është ashpërsimi i luftës ideologjike me imperializmin e revizionizmin.

«Sot në botë zhvillohet një luftë e ashpër midis marksizëm-leninizmit dhe ideologjisë borgjeze e gjithë shfaqjeve të saja për të pushtuar mendjet e njerëzve»¹.

— tha shoku Enver Hoxha në Kongresin IV të Partisë. Kanë kaluar më se katër vjet që atëhere dhe ne të gjithë jemi dëshmitarë se kjo luftë ka ardhur duke u ashpërsuar jo vetëm në fushën e politikës, por edhe në të gjitha fushat e tjera të ideologjisë, në filozofi, në shkencë ekonomike e historike, në letërsi e arte etj.

Revizionistët modernë, këta shërbëtorë besnikë të imperializmit dhe tradhëtarë të revolucionit e të socializmit, sulmojnë bazat e marksizëm-leninizmit në të gjitha drejtimet, pra edhe në fushën e letërsisë e të arteve, sulmojnë bazat e estetikës marksiste-leniniste, parimet themelore mbi krijimin e kulturës së socialiste nga përmbajtja e kombëtare nga forma, të përpunuara nga Marksia, Engelsi Lenini e Stalini dhe të vërtetuara nga eksperiencia e ndërtimit socialist. Ideologët borgjezë dhe shërbëtorët e tyre revizionistë predikojnë haptazi ose fshehur bashkekzistencën ideologjike, zvogëlojnë ose mohojnë funksionin dhe rolin e artit në shoqëri, përpiqen t'i heqin artit socialist karakterin revolucionar, frymën e optimizmit e të entuziazmit, të lëkundin besimin e masave në fitoren e komunizmit. Punonjësit e krijimtarisë sonë artistike duhet të mprehin gjithnjë e më shumë vigjilencën, të forcojnë luftën për mbrojtjen e pozitave revolucionare të artit socialist nga shtrembërimet revizioniste dhe të shumëfishojnë përpjekjet për konsolidimin e lulëzimin e mëtejshëm të letërsisë dhe të arteve tona.

Në këto rrethana të brendshme e ndërkombëtare, me këtë nivel që kanë arritur arti dhe letërsia jonë, sot shtrohet me forcë të madhe detyra që ato, si armë të rëndësishme në duart e Partisë, të mprehin edhe më shumë, të zhvillohen në gjerësi e të ngrihen në cilësi, të rritet roli i tyre në jetën e shoqërisë sonë, të bëhen mjete për frymëzimin e punonjësve për vepra të mëdha e heroike, për edukimin komunist me frymën klasore revolucionare

¹ Enver Hoxha. Raport mbi aktivitetin e Komitetit Qendror të PPSH, Kongresi IV i PPSH, f. 150. Tiranë, 1961.

dhe për mobilizimin e tyre në luftë për ndërtimin e plotë të socializmit, për mbrojtjen e atdheut e për triumfin e marksizëm-leninizmit.

Del qartë se zhvillimin e mëtejshëm të letërsisë dhe të arteve, thellimin e brendisë së tyre luftarake e revolucionare, Partia i shikon si mjete të fuqishme të të gjithë procesit të edukimit komunist. Për këtë ne synojmë ta vëmë edukimin estetik edhe më mirë në shërbim të edukimit ideo-politik dhe ideo-moral të masave, e në mënyrë të veçantë të brezit të ri, në shërbim të edukimit me dashurinë e pakufishme ndaj atdheut socialist dhe çështjes së revolucionit, me frymën klasore dhe revolucionare, me shpirtin e sakrificës e të vetëmohimit, me vetitë e pastra morale. Për të gjitha këto arësye problemet e edukimit ideo-estetik marrin tani një rëndësi të madhe dhe janë nga problemet më aktuale e më të mprehta të gjithë çështjes së edukimit komunist, të gjithë luftës sonë për formimin dhe kalitjen e njeriut të ri komunist.

Për një krijimtari letraro-artistike militante për çështjen e socializmit

Letërsia dhe artet në këta 21 vjet të Shqipërisë socialiste, duke ju përmbajtur parimit leninist të partishmërisë, kanë luajtur gjithnjë e më shumë një rol të madh transformues në jetën e shoqërisë sonë, janë bërë një armë efektive në luftën e masave punonjëse për socializëm. Konsolidimi i mëtejshëm i këtyre pozitave është garancia më e sigurtë që në të ardhshmen letërsia dhe artet të militojnë edhe më aktivisht për vijën e Partisë, për idealin e socializmit e të komunizmit.

Cilat janë problemet themelore që dalin para letërsisë dhe arteve në këtë fazë të zhvillimit të tyre, në mënyrë që ato të përmbushin me sukses misionin që kanë?

Pasqyrimi më i gjerë e më i thellë i luftës, i jetës dhe i punës së popullit, i idealeve dhe i aspiratave të tija, i aktualitetit, është problemi kryesor që duhet të tërheqë vëmendjen e shkrimtarëve e të artistëve tanë.

Në këtë drejtim letërsia dhe artet tona, në rrugën e zhvillimit të tyre, kanë fituar një eksperiencë të mirë, e cila duhet të shërbejë shumë për të ardhshmen. Gjatë këtyre 21 vjetëve të pasqyritimit ato janë marrë gjerësisht me pasqyrimin e ndryshimeve të mëdha revolucionare që kanë ndodhur te ne, me problemet tona më preokupante. Ato janë frymëzuar nga idetë e mëdha komuniste. Në to janë shprehur tiparet themelore të njeriut të ri të shoqërisë sonë socialiste.

Për të ilustruar këtë të vërtetë të pamohueshme mjafton të

shikojmë vendin që zë në letërsinë dhe në artet tona tema e Luftës nacional-çlirimtare, e cila, për rëndësinë e madhe që ka në edukimin patriotik e revolucionar të masave, nuk mund të shkëputet nga tema e përgjithshme aktuale, por mbetet gjithnjë brenda sferës së saj. Kush nuk i njeh veprat më të mira të Shefqet Musarajt apo Dhimitër Shuteriqit, të Fatmir Gjatës apo Kolë Jakovës, të Ali Abdihoxhës apo Petro Markos, të Kristo Konos, Odhise Paskalit apo Nexhmedin Zajmit e të shumë autorëve të tjerë të talentuar, të cilët, me artin e tyre pasqyrojnë me besnikëri heroizmin e popullit në luftën për çlirim? Heronjtë e tyre janë skalitur me aq mjeshtëri e vërtetësi sa çdo ish-partizan apo pjesëmarrës në luftë mund të shohë në ta veten e vet apo shokun e tij.

Transformimeve revolucionare që pasuan çlirimin e vendit, u është kushtuar pjesa më e madhe e krijimeve artistike. Në veprat më të mira të Sterjo Spasses apo të Zihni Sakos, të Llazar Siliqit, të Ismail Kadarese apo të Dritëro Agollit, të Foto Stamos apo të Vilson Kilicës, të Kristaq Ramës apo të Zef Shoshit, të Baki Kongolit apo Preng Jakovës si dhe të gjithë shkrimtarëve e artistëve tanë, si të atyre që prej kohësh kanë vënë talentin në shërbim të popullit, ashtu edhe të atyre që me energji të reja debutojnë në letërsi e arte, i thuret lavdi popullit tonë, i cili me vetëmohim e sakrificë ndërton socializmin. Në këto krijime pasqyrohet me mjeshtëri realiteti i ri socialist, përshkruhet lufta e punonjëseve për rindërtimin e vendit, për industrializimin socialist, për kolektivizimin e bujqësisë, përpjekjet për arësim e kulturë, lufta e ashpër klasore qoftë në planin kombëtar qoftë në atë ndërkombëtar.

Megjithkëtë, nuk mund të thuhet se letërsia dhe artet e kanë kryer plotësisht detyrën e tyre për pasqyrimin e aktualitetit dhe sidomos të realitetit të ditëve tona. Kështu, letërsia, muzika, piktura, skulptura, kinematografia etj., mbeten akoma «borxhlinj» ndaj pasqyrimin të Luftës nacional-çlirimtare, madhështisë dhe heroizmit të kësaj epopeje të lavdishme të popullit tonë. Duke ju përgjegjur kësaj detyre ato do të ndihmojnë që të kalitet edhe më shumë shpirti luftarak e revolucionar i masave të popullit dhe posaçërisht i rinisë, që mbetet gjithnjë një detyrë aktuale dhe shumë e rëndësishme për ne.

Veç kësaj, me gjithë rezultatet që janë arritur në disa gjini të arteve, e veçanërisht në artet figurative, ndërtimi socialist, problemet e mëdha e të rëndësishme që kanë preokupuar e preokupojnë masat punonjëse për ngritjen e jetës së re, nuk e kanë zënë akoma vendin e merituar në letërsi dhe në arte.

Të marrim për shembull vendin që zë në letërsi dhe në artet njeriu i punës. Kjo duhet të jetë temë themelore, kryesore e letërsisë dhe e arteve që militojnë për ndërtimin e socializmit. Për vendin tonë që ndërton socializmin duke dalë nga prapambetja e theksuar ekonomike e kulture, që është i detyruar të luftojë i

rrethuar nga armiq, puna dhe vetëm puna e palodhur e plot vetëmohim e njerëzve tanë është baza e bazave e ecjes sonë përpara.

Për fat të keq, kjo temë nuk ka gjetur akoma pasqyrimin e saj të plotë dhe në aspektet e saj tipike. Mund të themi se janë të pakta ato vepra që e trajtojnë thellë e artistikisht njeriun e punës në të gjithë procesin e jetës e të veprimtarisë së tij, që të frymëzojnë e të mobilizojnë njerëzit, që të rritin patosin e tyre në punë. Po kështu, janë krejt të pamjaftueshme këngët për masat dhe marshet e punës me të cilat punëtorët, fshatarët, rinia jonë heroike të shkojnë plot entuziazëm në frontin e punës, ashtu si dikur me këngët partizane në gojë suleshin e fitonin mbi armiqtë.

Të ndalemi në çështjen e fshatit. Në fshatin tonë, si rrjedhim i kolektivizimit të bujqësisë ka lindur një jetë e re, kanë lindur e janë formuar edhe njerëz të rinj me tipare, me koncepte e me botëkuptime të reja, janë vendosur marrëdhënje të reja shoqërore në të gjitha fushat e jetës. Transformimi socialist i fshatit është një epope e tërë, që vazhdon të shkruhet akoma nga fshatarësia punonjëse. Ky është një proces i ndërlikuar e i gjithanshëm ndryshimesh në jetën ekonomike, politike, sociale e kulture të fshatit mbi baza krejt të reja. Gjithë ky revolucion i madh dhe problemet e gjithanshme të fshatit tonë nuk pasqyrohen në gjithë gjerësinë e thellësinë e tyre në krijimtarinë artistike. Dhe këtu nuk është fjala vetëm për pasqyrimin e asaj që ndodhi dhe në fshatin tonë, gjë që padyshim, ka rëndësi të veçantë, por edhe për ndjekjen e këtij procesi që zhvillohet jo vetëvetiu, por në luftë kundër pengesave e vështirësive të shumta, kundër forcës së zakonit dhe të traditës. Është fjala për pasqyrimin e problemeve aktuale që dalin para fshatarësisë sonë, e luftës që bën Partia për zhvillimin e mëtejshëm të bujqësisë, për zgjidhjen e problemit të madh të sigurimit të bukës, për krijimin e kushteve më të mira social-ekonomike të fshatit etj.

Probleme shumë të rëndësishme lidhur me edukimin e masave shtroi vitin e kaluar Plenumi i korrikut i Komitetit Qendror të Partisë. Ato përbëjnë një nga detyrat më aktuale të Partisë, pra edhe një detyrë themelore për letërsinë dhe për artet tona. Lufta kundër mbeturinave e shfaqjeve të huaja, kundër zakoneve e traditave konservatore, kundër çdo ndikimi të ideologjisë borgjeze e revizioniste, është një luftë e madhe për kryerjen e revolucionit socialist, një formë kryesore e luftës kundër depërtimit të ideologjisë borgjeze e revizioniste që është pararoja e kundërrevolucionit politik.

Gjithë këtë luftë dhe gjithë këto transformime në fushat më të ndryshme të jetës së popullit tonë letërsia dhe artet duhet t'i paraqesin denjësisht në vepra artistike, që t'u flasin ndjenjave të njerëzve, mendjeve e zemrave të tyre, t'i emocionojnë masat, t'i frymëzojnë e t'i mbushin me guxim, me vendosmëri e me besim në forcat e veta.

Punonjësit tanë të krijimtarisë janë të gjithë të mendimit se në qendër të vëmendjes së letërsisë dhe të arteve duhet të jetë tema aktuale. Në fakt krijimtaria jonë letraro-artistike, siç e thamë më lart, tregon se shkrimtarët dhe artistët i janë drejtuar vazhdimisht temës së ditëve tona, por megjithkëtë në veprat e tyre ata shpeshherë e përshkruajnë zbehtë jetën e sotme.

Ku qëndron vështrësia? Në radhë të parë, në mosnjohjen e thellë të jetës dhe të proceseve të zhvillimit të saj, në moskapjen e asaj që është kryesore në procesin e jetës, sidomos të dallimit të asaj që është e re dhe që përfaqëson tendencën përparimtare të fenomeneve. Epoka jonë është epoka e përmbysjeve, e transformimeve të mëdha revolucionare, u përmbys një rend i tërë me prapambetjen e tij ekonomike e kulture, me marrëdhënjet e tija feudale e borgjeze, me botëkuptimin e konceptet e tij mikro-borgjeze dhe lindi një rend i ri, një njeri i ri me ndërgjegje të re e me pikëpamje të reja. Shkrimtari dhe artisti duhet t'i njohin e t'i shprehin këto ndryshime me artin e tyre. Sigurisht, kjo nuk është e lehtë, përkundrazi, është shumë e vështirë. Por pikërisht këtu qëndron edhe merito e detyra e tyre, të zbulojnë e të paraqesin para lexuesve e spektatorëve fenomenet që tregojnë si shembet e vjetra e lind e reja të ne. Por këto fenomene shpesh janë të pleksura. Ashtu siç i duhet gjeologut të futet thellë në shtresat e tokës për të gjetur metalet e rralla, ashtu i duhet edhe shkrimtarit dhe artistit të hyjnë thellë në jetën e popullit, ta njohin atë nga të gjitha anët, të futen thellë në procesin e në kontradiktat e saja, me qëllim që të dallojnë atë që është e re, përparimtare, socialiste në jetën tonë nga ajo që është e vjetër, reacionare e borgjeze, të luftojnë me këmbëngulje për afirmimin e triumfin e së resë mbi të vjetrën duke hyrë në luftë të hapur e të pamëshirshme me këtë.

Shkrimtarëve dhe artistëve, kur trajtojnë temën aktuale, u duhet të përshkruajnë një epokë ose të fiksojnë një ngjarje kur ajo është në proces zhvillimi. Pikërisht për këtë prej tyre kërkohet guxim ideologjik e krijues për të pasqyruar aktualitetin dhe tendencat e zhvillimit të tij, kërkohet që ata të luftojnë kundër mendimit të gabuar sipas të cilit realiteti i sotëm nuk mund të fiksohet, sidomos në letërsi, pa kaluar një farë kohe. Vetë eksperiencia e zhvillimit të letërsisë sonë tregon se kur artistët e shkrimtarët i janë vënë punës me guxim, ata kanë krijuar vepra shumë të mira edhe duke trajtuar temën aktuale. «Kënetat» e Fatmir Gjatës apo «Toka jonë» e Kolë Jakovës, «Ëndërr industriale» e Ismail Kadaresë apo «Ringjallja» e Llazar Siliqit, opera «Mrika» e Preng Jakovës apo shumë nga veprat e ekspozitës së arteve figurative në 20-vjetorin e çlirimit si dhe shumë vepra të tjera letraro-artistike dëshmojnë për këtë.

Siç dihet, në çdo epokë letërsinë dhe artin i kanë preokupuar

problemet e mëdha të kohës. Një mësim të shkëlqyer për këtë na jep edhe letërsia jonë e Rilindjes Kombëtare. Rilindasit tanë të mëdhenj u muarën kryesisht me temat e reja që u diktonte lëvizja kombëtare për liri e pavarësi, që u diktonte thirrja e zemrës së atdheut e të popullit të robëruar. Përveç temës historike, që ishte edhe ajo në shërbim të interesave imediate të popullit, Naimi, poeti ynë i madh dhe bashkëkohësit e tij trajtuan drejtpërdrejt edhe aktualitetin, i kënduan me patos të madh patriotik bukurisë së Shqipërisë, gjuhës shqipe, jetës së popullit punonjë, u bënë shprehës të aspiratave jetike të popullit dhe me veprat e tyre zgjuan ndërgjegjen kombëtare dhe ngritën popullin në luftë për liri kundër shtypjes dhe errësirës. Vetë kalimi i letërsisë sonë nga pozitat romantike përparimtare e demokratike në pozitat realiste, u bë nën ndikimin e fortë të trajtimit të temës aktuale, nën ndikimin e trajtimit të problemeve më të rëndësishme që preokuponin masat popullore. Naimi, Çajupi, Migjeni etj., të cilët kanë krijuar vepra aq emocionuese e të frymëzuara kanë ardhur deri në ditët tona të gjallë e të rinj dhe do të mbeten të pavdekshëm pikërisht sepse mbrujtën veprat e tyre me aspiratat e popullit dhe sepse trajtuan problemet më aktuale të popullit e të kohës së tyre.

Partia vazhdimisht ka theksuar e thekson detyrën që në qendër të letërsisë dhe të arteve të vendoset tema aktuale, sepse vetëm kështu letërsia dhe artet tona do ta forcojnë edhe më shumë karakterin e tyre militant, sepse në këtë mënyrë ato do të bëhen pjesë e pandarë dhe do të shkrihen me gjithë luftën tonë për socializëm, do të bëhen një armë efektive e Partisë në këtë luftë, do të kryejnë rolin e tyre për edukimin e masave, për transformimin e mobilizimin e tyre në ndërtimin e socializmit.

Ky është një parim themelor krejt në kundërshtim me «teoritë» borgjeze «të artit mbiklasor» si dhe me pikëpamjet e revizionistëve modernë, të cilët, me qëllim që t'i shkëputin artet nga lufta aktive politike e proletariatit, hapur ose tërthorazi, predikojnë «pavarësinë» e zhvillimit të tyre nga jeta aktuale politike, ekonomike e shoqërore e vendit, nga lufta për revolucionin e për ndërtimin socialist, dhe pretendojnë që ato të jenë të lira nga lufta e klasave, të jenë të pavarura nga përgjegjësia para masave punonjëse.

Duke theksuar në mënyrë të veçantë rëndësinë e trajtimit të temës aktuale, nevojën e pasqyrimin të çështjeve më themelore të jetës, Partia tërheq vëmendjen e shkrimtarëve dhe të artistëve në detyrën që duhet të përbëjë preokupacionin kryesor për punonjësit e krijimtarisë artistike.

Në letërsinë dhe në artet tona kanë zënë dhe do të zënë vendin e tyre tema historike si dhe tema të tjera që pasqyrojnë anët më të ndryshme të jetës shoqërore dhe të botës shpirtërore të njerëzve tanë. Por duhet theksuar se kohët e fundit janë botuar dhe

ekzekutuar relativisht shumë tregime, poezi apo këngë në të cilat vendin kryesor nuk e zë pasqyrimi i konflikteve të mëdha, nuk e zënë temat kryesore. Në to jo vetëm që në qendër janë vënë tema të ngushta dhe konfliktet anësore të sferës së marrëdhënjeve intime, por, çka është më keq, në disa raste trajtimi i këtyre temave bëhet duke u nisur nga një kënd i ngushtë vështrimi, nga një shikim abstrakt i çështjeve e, ndonjëherë, pa pasur parasysh parimet e reja morale të shoqërisë sonë. Detyra e shkrimtarëve dhe e artistëve si militantë e revolucionarë është që në krijimtarinë e tyre të pasqyrojnë, në radhë të parë, problemet kyçe të jetës dhe të luftës së punonjësve, të realitetit tonë. Ata, edhe kur trajtojnë temat personale intime, familjare etj., të cilat, siç dihet, kanë vendin e tyre në art, duhet të përpiqen t'i shohin ato të lidhura ngushtë me problemet e rëndësishme politike e etike të kohës, të zbulojnë nëpërmjet tyre idetë e mëdha të kohës duke u nisur gjithmonë nga pozitat e botëkuptimit tonë marksist-leninist dhe të moralit komunist, në luftë me çdo ndikim të botëkuptimit e të moralit borgjez e mikroborgjez, feudal e patriarkal.

Pasqyrimi me vërtetësi i realitetit është një kërkesë tjetër me rëndësi për zhvillimin e drejtë të letërsisë dhe të arteve tona.

Shkrimtari dhe artisti duhet ta paraqesin drejt realitetin në zhvillimin e tij revolucionar, ta pasqyrojnë atë me besnikëri dhe me forcën e duhur përgjithësuese në mënyrë që të ngjallin emociione të forta dhe të ushtrojnë ndikimin e duhur edukativ të lexuesit e spektatorët. Për këtë një rëndësi të veçantë ka këndi i vështrimit të tyre, qëndrimi ideor dhe emocional ndaj realitetit, talenti dhe aftësia e tyre.

Paraqitja me vërtetësi e realitetit ka qenë dhe mbetet kurdoherë një kërkesë themelore e Partisë ndaj krijimtarisë artistike. Këtu nuk është fjala as për ta lustruar, as për ta nxirë jetën, po për ta paraqitur atë në zhvillimin e saj revolucionar. Askush nuk mund të kërkojë që në letërsi e në arte të krijohen tipe punëtorësh, fshatarësh, intelektualësh e të rinjsh, komunistësh ose të paparti sipas ndonjë recete të caktuar e dëshirave subjektive. Detyra e artistit është që t'i paraqesë ata ashtu siç janë në jetë, pra, njerëz realë, që rrojnë e veprojnë në një botë reale. Në qoftë se Stavri Lara i romanit «Kënetë», siç e pamë edhe kohët e fundit në filmin «Vitet e para», është personazh i besueshëm e i dashur, kjo vjen pse ai është real në një botë reale, është një personazh tipik që vepron me vërtetësi në rrethana tipike të dhëna me mjeshteri nga autori.

Duke kërkuar nga shkrimtari e nga artisti që ta paraqesin drejt realitetin, natyrisht, letërsia dhe artet nuk mund të kuptohen pa frymën e tyre kritike kundër çdo gjëje të huaj të prapambetur e reaksionare që pengon ecjen përpara të shoqërisë sonë, kundër fenomeneve negative që vihen re në jetën e vendit dhe të njerëzve. Por duke demaskuar atë që është e huaj për socializ-

min, letërsia dhe artet duhet, në të njëjtën kohë, të pohojnë realitetin tonë socialist, atë që është e re, socialiste, përparimtare. Kritika ndaj realitetit nuk duhet të errësojë perspektivat e zhvillimit të jetës, të ndryshojë vendet që zënë në realitetin objektiv elementët pozitivë dhe ata negativë, të shtrembërojë kuadrin e jetës.

Në disa vepra letrare, sidomos të vjetëve të fundit, ndonjë autor ka shkarë e gabuar pikërisht sepse, duke errësuar anët pozitive dhe duke fryrë anët negative të jetës, ka shtrembëruar kuadrin e saj. Tipike në këtë drejtim është drama «Rrethimi i bardhë». Në këtë pjesë autori ka dashur të tregojë jetën gjoja ashtu siç është, por në fakt aty është shtrembëruar figura e lartë morale dhe heroike e punëtorëve, e teknikëve tanë, shpirti burror e i sakrificës i popullsisë së zonave malore, realiteti i mrekullueshëm i ditëve tona. Në vend që të tregojë solidariteti i disa personave të rrethuar nga dëbora në një objekt ndërtimi, solidaritet që është tipik në kohën e sotme për gjithë shoqërinë tonë, vendin kryesor në dramë e zënë dizarmonia e tyre dhe fryma individualiste që s'janë tipike për ta. Është për t'u theksuar se vetë jeta dëshmoi më së miri se përmbajtja e dramës ishte e shtrembër dhe kërkimet e autorit për t'u «thelluar në realizëm» ishin të gabuara. Vetëm pak kohë kaloi pas botimit e vënjes në skenë të kësaj drame dhe ndodhi një gjë pak a shumë analoge: një njeri humbi në dëborë, një kolektiv shkoi ta kërkonte shokun e humbur, nëntë vetë vdiqën për jetën e tij. Një për të gjithë e të gjithë për një. Ky është tipari karakteristik i kohës dhe i njerëzve tanë. Ky është heroizmi, shpirti i sakrificës e i dashurisë që karakterizon punonjësit tanë në momentet më të vështira.

Errësim të anëve pozitive dhe fryrje të anëve negative gjenden edhe te vëllimi me tregime «Zhurma e erërave të dikurshme», ku autori, në pasqyrimin e disa fenomeneve të jetës sonë, ka zënë një kënd vështrimi ideor të gabuar.

Jeta as ka qenë dhe as është shesh me lule. Por bukuria e jetës sonë socialiste qëndron pikërisht në hovin e papërmbajtshëm, optimist për kapërcimin e vështirësive. Paraqitja e vështirësive si diçka në vetëvete, duke harruar ç'ka më esenciale në jetën tonë, hovin e saj përpara, vetëmohimin dhe heroizmin e njerëzve tanë, do të thotë shmangje nga një qëndrim i vërtetë realist ndaj jetës, nxirje e jetës.

Revizionistët modernë, për të nxirë e njollosur realitetin sovjetik dhe të vendeve të tjera socialiste, po inkurajojnë në letërsi dhe në arte paraqitjen e të metave të shoqërisë si plagë të pashërueshme të saj. Kështu ata kërkojnë ta paraqesin socializmin si skëterrë dhe të neveritshëm, njeriun të keq e të pandreqshëm prej natyre, sakrificën e heroizmin si një punë boshë. Në këtë mënyrë ata përpiqen t'i heqin artit socialist karakterin revolucionar, pro-

pagandojnë deheroizimin e artit, orvaten të denigrojnë heroin e luftërave revolucionare, ndërtuesin e shoqërisë socialiste. Kështu ata predikojnë një art kapitullant e pacifist, vjellin vrer kundër veprave të vërteta revolucionare, largohen nga pozitat e klasës punëtore dhe të partishmërisë komuniste, bëjnë flamur të tyre humanizmin abstrakt borgjez, dashurinë kristiane për të gjithë. Duke ndjekur këtë rrugë, në fakt, letërsia dhe arti revizionist janë bërë pjesë e pandarë e propagandës së ideologjisë borgjeze dhe synojnë të minojnë besimin e masave punonjëse ndaj socializmit, të diskreditojnë e të minojnë vetë rendin socialist. Jo më kot Erenburgët e Aragonët, Tvardovskët, Solzhenicinët, Jevtushen-kot e shokët e tyre janë bërë sot aq popullorë e të afërt për ideologët borgjezë në fushën e artit, ashtu siç janë bërë në fushën e politikës Hrushovët, Brezhnjevët apo Mikojanët, shërbëtorë të devotshëm të borgjezisë imperialiste.

Në qendër të vëmendjes së letërsisë dhe të arteve duhet të jenë heronjtë e kohës sonë, punëtorët, fshatarët, intelektualët popullorë, njerëzit e rinj të edukuar nga Partia, ata që me vetëmohim e heroizëm punojnë e luftojnë për ndërtimin e socializmit, për mbrojtjen e lulëzimit e atdheut.

Shkrimtarët dhe artistët kanë merita të shumta në këtë drejtim. Po mbetet akoma shumë për të bërë që heroi i kohëve tona, ndërtuesi i shoqërisë së re, njeriu me ideale komuniste, të zërë vendin që i përket dhe të skalitet me vërtetësinë e madhësitinë e plotë në artin dhe në letërsinë tonë të re. Nëpërmjet këtij heroi triumfon e reja në jetë, pra, do të triumfojë edhe në art; kapërcehet ose shembet e vjetra në jetë, pra, do të kapërcehet e shembet edhe në art, krijohet shembulli i gjallë i punës krijuese, pra, do të krijohet edhe në art një shembull që t'i frymëzojë masat me dashurinë për punën, me shpirtin e sakrificës e të vetëmohimit për çështjen e socializmit. Nëpërmjet këtij heroi del perspektiva, zbulohet e ardhshmja, shfaqet optimizmi revolucionar i jetës, pra, do të dalë edhe qëndrimi i shkrimtarit apo i artistit në favor të këtij realiteti të ri në zhvillim, në favor të së resë që shkon përpara dhe që shkrimtari dhe artisti kanë për detyrë ta mbrojnë e ta ndihmojnë të zhvillohet, si bartës, edhe ata, të idealeve të mëdha të komunizmit. Kështu shkrimtari dhe artisti paraqesin në art jetën në vërtetësinë e saj. Kështu arti shërben për të kalitur njerëzit me idealet e moralin e ri.

Paraqitja e gjithanshme e heronjve, vënja në dukje e anëve të tyre pozitive ose negative varet nga tema që ka kapur shkrimtari apo artisti, nga qëllimi që ai i ka vënë vetes, nga specifika e llojit të artit, nga kushtet e rrethanat në të cilat veprojnë personazhet e ndryshme. Heronjtë nuk dalin më bindës e nuk jepen më thellë kur shkrimtari apo artisti apriori kërkon të gjejë të heroi pozitiv patjetër edhe të metat e tija, kurse te figura e ar-

mikut patjetër edhe anët e tija «pozitive». Në përgjithësi shkrimtari dhe artisti, në paraqitjen e heroit pozitiv, duhet të tregojnë atë që është kryesore, esencën e qënjes së tij, anët e tija më të mira dhe ta vëjë në luftë me çdo gjë të vjetër, të huaj, sepse kështu ai do të luajë rolin edukativ dhe do të bëhet shembull frymëzimi për të tjerët.

Dihet se trajtimi i temës aktuale kërkon edhe heroin e vet dhe ky hero është njeriu i punës; por gjatë procesit të punës krijuese, në mjaft raste, kjo kërkesë nuk realizohet në shkallën e duhur. Një piktor paraqiti në një ekspozitë dy punë të tija: e para paraqiste një grua të trishtuar me një fëmijë të dobët fizikisht dhe me një dhëmbje të madhe në fytyrë, të cilën e quajti «Refugjatja», e dyta paraqiste një punëtor të vjetër që i jepte zanatin një punëtori të ri, ku dy figurat kryesore humbisnin prapa një tornoje të madhe dhe një sfondi plot banderola të kuqe, ku lexohej edhe një parullë politike e ditës. E para ishte me të vërtetë një vepër me vlerë, e realizuar mirë, kurse e dyta ishte diçka pa jetë, skematike. Kuptohet se as merita dhe as dobësia këtu nuk janë të temës ose të heronjve, që autori vuri në qendër të tablove. Ato janë të vetë autorit, të njohjes së thellë të «Refugjates» dhe të mosnjohjes si duhet të heronjve punëtorë dhe gëzimit të punës. Nuk ka, pra, tema dhe heronj skematikë në vetëvete, por ka trajtim skematik të temës dhe të heroit nga ana e autorit.

Paraqitje jo të drejtë të heroit ka edhe në disa krijime në të cilat, duke dashur që ai të jetë sa më «realist», ose për të trajtuar thellë psikologjinë e tij, në fakt paraqiten personazhe që nuk kanë asgjë të përbashkët me bashkëkohësin tonë. Baza e këtij gabimi duhet kërkuar në faktin se njeriu trajtohet, në përgjithësi, i shkëputur nga shoqëria, nga thelbi i tij klasor dhe, shpeshherë, vihet theksi vetëm në anët e tija negative. Duke absolutizuar këtë koncept të gabuar, sidomos përsa u përket njollave që duhet të ketë medoemos njeriu i kohës sonë, shkrimtarët dhe artistët tanë do të shkonin shumë larg, do ta deheroizonin figurën e bashkëkohësit dhe do të merreshin me analiza psihike boshe, pa asnjë vlerë. Kjo do të çonte që në qendër të letërsisë sonë të viheshin bile edhe heronj të lëkundshëm, që zënë një pozitë ideologjike jo të shëndoshë, që qëndrojnë ndërmjet nesh dhe armiqve tanë, gjë që do të ishte krejt e padrejtë, historikisht e pasaktë dhe ideologjikisht e gabuar.

Gabime të kësaj natyre vihen re në veprat «Drama e një partizani pa emër» dhe «Një emër në mes të yjeve». Në të parën heronjtë përshkohen nga frika ndaj armikut dhe nga mosbesimi në fitore, ndërsa në të dytën përligjet mendimi sipas të cilit që të jesh hero nuk është e nevojshme të kesh një pregatitje ideologjike e morale, nuk është e nevojshme të kesh një ideal të lartë e të luftosh për të, por mjaftojnë vetëm rrethanat e rastit.

Shkrimtarët dhe artistët tanë në krijimtarinë e tyre duhet të jenë vigjilentë e të luftojnë kundër ndikimeve të huaja, kundër pikëpamjeve borgjeze e revizioniste lidhur me zhvillimin e artit. Ky është një problem shumë i rëndësishëm, që ka të bëjë me ruajtjen e pastërtisë ideologjike të artit tonë, të frymës së partishmërisë.

Ndikimi nga idetë e rrymat e ndryshme letrare e artistike që përhapin ideologët dhe estetët e artit borgjez e revizionist, flamuri i të cilave është humanizmi abstrakt dhe objektivizmi mbiklasor si dhe tërheqja thjesht pas elementëve të formës artistike të shkrimtarëve të huaj, përbëjnë një rrezik serioz për krijimtarinë tonë.

Para disa kohësh në revistën «Nëntori» u botua drama «Dueli». Autori në këtë dramë ka dashur të përshkruajë Luftën nacional-çlirimtare dhe forcën e saj nëpërmjet një dueli idesh, ku të triumfonte çështja e popullit, çështja e Partisë mbi ideologjinë e pushtuesit nazist. Por ky duel është shtjelluar nën ndikimin e ideve të huaja, pra, duke u larguar nga rruga e Partisë. Si rrjedhim, në fakt, del se ka pasur edhe armiq «të arësyeshëm», të cilët, megjithëse luftonin me fanatizëm për fitoren e fashizmit, ishin «objektivë» ndaj luftës sonë dhe «humanë». Kështu «Dueli» jo vetëm nuk paraqet drejt luftën e popullit, por zbukuron fytyrën e armiqve me të cilët u ndesh populli ynë në luftë. Kjo dramë është në kundërshtim me parimin e partishmërisë në letërsi.

Detyra e shkrimtarit komunist, me parti ose pa parti, është jo të bëjë thirrje «për të zbutur» urrejtjen ndaj armiqve, por t'i edukojë masat me patriotizmin e flaktë, me urrejtje për armiqtë e lirisë e të pavarësisë së atdheut dhe të çështjes së socializmit; jo të predikojë paqen kristiane midis njerëzve pa i dalluar ata se cilët janë, ç'klasa përfaqësojnë, për ç'interesa luftojnë. Një arti të tillë mbiklasor, një «humanizmi» të tillë abstrakt ne duhet t'i kundërvëmë artin dhe humanizmin tonë revolucionar, që u përgjigjen interesave të klasës, të Partisë, të luftës për socializmin kundër kapitalit, kundër shfrytëzimit, kundër pushtuesve.

Duhet thënë se «Dueli» dhe veprat e tjera që kritikua më tepër janë dështime të shkëputura, një lajthitje në krijimtarinë e autorëve të tyre. Autorët e këtyre veprave të gabuara janë të lidhur ngushtë me interesat e popullit e të Partisë dhe, siç e kanë treguar në krijimet e tjera të tyre, ata militojnë aktivisht për këto interesa.

Estetika marksiste na mëson se lënja pas dore e politikës, e qëllimit edukativ të një vepre, të largon nga rruga e drejtë, nga letërsia dhe nga arti revolucionar.

Shkrimtarët dhe artistët, të gjithë punonjësit e krijimtarisë artistike, në çdo hap të punës së tyre krijuese, duhet të zënë atë kënd vështrimi që u përgjigjet më së miri interesave të popullit,

të vijës së Partisë. Asnjë fenomen, ngjarje apo personazh nuk duhet parë jashtë këtyre interesave, sepse nuk ekziston asnjë fenomen i rëndësishëm shoqëror që të mos ketë lidhje me to. Kriteri themelor i vlerësimit të një krijimi artistik nuk mund të jetë tjetër veçse ky: sa i shërben çështjes së popullit e të Partisë kjo apo ajo veper letrare, kjo apo ajo tablo, kjo apo ajo këngë. Ky kriter nuk përjashton aspak kriterin artistik në përcaktimin e vlerës së një vepre, sepse pa vlerë artistike as mund të bëhet fjalë për letërsi, për muzikë, për pikturë, për art në përgjithësi. Por duke theksuar rëndësinë e përmbajtjes së shëndoshë ideo-politike, Partia ka parasysh prioritetin që ka politika, ka parasysh se arti kurrë nuk ka qenë dhe nuk mund të jetë qëllim në vetëvete, se ai kurdoherë i ka shërbyer një klase të caktuar.

Kjo përputhet plotësisht me parimin bazë të realizmit socialist parimin e partishmërisë në art, të përpunuar nga Lenini. Artisti militant për çështjen e popullit, të socializmit, të revolucionit, duhet të shkruajë e të këndojë kurdoherë nga pozitat e klasës punëtore, nga pozitat e luftëtarit të ndërtimit socialist, nga pozitat e komunizmit. Në kundërshtim me teoricienët borgjezë e revizionistë, të cilët flasin me hipokrizi për «lirinë absolute» të shkrimtarëve dhe të artistëve nga shoqëria dhe me këtë parullë të gënjeshtër maskojnë vartësinë e tyre, siç thoshte Lenini, nga «qesja me para» e kapitalistëve, shkrimtarët dhe artistët tanë kanë qenë dhe duhet të jenë edhe në të ardhshmen gjithnjë tendenciozë të partishëm, t'i shohin dhe t'i zgjidhin konfliktet nga pozitat revolucionare dhe t'u shërbejnë ashtu siç u kanë shërbyer, hapur, me gjithë shpirt, interesave të Partisë e të popullit.

V. I. Lenini ka thënë se letërsia e proletariatit socialist duhet t'u shërbejë

«milionat e dhjetëra miliona punonjësve, që janë lulja e vendit, forca e tij, e ardhmja e tij»¹.

Punonjësit tanë të krijimtarisë e kanë pasur parasysh kurdoherë këtë mësim të rëndësishëm. Ata edhe në të ardhshmen duhet të punojnë në këtë drejtim. Popullit i shërbehet duke i dhënë vepra me një përmbajtje të thellë ideo-politike, duke shkruar për problemet e tij më preokupante, duke mbajtur një qëndrim serioz ndaj punës krijuese, në mënyrë që t'i jepet atij një krijimtari e një niveli të lartë artistik, e thjeshtë dhe e kuptueshme për masat, e frymëzuar nga populli dhe nga jeta e tij.

Organizatave të Partisë, Ministrisë së Kulturës dhe të Arteve, Lidhjes së Shkrimtarëve dhe të Artistëve u dalin detyra të mëdha për edukimin dhe mobilizimin e njerëzve të krijimtarisë sonë arti-

¹ V. I. Lenin. Veprat, vëll. 10. f. 38-39.

stike, në mënyrë që ata, ashtu si gjithnjë, të shquhen për frymën e partishmërisë në krijimet e tyre si luftëtarë kundër pikëpamjeve e ndikimeve revizioniste e borgjeze në zhvillimin e artit, të shquhen si edukatorë në shërbim të masave të gjera punonjëse.

Krahas me thellimin dhe përmirësimin e përmbajtjes ideore të letërsisë dhe të arteve tona qëndron edhe problemi i rëndësishëm i ngritjes së mëtejshme të nivelit artistik të tyre. Shkrimtarët dhe artistët e kanë perfeksionuar edhe më shumë mjeshtërinë e tyre artistike, kanë krijuar vepra me një formë artistike të lartë, që u janë përgjegjur ideve të mëdha për të cilat ato militojnë, që kanë prekur dhe emocionuar mendjet dhe shpirtërat e njerëzve. Pa përmendur krijime të njohura të vjetëve të mëparshëm, vepra të tilla të krijuara këta dy-tre vjetët e fundit si «Përse mendohen këto male» e Ismail Kadaresë, «Lumi i vdekur» i Jakov Xoxes, punimet më të mira të ekspozitës së arteve figurative të hapur me rastin e njëzetvjetorit të çlirimit, opera «Lulja e Kujtimit» e Kristo Konos, baleti «Halili dhe Hajrija» i Tish Daisë, filmi «Vitet e para» i regjizorit Kristaq Dhama e të tjera janë rezultate të shënuara që premtojnë për suksese edhe më të mëdha në të ardhshmen.

Niveli i letërsisë dhe i arteve shkon gjithnjë duke u ngritur, por kërkesat kulturele gjithnjë në rritje të masave punonjëse e shtrojnë si një detyrë imperative luftën për cilësinë edhe në fushën e letërsisë e të arteve. Zgjidhja e kësaj detyre është e lidhur me përvetësimin e ligjeve të krijimit artistik, me pasurimin e mëtejshëm të gjuhës e larminë e stileve, me gjallërimin e ngjyrave e të tingujve, me përdorimin sa më të mirë të vizatimit, të melodisë të kompozicionit, të të gjitha mjeteve të teknikës së ndërlikuar e delikate artistike, me zhvillimin e individualitetit artistik.

Puna artistike është me përgjegjësi të madhe dhe është pikërisht kjo përgjegjësi që duhet të ndjehet edhe më fort nga njerëzit tanë të krijimit artistik. Shkrimtarët dhe artistët duhet të tregohen më kërkues e më këmbëngulës në punë. Fjala që thotë se «arti kërkon një talent dhe nëntë punë» është një e vërtetë e madhe. Prandaj, punonjësit krijues nuk duhet t'i lejojnë kurrë vetes të nxjerrin nga duart e tyre vepra të ngutura, ku nuk ndihet serioziteti i nevojshëm i përpunimit dhe i skalitjes.

Letërsia, piktura dhe muzika e realizmit socialist kanë lindur mbi bazën e zhvillimit të gjatë historik të shoqërisë sonë, të jetës së saj shpirtërore, të traditave të shquara e më të mira kulturo-artistike të popullit tonë. Partia ka shtruar vazhdimisht detyrën që artistët tanë ta njohin, ta studjojnë, të mbështeten më fort në trashëgimin tonë letrar e artistik të kultivuar e popullor, duke marrë prej tij elementët përparimtarë, patriotikë e demokratikë. Letërsia dhe arti socialist, që krijohen për popullin nuk duhen shkëputur asnjëherë prej krijimtarisë popullore, ku mund dhe

duhet të gjejnë kurdoherë mbështetje e frymëzim. Kjo nuk është një çështje e thjeshtë vazhdimësie, por një çështje që ka të bëjë drejtpërsëdrejti me krijimin e vlerave të vërteta letrare artistike, me krijimin e origjinalitetit të vërtetë të letërsisë e të artit shqiptar, që e dallon nga letërsia dhe nga arti i kombeve të tjera. Kjo nuk është as një çështje e shkëputur forme por një çështje e pandarë përmbajtjeje e forme. Duke pasqyruar realitetin e kohës dhe duke u thelluar përditë e më shumë në traditat kombëtare, shkrimtarët dhe artistët vënë në jetë një nga parimet themelore të marksizëm-leninizmit mbi kulturën e kohës sonë, e cila është dhe duhet të jetë socialiste nga përmbajtja dhe kombëtare nga forma. Prandaj, letërsia, muzika, piktura dhe skulptura, për të forcuar dhe zhvilluar më tej bazën e tyre kombëtare, duhet të bëjnë një punë edhe më të madhe për njohjen dhe përvetësimin e traditës kombëtare, veçanërisht të asaj popullore.

Artit që i mungon karakteri kombëtar i mungon në fund të fundit origjinaliteti, vlera e tij e vërtetë. Ai kthehet në një art epigon e kozmopolit. Estetët, letrarët dhe artistët revizionistë, duke u nisur nga njollosja e vlerave kombëtare të artit socialist, filluan pikërisht për këtë të vihen në udhën e arteve e të letërsisë dekadente të borgjezisë, të bëhen kështu kozmopolitë dhe epigonë të tyre.

Letërsia dhe artet tona duhet t'i konsolidojnë edhe më fort pozitën që kanë fituar në rrugën e zhvillimit të tyre si letërsi dhe arte të realizmit socialist. Përveç të tjerave, këtu është fjala edhe për lulëzimin e gjithanshëm të gjinive të ndryshme, sidomos të atyre që kanë një peshë më të madhe, apo që kanë mbetur tani për tani më prapa. Është fjala për rrugët e zhvillimit të mëtejshëm të letërsisë dhe të arteve, për ngritjen në një shkallë më të lartë të pjekurisë së tyre artistike.

Një ndër problemet themelore të zhvillimit të prozës sonë është konsolidimi i mëtejshëm i romanit, si gjini që ka mundësi të mëdha për pasqyrimin e gjerë e të thellë të jetës. Detyra e prozatorëve është që, mbi bazën e eksperiencës së fituar dhe duke u përpjekur të krijojnë vepra të një cilësie edhe më të mirë, të bëjnë që romani të jetë një gjini gjerësisht e lëruar. Në dramaturgjë, veç nevojës për më shumë drama e komedi të një niveli më të lartë artistik, detyra bazë është ecja me vendosmëri në rrugën e thellimit të tendencave realiste nëpërmjet kapërcimit të shfaqjeve romantiko-sentimentaliste që vihen re akoma në këtë fushë. Një rëndësi të veçantë ka edhe lërimi më i gjerë i gjinive të ashtuquajtura të vogla, si tregimi i shkurtër, skica, reportazhi letrar, vjersha, skeçi etj., të cilat, për vetë natyrën e tyre, janë mjaft operative e komunikuese me masat dhe militojnë ditë përditë për problemet aktuale.

Në pikturë duhet të marrin një zhvillim më të madh tablotë

kompozicionale. Deri tani në këto tablo ka mbizotëruar tema historike dhe e Luftës nacional-çlirimtare, kryesisht, sepse në këtë drejtim janë bërë edhe kërkesat e porositë shtetërore për muzeume. Zgjerimi dhe larmia e këtyre kërkesave e porosive do të sillte, bashkë me temën e ndërtimit socialist, edhe një përpjekje më të madhe për konsolidimin e kësaj gjinie të rëndësishme. Tendenca e disa piktorëve drejt tablosë monumentale do të mbështetej në këtë mënyrë edhe më shumë. Kështu piktura jonë, qoftë nga brendia apo nga forma, do të afrohet edhe më shumë me masat. Dhe kërkesa që piktura të afrohet edhe më shumë me masat është një nga detyrat më të rëndësishme e më të vështira që dalin para artit tonë figurativ. Konsolidimi i pozitave në tërë pikturën tonë të realizmit socialist duhet të bëhet duke ndjekur rrugën drejt masave me anë të temës së ditës, qoftë në tablotë kompozicionale, qoftë në portretin e njeriut të ri, ndërtues të socializmit, qoftë me peisazhin e ri shqiptar të ndërtimit socialist.

Përsa i përket muzikës, detyrë themelore është mbështetja te muzika popullore, te folklori ynë, i cili është një pasuri e paçmueshme dhe burim frymëzimi për kompozitorët tanë. Çështja e bazës kombëtare të muzikës sonë në përgjithësi, të një baze kombëtare në kushtet e reja të ndërtimit socialist, është në radhë të parë çështja e brendisë socialiste të artit tonë muzikor. Sentimentalizmi që karakterizonte disa herë pjesët tona të muzikës së lehtë, ritmet dhe orkestrimet ekstravagante që janë vënë re disa herë këta vjetët e fundit, janë një ndikim i huaj që u shfaq gjatë përpjekjeve për të krijuar e zhvilluar këtë gjini të muzikës sonë. Kjo ka ndodhur, sigurisht, edhe për faktin se kompozitorët tanë nuk kanë një eksperiencë të pasur dhe shpesh një ngritje profesionale të mjaftueshme. Por kryesorja është mungesa e qëndrimit kritik ndaj eksperiencës së huaj.

Çështja se si të mësojmë e çfarë të mësojmë nga arti përparimtar botëror, sidomos në konditat e sotme, kur ideologët borgjezë e revizionistët modernë rekomandojnë me bujë lloj-lloj idesh e formash pseudo të reja, ka, pra, një rëndësi të dorës së parë. Veçanërisht e theksojmë këtë lidhur edhe me pikëpamjet formaliste që janë vënë re edhe te ne, në disa autorë pa eksperiencë, në të kuptuarit e novatorizmit.

Dihet se novatorizmi ka të bëjë, në radhë të parë, me përmbajtjen, me zbulimin e asaj që është e re në jetën e shoqërisë sonë. Përmbajtja e re e shoqërisë sonë përcakton edhe përmbajtjen e re të artit, e cila, si rrjedhim kërkon, pa dyshim edhe një formë artistike të re dhe më të përfeksionuar. Ky është kuptimi i drejtë i novatorizmit, i cili ngrihet mbi një bazë që ka ekzistuar më parë, mbi traditat më të mira kulturele të së kaluarës dhe mbi eksperiencën që ka fituar arti ynë i ri socialist. Shoku Enver Hoxha,

në mbledhjen e korrikut të vitit 1961 me njerëzit e letërsisë dhe të arteve, ka thënë lidhur me këtë problem:

«Kudo ka poezi, kudo ka novatorizëm dhe askush nuk ka të drejtë dhe nuk mundet ta pengojë atë. Vetëm se duhet që ky novatorizëm të ecë në rrugën e drejtë duke respektuar parimet e realizmit socialist, duhet që vepra të jetë e thjeshtë, e qartë, madhështore, mobilizuese, të edukojë e t'i hapë popullit perspektivën. Kjo ka rëndësi të madhe dhe këtë ne e gjejmë kudo, . . . por njëkohësisht nuk duhet të hidhen poshtë traditat e mira të së kaluarës. Novatorizmi nuk duhet barazuar asnjëherë me mohimin e traditës»¹.

Duhet të themi se në përgjithësi shkrimtarët dhe artistët tanë i kanë pasur mirë parasysh këto mësimet të Partisë dhe janë në rrugë të drejtë kërkimi. Ne kemi shkrimtarë dhe artistë të talentuar të rinj dhe me moshë të kaluar që janë me të vërtetë novatorë, ashtu siç është novator në thelb tërë arti ynë i realizmit socialist. Këtë e tregon mirë zhvillimi i letërsisë sonë, sidomos gjatë vjetëve të fundit. Kështu, veçanërisht në poezi, janë krijuar vepra të fuqishme të mbështetura plotësisht në metodën e realizmit socialist dhe me një frymë të shëndoshë kombëtare, të cilat, në të njëjtën kohë, si nga brendia ashtu edhe nga forma e skalitja artistike janë plotësisht novatore.

Por ka edhe raste kur novatorizmi revolucionar është parë si mohim i traditave të mira të së kaluarës, si një çështje «mode» duke u identifikuar me nevojën për të qenë «të kohës», «origjinalë», pa marrë parasysh kërkesat ideologjike. Kështu, novatorizmi kuptohet si një çështje e thjeshtë forme, si diçka që duhet arritur me doemos e me një çmim të lirë, me anë të lojës së fjalëve, të figurave apo të ngjyrave, me anën e disa trukeve dhe elementeve, që për punën krijuese janë krejt të jashtme e të sipërfaqshme. Duke e kuptuar novatorizmin si një çështje «mode», aty-këtu duken përpjekje të gabuara për të futur forma artistike jo të diktuara nga brendia, nga nevoja për të paraqitur lëndën e jetës në formë sa më të qartë e të goditur, po për një farë snobizmi; zëvendësohet marrja e eksperiencës në mënyrë kritike nga arti përparimtar botëror me imitim të thjeshtë të disa autorëve, të rrymave e të stileve pa njohur mirë natyrën letrare-shoqërore të tyre.

Këto shfaqje janë ndjerë në festivalet e këngëve në radio, në të cilat janë ekzekutuar edhe këngë pa melodi e me ritëm të shturur, që s'janë gjë tjetër veçse kopje të modës perëndimore. Ato janë ndjerë në artet figurative, ku ka pasur edhe vepra me ngjyra

¹ Enver Hoxha. Fjala në mbledhjen e gjerë me shkrimtarët dhe artistët. «Rruga e Partisë» Nr. 9, f. 11-12, Tiranë, 1961.

të zymta e deformime të figurës së njeriut e të peisazhit nën pretekstin e thjeshtësimit të formave, gjë që ka çuar deri në cungimin dhe në shtrembërimin e idesë. Ato janë ndërjet edhe në skenografi ku, nganjëherë, konvencionalizmi i tepëruar ka dëmtuar edhe vetë idenë e veprave skenike. Raste të tilla ka pasur edhe në letërsi, ku në disa shkrime konfliktet janë trajtuar e zgjidhur në një mënyrë të tillë që nuk i pranon logjika e shëndoshë e luftës së klasave, ku ka humbur qartësia e veprave dhe janë bërë ato të pakuptueshme nga masat e lexuesve. Kjo ka ndodhur sidomos në poezinë e disa të rinjve, ku është krijuar një uniformitet i dëmshëm, i cili shprehet në vargje të pafrymëzuara, në përsëritjen e figurave të huazuara, në imitimim e njëri-tjetrit etj.

Shfaqjet për të cilat u fol më sipër përbëjnë, në kushtet e sotme, një rrezik për letërsinë e për artet tona, sepse aty fshihet mundësia e depërtimit të pikëpamjeve të huaja formaliste. Kundër këtij rreziku duhet të drejtohet lufta jonë e organizuar teorike e praktike, kundër tij Partia duhet të mobilizojë shkrimtarët, piktorët, skulptorët, kompozitorët, gjithë kuadrot më të talentuar e më të përgatitur ideologjikisht e artistikisht.

Në të njëjtën kohë, njerëzit e artit e të letërsisë duhet të bëjnë një luftë të vendosur kundër rutinës, cektësisë, skematizmit e konservatorizmit, të cilët gjithashtu, përbëjnë një problem serioz për letërsinë dhe për artet tona. Lufta kundër këtyre shfaqjeve e dobësive është një kusht i domosdoshëm që artet dhe letërsia jonë të ecin përpara, të çajnë rrugë të reja të pazbuluara deri më sot, të ngrihen në nivelin e kërkesave të kohës sonë.

Kuptimi i drejtë marksist-leninist i traditave dhe i novatorizmit, i unitetit të formës e të përmbajtjes, i marrjes në mënyrë kritike të eksperiencës së artit përparimtar botëror dhe i luftës kundër të gjitha shfaqjeve formaliste e konservatore do t'u japin patjetër një shtytje të re zhvillimit e lulëzimit të letërsisë dhe të arteve tona.

Për zhvillimin e mëtejshëm dhe në rrugë të drejtë të letërsisë dhe të arteve një rol shumë të madh e të rëndësishëm luan kritika letrare e artistike, e cila, me gjithë sukseset e arritura sidomos vjetët e fundit, mbetet akoma gjinia më e prapambetur. Kritika dhe mendimi ynë teorik në fushën e estetikës, me gjithë disa përpjekje që meritojnë vëmendjen, nuk janë në lartësinë e detyrës së tyre. Ato kanë zënë një vend të pamjaftueshëm në shtyp e në botime të veçanta, kanë vijuar të mbeten recensionale dhe të merren akoma rrallë me problemet që u dalin arteve e letërsisë. Rrahja e problemeve teorike bëhet në mënyrë pak a shumë të rastit dhe jo në lartësinë e duhur. Organizimi i paktë dhe shpeshherë i dobët i diskutimeve krijuese nga Lidhja e Shkrimtarëve dhe e Artistëve dhe nga organet e shtypit letrar është gjithashtu një e metë tjetër që duhet vënë në dukje.

Gjendja e kritikës letraro-artistike është një problem që duhet të preokupojë Partinë dhe njerëzit e arteve e të letërsisë. Ne kemi nevojë për një kritikë thellësisht parimore e të partishme, për një kritikë që të mbrojë me vendosmëri parimet marksiste-leniniste në fushën e artit e të letërsisë, që të godasë çdo shfaqje të huaj për ideologjinë dhe për moralin tonë, që të përkrahë e të mbështetë atë që është e shëndoshë, revolucionare, atë që militon për vijën e Partisë e që shërben për edukimin komunist të masave. Vetëm një kritikë e tillë është në dobi të autorëve, i shërben mbarëvajtjes së letërsisë e të arteve dhe ndihmon në orientimin e drejtë të masave për të kuptuar e vlerësuar si duhet veprat letraro-artistike.

Kritika jonë duhet të demaskojë pikëpamjet revizioniste në art dhe të zbulojë falsitetin, kalbëzimin dhe rrezikun e tyre. Ajo duhet t'u bëjë luftë rrymave revizioniste të «realizmit pa cak», të «pacifizmit pasiv», të «bashkekzistencës ideologjike», të të ashtuqajturit parim pannjerëzor të artit, të cilat, të gjitha së bashku, mohojnë karakterin klasor dhe partishmërinë e letërsisë e të arteve dhe i orientojnë ato drejt letërsisë e artit reaksionar borgjez.

Shkrimtarët dhe artistët, kritikët dhe teoricienët tanë, shtypi, e në radhë të parë shtypi letrar, «Nëntori» e «Drita», duhet të luftojnë për të ngritur rolin dhe rëndësinë e kritikës, principialitetin dhe vërtetësinë e saj, të preokupohen më shumë për rritjen e kuadrove të rinj, të kritikëve për zhvillimin e estetikës marksiste, për orientimin e drejtë të kritikës, në mënyrë që edhe ajo të merret në radhë të parë me veprat e problemet letraro-artistike që kanë të bëjnë me aktualitetin.

Një përgjegjësi të madhe ka veçanërisht organi i Komitetit Qendror «Zëri i Popullit», i cili duhet të mbajë mirë parasysh se ashtu si në të gjitha çështjet edhe në atë të kritikës letrare e artistike duhet të jetë tribuna ku të shprehet pozita parimore e Partisë mbi problemet e letërsisë dhe të arteve. Kujdes të veçantë, posaçërisht për orientimin e drejtë të letrarëve dhe të artistëve të rinj si dhe për edukimin e rinisë, duhet të tregojë në këtë drejtim organi i KQ të BRPSH «Zëri i Rinisë».

Një numër gjithnjë e më i madh të rinjsh janë duke treguar talentin e tyre në fushën e letërsisë e të arteve. Ndërmjet atyre ka mjaft premtime të gëzueshme, por, natyrisht, ka edhe shfaqje negative të tilla që janë të kuptueshme për moshën dhe për pjekurinë që kanë, si kapja pas temave të vockëla, mosnjohja e duhur e jetës dhe e problematikës të moshës së tyre etj. Lidhja e Shkrimtarëve dhe e Artistëve, organizatat e Partisë e ato të rinisë, me qëllim që të shtohen radhët e punonjësve krijues me gjak të ri, duhet t'i kushtojnë më shumë kujdes zbulimit, edukimit dhe rritjes së talenteve të reja që ka në fushën e letërsisë e të arteve.

Këto janë disa nga problemet e detyrat kryesore që aktualisht

dalin përpara letërsisë dhe arteve tona. Ato kanë të bëjnë me zhvillimin e mëtejshëm të arteve tona, me forcimin e karakterit të tyre luftarak, me ngritjen në një nivel më të lartë ideo-politik dhe artistik të tyre.

Një nga kushtet vendimtare për një zhvillim të shëndoshë të letërsisë dhe të arteve, për zbatimin me sukses të detyrave që shtron Partia para tyre, për zhdukjen e dobësive që vihen re në krijimtarinë tonë, është lidhja gjithnjë e më e ngushtë e shkrimtarëve, artistëve, piktorëve e kompozitorëve me popullin, njohja e thellë dhe e vazhdueshme e jetës së popullit, e realitetit tonë dhe, krahas kësaj, kuptimi marksist-leninist i fenomeneve dhe i proceseve më karakteristike të shoqërisë sonë.

Eksperiencia tregon se ata shkrimtarë dhe artistë që e kanë njohur thellë jetën, kanë krijuar vepra të bukura e të frymëzuara thellësisht realiste. Mund të përmendeshin shumë shembuj në këtë drejtim, qoftë nga lëmi i letërsisë apo i muzikës, qoftë nga ai i pikurës e i arteve të tjera. Shembulli më i freskët është romani i fundit i Jakov Xoxes «Lumi i vdekur», në të cilin duket qartë se autori njez thellë ambientin, jetën, psikologjinë e fshatit të Myzeqesë, të kaluarën e të tanishmen e tij.

Shkrimtarët dhe artistët tanë, në përgjithësi, i ka karakterizuar lidhja me jetën, me popullin. Këtu qëndron arsyeja e respektit dhe e dashurisë që kanë lexuesit për ta. Por në këtë drejtim ata duhet të bëjnë përpjekje edhe më të mëdha duke shfrytëzuar më drejt e më racionalisht kushtet favorizuese që kanë krijuar Partia e qeveria për këtë qëllim. Jeta jonë zhvillohet me ritme shumë të shpejta dhe me zhvillimin e saj ndryshojnë njerëzit dhe kushtet në të cilat ata jetojnë. Për ta pasqyruar këtë zhvillim shkrimtarët dhe artistët duhet të mos mbeten prapa, por ta ndjekin atë hap pas hapi duke e lidhur sa më ngushtë me popullin, duke marrë pjesë aktive në jetën ekonomike, politike, shoqërore e kulturore të vendit.

Shoku Enver Hoxha, duke folur në Plenumin e korrikut 1964 në Komitetin Qendror të Partisë, theksoi se

«Metoda më e mirë dhe shpëtimtare për ta është lidhja me jetën konkrete, me të mirat dhe brengat e popullit. . . Çështja e lidhjes së shkrimtarëve me jetën e popullit, me realitetin tonë socialist, është një çështje e madhe, që ka të bëjë drejtpërdrejt me zhvillimin e mëtejshëm të letërsisë sonë në rrugë të drejtë»¹.

1 Enver Hoxha. Fjala e mbylljes në Plenumin e KQ të PPSH mbi forcimin e mëtejshëm të punës ideologjike të Partisë për edukimin komunist të punonjësve. F. 28-29. Tiranë, 1964.

Partia ka bërë e u bën thirrje shkrimtarëve dhe artistëve të lidhen sa më ngushtë me jetën e popullit, të rrojnë me pulsën e jetës së tij, të njohin nga afër jetën dhe punën e njerëzve tanë, në fabrika e uzina, në miniera e kooperativa, në ferma e SMT, në shkolla e kantiere ndërtimi, në reparte ushtarake e kufitare, në fshat e qytet duke shfrytëzuar për këtë qëllim të gjitha rrugët e format e mundshme, që nga vendosja me afate të gjata apo të shkurtëra në qendrat e punës e të prodhimit e deri te kontaktet e vazhdueshme masive e individuale me njerëzit.

Ky problem ka një rëndësi të dyfishtë për artin dhe për vetë njerëzit e punës krijuese, sepse, nga njëra anë, ata do të njohin jetën e vërtetë, problematikën e ndërtimit të socializmit dhe heronjtë e ardhshëm të veprave të tyre; do të gjejnë temat që u duhen dhe frymëzimin e nevojshëm për të krijuar vepra dinjitoze, me një përmbajtje të thellë e me një nivel të lartë artistik. Nga ana tjetër, kjo do të shërbejë njëkohësisht edhe për edukimin e vetë njerëzve të krijimtarisë me frymën revolucionare, me qëndrimin burrëror ndaj vështirësive dhe me virtytet më të pastra që janë të mishëruara te masat punonjëse.

Njohja e thellë e realitetit është një proces i gjatë e i ndërlikuar. Për të njohur e interpretuar transformimet e thella që bëhen në gjirin e shoqërisë sonë, për t'u hyrë thellë fenomeneve shoqërore, për të njohur zhvillimin e tyre dialektik nëpërmjet kontraktave, për të zbuluar të renë që, nganjëherë, fshihet dhe është vështirë ta shohësh, për të ditur se cilat fenomene janë tipike, që lidhen me thelbin e rendit tonë, dhe cilat të dorës së dytë, jokatërishtike, të përkohshme, për t'u orientuar gjithnjë drejt në punën krijuese, shkrimtarët dhe artistët duhet ta njohin jetën jo vetëm nga ana e jashtme nëpërmjet fakteve të veçanta. Është e domosdoshme që ata të kenë edhe një përgatitje të mirë teorike, të përvetësojnë si duhet metodën dialektike marksiste-leniniste. Prandaj, Partia shtron me forcë detyrën që shkrimtarët dhe artistët, gjithë inteligjencia jonë krijuese, të studjojnë dhe të përvetësojnë ideologjinë marksiste-leniniste dhe vijën e përgjithshme politike të Partisë, që është zbatim i praktikë i teorisë marksiste-leniniste në kushtet konkrete të vendit tonë.

Byroja Politike e Komitetit Qendror të Partisë është e bindur se njerëzit e krijimtarisë sonë artistike që me veprat e tyre kanë luajtur një rol të dorës së parë për edukimin e masave dhe për zhvillimin e kulturës sonë socialiste, që kurdoherë, me vendosmëri e besim, kanë luftuar për interesat e popullit e të Partisë, do t'i shtojnë përpjekjet e tyre për t'i dhënë një hov të ri zhvillimit të letërsisë dhe të arteve tona të realizmit socialist, për të krijuar për punonjësit tanë edhe më shumë vepra letrare e artistike, të një niveli të lartë ideo-artistik, të bukura e të frymëzuara.

Të përmirësojmë punën për edukimin ideo-estetik të masave

Lenini ka thënë:

«Arti i përket popullit. Ai duhet t'i shtrijë rrënjët e tij të thella në shtresat e dëndura të masave të gjera punonjëse. Ai duhet të kuptohet nga këto masa dhe t'u pëlqejë. Ai duhet të bashkojë ndjenjat, mendimet dhe vullnetin e këtyre masave, t'i ngrejë ato»¹.

Arritjes së këtij qëllimi i shërbejnë si zhvillimi në rrugë të drejtë i krijimtarisë letrare dhe artistike ashtu edhe të gjitha institucionet kulturele e artistike, profesioniste e amatore, të gjithë punonjësit e kulturës dhe të artit tonë socialist.

Partia dhe shteti ynë i kanë dhënë dhe i japin gjithnjë përkrahjen e tyre aktive përhapjes sa më të gjerë të literaturës, të arteve dhe përgjithësisht të kulturës, të cilat po bëhen gjithnjë e më tepër një nevojë shpirtërore për masat e popullit dhe veçanërisht për rininë.

Gjatë këtyre 21 vjetëve të ne është krijuar një rrjet i gjerë teatrosht e ansamblesh, të cilat bëjnë një punë të madhe për propagandimin e përhapjen e arteve tona. Sot kemi 21 teatro të dramës e të estradës, Teatrin e operës e të baletit, Ansamblin shtetëror të këngëve e të valleve, Teatrin e kukllave, Ansamblin e Ushtrisë Popullore dhe një trupë cirku. Në këtë rrjet të gjerë institucionesh artistike profesioniste kultivohet arti ynë, gjejnë realizimin skenik veprat më të mëdha të autorëve shqiptarë dhe atyre të huaj, zhvillojnë talentet e tyre artistët e rinj, shumë prej të cilëve filluan rrugën e tyre si amatorë të thjeshtë dhe tani kanë arritur në një shkallë të lartë profesionale.

Duke e çmuar librin si një mjet të fuqishëm për edukimin ideologjik e estetik të masave, një vëmendje e veçantë u është kushtuar botimeve dhe sidomos botimit të letërsisë artistike. Libri letrar që përhapet në shkallë të gjerë nëpërmjet qindra bibliotekave e librarive popullore është bërë në kuptimin e plotë të fjalës një mjet i përditshëm për edukimin e masave një mik i tyre i ngushtë e i pandarë.

Muzika, piktura e skulptura po ushtrojnë gjithnjë e më shumë një ndikim të konsiderueshëm në edukimin ideo-artistik të rinisë dhe të masave të popullit. Festivalet e gjinive të ndryshme të muzikës dhe hapja e ekspozitave të arteve figurative janë bërë një fenomen i zakonshëm i jetës kulturele.

Ne kemi hedhur hapat e parë modestë në zhvillimin e përhapjen e një arti të ri për vendin tonë siç është ai i kinematogra-

fisë. Rritja e vazhdueshme e prodhimit të filmave, sidomos kronikalë e dokumentarë, ka hedhur tanimë bazat e shëndosha të kinematografisë kombëtare. Për t'u shërbyer sa më mirë masave të popullit është ngritur një rrjet i gjerë prej 241 kinemash, që ndiqen çdo vit nga miliona spektatorë dhe është bërë e mundshme që filmi të çohet edhe në fshat.

Një nga treguesit kryesorë që flet për përhapjen e kulturës në masat e popullit dhe veçanërisht të letërsisë dhe të arteve, është edhe lëvizja e amatorëve të artit, në të cilën janë aktivizuar masat e gjera të fshatit e të qytetit, punonjës të profesioneve e të moshave të ndryshme, burra, gra e fëmijë. Karakteristika kryesore e kësaj lëvizjeje është masiviteti dhe në përgjithësi përmbajtja e shëndoshë ideologjike. Kjo lëvizje e amatorëve të artit, nga njëra anë, ka shërbyer për rritjen e entuziazmit, për edukimin e mobilizimin e punonjësve në punë, dhe, nga ana tjetër, ka angazhuar masat të rinisë punëtore, shkollorë e fshatare në një punë të dobishme për vetë edukimin e tyre në kohën e lirë pas punës e mësimit. Zhvillimi i festivaleve artistike të muzikës e të këngës, i olimpiadave teatrale, i koncerteve të fjalës artistike, i festivaleve të kompozitorëve amatorë etj., në të cilat mesatarisht çdo vit janë aktivizuar deri në 100 mijë vetë, e ka çuar përpara lëvizjen e amatorëve të artit. Kjo lëvizje është një shprehje konkrete e pjesëmarrjes së masave në revolucionin kultural. Ajo është zbatimi i parimit që kultura u përket dhe u shërben masave. Ajo është zbatimi i metodës së vetedukimit të masave dhe i pjesëmarrjes së tyre në krijimin e në drejtimin e kulturës së re socialiste.

Këto realizime flasin për sukseset tona të mëdha në këtë fushë, për karakterin e thellë popullor e demokratik të kulturës sonë, për shpirtin e lartë krijues e ardashës të popullit tonë, për vitalitetin e tij të madh. Këto realizime janë, në të njëjtën kohë, një bazë e shëndoshë për një hov të ri më të madh sasior e cilësor të arteve tona dhe në përgjithësi të kulturës sonë.

Për këtë, detyrë e rëndësishme e organeve të Partisë e të pushtetit është që, në radhë të parë, të interesohen më shumë për shfrytëzimin më me efekt të mjeteve, formave dhe organizmave që kanë në dispozicion për edukimin e masave. Ne duhet të sigurojmë një përhapje, qarkullim e lexim më të madh të librit, një frekuentim më të mirë të bibliotekave dhe një tërheqje më të gjerë të spektatorëve e vizitorëve në teatrot, galeritë, muzeumet e në kinematë tona. Krahas me këtë ne duhet të marrim masat e nevojshme që të pasurohet e të zgjerohet më tej rrjeti dhe baza materiale e institucioneve kulturalo-artistike. Mundet që jemi akoma të kufizuar në mjete, por duke marrë parasysh konditat e vendit tonë, një kujdes i posaçëm duhet të tregohet për zhvillimin më të madh të kinofikimit, të radiofikimit dhe të veprimtarisë botuese, sidomos për fshatin.

1 Lenini për kulturën e artin, f. 577.

Institucionet kulturalo-artistike, profesioniste dhe amatore, kanë për detyrë të vënë në jetë politikën e Partisë mbi zhvillimin e letërsisë e të arteve duke u bërë nxitje e fuqishme për krijimet me përmbajtje të shëndoshë e me nivel të lartë artistik; të sigurojnë kurdoherë një interpretim të drejtë të krijimeve letrare dhe artistike, duke i dhënë përmbajtjes ideore edhe një formë të denjë artistike, të edukojnë në masat shije të drejta estetike dhe një kuptim të drejtë mbi artin, mbi atë që është e bukur e me të vërtetë edukative; të ndihmojnë që krijimet letrare dhe artistike të bëhen një mjet i fuqishëm për edukimin e masave e për mobilizimin e tyre në luftën për ndërtimin e socializmit, të luftojnë ndikimet e huaja formaliste, përçudnimet e shtrembërimet borgjeze e revizioniste, që synojnë në korrumpimin e në degjenerimin e punonjësve, sidomos të rinisë.

Me qëllim që institucionet kulturalo-artistike, punonjësit e kulturës e të arteve dhe lëvizja artistike amatore ta kryejnë më mirë rolin e tyre, duhet të kenë parasysh çështjet e mëposhtme:

Institucionet tona artistike e kulturalë, në të gjithë veprimtarinë e tyre, duhet të udhëhiqen kurdoherë nga kërkesat ideologjike të Partisë, me qëllim që të ushtrojnë në masat një ndikim edukativ gjithnjë e më të madh.

I gjithë programi i punës së institucioneve tona artistike e kulturalë duhet t'i përgjigjet detyrës së edukimit komunist të masave, prandaj, ai duhet t'u bëjë jehonë problemeve politike, ekonomike e shoqërore aktuale që ka Partia. Atë duhet ta përshkojë fund e krye fryma e politikës dhe e ideologjisë së Partisë, sepse vetëm në këtë mënyrë institucionet tona artistike e kulturalë do të militojnë për idetë e socializmit dhe do të ushtrojnë një ndikim të madh edukativ në masat.

Në punën e tyre të deritanishme institucionet e ndryshme, në përgjithësi, janë udhëhequr në radhë të parë nga këto kërkesa. Por në disa raste ato janë lënë në plan të dytë, apo janë lënë pas dore.

Dihet se repertori është elementi kryesor në punën e teatrove. Ai përcakton fytyrën e një institucioni artistik dhe është faktor vendimtar për përmbushjen ose jo me sukses të funksionit të tij edukativ. Mirëpo pikërisht në këtë drejtim ka mjaft dobësi e të meta, si bie fjala në repertorin e teatrove të estradave, të cilat janë një lloj arti mjaft i përhapur te ne dhe tërheqin numrin më të madh të spektatorëve. Pavarësisht nga sukseset që kanë pasur estradat tona, në to janë shfaqur herë pas here edhe gabime apo pasaktësi politike e ideologjike. Satira e humori, sidomos në këtë gjini të artit, janë mjete të fuqishme veprimi mbi masat, por ato duhet të qëllojnë në shenjë, atje ku duhet dhe të nisen nga pozita të shëndosha ideologjike.

Duhet luftuar në të gjitha drejtimet e me të gjitha forcat që orientimi i dhënë, që ato të jenë gazeta artistike të Partisë, që të

trajtojnë në mënyrë artistike problemet politike, ekonomike e shoqërore të ditës, të brendshme e të jashtme, të vihet plotësisht në jetë, pavarësisht nga vështirësitë e mëdha që paraqet ky lloj arti, si në gjetjen e repertorit ashtu edhe në realizimin e tij skenik.

Ndërtimi i një repertori sa më të përshtatshëm natyrisht nuk është problem vetëm për estradat, po për të gjitha llojet e teatrove, sepse ka pasur raste që edhe në skenat e teatrove dramatike të luhen pjesë të gabuara nga ana ideologjike, qoftë të autorëve të huaj, qoftë të atyre shqiptarë. Po kështu, repertori i Teatrit të operës e të baletit lë shumë për të dëshiruar. Në të mungojnë pjesë të tilla që t'i shërbejnë më drejtpërdrejt nxitjes e brumosjes së ndjenjave revolucionare të spektatorëve.

Kështu duhet parë puna edhe me të gjitha organizmat e tjera, të cilat merren me përhapjen e letërsisë, të arteve dhe përgjithësisht të kulturës në masat. Shtëpitë e kulturës, bibliotekat, muzeumet dhe gjithë lëvizja e amatorëve të artit duhet t'u shërbejnë masave dhe t'ja nënshtrojnë të gjithë veprimtarinë e tyre në radhë të parë edukimit komunist të masave. Puna e këtyre institucioneve nuk mund të jetë e shkëputur nga problemet aktuale që ka Partia në fushën e edukimit të masave.

Këto të meta tregojnë se drejtuesit e këtyre institucioneve dhe të organeve përkatëse të pushtetit e të Partisë nuk i kanë kështu kujdesin e duhur problemit të zgjedhjes së repertorit, në mënyrë që ai t'i përgjigjet sa më mirë politikës së Partisë, problemeve aktuale që kanë përpara masat punonjëse.

Parimi më i lartë i të gjitha institucioneve artistiko-kulturalë duhet të jetë që ato t'u shërbejnë masave të gjera të popullit, me qëllim që arti i tyre të vlejë për edukimin si dhe për argëtimin e çlodhjen e kulturuar të punëtorëve, të fshatarëve e të intelektualëve. Ndodh ngandonjëherë që institucionet artistike e kulturalë të mos e mbajnë mirë parasysh këtë parim, të mbyllën brenda katër mureve dhe të bëjnë «art». Natyrisht një art i tillë, që nuk i tërheq masat, që nuk shkon deri te masat, nuk ka vlerë. Këto institucione duhet të bëjnë një punë të madhe propagandistike e organizative, me qëllim që t'i forcojnë sa më shumë lidhjet me masat dhe veçanërisht me rininë, gjë që arrihet në radhë të parë nga fakti se çfarë idesh propagandojnë ato dhe në ç'mënyrë i propagandojnë.

Në fakt, teatrot tona, kush më shumë e kush më pak, kanë siguruar tanimë një spektator të rregullt e të qëndrueshëm. Por kjo është akoma e pamjaftueshme dhe përfaqëson vetëm njërin anë të veprimtarisë së tyre. Ana tjetër, po aq e rëndësishme, është vajtja e trupave teatrale te masat. Në këtë drejtim ka shumë pakujdesi e të meta, për të mos thënë se ka edhe një farë nënvleftësimi. Kjo gjendje duhet të ndryshojë rrënjësisht e sa më parë. Trupat e teatrove duhet të zbresin poshtë, të shkojnë te punëtorët,

te fshatarët, te ushtarët, dhe atje të demostrojne artin e tyre militant. Ato duhet të shkojnë medoemos edhe në fshat, edhe në rrethet e vogla kundrejt të cilave nganjëherë nuk mbahet qëndrim i drejtë nga ana e rretheve që kanë mundësi më të mëdha. Në qoftë se kjo punë do të organizohet më së miri, ajo do të ndihmojë mjaft në edukimin ideologjik dhe estetik të masave dhe njëkohësisht do të vlejë edhe për vetë edukimin e trupave artistike, të cilat ashtu siç thamë edhe për shkrimtarët e artistët, kanë shumë nevojë të njohin jetën e popullit punonjës dhe të mësojnë sa më shumë prej tij.

Organizimi i një veprimtarie të tillë kërkon që të merren një sërë masash duke filluar në radhë të parë nga ndërtimi i një repertori me kërkesa të larta ideologjike e artistike si dhe nga përshtatja e tij kushteve konkrete të vendit tonë.

Për ta kryer më mirë misionin e tyre, institucionet tona artistike e kulture si dhe gjithë lëvizja e amatorëve të artit, repertorin dhe gjithë programin e punës së tyre duhet ta mbështetin kryesisht në krijimtarinë e shkrimtarëve, artistëve dhe kompozitorëve tanë. Kjo do të thotë që në skenat tona të vihen më shumë pjesë kombëtare, të dëgjohen më shumë këngë e muzikë shqiptare, që Ndërmarrja e botimeve të botojë sa më shumë vepra të shkrimtarëve shqiptarë, që ambientet tona të zbukurohen me veprat e piktorëve e të skulptorëve tanë, me motivet e artit kombëtar. Një gjë e tillë duhet bërë, së pari, sepse veprat e shkrimtarëve, artistëve e kompozitorëve tanë kanë një vlerë më të madhe edukative për masat dhe janë më të kuptueshme prej tyre, pasi trajtojnë problemet e punës, të jetës dhe të luftës së popullit tonë dhe së dyti, sepse veprat e autorëve të vendit duhet të përkrahen më shumë e më aktivisht, duke rritur njëkohësisht edhe kërkesat ideo-artistike ndaj tyre. Kjo përkrahje është në të njëjtën kohë një nxitje për krijimtarinë tonë, si për rritjen e sasisë e të gjinive të ndryshme ashtu edhe për përmirësimin e cilësisë.

Vjetët e fundit, duke pasur parasysh porosinë e vazhdueshme të Partisë për t'u dhënë prioritet krijimeve tona kombëtare, është vepruar më mirë në këtë drejtim, por ka akoma shumë për të bërë. Në radhë të parë për vënjen në skenë të pjesëve kombëtare duhet të preokupohen seriozisht si regjizorët ashtu edhe aktorët. Për to të punohet me pasion të veçantë dhe të bëhet një propagandë më efektive, në mënyrë që idetë dhe niveli i tyre artistik të vihen në pah sa më mirë. E vërteta është se nuk veprohet gjithmonë kështu, qoftë nga drejtuesit e teatrove që zgjedhin repertorin, nga regjizorët që i vënë në skenë këto pjesë ashtu dhe nga aktorët që i luajnë. Kjo duket nga një farë nënvleftësimi që u bëhet pjesëve kombëtare, nga ngurrimi për t'i futur në repertor, si dhe disa herë nga puna e përciptë, e pakujdesshme dhe e nxituar që bëhet kur ato vihen në skenë.

Një gjë e tillë vihet re si në ekzekutimin e muzikës sonë popu-

llore ashtu edhe në krijimet e kompozitorëve tanë. Përpunimi dhe ekzekutimi i kësaj muzike nga forcat ekzekutive është, ndofta, shembulli më tipik që shpreh një qëndrim shumë formal ndaj krijimtarisë artistike kombëtare nga ana e institucioneve dhe e disa artistëve e drejtuesve të orkestrave.

Organizatata e Partisë, organet drejtuese të kulturës dhe institucionet tona artistike e kulturele në të ardhshmen, krahas zhvillimit dhe pasurimit të krijimtarisë sonë, duhet të luftojnë që në repertorët të ketë gjithnjë më shumë vepra kombëtare si dhe të përmirësojnë punën e tyre, në mënyrë që krijimet artistike, letrare e muzikore të autorëve tanë të përdoren më mirë e më me efekt për edukimin e masave.

Në bazë të frymës internacionaliste që e përshton gjithë kulturën tonë shumë nga institucionet artistike-kulturale, për ta njohur publikun me kulturën përparimtare botërore si dhe për të plotësuar disa nevoja të tyre, përdorin edhe krijime letrare e artistike të autorëve të huaj. Kështu veprojnë Ndërmarrja e botimeve, teatrot dramatike, Teatri i operës, Kinostudioja etj. Kjo praktikë, sa e pashmangshme aq edhe e nevojshme, përveç problemit të zgjedhjes me kujdes të autorëve dhe të veprave të huaja, nxjerr edhe problemin e raportit midis asaj që është jona dhe asaj që është e huaj. Këtu nuk është fjala për një përlllogaritje të thjeshtë që duhet të bëjnë institucionet, po për një kriter me rëndësi në punën e tyre në përshtatje me konceptet tona ideologjike e estetike.

Nuk shtrohet çështja që të mbyllim dyert për krijimet e autorëve të huaj përparimtarë. Kultura përparimtare botërore e krijuar brez pas brezi është një pasuri e çmueshme që i përket gjithë njerëzimit prej së cilës kultura jonë socialiste duhet të marrë në mënyrë krijuese gjithshka është e vlefshme dhe e dobishme për zhvillimin e saj të mëtejshëm. Por ne duhet të dimë se çfarë të marrim prej saj dhe si ta marrim atë. Sepse nuk duhet të harrojmë se krijimet e huaja, me përjashtim të atyre që i përkasin realizmit socialist, në përgjithësi nuk u përgjigjen kërkesave dhe nevojave tona dhe në mjaft raste përshkohen nga ide të huaja për socializmin, propagandojnë individualizmin dhe humanizmin borgjez. Bile edhe për vepra të atilla të shquara klasike që bëjnë pjesë në thesarin e kulturës botërore dhe që janë modele me vlerë artistike, do të ishte e padrejtë dhe gabim, që, duke i mbyllur sytë përpara emrit të madh të autorëve të tyre, të mos i përmbaheshim analizës klasore dhe të mos i shikonim ato me syrin kritik.

Si në të gjitha fushat edhe në atë të muzikës kemi pasur rezultate të dukshme. Muzika dhe kënga shqiptare buçasin sot nga aparatet e radiove, në skenat tona, në lokalet publike dhe në grupet e lëvizjes artistike amatore. Ajo tingëllon e gjallë, e freskët dhe optimiste, ajo frymëzohet nga eposi popullor, nga jeta jonë e re dhe ka një nivel të denjë artistik.

Por vjetët e fundit, siç e theksuam edhe më lart, na është dashur të luftojmë kundër disa shfaqjeve jo të mira në muzikë, kundër përhapjes e ndikimeve negative të muzikës së huaj, sidomos asaj të lehtë si dhe kundër disa krijimeve të këqia që i çonin muzikën e këngën shqiptare në shkëputje nga muzika e kënga popullore, në imitim të tjerëve si dhe në ritme e në forma interpretimi e ekzekutimi krejt të huaja për ne. Pati një kohë që në radion tonë, në estradat e në orkestrat e lokaleve publike dhe në koncertet e grupeve amatore një vend të madh zinin këngët e huaja, muzika e lehtë e huaj. Si rrjedhim, muzika popullore dhe këngët revolucionare e të punës nuk zinin vendin e duhur. Me gjithë masat që janë marrë, ky problem nuk ka gjetur akoma zgjidhje të plotë, prandaj duhet marrë në dorë më mirë dhe duhet vënë në rrugë të drejtë.

Sigurisht, problemi nuk është i lehtë dhe nuk zgjidhet me një direktivë, sepse këtu ke të bësh me dhjetëra orkestra, me qindra këngëtarë e instrumentistë, me mijëra diletantë e dhjetëramijëra amatorë të muzikës. Të gjithë këta duhen orientuar, bindur e edukuar. Ne nuk jemi kundër muzikës së huaj, por çmojmë e dashurojmë më tepër muzikën tonë kombëtare, prandaj kërkojmë që midis tyre të ekzistojë një raport i drejtë. Ndryshe ne vetë do të jemi përgjegjës për disa shije jo të shëndosha që vëmë re disa herë, sipas të cilave çdo gjë që është e huaj është e mirë dhe çdo gjë që është jona, në mos e keqe, do të jetë medoemos inferiore.

Por nuk mjafton vetëm të respektojmë nga ana formale këtë raport për të cilin po flasim. Kjo nuk do të kishte asnjë vlerë në goftë se, krahas kësaj, nuk do të merrnim të gjitha masat që krijimtarinë tonë kombëtare ta përpunojmë, ta ekzekutojmë, ta paraqitim sa më mirë e sa më bukur, sepse vetëm kështu, ajo do të bëjë efektin e duhur në masat, do të pëlqehet e do të dashurohet prej tyre.

Një vëmendje e posaçme duhet t'i kushtohet veçanërisht përhapjes sa më të gjerë të këngës dhe valles popullore, sidomos në masat e rinisë.

Një çështje tjetër që duhet ta shohim me seriozitetin më të madh është përmbajtja e filmave. Këtu është fjala për filmat që sjellim nga jashtë, duke përjashtuar filmat e Republikës Popullore të Kinës dhe të vendeve të tjera socialiste që janë në pozita të shëndosha marksiste-leniniste. Ne blejmë çdo vit një numër të mirë filmash nga vendet kapitaliste dhe nga ato revizioniste. Sado që organet kompetente përpiqen të zgjedhin filma me një përmbajtje pak a shumë përparimtare, prapëseprapë ata janë të momepsur me ideologjinë dhe me moralin borgjez, apo atë revizionist. Në këtë mënyrë këta filma ushtrojnë një ndikim negativ në edukimin e në formimin e masave të popullit. Dhe kjo është e

natyrshme: ç'mund të mësojë rinia jonë nga jeta boshe e dashnorëve sentimentalë të vendeve borgjeze, apo nga përpjekjet e një markezi që lufton me kontrabandistët e hajdutët për të marrë nën mbrojtje një vajzë nga shtresat e varfëra të popullit të cilën e dashuron? Atëhere pse i sjellim këta filma? Duket me të vërtetë si paradoksale, sepse në një anë i sjellim vetë dhe në anën tjetër i kritikojmë në shtyp dhe flasim për ndikimet e tyre negative në edukimin e masave. Kjo rrethanë do të thotë se problemi është i vështirë, por këtë problem ne duhet ta përballojmë.

Për t'ja arritur kësaj është e nevojshme që, përveç përpjekjeve më të mëdha që duhen bërë për një zgjedhje më të mirë të filmave të huaj, të punohet me spektatorët, të mësohen ata që t'i shohin filmat me sy kritik, të zbulojnë edhe anët e dobëta të tyre dhe të nxjerrin konkluzione të drejta. Për këtë problem duhet të interesohen drejtpërdrejt Kinostudioja «Shqipëria e Re», shtypi ynë me anë recensionesh si dhe organizatat e Partisë e ato të masave duke përdorur format, mjetet e mënyrat më të përshtatshme, të drejtëpërdrejta e të tërthorta, në mënyrë që rinia jonë të jetë më e orientuar në gjykimin e filmave të huaj.

Për të përballuar këtë problem, një rrugë tjetër, sado që e kufizuar, është edhe ajo e rritjes së prodhimeve tona kinematografike. Ne duhet të kujdesemi më shumë për zhvillimin e kinematografisë, sepse vetëm nëpërmjet saj do të gjejmë vend në ekran heronjtë dhe problemet e kohës sonë, të vendit tonë, jeta shqiptare, nga e cila do të frymëzohen dhe do të edukohen masat punonjëse.

Deri sot zhvillimi i artit kinematografik kombëtar ka zënë një vend relativisht të vogël në sistemin e arteve dhe të mjeteve për edukimin ideo-estetik. Për konditat e vendit tonë dhe duke marrë parasysh rëndësinë e kinematografisë, të cilën Lenini e Stalini e kanë quajtur artin më të përshtatshëm për masat, duhet të përkrahët e të stimulohet më shumë zhvillimi i saj, gjë që është e lidhur me mjete më të mëdha financiare dhe me vështirësi të tjera, por që janë të kalueshme, siç janë përgatitja e kuadrove të nevojshëm, sigurimi i skenarëve të përshtatshëm për filma dokumentarë e artistikë etj.

Probleme pak a shumë të ngjashme dalin edhe në fushën e botimeve. Librat e botuara, sidomos ato origjinale, deri-diku edhe ato të përkthyer nga letërsia e huaj, janë zgjedhur mbi bazën e disa kriterëve dhe kanë luajtur një rol me rëndësi në edukimin e masave. Numri i lexuesve është shtuar shumë, sidomos në masat e të rinjve. Përhapja në një shkallë të gjerë e librit letrar artistik nëpërmjet qindra bibliotekave e librarive popullore është sot një nga fenomenet më kuptimplotë të jetës sonë kulturale-shoqërore.

Sukseset dhe anët e dobëta të letërsisë të vjetëve të fundit

pasqyrohen edhe në lëmin e botimeve. Në këta katër vjetët e fundit botimi i veprave letrare të autorëve shqiptarë është shtuar në mënyrë të dukshme duke rritur njëkohësisht edhe kërkesat ideore dhe artistike ndaj autorëve. Kjo ka qenë një rrugë e drejtë. Por megjithatë janë botuar edhe disa vepra me dobësi ideore e artistike.

Shumë është bërë për botimin e veprave nga letërsia e huaj. Janë botuar veprat e autorëve më të shquar dhe veprat më të njohura të kohëve e të vendeve të ndryshme. Kjo ka qenë një punë e madhe që i ka ndihmuar lexuesit për t'u njohur me letërsinë botërore. Megjithëse në këtë drejtim përgjithësisht është vepruar drejt, ka pasur raste që janë botuar edhe vepra të molepsura me ide të huaja e reaksionare për ideologjinë tonë, siç janë pacifizmi, pesimizmi, individualizmi e humanizmi borgjez. Shkrimtarët e Perëndimit, qofshin edhe ata më përparimtarë, jetojnë e punojnë në kushtet e shoqërisë borgjeze. Veprat e tyre pasqyrojnë këtë shoqëri me veçoritë e saja, ato janë shkruar në radhë të parë për lexuesit e vendeve kapitaliste. Dihet gjithashtu se veprat e tyre më të mira i përkasin, përgjithësisht, realizmit kritik. Për këto arësye rreziqet e përhapjes së letërsisë perëndimore nuk duhen injoruar. E njëjta gjë duhet thënë edhe për veprat letrare të shkrimtarëve të vendeve revizioniste. Prandaj, në këtë front të botimeve letraro-artistike duhet ecur me kujdes dhe duhet punuar me përgjegjësi të madhe, duke zgjedhur më mirë veprat që duhen botuar, si dhe duke i shoqëruar me parathënje serioze, ku të vihen në dukje në mënyrë kritike idetë e autorit dhe vlera e veprës, me qëllim që të ndihmohen lexuesit për ta kuptuar drejt veprën.

Një çështje tjetër në të cilën duhet të përqëndrohet vëmendja e institucioneve kulturalo-artistike është përmirësimi i cilësisë së punës dhe ngritja e mëtejshme e mjeshtërisë artistike. Në këtë drejtim ne kemi pasur rezultate të mëdha. Në arritjen e këtyre rezultateve rol vendimtar kanë luajtur orientimet e drejta të Partisë dhe zhvillimi në rrugë të drejtë i gjithë krijimtarisë letrare e artistike në vendin tonë, kujdesi i vazhdueshëm dhe ndihma për regjizorët, aktorët, instrumentistët e këngëtarët dhe për gjithë artistët e skenës, lufta e pandërprerë kundër ndikimeve të kulturës e të artit borgjez e revizionist si dhe përgatitja e një ushtrie të tërë kuadrosh të aftë e besnikë për të gjitha degët e artit, në fillim jashtë shtetit dhe tani në shkollat tona.

Ne kemi sot një nivel të mirë në artin vokal. Teatri ynë gjithashtu ka bërë përparime të dukshme, kurse dobët është puna në estradat, në orkestrat e në koret si dhe në trupat e valleve. Ngritja e nivelit kultural e artistik të masave ka rritur kërkesat ndaj trupave e artistëve tanë. Prandaj duhet të ngrihet në një nivel më të lartë gjithë puna e tyre, sepse nuk mjafton vetëm të sigurojmë

një përmbajtje të shëndoshë, por është e domosdoshme të arrihet edhe një nivel i lartë artistik me sa më shumë mjeshtëri, kulturë dhe art. Dihet se regjizura, ekzekutimi dhe interpretimi, skenografia etj., luajnë një rol të rëndësishëm në ngritjen ose në uljen e vlerave të vërteta të një veprë dramatike ose muzikore, në zhvillimin e ideve të autorit e në transmetimin e tyre te spektatorët dhe dëgjuesit.

Një pengesë serioze për ecjen përpara me ritmet e kërkua në çështjen e cilësisë artistike është të kënaqurit me pak, fenomen ky që vihet re në disa trupa artistike. Si në artin lirik vokal e në atë teatral ashtu edhe në estradat, në orkestrat, në koret e në grupet e valleve, pas një periudhe plot suksese, bien në sy disa shënja që flasin për një farë vetëkënaqësie me atë që është arritur dhe shfaqet mendimi sipas të cilit niveli i sotëm është i mjaftueshëm për publikun tonë. Qëndrime të tilla janë të rrezikshme për artin dhe duhen luftuar. Mendime të tilla diktohen nga arësye subjektive, që kanë lidhje me nivelin e ulët kultural dhe me përgatitjen e pamjaftueshme profesionale të një pjese jo të vogël të atyre që punojnë në trupat e ndryshme artistike.

Estradat më shumë se kushdo vuajnë nga niveli i ulët artistik. Kur flasim për nivelin e tyre të ulët artistik, kemi parasysh se ky është bërë një fenomen pothuajse i përgjithshëm i punës së tyre duke filluar që nga tematika, nga trajtimi artistik e deri te pjesa vokale e instrumentale. Duket qartë se e meta kryesore e punës së tyre është diletantizmi. Shkaqet e këtij diletantizmi janë sa subjektive aq edhe objektive. Ne e filluam këtë punë pa asnjë eksperiencë dhe kryesorja, pa pasur kuadrot e nevojshëm. Në punë e sipër shumë kuadro u aftësuan, por shumë të tjerë nuk shkuan më larg se niveli i grupeve diletante prej nga vinin. Kjo ndodhi si për disa aktorë e orkestrantë ashtu edhe për disa regjizorë. Dhe, ajo që është më e keqja, ne nuk kemi qenë në gjendje deri më sot që t'i furnizonim me kuadro profesionalisht të përgatitur dhe, nga ana tjetër, vetë pjesëtarët e këtyre trupave nuk kanë bërë gjithnjë përpjekjet e duhura për të ngritur nivelin e tyre nëpërmjet një pune këmbëngulëse individuale.

Kjo gjendje vazhdon të ekzistojë akoma. Niveli arësimor mesatar i trupave të estradave nuk e kalon shtatëvjeçaren, kurse ai profesional është shpeshherë minimal. Ministria e Kulturës dhe e Arteve duhet të marrë masa më të shpejta e më rrënjësore për aftësimin e trupave të estradave, për ngritjen e rolit të tyre, për ngritjen e nivelit të tyre artistik. Dhe kjo duhet filluar nga lufta që duhet të bëjnë vetë trupat kundër ndjenjës së të kënaqurit me pak, mediokritetit e shfaqjeve të diletantizmit.

S'ka dyshim se lufta kundër këtyre shfaqjeve nuk është diçka që u përket vetëm teatrove të estradave. Lufta për një profesionalizëm më të lartë, lufta për ngritjen e nivelit artistik të punës,

për ta bërë çdo gjë më bukur, më mirë, është një problem me rëndësi që shtrohet para gjithë institucioneve artistiko-kulturale.

Teatrot dramatike, për shembull, kanë arritur rezultate të dukshme, sidomos vjetët e fundit, për shkak të një zhvillimi më të madh që pati dramaturgjia jonë dhe të diplomimit të regjizorëve dhe të aktorëve të rinj. Por pikërisht në po këta vjet u bë akoma më e qartë edhe nevoja e një përmirësimi të mëtejshëm të punës së tyre, sepse sot për sot ato po mjaftohen me atë që qe e pëlqyeshme dje.

Për të shënuar një hov të ri edhe më të madh në punën e teatrove duhet të kapemi pas hallkave kyçe të punës së tyre. Pikësepari e mbi të gjitha qëndron përcaktimi i repertorit më të përshtatshëm, në mënyrë që ai t'u përgjigjet detyrave aktuale dhe kërkesave ideo-politike për të cilat folëm më lart. Një hallkë tjetër është ajo e regjizurës. Ne kemi akoma pak regjizorë dhe deri më sot nuk kemi mundur t'i përgatitim në vend. Duke qenë si numër të paktë, mbi shpatullat e tyre bie një punë voluminoze dhe në këtë mënyrë është e kuptueshme që pas një kohe, vjen një farë boshatisje e frymëzimit artistik dhe përsëritje e vetëvetes. Ky fenomen ka filluar ta nxjerrë kokën edhe për shkak të studimit të pamjaftueshëm e të përpjekjeve të pakta nga ana e tyre. Regjizura jonë në përgjithësi është realiste, por nuk mungojnë rastet kur regjizorët, nga dëshira që të jenë origjinalë, i largohen kësaj karakteristike themelore dhe, ngandonjëherë, bien në konvencionalizëm të tepruar, në formalizëm etj. Këto zigzage të gabuara, që përdoren shpesh si rruga më e shkurtër dhe më e lehtë, dëmtojnë si lojën e aktorëve ashtu edhe vlerën edukative të pjesës.

Në përmirësimin e punës së teatrove ndikon drejtpërsëdrejti edhe gjendja profesionale e trupave. Disa nga pjesëtarët e tyre nuk kanë as arësimin profesional e as talentin e duhur dhe, çka është më e keqe, nuk bëjnë përpjekjet e nevojshme për t'u kualifikuar në punë e sipër, nuk kanë ecur krahas me përparimet që kanë bërë teatri, opera, baleti etj. dhe janë bërë një pengesë serioze për ngritjen e nivelit artistik në këto institucione. Kjo situatë bën që vendin e një atmosfere të shëndoshë pune e krijimtarie ta zërë, ngandonjëherë, rutina. Rritja e aftësive artistike kërkon një punë këmbëngulëse, së cilës nuk duhet t'i shmangen artistët tanë, qoftë nëpërmjet shkollave e kurseve, qoftë nëpërmjet një pune e studimi individual të pandërprerë. Nga ana tjetër, Ministria e Kulturës dhe e Arteve duhet të marrë të gjitha masat që trupat e teatrove të plotësohen me gjak të ri nga diplomantët e shkollave të larta artistike.

Shkollat e larta artistike në tërësi janë në rrugë të drejtë, kanë hedhur baza të shëndosha dhe diplomantët që kanë dalë prej tyre kanë treguar përgatitje të mirë ideore dhe artistike. Në këto

shkolla, krahas punës pedagogjike, duhet të forcohet edhe puna shkencore, të përcaktohen edhe më mirë profilet në përshtatshmëri me nevojat tona, të rritet niveli i mësimi e i përgatitjes së studentëve dhe të forcohet edhe më shumë karakteri kombëtar i tyre.

Edukimi i shijeve të drejta estetike në masat është një problem tjetër i madh që duhet t'i preokupojë më shumë organet e Partisë, të pushtetit dhe organizatat e masave.

Shtresa të ndryshme të popullsisë, kategori të ndryshme njerëzish dhe persona të veçantë kanë shije të ndryshme artistike. Por personi i veçantë rron në një shoqëri të caktuar, i përket një kombi, një klase dhe një shtrese të caktuar të popullsisë. Shijet e tija estetike nuk janë të shkëputura nga të gjitha këto rrethana derisa personi i caktuar është i lidhur me to në mënyrë të pazgjidhshme.

Këtë rrjedh se çështja e shijeve estetike është një çështje botëkuptimi, sepse të pëlqesh muzikën e popullit tënd apo muzikën dekadente perëndimore, të pëlqesh letërsinë e artin e vendit tënd apo të mos i përfillësh ato dhe të priresh pas modeleve të huaja duke u pajtuar kështu edhe me idetë e tyre, kjo është një çështje ideologjike. Duke vazhduar këtë ide, mund të themi se edhe mënyra si vishet njeriu, si rregullon ambientin ku punon e jeton etj., ka lidhje me formimin ideologjik të tij.

Shijet estetike edukohen, prandaj Partia duhet të punojë me këmbëngulje për të edukuar në masat shije të drejta duke luftuar kundër shijeve të këqia, që dëmtojnë formimin estetik të punonjësve dhe ndërgjegjen e tyre. Një gjë e tillë arrihet duke bërë një punë të madhe për të përhapur sa më gjerë në masat librin, muzikën, pikturën dhe të gjitha mjetet e tjera që i shërbejnë edukimit ideo-estetik të masave. Më lart folëm për zhvillimin e madh që ka marrë veprimtaria botuese në vendin tonë. Por rëndësi në këtë mes ka që librat e botuara të lexohen nga masat. Dhe në këtë drejtim, me gjithë përparimet e dukshme, ne duhet të ngremë zërin me forcë, sepse rezulton që, në përgjithësi, lexohet pak. Kjo situatë duhet të na preokupojë më tepër dhe të vëmë të gjitha forcat që libri të dashurohet e të lexohet më shumë nga të gjithë. Leximi duhet të bëhet edukatë nga çdo njeri, i madh e i vogël, sepse, sidomos për konditat e vendit tonë që në disa drejtime ka mjete më të pakta, libri përfaqëson një rezervë të jashtëzakonshme për ngritjen e kulturës së popullit.

Çështja bile nuk shtrohet vetëm që të lexohet sa më shumë, por edhe çfarë të lexohet, e sidomos me ç'sy të lexohet. Prandaj, që leximi të japë rezultatin maksimal dhe t'i përgjigjet detyrës për edukimin e shijeve të drejta estetike, organet e Partisë e të pushtetit dhe organizatat e masave duhet të kujdesen më shumë e më konkretisht për politikën e përhapjes së librave, për udhëheqjen e leximit të librave nga masat dhe veçanërisht nga rinia.

Një kujdes më i madh duhet të tregohet veçanërisht edhe përse i përket përhapjes së veprave të arteve figurative nëpërmjet muzeumeve, galerive, botimeve e riprodhimeve, parqeve e vendeve publike, me qëllim që masat t'i shijojnë më shumë ato e të edukohen nëpërmjet tyre.

Shkolla luan një rol të veçantë në formimin dhe në edukimin ideo-estetik të brezit të ri. Në shkollë rinia merr formimin fillestar estetik si nëpërmjet lëndëve speciale, siç janë letërsia, muzika, vizatimi, ashtu edhe nëpërmjet gjithë punës mësimore e edukative që bëhet atje. Sa më me baza të jetë ky formim estetik i nxënësve, aq më shpejt e më drejt do të orientohen ata në jetë lidhur me çështjet estetike. Sot në shkollën tonë bëhet një punë e madhe në këtë drejtim por megjithkëtë ka aq dobësi e të meta saqë masat që duhen marrë kanë një karakter të ngutshëm e të gjithanshëm. E keqja kryesore buron nga nënvleftësimi që i bëhet këtij problemi nga vetë shkolla, si nëpërmjet lëndëve të djathtësisë ashtu edhe nëpërmjet gjithë punës edukative e kulturele jash-të mësimi. Shkolla jonë duhet t'i japë një rëndësi të madhe edukimit estetik të brezit të ri me koncepte e shije të shëndosha, që t'u vlejë për gjithë jetën. Mësimi i letërsisë, i muzikës, i vizatimit duhet të bëhet një orë interesante dhe mjaft tërheqëse për nxënësit, që jo vetëm t'u ngjallë atyre dashurinë për artin, por edhe t'i pajisë me një kulturë modeste artistike si dhe të zgjojë e të nxitë talentet e tyre të fshehura.

Me problemin e edukimit ideo-estetik nuk duhet të merren vetëm disa institucione të caktuara, por e gjithë shoqëria jonë. Në fakt njerëzit, në të gjithë jetën e tyre, ndeshen me probleme që kanë të bëjnë me edukimin e ndjenjës së të bukurës duke filluar që nga familja, ambienti i punës e deri në institucionet artistike, që nga ndërtimi i fshatrave, i qyteteve e deri te punimet e drurit e qëndizmat. Për këtë arsye është e nevojshme që çështja e edukimit ideo-estetik të bëhet një problem për të gjithë shoqërinë tonë.

Le të marrim si shembull arkitekturën. A nuk është ajo njëkohësisht edhe shkencë e përpiktë edhe art? S'ka dyshim se ajo ka të bëjë shumë me edukimin ideo-estetik, bile shokët arkitektë kanë të drejtë kur thonë se përpara artit, në kuptimin e ngushtë të fjalës, është ajo, arkitektura, që ushtron ndikimin estetik të parë e të pashmangshëm te masat. Ngado që të shkojmë do të ndeshemi me ndërtesat, ansamblet e ndryshme, parqet, lulishtet, monumentet, bile edhe me vitrinat e magazinave. Të gjitha këto nuk ka si të mos ndikojnë në edukimin estetik të bashkëqytetarëve tanë.

Organizatata e Partisë, organizatat e masave dhe organet e pushtetit duhet të tregojnë një vëmendje të veçantë për zhvillimin e lëvizjes artistike amatore, për zgjerimin e saj në qytet e në fshat, për ngritjen e saj në një nivel ideo-artistik më të lartë.

Zhvillimi, nxitja dhe organizimi më i mirë i lëvizjes artistike amatore, duke zgjeruar edhe më shumë numrin e pjesëmarrësve si dhe duke ngritur nivelin ideo-artistik të saj, është një detyrë me rëndësi për organet dhe për institucionet shtetërore, për organizatat e masave, për punonjësit profesionistë të artit si dhe për të gjithë pjesëmarrësit e kësaj lëvizjeje të gjerë artistike. Çdo pikëpamje për të nënvleftësuar rolin e lëvizjes artistike amatore, nën pretekstin se niveli artistik i saj është i ulët, duhet hedhur poshtë. Në zhvillimin e artit ne duhet të ecim në të dy drejtimet edhe me institucionet profesioniste, edhe me lëvizjen amatore. Ato jo vetëm nuk përjashtojnë por, përkundrazi, e plotësojnë njëra-tjetrën.

Trupat profesioniste, sado që mund të zhvillohen, nuk mund t'i përballojnë të gjitha nevojat e vendit. Prandaj, grupet artistike amatore, duke tërhequr me mijëra e dhjetëra mijëra njerëz në një lëvizje masive, plotësojnë shumë kërkesa të masave dhe ndihmojnë për zhvillimin e talenteve, të cilat do të mbushin më vonë trupat profesioniste. Ato luajnë një rol me rëndësi për të rritur në masat dashurinë për letërsinë, teatrin, muzikën, artet figurative dhe për edukimin e tyre ideo-estetik. Lëvizja artistike amatore është njëkohësisht një mjet artistik i fuqishëm dhe i veçantë i agjitacionit politik të Partisë, që ushtron një ndikim të madh në edukimin politik e moral të punonjësve.

Kuadri drejtues i kësaj lëvizjeje luan pa dyshim rolin vendimtar. Grupet amatore kanë nevojë për regjizorë, për drejtues orkestrash e koresh, për instrumentistë, për piktorë etj. Në qoftë se në grupet artistike amatore deri tani nuk ka stabilitet dhe niveli i tyre është i ulët, shkaku duhet kërkuar kryesisht në mungesën e kuadrit drejtues.

Kuptohet se gjithë kuadrin drejtues të lëvizjes amatore nuk mund ta përgatitim me anë të shkollave artistike. Prandaj, detyra e organeve të pushtetit dhe të Partisë është që në këtë drejtim të veprojnë me guxim duke zgjedhur si drejtues amatorët më të mirë, të cilët mund të kualifikohen nëpërmjet kursesh të shkurtëra pranë shtëpive të kulturës. Nga ana tjetër, të aktivizohen për këtë qëllim arësimtarët dhe përse i përket drejtimit të grupeve artistike amatore të qendrave të punës në qytete mund të përdoren edhe aktorët, pjesëtarët më të mirë të orkestrave e të koreve, të cilët duhet të kenë nën kujdestari grupe të ndryshme amatore.

Vështirësia tjetër është në repertorin, i cili është i varfër si sasi dhe i dobët si cilësi. Ndodh që në festivale ose në olimpiada të ndryshme grupet artistike amatore paraqiten me të njëjtat pjesë muzikore, teatrale etj., gjë që krijon përsëritje e monotoni. Shpesh ato e kanë vështirë të gjejnë pjesë të përshtatshme për nivelin dhe për qëllimet që i vënë vetes. Ka ekzistuar një mendim se me këtë çështje duhet të merret kryesisht qendra, e cila duhet të furnizojë bazën me këtë lloj lënde të parë, kurse në të vërtetë duhet të jetë

baza ajo që duhet dhe ka mundësi të plotësojë nevojat e grupeve të saj me repertor, i cili në këtë mënyrë do të jetë edhe më afër jetës e problemeve të terrenit. Shtëpitë e kulturës duhet t'i aktivizojnë më mirë forcat krijuese të rrethit, lokalitetit ose të kooperativës dhe të përdorin gjerësisht shpalljen e konkurseve.

Rëndësi e veçantë duhet t'i jepet sidomos orientimit të kësaj lëvizjeje artistike. Ka shënja që ajo të prirët më shumë ndaj gjinisë së estradës dhe muzikës së lehtë. Një gjë e tillë është e gabuar. Pa nënvleftësuar edhe këto gjini të artit është e nevojshme, në radhë të parë, që lëvizja artistike amatore të merret më shumë me përhapjen e këngës e të valles popullore si dhe me këngët revolucionare, qytetare e të punës. Përveç kësaj, ne duhet të punojmë që të ngjallim e të rritim një lëvizje të gjerë edhe në radhët e amatorëve të letërsisë, të vizatimit dhe të gjinive të tjera të artit.

Në lidhje me zhvillimin e kulturës dhe të lëvizjes artistike amatore në fshat ka një problem të rëndësishëm: sa bën shteti për fshatin në fushën e kulturës nga pikëpamja materiale? Nga një shikim i vëmendshëm mund të thuhet se në këtë drejtim duhen marrë masa më të efektshme inkurajuese dhe duhen vënë disa përpjesëtime më të drejta në shpërndarjen e mjeteve financiare për sektorët social-kulturalë të fshatit.

Udhëheqja e Partisë — garanci për suksese të mëtejshme në fushën e letërsisë e të arteve

Sukseset e mëdha të letërsisë e të arteve, shpërthimi i paparë i talenteve të reja, lidhja e tyre e ngushtë me veprën heroike të popullit tonë, janë rezultat i udhëheqjes së drejtë të Partisë në këtë fushë.

Udhëheqja e drejtë e Partisë do të jetë edhe në të ardhshmen garanci që letërsia dhe artet të arrijnë rezultate të reja, edhe më të mëdha. Po kur flasim për udhëheqjen e Partisë nuk duhet të kuptojmë me këtë vetëm atë udhëheqje të përgjithshme ideologjike që Partia realizon nëpërmjet anëtarëve të saj në sektorët e letërsisë e të arteve, por një udhëheqje të përditshme e konkrete nga ana e organizatave të Partisë, e cila ka të bëjë me zgjidhjen e drejtë të problemeve që dalin gjatë punës në frontin letrar-artistik.

Detyrat që shtrohen në këtë plenum për zhvillimin e mëtejshëm të letërsisë e të arteve kërkojnë që të forcohet, të përmirësohet dhe të kualifikohet udhëheqja e komiteteve dhe e organizatave të Partisë. Vetëm këtu duhet parë garancia më e sigurtë që këto detyra shumë të rëndësishme të gjejnë zbatimin e tyre të plotë në jetë. Por që të forcohet e të përmirësohet udhëheqja e

organizatave të Partisë është e nevojshme, në radhë të parë, që ato të njohin edhe më thellë specifikën e këtyre sektorëve, d.m.th. vendin dhe rolin që zë arti në kulturën dhe në pasurinë shpirtërore të popullit tonë, natyrën, përmbajtjen, formën dhe mjetet që përdor ai. Vetëm në këtë mënyrë ato do të jenë në gjendje të drejtojnë si duhet. Në qoftë se ndonjë komitet partie në udhëheqjen e sektorëve të letërsisë e të arteve do të përdorë po atë metodë dhe po atë stil pune që përdor edhe në udhëheqjen e sektorëve të tjerë, të themi, fjala vjen, të atij ekonomik apo ushtarak, atëhere rezultatet nuk do të jenë të kënaqshme. Ai komitet partie nuk do të luajë plotësisht rolin e tij prej udhëheqësi dhe praktikisht do të dobësojë kontaktin dhe komunikimin me punonjësit e këtyre sektorëve.

Atëhere në se duhet të konsistojë udhëheqja e organizatave të Partisë për letërsinë dhe për artet?

Në punën e tyre për të udhëhequr letërsinë dhe artet komitetet e Partisë duhet të kapen në radhë të parë pas problemeve që kanë të bëjnë me orientimin ideo-politik të krijimtarisë, pas problemeve që kanë të bëjnë me saktësinë ideologjike të saj, si të përmbajtjes ashtu edhe të formës. Në qoftë se me punën tonë do të bëjmë që letërsia dhe artet të zhvillohen në një rrugë të shëndoshë dhe të pastër nga pikëpamja ideologjike, atëhere mund të themi se e kemi kryer mirë detyrën tonë për udhëheqjen e drejtë të krijimtarisë. Veç duhet pasur parasysh se orientimi ideo-politik nuk është një gjë e dhënë një herë e përgjithmonë, por një ndihmë e vazhdueshme që duhet dhënë në vartësi nga problemet që shtrohen për t'u zgjidhur dhe nga specifika e tyre.

Lidhur me këto, organizatat e Partisë duhet të tregojnë më shumë kujdes për të kapur problemet më me peshë të frontit kulturalo-artistik, ato që më shumë se kushdo veprojnë në edukimin komunist të masave. Për fat të keq, disa herë është vënë re që organizatat e Partisë bien në praktikizëm dhe mbeten në sipërfaqe të çështjeve. Ç'ndodh p.sh. me organizimin e festivaleve të ndryshme të muzikës, këngës e valleve të amatorëve të artit? Shumë organizata partie me të drejtë vihen në garë midis tyre dhe bëjnë përpjekje që t'ja kalojnë njëra-tjetrës në organizimin sa më të mirë të këtyre festivaleve. Mirëpo këto përpjekje kthehen shpesh në një ngarendje pas shifrave e treguesve të ndryshëm sasiorë në vend që të kujdesen për orientimin e kësaj lëvizjeje, në mënyrë që ajo të jetë e shëndoshë nga ana ideo-politike dhe t'i shërbejë edukimit të masave me frymën revolucionare të Partisë.

Kusht i domosdoshëm për forcimin dhe përmirësimin e udhëheqjes së Partisë është edhe njohja më mirë e problemeve specifike të karakterit estetik që kanë letërsia dhe artet. Ka ardhur koha që organet e Partisë, e në radhë të parë kuadrot që merren me sektorin letrar-artistik, të perfeksionohen e t'u hyjnë më thellë

problemeve të krijimtarisë artistike. Arti po zhvillohet me ritme të shpejta dhe në të gjitha gjinitë e rëndësishme të tij, sidomos në rrethet kryesore të vendit. Për t'u dhënë shkrimtarëve e artistëve një ndihmë më të efektshme jo vetëm në çështjet ideologjike, por edhe në ato artistike, kuadrot e Partisë, veçanërisht ata që lidhen drejtpërdrejt me këta sektorë, duhet të studjojnë bazat e estetikës marksiste-leniniste. Një gjë e tillë do t'i forcojë edhe më shumë lidhjet dhe kontaktin e tyre me punonjësit e krijimtarisë. Por, duke bërë këtë është e nevojshme të luftohet kundër çdo tendence apo shfaqjeje për të vendosur një tutelë mbi punën e shkrimtarëve dhe të artistëve për të zënë pozitën e mësuesit në procesin e punës së tyre krijuese. Nga ana tjetër, punonjësit e letërsisë e të arteve duhet të bëjnë përpjekje më të mëdha për të përvetësuar ideologjinë e Partisë, gjë që arrihet, përveç të tjerave, duke siguruar udhëheqjen e Partisë, duke kërkuar këshillat dhe ndihmën e saj.

Karakteristika kryesore e udhëheqjes së Partisë në sektorët e letërsisë e të arteve është, pa dyshim, puna e saj bindëse. Më shumë se kudo drejtimi i këtyre sektorëve duhet bërë jo me anë udhëzimesh të përgjithshme, por me një punë të madhe sqaruese individuale, me një qëndrim të vëmendshëm e të durueshëm ndaj çdo shkrimtari e artisti. Dhe në të kundërtën, këtu më pak se kudo mund të përdoren masa administrative dhe metoda e komandimit. Është e nevojshme të kihet parasysh se në krijimtarinë artistike janë të domosdoshme iniciativat personale, prirjet individuale dhe fantazia. Natyrisht, kjo nuk do të thotë që organizatat e Partisë të jenë tolerante ndaj shfaqjeve të huaja e veprave të shtrembëra ideologjike. Përkundrazi, ato duhet të jenë gjithmonë vigjilente e parimore, në mënyrë që të ruhet gjithnjë e pastër platforma ideologjike e letërsisë dhe e arteve.

Partia e realizon udhëheqjen e saj edhe nëpërmjet komunistëve që punojnë në sektorët e letërsisë dhe të arteve, të cilët bëhen përcues të politikës dhe të ideologjisë së saj. Sa më të pjekur të jenë këta komunistë, sa më të ngritur nga ana ideologjike e sa më luftarakë të jenë ata, aq më mirë do të jetë për mbarëvajtjen e punëve. Prandaj është detyrë e komiteteve të Partisë që t'u kushtojnë kujdes të madh forcimit dhe kalitjes së organizatave bazë të Partisë që punojnë në sektorët e letërsisë e të arteve, të kulturës përgjithësisht. Vihet re, ngandonjëherë, që pikërisht në këto organizata ka shfaqje të mungesës së disiplinës, të mungesës së principialitetit, bile edhe grindje e tarafe. Shpesh këto gjëra bëhen nën pretekstin se «jemi artistë» dhe se natyra e punës nuk mund të pajtohet me një disiplinë të rreptë, se ajo kërkon më shumë elasticitet etj. Në qoftë se ka shokë që gëzojnë në këtë mënyrë, natyrisht, ata gabojnë. Në Partinë tonë marksiste-leniniste nuk ka dy disiplina. Komunisti, çfarëdo që të

jetë, punëtor apo intelektual, ushtarak apo artist, para së gjithash, është komunist që ka përqaftuar idealet e socializmit, për të cilat ai është gati të japë edhe jetën po ta dojë nevoja, që lufton pa u lodhur për zbatimin me përpikmëri të vijës së Partisë, që i përmbahet me rreptësi disiplinës së Partisë. Shkrimtarët dhe artistët komunistë duhet të jenë luftëtarë të zjarrtë për zbatimin e politikës së Partisë në fushën e letërsisë e të arteve dhe me forcën e shembullit të tyre duhet të mobilizojnë gjithë masën e punonjësve krijues për t'i çuar edhe më përpara letërsinë dhe artet tona.

Kur flasim për forcimin e organizatave bazë të Partisë të këtyre sektorëve duhet të kemi parasysh, në radhë të parë, kujdesin për të ngritur principialitetin e shkrimtarëve dhe të artistëve në drejtimin e në shqyrtimin e çështjeve. Duhet ta themi se mjaft nga gabimet në të cilat kanë rënë disa shokë nuk do të kishin ndodhur në qoftë se shokët komunistë, kuadrot dhe gjithë punonjësit e këtij fronti do të ishin treguar më principialë, më luftarakë, në qoftë se do të punonin duke u nisur nga mësimet e Partisë dhe jo nga simpatitë apo antipatitë personale.

Krahas luftës për një principialitet më të lartë duhet shtruar edhe lufta kundër një farë indiferentizmi që vihet re disa herë në radhët e shkrimtarëve dhe të artistëve. Partia e ka shpjeguar edhe herë të tjera se indiferentizmi është një pozitë ideologjike shpesh gabuar, një mentalitet mikroborgjez, që çon ujë në mullirin e huaj, prandaj ai nuk u shkon për shtat njerëzve tanë e aq më pak komunistëve.

Partia jonë ka bërë një punë të madhe për edukimin ideologjik të shkrimtarëve dhe të artistëve. Frutet e kësaj pune, frutet e udhëheqjes së drejtë të Partisë janë të dukshme; karakteristika e përbashkët e gjithë punonjësve të letërsisë e të arteve, me parti ose pa parti qofshin, është fryma e besnikërisë së tyre ndaj Partisë, socializmit dhe ndaj ideologjisë marksiste-leniniste, është patriotizmi i tyre i flaktë, lidhja e tyre e ngushtë me jetën dhe me interesat e popullit tonë, pjekuria politike për të qenë kurdoherë në lartësinë e detyrave kombëtare e ndërkombëtare që qëndrojnë para Partisë dhe popullit tonë.

Në çdo kohë e në çdo rrethanë, sado e vështirë dhe e komplikuar që të ketë qenë, inteligjencia jonë artistike, ashtu si i gjithë populli ynë, ka qëndruar e patundur përkrah Partisë në pozitë të shëndosha të ideologjisë marksiste-leniniste dhe ka luftuar me guxim e me vendosmëri për mbrojtjen e vijës së Partisë sonë.

Por, sigurisht, do të ishte gabim të mendonim se në punën tonë çdo gjë shkon vetëm mirë, pa zigzage, pa vështirësi e të meta. Presioni i ideologjisë borgjeze e revizioniste bën punën e vet për të lëkundur e për të përçarë kompaktësinë e radhëve të inteligjencës sonë artistike. Revizionizmi, me flamujt e tij joshës e mashtrues për një art «të kulluar», «antiskematik», «thelësisht realist», «hu-

manist» etj., përpiqet të ngjallë konfuzion, të çorientojë e të largojë letërsinë e artin tonë nga rruga e vetme e drejtë, e realizmit socialist. Në këtë situatë problemi i edukimit të mëtejshëm ideologjik, politik e moral të letrarëve e artistëve mbetet problemi kyç më i rëndësishëm i Partisë sonë. Nevoja e përmirësimit dhe e forcimit të gjithanshëm të kësaj pune diktohet edhe nga vetë zhvillimi i letërsisë dhe i arteve tona.

Është e nevojshme që shkrimtarët dhe artistët tanë, gjithë punonjësit e kulturës, të përvetësojnë më mirë materializmin dialektik e historik dhe ta lidhin atë me problemet e punës së tyre. Në të ardhshmen del nevoja e përmirësimit të sistemit të arësimit në parti me inteligjencien krijuese duke përfshirë këtu, përveç problemeve të përgjithshme ideologjike, edhe tema mbi estetikën marksiste-leniniste, tema të lidhura me problemet aktuale të letërsisë e të arteve tona, si dhe me luftën kundër revizionizmit në këtë fushë. Një kombinim i tillë i punës ideo-politike me atë profesionale do të vlente për kalitjen e mëtejshme të shkrimtarëve dhe të artistëve si dhe për përvetësimin e drejtë nga ana e tyre të metodës së realizmit socialist. Në këtë mënyrë seminarët teorike do të bëheshin shkolla të vërteta, ku do të vlonin e do të rriheshin mendime të ndryshme dhe ku do të forcohej uniteti i nevojshëm për problemet themelore ideo-estetike. Kujdes të posaçëm duhet të tregojnë organet e Partisë për organizimin e mirë të diskutimeve krijuese teoriko-profesionale, të cilat luajnë një rol të madh në edukimin e gjithanshëm të artistëve e të shkrimtarëve. Niveli ideo-artistik i kuadrove është rritur shumë, pra, ne i kemi të gjitha mundësitë që t'i zhvillojmë në lartësinë e duhur diskutimet pa të cilat zhvillimi i artit do të ndërpritej.

Në këtë drejtim detyra të mëdha dalin veçanërisht për komitetin e Partisë të qytetit të Tiranës, i cili duhet të marrë të gjitha masat e duhura për forcimin e përmirësimit e punës, për edukimin e gjithanshëm të inteligjencies artistike të kryeqytetit.

Detyra të mëdha e të vështira ka, pa dyshim, vetë organizata e punonjëseve krijuese, Lidhja e Shkrimtarëve dhe e Artistëve. Kjo shoqatë ka luajtur një rol të shënuar në grumbullimin, në mobilizimin dhe në edukimin e letrarëve dhe të artistëve të vendit tonë, në orientimin e përkrahjen që u ka dhënë atyre për realizimin e detyrës së tyre të madhe e fisnike. Por megjithkëtë në punën e Lidhjes së Shkrimtarëve dhe të Artistëve janë vërejtur të meta serioze, që kanë penguar mbarëvajtjen e punëve në atë shoqatë. Puna për orientimin ideologjik të problematikës së Lidhjes dhe për kalitjen ideologjike të anëtarëve të saj, në përgjithësi, ka qenë e mirë; por në disa raste ajo nuk ka qenë në nivelin e duhur dhe është bërë me gabime. Organet udhëheqëse të saj nuk kanë bërë atë që duhet për gjallërimin e jetës ideo-politike e profesionale të shoqatës për trajtimin në kohë e për zgjidhjen e drejtë të proble-

meve të ndryshme dhe përgjithësisht për përpunimin e për zhvillimin e mëtejshëm të mendimit estetik mbi letërsinë dhe artet në radhët e shkrimtarëve, artistëve dhe në të gjithë vendin tonë. Këto të meta shpjegohen, përveç të tjerave, edhe me mungesën e një pune të organizuar mirë në udhëheqjen e kësaj organizate dhe në aparatit e saj.

Duke marrë parasysh këto të meta e dobësi del e qartë se shokët komunistë që punojnë në Lidhjen e Shkrimtarëve dhe të Artistëve, në bazë të detyrave që shtron ky plenum, duhet të marrin sa më parë të gjitha masat e nevojshme për ta ndryshuar këtë gjendje dhe për ta ngritur punën e saj në nivelin e detyrave të mëdha dhe historike që ajo ka përpara.

Një kujdes të veçantë duhet të tregojë Lidhja e Shkrimtarëve dhe e Artistëve për organet e saj të shtypit, për gazetën «Drita» dhe për revistën «Nëntori». Puna e këtyre organeve për trajtimin e problemeve të letërsisë dhe të arteve dhe për formimin e opinionit të drejtë të masës, së cilës i drejtohen, është akoma e pamjaftueshme. Duke lexuar faqet e tyre, dhe veçanërisht ato të gazetës «Drita», duket qartë se aty disa herë botohen materiale të dobëta jo vetëm artistikisht, por edhe ideologjikisht, që jo vetëm nuk i sjellin ndonjë dobi letërsisë sonë, po ndikojnë për keq, prishin shijet e lexuesve. Gazeta «Drita» dhe revista «Nëntori» duhet të luajnë një rol shumë të madh në pasqyrimin e jetës artistike e kulture të vendit tonë, në orientimin dhe në nxitjen e shkrimtarëve që të përbushin detyrat e tyre, në zhvillimin e kritikës parimore letraro-artistike, në trajtimin e problemeve ideo-artistike që ka fronti ynë i letërsisë dhe i arteve si dhe në luftën kundër revizionizmit në letërsi dhe në arte.

Partia ka çmuar kurdoherë lart dhe ka përkrahur sukseset krijuese të shkrimtarëve, kompozitorëve, piktorëve, skulptorëve, aktorëve, regjizorëve, të artistëve të operës e të baletit, të kinematografisë, të cilët, të frymëzuar nga politika e saj, kanë krijuar vepra të denja për kohën tonë socialiste. Edhe në të ardhshmen Partia ka besim të patundur se këta artistë, të cilët janë bij besnikë të popullit të frymëzuar nga patriotizmi i lartë socialist, nga ndërgjegjja socialiste në punë, nga veprat heroike e madhështore të Shqipërisë socialiste, do të luftojnë me të gjitha forcat për të krijuar vepra të tjera të bukura e të denja të realizmit socialist. Partia ka besim të patundur se shkrimtarët dhe artistët tanë do të vënë të gjitha talentet e tyre për të përjetësuar në art heroizmin, krenarinë dhe lavdinë e popullit dhe të Partisë sonë.

Botohet sipas broshurës: Raport i Byrosë Politike të KQ të PPSH «Mbi rritjen e rolit të letërsisë dhe arteve për edukimin komunist të masave», mbajtur nga shoku Ramiz Alia.

Tiranë, 1965

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit» Nr. 258, 28 tetor 1965

V E N D I M

I PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH MBI APROVIMIN E RAPORTIT «MBI RRITJEN E ROLIT TË LETËRSISË DHE ARTEVE PËR EDUKIMIN KOMUNIST TË MASAVE»

26 tetor 1965

Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH, në mbledhjen e tij të datës 25—26.X.1965, pasi dëgjoi dhe diskutoi raportin e Byrosë Politike të Komitetit Qendror të PPSH «Mbi rritjen e rolit të letërsisë dhe arteve për edukimin komunist të masave», mbajtur nga anëtari i Byrosë Politike dhe sekretar i Komitetit Qendror të PPSH, shoku Ramiz Alia,

V e n d o s i :

Të aprovojë njëzëri raportin e mësipërm, i cili të shërbejë si program pune për përmirësimin e punës në sektorët e letërsisë dhe të arteve dhe në edukimin ideo-estetik të masave.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë.

V E N D I M

I BYROSË POLITIKE TË KQ TË PPSH «MBI LUFTËN KUNDËR BUROKRATIZMIT PËR NJË METODË DHE STIL REVOLUCIONAR NË PUNË»

24 dhjetor 1965

Komiteti Qendror i tërheq vëmendjen gjithë Partisë për nevojën e një lufte të vendosur, për masa rrënjësore kundër shtrembërimeve burokratike në organet e pushtetit dhe shfaqjeve të burokratizmit në vetë Partinë. Partia e ka konsideruar kurdoherë burokratizmin si të keqen më të madhe për aparatet shtetërore dhe të Partisë, sepse burokratizmi shpërndan aparatet nga masat, ndryshon iniciativën në punë, sidomos iniciativën e organeve lokale, degjeron vetë aparatet, duke e shndërruar atë në një maqinë të rëndë, të pamanevrueshme, zhduk demokracinë. Prandaj, gjatë gjithë ekzistencës së tyre, Partia dhe organet e pushtetit popullor, kanë zhvilluar vazhdimisht një luftë të papajtueshme me burokratizmin dhe shfaqjet e ndryshme të tij, kanë luftuar për perfeksionimin e vazhdueshëm të punës së aparateve tona. Sukseset në këtë drejtim kanë qenë të rëndësishme.

Megjithatë, organet shtetërore dhe të Partisë vazhdojnë të vuajnë nga sëmundja e burokratizmit, e cila përditë e më shumë po bëhet më kërcënuese dhe më e padurueshme. Ka ardhur koha që kundër saj të luftojmë në mënyrën më të organizuar, më me vendosmëri se asnjëherë, me masa rrënjësore dhe efektive.

Shtrembërimet burokratike në aparatet shtetërore janë jo vetëm trashëgim i së kaluarës, por në shumicën e rasteve ato janë një shprehje e presionit të armikut të klasës mbi aparatet tona. Ato janë gjithashtu një shfaqje e konservatorizmit, e mungesës së aftësive dhe të kulturës në punonjësit tanë. Lufta kundër burokratizmit duhet konsideruar si një nga format e rëndësishme të luftës së klasave. Prandaj, kundër tij duhet luftuar ashtu si edhe kundër armikut të klasës.

Në aparatet e Partisë elementët e burokratizmit lindin nga marrëdhënjet e aparateve të Partisë me ato të shtetit, nga tërheqja e një numri të madh anëtarësh të Partisë në punë administrative, nga ndikimi që ushtrohet mbi Partinë prej elementëve burokratë,

nga tendenca e ortakllëkut dhe paralelizmit në punë me organet shtetërore që vihet re në stilin e metodën e punës të aparateve të Partisë.

Detyrat madhështore që na dalin përpara, plani i katërt pesë-vjeçar që po hartojmë, fryma e përgjithshme e thirrjes së Komitetit Qendror dhe e Këshillit të Ministrave, si dhe zbatimi i plotë i çështjeve që shtrun ajo, nuk mund të arrihen kurrsesi po nuk likuiduam burokratizmin, po s'ndryshuam rrënjësisht metodën dhe stilin tonë të punës. Vrullit revolucionar të masave që ka shpërthyer me forcë të veçantë, t'i përgjigjemi me një punë drejtuese revolucionare që ta inkurajojë, ta organizojë dhe ta çojë atë akoma më përpara.

Me qëllim që të dëbojmë para së gjithash nga puna e Partisë shfaqjet e huaja të burokratizmit që organizatat e Partisë të bëjnë më me efikasitet luftën për zhdukjen e burokracisë në punën e aparateve shtetërore, Komiteti Qendror vendos që të fillohet me masa të rrepta e revolucionare në këtë drejtim në aparatet e Partisë, duke filluar nga aparati i Komitetit Qendror dhe menjëherë pastaj në shembullin dhe nën drejtimin e tyre, të bëhet ky operacion i thellë, i ndjeshëm dhe i fortë në organet shtetërore, duke filluar nga aparati i Këshillit të Ministrave e deri në ndërmarrjet.

I

Të zhvendosim qendrën e gravitetit të punës sonë nga puna me shkresa e vendime në punën e gjallë

Në qoftë se deri tani një pjesë të madhe të punës e kemi shpenzuar për të shkruar e studjuar raporte, letra e vendime, duke i lënë pak kohë punës së gjallë me njerëzit, punës vërtet të gjallë, efektive e të dobishme, në të ardhshmen duhet të bëjmë patjetër të kundërtën.

1. — Në Komitetin Qendror të Partisë dhe në komitetet e Partisë të rretheve të hiqet dorë një herë e mirë nga mbledhjet e tepërta dhe të ngarkuara me shumë çështje. T'i shtrohen udhëheqjes vetëm problemet kyçe që kërkojnë domosdo ndërhyrjen e saj. Më mirë pak, por mirë.

Në çdo rast materialet që i paraqiten udhëheqjes së Partisë duhet të jenë sa më të qarta dhe të zhveshura nga frazeologjia dhe konsideratat e përgjithshme. Materiali bazë dhe më i rëndësishëm duhet të jenë projektvendimet, ku në mënyrë të saktë e të qartë të shprehen masa konkrete që propozohen të merren nga udhëheqja e Partisë për problemin që shqyrton. Organi që paraqit projektin duhet të arësyetojë gojarisht me fakte dhe konkretisht ne-

vojën e marrjes së atij vendimi. Vetëm në rastin kur kërkohet nga udhëheqja, arësytimet mund të paraqiten me shkrim.

2. — Shkresat, relacionet, evidencat e tepërta e të panevojshme janë armiku kryesor i punës së gjallë, burimi kryesor i burokratizimit të kuadrit, të aparateve. Të braktisen ato me neveri, duke bërë një krasitje të rëndë dhe duke mbajtur vetëm minimumet e domosdoshme...

3. — Për të luftuar formalizmin në punën me kuadrin dhe për të rritur në këtë drejtim përgjegjësinë e organizatave bazë, organeve lokale të Partisë dhe organeve shtetërore, të bëhen ndryshime të thella në nomenklaturën e kuadrove...

Të rritet kujdesi e puna kolegjiale në shqyrtimin e çështjeve të kuadrit nga organet shtetërore, sidomos tani me zgjerimin e nomenklaturës së tyre dhe të forcohet kontrolli e ndihma e Partisë, duke e filluar këtë që nga organizatat bazë.

4. — Të konsiderohet si detyrë e dorës së parë kontrolli i zbatimit të përpiktë të vendimeve. Lenini mëson:

«Të kontrollojmë njerëzit dhe të kontrollojmë zbatimin e vërtetë të detyrës — këtu, edhe një herë këtu, vetëm këtu qëndron tani thelbi i gjithë punës, i gjithë politikës»¹.

Të hiqet dorë nga kontrolli prej «super-revizori» që bëjnë inspektorët dhe instruktorët e Komitetit Qendror dhe të komiteteve të Partisë. Kontrolli ynë duhet të shkrihet me organizimin në praktikë të zbatimit të vendimeve. Njëkohësisht, ai duhet të hedhë dritë jo vetëm mbi atë se si zbatohen detyrat, por dhe se ç'tregon praktika, si i shohin ato masat. Organet e Partisë dhe të pushtetit në rrethe janë të detyruara t'i zbatojnë vazhdimisht direktivat e Partisë dhe të qeverisë, si dhe urdhëresat e tyre, duke shtruar njëkohësisht përpara organeve qendrore çështjen e ndryshimeve që i duhet bërë ndonjë vendimi, nevoja e të cilave diktohet nga eksperiencia e bazës. Organet qendrore, të Partisë apo të pushtetit, duhet t'i shqyrtojnë me rreptësi dhe të zgjidhin menjëherë kërkesat që vijnë nga baza për korigjimin e ndonjë dispozite apo direktive të lëshuar nga lart. Pa një kombinim efektiv të vendimeve nga lart me eksperiencën e bazës, nuk mund të ketë drejtim të shëndoshë. Eksperiencia e verifikimit të zbatimit dhe eksperiencia lokale duhet të jenë baza për përmirësimin e mëtejshëm të punës së krejt aparatit shtetëror dhe ekonomik.

Ruajtja e vijës së Partisë në zbatimin e vendimeve, dëgjimi me kujdes i zërit të masës, i mendimeve dhe ankesave të tyre, organizimi i zbatimit të tyre e ndihma e organeve qendrore të pushtetit, puna e njerëzve dhe sidomos studimi dhe përhapja e eksperiencës

¹ V. I. Lenin. Veprat, vëll. 33, f. 245.

cës së përparuar — këto, mbi të gjitha, duhet të përbëjnë fushën e veprimt të kontrollit të Partisë.

Drejtoritë e Komitetit Qendror, si aparate të një organi, si rregull, duhet të veprojnë bashkërisht në kryerjen e funksionit të tyre të kontrollit në bazë. Si studimet, ashtu edhe kontrollet, zakonisht, të jenë frut i punës së përbashkët të disa drejtorive, apo i të gjitha drejtorive të Komitetit Qendror.

5. — Të kapërcehen me guxim pengesat që frenojnë iniciativën e punonjëseve, që ndrydhnin iniciativën e bazës. T'i jepet fund tutelës burokratike, si ndaj dikasterëve, ashtu edhe ndaj komiteteve të Partisë në rrethe. Çdo kuadër, çdo organ, të mbajë përgjegjësi të plotë për detyrat që i janë besuar. Ndarja e përpiktë e punës dhe caktimi i përgjegjësive, kompetencave dhe detyrave të çdo organi e të çdo personi, është një nga kushtet më të rëndësishme për përmirësimin e punës së aparateve të Partisë e të shtetit dhe për sigurimin e mundësive reale për verifikimin e zbatimit të vendimeve. Duhet t'i jepet fund me vendosmëri praktikës së dëmshme të monopolizimit të kompetencave dhe të dublimit të përgjegjësive. Duke filluar që nga kuadrot kryesorë të Partisë e të Këshillit të Ministrave e deri poshtë, secili të marrë përgjegjësi të plotë për punën e ngarkuar, të veprojë sipas kompetencave që i janë dhënë dhe të mbrojë kompetencat e tij, duke mos i lejuar askujt që t'ja marrë ato. Të kemi besim të madh te kuadrot, t'i ndihmojmë ato në rrugën e drejtë marksiste-leniniste që të kenë iniciativë, të kenë kurajë, të kenë guxim, t'i bëjmë me të vërtetë udhëheqës të zot për çdo situatë e rrethanë.

T'i jepet fund me vendosmëri praktikës jashtëzakonisht të përhapur deri tani, që ka zëvendësuar zgjidhjen e problemeve sipas kompetencave dhe përgjegjësive, që kanë organet e ndryshme, me vendime komisionesh të shumta, pa përgjegjësi, qofshin këto ndërdikasteriale ose të njëjtit dikaster. Një metodë e tillë pune zhduk mundësinë reale të verifikimit të zbatimit, shpërndan përgjegjësinë dhe krijon frymën demobilizuese të mbulimit reciprok pas njëri-tjetrit.

6. — Luftën e vendosur për respektimin e përgjegjësive dhe kompetencave të personave të ndryshëm, luftën për rritjen e iniciativës së kuadrove, luftën kundër skematizmit, konservatorizmit të dëmshëm, kundër rutinës dhe frikës për adoptimin dhe zbatimin e së resë, që diktojnë rrethanat e zhvillimit, modernizimi i sektorëve, zgjerimi i punëve dhe perspektivat e reja të dinamizmit revolucionar, duhet ta fillojnë të parët aparati dhe sekretarët e Komitetit Qendror dhe aparati e zëvendëskryetarët e Këshillit të Ministrave.

Përsa i përket aparatit të Komitetit Qendror, me qëllim që menjëherë të fillojë punën në frymën e sipërme, të merren këto masa:

a) Të hiqet dorë nga ajo mori protokolle, relacionesh, raportesh të mbledhjeve e kolegjiuemeve, nga tërë ato vendime që dërgon qeveria, nga tërë ato evidenca periodike e shkresa «për dijeni» që vijnë nga dikasteret, të cilat flasin jo vetëm për shkallën e burokracisë, në të cilën janë zhytur aparatet tona, por edhe për mungesën e iniciativës dhe të përgjegjësive.

b) Qeveria t'i dërgojë Komitetit Qendror vetëm vendimet më të rëndësishme; vetëm Komisioni i Planit dhe asnjë tjetër, të dërgojë në Komitetin Qendror një evidencë të përmbledhur mujore për realizimin e detyrave të planit.

c) Komitetit Qendror t'i ngrihen probleme të rëndësishme, me gojë, me telefon edhe me shkresë, kur duhet, por gjithmonë probleme të rëndësishme që kërkojnë ndërhyrjen e tij. As që mund të jepet recetë përse duhet informuar Komiteti Qendror e përse jo. Komitetet e Partisë, dikasteret dhe institucionet e tjera të gjejnë vetë çështjet e rëndësishme. Të jetë e qartë se sa e dëmshme është të ngarkosh udhëheqjen jashtë masës me çështje të panevojshme, aq e dëmshme dhe e rrezikshme është gjithashtu t'i presësh asaj çdo burim informacioni.

ç) Praktika ka provuar se caktimi nga lart i afateve për mbledhjet e ndryshme ka çuar në formalizëm. U lihet iniciativë e plotë të gjitha organeve të Partisë të bëjnë mbledhje kur duhet dhe përse duhet, duke respektuar parimet dhe normat e jetës së Partisë. Asnjë mbledhje të mos bëhet kur nuk nevojitet.

d) Të deleguarit e Komitetit Qendror ose punonjësit e aparatit të Komitetit Qendror që shkojnë në mbledhje të ndryshme të forumeve lokale të Partisë, nuk duhet të vënë dorë për të «rregulluar» e «korigjuar» raportet. Mendimet e tyre kritike ata t'i thonë në mbledhje. Të mos vihet dorë nga aparati, gjithashtu, mbi raportet që komitetet e Partisë të rretheve i paraqesin Byrosë Politike ose Sekretariatit të Komitetit Qendror.

dh) Ortakllëku, sidomos në marrëdhënjet e aparatit të Komitetit Qendror me dikasteret, ose të komiteteve të Partisë me komitetet ekzekutive të rretheve, është i huaj për metodën e punës së Partisë, ai dëmton punën, dobëson kontrollin e Partisë mbi këto organe, ul përgjegjësinë e kuadrove dhe organeve, shton burokratizmin, vonon zgjidhjen e çështjeve. Të hiqet dorë përfundimisht prej tij.

7. — Arma më e fuqishme për të luftuar me efikasitet burokratizmin dhe rutinën është arma e autokritikës dhe e kritikës nga poshtë-lart e nga lart-poshtë, e kritikës pa dallim pozite e personi.

Partia të edukojë punonjësit, e në radhë të parë komunistët që të jenë të papajtueshëm me çdo shfaqje të burokratizmit, me çdo shtrembërim burokratik të vijës së Partisë, të godasin me

forcë e pa mëshirë zvarritjet e palejueshme, talljet dhe sorollatjet burokratike, familjaritetin e sëmure, miqësitë personale, hatëret, shpërdoruesit, ryshfetçinjtë, shpërdoruesit e pozitës zyrtare, dëm-tuesit dhe dembelët, të godasin qëndrimet prej kapadaiu, mendje-madhi dhe arroganti të kujtdo qofshin, ndaj kërkesave të punonjës-ve. Kundër të gjithë atyre që do të pengojnë luftën kundër burokratizmit, që do të hakmerren për kritikën nga poshtë ose që do të shtypin kritikën, të merren masat më të rënda, deri në shkarkim nga postet që u janë besuar, duke ja bërë të njohura publikut këto masa nëpërmjet botimit të tyre në shtypin qendror.

Të mbahet gjithnjë parasysh parimi i njohur i ripërtritjes së vazhdueshme e të pandërprerë të aparateve tona. Të dëgjohet me kujdes zëri i punonjësve, sidomos i zgjedhësve, lidhur me punën e çdo nëpunësi apo funksionari të emëruar, apo të zgjedhur. Nuk duhen fetishizuar nomenklaturat, as opinionet e organeve apo kuadrove të veçantë drejtues për vartësit e tyre, por mbi të gjitha të merret parasysh opinioni i masave. Kur masat kritikojnë rëndë një person që nuk kryen detyrën, kur ato kërkojnë heqjen ose revokimin e tij (kur ky është i zgjedhur), organet udhëheqëse menjëherë duhet të marrin masat përkatëse, pavarësisht se kush është ky person, ta transferojnë atë, ta ulin në përgjegjësi dhe po të jetë çështja shumë serioze, edhe ta pushojnë.

8. — «Memurët» burokratë nxjerrin kokën më mirë se kudo kur vihen përballë punës së gjallë të masave. Ata që kërkojnë të zëvendësojnë punën e organizatave të gjera të pushtetit, të rinisë, bashkimeve profesionale, gruas e frontit, të kooperativave etj., me punën burokratike, të shkëputur nga masat, të drejtuesve të tyre, të kryetarëve apo sekretarëve, ata janë ca burokratë tipikë dhe asgjë më tepër. Organizatat e Partisë duhet të luftojnë që të gjallërohet demokracia e brendshme në këto organizata, të sigurohet sa më mirë tërheqja e të gjitha masave në diskutimin dhe drejtimin e çështjeve shtetërore. Vija e Partisë është vija e masave. Nga ana tjetër organet e Partisë duhet të përmirësojnë në mënyrë të gjithanshme drejtimin e këtyre organizatave, duke luftuar me vendosmëri kundër zëvendësimit të opinionit të masave me metodën e komandimit e të kujdestarisë mesquine nga ana e komiteteve të Partisë.

9. — Shtypi ynë, posaçërisht shtypi i Partisë, duhet si me kamzhik të fshikullojë burokratizmin dhe burokratët. Pa drojtje dhe gjithmonë me dinjitet, ai ta ngrejë zërin kundër kujtdo, pa përjashtim, që në një mënyrë ose në një tjetër ndihmon në burokratizimin e punëve tona. Komiteti Qendror e konsideron akoma të pamjaftueshme luftën që bën shtypi kundër sëmurdjes së burokratizmit.

Të shkulum nga rrënjët burokratizmin në aparatet shtetërore

Duke pasur parasysh se në aparatet shtetërore, të qendrës dhe të bazës, edhe për vetë natyrën e punës së tyre, burokratizmi si sëmurdje shfaqet më virulente dhe më e thellë, është e domosdoshme që nga Këshilli i Ministrave, në frymën e këtij vendimi, të organizohet mirë dhe shpejt puna për spastrim rrënjësor të shtrembërimeve burokratike, si në aparatet e Kryeministrit, ashtu edhe në ato të ministrive, organeve të tjera qendrore dhe të atyre të rretheve, shtetërore dhe ekonomike.

Është pikërisht koha që tërë Partia, gjithë kuadrot që punojnë në pushtet, t'i futen seriozisht luftës kundër burokratizmit për ta bërë aparatet shtetërore më të thjeshtë, më pak të kushtueshëm dhe më të lidhur me masat. Praktika ka vërtetuar se metoda e punës e aparatit shtetëror nuk përputhet plotësisht me detyrat madhështore që qëndrojnë para tij. Pesëvjeçari i katërt që po hartohet me pjesëmarrjen aktive të masave cakton detyra aq të mëdha, të cilat nuk do të mund të realizoheshin pa e bërë më të manevrueshëm, më operativ, pa e lidhur më mirë me punonjësit, pa e zhveshur nga burokratizmi gjithë aparatet shtetëror, atë ekzekutiv dhe planifikues.

Shtrembërimet burokratike në aparatet shtetërore, moszgjidhja në kohë dhe drejt e kërkesave të masave, shikimi i ngushtë i problemeve nën prizmin dikasterial, pa parë interesin e përgjithshëm të punonjësve, hatëret dhe akrobllëqet, zëvendësimi i punës së gjallë me shkresat e letrat pa mbarim, të gjitha këto, s'duhet harruar, shtrembërojnë në sytë e masave natyrën e vërtetë të pushtetit tonë popullor. Prandaj, kundër tyre duhet luftuar pa mëshirë e deri në fund.

Për këto arsye ngarkohet Këshilli i Ministrave që jo më vonë se brenda muajit janar 1966 të përcaktojë masat konkrete lidhur me luftën kundër burokratizmit në aparatet shtetërore, duke pasur parasysh parimet kryesore që theksohen në këtë vendim.

Komiteti Qendror i rekomandon Këshillit të Ministrave në mënyrë të veçantë të ketë parasysh çështjet e mëposhtme:

1. — Të pakësojë deri në minimumin e domosdoshëm të gjitha shkresat, raportet, evidencat e panumërta që shkëmbehen nga lart-poshtë e nga poshtë-lart, të cilat kanë gozhdur kuadrot dhe specialistët më të mirë nëpër zyra.

2. — Të shihen me shumë vëmendje, me qëllim që të spastrohen dhe të flaken tej, edhe ato ligje, urdhëresa, rregullore e udhëzime të ndryshme që janë formuluar gjatë shumë vjetëve dhe që

sot në praktikën e punës janë bërë të panevojshme dhe janë kthyer në një pengesë serioze për perfeksionimin e aparateve tona shtetërore. Edukimi i punonjësve të aparateve shtetërore me ndjenjen e përgjegjësisë ndaj detyrës si dhe mësimi i shkencës së administrimit të punëve në shtet, në asnjë mënyrë nuk mund dhe nuk duhet të kodifikohet.

3. — Të rishikohen me kujdesin më të veçantë dhe të përcaktohen qartë detyrat, kompetencat dhe përgjegjësitë e zëvendëskryeministrave dhe ministrave, duke pasur parasysh se elementë të tillë të burokratizmit, si centralizimi i tepruar, monopolizimi i kompetencave, tutela burokratike mbi ministritë e ndryshme, mungesa e përcaktimit të përgjegjësisë konkrete, zëvendësimi i udhëheqjes së gjallë me mbledhje, komisione e shkresa, organizimet dhe riorganizimet e tepruara të aparatit shtetëror, janë bërë tashmë të padurueshme.

4. — Të përcaktohen qartë nga çdo ministri dhe organ qendror përgjegjësitë dhe kompetencat e zëvendëskryeministrave, drejtorive, degëve dhe kështu me radhë, të pastrohen këto nga shkresat burokratike, të përcaktohen marrëdhënjet, detyrat dhe të drejtat e tyre në lidhje me bazën dhe sektorin që drejtojnë, në mënyrë që të dalin qartë se cilat janë problemet kyçe dhe detyrat e udhëheqjes së ministrisë, të kolegjiut, të drejtorive a degëve dhe cilat janë detyrat e bazës dhe lidhjet e saja me dikasterin. Mbi këtë bazë, çdo dikaster të mund të përcaktojë metodën e kontrollit, përgjegjësitë, ndihmën bazës etj.

5. — Të çlirohen komitetet ekzekutive nga ato detyrime të tepruara ndaj dikastereve dhe organeve qendrore dhe të përcaktohen më qartë kompetencat e tyre, të cilat u duhen shtuar. Puna e gjallë, zbatimi i detyrave — kjo duhet të jetë detyra themelore e këtyre organeve dhe jo shkresat.

6. — Në luftën kundër burokratizmit në aparatet shtetërore të tërhiqen gjithnjë e më shumë masat punonjëse. Të forcohet kontrolli i tyre mbi tërë punën tonë, të tërhiqen ato sa më shumë, nëpërmjet formave ekzistuese dhe të tjerave që mund të nxjerrë jeta, për të drejtuar punët e përgjithshme të shtetit. Pa pjesëmarrjen direkte të masave, nuk mund të luftohet burokratizmi. Çdo luftë tjetër kundër burokratizmit, që nuk mbështetet mbi aktivitetin e masave dhe veçanërisht të klasës punëtore dhe Bashkimeve të tyre Profesionale, që mundohet ta zëvendësojë kontrollin e vetë punëtorëve apo punonjësve me veprimtarinë vetëm të një organi, qoftë ky edhe nga më të ndërgjegjshmit, nuk mund të japë asnjë rezultat serioz për një përmirësim të vërtetë të punës së aparatit shtetëror. Në mënyrë të veçantë në këtë drejtim dhe në luftën kundër burokratizmit duhet të orientohet Komisioni i Kontrollit të Shtetit, i cili duhet të heqë dorë nga funksionet e thjeshta të «revizorit».

Disa çështje të veçanta

1. — Në frymën e thirrjes së Komitetit Qendror dhe Këshillit të Ministrave, si dhe të këtij vendimi, të merren masa për luftimin e formalizmit dhe zyrtarizmit në punën ideo-politike dhe organizative të Partisë. Të likuidohet mithi i formës. Të lihen mënjanë ato forma të vjetëruara e që janë bërë pengesë dhe të futen me iniciativë forma të reja, të dobishme. Në asnjë mënyrë të mos qëndrohet skllav i formës.

2. — Mbështetur në këtë vendim komitetet e Partisë në rrethe të rishikojnë menjëherë punën e tyre dhe pa humbur kohë të marrin masa e të zhvendosin punën e tyre nga shkresat e letrat, nga evidencat e statistikat, në punën e gjallë me njerëzit, në zbatimin e vendimeve dhe ligjeve të Partisë dhe të shtetit. Propozimet eventuale që organet qendrore të Partisë e të pushtetit mund të kenë, lidhur me luftën kundër burokratizmit, t'i bëjnë pa humbur kohë. Komitetet e Partisë t'u kushtojnë kujdes organizatave të Partisë, të cilat kudo ku veprojnë, në ndërmarrje, në administratë apo institucion arësivor e kultural, duhet të tregohen luftëtare të vendosura kundër burokratizmit, ta shkallmojnë atë kudo që të shfaqet dhe në çdo formë që të shfaqet. Komunistët duhet të jenë në ballë të kësaj lufte. Organizatat e Partisë duhet ta kenë të qartë se komunistët që nuk e studjojnë dhe nuk duan të studjojnë seriozisht artin e të qeverisurit, që punojnë në mënyrë të përciptë, pa hyrë në thelbin e punës që u është ngarkuar, shpeshherë shndërrohen në bisht dhe maskë për burokratët dinakë. Këta komunistë, të cilët kujtojnë se drejtojnë dhe qeverisin, në realitet janë pseudo-komunistë, që veprojnë jo sipas mësimave të Partisë, por sipas pikëpamjeve të huaja për karakterin e pushtetit popullor, ata i shkarkojnë dëmin më të madh ndërtimit të socializmit.

3. — Masat që po merr Komiteti Qendror për luftën kundër burokratizmit patjetër do të kursejnë kohën e punës. Pra, do të dalë problemi i një rishpërndarjeje të drejtë të njerëzve, si edhe problemi i shkurtimit të organikave. Organet udhëheqëse të Partisë e të pushtetit, në qendër e në bazë, duhet të organizojnë punën që punonjësit, të cilët deri tani të shumtën e kohës e harxhonin në «punë» me letra e shkresa, tani të merren me punë konkrete, të gjallë, me punë me njerëzit. Ndryshe këta kuadro do ta ngjallin përsëri burokratizmin, në mënyrë që të justifikojnë qenjen e tyre në postin që zënë. Organet udhëheqëse të Partisë e pushtetit duhet t'i dalin përpara kësaj pune, duke parë edhe mundësinë e shkurtimit të organikave nga njerëzit që dalin të tepërt në punë, të cilët të dërgohen menjëherë në prodhim.

4. — Të jetë e qartë për të gjithë se Komiteti Qendror i merr këto masa jo për të «lehtësuar barrën» e për të dobësuar e dëmtuar punën. Përkundrazi bëhet një krasitje e rëndë e të gjitha atyre gjërave të padobishme, që të mund ta bëjmë gjithnjë e më mirë punën tonë për zbatimin e vijës së drejtë të Partisë, për lumturinë e popullit tonë, për ndërtimin e plotë të shoqërisë socialiste. Me këtë operacion të thellë, Komiteti Qendror kërkon të qërohen që nga rrënjët ferrat dhe gjembat që na pengojnë. Zhvendosja e qendrës së gravitetit të punës sonë nga shkresat në punën e gjallë me njerëzit dhe në kontrollin sistematik për zbatimin e ligjeve të shtetit, urdhëresave të qeverisë e direktivave të Partisë, nuk është vetëm një nga mjetet më të rëndësishme të luftës kundër burokratizmit dhe rutinës, por edhe një nga mjetet më të rëndësishme, që sigurojnë zbatimin e drejtë të vijës klasore në punën e gjithë organeve shtetërore. Organizimi i një verifikimi sistematik të zbatimit dhe të respektimit të ligjshmërisë revolucionare duhet të jetë detyra më e rëndësishme për të gjitha organet e Partisë, organet shtetërore dhe ekonomike të të gjitha shkallëve.

E tërë kjo punë duhet të çlirojë kuadrot nga burokratizmi, por jo nga detyrat, t'i ndihmojë ata të shohin drurët dhe jo fletët, ta ndjejnë veten përgjegjës dhe të vënë përpara përgjegjësisë të tjerët, t'u lihet iniciativë në punë e në mendime, t'u hiqet tutela burokratike, të kuptojnë centralizmin e vërtetë demokratik dhe jo centralizmin burokratik. Kjo do të krijojë një stil dhe një metodë të re pune që nuk mund ta kodifikojmë e ta fusim në formulime «të reja». Format do të gjallërohen, do të zhvillohen, nuk do të jenë kudo stereotipe. I njëjtë do të jetë e do të mbetet orientimi bazë i punës, direktiva dhe qëllimet që synohet të arrihen, ruajtja e parimeve bazë në çdo drejtim.

Kjo duhet të kuptohet si forcim i punës, si një disiplinë e vërtetë pune dhe jo shturje; kjo duhet të kuptohet si një kërkesë e vërtetë llogarie nga poshtë-lart dhe anasjelltas; kjo duhet të kuptohet si forcim dhe jo si dobësim i disiplinës; kjo duhet të kuptohet si forcim dhe jo si dobësim i centralizmit të vërtetë demokratik.

5. — U rekomandohet Komisionit Qendror të Revizionimit dhe Komitetit të Kontrollit të Partisë që të ndjekin me kujdes punën që do të bëhet në Komitetin Qendror dhe në komitetet e Partisë të rretheve për luftimin e burokratizmit, si dhe konkretisht për zbatimin e këtij vendimi.

Populli thotë shpesh «ujët del i pastër nga burimi, por turbullohet rrugës» duke dashur të tregojë me këtë punën e pastër që bëhet në qendër. S'ka dyshim se në përgjithësi vija jonë e për-

gjithshme ka qenë kurdoherë dhe mbetet e drejtë dhe e pastër si kristali. Por, duhet pranuar gjithashtu se në shumë raste, me metodën tonë të punës kemi ndikuar që këtej nga lart për turbullimin e ujit. Vetë e kemi krijuar këtë situatë — vetë duhet dhe mundet plotësisht ta korrigjojmë. Të luftojmë, pra, me guxim dhe frymë revolucionare kundër së keqes së burokratizmit.

Ky vendim le të japë sinjalin për një hov të ri të vrullshëm dhe të pandërprerë në përmirësimin e metodës dhe stilit të punës.

*
* * *

Me këtë vendim të Komitetit Qendror ne hedhim vetëm hapin e parë në luftën kundër burokratizmit, për likuidimin e shkresave dhe të letrave, për përmirësimin e mëtejshëm të stilit në punë, karakteristika e të cilit duhet të jetë puna e gjallë dhe verifikimi i zbatimit të vendimeve. Nuk ka dyshim se në punë e sipër, me eksperiencën që do të grumbullojmë, masa të tjera do të duhet të marrim, pastrime të tjera do të duhet të bëjmë, sulme edhe më të ashpëra do të duhet të drejtojmë kundër burokratizmit e rutinës. Prandaj lufta kundër burokratizmit nuk është një fushatë e përkohshme. Kjo përbën një detyrë të përhershme për gjithë Partinë dhe për organet e pushtetit. Nga ana tjetër, lufta kundër burokratizmit nuk duhet të kufizohet vetëm në neveritjen e shkresave dhe të letrave. të evidencave dhe mbledhjeve të panevojshme. Ky do të ishte një kuptim shumë vulgar e i thjeshtësuar i burokratizmit. Burokratizmi dhe lufta kundër tij duhen parë ngushtë me stilin dhe metodën e punës, me mënyrën e të menduarit, me konceptet e njerëzve mbi detyrën, mbi përgjegjësinë, mbi rolin e udhëheqësit dhe organizatorit të masave, mbi funksionin e «shërbëtorit të popullit» etj., etj. Si rrjedhim, lufta kundër burokratizmit duhet të na sjellë jo vetëm pakësimin e letrave e shkresave, por edhe një stil e metodë pune më të zhdërvjelltë, më revolucionare, më aktive e të gjallë, duhet të sjellë ndryshimin në konceptet e komunistëve dhe të kuadrove lidhur me rolin e tyre si udhëheqës e organizatorë të masave.

Duke marrë parasysh rëndësinë jashtëzakonisht të madhe të këtij dokumenti, Komiteti Qendror i Partisë porositi komitetet e Partisë, organizatat bazë dhe gjithë komunistët, se do të ishte e pamjaftueshme që ky vendim të lexohej apo të shqyrtohej vetëm në një mbledhje të komitetit të Partisë, apo të organizatës bazë. Këtë dokument duhet ta ketë parasysh në çdo hap të veprimtarisë së vet çdo komunist dhe çdo organ udhëheqës.

Komiteti Qendror është i bindur se si kurdoherë e gjithë Partia, të gjithë kuadrot e vendit tonë, do të zbatojnë me ndër-gjegje të plotë dhe menjëherë këtë vendim të rëndësishëm.

PËR BYRONË POLITIKE TË KQ TË PPSH
SEKRETARI I PARË

ENVER HOXHA

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

TREGUESI I LËNDËS

Faqe

Parathënje. 5

1961

1. Plenumi II i KQ të PPSH, Tiranë, 30 qershor — I korrik 1961. . .
Vendim i Plenumit të KQ të PPSH «Mbi masat që
duhen marrë për forcimin e mëtejshëm të regjimit të
kursimit». 9
2. Letër e KQ të PPSH dhe e Këshillit të Ministrave të RPSH drej-
tuar KQ të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe Këshi-
llit të Ministrave të Bashkimit Sovjetik ku zbulohen shkaqet e
vërteta të keqësimit të marrëdhënjeve shqiptaro-sovjetike.
6 korrik 1961. 25
3. Deklaratë e Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë
mbi çështjen e përfundimit të Traktatit të Paqes me Gjermaninë.
7 gusht 1961. 62
4. Promemorje e KQ të PPSH drejtuar KQ të Partisë Komuniste të
Bashkimit Sovjetik lidhur me vendimin e padrejtë të Qeverisë
Sovjetike për prerjen e bursave dhe dëbimin nga Bashkimi Sovje-
tik të studentëve shqiptarë. 16 shtator 1961. 70
5. Plenumi IV i përbashkët i Komitetit Qendror të PPSH dhe i Ko-
mitetit Qendror të BRPSH. Tiranë, 25—26 shtator 1961 72
Vendim i Plenumit të KQ të PPSH «Mbi forcimin e më-
tejshëm të punës për edukimin komunist të rinisë dhe
mobilizimin e saj për ndërtimin e plotë të shoqërisë
socialiste në vendin tonë». 73

615

	Faqe
6. Letër e KQ të PPSH drejtuar KQ të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik në përgjegje të letrës shpifëse të udhëheqjes së PK të BS të 24 gushtit 1961. 12 tetor 1961.	92
7. Deklaratë e KQ të PPSH kundër sulmit dhe shpifjeve të N. Hrushovit në Kongresin XXII të PK të BS, 20 tetor 1961.	153
1962	
8. Plenumi VI i KQ të PPSH. Tiranë, 24—25 janar 1962 Vendim i Plenumit të KQ të PPSH «Mbi rezultatet e plotësimit të planit dhe të buxhetit të shtetit për vitin 1961 dhe mbi masat që duhen marrë për plotësimin e detyrave të planit dhe të buxhetit të vitit 1962.» ..	156 157
9. Vendim i Komitetit Qendror të PPSH «Mbi zhvillimin e mëtejshëm të fiskulturës e sportit». 1 mars 1962.	171
10. Plenumi VII i KQ të PPSH. Tiranë, 18—19 korrik 1962 Vendim i Plenumit të KQ të PPSH «Mbi përmirësimin e mëtejshëm të punës për përgatitjen dhe kualifikimin e kuadrit».	180
11. Plenumi VIII i KQ të PPSH. Tiranë, 26—28 tetor 1962 Raport i Byrosë Politike të KQ të PPSH «Mbi masat për zhvillimin e mëtejshëm të bujqësisë për sigurimin e rritjes së vazhdueshme të prodhimit bujqësor». Vendim i Plenumit të KQ të PPSH mbi aprovimin e raportit «Mbi masat për zhvillimin e mëtejshëm të bujqësisë për sigurimin e rritjes së vazhdueshme të prodhimit bujqësor».	201 202 283
12. Vendim i KQ të PPSH, i Presidiumit të Kuvendit Popullor dhe i Këshillit të Ministrave të RPSH mbi 50-vjetorin e shpalljes së pavarësisë. 19 nëntor 1962.	284
1963	
13. Plenumi IX i KQ të PPSH. Tiranë, 25—26 janar 1963 Komunikatë.	295
14. Plenumi X i KQ të PPSH. Tiranë, 6—8 qershor 1963 Raport i mbajtur nga Sekretari i Parë i KQ të PPSH,	296

	Faqe
shoku Enver Hoxha «Mbi gjendjen ekonomike, sociale e kulturele të fshatit dhe masat për ngritjen e mëtejshme të saj».	297
Vendim i Plenumit të KQ të PPSH mbi aprovimin e raportit «Mbi gjendjen ekonomike, sociale e kulturele të fshatit dhe masat për ngritjen e mëtejshme të saj».	386
15. Plenumi XI i KQ të PPSH. Tiranë, 13—14 dhjetor 1963 Raport i Byrosë Politike të KQ të PPSH «Mbi forcimin e mëtejshëm të Partisë».	387 388
1964	
16. Plenumi XII i KQ të PPSH, Tiranë, 11-12 shkurt 1964 Komunikatë.	450
17. Plenumi XIII i KQ të PPSH, Tiranë, 7—9 korrik 1964 Raport i Byrosë Politike të KQ të PPSH «Mbi forcimin e mëtejshëm të punës ideologjike të Partisë për edukimin komunist të punonjësve». Vendim i Plenumit të KQ të PPSH mbi aprovimin e raportit «Mbi forcimin e mëtejshëm të punës ideologjike të Partisë për edukimin komunist të punonjësve».	451 502
1965	
18. Plenumi XIV i KQ të PPSH, Tiranë, 18—19 shkurt 1965. Raport i Byrosë Politike të KQ të PPSH «Mbi përfundimet e planit dhe të buxhetit të shtetit për vitin 1964 dhe detyrat e planit të buxhetit për vitin 1965» Vendim i Plenumit të KQ të PPSH mbi aprovimin e raportit «Mbi përfundimet e plotësimit të planit dhe të buxhetit të shtetit për vitin 1964 dhe detyrat e planit dhe të buxhetit për vitin 1965».	504 505 538
19. Thirrje e Komitetit Qendror të PPSH dhe e Këshillit të Ministrave të RPSH mbi pjesëmarrjen e masave popullore për diskutimin dhe hartimin e planit të katërt pesëvjeçar të zhvillimit të ekonomisë dhe kulturës për periudhën 1966—1970, 23 tetor 1965. ..	539
20. Plenumi XV i KQ të PPSH. Tiranë, 25—26 tetor 1965 Raport i Byrosë Politike të KQ të PPSH «Mbi rritjen e	558

	Faqë
rolit të letërsisë dhe arteve për edukimin komunist të masave»	559
Vendim i Plenumit të KQ të PPSH mbi aprovimin e raportit «Mbi rritjen e rolit të letërsisë dhe arteve për edukimin komunist të masave»	602
21. Vendim i Byrosë Politike të KQ të PPSH «Mbi luftën kundër burokratizmit për një metodë dhe stil revolucionar në punë». 24 dhjetor 1965.	603
1961	
16. Plenumi XII i KQ të PPSH, Tiranë, 11-13 shtator 1961	
17. Plenumi XIII i KQ të PPSH, Tiranë, 17-9 shtator 1961	
18. Plenumi XIV i KQ të PPSH, Tiranë, 18-19 shtator 1961	
1962	
19. Plenumi XV i KQ të PPSH, Tiranë, 23-25 shtator 1962	
20. Plenumi XVI i KQ të PPSH, Tiranë, 23-25 shtator 1962	
19. Tërësi e Komitetit Qendror të PPSH dhe e Komitetit të Ministrave të PPSH mbi përcaktimin e masave për përkrahjen dhe partizanëve gjatë të kalimit përvojës në ndërtimin të ekonomisë dhe kulturës për periudhën 1960-1970. 23 shtator 1962 ..	
20. Plenumi XVII i KQ të PPSH, Tiranë, 23-25 shtator 1962	

Tirazhi 20.000 kopje

Format 60x92/16

Stash: 2204-65

Shtyp. NISH. Shtypshkronjave «MIHAL DURI»
Stabilimenti «8 NËNTORI» — Tiranë, 1970